Grup autorësh

LIBËR PËR MËSUESIN

Abetare e përbashkët Shqipëri - Kosovë

BOTIME

pegi

Përmbajtje

Plani mësimor vjetor	5
Plani tremujor Shtator-Dhjetor	15
Plani tremujor Dhjetor-Mars	23
Plani tremujor Mars-Qershor	31
Planifikimi ditor për Paraabetaren	39
Test për Paraabetaren	103
Planifikimi ditor për Abetaren	105
Test 1 për Abetaren	229
Test 2 për Abetaren	454
Planifikimi ditor për Pasabetaren	526
Test vjetor	618

Plani mësimor

Lënda : Abetare mbarëkombëtare

Numri i orëve mësimore sipas tematikave
35 orë x 8 orë / javë = 280orë

Tematika	Orë
Të dëgjuarit	10 orë
Të folurit	10 orë
Të lexuarit	160 orë
Të shkruarit	70 orë
Përdorimi i drejtë i gjuhës	30 orë
Gjithsej	280 orë

Fusha : Gjuhët dhe komunikimi
Lënda: Gjuhë shqipe

Rezultatet kryesore të të nxënit sipas kompetencave kyçe që realizohen nëpërmjet lëndës së gjuhës shqipe gjatë shkallës 1

Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit
▪ ritregon ngjarjen e një teksti të dëgjuar, përmbajtja e të cilit nuk është më shumë se një faqe teksti; ▪ shpreh me gojë dhe me shkrim për 3-5 minuta para moshatarëve dhe të tjerëve përjetimet dhe emocionet që e kanë shoqëruar gjatë shikimit të një filmi ose dokumentari, dëgjimit të një tregimi apo përralle; ▪ paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup; ▪ lexon me zë një tekst së paku prej gjysmë faqeje të pa lexuar më parë; ▪ shkruan një tekst të shkurtër (gjysmë faqe për një temë të caktuar); ▪ shpreh mesazhin e një teksti të thjeshtë letrar, përmes njërës nga format shprehëse: të folurit, shkrimit, dramatizimit (lojë me role); ▪ identifikon personazhet kryesore të një tregimi, drame apo filmi dhe luan rolin e njërit prej personazheve në bashkëveprim me moshatarët;
Kompetenca e të menduarit
▪ sqaron me anë të të folurit hapat e zgjidhjes së një problemi të thjeshtë, me të cilin ballafaqohet në një situatë jetësore;
Kompetenca e të nxënit
▪ ndjek udhëzimet e dhëna në një tekst për të realizuar një veprim / aktivitet / detyrë, që kërkohet; ▪ parashtron pyetje dhe përgjigjet në pyetjet për temën /problemin/ detyrën e dhënë në njërën nga format e të shprehurit; ▪ zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes; ▪ mbikëqyr në mënyrë të pavarur përparimin e vet në një detyrë, aktivitet duke përdorur teknika të ndryshme për gjetjen e gabimeve (si shënim të gabimeve - vështirësive) dhe i korrigjon ato derisa gjen zgjidhjen; ▪ grumbullon dhe klasifikon materialet e performancës së vet, për përgatitjen apo pasurimin e portofolit personal;
Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin
1. përgatit një plan të thjeshtë ditor me shkrim, për dy- tri aktivitete ditore, duke pasur parasysh kohën, vendin, materialet dhe mjetet e nevojshme për kryerjen e detyrës;

2. gjen të përbashkëtat dhe ndryshimet ndërmjet aktiviteteve, që organizohen në shkollë me ato në shtëpi dhe i përshkruan në mënyrë individuale përmes njërës nga format e të shprehurit duke i diskutuar në grup; **3.** identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në shtëpi;
Kompetenca personale
bashkëpunon me të tjerët pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitetet në klasë, shkollë apo jashtë saj;
Kompetenca qytetare
diskuton dhe në bashkëpunim me anëtarët e grupit vendos rregullat e punës në grup; shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive, vendos duke bashkëpunuar me të gjithë anëtarët për mënyrat që çojnë drejt përfundimit të një aktiviteti të caktuar;
Kompetenca digjitale
ritregon ngjarjen e një teksti të dëgjuar (nga mjetet audio-vizuale), përmbajtja e të cilit të mos jetë më shumë se një faqe teksti; realizojnë punime origjinale, vetjake duke përdorur figurat e gjetura nga burime informacioni, si një formë për të shprehur emocionet e tyre.

Rezultatet kryesore të të nxënit sipas kompetencave të fushës

KOMPETENCA: Të dëgjuarit e teksteve të ndryshme

Nxënësi/ja:

- Demonstron të kuptuarit e teksteve që dëgjon në situata të ndryshme;
- Ritregon me fjalët e tij përmbajtjen ose informacionin kryesor të një bisede, poezie, përralle, tregimi, rregulle praktike ose udhëzimi.

KOMPETENCA: Të folurit për të komunikuar dhe për të mësuar

Nxënësi/ja:

- Flet rrjedhshëm, kuptueshëm dhe me intonacionin e duhur, kur tregon një ngjarje, një përvojë të tijën ose kur përshkruan diçka etj.;
- Diskuton në grupe të vogla për tema që i interesojnë, bën pyetje dhe jep përgjigje të thjeshta;
- Përgatit materiale për organizimin e shfaqjeve dhe ekspozitave në klasë;
- Merr pjesë në lojë me role.
- Shqipton saktë dhe me intonacionin e theksin e duhur fjalët dhe fjalitë;
- Shprehet saktë, kuptueshëm dhe me fjali të plota, kur bën një kërkesë, pyet, sqaron, kërkon ndjesë, falënderon dhe u përgjigjet pyetjeve;
- Reciton vjersha të shkurtra, të mësuara përmendsh;

KOMPETENCA: Të lexuarit e teksteve letrare dhe joletrare

Nxënësi/ja:

- Përdor strategjitë e duhura për të lexuar tekste të thjeshta, mëson fjalë të reja, dallon fjalën, fjalinë dhe paragrafin;
- Lexon me zë një tekst të shkurtër dhe tregon funksionin e pjesëve plotësuese të tekstit (p.sh., foto, vizatim, pamje etj.);
- Tregon brendinë duke respektuar strukturën e tekstit ose parafrazon tekstin;
- Jep përshtypjet e veta në lidhje me një tekst të shkurtër letrar (poezi, përralla nga folklori, përralla nga autorë të ndryshëm, tregime, fabula) dhe joletrar (si p.sh., kalendar, fjalor i thjeshtë).

Kompetenca: Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale

Nxënësi/ja:

- Shkruan për të komunikuar idetë e veta te të tjerët nëpërmjet fjalëve, fjalive etj.;
- Shkruan tekste të thjeshta (urim, letër, kartolinë) sipas modeleve të dhëna.
- Shkruan fjalë dhe fjali me të diktuar;
- U përgjigjet me shkrim pyetjeve të thjeshta.
- Shkruan për tema të përshtatshme për moshën e tij;
- Shkruan një tekst të shkurtër.

Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës

Nxënësi:

- Dallon dhe formon fjali të thjeshta dëftore dhe pyetëse, duke respektuar shenjat e pikësimit;
- Dallon emra njerëzish, sendesh dhe kafshësh në numrin njëjës dhe shumës;
- Zgjedhon folje të rregullta në kohën e tashme, sipas modeleve të dhëna;
- Dallon mbiemrin si fjalë, që tregon cilësi të emrit;
- Gjen dhe formon fjali me përemra vetorë dhe me numërorë.

FUSHA: GJUHËT DHE KOMUNIKIMI
LËNDA: GJUHA SHQIPE

Tematikat	Shpërndarja e përmbajtjes së lëndës		
	Shtator – Dhjetor (93 orë)	**Janar – Mars (93 orë)**	**Prill – Qershor (94 orë)**
Të dëgjuarit Të folurit Të lexuarit Të shkruarit Përdorimi i drejtë i gjuhës	1. Abetarja ime : Unë jam 2. Tingulli dhe shkronja A: Drejt shkollës 3. Tingulli dhe shkronja I: Drejt shkollës 4. Tingulli dhe shkronja M: Drejt shkollës 5. Tingulli dhe shkronja N: Në shtëpi 6. Tingulli dhe shkronja E, Ë: Në shtëpi 7. Tingulli dhe shkronja B: Në mëngjes 8. Tingulli dhe shkronja F: Në fshat 9. Tingujt dhe shkronjat C, Ç 10. Tingujt dhe shkronjat H,U 11. Tingulli dhe shkronja D,DH: Kalendari i ditëlindjeve 12. Tingulli dhe shkronja K: Kafshët 13. Tingulli dhe shkronja J: Kafshët 14. Tingulli dhe shkronja G: Në garë 15. Tingulli dhe shkronja Gj: Gjëegjëza 16. Tingulli dhe shkronja L, Ll: Luajmë 17. Tingulli dhe shkronja P 18. Rimarrje, përsëritje, kontroll 19. Tingulli dhe shkronja NJ 20. Tingulli dhe shkronja O, Q. Qyteti 21. Tingulli dhe shkronja R, RR. Në rrugë 22. Tingulli dhe shkronja S. Qyteti 23. Tingulli dhe shkronja SH. Shkronjat 24. Tingulli dhe shkronja T. Mjetet e udhëtimit 25. Tingulli dhe shkronja TH. 26. Tingulli dhe shkronja X. Në garë 27. Tingulli dhe shkronja XH. 28. Tingulli dhe shkronja V. 29. Tingulli dhe shkronja Y. 30. Tingulli dhe shkronja Z. 31. Tingulli dhe shkronja Zh. **32. Rimarrje, përsëritje, kontroll**	**1.** Punim i faqes 43 të Abetares **2.** Punim i shkronjës B, b faqe 44 të Abetares **3.** Punim e shkrim i shkronjës B, b, Abetare pune faqe 35 **4.** Punim e lexim i shkronjës B, b faqe 45 të Abetares **5.** Ushtrime aplikative për shkrim dore, shkronja B, b. **6.** Punim i faqes 44-45 të Abetares. Burrë bore. **7.** Punim i shkronjës H, h faqe 46 të Abetares. **8.** Punim e shkrim i shkronjës H, h, Abetare pune faqe 36 **9.** Punim e lexim i shkronjës H, h faqe 47 të Abetares. **10.** Ushtrime aplikative për shkrim dore, shkronja H, h. **11.** Punim i faqes 46-47 të Abetares. Bisedë me Hënën. **12.** Punim i shkronjës T, t faqe 48 të Abetares. **13.** Punim e shkrim i shkronjës T, t, Abetare pune faqe 37 **14.** Punim e lexim i shkronjës T, t faqe 49 të Abetares. **15.** Ushtrime aplikative për shkrim dore, shkronja T, t. **16.** Punim i faqes 48-49 të Abetares .Kompjuteri. **17.** Punim i shkronjës S, s faqe 50 të Abetares. **18.** Punim e shkrim i shkronjës S, s,	**1.** Punim e shkrim i shkronjës C, c, Abetare pune faqe 53 **2.** Punim e lexim i shkronjës C, c faqe 81 të Abetares **3.** Ushtrime aplikative për shkrim dore, shkronja C, c. **4.** Punim i faqes 80 - 81 të Abetares. Ola dhe trumcaku. **5.** Punim i shkronjës Ç, ç faqe 82 të Abetares **6.** Punim e shkrim i shkronjës Ç, ç, Abetare pune faqe 54 **7.** Punim e lexim i shkronjës Ç, ç faqe 83 të Abetares **8.** Ushtrime aplikative për shkrim dore, shkronja Ç, ç. **9.** Punim i faqes 82 - 83 të Abetares. Palaçoja në shitore. **10.** Punim i faqes 84 të Abetares **11.** Punim i faqes 54 të Abetares së punës **12.** Punim i faqes 85 të Abetares **13.** Veprimtari shkrimi (diktim) **14.** Përforcim i shkronjave të mësuara **15.** Punim i shkronjës Nj, nj faqe 86 të Abetares **16.** Punim e shkrim i shkronjës Nj, nj, Abetare pune faqe 56 **17.** Punim e lexim i shkronjës Nj, nj faqe 87 të Abetares **18.** Ushtrime aplikative për shkrim dore, shkronja Nj, nj. **19.** Punim i faqes 86 - 87 të Abetares. Njollat e Njomëzës. **20.** Punim i shkronjës Y, y faqe 88 të Abetares **21.** Punim e shkrim i shkronjës Y, y, Abetare pune faqe 57

	33. Punim i shkronjave A,a Abetare f.22 **34.** Ushtrime aplikative për shkrim dore f 24 **35.** Lexim dhe punim i faqes 22 në Abetare **36.** Ushtrime aplikative për shkrim dore. **37.** Punim i shkronjave I,i faqe 23 në Abetare **38.** Ushtrime aplikative Abetare pune faqe 24 **39.** Punim e lexim i faqes 23 Abetare **40.** Ushtrime dhe modeli i shkrimit të dorës I, i **41.** Punim i shkronjave M, m faqe 24 të Abetares **42.** Ushtrime aplikative Abetare pune faqe 25 **43.** Punim e lexim i faqes 25 në Abetare **44.** Ushtrime dhe modeli i shkrimit të dorës M,n **45.** Punim i shkronjave N, n faqe 25 Abetare **46.** Ushtrime aplikative Abetare pune faqe 25 **47.** Punim e lexim i faqes 25 në Abetare **48.** Ushtrime dhe modeli i shkrimit te dorës N, n **49.** Punim i shkronjës E, e faqe 26 Abetare **50.** Ushtrime aplikative Abetare pune faqe 26 **51.** Punim e lexim i faqes 26 Abetare **52.** Ushtrime dhe modelim i shkrimit të dorës E, e **53.** Punim i shkronjës Ë,ë faqe 27 Abetare **54.** Ushtrime aplikative Abetare pune faqe 25 **55.** Punim e lexim i faqes 27 në Abetare **56.** Ushtrime dhe modeli i shkrimit të dorës Ë, ë **57.** Punim i faqes 28 të Abetares **58.** Punim i faqes 27 në Abetare pune **59.** Punim i faqes 29 të Abetares **60.** Veprimtari shkrimi (Diktim) **61.** Punim i shkronjës R, r faqe 30 të Abetares **62.** Punim e shkrim i shkronjës R, r, Abetare pune fq. 28 **63.** Punim e lexim i shkronjës R, r faqe 31 të Abetares **64.** Ushtrime aplikative për shkrim dore, shkronja R,r.	Abetare pune faqe 38 **19.** Punim e lexim i shkronjës S, s faqe 51 të Abetares. **20.** Ushtrime aplikative për shkrim dore, shkronja S, s. **21.** Punim i faqes 50-51 të Abetares. Respekto semaforin. **22.** Punim i shkronjës Sh, sh faqe 52 të Abetares. **23.** Punim e shkrim i shkronjës Sh, sh, Abetare pune faqe 39 **24.** Punim e lexim i shkronjës Sh, sh faqe 53 të Abetares. **25.** Ushtrime aplikative për shkrim dore, shkronja Sh, sh. **26.** Punim i faqes 52-53 të Abetares. Ankesat e shkronjave **27.** Punim i shkronjës F, f faqe 54 të Abetares. **28.** Punim e shkrim i shkronjës F, f, Abetare pune faqe 40 **29.** Punim e lexim i shkronjës F, f faqe 55 të Abetares. **30.** Ushtrime aplikative për shkrim dore, shkronja F, f. **31.** Punim i faqes 54-55 të Abetares. Flamuri **32.** Punim i faqes 56 të Abetares. **33.** Punim i faqes 41 të Abetares së punës **34.** Punim i faqes 57 të Abetares. **35.** Veprimtari shkrimi (diktim) **36.** Përforcim i shkronjave të mësuara **37.** Punim i shkronjës Rr, rr faqe 58 të Abetares. **38.** Punim e shkrim i shkronjës Rr, rr, Abetare pune faqe 42 **39.** Punim e lexim i shkronjës Rr, rr faqe 59 të Abetares. **40.** Ushtrime aplikative për shkrim dore, shkronja Rr, rr. **41.** Punim i faqes 58-59 të Abetares.	**22.** Punim e lexim i shkronjës Y, y faqe 89 të Abetares **23.** Ushtrime aplikative për shkrim dore, shkronja Y, y. **24.** Punim i faqes 88 - 89 të Abetares. Lapsat me ngjyra. **25.** Punim i shkronjës Z, z faqe 90 të Abetares **26.** Punim e shkrim i shkronjës Z, z, Abetare pune faqe 58 **27.** Punim e lexim i shkronjës Z, z faqe 91 të Abetares **28.** Ushtrime aplikative për shkrim dore, shkronja Z, z. **29.** Punim i faqes 90 - 91 të Abetares. Zemra e Nënë Terezës **30.** Punim i shkronjës X, x faqe 92 të Abetares **31.** Punim e shkrim i shkronjës X, x, Abetare pune faqe 59 **32.** Punim e lexim i shkronjës X, x faqe 93 të Abetares **33.** Ushtrime aplikative për shkrim dore, shkronja X, x. **34.** Punim i faqes 92 - 93 të Abetares. Ylli i vogël lart në qiell. **35.** Punim i shkronjës Xh, xh faqe 94 të Abetares **36.** Punim e shkrim i shkronjës Xh, xh, Abetare pune faqe 60 **37.** Punim e lexim i shkronjës Xh, xh faqe 95 të Abetares **38.** Ushtrime aplikative për shkrim dore, shkronja Xh, xh. **39.** Punim i faqes 94 - 95 të Abetares. Xhamaprerësi **40.** Punim i shkronjës Zh, zh faqe 96 të Abetares **41.** Punim e shkrim i shkronjës Zh, zh, Abetare pune faqe 61 **42.** Punim e lexim i shkronjës Zh, zh faqe 97 te Abetares **43.** Ushtrime aplikative për shkrim dore, shkronja Zh, zh. **44.** Punim i faqes 96 - 97 të Abetares. Zhurma e pyllit. **45.** Punim i faqes 98 të Abetares

	65. Punim i faqes 30-31 të Abetares . Në rëre. **66.** Punim i shkronjës U, u faqe 32 të Abetares **67.** Punim e shkrim i shkronjës U, u, Abetare pune fq.29 **68.** Punim e lexim i shkronjës U, u faqe 33 të Abetares **69.** Ushtrime aplikative për shkrim dore, shkronja U,u. **70.** Punim i faqes 32-33 të Abetares . Në lumë. **71.** Punim i shkronjës L, l faqe 34 të Abetares **72.** Punim e shkrim i shkronjës L, l, Abetare pune fq.30 **73.** Punim e lexim i shkronjë L, l faqe 35 të Abetares **74.** Ushtrime aplikative për shkrim dore, shkronja L,l. **75.** Punim i faqes 34-35 të Abetares. Me lahutë. **76.** Punim i shkronjës K, k faqe 36 të Abetares **77.** Punim e shkrim i shkronjës K, k, Abetare pune fq 31 **78.** Punim e lexim i shkronjës K, k faqe 37 të Abetares **79.** Ushtrime aplikative për shkrim dore, shkronja K,k. **80.** Punim i faqes 36-37 të Abetares. Kali i Kelit. **81.** Punim i shkronjës O, o faqe 38 të Abetares **82.** Punim e shkrim i shkronjës O, o, abetare pune fq 32 **83.** Punim e lexim i shkronjës O, o faqe 39 te abetares **84.** Ushtrime aplikative për shkrim dore, shkronja O, o **85.** Punim i faqes 38-39 të Abetares. Ola mëson me orar. **86.** Punim i shkronjës P, p faqe 40 të Abetares **87.** Punim e shkrim i shkronjës P, p, Abetare pune fq 33 **88.** Punim e lexim i shkronjës P, p faqe 41 të Abetares	Shporta me rrush **42.** Punim i shkronjës J, j faqe 60 të Abetares. **43.** Punim e shkrim i shkronjës J, j, Abetare pune faqe 43 **44.** Punim e lexim i shkronjës J, j faqe 61 të Abetares **45.** Ushtrime aplikative për shkrim dore, shkronja J, j. **46.** Punim i faqes 60-61 të Abetares .Kësulëkuqja dhe ujku **47.** Punim i shkronjës V, v faqe 62 të Abetares. **48.** Punim e shkrim i shkronjës V, v, Abetare pune faqe 44 **49.** Punim e lexim i shkronjës V, v faqe 63 të Abetares. **50.** Ushtrime aplikative për shkrim dore, shkronja V, v. **51.** Punim i faqes 62-63 të Abetares .Kalendari i vitit **52.** Punim i shkronjës Q, q faqe 64 të Abetares. **53.** Punim e shkrim i shkronjës Q, q, Abetare pune faqe 45 **54.** Punim e lexim i shkronjës Q, q faqe 65 të Abetares. **55.** Ushtrime aplikative për shkrim dore, shkronja Q, q. **56.** Punim i faqes 64-65 të Abetares. Qershitë u poqën **57.** Punim i shkronjës D, d faqe 66 të Abetares. **58.** Punim e shkrim i shkronjës D, d, Abetare pune faqe 47 **59.** Punim e lexim i shkronjës D, d faqe 67 të Abetares. **60.** Ushtrime aplikative për shkrim dore, shkronja D, d. **61.** Punim i faqes 66-67 të Abetares .Në ditëlindje	**46.** Punim i faqes 99 të Abetares **47.** Punim i faqeve 98-99 të Abetares **48.** Veprimtari shkrimi (diktim) **49.** Recitojmë vjersha të ndryshme **50.** Dramatizim i një pjese **51.** Abetare, Abetare **52.** Mësojmë për gjuhën Ush.1,2 fq 62 **53.** Mendime të ngjyrosura **54.** Emra njerëzish dhe sendesh Ush 3,4 fq 62 **55.** Për një shkronjë që ti s'e vë. **56.** Emra kafshësh Fq 63 **57.** Alfabeti i gjyshe Rozës **58.** Emra njerëzish Fq 64 **59.** Para televizorit **60.** Emra Fq.65 **61.** Edukata **62.** Emra njerëzish-kafshësh-sendesh Fq 66 **63.** Në zyrën e babait **64.** Emra njerëzish Fq 67 **65.** Librat rrinë radhë - radhë **66.** Emra në njëjës dhe shumës fq.68 **67.** Biçikleta **68.** Emrat që tregojnë cilësi Fq 69 **69.** Dy duar tre fëmijë **70.** Emrat që tregojnë cilësi Fq 70 **71.** Hunda e Pinokut **72.** Përshkruajmë shokun Fq 71 ush 1,4 **73.** Dielli dhe reja **74.** Përshkruajmë sende dhe objekte Fq 71 usht 2,3 **75.** Miqtë e pyllit **76.** Fjalët që tregojnë cilësi Fq 72 **77.** Zemërimi i luleve **78.** Fjalë që tregojnë veprime Fq 73 **79.** Legjenda e luledielli t **80.** Fjalë që tregojnë veprime Fq 74 **81.** Piktura e Edlirës **82.** Fjalët që tregojnë veprime Fq 75 **83.** Një gjuhë për të gjithë. **84.** Fjalët që tregojnë veprime Fq 76 ush 1 **85.** Miq nga hapësira **86.** Fjalët që tregojnë veprime Fq 76 2,3 **87.** Kur nuk kishte telefon

	89. Ushtrime aplikative për shkrim dore, shkronja P, p **90.** Punim i faqes 40-41 të Abetares. Në shitore. **91.** Punim i faqes 42 të Abetares **92.** Punim i faqes 34 të Abetares së punës **93.** Vlerësim përmbledhës	**62.** Punim i shkronjës Dh, dh faqe 68 të Abetares. **63.** Punim e shkrim i shkronjës Dh, dh, Abetare pune faqe 49 **64.** Punim e lexim i shkronjës Dh, dh faqe 69 të Abetares. **65.** Ushtrime aplikative për shkrim dore, shkronja Dh,dh. **66.** Punim i faqes 68-69 të Abetares. Bardhi te dentistja **67.** Punim i faqes 70 të Abetares. **68.** Punim i faqes 48 të Abetares së punës **69.** Punim i faqes 71 të Abetares. **70.** Veprimtari shkrimi (diktim) **71.** Përforcim i shkronjave të mësuara **72.** Punim i shkronjës Ll, ll faqe 72 të Abetares. **73.** Punim e shkrim i shkronjës Ll, ll, Abetare pune faqe 46 **74.** Punim e lexim i shkronjës Ll, ll faqe 73 të Abetares. **75.** Ushtrime aplikative për shkrim dore, shkronja Ll, ll. **76.** Punim i faqes 72-73 të Abetares. Kush e hëngri akulloren? **77.** Punim i shkronjës G, g faqe 74 të Abetares. **78.** Punim e shkrim i shkronjës G, g, Abetare pune faqe 50 **79.** Punim e lexim i shkronjës G, g faqe 75 të Abetares. **80.** Ushtrime aplikative për shkrim dore, shkronja G, g. **81.** Punim i faqes 74 - 75 të Abetares .Gomari në festë. **82.** Punim i shkronjës Gj, gj faqe 76 të Abetares. **83.** Punim e shkrim i shkronjës Gj, gj, Abetare pune faqe 51	**88.** Përshkruajmë ditëlindjen Fq 77 **89.** Flasim për filmat vizatimorë. **90.** Përshkruajnë ditë pushimi Fq 78 **91.** Përshkruajmë një ditë me shi Fq 79 **92.** Kush? Çfarë? Ku? Si? Pse? fq 80 **93.** Përshkruajmë stinët Fq 81 **94.** Vlerësim përmbledhës

		84. Punim e lexim i shkronjës Gj, gj faqe 77 të Abetares. **85.** Ushtrime aplikative për shkrim dore, shkronja Gj, gj. **86.** Punim i faqes 76 - 77 të Abetares Gjëegjëza **87.** Punim i shkronjës Th, th faqe 78 të Abetares. **88.** Punim e shkrim i shkronjës Th, th, Abetare pune faqe 52 **89.** Punim e lexim i shkronjës Th, th faqe 79 të Abetares. **90.** Ushtrime aplikative për shkrim dore, shkronja Th, th. **91.** Punim i faqes 78 - 79 të Abetares. Porosia e fundit e Skënderbeut. **92.** Punim i shkronjës C, c faqe 80 të Abetares. **93.** Vlerësim përmbledhës	

PLANI TREMUJOR
SHTATOR – DHJETOR

32 orë paraabetare + 61 orë abetare

Tabela përmbledhëse për tremujorin e parë

Kompetencat/ klasa	**Të dëgjuarit e teksteve të ndryshme**	**Të folurit për të komunikuar dhe për të mësuar**	**Të lexuarit e teksteve letrare dhe joletrare**	**Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale**	**Përdorimi i drejtë i gjuhës**	**Totali**
Klasa e parë	3	3	46	41	0	93

Nr.	Tematika	Tema mësimore	Situata e parashikuar e të nxënit	Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	Vlerësimi	Burimet dhe materialet didaktike	Data / Dita
Periudha përgatitore (Para Abetare) 4 javë x 8 orë = 32 orë							
1.	D, F, Sh, GJ	Abetarja ime Unë jam	Prezantim	diskutim për njohuritë paraprake dramatizim rrjeti i diskutimit pyetja sjell pyetjen lojë tryezë e rrumbullakët	Shqipton saktë dhe me intonacionin e theksin e duhur tingujt dhe fjalët Shkruan fjalë globale me të diktuar. Flet rrjedhshëm, kuptueshëm dhe me intonacionin e duhur, kur tregon një ngjarje, një përvojë të tijën ose kur përshkruan diçka. Demonstron të kuptuarit e teksteve që dëgjon në situata të ndryshme.	Korniza kurrikulare	
2.		Tingulli dhe shkronja A Drejt shkollës	Shkolla ime			Programi lëndor	
3.		Tingulli dhe shkronja I Drejt shkollës				Udhëzime nga IZHA	
4.		Tingulli dhe shkronja M Drejt shkollës				Revista për fëmijë	
5.		Tingulli dhe shkronja N	Numrat			Fjalor	
6.		Tingulli dhe shkronja E, Ë Në shtëpi	Elefanti			Shkronja lëvizore	
7.		Tingulli dhe shkronja B Në mëngjes	Balona			Udhëzues të ndryshëm	
8.		Tingulli dhe shkronja F Në fshat	Fshati			Fisha të përgatitura	
9.	D, F, Sh, GJ	Tingujt dhe shkronjat C, Ç	Zogjtë	diskutim për njohuritë paraprake imitim zërash e tingujsh	Demonstron të kuptuarit e teksteve që dëgjon në situata të ndryshme. Shqipton saktë dhe me	biblioteka	
10		Tingujt dhe shkronjat H,U	Zërat e natyrës			Udhëzues të ndryshëm	

11		Tingulli dhe shkronja D,DH Kalendari i ditëlindjeve	Festa e ditëlindjes	rrjeti i diskutimit pyetja sjell pyetjen dramatizim lojëra	intonacionin e theksin e duhur fjalët me shkronjat e mësuara. Shkruan fjalë globale me të diktuar. Diskuton në grupe të vogla për tema që i interesojnë, bën pyetje dhe jep përgjigje të thjeshta. Reciton vjersha të shkurtra, të mësuara përmendësh	Revista për fëmijë	
12		Tingulli dhe shkronja K Kafshët	Përralla: Ujku dhe kecat			Udhëzues të ndryshëm	
13		Tingulli dhe shkronja J Kafshët	Kafshët			Shkronja lëvizore	
14		Tingulli dhe shkronja G Në garë	Jemi në garë			Fjalor	
15		Tingulli dhe shkronja Gj Gjëegjëza	Gjëegjëzat			biblioteka	
16		Tingulli dhe shkronja L, Ll Luajmë	Loja			Udhëzues të ndryshëm	
17	D, F, Sh, Gj	Rimarrje, përsëritje, kontroll	Lodrat e mia	diskutim për njohuritë paraprake imagjinata e drejtuar harta e konceptit rrjeti i diskutimit dramatizim pyetja sjell pyetjen	Shqipton saktë dhe me intonacionin e theksin e duhur fjalët. Shkruan fjalë globale me të diktuar Tregon e njohuritë paraprake që ka rreth temës ose përmbajtjes së tekstit që dëgjon. Shpreh pëlqimet e tij rreth ngjarjeve ose personazheve të tekstit.	Fisha të përgatitura	
18		Tingulli dhe shkronja P	Përralla e Pinokut			Revista për fëmijë	
19		Tingulli dhe shkronja NJ	Shkronjat			Fjalor	
20		Tingulli dhe shkronja O, Q. Qyteti	Në qytet			Shkronja lëvizore	
21		Tingulli dhe shkronja R, RR. Në rrugë	Në rrugë			Fisha të përgatitura	
22		Tingulli dhe shkronja S. Qyteti	Qyteti me semaforë			Udhëzues të ndryshëm	
23		Tingulli dhe shkronja SH. Shkronjat	Shkronjat			biblioteka Revista për fëmijë	
24		Tingulli dhe shkronja T. Mjetet e udhëtimit	Mjetet e udhëtimit				

25	D, F, Sh, Gj	Tingulli dhe shkronja TH.	Thesi i dhuratave për ditëlindje	diskutim për njohuritë paraprake dramatizim harta e konceptit rrjeti i diskutimit imitim tingujsh e zërash pyetja sjell pyetjen	Reciton vjersha të shkurtra, të mësuara përmendsh. Dallon dhe shkruan shkronjat e gjuhës shqipe, të shtypit . Respekton hapësirën mes shkronjave, fjalëve; Plotëson pjesët që u mungojnë fjalëve. Shkruan fjalë me të diktuar .	Fjalor	
26		Tingulli dhe shkronja X. Në garë	Nxënësit në garë			Shkronja lëvizore	
27		Tingulli dhe shkronja XH.	Borëbardha dhe shtatë xhuxhat			Fisha të përgatitura	
28		Tingulli dhe shkronja V.	Filmat vizatimorë			Revista për fëmijë	
29		Tingulli dhe shkronja Y.	Ylberi i ngjyrave			biblioteka	
30		Tingulli dhe shkronja Z.	Zemra			Udhëzues të ndryshëm	
31		Tingulli dhe shkronja Zh.	Zhytësit e talentuar			Shkronja lëvizore	
32		**Rimarrje, përsëritje, kontroll**				Udhëzues të ndryshëm	
Periudha e Abetares (61 orë)							
33	L	Punim i shkronjave A,a Abetare f.22	Klasa ime	diskutim për njohuritë paraprake imagjinata e drejtuar harta e konceptit rrjeti i diskutimit stuhi mendimi	Shqipton saktë dhe me intonacionin e theksin e duhur tingujt dhe fjalët. Dallon dhe shkruan shkronjat a dhe i të shtypit dhe të dorës, të vogla e të mëdha. Respekton hapësirën mes shkronjave, fjalëve.	Fisha të përgatitura	
34	Sh	Ushtrime aplikative Abetare pune fq. 24 shkronjat A,a				Revista për fëmijë	
35	L	Lexim dhe punim i faqes 22 në Abetare				Udhëzues të ndryshëm	
36	Sh	Ushtrime aplikative për shkrim dore. Abetare pune fq 24 shkronja A,a				Fjalor	
37	L	Punim i shkronjave I,i faqe 23 në Abetare	Emri im			Udhëzime nga IZHA	

38	Sh	Ushtrime aplikative Abetare pune faqe24		dramatizim lojëra	Plotëson pjesët që u mungojnë fjalëve. Diskuton në grupe të vogla për tema që i interesojnë, bën pyetje dhe jep përgjigje të thjeshta	Shkronja lëvizore	
39	L	Punim e lexim i faqes 23 Abetare				Revista për fëmijë	
40	Sh	Ushtrime dhe modeli i shkrimit të dorës I, i				Fjalor	
41	L	Punim i shkronjave M, m faqe 24 të Abetares	Mami im	pyetja sjell pyetjen kubimi diskutim për njohuritë paraprake loja e elefantit imagjinata e drejtuar stuhi mendimi dramatizim lojëra	Shqipton saktë dhe me intonacionin e theksin e duhur tingujt dhe fjalët. Dallon dhe shkruan shkronjat m dhe n të shtypit dhe të dorës, të vogla e të mëdha. Respekton hapësirën mes shkronjave, fjalëve. Diskuton në grupe të vogla për tema që i interesojnë, bën pyetje dhe jep përgjigje të thjeshta	Fisha të përgatitura	
42	Sh	Ushtrime aplikative Abetare pune faqe 25				Udhëzime nga IZHA	
43	L	Punim e lexim i faqes 25 në Abetare				Shkronja lëvizore	
44	Sh	Ushtrime dhe modeli i shkrimit të dorës M,m				biblioteka	
45	L	Punim i shkronjave N, n faqe 25 Abetare	Nëna ime			Fjalor	
46	Sh	Ushtrime aplikative Abetare pune faqe 25				Revista për fëmijë	
47	L	Punim e lexim i faqes 25 në Abetare				biblioteka	
48	Sh	Ushtrime dhe modeli i shkrimit te dorës N, n				Fisha të përgatitura	
49	L	Punim i shkronjës E, e faqe 26 Abetare	Era e vjeshtës	harta e konceptit rrjeti i diskutimit loja e elefantit lexim i drejtuar imagjinata e drejtuar	Shqipton saktë dhe me intonacionin e theksin e duhur tingujt dhe fjalët. Dallon dhe shkruan shkronjat E dhe Ë të shtypit dhe të dorës, të vogla e të mëdha. Respekton hapësirën	Udhëzues të ndryshëm	
50	Sh	Ushtrime aplikative Abetare pune faqe 26				Udhëzime nga IZHA	
51	L	Punim e lexim i faqes 26 Abetare				Shkronja lëvizore	
52	Sh	Ushtrime dhe modelim i shkrimit të dorës E, e				Fjalor	
53	L	Punim i shkronjës Ë,ë faqe 27 Abetare	Qielli me hënë			Udhëzime nga IZHA	

54	Sh	Ushtrime aplikative Abetare pune faqe 25		parashikim me terma paraprake	mes shkronjave, fjalëve. Shpreh pëlqimet e tij rreth ngjarjeve ose personazheve të tekstit	Fisha të përgatitura	
55	L	Punim e lexim i faqes 27 në Abetare				Revista për fëmijë	
56	Sh	Ushtrime dhe modeli i shkrimit të dorës Ë, ë				Udhëzues të ndryshëm	
57	L	Punim i faqes 28 të Abetares	Pema me shkronja	diskutim për njohuritë paraprake imagjinata e drejtuar Imitime tingujsh e zërash pyetja sjell pyetjen dramatizim	Flet rrjedhshëm, kuptueshëm dhe me intonacionin e duhur, kur tregon një ngjarje, një përvojë të tijën ose kur përshkruan diçka. Shqipton saktë dhe me intonacionin e theksin e duhur tingujt dhe fjalët. Dallon dhe shkruan shkronjat e mësuara të shtypit dhe të dorës, të vogla e të mëdha.	biblioteka	
58	Sh	Punim i faqes 27 në Abetare pune				Shkronja lëvizore	
59	L	Punim i faqes 29 të Abetares				Udhëzime nga IZHA	
60	Sh	Veprimtari shkrimi (Diktim)				Fisha të përgatitura	
61	L	Punim i shkronjës R, r faqe 30 të Abetares	Në rërë			Revista për fëmijë	
62	Sh	Punim e shkrim i shkronjës R, r, Abetare pune faqe 28				Fjalor	
63	L	Punim e lexim i shkronjës R, r faqe 31 të Abetares				Udhëzues të ndryshëm	
64	Sh	Ushtrime aplikative për shkrim dore, shkronja R,r.				Fisha të përgatitura	
65	L	Punim i faqes 30-31 të Abetares . Në rëre.		imagjinata e drejtuar, harta e konceptit rrjeti i diskutimit pyetja sjell pyetjen stuhi mendimi	Shqipton saktë dhe me intonacionin e theksin e duhur tingujt dhe fjalët. Dallon dhe shkruan shkronjat u dhe l të shtypit dhe të dorës, të vogla e të mëdha.	Revista për fëmijë	
66	L	Punim i shkronjës U, u faqe 32 të Abetares	Në lumë			biblioteka	
67	Sh	Punim e shkrim i shkronjës U, u, Abetare pune faqe 29				Udhëzime nga IZHA	
68	L	Punim e lexim i shkronjës U, u faqe 33 të Abetares				Shkronja lëvizore	

69	Sh	Ushtrime aplikative për shkrim dore, shkronja U,u.		dramatizim lojëra	Respekton hapësirën mes shkronjave, fjalëve. Shpreh pëlqimet e tij	Fisha të përgatitura	
70	L	Punim i faqes 32-33 të Abetares . Në lumë.				Udhëzues të ndryshëm	
71	L	Punim i shkronjës L, l				Fjalor	
		faqe 34 të Abetares	Me lahutë	imagjinata e drejtuar harta e konceptit rrjeti i diskutimit pyetja sjell pyetjen tryezë e rrumbullakët stuhi mendimi dramatizim lojëra	rreth ngjarjeve ose personazheve të tekstit Plotëson pjesët që u mungojnë fjalëve. Flet rrjedhshëm, kuptueshëm dhe me intonacionin e duhur, kur tregon një ngjarje, një përvojë të tijën ose kur përshkruan diçka. Shqipton saktë dhe me intonacionin e theksin e duhur tingujt dhe fjalët. Dallon dhe shkruan shkronjën K të shtypit dhe të dorës, të vogël e të madhe.		
72	Sh	Punim e shkrim i shkronjës L, l, Abetare pune faqe 30				Revista për fëmijë	
73	L	Punim e lexim i shkronjë L, l faqe 35 të Abetares				Shkronja lëvizore	
74	Sh	Ushtrime aplikative për shkrim dore, shkronja L,l.				Udhëzime nga IZHA	
75	L	Punim i faqes 34-35 të Abetares. Me lahutë.				Udhëzues të ndryshëm	
76	Sh	Punim i shkronjës K, k faqe 36 të Abetares	Kali i Kelit			Revista për fëmijë	
77	Sh	Punim e shkrim i shkronjës K, k, Abetare pune faqe 31				Fjalor	
78	L	Punim e lexim i shkronjës K, k faqe 37 të Abetares				Shkronja lëvizore	
79	Sh	Ushtrime aplikative për shkrim dore, shkronja K,k.				Fisha të përgatitura	
80	L	Punim i faqes 36-37 të Abetares. Kali i Kelit.				Udhëzime nga IZHA	
81	L	Punim i shkronjës O, o faqe 38 të Abetares	Ola mëson me orar.	harta e konceptit	Shqipton saktë dhe me	Shkronja lëvizore	

82	Sh	Punim e shkrim i shkronjës O, o, Abetare pune faqe 32		rrjeti i diskutimit pyetja sjell pyetjen Dramatizim stuhi mendimi lojëra tryezë e rrumbullakët	intonacionin e theksin e duhur tingujt dhe fjalët. Dallon dhe shkruan shkronjat O dhe P të shtypit dhe të dorës, të vogla e të mëdha. Respekton hapësirën mes shkronjave, fjalëve. Shpreh pëlqimet e tij	Fisha të përgatitura	
83	L	Punim e lexim i shkronjës O, o faqe 39 të Abetares				biblioteka	
84	Sh	Ushtrime aplikative për shkrim dore, shkronja O, o.				Fjalor	
85	L	Punim i faqes 38-39 të Abetares. Ola mëson me orar.				Udhëzues të ndryshëm	
86	L	Punim i shkronjës P, p				Shkronja	
		faqe 40 të Abetares	Në shitore	imagjinata e drejtuar harta e konceptit pyetja sjell pyetjen dramatizim	rreth ngjarjeve ose personazheve të tekstit Flet rrjedhshëm, kuptueshëm dhe me intonacionin e duhur, kur tregon një ngjarje, një përvojë të tijën ose kur përshkruan diçka.	lëvizore	
87	Sh	Punim e shkrim i shkronjës P, p, Abetare pune faqe 33				Fisha të përgatitura	
88	L	Punim e lexim i shkronjës P, p faqe 41 të Abetares				Shkronja lëvizore	
89	Sh	Ushtrime aplikative për shkrim dore, shkronja P, p.				Udhëzime nga IZHA	
90	L	Punim i faqes 40-41 të Abetares. Në shitore.				Udhëzues të ndryshëm	
91	L	Punim i faqes 42 të Abetares				Revista për fëmijë	
92	L	Punim i faqes 34 të Abetares së punës				Revista për fëmijë	
93	Sh	Test përmbledhës				Revista për fëmijë	

PLANI 3 MUJOR
DHJETOR – MARS
(93 ORË)

Tabela përmbledhëse për tremujorin e dytë

Kompetencat/ klasa	Të dëgjuarit e teksteve të ndryshme	Të folurit për të komunikuar dhe për të mësuar	Të lexuarit e teksteve letrare dhe joletrare	Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale	Përdorimi i drejtë i gjuhës	Totali
Klasa e parë	3	3	52	35	0	93

Nr.	Tematika	Tema mësimore	Situata e parashikuar e të nxënit	Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	Vlerësimi	Burimet dhe materialet didaktike	Data / Dita
1.		Punim i faqes 43 të Abetares	Në dimër	Diskutim për njohuritë paraprake Dramatizim Rrjeti i diskutimit Pyetja sjell pyetjen Lojë	Demonstron të kuptuarit e teksteve që dëgjon në situata të ndryshme. Shkruan fjalë dhe fjali me të diktuar. Flet rrjedhshëm, kuptueshëm dhe me intonacionin e duhur,	Korniza kurrikulkare	
2.	D	Punim i shkronjës B, b faqe 44 të Abetares				Programi lëndor	
3.	F	Punim e shkrim i shkronjës B, b, Abetare pune faqe 35				Udhëzime nga IZHA	
4.	L	Punim e lexim i shkronjës B, b faqe 45 të Abetares				Revista për fëmijë	
5.	Sh	Ushtrime aplikative për shkrim dore, shkronja B,				Fjalor	

		b			kur tregon një ngjarje,		
6.	Gj	Punim i faqes 44-45 të Abetares. Burrë bore		Tryezë e rrumbullakët		Shkronja lëvizore	
7.		Punim i shkronjës H, h faqe 46 të Abetares.	Natë me hënë	Diskutim për njohuritë paraprake	Shqipton saktë dhe me intonacionin e theksin e duhur fjalët me shkronjat e mësuara.	Udhëzues të ndryshëm	
8.		Punim e shkrim i shkronjës H, h, Abetare pune faqe 36		Imitim zërash e tingujsh		Fisha të përgatitura	
9.		Punim e lexim i shkronjës H, h faqe 47 të Abetares		Rrjeti i diskutimit	Shkruan fjalë dhe fjali me të diktuar.	biblioteka	
10		Ushtrime aplikative për shkrim dore, shkronja H, h.		Pyetja sjell pyetjen	Diskuton në grupe të vogla për tema që i interesojnë, bën pyetje dhe jep përgjigje të thjeshta.	Udhëzues të ndryshëm	
11		Punim i faqes 46-47 të Abetares. Bisedë me Hënën.				Revista për fëmijë	
12		Punim i shkronjës T, t faqe 48 të Abetares	Objektet që na pëlqejnë	Dramatizim	Dallon dhe shkruan shkronjën t të shtypit dhe të dorës, të vogël e të madhe.	Udhëzues të ndryshëm	
13	D F L Sh G	Punim e shkrim i shkronjës T, t, Abetare pune faqe 37		Lojëra	Shqipton saktë dhe me intonacionin e theksin e duhur fjalët.	Shkronja lëvizore	
14		Punim e lexim i shkronjës T, t faqe 49 të Abetares.		Diskutim për njohuritë paraprake	U përgjigjet me shkrim pyetjeve të thjeshta.	Fjalor	
15		Ushtrime aplikative për shkrim dore, shkronja T, t.				biblioteka	
16		Punim i faqes 48-49 të Abetares .Kompjuteri				Udhëzues të ndryshëm	
17	D F L Sh G	Punim i shkronjës S, s faqe 50 të Abetares	Qarkullimi rrugor	Imagjinata e drejtuar	Dallon dhe shkruan shkronjën s dhe të shtypit dhe të dorës, të vogël e të madhe.	Fisha të përgatitura	
18		Punim e shkrim i shkronjës S, s, Abetare pune faqe 38		Harta e konceptit	Shkruan fjalë dhe fjali me të diktuar	Revista për fëmijë	
19		Punim e lexim i shkronjës S, s faqe 51 të Abetares		Rrjeti i diskutimit	Reciton vjersha të	Fjalor	

20		Ushtrime aplikative për shkrim dore, shkronja S, s.		Dramatizim	shkurtra, të mësuara përmendsh	Shkronja lëvizore	
21		Punim i faqes 50-51 të Abetares. Respekto semaforin				Fisha të përgatitura	
22	D F L Sh G	Punim i shkronjës Sh, sh faqe 52 të Abetares	Luajmë me shkronja	Pyetja sjell pyetjen Diskutim për njohuritë paraprake Dramatizim Rishikim në dyshe	Tregon e njohuritë paraprake që ka rreth temës ose përmbajtjes së tekstit që dëgjon. Shpreh pëlqimet e tij rreth ngjarjeve ose personazheve të tekstit. Dallon dhe shkruan shkronjën sh të shtypit dhe të dorës, të vogël e të madhe. merr pjesë në lojë me role.	Udhëzues të ndryshëm	
23		Punim e shkrim i shkronjës Sh, sh, Abetare pune faqe 39				biblioteka Revista për fëmijë	
24		Punim e lexim i shkronjës Sh, sh faqe 53 të Abetares					
25		Ushtrime aplikative për shkrim dore, shkronja Sh, sh				Fjalor	
26		Punim i faqes 52-53 të Abetares. Ankesat e shkronjave				Shkronja lëvizore	
27	D F L Sh G	Punim i shkronjës F, f faqe 54 të Abetares.	Flamuri ynë	Harta e konceptit Rrjeti i diskutimit Imitim tingujsh e zërash Pyetja sjell pyetjen Rishikim në dyshe	Respekton hapësirën mes shkronjave, fjalëve; Plotëson pjesët që u mungojnë fjalëve. Shkruan fjalë dhe fjali me të diktuar. Shkruan tekste të thjeshta sipas	Fisha të përgatitura	
28		Punim e shkrim i shkronjës F, f, Abetare pune faqe 40				Revista për fëmijë	
29		Punim e lexim i shkronjës F, f faqe 55 të Abetares				biblioteka	
30		Ushtrime aplikative për shkrim dore, shkronja F, f.				Udhëzues të ndryshëm	
31		Punim i faqes 54-55 të Abetares. Flamuri				Shkronja lëvizore	

32	D F L Sh G	Punim i faqes 56 të Abetares			modeleve të dhëna U përgjigjet me shkrim pyetjeve të thjeshta.	Udhëzues të ndryshëm	
33		Punim i faqes 41 të Abetares së punës	Lojë me fjalët	Diskutim për njohuritë paraprake Imagjinata e drejtuar Harta e konceptit	Shqipton saktë dhe me intonacionin e theksin e duhur tingujt dhe fjalët. Dallon dhe shkruan shkronjën f të shtypit dhe të dorës, të vogël e të madhe. Respekton hapësirën mes shkronjave, fjalëve.	Fisha të përgatitura	
34		Punim i faqes 57 të Abetares				Revista për fëmijë	
35		Veprimtari shkrimi (diktim)				Udhëzues të ndryshëm	
36		Përforcim i shkronjave të mësuara				Fjalor	
37	D F L Sh G	Punim i shkronjës Rr, rr faqe 58 të Abetares.	Frutat	Rrjeti i diskutimit Stuhi mendimi Dramatizim Lojëra Rishikim në dyshe	Plotëson pjesët që u mungojnë fjalëve. Diskuton në grupe të vogla për tema që i interesojnë, bën pyetje dhe jep përgjigje të th Dallon dhe shkruan shkronjën f të shtypit dhe të dorës, të vogël e të madhe	Udhëzime nga IZHA	
38		Punim e shkrim i shkronjës Rr, rr, Abetare pune faqe 42				Shkronja lëvizore	
39		Punim e lexim i shkronjës Rr, rr faqe 59 të Abetares.				Revista për fëmijë	
40		Ushtrime aplikative për shkrim dore, shkronja Rr, rr.				Fjalor	
41	D F L Sh G	Punim i faqes 58-59 të Abetares. Shporta me rrush	Në botën e përrallave	Pyetja sjell pyetjen Kubimi Diskutim për njohuritë paraprake Loja e elefantit	demonstron të kuptuarit e teksteve që dëgjon në situata të ndryshme Shqipton saktë dhe me intonacionin e theksin e duhur tingujt dhe	Fisha të përgatitura	
42		Punim i shkronjës J, j faqe 60 të Abetares				Udhëzime nga IZHA	
43		Punim e shkrim i shkronjës J, j, Abetare pune faqe 43				Shkronja lëvizore	

44		Punim e lexim i shkronjës J, j faqe 61 të Abetares		Imagjinata e drejtuar Stuhi mendimi Dramatizim	fjalët. Dallon dhe shkruan shkronjën j të shtypit dhe të dorës, të vogël e të madhe. U përgjigjet me shkrim pyetjeve të thjeshta.	biblioteka	
45		Ushtrime aplikative për shkrim dore, shkronja J, j.				Fjalor	
46		Punim i faqes 60-61 të Abetares. Kësulëkuqja dhe ujku				Revista për fëmijë	
47	D F L Sh G	Punim i shkronjës V, v faqe 62 të Abetares.	Viti dhe stinët	Lojëra Harta e konceptit Rrjeti i diskutimit Loja e elefantit Lexim i drejtuar	Përdor strategjitë e duhura për të lexuar tekste të thjeshta. Dallon dhe shkruan shkronjën v të shtypit dhe të dorës, të vogël e të madhe. U përgjigjet me shkrim pyetjeve të thjeshta.	biblioteka	
48		Punim e shkrim i shkronjës V, v, Abetare pune faqe 44				Fisha të përgatitura	
49		Punim e lexim i shkronjës V, v faqe 63 të Abetares.				Udhëzues të ndryshëm	
50		Ushtrime aplikative për shkrim dore, shkronja V, v.				Udhëzime nga IZHA	
51		Punim i faqes 62-63 të Abetares. Kalendari i vitit				Shkronja lëvizore	
52	D F L Sh G	Punim i shkronjës Q, q faqe 64 të Abetares.	Qershitë	Imagjinata e drejtuar Parashikim me terma paraprake Rishikim në dyshe Lexim i drejtuar	Shpreh pëlqimet e tij rreth ngjarjeve ose personazheve të tekstit Dallon dhe shkruan shkronjën q të shtypit dhe të dorës, të vogël e të madhe. Demonstron të kuptuarit e teksteve që dëgjon në situata të ndryshme.	Fjalor	
53		Punim e shkrim i shkronjës Q, q, Abetare pune faqe 45				Udhëzime nga IZHA	
54		Punim e lexim i shkronjës Q, q faqe 65 të Abetares.				Fisha të përgatitura	
55		Ushtrime aplikative për shkrim dore, shkronja Q, q.				Revista për fëmijë	
56		Punim i faqes 64-65 të Abetares. Qershitë u poqën				Udhëzues të ndryshëm	

57	D F L Sh G	Punim i shkronjës D, d faqe 66 të Abetares.	Ditëlindja ime	Diskutim për njohuritë paraprake Imagjinata e drejtuar Imitime tingujsh e zërash Pyetja sjell pyetjen	Flet rrjedhshëm, kuptueshëm dhe me intonacionin e duhur, kur tregon një ngjarje, një përvojë të tijën ose kur përshkruan diçka. Dallon dhe shkruan shkronjë d të shtypit dhe të dorës, të vogël e të madhe.	biblioteka	
58		Punim e shkrim i shkronjës D, d, Abetare pune faqe 47				Shkronja lëvizore	
59		Punim e lexim i shkronjës D, d faqe 67 të Abetares.				Udhëzime nga IZHA	
60		Ushtrime aplikative për shkrim dore, shkronja D, d.				Fisha të përgatitura	
61		Punim i faqes 66-67 të Abetares. Në ditëlindje				Revista për fëmijë	
62	D F L Sh G	Punim i shkronjës Dh, dh faqe 68 të Abetares.	Te dentistja	Dramatizim Imagjinata e drejtuar, Harta e konceptit Rrjeti i diskutimit Pyetja sjell pyetjen Stuhi mendimi Dramatizim Lojëra Lexim i drejtuar Rishikim në dyshe	Shprehet saktë, kuptueshëm dhe me fjali të plota, kur bën një kërkesë, pyet, sqaron. Dallon dhe shkruan shkronjën d të shtypit dhe të dorës, të vogël e të madhe. Shqipton saktë dhe me intonacionin e theksin e duhur tingujt dhe fjalët. Dallon dhe shkruan shkronjat e mësuara të shtypit dhe të dorës, të vogla e të mëdha. Përdor strategjitë e duhura për të lexuar tekste të thjeshta, mëson fjalë të reja	Fjalor	
63		Punim e shkrim i shkronjës Dh, dh, Abetare pune faqe 49				Udhëzues të ndryshëm	
64		Punim e lexim i shkronjës Dh, dh faqe 69 të Abetares.				Fisha të përgatitura	
65		Ushtrime aplikative për shkrim dore, shkronja Dh,dh.				Revista për fëmijë	
66		Punim i faqes 68-69 të Abetares. Bardhi te dentistja				biblioteka	
67		Punim i faqes 70 të Abetares.				Udhëzime nga IZHA	
68		Punim i faqes 48 të Abetares së punës				Shkronja lëvizore	
69		Punim i faqes 71 të Abetares.				Fisha të përgatitura	
70		Veprimtari shkrimi (diktim)				Udhëzues të ndryshëm	

71		Përforcim i shkronjave të mësuara			Demonstron të kuptuarit e teksteve që dëgjon në situata të ndryshme.	Fjalor	
72	D F L Sh G	Punim i shkronjës Ll, ll faqe 72 të Abetares.	Ëmbëlsirat	Imagjinata e drejtuar harta e konceptit Rrjeti i diskutimit Pyetja sjell pyetjen Tryezë e rrumbullakët	Flet rrjedhshëm, kuptueshëm dhe me intonacionin e duhur, kur tregon një ngjarje, një përvojë të tijën ose kur përshkruan diçka. Shqipton saktë dhe me intonacionin e theksin e duhur tingujt dhe fjalët. Dallon dhe shkruan shkronjën ll të shtypit dhe të dorës, të vogël e të madhe.	Revista për fëmijë	
73		Punim e shkrim i shkronjës Ll, ll, Abetare pune faqe 46				Shkronja lëvizore	
74		Punim e lexim i shkronjës Ll, ll faqe 73 të Abetares				Udhëzime nga IZHA	
75		Ushtrime aplikative për shkrim dore, shkronja Ll, ll				Udhëzues të ndryshëm	
76		Punim i faqes 72-73 të Abetares. Kush e hëngri akulloren?				Revista për fëmijë	
77	D F L Sh G	Punim i shkronjës G, g faqe 74 të Abetares.	Kafshët	Stuhi mendimi Dramatizim Lojëra Harta e konceptit Rrjeti i diskutimit	Shqipton saktë dhe me intonacionin e theksin e duhur tingujt dhe fjalët. Dallon dhe shkruan shkronjën g të shtypit dhe të dorës, të vogël e të madhe. Respekton hapësirën mes shkronjave, fjalëve	Fjalor	
78		Punim e shkrim i shkronjës G, g, Abetare pune faqe 50				Fisha të përgatitura	
79		Punim e lexim i shkronjës G, g faqe 75 të Abetares.				Udhëzime nga IZHA	
80		Ushtrime aplikative për shkrim dore, shkronja G, g.				Shkronja lëvizore	
81		Punim i faqes 74 - 75 të Abetares. Gomari në festë				Fisha të përgatitura	
82	D F	Punim i shkronjës Gj, gj faqe 76 të Abetares.	Gjëegjëza	Pyetja sjell pyetjen	Shpreh pëlqimet e tij rreth ngjarjeve ose	biblioteka	

83	L Sh G	Punim e shkrim i shkronjës Gj, gj, Abetare pune faqe 51		Dramatizim Stuhi mendimi Lojëra Tryezë e rrumbullakët	personazheve të tekstit Shkruan tekste të thjeshta sipas modeleve Dallon dhe shkruan shkronjën gj të shtypit dhe të dorës, të vogël e të madhe Merr pjesë në lojë me role.	Fjalor	
84		Punim e lexim i shkronjës Gj, gj faqe 77 të Abetares.				Udhëzues të ndryshëm	
85		Ushtrime aplikative për shkrim dore, shkronja Gj, gj				Shkronja lëvizore	
86		Punim i faqes 76 - 77 të Abetares. Gjëegjëza				Fisha të përgatitura	
87	D F L Sh G	Punim i shkronjës Th, th faqe 78 të Abetares.	Skënderbeu	Imagjinata e drejtuar Harta e konceptit Pyetja sjell pyetjen Dramatizim Lexim i drejtuar Dramatizim	Flet rrjedhshëm, kuptueshëm dhe me intonacionin e duhur, kur tregon një ngjarje, një përvojë të tijën ose kur përshkruan diçka. Shprehet saktë, kuptueshëm dhe me fjali të plota, kur bën një kërkesë, pyet, sqaron, kërkon ndjesë, falenderon dhe u përgjigjet pyetjeve;	Shkronja lëvizore	
88		Punim e shkrim i shkronjës Th, th, Abetare pune faqe 52				Udhëzime nga IZHA	
89		Punim e lexim i shkronjës Th, th faqe 79 të Abetares.				Udhëzues të ndryshëm	
90		Ushtrime aplikative për shkrim dore, shkronja Th, th				Revista për fëmijë	
91		Punim i faqes 78 - 79 të Abetares. Porosia e fundit e Skënderbeut.				Revista për fëmijë	
92		Punim i shkronjës C, c faqe 80 të Abetares.	Zogjtë	Imagjinata e drejtuar	Demonstron të kuptuarit e teksteve që dëgjon në situata të ndryshme.	Revista për fëmijë	
93		Test					

PLANI 3 MUJOR
MARS - QERSHOR
(94 ORË)

Tabela përmbledhëse për tremujorin e tretë

Kompetencat/ klasa	Të dëgjuarit e teksteve të ndryshme	Të folurit për të komunikuar dhe për të mësuar	Të lexuarit e teksteve letrare dhe joletrare	Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale	Përdorimi i drejtë i gjuhës	Totali
Klasa e parë	4	4	56	0	30	94

Planifikimi tremujor mars- qershor (94 orë)

Nr.	Tematika	Tema mësimore	Situata e parashikuar e të nxënit	Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	Vlerësimi	Burimet dhe materialet didaktike	Data / Dita
1.	D	Punim e shkrim i shkronjës C, c, Abetare pune faqe 53	Zogjtë	Diskutim për njohuritë paraprake	Demonstron të kuptuarit e teksteve që dëgjon në situata të ndryshme.	Korniza kurrikulare	
2.		Punim e lexim i shkronjës C,				Programi lëndor	

	F L Sh Gj	c faqe 81 të Abetares		Dramatizim Rrjeti i diskutimit	Shkruan fjalë dhe fjali me të diktuar.		
3.		Ushtrime aplikative për shkrim dore, shkronja C, c.				Udhëzime nga IZHA	
4.		Punim i faqes 80 - 81 të Abetares. Ola dhe trumcaku.				Revista për fëmijë	
5.		Punim i shkronjës Ç, ç faqe 82 të Abetares	Veshjet tona	Pyetja sjell pyetjen Lojë Tryezë e rrumbullakët Diskutim për njohuritë paraprake Imitim zërash e tingujsh Rrjeti i diskutimit Pyetja sjell pyetjen	Flet rrjedhshëm, kuptueshëm dhe me intonacionin e duhur, kur tregon një ngjarje, një përvojë të tijën ose kur përshkruan diçka. Shqipton saktë dhe me intonacionin e theksin e duhur fjalët me shkronjat e mësuara . Shkruan fjalë dhe fjali me të diktuar.	Fjalor	
6.		Punim e shkrim i shkronjës Ç, ç, Abetare pune faqe 54				Shkronja lëvizore	
7.		Punim e lexim i shkronjës Ç, ç faqe 83 të Abetares				Udhëzues të ndryshëm	
8.		Ushtrime aplikative për shkrim dore, shkronja Ç, ç.				Fisha të përgatitura	
9.		Punim i faqes 82 - 83 të Abetares. Palaçoja në shitore.				biblioteka	
10		Punim i faqes 84 të Abetares				Udhëzues të ndryshëm	
11		Punim i faqes 54 të Abetares së punës				Revista për fëmijë	
12		Punim i faqes 85 të Abetares	Mbjellim bimë	Dramatizim Lojëra Diskutim për njohuritë paraprake	Diskuton në grupe të vogla për tema që i interesojnë, bën pyetje dhe jep përgjigje të thjeshta.	Udhëzues të ndryshëm	
13	D F L Sh Gj	Veprimtari shkrimi (diktim)				Shkronja lëvizore	
14		Përforcim i shkronjave të mësuara				Fjalor	
15		Punim i shkronjës Nj, nj faqe 86 të Abetares	Njollat	Imagjinata e drejtuar Harta e konceptit Rrjeti i diskutimit Dramatizim	Shqipton saktë dhe me intonacionin e theksin e duhur fjalët . U përgjigjet me shkrim pyetjeve të thjeshta. Dallon dhe shkruan shkronjën Nj të shtypit dhe të dorës, të vogël	biblioteka	
16		Punim e shkrim i shkronjës Nj, nj, Abetare pune faqe 56				Udhëzues të ndryshëm	
17		Punim e lexim i shkronjës Nj, nj faqe 87 të Abetares				Fisha të përgatitura	
18		Ushtrime aplikative për shkrim dore, shkronja Nj, nj.				Revista për fëmijë	

19		Punim i faqes 86 - 87 të Abetares. Njollat e Njomëzës.			e të madhe. Shkruan fjalë dhe fjali me të diktuar	Fjalor	
20		Punim i shkronjës Y, y faqe 88 të Abetares	Ngjyrat e natyrës	Pyetja sjell pyetjen Diskutim për njohuritë paraprake Dramatizim Rishikim në dyshe	Reciton vjersha të shkurtra, të mësuara përmendsh Tregon e njohuritë paraprake që ka rreth temës ose përmbajtjes së tekstit që dëgjon .Shpreh pëlqimet e tij rreth ngjarjeve ose personazheve të tekstit. Dallon dhe shkruan shkronjën z të shtypit dhe të dorës, të vogël e të madhe. Merr pjesë në lojë me role.	Shkronja lëvizore	
21		Punim e shkrim i shkronjës Y, y, Abetare pune faqe 57				Fisha të përgatitura	
22		Punim e lexim i shkronjës Y, y faqe 89 të Abetares				Udhëzues të ndryshëm	
23		Ushtrime aplikative për shkrim dore, shkronja Y, y.				Biblioteka	
						Revista për fëmijë	
24		Punim i faqes 88 - 89 të Abetares. Lapsat me ngjyra					
25	D F L Sh Gj	Punim i shkronjës Z, z faqe 90 të Abetares				Fjalor	
26		Punim e shkrim i shkronjës Z, z, Abetare pune faqe 58				Shkronja lëvizore	
27		Punim e lexim i shkronjës Z, z faqe 91 të Abetares	Nënë Tereza	Harta e konceptit Rrjeti i diskutimit Imitim tingujsh e zërash Pyetja sjell pyetjen	Respekton hapësirën mes shkronjave, fjalëve; Plotëson pjesët që u mungojnë fjalëve. Shkruan fjalë dhe fjali me të diktuar . Shkruan tekste të thjeshta sipas modeleve të dhëna	Fisha të përgatitura	
28		Ushtrime aplikative për shkrim dore, shkronja Z, z.				Revista për fëmijë	
29		Punim i faqes 90 - 91 të Abetares. Zemra e Nënë Terezës				biblioteka	
30		Punim i shkronjës X, x faqe 92 të Abetares	Xixëllonja	Rishikim në dyshe Diskutim për njohuritë	U përgjigjet me shkrim pyetjeve të thjeshta. Shqipton saktë dhe me intonacionin e theksin e	Udhëzues të ndryshëm	
31		Punim e shkrim i shkronjës X, x, Abetare pune faqe 59				Shkronja lëvizore	

32		Punim e lexim i shkronjës X, x faqe 93 të Abetares		paraprake Imagjinata e drejtuar Harta e konceptit	duhur tingujt dhe fjalët. Dallon dhe shkruan shkronjën x të shtypit dhe të dorës, të vogël e të madhe. Respekton hapësirën mes shkronjave, fjalëve.	Udhëzues të ndryshëm	
33		Ushtrime aplikative për shkrim dore, shkronja X, x.				Fisha të përgatitura	
34		Punim i faqes 92 - 93 të Abetares. Ylli i vogël lart në qiell.				Revista për fëmijë	
35		Punim i shkronjës Xh, xh faqe 94 të Abetares	Profesionet			Udhëzues të ndryshëm	
36		Punim e shkrim i shkronjës Xh, xh, Abetare pune faqe 60				Fjalor	
37		Punim e lexim i shkronjës Xh, xh faqe 95 të Abetares		Rrjeti i diskutimit Stuhi mendimi Dramatizim Lojëra	Plotëson pjesët që u mungojnë fjalëve. Diskuton në grupe të vogla për tema që i interesojnë, bën pyetje dhe jep përgjigje të thjeshta.	Udhëzime nga IZHA	
38	D F L Sh Gj	Ushtrime aplikative për shkrim dore, shkronja Xh, xh.				Shkronja lëvizore	
39		Punim i faqes 94 - 95 të Abetares. Xhamaprerësi				Revista për fëmijë	
40		Punim i shkronjës Zh, zh faqe 96 të Abetares	Të mbrojmë natyrën	Rishikim në dyshe Pyetja sjell pyetjen Kubimi Diskutim për njohuritë paraprake Loja e elefantit Imagjinata e drejtuar Stuhi mendimi	demonstron të kuptuarit e teksteve që dëgjon në situata të ndryshme Shqipton saktë dhe me intonacionin e theksin e duhur tingujt dhe fjalët. Dallon dhe shkruan shkronjën zh të shtypit dhe të dorës, të vogël e të madhe. U përgjigjet me shkrim pyetjeve të thjeshta.	Fjalor	
41		Punim e shkrim i shkronjës Zh, zh, Abetare pune faqe 61				Fisha të përgatitura	
42		Punim e lexim i shkronjës Zh, zh faqe 97 te Abetares				Udhëzime nga IZHA	
43		Ushtrime aplikative për shkrim dore, shkronja Zh, zh.				Shkronja lëvizore	
44		Punim i faqes 96 - 97 të Abetares. Zhurma e pyllit.				biblioteka	
45		Punim i faqes 98 të Abetares	Alfabeti i gjuhës shqipe	Dramatizim	Përdor strategjitë e duhura për të lexuar	Fjalor	

46		Punim i faqes 99 të Abetares		Lojëra Harta e konceptit Rrjeti i diskutimit Loja e elefantit Lexim i drejtuar Imagjinata e drejtuar	tekste të thjeshta. U përgjigjet me shkrim pyetjeve të thjeshta. Reciton vjersha të shkurtra, të mësuara përmendsh Merr pjesë në lojë me role	Revista për fëmijë	
47		Punim i faqeve 98-99 të Abetares				biblioteka	
48		Veprimtari shkrimi (diktim)				Fisha të përgatitura	
49		Abetare, Abetare				Udhëzues të ndryshëm	
50		Recitojmë vjersha të ndryshme				Udhëzime nga IZHA	
51		Mësojmë për gjuhën Ush.1,2 fq. 62	Gjuha shqipe		Reciton vjersha të shkurtra, të mësuara përmendsh	Shkronja lëvizore	
52	D F L Sh Gj	Mendime të ngjyrosura				Fjalor	
53		Emra njerëzish dhe sendesh Ush 3,4 fq62	Ngjyrat	Parashikim me terma paraprake Rishikim në dyshe Lexim i drejtuar Diskutim për njohuritë paraprake Imagjinata e drejtuar Imitime tingujsh e zërash Pyetja sjell pyetjen	Shpreh pëlqimet e tij rreth ngjarjeve ose personazheve të tekstit Dallon emra njerëzish, sendesh dhe kafshësh në numrin njëjës dhe shumës. Demonstron të kuptuarit e teksteve që dëgjon në situata të ndryshme. Flet rrjedhshëm, kuptueshëm dhe me intonacionin e duhur, kur tregon një ngjarje, një përvojë të tijën ose kur përshkruan diçka.	Udhëzime nga IZHA	
54		Për një shkronjë që ti s'e vë.				Fisha të përgatitura	
55		Emra kafshësh Fq 63	Shkronjat			Revista për fëmijë	
56		Alfabeti i gjyshe Rozës				Udhëzues të ndryshëm	
57		Emra njerëzish Fq 64	Alfabeti			biblioteka	
58		Para televizorit				Shkronja lëvizore	
59		Emra Fq. 65	Televizori			Udhëzime nga IZHA	
60		Edukata				Fisha të përgatitura	
61		Emra njerëzish-kafshësh-sendesh Fq 66	Kafshët shtëpiake			Revista për fëmijë	

					Dallon emra njerëzish, sendesh dhe kafshësh në numrin njëjës dhe shumës. Shprehet saktë, kuptueshëm dhe me fjali të plota, kur bën një kërkesë, pyet, sqaron. Përdor strategjitë e duhura për të lexuar tekste të thjeshta, mëson fjalë të reja Demonstron të kuptuarit e teksteve që dëgjon në situata të ndryshme. Dallon mbiemrin si fjalë, që tregon cilësi të emrit.		
62		Në zyrën e babait		Dramatizim Imagjinata e drejtuar, Harta e konceptit Rrjeti i diskutimit Pyetja sjell pyetjen Stuhi mendimi Dramatizim Lojëra Lexim i drejtuar Rishikim në dyshe		Fjalor	
63	D F L Sh Gj	Emra njerëzish Fq 67	Profesionet			Udhëzues të ndryshëm	
64		Librat rrinë radhë - radhë				Fisha të përgatitura	
65		Emra në njëjës dhe shumës fq.68	Librat			Revista për fëmijë	
66		Biçikleta				biblioteka	
67		Emrat që tregojnë cilësi Fq 69	Dëshirat			Udhëzime nga IZHA	
68		Dy duar tre fëmijë				Shkronja lëvizore	
69		Emrat që tregojnë cilësi Fq 70	Vjersha			Fisha të përgatitura	
70		Hunda e Pinokut				Udhëzues të ndryshëm	
71		Dramatizim i një pjese	Pinoku			Fjalor	
72		Përshkruajmë shokun Fq 71 ush 1,4				Revista për fëmijë	
73		Dielli dhe reja	Përralla	Imagjinata e drejtuar Harta e konceptit Rrjeti i diskutimit Pyetja sjell pyetjen	Flet rrjedhshëm, kuptueshëm dhe me intonacionin e duhur, kur tregon një ngjarje, një përvojë të tijën ose kur përshkruan diçka. Shqipton saktë dhe me intonacionin e theksin e duhur tingujt dhe fjalët. Dallon mbiemrin si	Shkronja lëvizore	
74		Përshkruajmë sende dhe objekte Fq 71 usht 2,3				Udhëzime nga IZHA	
75		Miqtë e pyllit	Miqtë			Udhëzues të ndryshëm	
76		Fjalët që tregojnë cilësi Fq 72				Revista për fëmijë	

				Tryezë e rrumbullakët	fjalë, që tregon cilësi të emrit.		
77	D F L Sh Gj	Zemërimi i luleve	Lulet	Stuhi mendimi Dramatizim Lojëra Harta e konceptit Rrjeti i diskutimit Pyetja sjell pyetjen Dramatizim Stuhi mendimi Lojëra Tryezë e rrumbullakët	Shqipton saktë dhe me intonacionin e theksin e duhur tingujt dhe fjalët. Zgjedhon folje të rregullta në kohën e tashme, sipas modeleve të dhëna.	Fjalor	
78		Fjalë që tregojnë veprime Fq 73				Fisha të përgatitura	
79		Legjenda e luledielli t	Legjenda			Udhëzime nga IZHA	
80		Fjalë që tregojnë veprime Fq 74				Shkronja lëvizore	
81		Piktura e Edlirës	Piktura			Fisha të përgatitura	
82		Fjalët që tregojnë veprime Fq 75			Shpreh pëlqimet e tij rreth ngjarjeve ose personazheve të tekstit. Shkruan tekste të thjeshta sipas modeleve. Merr pjesë në lojë me role.	biblioteka	
83		Një gjuhë për të gjithë	Muzika			Fjalor	
84		Fjalët që tregojnë veprime Fq 76 ush 1				Udhëzues të ndryshëm	
85		Miq nga hapësira	Hapësira			Shkronja lëvizore	
86		Fjalët që tregojnë veprime Fq 76 2,3				Fisha	
87	D F L Sh Gj	Kur nuk kishte telefon	Telefoni	Imagjinata e drejtuar Harta e konceptit Pyetja sjell pyetjen Dramatizim Lexim i drejtuar Dramatizim	Flet rrjedhshëm, kuptueshëm dhe me intonacionin e duhur, kur tregon një ngjarje, një përvojë të tijën ose kur përshkruan diçka. Shprehet saktë, kuptueshëm dhe me fjali të plota, kur bën një kërkesë, pyet, sqaron, kërkon ndjesë,	Shkronja lëvizore	
88		Përshkruajmë ditëlindjen Fq 77				Udhëzime nga IZHA	
89		Flasim për filmat vizatimorë.	Filmat vizatimorë			Udhëzues të ndryshëm	
90		Përshkruajnë ditë pushimi Fq 78				Revista për fëmijë	
91		Përshkruajmë një ditë me shi Fq 79				Revista për fëmijë	

					falenderon dhe u përgjigjet pyetjeve;		
92		Kush? Çfarë? Ku? Si? Pse? fq 80	Stinët	Imagjinata e drejtuar	Dallon dhe formon fjali të thjeshta dëftore dhe pyetëse, duke respektuar shenjat e pikësimit.	Revista për fëmijë	
93		Përshkruajmë stinët Fq 81					
94		Test					

PLANIFIKIMI DITOR PËR PARAABETAREN

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 1	Klasa: 1
Tema mësimore: Abetarja ime Unë jam			Situata e të nxënit: Prezantim
R.N. sipas kompetencave kyçe: Nxënësi: K.1 dëgjon me vëmendje prezantimin e tjetrit dhe merr pjesë në diskutim me pyetje, komente apo sqarime. K.3 parashtron pyetje dhe përgjigjet në pyetjet për temën/problemin/detyrën e dhënë në njërën nga format e të shprehurit. K.4 identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në shtëpi. K.5 bashkëpunon me të tjerët pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitetet në klasë, shkollë apo jashtë saj. K.6 shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive.			
R.N. të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: • Prezanton emrin, mbiemrin para shokëve. • Përshkruan emocionet e ditës së parë të shkollës. • Lexon globalisht emrin e vet dhe të shokëve. • Shkruan emrin globalisht.			Fjalë kyçe: emër, mbiemër, unë, jam Teknika dhe strategji: • Bashkëbisedim • Punë individuale • Lexim global • Shkrim global
Burimet e informacionit dhe mjete: Abetare, lapsa, fletore, mjete vizatimi, etiketa me emrat e nxënësve, shportë, pemë e madhe e vizatuar, tabela plastike			Lidhja me fushat e tjera: Matematikë Arte Edukim me të drejtat e fëmijëve Shoqëria dhe mjedisi
Përshkrim kontekstual i situatës: *Veprimtari paraprake:* Bashkëbisedim me nxënësit rreth ditës së parë të shkollës. - Si ndieni sot? Pse? - Si u përgatitët për ditën e sotme? - Kush ju ndihmoi? - Çfarë patë kur hytë në oborr? - Si ishte shkolla, klasa? Mësuesja bën prezantimin dhe urimin e rastit. Hapi 1 Mësuesja ka përgatitur emrat e nxënësve në etiketa. Secila etiketë mban një figurë që fillon me shkronjën e parë të emrit të nxënësve. Shkronja e parë është më e madhe se shkronjat e tjera.			

Mësuesja thërret nxënësit me radhë dhe ua ngjit në gjoks etiketat me emrat përkatës.
Nxënësit lihen për 5' të bashkëbisedojnë me njëri-tjetrin.

Nxënësit prezantohen para klasës me dy-tri fjali, p.sh.:
Unë quhem Blerta. Kam një motër që quhet Jona. Prindërit e mi quhen Arta dhe Albert.
Për nxënësit që kanë vështirësi, mësuesja drejton pyetje si:

- Si quhesh?
- A ke motër ose vëlla?
- Si quhen mami dhe babi?

Mësuesja ndihmon nxënësit të vendosin etiketat në pemën e klasës.

Hapi i dytë

Mësuesja u shpërndan nxënësve etiketa ku janë shkruar emrat e tyre të pangjyrosur.
Nxënësit do të ngjyrosin shkronjat brenda vijave dhe do t'i vendosin etiketat mbi tavolinat e tyre.

Hapi i tretë

Mësuesja pyet nxënësit nëse dinë të shkruajnë emrin e tyre. Nxënësve që nuk dinë ta shkruajnë emrin e tyre u jep etiketën e parapërgatitur me emrin e tyre. Nxënësve të tjerë u jep nga një fletë të bardhë ose një tabelë plastike për të shkruar emrin.
Mësuesja nuk bën vërejtje për saktësinë e shkrimit, por i motivon nxënësit që kanë vështirësi për ta përsëritur disa herë, derisa ta realizojnë.

Hapi i katërt

Nxënësit i ngjitin etiketat me emrat e tyre në tabelë dhe më pas i lexojnë së bashku.
Mësuesja here pas here u ndërron vendin etiketave dhe lexohen përsëri, nga fillimi në fund dhe nga fundi në fillim.

Demonstrim i rezultateve të arritura:

Shkruajnë emrin e tyre.
Lexojnë emrin globalisht.

Vlerësimi i situatës:
Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- Prezanton emrin, mbiemrin para shokëve.
- Përshkruan emocionet e ditës së parë të shkollës.
- Lexon globalisht emrin e vet dhe të shokëve.
- Shkruan emrin globalisht.

Detyra:

1. Shkruajnë emrin e tyre.
2. Shkruajnë emrat e prindërve.

Refleksione:

<table>
<tr><td>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla: 1</td><td>Klasa: 1</td></tr>
<tr><td colspan="3">Tema mësimore:
Tingulli dhe shkronja A
Drejt shkollës</td><td>Situata e të nxënit:
Shkolla ime</td></tr>
<tr><td colspan="4">R.N. sipas kompetencave kyçe:
Nxënësi:
K.1 paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup.
K.2 paraqet argumente pro dhe kundër për një mendim, qëndrim, sjellje të manifestuar nga një apo më shumë persona (në klasë/shkollë apo jashtë saj).
K.3 parashtron pyetje dhe përgjigjet në pyetjet për temën /problemin/ detyrën e dhënë në njërën nga format e të shprehurit.
K.4 identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në shtëpi.
K.5 bashkëpunon me të tjerët pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitetet në klasë, shkollë apo jashtë saj.
K.6 shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive.</td></tr>
<tr><td colspan="3" rowspan="2">R.N. të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:
Nxënësi:
• Përshkruan mbi bazën e figurave.
• Dallon shkronjën A.
• Shqipton tingullin A duke e lidhur me shkronjën A.
• Gjen tingullin dhe shkronjën A në fjalë të ndryshme.
• Lexon globalisht fjalë që kanë shkronjën A në trup të tyre.
• Shkruan shkronjë A të madhe të shtypit.</td><td>Fjalë kyçe:
shkollë, klasë, oborr, mësuese, nxënës, Ani, Ola</td></tr>
<tr><td>Teknika dhe strategji:
• Bashkëbisedim
• Punë individuale
• Stuhi mendimi
• Veprimtari në dyshe</td></tr>
<tr><td colspan="3">Burimet e informacionit dhe mjete:

Abetare, Abetare pune, shkronja A, lapsa, fletore, mjete vizatimi, etiketa me fjalë, tabela plastike, figura, lodra për fëmijë, shkronja, fletë formati, fije makaronash, magnetofon, CD</td><td>Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë
Arte
Edukim me të drejtat e fëmijëve
Shoqëria dhe mjedisi</td></tr>
<tr><td colspan="4">Përshkrim kontekstual i situatës:
Veprimtari paraprake:

Mësuesja vendos në magnetofon këngën “Vallja e shkronjave”.
Dëgjohet kënga 1-2 herë dhe nxiten nxënësit të shoqërojnë këngën.
Shpjegohet kuptimi i fjalës shkronjë duke e ilustruar shpjegimin me shkronja.

Hapi i parë: Bashkëbisedim

Hapin librat dhe përshkruajnë figurën në fq. 8. Pasi njihen me dy personazhet, Anin dhe Olën, mësuesja</td></tr>
</table>

pyet:
- Ku po shkojnë Ani dhe Ola?
- Si e kuptoni që po shkojnë në shkollë? Çfarë mban Ola në dorë?
- Cili po i shoqëron?
- Si ndihen fëmijët?
- Pse mendoni se janë të gëzuar?

Lexohen emrat e tyre disa herë.
- Cilat shkronja njihni në emrat e tyre?

Hapi i dytë: Stuhi mendimi

Mësuesja nxit nxënësit të emërtojnë disa nga objektet që shohin në klasë dhe të tregojnë përse përdoren. Ndërkohë, mësuesja vendos pranë objektit etiketën me fjalën përkatëse.
Lexohen fjalët nga mësuesja, ndërsa nxënësit numërojnë sa herë dëgjojnë tingullin A.

Hapi i tretë: Veprimtari në dyshe

Mësuesja paraqet para nxënësve shkronjën A të madhe të shtypit dhe shpjegon formën e saj. E vizaton në ajër dhe pastaj në tabelë. Modelohet me fije makarona. U kërkon edhe nxënësve të bëjnë të njëjtën gjë. Shqiptohet disa herë.
Kërkon nga nxënësit në grupe dyshe të gjejnë fjalë të tjera që përmbajnë në trup të tyre tingullin A.
Nxënësit gjejnë në klasë objekte që përmbajnë tingullin A (dollapi, tabela, dritare, lapsi etj.).

Hapi i katërt: Punë individuale

Mësuesja vendos në tabelë disa figura që kanë poshtë fjalët përkatëse. (banane, akullore, ananas etj.)
Nxënësit gjejnë ku ndodhet shkronja A në këto fjalë. Mësuesja ndan fjalët në rrokje duke lëvizur duart majtas – djathtas dhe ndihmon nxënësit të gjejnë në cilën rrokje ndodhet shkronja A.
Nxënësit hapin Abetaren e punës dhe emërtojnë figurat (ARIU, ARRA).
Shkruajnë elementet e shkrimit dhe më pas shkronjën A.

Demonstrim i rezultateve të arritura:
Shkruajnë shkronjën A.
Lexojnë fjalë globalisht.
Vlerësimi i situatës:
Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:
- Përshkruan mbi bazën e figurave.
- Dallon shkronjën A.
- Shqipton tingullin A duke e lidhur me shkronjën A.
- Gjen tingullin dhe shkronjën A në fjalë të ndryshme.
- Lexon globalisht fjalë që kanë shkronjën A në trup të tyre.
- Shkruan shkronjën A të madhe të shtypit.

Detyra:
1. Shkruajnë dy rreshta me shkronjën A.
2. Shkruajnë fjalët globale ARIU, ANI, OLA.

Refleksione:

<table>
<tr><td>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla: 1</td><td>Klasa: 1</td></tr>
<tr><td colspan="3">Tema mësimore:
Tingulli dhe shkronja I
Drejt shkollës</td><td>Situata e të nxënit:
Shkolla ime</td></tr>
<tr><td colspan="4">R.N. sipas kompetencave kyçe:
Nxënësi:
K.1 paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup.
K.2 paraqet argumente pro dhe kundër për një mendim, qëndrim, sjellje të manifestuar nga një apo më shumë persona (në klasë/shkollë apo jashtë saj).
K.3 grumbullon dhe klasifikon materialet e performancës së vet, për përgatitjen apo pasurimin e portofolit personal.
K.4 identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në shtëpi.
K.5 bashkëpunon me të tjerët pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitetet në klasë, shkollë apo jashtë saj.
K.6 vendos duke bashkëpunuar me të gjithë anëtarët për mënyrat që çojnë drejt përfundimit të një aktiviteti të caktuar.</td></tr>
<tr><td colspan="3" rowspan="2">R.N. të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:
Nxënësi:
• Përshkruan klasën dhe shkollën.
• Dallon shkronjën I.
• Shqipton tingullin I duke e lidhur me shkronjën I.
• Gjen tingullin dhe shkronjën I në fjalë të ndryshme.
• Lexon globalisht fjalë që kanë shkronjën I në trup të tyre. Shkruan shkronjë I të madhe të shtypit.</td><td>Fjalë kyçe:
shkollë, klasë, oborr, mësuese, nxënës, Ani, Umi</td></tr>
<tr><td>Teknika dhe strategji:
• Bashkëbisedim
• Stuhi mendimi
• Demonstrim/punë në grupe
• Punë individuale</td></tr>
<tr><td colspan="3">Burimet e informacionit dhe mjete:

Abetare, Abetare pune, shkronja I, lapsa, fletore, mjete vizatimi, etiketa me fjalë, tabela plastike, figura, lodra për fëmijë, shkronja, fletë formati, fije makaronash, magnetofon, CD</td><td>Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë
Arte
Edukim me të drejtat e fëmijëve
Shoqëria dhe mjedisi</td></tr>
<tr><td colspan="4">Përshkrim kontekstual i situatës:
Veprimtari paraprake:

Mësuesja u kërkon nxënësve të mbyllin sytë dhe të dëgjojnë përshkrimin që do të bëjë mësuesja. Nxënësit mbyllin sytë, dëgjojnë përshkrimin dhe gjejnë për cilin vend flitet:
Një oborr i madh me shumë fëmijë që luajnë e lodrojnë të gëzuar.(shkolla)
Një dhomë e madhe me shumë fëmijë, shumë tavolina, libra e fletore.(klasa)

Hapi i parë: Bashkëbisedim

Hapin librat dhe përshkruajnë figurën në fq. 9. Mësuesja pyet:
- Çfarë shikoni në figurë? Si është shkolla e tyre? Si është oborri?</td></tr>
</table>

- A ngjan me shkollën tuaj? Pse?
- Çfarë ka përreth shkollës? Si po shkojnë fëmijët? Cili i shoqëron?

Lexohet disa herë emri UMI.

- Cilat shkronja njihni në këtë fjalë?

Hapi i dytë: Stuhi mendimi

Mësuesja thotë disa fjalë dhe kërkon nga nxënësit të gjejnë në cilat prej tyre dëgjojnë tingullin I (lapsi, dritare, lule, oborri, akullore, majmuni, etj) .
Mësuesja nxit nxënësit të emërtojnë disa nga objektet që shohin në klasë dhe të tregojnë përse përdoren.
Ndërkohë, mësuesja vendos pranë objektit etiketën me fjalën përkatëse.
Lexohen fjalët nga mësuesja, ndërsa nxënësit numërojnë sa herë dëgjojnë tingullin I (muri, çanta, stilolapsi, dollapi, etj.) .

Hapi i tretë: Demonstrim/punë në grupe

Mësuesja paraqet para nxënësve shkronjën I të madhe të shtypit dhe shpjegon formën e saj. E vizaton në ajër dhe pastaj në tabelë. Modelohet me fije makarona, tela të përthyeshëm. U kërkon edhe nxënësve të bëjnë të njëjtën gjë.
Shqiptohet disa here tingulli I nga nxënësit.
Kërkon nga nxënësit në grupe të gjejnë shkronjën I në etiketat me emrat e nxënësve. U jepet kohë nxënësve për t'i gjetur dhe më pas diskutohen gjetjet.

Hapi i katërt: Punë individuale
Mësuesja vendos në tabelë disa figura që kanë poshtë fjalët përkatëse (topi, lule, deti, çadra, ariu etj.).
Nxënësit gjejnë ku ndodhet shkronja I në këto fjalë. Mësuesja ndan fjalët në rrokje duke lëvizur duart majtas – djathtas dhe ndihmon nxënësit të gjejnë në cilën rrokje ndodhet shkronja I.
Nxënësit hapin Abetaren e punës dhe emërtojnë figurat (LIBRI, IRIQI, ANI). Plotësojnë kutizat me shkronjën I.
Shkruajnë elementet e shkrimit dhe më pas shkronjën I. Mësuesja ndjek nga afër punën e nxënësve dhe ndihmon ata që kanë vështirësi.

Demonstrim i rezultateve të arritura:
Shkruajnë shkronjën I.
Lexojnë fjalë globalisht.
Vlerësimi i situatës:
Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- Përshkruan klasën dhe shkollën.
- Dallon shkronjën I.
- Shqipton tingullin I duke e lidhur me shkronjën I.
- Gjen tingullin dhe shkronjën I në fjalë të ndryshme.
- Lexon globalisht fjalë që kanë shkronjën I në trup të tyre.
  Shkruan shkronjë I të madhe të shtypit.

Detyra:

1. Shkruajnë dy rreshta me shkronjën I.
2. Shkruajnë fjalët globale ARIU, ANI, UMI.
3. Vizatojnë shkollën e tyre.

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 1	Klasa: 1
Tema mësimore: Tingulli dhe shkronja M Drejt shkollës			Situata e të nxënit: Shkolla ime
R.N. sipas kompetencave kyçe: Nxënësi: K.1 paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup. K.2 paraqet argumente pro dhe kundër për një mendim, qëndrim, sjellje të manifestuar nga një apo më shumë persona (në klasë/shkollë apo jashtë saj). K.3 parashtron pyetje dhe përgjigjet në pyetjet për temën /problemin/ detyrën e dhënë në njërën nga format e të shprehurit. K.4 identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në shtëpi. K.5 bashkëpunon me të tjerët pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitetet në klasë, shkollë apo jashtë saj. K.6 shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive.			
R.N. të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: • Përshkruan shkollën mbi bazën e figurës. • Dallon shkronjën M të madhe të shtypit. • Shqipton tingullin M duke e lidhur me shkronjën M. • Gjen tingullin dhe shkronjën M në fjalë të ndryshme. • Lexon globalisht fjalë që kanë shkronjën M në trup të tyre. Shkruan shkronjën M të madhe të shtypit.			Fjalë kyçe: shkollë, klasë, oborr, mësuese, nxënës, mami, mali, macja Teknika dhe strategji: • Bashkëbisedim • Stuhi mendimi • Demonstrim/punë në grupe • Punë individuale
Burimet e informacionit dhe mjete: Abetare, Abetare pune, shkronja M, lapsa, fletore, mjete vizatimi, etiketa me fjalë, tabela plastike, figura, lodra për fëmijë, shkronja, fletë formati, fije makaronash, magnetofon, CD.			Lidhja me fushat e tjera: Matematikë Arte Edukim me të drejtat e fëmijëve Shoqëria dhe mjedisi
Përshkrim kontekstual i situatës: *Veprimtari paraprake:* Mësuesja paraqet disa vizatime të shkollës të bëra nga nxënësit në shtëpi dhe i nxit nxënësit të përshkruajnë shkollën mbi bazën e tyre. Hapi i parë: Lojë Mësuesja ka futur në një kuti një mollë. Fton nxënësit të futin dorën dhe ta prekin. Tregojnë se çfarë është e më pas mësuesja nxjerr figurën e mollës poshtë së cilës është shkruar fjala *MOLLA*. (shkronja M shkruhet me ngjyrë tjetër). Shqiptohet fjala nga nxënësit disa herë.			

Hapi i dytë: Stuhi mendimi

Mësuesja thotë disa fjalë dhe kërkon nga nxënësit të gjejnë në cilat prej tyre dëgjojnë tingullin M (lapsi, muri, lule, milingona, akullore, majmuni etj.) .
Lexohen fjalët nga mësuesja, ndërsa nxënësit numërojnë sa herë dëgjojnë tingullin M.

Hapi i tretë: Demonstrim/punë në grupe

Mësuesja paraqet para nxënësve shkronjën M të madhe të shtypit dhe shpjegon formën e saj. Vihet në dukje ngjashmëria e shkronjës M me malet duke vizatuar një varg malesh në tabelë. E vizaton në ajër dhe pastaj në tabelë. Modelohet me fije makarona, tela të përthyeshëm. U kërkon edhe nxënësve të bëjnë të njëjtën gjë.
Shqiptohet disa here tingulli M nga nxënësit.
Nxënësit gjejnë fjalë të tjera me shkronjën M, mësuesja i shkruan në tabelë dhe nxënësit qarkojnë shkronjën.
Në faqen 9 të Abetares dallojnë shkronjën M te fjala UMI.

Hapi i katërt: Punë individuale

Nxënësit hapin Abetaren e punës dhe emërtojnë figurat (MAMI, MALI, MACJA). Plotësojnë kutizat me shkronjën M.
Shkruajnë elementet e shkrimit dhe më pas shkronjën M. Mësuesja ndjek nga afër punën e nxënësve dhe ndihmon ata që kanë vështirësi.
Kujtojnë përrallën *Iriqi dhe mollët,* duke e treguar ose lexuar mësuesja.
Vizatojnë mollën dhe shkruajnë globalisht fjalën MOLLA.

Demonstrim i rezultateve të arritura:
Shkruajnë shkronjën M.
Lexojnë globalisht fjalë me shkronjën M.

Vlerësimi i situatës:
Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- Përshkruan shkollën mbi bazën e figurës.
- Dallon shkronjën M të madhe të shtypit.
- Shqipton tingullin M duke e lidhur me shkronjën M.
- Gjen tingullin dhe shkronjën M në fjalë të ndryshme.
- Lexon globalisht fjalë që kanë shkronjën M në trup të tyre.
  Shkruan shkronjë M të madhe të shtypit.

Detyra:

1. Shkruajnë dy rreshta me shkronjën M.
2. Shkruajnë fjalët globale MAMI, MACJA, MALI, MOLLA.

Refleksione:

<table>
<tr><td>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla: 1</td><td>Klasa: 1</td></tr>
<tr><td colspan="3">Tema mësimore:
Tingulli dhe shkronja N</td><td>Situata e të nxënit:
Numrat</td></tr>
<tr><td colspan="4">R.N. sipas kompetencave kyçe:
Nxënësi:
K.1 paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup.
K.2 paraqet argumente pro dhe kundër për një mendim, qëndrim, sjellje të manifestuar nga një apo më shumë persona (në klasë/shkollë apo jashtë saj).
K.3 grumbullon dhe klasifikon materialet e performancës së vet, për përgatitjen apo pasurimin e portofolit personal.
K.4 identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në shtëpi.
K.5 bashkëpunon me të tjerët pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitetet në klasë, shkollë apo jashtë saj.
K.6 vendos duke bashkëpunuar me të gjithë anëtarët për mënyrat që çojnë drejt përfundimit të një aktiviteti të caktuar.</td></tr>
<tr><td colspan="3" rowspan="2">R.N. të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:
Nxënësi:
• Dallon shkronjën N të madhe të shtypit.
• Shqipton tingullin N duke e lidhur me shkronjën N.
• Lexon globalisht fjalë që kanë shkronjën N në trup të tyre. Shkruan shkronjë N të madhe të shtypit.</td><td>Fjalë kyçe:
shtëpi, nënë, numra</td></tr>
<tr><td>Teknika dhe strategji:
• Bashkëbisedim
• Stuhi mendimi
• Demonstrim/punë në grupe
• Punë individuale</td></tr>
<tr><td colspan="3">Burimet e informacionit dhe mjete:

Abetare, Abetare pune, shkronja N, shkronjat e mësuara (A, I, M) lapsa, fletore, mjete vizatimi, etiketa me fjalë, tabela plastike, figura, lodra për fëmijë, shkronja, fletë formati, fije makaronash, magnetofon, CD</td><td>Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë
Arte
Edukim me të drejtat e fëmijëve
Shoqëria dhe mjedisi
Edukim fizik, sporte dhe shëndet</td></tr>
<tr><td colspan="4">Përshkrim kontekstual i situatës:
Veprimtari paraprake:
Mësuesja i nxjerr nxënësit për disa minuta në oborr dhe zhvillon me ta lojën “Thërritja e numrave”. Nxënësit ndahen në dy skuadra me numër të barabartë nxënësish dhe secili nxënës numëron duke filluar nga 1 deri… (varet nga numri i nxënësve).
Mësuesja qëndron në krye të dy skuadrave (skuadrat vendosen përballë njëra-tjetrës) me një shami në dorë dhe thërret numrat, p. sh. numrin 1. Nxënësit e të dy skuadrave që kanë numrin 1 nisen me vrap për të rrëmbyer shaminë. Nxënësi që e kap shaminë i pari fiton një pike për skuadrën e tij. Përsëritet loja disa herë.</td></tr>
</table>

Hapi i parë: Bashkëbisedim

Mësuesja vendos në tabelë disa numra. Fton nxënësit t'i lexojnë dhe pyet:
- Çfarë janë këta që lexuam?
- Përse na duhen numrat?
- Në cilën lëndë mësojmë për numrat?

Shkruan fjalë NUMRA ku shkronja N dallohet me ngjyrë tjetër dhe lexohet disa herë. Mësuesja tregon kujdes për të dëgjuar të gjithë nxënësit si shqiptojnë tingullin N.

Hapi i dytë: Stuhi mendimi

Mësuesja thotë disa fjalë dhe kërkon nga nxënësit të gjejnë në cilat prej tyre dëgjojnë tingullin N dhe të thonë *STOP* (unë, Ola, Ani, mami, nëna etj.).
Nxiten nxënësit të gjejnë fjalë të tjera me shkronjën N. Mësuesja i shkruan në tabelë dhe nxënësit qarkojnë shkronjën N.

Hapi i tretë: Demonstrim/punë në grupe

Mësuesja paraqet para nxënësve shkronjën N të madhe të shtypit dhe shpjegon formën e saj. E vizaton në ajër dhe pastaj në tabelë. Modelohet me fije makarona, tela të përthyeshëm.
U kërkon edhe nxënësve të bëjnë të njëjtën gjë.

Hapi i katërt: Punë individuale

Nxënësit hapin Abetaren e punës dhe emërtojnë figurat (NUMRA, NËNA). Plotësojnë kutizat me shkronjën N.
Shkruajnë elementet e shkrimit dhe më pas shkronjën N. Mësuesja ndjek nga afër punën e nxënësve dhe ndihmon ata që kanë vështirësi.
Ngjyrosin numra të ndryshëm në fletë të bardha.

Demonstrim i rezultateve të arritura:
Shkruajnë shkronjën N.
Lexojnë fjalë globalisht.
Vlerësimi i situatës:
Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:
- Dallon shkronjën N të madhe të shtypit.
- Shqipton tingullin N duke e lidhur me shkronjën N.
- Lexon globalisht fjalë që kanë shkronjën N në trup të tyre.
  Shkruan shkronjë N të madhe të shtypit.

Detyra:
1. Shkruajnë dy rreshta me shkronjën N.
2. Shkruajnë fjalët globale NËNA, NUMRA, ANI.
3. Gjejnë në tituj gazetash shkronjën N.

Refleksione:

<table>
<tr><td>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla: 1</td><td>Klasa: 1</td></tr>
<tr><td colspan="3">Tema mësimore:
Tingujt dhe shkronjat E, Ë
Në shtëpi</td><td>Situata e të nxënit:
Elefanti</td></tr>
<tr><td colspan="4">R.N. sipas kompetencave kyçe:
Nxënësi:
K.1 paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup.
K.2 paraqet argumente pro dhe kundër për një mendim, qëndrim, sjellje të manifestuar nga një apo më shumë persona (në klasë/shkollë apo jashtë saj).
K.3 parashtron pyetje dhe përgjigjet në pyetjet për temën/problemin/detyrën e dhënë në njërën nga format e të shprehurit.
K.4 identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në shtëpi.
K.5 bashkëpunon me të tjerët pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitetet në klasë, shkollë apo jashtë saj.
K.6 shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive.</td></tr>
<tr><td colspan="3" rowspan="2">R.N. të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:
Nxënësi:
• Dallon shkronjat E, Ë në fjalët e dhëna.
• Shqipton tingujt E, Ë duke i lidhur me shkronjat E, Ë.
• Gjen tingujt dhe shkronjat E, Ë në fjalë të ndryshme.
• Lexon globalisht fjalë që kanë shkronjat E, Ë në trup të tyre.
• Shkruan shkronjat E, Ë të mëdha të shtypit.</td><td>Fjalë kyçe:
elefant, era, ena, hëna, nëna</td></tr>
<tr><td>Teknika dhe strategji:
• Lojë
• Punë individuale
• Stuhi mendimi
• Veprimtari në dyshe</td></tr>
<tr><td colspan="3">Burimet e informacionit dhe mjete:

Abetare, Abetare pune, shkronjat E, Ë, shkronjat e mësuara, lapsa, fletore, mjete vizatimi, etiketa me fjalë, tabela plastike, figura, lodra për fëmijë, shkronja, fletë formati, fije makaronash, magnetofon, CD</td><td>Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë
Arte
Edukim me të drejtat e fëmijëve
Shkencat natyrore
Edukim fizik, sporte dhe shëndet</td></tr>
<tr><td colspan="4">Përshkrim kontekstual i situatës:
Veprimtari paraprake:

Mësuesja organizon me nxënësit “Lojën e elefantit”.
Në fillim këndon këngën mësuesja: “Një elefant, një elefant, në fije t’perit kolovitet dhe kur e pa që s’u këput, thirri dhe një tjetër elefant”.
Kapet dorazi me një nxënës dhe rifillon këngën bashkë me nxënësit e tjerë: “dy elefantë, dy elefantë, në fije t’perit koloviten dhe kur e panë që s’u këput, thirrën dhe një tjetër elefant”.
Loja vazhdon duke renditur 5 – 6 “elefantë”.</td></tr>
</table>

Hapi i parë: Stuhi mendimi

Mësuesja nxit nxënësit të tregojnë çfarë dinë për elefantin. Mbasi dëgjon mendimet e nxënësve, mësuesja përmbledh mendimet e tyre:
Elefanti është kafshë barngrënëse. Është kafsha më e madhe në tokë. Ai ka një hundë të gjatë.
Shkruhet në tabelë fjala ELEFANTI dhe lexohet disa herë së bashku me nxënësit. Shkronja E shkruhet me ngjyrë tjetër.
Mësuesja shqipton edhe fjalë të tjera me shkronjën E, nxënësit thonë STOP kur dëgjojnë tingullin E (dritare, dollap, park, lulishte, banane, etj.).

Hapi i dytë: Veprimtari në dyshe

Mësuesja paraqet para nxënësve shkronjën E të madhe të shtypit dhe shpjegon formën e saj. E vizaton në ajër dhe pastaj në tabelë.
Shqiptohet disa herë.
Kërkon nga nxënësit në grupe dyshe të gjejnë fjalë të tjera që përmbajnë në trup të tyre tingullin E.
Nxënësit gjejnë në klasë objekte që përmbajnë tingullin E (fletore, tabela, dritare, dera,etj.).
Paraqet dhe shkronjën Ë dhe krahasohet me shkronjën E.
Nxiten të tregojnë fjalë me shkronjën Ë.

Hapi i tretë: Punë individuale

Mësuesja vendos në tabelë disa figura që kanë poshtë fjalët përkatëse (banane, akullore, ëndërr, ëmbëlsirë, mollë, etj.)
Nxënësit gjejnë ku ndodhen shkronjat E, Ë në këto fjalë. Mësuesja ndan fjalët në rrokje duke lëvizur duart majtas – djathtas dhe ndihmon nxënësit të gjejnë në cilën rrokje ndodhet shkronja E dhe në cilat shkronja Ë.
Hapet Abetarja në faqen 10 dhe tregojnë çfarë shohin.
Nxënësit hapin Abetaren e punës dhe emërtojnë figurat (ENA, ERA, ELEFANTI, HËNA, NËNA).
Shkruajnë elementet e shkrimit dhe më pas shkronjat E, Ë.
Modelohet me fije makarona. U kërkon edhe nxënësve të bëjnë të njëjtën gjë.
Demonstrim i rezultateve të arritura:
Shkruajnë shkronjat E, Ë.
Lexojnë fjalë globalisht.
Vlerësimi i situatës:
Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- Dallon shkronjat, E, Ë në fjalët e dhëna.
- Shqipton tingujt E, Ë duke i lidhur me shkronjat E, Ë.
- Gjen tingujt dhe shkronjat E, Ë në fjalë të ndryshme.
- Lexon globalisht fjalë që kanë shkronjat, E, Ë në trup të tyre.
- Shkruan shkronjat E, Ë të mëdha të shtypit.

Detyra:

1. Shkruajnë nga dy rreshta me shkronjat E, Ë.
2. Shkruajnë fjalët globale ENA, ERA, ELEFANTI, HËNA, NËNA.
3. Vizatojnë elefantin.

Refleksione:

<table>
<tr><td>Fusha:Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla 1</td><td>Klasa 1</td></tr>
<tr><td colspan="3">Tema mësimore:
Tingulli dhe shkronja B
Në mëngjes</td><td>Situata e të nxënit:
Balona</td></tr>
<tr><td colspan="4">R.N. sipas kompetencave kyçe:
Nxënësi:
K.1 paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup.
K.3 ndjek udhëzimet e dhëna në një tekst për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë, që kërkohet.
K.3 grumbullon dhe klasifikon materialet e performancës së vet, për përgatitjen apo pasurimin e portofolit personal.
K.4 identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në shtëpi.
K.5 bashkëpunon me të tjerët pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitetet në klasë, shkollë apo jashtë saj.
K.6 shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive.</td></tr>
<tr><td colspan="3" rowspan="2">R.N. të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:
Nxënësi:
• Përshkruan mbi bazën e figurave veprimet që bën në mëngjes.
• Dallon shkronjën B.
• Shqipton tingullin B duke e lidhur me shkronjën B.
• Gjen tingullin dhe shkronjën B në fjalë të ndryshme.
• Lexon globalisht fjalë që kanë shkronjën B në trup të tyre. Shkruan shkronjën B të madhe të shtypit.</td><td>Fjalë kyçe:
bëj, balona, balena, bebi</td></tr>
<tr><td>Teknika dhe strategji:
• Stuhi mendimi
• Demonstrim
• Punë individuale
• Lojë</td></tr>
<tr><td colspan="3">Burimet e informacionit dhe mjete:

Abetare, Abetare pune, shkronja B, lapsa, fletore, mjete vizatimi, etiketa me fjalë, tabela plastike, figura, lodra për fëmijë, shkronja, fletë formati, fije makaronash, magnetofon, CD</td><td>Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë
Arte
Edukim me të drejtat e fëmijëve
Shoqëria dhe mjedisi
Edukim fizik, sporte dhe shëndet</td></tr>
<tr><td colspan="4">Përshkrim kontekstual i situatës:
Veprimtari paraprake:

Nxënësit kanë parapërgatitur që më parë balona të ndryshme dhe i paraqesin para shokëve.
Krahasohen format, ngjyrat dhe madhësitë e tyre.
Nxënësit shkruajnë nëpër balona shkronjat e mësuara.

Hapi i parë: Stuhi mendimi
Mësuesja thotë disa fjalë dhe kërkon nga nxënësit të gjejnë në cilat prej tyre dëgjojnë tingullin B (bebi, laps, derë, banane, bora, biçikletë etj.).
Mësuesja nxit nxënësit të tregojnë fjalë që përmbajnë shkronjën B dhe i shkruan fjalët në tabelë.</td></tr>
</table>

Hapi i dytë: Demonstrim

Mësuesja paraqet para nxënësve shkronjën B të madhe të shtypit dhe shpjegon formën e saj. E vizaton në ajër dhe pastaj në tabelë.
Modelohet shkronja B duke përdorur materiale të ndryshme dhe kërkohet nga nxënësit të bëjnë të njëjtë gjë.
Shqiptohet disa here tingulli B nga nxënësit.
Qarkohet shkronja B në fjalët e shkruara në tabelë dhe përcaktohet vendi i saj (në fillim, në mes, në fund).

Hapi i tretë: Punë individuale

Hapet Abetarja në faqen 14 dhe përshkruajnë çfarë veprimesh bëjnë në mëngjes.
Nxënësit hapin Abetaren e punës dhe emërtojnë figurat (BALONA, BEBI, BALENA). Plotësojnë kutizat me shkronjën B.
Shkruajnë elementet e shkrimit dhe më pas shkronjën B. Mësuesja ndjek nga afër punën e nxënësve dhe ndihmon ata që kanë vështirësi.
Shkruajnë edhe shkronjën B mbi balonat e përgatitura dhe dalin në oborr për të ngritur balonat e përgatitura.

Hapi i katërt: Lojë

Mësuesja thotë fjalë të ndryshme. Te fjalët që do të dëgjojnë tingullin B, nxënësit çohen në këmbë ose ngrenë dorë lart.
Përsërite loja disa herë.

Demonstrim i rezultateve të arritura:
Shkruajnë shkronjën B në fletoren individuale.
Lexojnë fjalë globalisht.

Vlerësimi i situatës:
Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- Përshkruan mbi bazën e figurave veprimet që bën në mëngjes.
- Dallon shkronjën B.
- Shqipton tingullin B duke e lidhur me shkronjën B.
- Gjen tingullin dhe shkronjën B në fjalë të ndryshme.
- Lexon globalisht fjalë që kanë shkronjën B në trup të tyre.
  Shkruan shkronjën B të madhe të shtypit.

Detyra:

1. Shkruajnë dy rreshta me shkronjën B.
2. Shkruajnë fjalët globale BALONA, BALENA, BEBI.
3. Vizatojnë balona.

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 1	Klasa: 1
Tema mësimore: Tingulli dhe shkronja F Në fshat			Situata e të nxënit: Fshati

R.N. sipas kompetencave kyçe:
Nxënësi:
K.1 paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup.
K.2 paraqet argumente pro dhe kundër për një mendim, qëndrim, sjellje të manifestuar nga një apo më shumë persona (në klasë/shkollë apo jashtë saj).
K.3 parashtron pyetje dhe përgjigjet në pyetjet për temën /problemin/detyrën e dhënë në njërën nga format e të shprehurit.
K.4 identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në shtëpi.
K.5 bashkëpunon me të tjerët pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitetet në klasë, shkollë apo jashtë saj.
K.6 shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive.

R.N. të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:
Nxënësi:

- Përshkruan mbi bazën e figurave duke folur rrjedhshëm, qartë.
- Dallon shkronjën F.
- Shqipton tingullin F duke e lidhur me shkronjën F.
- Gjen tingullin dhe shkronjën F në fjalë të ndryshme.
- Lexon globalisht fjalë që kanë shkronjën F në trup të tyre. Shkruan shkronjën F të madhe të shtypit.

Fjalë kyçe:
fshat, fiku, flutura

Teknika dhe strategji:

- Stuhi mendimi
- Demonstrim
- Punë individuale
- Lojë

Burimet e informacionit dhe mjete:

Abetare, Abetare pune, shkronja F, lapsa, fletore, mjete vizatimi, etiketa me fjalë, tabela plastike, figura, lodra për fëmijë, shkronja, fletë formati, fije makaronash, magnetofon, CD, videoprojektor

Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë
Arte
Shoqëria dhe mjedisi

Përshkrim kontekstual i situatës:
Veprimtari paraprake:

Mësuesja paraqet me videoprojektor ose me foto pamje të ndryshme nga fshati dhe i nxit nxënësit të tregojnë çfarë shohin.
Nxënësit sjellin përvoja personale nga fshati në qoftë se kanë.

Hapi i parë: Bashkëbisedim
Nxënësit hapin Abetaren në faqen 16 dhe vështrojnë me kujdes. Mësuesja pyet:

- Çfarë shikoni në figurë?
- Si është veshur punëtori? Pse?
- Çfarë ka në karrocë? Po fëmijët çfarë kanë në duar?
- Cilat kafshë duken në figurë?

Nxënësit dallojnë shkronjat e mësuara te fjalët e dhëna, ose i lexojnë fjalët globalisht nëse mundin.
Mësuesja shkruan fjalën FSHATI (shkronja F shkruhet me ngjyrë tjetër) në tabelë dhe lexohet disa herë bashkë me nxënësit.

Hapi i dytë: Stuhi mendimi

Mësuesja thotë disa fjalë dhe kërkon nga nxënësit të gjejnë në cilat prej tyre dëgjojnë tingullin F (festë, lule, fik, flutur, vezë, makinë).
Mësuesja nxit nxënësit të tregojnë fjalë që përmbajnë shkronjën F dhe i shkruan fjalët në tabelë.

Hapi i tretë: Demonstrim

Mësuesja paraqet para nxënësve shkronjën F të madhe të shtypit dhe shpjegon formën e saj. Krahasohet me shkronjat e tjera të mësuara (E, Ë). E vizaton në ajër dhe pastaj në tabelë.
Modelohet shkronja F duke përdorur materiale të ndryshme dhe kërkohet nga nxënësit të bëjnë të njëjtë gjë. E shkruajnë në tabelat plastike.
Shqiptohet disa herë tingulli F nga nxënësit.
Qarkohet shkronja F në fjalët e shkruara në tabelë dhe përcaktohet vendi i saj (në fillim, në mes, në fund).

Hapi i katërt: Punë individuale

Nxënësit hapin Abetaren e punës dhe emërtojnë figurat (FIKU, FLUTURA). Plotësojnë kutizat me shkronjën F.
Shkruajnë elementet e shkrimit të dorës dhe më pas shkronjën B. Mësuesja ndjek nga afër punën e nxënësve dhe ndihmon ata që kanë vështirësi.

Hapi i pestë: Lojë

Mësuesja thotë fjalë të ndryshme. Te fjalët që do të dëgjojnë tingullin F, nxënësit çohen në këmbë ose ngrenë dorë lart.
Përsërite loja disa herë.
Demonstrim i rezultateve të arritura:
Shkruajnë shkronjën F në fletoren individuale.
Lexojnë globalisht fjalë me shkronjën F.
Vlerësimi i situatës:
Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- Përshkruan mbi bazën e figurave duke folur rrjedhshëm, qartë.
- Dallon shkronjën F.
- Shqipton tingullin F duke e lidhur me shkronjën F.
- Gjen tingullin dhe shkronjën F në fjalë të ndryshme.
- Lexon globalisht fjalë që kanë shkronjën F në trup të tyre.
  Shkruan shkronjën F të madhe të shtypit.

Detyra:

1. Shkruajnë dy rreshta me shkronjën F.
2. Shkruajnë fjalët globale FIKU, FLUTURA, FSHATI.
3. Vizatojnë fluturën.

Refleksione:

<table>
<tr><td>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla 1</td><td>Klasa 1</td></tr>
<tr><td colspan="3">Tema mësimore:
Tingujt dhe shkronjat C, Ç</td><td>Situata e të nxënit:
Zogjtë</td></tr>
<tr><td colspan="4">R.N. sipas kompetencave kyçe:
Nxënësi:
K.1 paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup.
K.3 mbikëqyr në mënyrë të pavarur përparimin e vet në një detyrë, aktivitet duke përdorur teknika të ndryshme për gjetjen e gabimeve (si shënim të gabimeve - vështirësive) dhe i korrigjon ato derisa gjen zgjidhjen.
K.4 identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në shtëpi.
K.5 bashkëpunon me të tjerët pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitetet në klasë, shkollë apo jashtë saj.
K.6 shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive.</td></tr>
<tr><td colspan="3" rowspan="2">R.N. të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:
Nxënësi:
• Dallon shkronjat C, Ç.
• Shqipton tingujt C,Ç duke i lidhur me shkronjat C, Ç.
• Gjen tingujt dhe shkronjat C, Ç në fjalë të ndryshme.
• Lexon globalisht fjalë që kanë shkronjat C, Ç në trup të tyre. Shkruan shkronjat C, Ç të mëdha të shtypit.</td><td>Fjalë kyçe:
Zogj, ciu- ciu, mace, celular, çadër, çekiç</td></tr>
<tr><td>Teknika dhe strategji:
• Stuhi mendimi
• Demonstrim
• Punë individuale</td></tr>
<tr><td colspan="3">Burimet e informacionit dhe mjete:

Abetare, Abetare pune, shkronjat C, Ç, lapsa, fletore, mjete vizatimi, etiketa me fjalë, tabela plastike, figura, lodra për fëmijë, shkronja, fletë formati, fije makaronash, magnetofon, CD</td><td>Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë
Arte
Shoqëria dhe mjedisi
Edukim mjedisor</td></tr>
<tr><td colspan="4">Përshkrim kontekstual i situatës:
Veprimtari paraprake:

Në magnetofon, mësuesja vendos një kasetë me cicërima zogjsh dhe lihen nxënësit të dëgjojnë dhe të shprehin emocionet e tyre për disa minuta.
Mësuesja pyet:
- Çfarë po dëgjoni?
- Ku i keni dëgjuar cicërimat e tyre?
- Çfarë dini ju për zogjtë?
- Pse janë të dobishëm zogjtë për drurët?
- Cili zog është quajtur doktori i pemëve? Pse? Si godet ai me sqep?</td></tr>
</table>

Mësuesja fton nxënësit të imitojnë zogj të ndryshëm nëse dinë.

Më pas këndojnë këngën: Ciu, ciu, ciu o zog i vogël,
ciu, ciu qan apo këndon?
Ciu, ciu flas me nënën time,
nëna gjuhën ma kupton.
Kënga shoqërohet edhe me përplasjen e shuplakave.

Hapi i parë: Stuhi mendimi

Mësuesja i ndan nxënësit në dy grupe. Njëri grup do të gjejë fjalë me shkronjën C, ndërsa grupi tjetër do të gjejë fjalë me shkronjën Ç. Mësuesja i shkruan fjalët në tabelë, derisa grupet të mos kenë më fjalë.

Hapi i dytë: Demonstrim

Mësuesja paraqet para nxënësve shkronjat C, Ç të mëdha të shtypit dhe shpjegon formën e tyre.
Krahasohen me njëra - tjetrën. I vizaton në ajër dhe pastaj në tabelë.
Modelohen shkronjat C, Ç duke përdorur materiale të ndryshme dhe kërkohet nga nxënësit të bëjnë të njëjtë gjë. I shkruajnë në tabelat plastike.
Shqiptohen disa herë tingujt C, Ç nga nxënësit.
Qarkohen shkronjat C, Ç në fjalët e shkruara në tabelë dhe përcaktohet vendi i tyre (në fillim, në mes, në fund).

Hapi i tretë: Punë individuale

Nxënësit hapin Abetaren e punës dhe emërtojnë figurat (celular, mace, çakalli, çadër, çekiç). Ndahen fjalët në rrokje dhe plotësojnë kutizat me shkronjat C, Ç.
Shkruajnë elementet e shkrimit të dorës dhe më pas shkronjat C, Ç. Mësuesja ndjek nga afër punën e nxënësve dhe ndihmon ata që kanë vështirësi.

Demonstrim i rezultateve të arritura:
Shkruajnë shkronjat C, Ç në fletoren individuale.
Lexojnë globalisht fjalë me shkronjat C, Ç.

Vlerësimi i situatës:
Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- Dallon shkronjat C, Ç.
- Shqipton tingujt C, Ç duke i lidhur me shkronjat C, Ç.
- Gjen tingujt dhe shkronjat C, Ç në fjalë të ndryshme.
- Lexon globalisht fjalë që kanë shkronjat C, Ç në trup të tyre.
  Shkruan shkronjat C, Ç të mëdha të shtypit.

Detyra:

1. Shkruajnë nga dy rreshta me shkronjat C, Ç.
2. Shkruajnë fjalët globale CELULAR, MACE, ÇAKALLI, ÇADËR, ÇEKIÇ.

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 1	Klasa: 1
Tema mësimore: Tingujt dhe shkronjat H, U			Situata e të nxënit: Zërat e natyrës

R.N. sipas kompetencave kyçe:
Nxënësi:
K.1 paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup.
K.3 ndjek udhëzimet e dhëna në një tekst për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë, që kërkohet.
K.3 mbikëqyr në mënyrë të pavarur përparimin e vet në një detyrë, aktivitet duke përdorur teknika të ndryshme për gjetjen e gabimeve (si shënim të gabimeve - vështirësive) dhe i korrigjon ato derisa gjen zgjidhjen.
K.4 identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në shtëpi.
K.5 bashkëpunon me të tjerët pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitetet në klasë, shkollë apo jashtë saj.
K.6 shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive.

R.N. të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:
Nxënësi:

- Dallon shkronjat H, U.
- Shqipton tingujt H,U duke i lidhur me shkronjat H, U.
- Gjen tingujt dhe shkronjat H, U në fjalë të ndryshme.
- Lexon globalisht fjalë që kanë shkronjat H,U në trup të tyre. Shkruan shkronjat H,U të mëdha të shtypit sipas modelit.

Fjalë kyçe:
hëna, helikopter, ujku, ura

Teknika dhe strategji:

- Stuhi mendimi
- Demonstrim
- Punë individuale

Burimet e informacionit dhe mjete:

Abetare, Abetare pune, shkronjat H,U, lapsa, fletore, mjete vizatimi, etiketa me fjalë, tabela plastike, figura, lodra për fëmijë, shkronja, fletë formati, fije makaronash, magnetofon, CD, kënga "Gjuha e kafshëve".

Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë
Arte
Shoqëria dhe mjedisi
Eukim mjedisor

Përshkrim kontekstual i situatës:
Veprimtari paraprake:
Këndohet kënga *Gjuha e kafshëve*

Ciu, ciu, ciu o zog i vogël,
ciu, ciu qan apo këndon?
Ciu, ciu flas me nënën time,
nëna gjuhën ma kupton.

Be, be, be o qengji vogël
be, be qan apo këndon?
Be, be flas me nënën time,
nëna gjuhën ma kupton.

Mjau, mjau, mjau moj kotele,
Mjau, mjau qan apo këndon?
Mjau, mjau flas me nënën time,
Nëna gjuhën ma kupton.

Nxënësit përsëritin këngën duke përplasur shuplakat, por imitojnë edhe zëra të tjerë kafshësh.

Hapi i parë: Stuhi mendimi

Mësuesja i ndan nxënësit në dy grupe. Njëri grup do të gjejë fjalë që kanë shkronjën H në trup të tyre, ndërsa grupi tjetër do të gjejë fjalë që kanë shkronjën U në trup të tyre. Mësuesja i shkruan fjalët në tabelë, derisa grupet të mos kenë më fjalë. Numërohen fjalët e gjetura nga nxënësit.
Paraqiten para nxënësve etiketa me fjalë që përmbajnë shkronjën U, shkronjën H, si dhe fjalë që nuk përmbajnë asnjërën prej shkronjave H, U. Nxënësit përjashtojnë fjalët që nuk përmbajnë shkronjat H, U.

Hapi i dytë: Demonstrim

Mësuesja paraqet para nxënësve shkronjat H, U të mëdha të shtypit dhe shpjegon formën e tyre.
Krahasohen me njëra-tjetrën si dhe me shkronjat e tjera.
I vizaton në ajër dhe pastaj në tabelë.
Modelohen shkronjat H, U duke përdorur materiale të ndryshme dhe kërkohet nga nxënësit të bëjnë të njëjtë gjë. I shkruajnë në tabelat plastike.
Shqiptohen disa herë tingujt H, U nga nxënësit.
Qarkohen shkronjat H, U në fjalët e shkruara në tabelë dhe përcaktohet vendi i tyre (në fillim, në mes, në fund).

Hapi i tretë: Punë individuale

Nxënësit hapin Abetaren e punës dhe emërtojnë figurat (hëna, helikopteri, ujku, ura,). Ndahen fjalët në rrokje, përcaktohet numri i rrokjeve, vendi i shkronjave H, U dhe plotësojnë kutizat me shkronjat H, U.
Mësuesja mund të kërkojë nga nxënësit që të formojnë edhe fjali me fjalët e dhëna.
Shkruajnë elementet e shkrimit të dorës dhe më pas shkronjat H, U. Mësuesja ndjek nga afër punën e nxënësve dhe ndihmon ata që kanë vështirësi.

Demonstrim i rezultateve të arritura:

Shkruajnë shkronjat H, U në fletoren individuale.
Lexojnë globalisht fjalë me shkronjat H, U.

Vlerësimi i situatës:
Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- Dallon shkronjat H, U.
- Shqipton tingujt H,U duke i lidhur me shkronjat H, U.
- Gjen tingujt dhe shkronjat H, U në fjalë të ndryshme.
- Lexon globalisht fjalë që kanë shkronjat H,U në trup të tyre.
  Shkruan shkronjat H, U të mëdha të shtypit.

Detyra:

1. Shkruajnë nga dy rreshta me shkronjat H, U.
2. Shkruajnë fjalët globale HËNA, UJKU, URA, HELIKOPTER.

Refleksione:

<table>
<tr><td>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla: 1</td><td>Klasa: 1</td></tr>
<tr><td colspan="3">Tema mësimore:
Tingujt dhe shkronjat D, Dh
Kalendari i ditëlindjeve</td><td>Situata e të nxënit:
Festa e ditëlindjes</td></tr>
<tr><td colspan="4">R.N. sipas kompetencave kyçe:
Nxënësi:
K.1 paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup.
K.3 ndjek udhëzimet e dhëna në një tekst për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë, që kërkohet.
K.3 mbikëqyr në mënyrë të pavarur përparimin e vet në një detyrë, aktivitet duke përdorur teknika të ndryshme për gjetjen e gabimeve (si shënim të gabimeve - vështirësive) dhe i korrigjon ato derisa gjen zgjidhjen.
K.4 identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në shtëpi.
K.5 bashkëpunon me të tjerët pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitetet në klasë, shkollë apo jashtë saj.
K.6 shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive.</td></tr>
<tr><td colspan="3" rowspan="2">R.N. të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:
Nxënësi:
• Përshkruan figurën duke folur rrjedhshëm, qartë.
• Dallon shkronjat D, Dh në fjalë të ndryshme.
• Shqipton tingujt D, Dh duke i lidhur me shkronjat D, Dh.
• Gjen tingujt dhe shkronjat D, Dh në fjalë të ndryshme.
• Lexon globalisht fjalë që kanë shkronjat D, Dh në trup të tyre. Shkruan shkronjat D, Dh të mëdha të shtypit sipas modelit.</td><td>Fjalë kyçe:
ditëlindje, dielli, delfini, dhelpra, dhëmbi, dhjeta</td></tr>
<tr><td>Teknika dhe strategji:
• Bashkëbisedim
• Stuhi mendimi
• Demonstrim
• Punë individuale</td></tr>
<tr><td colspan="3">Burimet e informacionit dhe mjete:
Abetare, Abetare pune, shkronjat D, DH, lapsa, fletore, mjete vizatimi, etiketa me fjalë, tabela plastike, figura, lodra për fëmijë, shkronja, fletë formati, fije makaronash, magnetofon, CD</td><td>Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë
Arte
Shoqëria dhe mjedisi
Edukim me të drejtat e fëmijëve</td></tr>
<tr><td colspan="4">Përshkrim kontekstual i situatës:
Veprimtari paraprake:

Mësuesja nxit nxënësit të mendojnë dhe të thonë se çfarë mendojnë pasi dëgjojnë fjalën dhuratë.
Vendoset në magnetofon kënga “Shumë urime për ty” dhe këndohet nga nxënësit.
Nxënësit mund të tregojnë për festimin e ditëlindjes së tyre.

Hapi i parë: Bashkëbisedim

Hapen librat në faqen 18 të Abetares dhe nxiten nxënësit të flasin rreth figurës:
- Çfarë shikoni?</td></tr>
</table>

- Si duken fëmijët? Pse mendoni se janë të gëzuar?
- Si është zbukuruar vendi? Çfarë ka mbi tavolinë?

Mësuesja lexon muajt e renditur në figurë dhe nxit nxënësit të ngjyrosin një kuadrat dhe datën e ditëlindjes në kalendarin e ditëlindjeve në tekst.

Hapi i dytë: Stuhi mendimi

Mësuesja i ndan nxënësit në dy grupe. Njëri grup do të gjejë fjalë që kanë shkronjën D në trup të tyre, ndërsa grupi tjetër do të gjejë fjalë që kanë shkronjën Dh në trup të tyre. Mësuesja i shkruan fjalët në tabelë, derisa grupet të mos kenë më fjalë. Numërohen fjalët e gjetura nga nxënësit.
Paraqiten para nxënësve etiketa me fjalë që përmbajnë shkronjën D, shkronjën Dh, si dhe fjalë që nuk përmbajnë asnjërën prej shkronjave D, Dh. Nxënësit përjashtojnë fjalët që nuk përmbajnë shkronjat D, Dh.
Hapi i tretë: Demonstrim

Mësuesja paraqet para nxënësve shkronjat D, Dh të mëdha të shtypit dhe shpjegon formën e tyre.
Krahasohen me njëra-tjetrën si dhe me shkronjat e tjera.
I vizaton në ajër dhe pastaj në tabelë.
Modelohen shkronjat D, Dh duke përdorur materiale të ndryshme dhe kërkohet nga nxënësit të bëjnë të njëjtë gjë. I shkruajnë në tabelat plastike.
Shqiptohen disa herë tingujt D, Dh nga nxënësit. Mësuesja tregon kujdes në shqiptimin e saktë të tingullit Dh (mos ngatërrohet me tingullin Ll).
Qarkohen shkronjat D, Dh në fjalët e shkruara në tabelë dhe përcaktohet vendi i tyre (në fillim, në mes, në fund).
Hapi i katërt: Punë individuale

Nxënësit hapin Abetaren e punës dhe emërtojnë figurat (dielli, delfini, dhëmbi, dhjeta, dhelpra). Ndahen fjalët në rrokje, përcaktohet numri i rrokjeve, vendi i shkronjave D, Dh dhe plotësojnë kutizat me shkronjat D, Dh. Mësuesja mund të kërkojë nga nxënësit që të formojnë edhe fjali me fjalët e dhëna.
Shkruajnë elementet e shkrimit të dorës dhe më pas shkronjat D, Dh. Mësuesja ndjek nga afër punën e nxënësve dhe ndihmon ata që kanë vështirësi.

Demonstrim i rezultateve të arritura:
Shkruajnë shkronjat D, Dh në fletoren individuale.
Lexojnë globalisht fjalë me shkronjat D, Dh.
Vlerësimi i situatës:
Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- Përshkruan figurën duke folur rrjedhshëm, qartë.
- Dallon shkronjat D, Dh në fjalë të ndryshme.
- Shqipton tingujt D, Dh duke i lidhur me shkronjat D, Dh.
- Gjen tingujt dhe shkronjat D, Dh në fjalë të ndryshme.
- Lexon globalisht fjalë që kanë shkronjat D, Dh në trup të tyre.
  Shkruan shkronjat D, Dh të mëdha të shtypit sipas modelit.

Detyra:

1. Shkruajnë nga dy rreshta me shkronjat D, Dh.
2. Shkruajnë fjalët globale DIELLI, DELFINI, DHELPRA, DHURATA, DHJETA.

Refleksione:

<table>
<tr><td>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla: 1</td><td>Klasa: 1</td></tr>
<tr><td colspan="3">Tema mësimore:
Tingulli dhe shkronja K
Kafshët</td><td>Situata e të nxënit:
Përralla: Ujku dhe kecat</td></tr>
<tr><td colspan="4">R.N. sipas kompetencave kyçe:
Nxënësi:
K.1 shpreh mesazhin e një teksti të thjeshtë letrar, përmes njërës nga format shprehëse: të folurit, dramatizimit (lojë me role).
K.1 identifikon personazhet kryesore të një tregimi, drame apo filmi dhe luan rolin e njërit prej personazheve në bashkëveprim me moshatarët.
K.3 grumbullon dhe klasifikon materialet e performancës së vet, për përgatitjen apo pasurimin e portofolit personal.
K.4 identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në shtëpi.
K.6 shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive.
K.7 ritregon ngjarjen e një teksti të dëgjuar (nga mjetet audio-vizuale), përmbajtja e të cilit të mos jetë më shumë se një faqe teksti.</td></tr>
<tr><td colspan="3" rowspan="2">R.N. të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:
Nxënësi:
• Përshkruan figurat në tekst.
• Interpreton në role.
• Dallon shkronjën K të madhe të shtypit në fjalët e dhëna.
• Shqipton tingullin K duke e lidhur me shkronjën K.
• Gjen tingullin dhe shkronjën K në fjalë të ndryshme.
• Lexon globalisht fjalë që kanë shkronjën K në trup të tyre. Shkruan shkronjën K të madhe të shtypit dhe fjalë me të.</td><td>Fjalë kyçe:
ujku, kecat, kali, makina</td></tr>
<tr><td>Teknika dhe strategji:
• Bashkëbisedim
• Dramatizim
• Demonstrim/punë në grupe
• Punë individuale</td></tr>
<tr><td colspan="3">Burimet e informacionit dhe mjete:

Abetare, Abetare pune, shkronja K, shkronjat e mësuara, lapsa, fletore, mjete vizatimi, etiketa me fjalë, tabela plastike, figura, lodra për fëmijë, shkronja, fletë formati, fije makaronash, magnetofon, CD</td><td>Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë
Arte
Edukim me të drejtat e fëmijëve
Shkencat natyrore</td></tr>
<tr><td colspan="4">Përshkrim kontekstual i situatës:
Veprimtari paraprake:

Mësuesja u tregon nxënësve vetëm foton e parë të përrallës Ujku dhe kecat dhe lihen nxënësit të kujtojnë përrallën.
Nëse nxënësit kanë vështirësi, tregohen fotot me radhë. Nxiten nxënësit të shprehen rrjedhshëm, qartë.
Dramatizohet përralla nga nxënësit.
Nëse është e mundur shfaqet filmi vizatimor me të njëjtin titull.</td></tr>
</table>

Hapi i parë: Bashkëbisedim

Mësuesja shkruan titullin në tabelë UJKU DHE KECAT.
- Çfarë kanë të përbashkët këto fjalë? (janë emra kafshësh, kanë shkronjën K).
- Tregoni emra kafshësh që kanë tingullin K kur i shqiptojmë.

Mësuesja i shkruan emrat e gjetur nga nxënësit në tabelë (kali, krokodili, ketri, kaprolli, kanguri etj.).
Nëse nxënësit kanë vështirësi për t'i gjetur mësuesja i ndihmon duke dhënë cilësi të tyre.

Hapi i dytë: Demonstrim/punë në grupe

Mësuesja paraqet para nxënësve shkronjën K të madhe të shtypit dhe shpjegon formën e saj. E vizaton në ajër dhe pastaj në tabelë.
Modelohet me fije makarona, tela të përthyeshëm.
U kërkon edhe nxënësve të bëjnë të njëjtën gjë.
Shqiptohet disa here tingulli K nga nxënësit.
Kërkon nga nxënësit në grupe të gjejnë shkronjën K në fjalët e shkruara në tabelë. U jepet kohë nxënësve për t'i gjetur dhe më pas diskutohen gjetjet.

Hapi i tretë: Punë individuale

Nxënësit hapin Abetaren e punës dhe emërtojnë figurat (KALI, MAKINA).
Ndahen fjalët në rrokje dhe tregojnë numrin e rrokjeve për çdo fjalë.
Plotësojnë kutizat me shkronjën K.
Shkruajnë elementet e shkrimit dhe më pas shkronjën K. Mësuesja ndjek nga afër punën e nxënësve dhe ndihmon ata që kanë vështirësi.

Demonstrim i rezultateve të arritura:
Shkruajnë shkronjën K.
Lexojnë fjalë globalisht.

Vlerësimi i situatës:
Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:
- Përshkruan figurat në tekst.
- Interpreton në role.
- Dallon shkronjën K të madhe të shtypit në fjalët e dhëna.
- Shqipton tingullin K duke e lidhur me shkronjën K.
- Gjen tingullin dhe shkronjën K në fjalë të ndryshme.
- Lexon globalisht fjalë që kanë shkronjën K në trup të tyre.
  Shkruan shkronjën K të madhe të shtypit dhe fjalë me të.

Detyra:
1. Shkruajnë dy rreshta me shkronjën K.
2. Shkruajnë fjalët globale KALI, MAKINA, KECI, UJKU.

Refleksione:

<table>
<tr><td>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla: 1</td><td>Klasa: 1</td></tr>
<tr><td colspan="3">Tema mësimore:
Tingulli dhe shkronja J
Kafshët</td><td>Situata e të nxënit:
Kafshët</td></tr>
<tr><td colspan="4">R.N. sipas kompetencave kyçe:
Nxënësi:
K.1 paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup.
K.2 paraqet argumente pro dhe kundër për një mendim, qëndrim, sjellje të manifestuar nga një apo më shumë persona (në klasë/shkollë apo jashtë saj).
K.3 parashtron pyetje dhe përgjigjet në pyetjet për temën/problemin/detyrën e dhënë në njërën nga format e të shprehurit.
K.4 identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në shtëpi.
K.5 bashkëpunon me të tjerët pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitetet në klasë, shkollë apo jashtë saj.
K.6 shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive.</td></tr>
<tr><td colspan="3" rowspan="2">R.N. të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:
Nxënësi:
• Dallon shkronjën J të madhe të shtypit në fjalët e dhëna.
• Shqipton tingullin J duke e lidhur me shkronjën J.
• Gjen tingullin dhe shkronjën J në fjalë të ndryshme.
• Lexon globalisht fjalë që kanë shkronjën J në trup të tyre. Shkruan shkronjën J të madhe të shtypit dhe fjalë me të.</td><td>Fjalë kyçe:
macja, ujku, cjapi, lejlek</td></tr>
<tr><td>Teknika dhe strategji:
• Bashkëbisedim
• Demonstrim/punë në grupe
• Punë individuale</td></tr>
<tr><td colspan="3">Burimet e informacionit dhe mjete:

Abetare, Abetare pune, shkronja J, shkronjat e mësuara, lapsa, fletore, mjete vizatimi, etiketa me fjalë, tabela plastike, figura, lodra për fëmijë, shkronja, fletë formati, fije makaronash, magnetofon, CD</td><td>Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë
Arte
Shkencat natyrore</td></tr>
<tr><td colspan="4">Përshkrim kontekstual i situatës:
Veprimtari paraprake:

Mësuesja organizon me nxënësit një bisedë rreth fotove. Ajo paraqet fotot e maces, ujkut, cjapit, lejlekut dhe i nxit nxënësit të tregojnë çfarë dinë rreth tyre.
Mund të lexohen vjersha ose fabula me këto kafshë.

Hapi i parë: Bashkëbisedim
Mësuesja paraqet etiketat me fjalët MACJA, UJKU, CJAPI, LEJLEKU dhe u kërkon nxënësve të ngjitin etiketat me fjalë te kafshët që ato emërtojnë. Më pas pyet:
- Çfarë kanë të përbashkët këto figura? (emërtojnë kafshë).
- Po fjalët çfarë kanë të përbashkët? (shkronjën J).</td></tr>
</table>

Nxiten nxënësit të tregojnë të tjera fjalë me shkronjën J. Mësuesja i shkruan fjalët në tabelë.
Hapi i dytë: Demonstrim/ punë në grupe

Mësuesja paraqet para nxënësve shkronjën J të madhe të shtypit dhe shpjegon formën e saj. E vizaton në ajër dhe pastaj në tabelë.
Modelohet me fije makarona ose materiale të ndryshme.
U kërkon edhe nxënësve të bëjnë të njëjtën gjë.
Shqiptohet disa herë tingulli j nga nxënësit.
Kërkon nga nxënësit në grupe të gjejnë shkronjën j në fjalët e shkruara në tabelë dhe t' lexojnë ato globalisht. U jepet kohë nxënësve për t'i gjetur dhe më pas diskutohen gjetjet.

Hapi i tretë: Punë individuale

Nxënësit hapin Abetaren e punës dhe emërtojnë figurat (MACJA, JAKA, JASTËK).
Ndahen fjalët në rrokje dhe tregojnë numrin e rrokjeve për çdo fjalë.
Plotësojnë kutizat me shkronjën J.
Ngjyrosi figurat e dhëna dhe më pas shkruajnë shkronjën J. Mësuesja ndjek nga afër punën e nxënësve dhe ndihmon ata që kanë vështirësi.

Demonstrim i rezultateve të arritura:
Shkruajnë shkronjën J.
Lexojnë fjalë globalisht.

Vlerësimi i situatës:
Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- Dallon shkronjën J të madhe të shtypit në fjalët e dhëna.
- Shqipton tingullin J duke e lidhur me shkronjën J.
- Gjen tingullin dhe shkronjën J në fjalë të ndryshme.
- Lexon globalisht fjalë që kanë shkronjën J në trup të tyre.
  Shkruan shkronjën J të madhe të shtypit dhe fjalë me të.

Detyra:

1. Shkruajnë dy rreshta me shkronjën J.
2. Shkruajnë fjalët globale MACJA, CJAPI, UJKU.
3. Vizatojnë kafshën që u pëlqen më shumë.

Refleksione:

<table>
<tr><td>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla: 1</td><td>Klasa: 1</td></tr>
<tr><td colspan="3">Tema mësimore:
Tingulli dhe shkronja G
Në garë</td><td>Situata e të nxënit:
Jemi në garë</td></tr>
<tr><td colspan="4">R.N. sipas kompetencave kyçe:
Nxënësi:
K.1 paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup.
K.2 sqaron me anë të të folurit hapat e zgjidhjes së një problemi të thjeshtë, me të cilin ballafaqohet në një situatë jetësore.
K.3 ndjek udhëzimet e dhëna në një tekst për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë, që kërkohet.
K.4 gjen të përbashkëtat dhe ndryshimet ndërmjet aktiviteteve, që organizohen në shkollë me ato në shtëpi dhe i përshkruan në mënyrë individuale përmes njërës nga format e të shprehurit duke i diskutuar në grup.
K.5 bashkëpunon me të tjerët pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitetet në klasë, shkollë apo jashtë saj.
K.6 diskuton dhe në bashkëpunim me anëtarët e grupit vendos rregullat e punës në grup.</td></tr>
<tr><td colspan="3" rowspan="2">R.N. të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:
Nxënësi:
• Përshkruan figurat në tekst.
• Dallon shkronjën G të madhe të shtypit në fjalët e dhëna.
• Shqipton tingullin G duke e lidhur me shkronjën G.
• Gjen tingullin dhe shkronjën G në fjalë të ndryshme.
• Lexon globalisht fjalë që kanë shkronjën G në trup të tyre. Shkruan shkronjën G të madhe të shtypit dhe fjalë me të.</td><td>Fjalë kyçe:
Garë, gomari, globi, gishti</td></tr>
<tr><td>Teknika dhe strategji:
• Bashkëbisedim
• Demonstrim/punë në grupe
• Punë individuale</td></tr>
<tr><td colspan="3">Burimet e informacionit dhe mjete:

Abetare, Abetare pune, shkronja G, shkronjat e mësuara, lapsa, fletore, mjete vizatimi, etiketa me fjalë, tabela plastike, figura, lodra për fëmijë, shkronja, fletë formati, fije makaronash.</td><td>Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë
Arte
Edukim me të drejtat e fëmijëve
Edukim fizik, sporte dhe shëndet</td></tr>
<tr><td colspan="4">Përshkrim kontekstual i situatës:
Veprimtari paraprake:

Nxënësit dalin në oborr dhe mësuesja zhvillon me ta një garë sipas dëshirës, p.sh., garë vrapi, garë kërcimi, stafetë etj.
Tregohet kujdes në njohjen e nxënësve me rregullat e garës dhe respektimin e tyre.</td></tr>
</table>

Hapi i parë: Bashkëbisedim
Hapen librat e Abetares në faqen 19 dhe nxiten nxënësit të vështrojnë figurat. Mësuesja pyet:
- Çfarë shikoni?
- Çfarë po bëjnë fëmijët?
- Çfarë ka ndodhur gjatë garës? Pse u rrëzua ai? Si u zgjidh problemi?
- Çfarë mësimi nxjerrim nga gabimi i tij?

Mësuesja nxit nxënësit të tregojnë ngjarjen të plotë duke u bazuar te figurat. Dëgjohen 3 – 4 nxënës.

Hapi i dytë: Demonstrim/punë në grupe

Shkruhet titulli dhe lexohet disa herë *Në garë.*
Ushtrohen në shqiptimin e tingullit g.
Mësuesja thotë disa fjalë dhe nxënësit dallojnë në cilat prej tyre dëgjojnë tingullin g (libri, gota, gomari, lapsi etj.) .
Mësuesja paraqet para nxënësve shkronjën G të madhe të shtypit dhe shpjegon formën e saj duke e krahasuar me shkronjat C, Ç. E vizaton në ajër dhe pastaj në tabelë.
Modelohet me materiale të ndryshme.
U kërkon edhe nxënësve të bëjnë të njëjtën gjë.
Shqiptohet disa here tingulli G nga nxënësit.
Kërkon nga nxënësit në grupe të gjejnë fjalë me shkronjën G në trup të tyre. Shkruhen fjalët në tabelë dhe përcaktohet pozicioni i shkronjës G.

Hapi i tretë: Punë individuale

Nxënësit hapin Abetaren e punës dhe emërtojnë figurat (GOMARI, GISHTI, GLOBI).
Ndahen fjalët në rrokje dhe nxënësit tregojnë numrin e rrokjeve për çdo fjalë.
Plotësojnë kutizat me shkronjën G.
Shkruajnë elementet e shkrimit dhe më pas shkronjën G. Mësuesja ndjek nga afër punën e nxënësve dhe ndihmon ata që kanë vështirësi.

Demonstrim i rezultateve të arritura:
Shkruajnë shkronjën G.
Lexojnë globalisht fjalë me shkronjën G.
Vlerësimi i situatës:
Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:
- Përshkruan figurat në tekst.
- Dallon shkronjën G të madhe të shtypit në fjalët e dhëna.
- Shqipton tingullin G duke e lidhur me shkronjën G.
- Gjen tingullin dhe shkronjën G në fjalë të ndryshme.
- Lexon globalisht fjalë që kanë shkronjën G në trup të tyre.
  Shkruan shkronjën G të madhe të shtypit dhe fjalë me të.

Detyra:
1. Shkruajnë dy rreshta me shkronjën G.
2. Shkruajnë fjalët globale GARA, GOMARI, GISHTI, GLOBI.

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 1	Klasa: 1
Tema mësimore: Tingulli dhe shkronja GJ Gjëegjëzat			Situata e të nxënit: Gjëegjëzat

R.N. sipas kompetencave kyçe:
Nxënësi:
K.1 paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup.
K.2 paraqet argumente pro dhe kundër për një mendim, qëndrim, sjellje të manifestuar nga një apo më shumë persona (në klasë/shkollë apo jashtë saj).
K.3 parashtron pyetje dhe përgjigjet në pyetjet për temën/problemin/detyrën e dhënë në njërën nga format e të shprehurit.
K.4 identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në shtëpi.
K.5 bashkëpunon me të tjerët pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitetet në klasë, shkollë apo jashtë saj.
K.6 shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive.

R.N. të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:
Nxënësi:

- Dallon shkronjën Gj të madhe të shtypit në fjalët e dhëna.
- Shqipton tingullin Gj duke e lidhur me shkronjën Gj.
- Gjen tingullin dhe shkronjën Gj në fjalë të ndryshme.
- Lexon globalisht fjalë që kanë shkronjën Gj në trup të tyre. Shkruan shkronjën Gj të madhe të shtypit dhe fjalë me të.

Fjalë kyçe:
gjëegjëzë, gjethe, gjeli

Teknika dhe strategji:

- Bashkëbisedim
- Demonstrim/punë në grupe
- Punë individuale

Burimet e informacionit dhe mjete:

Abetare pune, shkronja Gj, shkronjat e mësuara, lapsa, fletore, mjete vizatimi, etiketa me fjalë, tabela plastike, figura, libra me gjëegjëza, shkronja, fletë formati, fije makaronash.

Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë
Arte
Edukim me të drejtat e fëmijëve
Shoqëria dhe mjedisi

Përshkrim kontekstual i situatës:
Veprimtari paraprake:

Mësuesja u tregon nxënësve gjëegjëza të ndryshme të përshtatshme me moshën dhe i nxit nxënësit t'i gjejnë:

Zu-zu-zu, zu-zu-zu,
shkon atje e shkon këtu,
punon ditë e punon natë,
na jep dyllë e na jep mjaltë. (bleta)

Mendje s'ka por të mëson
gojë s'ka por me ty flet
ti përditë me të jeton
mik të ngushtë e ke për jetë. (libri)

Mësuesja nxit edhe nxënësit të tregojnë gjëegjëza nëse dinë.

Hapi i parë: Bashkëbisedim
Nxiten nxënësit të tregojnë për gjëegjëzat:
- Çfarë janë?
- Për çfarë tregojnë?
- Përse shërbejnë?
- Si i gjejmë?

Mësuesja shkruan në tabelë fjalën *GJËEGJËZA* dhe e lexon disa herë bashkë me nxënësit.

Hapi i dytë: Demonstrim/punë në grupe
Mësuesja thotë disa fjalë dhe nxënësit dallojnë në cilat prej tyre dëgjojnë tingullin gj (gjeli, macja, gjilpërë, libri, gjerdani, gjethe etj.) .
Mësuesja paraqet para nxënësve shkronjën GJ të madhe të shtypit dhe shpjegon formën e saj duke e krahasuar me shkronjat G, J. E vizaton në ajër dhe pastaj në tabelë.
Modelohet me materiale të ndryshme.
U kërkon edhe nxënësve të bëjnë të njëjtën gjë.
Shqiptohet disa herë tingulli GJ nga nxënësit.
Paraqet figura të ndryshme emërtimet e të cilave përmbajnë shkronjën GJ dhe i shkruan me ngjyrë të dallueshme pasi emërtohen figurat nga nxënësit (gjeli, gjarpri, gjethe, gjirafa, gjerdani etj.).
Kërkon nga nxënësit në grupe të gjejnë fjalë me shkronjën GJ në trup të tyre. Shkruhen fjalët në tabelë dhe përcaktohet pozicioni i shkronjës GJ.

Hapi i tretë: Punë individuale
Nxënësit hapin Abetaren e punës dhe emërtojnë figurat (GJETHJA, GJELI).
Ndahen fjalët në rrokje dhe nxënësit tregojnë numrin e rrokjeve për çdo fjalë.
Plotësojnë kutizat me shkronjën GJ.
Shkruajnë elementet e shkrimit të dorës dhe më pas shkronjën GJ. Mësuesja ndjek nga afër punën e nxënësve dhe ndihmon ata që kanë vështirësi.
Vizatojnë shkronjën GJ me ngjyra në fletë të bardhë dhe e shoqërojnë me një ose dy figura që kanë shkronjën GJ.

Demonstrim i rezultateve të arritura:
Shkruajnë shkronjën GJ.
Lexojnë globalisht fjalë me shkronjën GJ.
Vlerësimi i situatës:
Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:
- Dallon shkronjën Gj të madhe të shtypit në fjalët e dhëna.
- Shqipton tingullin Gj duke e lidhur me shkronjën Gj.
- Gjen tingullin dhe shkronjën Gj në fjalë të ndryshme.
- Lexon globalisht fjalë që kanë shkronjën Gj në trup të tyre.
  Shkruan shkronjën Gj të madhe të shtypit dhe fjalë me të.

Detyra: Shkruajnë dy rreshta me shkronjën GJ.
Shkruajnë fjalët globale GJELI, GJETHJA, GJILPËRA, GJERDAN.

Refleksione:

<table>
<tr><td>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla: 1</td><td>Klasa: 1</td></tr>
<tr><td colspan="3">Tema mësimore:
Tingujt dhe shkronjat L, LL
Luajmë</td><td>Situata e të nxënit:
Loja</td></tr>
<tr><td colspan="4">R.N. sipas kompetencave kyçe:
Nxënësi:
K.1 paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup.
K.2 paraqet argumente pro dhe kundër për një mendim, qëndrim, sjellje të manifestuar nga një apo më shumë persona në klasë.
K.3 parashtron pyetje dhe përgjigjet në pyetjet për temën /problemin/detyrën e dhënë në njërën nga format e të shprehurit.
K.4 identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në shtëpi.
K.5 bashkëpunon me të tjerët pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitetet në klasë, shkollë apo jashtë saj.
K.6 shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive.</td></tr>
<tr><td colspan="3" rowspan="2">R.N. të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:
Nxënësi:
Përshkruan mbi bazën e figurave.
• Dallon shkronjat L, LL në fjalët e dhëna.
• Shqipton tingujt L, LL duke i lidhur me shkronjat L, LL.
• Gjen tingujt dhe shkronjat L, LL në fjalë të ndryshme.
• Lexon globalisht fjalë që kanë shkronjat L, LL në trup të tyre.
• Shkruan shkronjat L, LL të mëdha të shtypit.</td><td>Fjalë kyçe:
lojë, lulja, librat, llamba, molla, lepuri</td></tr>
<tr><td>Teknika dhe strategji:
• Lojë
• Bashkëbisedim
• Punë individuale
• Veprimtari në dyshe</td></tr>
<tr><td colspan="3">Burimet e informacionit dhe mjete:

Abetare, Abetare pune, shkronjat L, LL, shkronjat e mësuara, lapsa, fletore, mjete vizatimi, etiketa me fjalë, tabela plastike, figura, lodra për fëmijë, shkronja, fletë formati, fije makaronash, magnetofon, CD</td><td>Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë
Arte
Edukim me të drejtat e fëmijëve
Edukim fizik, sporte dhe shëndet</td></tr>
<tr><td colspan="4">Përshkrim kontekstual i situatës:
Veprimtari paraprake:

Mësuesja organizon me nxënësit një lojë të thjeshtë të cilën munda ta zgjedhin vetë nxënësit ose ua sugjeron ajo. Loja mund të zhvillohet në oborr ose në kushtet e klasës. Theksohet se loja ka rregulla dhe ato duhen zbatuar nga të gjithë.
Nxënësit në përfundim të lojës tregojnë se si janë ndier.

Hapi i parë: Bashkëbisedim
Mësuesja nxit nxënësit të tregojnë çfarë shikojnë në figurën e librit (faqe 17 e Abetares).</td></tr>
</table>

- Çfarë shikoni? Cila stinë është? Nga e kuptoni?
- Çfarë po bën djali? Ç'mendim keni për veprimin e tij?
- Çfarë bëri vajza? Pse qeshi djali në fillim?
- Çfarë ndodhi në fund? Ç'mendim keni për veprimin e vajzës?
- A mund të tregojmë një ngjarje me këto figura?

Dëgjohen 2-3 nxënës.
Shkruhet titulli në tabelë dhe lexohet disa herë *LUAJMË*.

- Cilin tingull dëgjoni në fillim?

Hapi i dytë: Veprimtari në dyshe

Mësuesja paraqet para nxënësve shkronjën L të madhe të shtypit dhe shpjegon formën e saj. E vizaton në ajër dhe pastaj në tabelë.
Shqiptohet disa herë.
Kërkon nga nxënësit në grupe dyshe të gjejnë fjalë të tjera që përmbajnë në trup të tyre tingullin L.
Nxënësit gjejnë në klasë objekte që përmbajnë tingullin L (fletore, tabela, lule, lapsi etj.).
Paraqet dhe shkronjën LL dhe krahasohet me shkronjën L.
Nxiten të tregojnë fjalë me shkronjën LL.

Hapi i tretë: Punë individuale

Mësuesja vendos në tabelë disa figura që kanë poshtë fjalët përkatëse (lule, libri, elefanti, molla, shalli, llamba).
Nxënësit gjejnë ku ndodhen shkronjat L, LL në këto fjalë. Mësuesja ndan fjalët në rrokje duke lëvizur duart majtas – djathtas dhe ndihmon nxënësit të gjejnë në cilën rrokje ndodhet shkronja L dhe në cilat shkronja LL.
Nxënësit hapin Abetaren e punës dhe emërtojnë figurat (LULJA, LIBRAT, LEPURI, LLAMBA, MOLLA).
Shkruajnë elementet e shkrimit të dorës dhe më pas shkronjat L, LL.
Modelohen shkronjat L, LL në fletë bardhë dhe ilustrohen me 1 – 2 figura që përmbajnë shkronjën e modeluar.
Demonstrim i rezultateve të arritura:
Shkruajnë shkronjat L, LL.
Lexojnë fjalë globalisht.
Vlerësimi i situatës:
Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- Dallon shkronjat L, LL në fjalët e dhëna.
- Shqipton tingujt L, LL duke i lidhur me shkronjat L, LL.
- Gjen tingujt dhe shkronjat L, LL në fjalë të ndryshme.
- Lexon globalisht fjalë që kanë shkronjat L, LL në trup të tyre.
- Shkruan shkronjat L, LL të mëdha të shtypit.

Detyra: Shkruajnë nga dy rreshta me shkronjat L, LL.
Shkruajnë fjalët globale LULJA, LIBRAT, LEPURI, LLAMBA, MOLLA
Vizatojnë një lule, një mollë.

Refleksione:

<table>
<tr><td>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla 1</td><td>Klasa 1</td></tr>
<tr><td colspan="3">Tema mësimore:
Rimarrje, përsëritje, kontroll</td><td>Situata e të nxënit:
Lodrat e mia</td></tr>
<tr><td colspan="4">R.N. sipas kompetencave kyçe:
Nxënësi:
K.1 paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup.
K.2 sqaron me anë të të folurit hapat e zgjidhjes së një problemi të thjeshtë, me të cilin ballafaqohet në një situatë jetësore.
K.3 parashtron pyetje dhe përgjigjet në pyetjet për temën/problemin/detyrën e dhënë në njërën nga format e të shprehurit.
K.3 grumbullon dhe klasifikon materialet e performancës së vet, për përgatitjen apo pasurimin e portofolit personal.
K.4 identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në shtëpi.
K.5 bashkëpunon me të tjerët pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitetet në klasë, shkollë apo jashtë saj.
K.6 shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive.</td></tr>
<tr><td colspan="3" rowspan="2">R.N. të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:
Nxënësi:
Flet rrjedhshëm dhe qartë kur përshkruan diçka.
• Dallon shkronjat e mëdha të shtypit të mësuara deri tani në fjalët e dhëna.
• Shqipton tingujt e mësuar duke i lidhur me shkronjat përkatëse.
• Gjen tingujt dhe shkronjat e mësuara në fjalë të ndryshme.
• Lexon globalisht fjalë që kanë shkronjat e mësuara në trup të tyre.
• Shkruan shkronjat e mëdha të shtypit që ka mësuar deri tani dhe fjalë globale me to.</td><td>Fjalë kyçe:
lodra, topi, kukulla, balona, ariu, makina, kali</td></tr>
<tr><td>Teknika dhe strategji:
• Bashkëbisedim
• Veprimtari në grupe
• Veprimtari në dyshe
• Punë individuale</td></tr>
<tr><td colspan="3">Burimet e informacionit dhe mjete:

Abetare, Abetare pune, shkronjat e mësuara të shtypit, lapsa, fletore, mjete vizatimi, etiketa me fjalë, tabela plastike, figura, lodra për fëmijë, shkronja, fletë formati, fije makaronash, magnetofon, CD</td><td>Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë
Arte
Edukim me të drejtat e fëmijëve
Shkencat natyrore
Edukim fizik, sporte dhe shëndet</td></tr>
<tr><td colspan="4">Përshkrim kontekstual i situatës:
Veprimtari paraprake:

Mësuesja u ka kërkuar nxënësve paraprakisht të sjellin në klasë lodrat e tyre të preferuara.
Bashkë me nxënësit i organizon ato në një kënd të klasës dhe e emërton “ Këndi i lodrave”.
Nxiten të përshkruajnë lodrën e tyre të preferuar. Mësuesja pyet: Çfarë është? Si ia ke vendosur emrin? (në qoftë se ka) Kush ta ka dhuruar? Pse të pëlqen? Kur luan me të? etj.</td></tr>
</table>

Hapi i parë: Veprimtari në grupe

Mësuesja i organizon nxënësit në grupe. Në çdo grup ajo vendos etiketa boshe dhe u kërkon nxënësve të shkruajnë emërtimet e lodrave që ndodhen në " Këndin e lodrave".
Gjatë kohës që nxënësit punojnë, mësuesja ndjek nga afër punën e nxënësve dhe i ndihmon nëse kanë nevojë.
Në përfundim të punës, mbasi i kontrollojnë me njëri-tjetrin, nxënësit i vendosin në tabelë ku bëhet prezantimi i punës dhe krahasimi i gjetjeve me grupet e tjera.
Fjalët që mund të shkruajnë nxënësit janë: KUKULLA, TOPI, BALONA, ARIU, MAKINA, KALI etj.

Hapi i dytë: Veprimtari në dyshe

Në çdo dyshe nxënësish, mësuesja vendos një nga shkronjat e mësuara deri tani dhe u kërkon të gjejnë sa më shumë fjalë me të. Në varësi të numrit të nxënësve, një shkronjë mund t'u jepet edhe dy dysheve.
Fjalët e gjetura i shkruajnë në etiketa ose copëza fletësh të prera në forma të ndryshme dhe më pas i ngjitin në një tabak letre në një kënd të klasës.

Hapi i tretë: Punë individuale

Nxënësit modelojnë shkronja të ndryshme sipas dëshirës me plastelinë, makarona, letër me ngjyra etj.
Vizatojnë lodrën e tyre të preferuar.

Demonstrim i rezultateve të arritura:
Shkruajnë shkronjat e mësuara të shtypit me të diktuar.
Shkruajnë fjalë globale me to.
Lexojnë fjalë globalisht.

Vlerësimi i situatës:
Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- Flet rrjedhshëm dhe qartë kur përshkruan diçka.
- Dallon shkronjat e mëdha të shtypit të mësuara deri tani në fjalët e dhëna.
- Shqipton tingujt e mësuar duke i lidhur me shkronjat përkatëse.
- Gjen tingujt dhe shkronjat e mësuara në fjalë të ndryshme.
- Lexon globalisht fjalë që kanë shkronjat e mësuara në trup të tyre.
- Shkruan shkronjat e mëdha të shtypit që ka mësuar deri tani dhe fjalë globale me to.

Detyra:

1. Shkruajnë fjalë globale me shkronjat e mësuara.
2. Modelojnë shkronjat e mësuara.
3. Gjejnë shkronjat e mësuara në copëza gazetash.

Refleksione:

<table>
<tr><td>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla: 1</td><td>Klasa: 1</td></tr>
<tr><td colspan="3">Tema mësimore:
Tingulli dhe shkronja P</td><td>Situata e të nxënit:
Përralla e Pinokut</td></tr>
<tr><td colspan="4">R.N. sipas kompetencave kyçe:
Nxënësi:
K.1 ritregon ngjarjen e një teksti të dëgjuar, përmbajtja e të cilit nuk është më shumë se një faqe teksti.
K.1 shpreh me gojë dhe me shkrim për 3-5 minuta para moshatarëve dhe të tjerëve përjetimet dhe emocionet që e kanë shoqëruar gjatë shikimit të një filmi ose dokumentari, dëgjimit të një tregimi apo përralle.
K.3 zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes.
K.4 identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në shtëpi.
K.5 bashkëpunon me të tjerët pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitetet në klasë, shkollë apo jashtë saj.
K.7 ritregon ngjarjen e një teksti të dëgjuar (nga mjetet audio-vizuale), përmbajtja e të cilit të mos jetë më shumë se një faqe teksti.</td></tr>
<tr><td colspan="3" rowspan="2">R.N. të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:
Nxënësi:
• Dallon shkronjën P të madhe të shtypit.
• Shqipton tingullin P duke e lidhur me shkronjën P.
• Gjen tingullin dhe shkronjën P në fjalë të ndryshme.
• Lexon globalisht fjalë që kanë shkronjën P në trup të tyre.
• Shkruan shkronjën P të madhe të shtypit.</td><td>Fjalë kyçe:
Pinoku, përrallë, pula</td></tr>
<tr><td>Teknika dhe strategji:
• Bashkëbisedim
• Demonstrim/punë në grupe
• Punë individuale</td></tr>
<tr><td colspan="3">Burimet e informacionit dhe mjete:

Abetare, Abetare pune, shkronja P, lapsa, fletore, mjete vizatimi, etiketa me fjalë, tabela plastike, figura, lodra për fëmijë, shkronja, fletë formati, fije makaronash, përralla e Pinokut</td><td>Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë
Arte
Edukim me të drejtat e fëmijëve
Shoqëria dhe mjedisi</td></tr>
<tr><td colspan="4">Përshkrim kontekstual i situatës:
Veprimtari paraprake:

Mësuesja nxit nxënësit të kujtojnë përrallën e Pinokut:
- Çfarë ishte Pinoku?
- Kush e përgatiti? Pse e përgatiti?
- Pse Pinoku e kishte hundën e madhe?
- Çfarë ndodhi në fund me të?
Tregohet përralla nga 2 – 3 nxënës ose nga vetë mësuesja duke e shoqëruar edhe me foto ku tregohet Pinoku.</td></tr>
</table>

Hapi i parë: Lojë

Shkruhet fjala *PINOKU* në tabelë dhe lexohet nga nxënësit.

- Cilin tingull dëgjoni në fillim?

Mësuesja lexon disa fjalë. Në fjalët që dëgjojnë tingullin p, nxënësit do të thonë STOP (kukull, hundë, plaku, parku, abetare, dhelpra, perime etj.). Loja mund të zhvillohet në kor ose individualisht.

Hapi i dytë: Demonstrim/punë në grupe

Mësuesja paraqet para nxënësve shkronjën P të madhe të shtypit dhe shpjegon formën e saj. Vihet në dukje ngjashmëria e shkronjës P me shkronjën B. E vizaton në ajër dhe pastaj në tabelë.
Nxënësit gjejnë fjalë të tjera me shkronjën P, mësuesja i shkruan në tabelë dhe nxënësit qarkojnë shkronjën.
Shkruajnë shkronjën P në fletë të bardhë disa herë.

Hapi i tretë: Punë individuale

Nxënësit hapin Abetaren e punës dhe emërtojnë figurat (PINOKU, PULA, PAPAGALLI). Plotësojnë kutizat me shkronjën P.
Ngjyrosin dhe emërtojnë perimet e dhëna dhe më pas shkruajnë shkronjën M. Mësuesja ndjek nga afër punën e nxënësve dhe ndihmon ata që kanë vështirësi.
Vizatojnë ose modelojnë shkronjën P në fletë vizatimi dhe e shoqërojnë me 1 – 2 figura që përmbajnë shkronjë P.

Demonstrim i rezultateve të arritura:
Shkruajnë shkronjën P.
Lexojnë globalisht fjalë me shkronjën P (Pinoku).

Vlerësimi i situatës:
Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- Dallon shkronjën P të madhe të shtypit.
- Shqipton tingullin P duke e lidhur me shkronjën P.
- Gjen tingullin dhe shkronjën P në fjalë të ndryshme.
- Lexon globalisht fjalë që kanë shkronjën P në trup të tyre.
- Shkruan shkronjën P të madhe të shtypit.

Detyra:

1. Shkruajnë dy rreshta me shkronjën P.
2. Shkruajnë fjalët globale PINOKU, PULA, PERIME, LEPURI.

Refleksione:

<table>
<tr><td>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla: 1</td><td>Klasa: 1</td></tr>
<tr><td colspan="3">Tema mësimore:
Tingulli dhe shkronja Nj</td><td>Situata e të nxënit:
Shkronjat</td></tr>
<tr><td colspan="4">R.N. sipas kompetencave kyçe:
Nxënësi:
K.1 paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup.
K.3 zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes.
K.4 identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në shtëpi.
K.5 bashkëpunon me të tjerët pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitetet në klasë, shkollë apo jashtë saj.
K.6 shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive.</td></tr>
<tr><td colspan="3" rowspan="2">R.N. të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:
Nxënësi:
• Dallon shkronjën NJ në fjalët e dhëna.
• Shqipton tingullin NJ duke e lidhur me shkronjën NJ.
• Gjen tingullin dhe shkronjën NJ në fjalë të ndryshme.
• Lexon globalisht fjalë që kanë shkronjën NJ në trup të tyre. Shkruan shkronjën NJ të madhe të shtypit dhe fjalë globale.</td><td>Fjalë kyçe:
shkronja, njëshi, njeriu</td></tr>
<tr><td>Teknika dhe strategji:
• Stuhi mendimi
• Demonstrim
• Punë individuale</td></tr>
<tr><td colspan="3">Burimet e informacionit dhe mjete:

Abetare pune, shkronja NJ, lapsa, fletore, mjete vizatimi, etiketa me fjalë, tabela plastike, figura, lodra për fëmijë, shkronja, fletë formati, fije makaronash</td><td>Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë
Arte
Edukim me të drejtat e fëmijëve
Shoqëria dhe mjedisi</td></tr>
<tr><td colspan="4">Përshkrim kontekstual i situatës:
Veprimtari paraprake:

Mësuesja u shpërndan nxënësve shabllone shkronjash të mëdha të shtypit dhe i udhëzon që të shkruajnë me to në një fletë të bardhë (A,I,L,M,N,K,D,G, GJ...).
Mbasi i shkruajnë, nxënësit i ngjyrosin me ngjyra sipas dëshirës.
Mund të shoqërohet edhe me një lojë: Një nxënës lëviz në ajër dorën sipas modelit të një shkronje, nxënësit e tjerë gjejnë se cila shkronjë është.</td></tr>
</table>

Hapi i parë: Stuhi mendimi

Mësuesja pyet:
- Çfarë kemi vizatuar? Cila shkronjë ju pëlqen më shumë? Pse ju pëlqen?

Dëgjohen disa nxënës.
Shkruan fjalën SHKRONJA në tabelë dhe lexohet disa herë së bashku me nxënësit.

Hapi i dytë: Demonstrim

Mësuesja paraqet para nxënësve shkronjën NJ të madhe të shtypit dhe shpjegon formën e saj. E vizaton në ajër dhe pastaj në tabelë.
Modelohet shkronja NJ duke përdorur materiale të ndryshme dhe kërkohet nga nxënësit të bëjnë të njëjtë gjë.
Shqiptohet disa herë tingulli NJ nga nxënësit.
Nxiten nxënësit të thonë fjalë të tjera që përmbajnë në trupin e tyre shkronjën NJ dhe i shkruan në tabelë.
Qarkohet shkronja NJ në fjalët e shkruara në tabelë dhe përcaktohet vendi i saj (në fillim, në mes, në fund).

Hapi i tretë: Punë individuale

Nxënësit hapin Abetaren e punës dhe emërtojnë figurat (NJËSHI, NJERIU). Plotësojnë kutizat me shkronjën NJ.
Ngjyrosin figurat e njeriut dhe njëshit dhe më pas shkruajnë shkronjën B. Mësuesja ndjek nga afër punën e nxënësve dhe ndihmon ata që kanë vështirësi.
Shkruajnë emrin e tyre me shkronja të zbukuruara.

Demonstrim i rezultateve të arritura:
Shkruajnë shkronjën NJ në fletoren individuale.
Lexojnë fjalë globalisht.

Vlerësimi i situatës:
Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- Dallon shkronjën NJ në fjalët e dhëna.
- Shqipton tingullin NJ duke e lidhur me shkronjën NJ.
- Gjen tingullin dhe shkronjën NJ në fjalë të ndryshme.
- Lexon globalisht fjalë që kanë shkronjën NJ në trup të tyre.
- Shkruan shkronjën NJ të madhe të shtypit dhe fjalë globale.

Detyra:
1. Shkruajnë dy rreshta me shkronjën NJ.
2. Shkruajnë fjalët globale NJËSHI, NJERIU, SHKRONJA.

Refleksione:

<table>
<tr><td>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla: 1</td><td>Klasa: 1</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore:
Tingulli dhe shkronja O, Q. Qyteti</td><td colspan="2">Situata e të nxënit:
Në qytet</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe
Nxënësi:
➢ Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar.
➢ Kompetenca e të nxënit: Parashtron pyetje dhe përgjigje në lidhje me temën.
➢ Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin: Gjen të përbashkëtat dhe ndryshimet ndërmjet aktiviteteve që bën në klasë me ato në ambiente të tjera.</td></tr>
<tr><td colspan="2" rowspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore
Nxënësi:
- Shqipton tingujt O, Q.
- Të dallojë fjalë me O, Q në fillim ose që përmbajnë shkronjat O, Q në trup të tyre. (në pozicione të ndryshme)
- Lexon globalisht disa nga fjalët e dhëna.
- Komenton e përshkruan figurën.
- Formon fjali me fjalët e faqes.
- Vizaton figura që përmbajnë shkronjat O, Q dhe i emërton ato me shkrim shtypi.</td><td colspan="2">Fjalë kyçe:
Qyteti, rrugët, ndërtesat, njerëzit, semafor, makina, shkolla, spitali, shitore, posta, restorant, qeni, Umi, Ola, Ani.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Teknika dhe strategji:
❖ Bisedë
❖ Vëzhgim
❖ Demonstrim
❖ Lojë roli
❖ Vizatim/Emërtim me shkrim global</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, modele shkronjash shtypi, grafiku i shkronjave O, Q të shtypit, kartolina e Tiranës, foto me pamje nga qyteti, etiketa me fjalë me O, Q, figura dhe objekte si: qeni, orë, qilimi, qengji, qershia, qepë, qumësht, iriq, robot...</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera:
Lënda: Edukim fizik, Matematikë, Arte, Shoqëria dhe mjedisi.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Përshkrimi kontekstual i situatës:
▪ Veprimtari paraprake:
Hapi 1. Fillon me një bisedë për foton e paraqitur nga qendra e Tiranës. (kartolina e qendrës së Tiranës Ora në qendër të qytetit). Nxënësit nxiten të tregojnë për qytetin e tyre (mund të shoqërohen edhe me foto). Listojnë edhe disa nga emrat e qyteteve që vetë nxënësit njohin apo kanë vizituar.
Hapi 2. Nxënësit nxiten të listojnë ngjashmëritë dhe ndryshimet mes qytetit të tyre dhe atij të paraqitur në faqet 12-13 të librit. (edhe nxënësit që jetojnë në fshat e njohin qytetin të cilit i përkasin)
▪ Veprimet në situatë
Hapi 3. Hapet libri dhe komentohet figura, drejtohet biseda dhe komunikimi i shokëve në grup për pozicionet e Olës, Ani dhe qenushit Umi. Çfarë po bëjnë fëmijët? Cila pjesë e qytetit ju duket më e zhurmshme? Ku kalojnë njerëzit? Kush e orienton trafikun e makinave?
Lexohen globalisht fjalët e paraqitura në faqe si emërtime institucionesh (shkolla, spitali) dhe të njësive të shërbimit (restorant, shitore). Komentohet për rolin dhe rëndësinë sociale të tyre.
Shkruaj fjalët në dërrasë. Kryhet procesi i analizës për shkëputjen e tingujve dhe shkronjave O, Q.</td></tr>
</table>

Hapi 4. Shkruaj fjalët: QYTET, ORË, QENI, ORIZ. Kryhet procesi i analizës për shkëputjen e tingujve dhe shkronjave O, Q (nxënësit ndajnë edhe fjalët në rrokje).
Kalohet në ushtrime fonetike në shqiptimin e tingujve të rinj dhe theksohet se njëri është tingull zanor O e tjetri bashkëtingëllor.
Hapi 5. Demonstron para klasës grafiku i shkronjave të vogla dhe të mëdha të shtypit. Nxit nxënësit të bëjnë ngjashmëritë dhe dallimet me objekte të tjera rrethanore.
- Nxiten nxënësit të gjejnë fjalë që fillojnë me **O, Q**, e kanë në trup ose mbarojnë me **o, q**.
Hapi 6. Nxënësit punojnë individualisht për plotësimin e faqes 17 abetare pune me qarkimin dhe vizatimin e O, Q. Plotësohen shkronjat e shtypit në fjalë sipas modelit. Bëhet leximi dhe ndarja në rrokje e fjalëve në të djathtë të faqes. Ngre disa nxënës që shkruajnë fjalët në tabelë, të tjerë i përdorin në fjali ato.

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 7. Shkruan apo paraqiten shkronja të mëdha dhe fjalët kryesore në tabelë. Ndahen fjalët në rrokje. Individualisht nxënësit qarkojnë O, Q në fjalët e dhëna me fisha apo libra e revista.
Lexohen nga nxënësit në zinxhir fjalët e faqes 17.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Shqipton tingujt **O, Q**.
- ✓ Gjen dhe thotë fjalë që fillojnë me **O, Q** ose që përmbajnë tingujt **O, Q** në trup të tyre.
- ✓ Lexon globalisht fjalët e librit.
- ✓ Formon fjali me objekte e figura të faqes.
- ✓ Përshkruan mbi bazën e figurave.

Detyrë shtëpie:

1. Lexo dhe shkruaj nga një rresht me fjalët në abetare pune.
2. Shkruaj 5 rreshta me shkronjat **O, Q**.
3. Gjej dhe ngjit në A_4 fjalë me shkronjat o,q në pozicione të ndryshme.
4. Vizato dhe emërto figura që kanë në trup shkronjat O, Q.

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1	**Klasa:** 1
Tema mësimore: **Tingulli dhe shkronja R, RR. Në rrugë**		**Situata e të nxënit:** Në rrugë	

***Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe**

Nxënësi:

- ***Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit:*** Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar.
- ***Kompetenca e të nxënit:*** Parashtron pyetje dhe përgjigje në lidhje me temën.
- ***Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin:*** Gjen të përbashkëtat dhe ndryshimet ndërmjet aktiviteteve që bën në klasë me ato në ambiente të tjera. (në rrugë)

***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore**

Nxënësi:

- Shqipton tingujt **R, Rr**.
- Të dallojë fjalë me **R, Rr** në fillim ose që përmbajnë shkronjat R, Rr në trup të tyre. (në pozicione të ndryshme)
- Lexon globalisht disa nga fjalët e dhëna.
- Shkruan globalisht disa fjalë.
- Komenton e përshkruan figurat.
- Formon fjali me figurat e shoqëruara me emërtimet përkatëse.
- Vizaton figura që përmbajnë shkronjat R, Rr dhe i emërton ato me shkrim shtypi.
- Pasuron fjalorin me fjalë që përmbajnë shkronjat r, rr.

Fjalë kyçe:

Qyteti, rrugët, ndërtesat, njerëzit, semafor, polici, makina, shkolla, roboti, vijat e bardha, raketa, rrota, rrepa, rripi, shitore, posta, restorant, qeni, Umi, Ola, Ani.

Teknika dhe strategji:

- Bisedë
- Vëzhgim
- Punë në dyshe
- Demonstrim
- Lojë roli
- Vizatim/Emërtim me shkrim global

Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, modele shkronjash shtypi, grafiku i shkronjave **R, Rr** të shtypit,telefon/mjet regjistrues, foto me pamje nga rrugët e qytetit, etiketa me fjalë me R, Rr, figura dhe objekte me emrat e shkruar poshtë tyre si: roboti, orë, raketa, rosa, rripi, rrotë, rrepa, ariu, rruga...

Lidhja me fushat e tjera:

Lënda: Edukim fizik, Matematikë, Arte, Shoqëria dhe mjedisi.

Përshkrimi kontekstual i situatës:

- ***Veprimtari paraprake:***

Hapi 1. Fillon me një bisedë për foton e paraqitur nga mësuesi/ja ose zhurma të regjistruara në telefon ose magnetofon (nga rrugë me trafik dhe rrugë mes lagjesh/rrugë fshati). Nxënësit nxiten të tregojnë për rrugët që ndjekin nga shtëpia për në shkollën e tyre (mund të shoqërohen edhe me foto të sjella nga nxënësit). Listojnë edhe disa nga emrat e rrugëve që dinë apo përshkojnë më shpesh nxënësit.

Hapi 2. Nxënësit nxiten të listojnë ngjashmëritë dhe ndryshimet mes rrugëve të qytetit dhe fshatit. (trafiku, gjerësia, trotuari, pedonale)

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 3. Hapet libri dhe komentohet figura, drejtohet biseda dhe komunikimi i nxënësve për trafikun në

kryqëzim dhe në rrugët periferike të qytetit. Çfarë rregullash zbatojnë fëmijët për të shkuar në shkollë.(kalojnë nga njëra anë e rrugës në anën tjetër përmes vijave të bardha) Po fëmijët me biçikleta cilën rrugë ndjekin? Si quhen vendet përbri rrugëve ku duhet të kalojnë këmbësorët? (trotuare) Cila pjesë e qytetit ju duket më e zhurmshme? Kush e orienton trafikun në rrugë?(organi përgjegjës është policia rrugore). Sa rrugë ka në pamjen e dhënë? Nxënësit mund të dramatizojnë një situatë të thjeshtë në kryqëzim.

Lexohen globalisht fjalët e paraqitura në faqe si emërtime institucionesh (shkolla, televizioni) dhe të njësive të shërbimit (restorant, barnatore). Komentohet për rolin dhe rëndësinë sociale të tyre.

Mësuesi/ja paraqet fjalët RRUGË, RESTORANT në dërrasë. Nxënësit i lexojnë globalisht.

Hapi 4. Shkruhen/paraqiten me figura të shoqëruara me emërtime fjalët: RRUGË, RREPA, RAKETA, RËRË. Nxënësit të ndarë në grupe dyshe kryejnë procesin e analizës për shkëputjen e tingujve dhe shkronjave R, Rr nga fjalët e dhëna (nxënësit ndajnë edhe fjalët në rrokje).

Kalohet në ushtrime fonetike në shqiptimin e tingujve të rinj dhe theksohet pozicioni i gojës gjatë artikulimit të tingujve bashkëtingëllorë.

Hapi 5. Demonstron para klasës grafiku i shkronjave të vogla dhe të mëdha të shtypit. Nxit nxënësit të bëjnë ngjashmëritë dhe dallimet me shkronja e objekte të tjera rrethanore.

- Nxiten nxënësit të gjejnë fjalë që fillojnë me **R, RR** ose që e kanë në trup **r, rr**.

Hapi 6. Nxënësit punojnë individualisht për plotësimin e faqes 18 të abetares së punës me qarkimin dhe vizatimin e R, Rr. Plotësohen edhe shkronjat mungesore në fjalë. Bëhet leximi dhe ndarja në rrokje e fjalëve në të majtë të faqes. Ngre disa nxënës që shkruajnë fjalët në tabelë, të tjerë i përdorin në fjali ato.

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 7. Shkruhen apo paraqiten shkronja të mëdha dhe fjalët kryesore në tabelë. Ndahen fjalët në rrokje. Individualisht nxënësit qarkojnë R, Rr në fjalët e dhëna me etiketa apo libra e revista.

Lexohen nga nxënësit në zinxhir fjalët e faqes 18 si dhe shkruhen në A4 shkronjat R e RR.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Shqipton tingujt **R, Rr.**
- ✓ Gjen dhe thotë fjalë që fillojnë me **R, RR** ose që përmbajnë tingujt **R, RR** në trup të tyre.
- ✓ Lexon globalisht fjalët e dhëna.
- ✓ Formon fjali me objekte e figura të faqes.
- ✓ Përshkruan mbi bazën e figurave.
- ✓ Shkruan globalisht me të kopjuar disa fjalë me R, RR.

Detyrë shtëpie:

1. Lexo dhe shkruaj nga një rresht me fjalët në abetare pune.
2. Shkruaj 5 rreshta me shkronjat **R, Rr**.
3. Gjej dhe ngjit në A4 fjalë me shkronjat r, rr në pozicione të ndryshme.

Refleksione:

<table>
<tr><td>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla:1</td><td>Klasa1</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore:
Tingulli dhe shkronja S. Qyteti</td><td colspan="2">Situata e të nxënit:
Qyteti me semaforë</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe
Nxënësi:
➢ Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar.
➢ Kompetenca e të nxënit: Parashtron pyetje dhe përgjigje në lidhje me temën.
➢ Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin:
○ Gjen të përbashkëtat dhe ndryshimet ndërmjet aktiviteteve që bën në klasë me ato në ambiente të tjera.
○ Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjete) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një aktiviteti, detyre në klasë, shtëpi.</td></tr>
<tr><td colspan="2" rowspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore
Nxënësi:
✚ Shqipton tingullin bashkëtingëllor S.
✚ Të dallojë fjalë me S, në fillim ose që përmbajnë shkronjën S në trup të tyre. (në pozicione të ndryshme)
✚ Lexon globalisht disa nga fjalët e dhëna.
✚ Komenton e përshkruan foto/figura.
✚ Luan me lojë roli.
✚ Formon fjali me fjalët e dhëna.
✚ Shkruan globalisht disa fjalë me S.
✚ Vizaton figura që përmbajnë shkronjën S dhe i emërton ato me shkrim shtypi.</td><td colspan="2">Fjalë kyçe:
Qyteti, rrugët, ndërtesat, këmbësorët, semafor, makina, shkolla, spitali, shitore, posta, restorant, sinjal, simbol.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Teknika dhe strategji:
❖ Bisedë
❖ Demonstrim
❖ Lojë roli
❖ Analizë-sintezë
❖ Vizatim/Emërtim me shkrim global</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, modele shkronjash shtypi, grafiku i shkronjës S të shtypit, semafor lodër, foto me pamje nga qyteti, etiketa me fjalë me S, figura të emërtuara poshtë si dhe objekte: semafori, syri, syze, sapuni, sirena, stop, makina me bateri/lodër.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera:
Lënda: Edukim fizik, Matematikë, Arte, Shoqëria dhe mjedisi.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Përshkrimi kontekstual i situatës:
▪ Veprimtari paraprake:
Hapi 1. Fillon me një lojë ku nxënësit dramatizojnë situatën në një kryqëzim rruge. Njëri nga nxënësit është semafori (mund të realizohet i futur në një kuti) dhe ndryshon tabelat me ngjyra (kuqe, blu, portokalli) duke nxitur të lëvizin e ndalojnë nëpër qytetin imagjinar nxënësit dhe mësuesja në drejtime të ndryshme (mund të realizohen lëvizjet edhe me makina lodër në oborrin e shkollës).
Hapi 2. Nxënësit nxiten të tregojnë ngjashmëritë dhe ndryshimet mes qytetit e fshatit në lidhje me përdorimin e semaforit. Diskutohet për vlerat dhe rëndësinë e sjelljes drejt në rrugë për të shmangur aksidentet.
▪ Veprimet në situatë</td></tr>
</table>

Hapi 3. Hapet libri dhe komentohen figurat 12-13, drejtohet biseda për pozicionet e semaforëve. Ato vendosen në kryqëzime rrugësh. Cili simbol i semaforit mundëson kalimin e rrugës nga kalimtarët? Cila ngjyrë simbolizon ndalim kalimi? Ku kalojnë njerëzit? Në rastet kur nuk punon semafori kush e drejton trafikun e lëvizjeve?
Nxënësit qarkojnë numrin e semaforëve që janë paraqitur në figurë. Sa të tillë janë?
Hapi 4. Shkruaj fjalët: SEMAFOR, SYZE, SINJAL, SYRI, SPITAL. Kryhet procesi i analizës për shkëputjen e tingullit dhe shkronjës S. (nxënësit ndajnë edhe fjalët në rrokje).
Kalohet në ushtrime fonetike në shqiptimin e tingullit bashkëtingëllor S.
Hapi 5. Demonstron para klasës grafiku i shkronjës së vogël dhe të madhe të shtypit. Nxit nxënësit të bëjnë ngjashmëritë dhe dallimet me shkronja e objekte të tjera rrethanore.
- Nxiten nxënësit të gjejnë fjalë që fillojnë me **S** e kanë në trup ose mbarojnë me **S**.
Hapi 6. Nxënësit punojnë individualisht për plotësimin pjesës së parë të faqes 19 të abetares së punës me qarkimin dhe vizatimin e S. Bëhet leximi dhe ndarja në rrokje e fjalëve në të djathtë të faqes. Ngre disa nxënës të lexojnë e të tjerë të shkruajnë në tabelë fjalët *mëngjesi, mesdita, pasditja, mbrëmja* të tjerë i përdorin në fjali/ngjarje ato.

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 7. Shkruhen apo paraqiten shkronja të mëdha dhe fjalët kryesore në tabelë. Ndahen fjalët në rrokje. Individualisht nxënësit qarkojnë S në fjalët e dhëna me etiketa apo libra e revista.
Lexohen nga nxënësit në zinxhir fjalët e faqes 19 apo ato të shkruara në dërrasë.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Shqipton tingujt **S.**
- ✓ Gjen dhe thotë fjalë që fillojnë me **S** ose që përmbajnë tingujt **S** në trup të tyre.
- ✓ Lexon globalisht fjalët.
- ✓ Formon fjali me objekte e figura të faqes.
- ✓ Shkruan shkronjën S e fjalë me s në pozicione të ndryshme.
- ✓ Improvizon situata.

Detyrë shtëpie:

1. Lexo dhe shkruaj nga një rresht me fjalët në abetare pune.
2. Shkruaj 5 rreshta me shkronjën **S.**
3. Gjej dhe ngjit në A_4 fjalë me shkronjën S në pozicione të ndryshme.
4. Vizato një semafor dhe shkruaj fjalë që përmbajnë në trup **S.**

Refleksione:

<table>
<tr><td>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla:1</td><td>Klasa1</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore:
Tingulli dhe shkronja SH. Shkronjat</td><td colspan="2">Situata e të nxënit:
Shkronjat</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe
Nxënësi:
➢ Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar.
➢ Kompetenca e të nxënit: Parashtron pyetje dhe përgjigje në lidhje me temën.
➢ Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin: Gjen të përbashkëtat dhe ndryshimet ndërmjet aktiviteteve që bën në klasë me ato në ambiente të tjera.</td></tr>
<tr><td colspan="2" rowspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore
Nxënësi:
✚ Shqipton tingullin bashkëtingëllor SH.
✚ Të dallojë fjalë me SH në fillim ose që përmbajnë shkronjën SH në trup të tyre. (në pozicione të ndryshme).
✚ Lexon globalisht disa nga fjalët e dhëna.
✚ Komenton e përshkruan foto/figura.
✚ Luan me lojë roli.
✚ Formon fjali me fjalët e dhëna.
✚ Shkruan globalisht disa fjalë me SH.
✚ Vizaton figura që përmbajnë shkronjën SH dhe i emërton ato me shkrim shtypi.</td><td colspan="2">Fjalë kyçe: rrugët, shtëpi, shitës, semafor, makina e shpejtë, shkolla, spitali, shitore, shitëse, posta, shërbim, restorant, sinjal, shenja, shkronja.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Teknika dhe strategji:
❖ Bisedë
❖ Demonstrim
❖ Lojë roli
❖ Analizë-sintezë
❖ Vizatim/Emërtim me shkrim global</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, modele shkronjash shtypi, grafiku i shkronjës SH të shtypit, tabela e shkronjave, alfabeti me fletë të fotokopjuara, magnetofon, etiketa me fjalë me SH, figura të emërtuara si dhe objekte: shkalla, shkollë, shkronjat, shtëpia, shamia, shkolla, shkopi, shqiponja, shatërvan.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera:
Lënda: Matematikë, Arte, Shoqëria dhe mjedisi.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Përshkrimi kontekstual i situatës:
▪ Veprimtari paraprake:
Hapi 1. Mësimi fillon me një këngë <u>Të mësojmë së bashku</u> – alfabetin në këngë (tring) nose <u>Kënga e alfabetit shqip</u> në youtube. Kalohet në një lojë ku nxënësit paraqesin në A4 shkronja të mëdha të shtypit dhe i demonstrojnë para klasës si në një paradë duke i shoqëruar edhe me një fjalë apo emër që të fillojë me të. Njëri nga nxënësit mund të drejtojë radhën e paradës së shkronjës e të kërkojë nga shokët të thonë fjalë që e kanë atë në pozicione të ndryshme. Nxënësit shënojnë në fletët e fotokopjuara të alfabetit shkronjat që parakaluan.
Hapi 2. Nxënësit nxiten të tregojnë cila nga shkronjat është prezantuar më shumë herë. Pse? Sa herë? Diskutohet për alfabetin e gjuhës shqipe shkollën e parë shqipe që është hapur në Korçë në 07.03.1887. Shoqërohen me foto të shkollës së parë shqipe dhe shkollës ku ne sot mësojmë. Komente e argumente për to. Paraqitet fjala SHKOLLA dhe kalohet në analizën e saj duke veçuar bashkëtingëlloren SH.</td></tr>
</table>

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 3. Hapet libri dhe komentohen fjalët e shkruara në faqe 12-13. Nxiten nxënësit të qarkojnë me të kuqe shkronjat **S** (**S**emafori) dhe me blu shkronjat **SH (Sh**itore**)** tek emërtimet e tyre. Nxënësit tregojnë numrin përkatës të tyre në tabelë. Sa të tilla janë? Nxënësit mund të veprojnë edhe me fletë të fotokopjuara.

Shkronja **S**	Shkronja **SH**

Hapi 4. Shkruaj fjalët: SHALLI, SHKALLA, SHAPKA, SHQIPONJA, SHQIPE, SHKRONJA. Kryhet procesi i analizës për shkëputjen e tingullit dhe shkronjës SH. (nxënësit ndajnë edhe fjalët në rrokje). Kalohet në ushtrime fonetike në shqiptimin e tingullit bashkëtingëllor Sh .

Hapi 5. Demonstron para klasës grafiku i shkronjës së vogël dhe të madhe të shtypit. Nxit nxënësit të bëjnë ngjashmëritë dhe dallimet me S e objekte të tjera rrethanore.

- Nxiten nxënësit të gjejnë fjalë që fillojnë me **SH** e kanë në trup atë.

Hapi 6. Nxënësit punojnë individualisht për plotësimin pjesës së dytë të faqes 19 të abetares së punës me qarkimin dhe vizatimin e SH. Bëhet leximi dhe ndarja në rrokje e fjalëve në të djathtë të faqes. Ngre disa nxënës të lexojnë e të tjerë të shkruajnë në tabelë fjalët duke i përdorur në fjali/ngjarje ato.

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 7. Shkruhen apo paraqiten me shkronja të mëdha të shtypit fjalët kryesore në tabelë. Ndahen fjalët në rrokje. Individualisht nxënësit qarkojnë SH në fjalët e dhëna me etiketa apo libra e revista. Lexohen nga nxënësit në zinxhir fjalët e pjesës së dytë të faqes19 apo ato të shkruara në dërrasë.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Shqipton tingullin **SH.**
- ✓ Gjen dhe thotë fjalë që fillojnë me **SH** ose që përmbajnë tingullin **SH** në trup të tyre.
- ✓ Lexon globalisht fjalët.
- ✓ Formon fjali me objekte e figura të faqes.
- ✓ Shkruan shkronjën **SH** e fjalë me sh në pozicione të ndryshme.
- ✓ Improvizon situata.

Detyrë shtëpie:

1. Lexo dhe shkruaj nga një rresht me fjalët në abetaren e punës.
2. Shkruaj 5 rreshta me shkronjën **Sh**.
3. Gjej dhe ngjit në A_4 fjalë me shkronjën Sh në pozicione të ndryshme.
4. Vizato një shkollë dhe shkruaj në oborrin e saj fjalë që përmbajnë në trup SH.

Refleksione:

<table>
<tr><td>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla: 1</td><td>Klasa: 1</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore:
Tingulli dhe shkronja T. Mjetet e udhëtimit</td><td colspan="2">Situata e të nxënit:
Mjetet e udhëtimit</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe
Nxënësi:
➢ Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar.
➢ Kompetenca e të nxënit: Parashtron pyetje dhe përgjigje në lidhje me temën.
➢ Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin:
o Gjen të përbashkëtat dhe ndryshimet ndërmjet aktiviteteve që bën në klasë me ato në ambiente të tjera.</td></tr>
<tr><td colspan="2" rowspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore
Nxënësi:
✚ Shqipton tingullin bashkëtingëllor T.
✚ Të dallojë fjalë me T në fillim ose që përmbajnë shkronjën T në trup të tyre.(në pozicione të ndryshme)
✚ Lexon globalisht disa nga fjalët e dhëna.
✚ Komenton e përshkruan figura.
✚ Formon fjali me fjalët e faqes.
✚ Vizaton figura që përmbajnë shkronjën T dhe i emërton ato me shkrim shtypi.</td><td>Fjalë kyçe:
Qyteti, rrugët, ndërtesat, njerëzit, topi, treni, trageti, transporti, spitali, shitore, posta, restorant, televizioni.</td></tr>
<tr><td>Teknika dhe strategji:
❖ Bisedë
❖ Demonstrim
❖ Analizë-sintezë.
❖ Vizatim/Emërtim me shkrim global</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, modele shkronjash shtypi, grafiku i shkronjave T, t të shtypit, foto me pamje mjetesh transporti, etiketa me fjalë me T, figura dhe objekte si: treni, trageti, helikopteri, tapa, topi, tavolina, tastierë.</td><td>Lidhja me fushat e tjera:
Lënda: Matematikë, Arte, Shoqëria dhe mjedisi.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Përshkrimi kontekstual i situatës:
▪ Veprimtari paraprake:
Hapi 1. Paraqiten përpara klasës foto apo lodra: treni, trageti, helikopteri, makina, biçikleta. Nxënësit nxiten të emërtojnë e të tregojnë përse shërbejnë.(shërbejnë për transporte) Listojnë edhe disa mjete të tjera udhëtimi që vetë nxënësit njohin apo kanë përdorur. Iu kërkohet nxënësve që të imitojnë disa prej tyre si në tinguj edhe në veprime.
Hapi 2. Nxënësit nxiten të listojnë ngjashmëritë dhe ndryshimet mes tyre. Iu paraqiten emërtimet e tyre me shkronja të mëdha me simbolin e T të ngjyrosur TRENI, HELIKOPTERI, TRAGETI, BIÇIKLETA, AUTOBUSI. Nxënësit tregojnë cilat janë shkronjat që përsëriten në çdo fjalë. (i,t. I ngjyrosin ato). Tingulli i bashkëtingëllores T është tingulli i ri.
▪ Veprimet në situatë
Hapi 3. Hapet libri dhe komentohet figura, Cilat mjete të transportit janë paraqitur në faqet 12-13 të librit. Drejtohet biseda dhe komunikimi për mjetet e transportit qytetas. Po ju me farë mjetesh udhëtoni për në shkollë? Cili është mjeti më i shpejtë i transportit sipas jush? Nxënësit argumentojnë përgjigjet</td></tr>
</table>

me informacionet e ndryshme që ata kanë.
Lexohen globalisht fjalët e paraqitura në faqe dhe iu kërkohet të veçojnë ato fjalë që kanë në trup shkronjën T e t'i shkruajnë fjalët me të kopjuar në dërrasë. Kryhet procesi i analizës për shkëputjen e rrokjeve dhe shkronjës **T**. (spi-ta-li)
Hapi 4. Shkruaj fjalët: QYTET, TAVOLINË, TOPI, TAPA. Kryhet procesi i analizës për shkëputjen e shkronjës T (nxënësit ndajnë edhe fjalët në rrokje). Kalohet në ushtrime fonetike në shqiptimin e tingullit të ri, theksohet se T është tingull bashkëtingëllor. Listohen edhe emra që fillojnë me T. *Tomi*
Hapi 5. Demonstron para klasës grafiku i shkronjave të vogla dhe të mëdha të shtypit. Nxit nxënësit të bëjnë ngjashmëritë dhe dallimet me shkronja e objekte të tjera rrethanore.
- Nxiten nxënësit të gjejnë fjalë që fillojnë me **T**, e kanë në trup **t**.
Hapi 6. Nxënësit punojnë individualisht për plotësimin gjysmës së faqes 20 të abetares së punës me qarkimin dhe vizatimin e T si dhe elementëve të shkrimit. Bëhet leximi dhe ndarja në rrokje e fjalëve në të majtë të faqes. Ngre disa nxënës që shkruajnë fjalët në tabelë, të tjerë i përdorin në fjali ato.

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 7. Vizaton dhe emërton figura me shkronja të mëdha të shtypit.(p.sh TRENI) Ndahen fjalët në rrokje. Individualisht nxënësit qarkojnë T në fjalët e dhëna me etiketa apo libra e revista.
Lexohen nga nxënësit në zinxhir fjalët e faqes 20.

Vlerësimi i situatës:
Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Shqipton tingullin bashkëtingëllor **T**.
- ✓ Gjen dhe thotë fjalë që fillojnë me **T** ose që përmbajnë tingullin e **T** në trup të tyre.
- ✓ Lexon globalisht fjalët e dhëna.
- ✓ Formon fjali me objekte e figura të faqes.
- ✓ Përshkruan mbi bazën e figurave.

Detyrë shtëpie:

1. Lexo dhe shkruaj nga 2-3 rreshta me fjalët në abetaren e punës.
2. Shkruaj 5 rreshta me shkronjat **T**, **t**.
3. Gjej, ngjit dhe vizato në A4 fjalë me shkronjën T në pozicione të ndryshme.
4. Vizato një mjet udhëtimi dhe emërto disa mjete udhëtimi që kanë në trup shkronjën T.

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1	**Klasa:** 1
Tema mësimore: **Tingulli dhe shkronja TH**.		**Situata e të nxënit:** Thesi i dhuratave për ditëlindje	

***Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe**

Nxënësi:

- ***Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit:*** Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar.
- ***Kompetenca e të nxënit:*** Parashtron pyetje dhe përgjigje në lidhje me temën.
- ***Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin:*** Gjen të përbashkëtat dhe ndryshimet ndërmjet aktiviteteve që bën në klasë me ato në ambiente të tjera.
- ***Kompetenca digjitale:*** Realizon punime vetjake duke përdorur figurat e gjetura nga burime informacioni, si një formë për të shprehur emocionet.

***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore**

Nxënësi:

- Shqipton tingullin bashkëtingëllor **TH**.
- Të dallojë fjalë me **TH** në fillim ose që përmbajnë shkronjën Th në trup të tyre. (në pozicione të ndryshme).
- Lexon globalisht disa nga fjalët e dhëna.
- Komenton e përshkruan figura.
- Formon fjali me fjalët e faqes.
- Vizaton figura që përmbajnë shkronjën **TH** dhe i emërton ato me shkrim shtypi.

Fjalë kyçe: *thesi, dhurata, thika, thupra, thumbi, thesi i dhuratave, kalendari i ditëlindjes*

Teknika dhe strategji:

- Bisedë
- Punë në grupe
- Analizë-sintezë.
- Vizatim/Emërtim me shkrim global

Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, modele shkronjash shtypi, grafiku i shkronjave **TH, th** të shtypit, foto me pamje festa ditëlindjesh, thes, etiketa me fjalë me **TH**, figura dhe objekte si: thesi, thika, thumbi, thjerrëz, thekër, thupra.

Lidhja me fushat e tjera:

Lënda: Matematikë, Arte, Shoqëria dhe mjedisi.

Përshkrimi kontekstual i situatës:

- ***Veprimtari paraprake:***

Hapi 1. Paraqiten përpara klasës foto nga festa të ndryshme ditëlindjesh. Zhvillohet një bisedë për llojet e festave që kanë organizuar nxënësit për ditëlindjet e tyre apo edhe të të afërmve të tyre.

Hapi 2. Nxënësve iu kërkohet që në A4 të shkruajnë numrin që korrespondon me datën e lindjes së tyre (ose edhe muajin). Lexohen muajt e vitit të paraqitura me etiketa në dërrasë. Nxënësve iu kërkohet të grupohen sipas muajve të lindjes para klasës. Secili grup shkruan globalisht në A4 emrin e dhuratës/ave të preferuara dhe i futin ato në thesin e dhuratave (dikush edhe e vizaton). Shkruhet në dërrasë fjala THESI qarkohen shkronjat e mësuara e veçohet tingulli bashkëtingëllor Th.

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 3. Hapet libri dhe komentohet figura e faqes 18. Secili nga nxënësit qarkon muajin e ditëlindjes dhe shënon datën. Më tej lexohen globalisht fjalët që nxirren me radhë nga thesi dhe iu kërkohet të

veçojnë atë fjalë që përfaqëson dhuratën më të preferuar nga nxënësit. Shkruhet ajo fjalë në dërrasë. Kryhet procesi i analizës së saj për ndarjen në rrokje. (to-pi)

Hapi 4. Shkruaj fjalët: THANA, TAPA/ TUL, THUR. Kryhet procesi i analizës për shkëputjen e shkronjave T e TH (nxënësit ndajnë edhe fjalët në rrokje). Kalohet në ushtrime fonetike në shqiptimin e tingullit të ri, theksohet se TH është tingull bashkëtingëllor e bëhet krahasimi me T.

Hapi 5. Demonstron para klasës grafiku i shkronjave të vogla dhe të mëdha të shtypit. Nxit nxënësit të bëjnë ngjashmëritë dhe dallimet me T e H dhe objekte të tjera rrethanore.

- Nxiten nxënësit të gjejnë fjalë që fillojnë me **TH**, e kanë në trup **th**. THUPRA, THUMBI, THUTHUQ, THIKA.

Hapi 6. Nxënësit punojnë individualisht për plotësimin gjysmës së dytë të faqes 20 të abetares së punës me qarkimin dhe vizatimin e TH si dhe elementëve të shkrimit. Plotësohen shkronjat që mungojnë në fjalë. Bëhet leximi dhe ndarja në rrokje e tyre. Ngre disa nxënës që shkruajnë fjalët në tabelë, të tjerë i përdorin në fjali ato.

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 7. Vizaton dhe emërton figura me shkronja të mëdha të shtypit. (p.sh. THESI) Ndahen fjalët në rrokje. Individualisht nxënësit qarkojnë TH në fjalët e dhëna me etiketa apo libra e revista.
Lexohen nga nxënësit në zinxhir fjalët e faqes 20.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Shqipton tingullin bashkëtingëllor **TH**.
- ✓ Gjen dhe thotë fjalë që fillojnë me **TH** ose që përmbajnë tingullin e **Th** në trup të tyre.
- ✓ Lexon globalisht fjalët e dhëna.
- ✓ Formon fjali me objekte e figura të faqes.
- ✓ Përshkruan mbi bazën e fotove e figurave.

Detyrë shtëpie:

1. Lexo dhe shkruaj nga 2-4 rreshta me fjalët në abetaren e punës.
2. Shkruaj 5-6 rreshta me shkronjat **TH, th**.
3. Gjej, ngjit dhe vizato në A4 fjalë me shkronjën TH në pozicione të ndryshme.
4. Vizato një thes dhe shkruaj në të fjalë që kanë në trup shkronjën Th.

Refleksione:

<table>
<tr><td>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla: 1</td><td>Klasa: 1</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore:
Tingulli dhe shkronja X. Në garë</td><td colspan="2">Situata e të nxënit:
Nxënësit në garë</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe
Nxënësi:
➢ Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar.
➢ Kompetenca e të nxënit: Parashtron pyetje dhe përgjigje në lidhje me temën.
➢ Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin: Gjen të përbashkëtat dhe ndryshimet ndërmjet aktiviteteve që bën në klasë me ato në ambiente të tjera.</td></tr>
<tr><td colspan="2" rowspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore
Nxënësi:
✚ Shqipton tingullin bashkëtingëllor X.
✚ Të dallojë fjalë me X në fillim ose që përmbajnë shkronjën X në trup të tyre.(në pozicione të ndryshme)
✚ Lexon globalisht disa nga fjalët e dhëna.
✚ Komenton e përshkruan figura.
✚ Formon fjali me fjalët e dhëna.
✚ Vizaton figura që përmbajnë shkronjën X dhe i emërton ato me shkrim shtypi.</td><td colspan="2">Fjalë kyçe:
Nxënësit, xixëllonjë, xixa, nxin, lexon, nxiton</td></tr>
<tr><td colspan="2">Teknika dhe strategji:
❖ Bisedë
❖ Demonstrim
❖ Analizë-sintezë.
❖ Vizatim/Emërtim me shkrim global</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, modele shkronjash shtypi, grafiku i shkronjave X, x të shtypit, foto me pamje nxënësish në garë, foto të xixëllonjës, etiketa me fjalë me X ose teksti i vjershës Xixëllonja, figura dhe objekte si: nxënësit, nxirë, xixa, xixëllonja, lexon...</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera:
Lënda: Edukim fizik, Matematikë, Arte, Shoqëria dhe mjedisi.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Përshkrimi kontekstual i situatës:
▪ Veprimtari paraprake:
Hapi 1. Nxënësit dalin në oborrin e shkollës dhe të ndarë në dy grupe zhvillojnë një garë vrapimi. Nxënësit nxiten të zgjedhin nxënësin më të shpejtë në garë. Tregojnë kur, ku zhvillohen garat sportive dhe të listojnë llojet e garave që zhvillojnë më shpesh mes tyre.
Hapi 2. Nxënësit nxiten të gjejnë gjëegjëzën. Natën të ndriçon,
kur pranë të kalon,
syrin hap e mbyll,
energji lëshon
kur drejtim ndryshon.(xixëllonja)
▪ Veprimet në situatë
Hapi 3. Hapet libri dhe komentohen figurat e faqes 19. Duke parë figurat nxiten nxënësit të krijojnë një ngjarje. Cilat janë rregullat e garës sportive? Çfarë ndodhi me djalin në figurën 4? Cili është mjeti që ju vjen më shpejt në ndihmë kur dëmtoheni, aksidentoheni ose jeni sëmurë? (ambulanca) Nxënësit argumentojnë përgjigjet me informacionet e ndryshme që ata kanë.</td></tr>
</table>

Lexohet globalisht fjalia e paraqitur në dërrasë NXËNËSIT NË GARË dhe iu kërkohet të veçojnë ato shkronjë që nuk kanë punuar më parë. Veçojnë shkronjën X e shkruajnë fjalën me të kopjuar nga dërrasa. Kryhet procesi i analizës për shkëputjen e rrokjeve dhe shkronjës **X**. (nxë-në-si)

Hapi 4. Shkruaj fjalët e vjershës/paraqitet në flip-art vjersha XIXËLLONJAT. (shoqërohen me foto)

Xixë-xixëllonja,/ xixëllon si yll/netëve verore/"syrin" hap e mbyll.
Ku Guximi ynë,/qenin Xen merr pas/ edhe me nxitim/ i ndjekin plot gaz.
O sa shumë vrapojnë!/Nxehen që si kapin./Qeshin xixëllonjat./"syrin"mbyllin-hapin. Adelina Mamaqi.

Kryhet procesi i analizës për qarkimin e shkronjës X (nxënësit ndajnë edhe fjalët në rrokje). Kalohet në ushtrime fonetike në shqiptimin e tingullit të ri, theksohet se X është tingull bashkëtingëllor. Listohen edhe emra që fillojnë me X. *Xeni*

Hapi 5. Demonstron para klasës grafiku i shkronjave të vogla dhe të mëdha të shtypit. Nxit nxënësit të bëjnë ngjashmëritë dhe dallimet me shkronja e objekte të tjera rrethanore.

- Nxiten nxënësit të gjejnë fjalë që fillojnë me **X**, e kanë në trup **x**.

Hapi 6. Nxënësit punojnë individualisht për plotësimin gjysmës së faqes 23 të abetares së punës me qarkimin dhe vizatimin e X si dhe plotësimin e shkronjave mungesore. Bëhet leximi dhe ndarja në rrokje e fjalëve në të djathtë të faqes. Ngre disa nxënës që shkruajnë fjalët në tabelë, të tjerë i përdorin në fjali ato.

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 7. Vizaton dhe emërton figura me shkronja të mëdha të shtypit. (p.sh. XIXA) Ndahen fjalët në rrokje. Individualisht nxënësit qarkojnë X në fjalët e dhëna me etiketa apo libra e revista.
Lexohen nga nxënësit fjalët globalisht.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Shqipton tingullin bashkëtingëllor **X**.
- ✓ Gjen dhe thotë fjalë që fillojnë me **X** ose që përmbajnë tingullin e **x** në trup të tyre.
- ✓ Lexon globalisht fjalët e dhëna.
- ✓ Formon fjali me objekte e figura të faqes.
- ✓ Përshkruan mbi bazën e figurave.
- ✓ Lexon dhe shkruan globalisht fjalë që kanë në trup X.

Detyrë shtëpie:

1. Lexo dhe shkruaj nga 2-3 rreshta me fjalët në abetaren e punës.
2. Shkruaj 5 rreshta me shkronjat **x**, **X**.
3. Gjej, ngjit dhe vizato në A_4 fjalë me shkronjën X në pozicione të ndryshme.
4. Vizato një xixë dhe shkruaj rreth saj fjalë që kanë në trup shkronjën X.

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1	**Klasa:** 1
Tema mësimore: **Tingulli dhe shkronja XH**.		**Situata e të nxënit:** Borëbardha dhe shtatë xhuxhat	
Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe** Nxënësi: ➢ ***Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar. ➢ ***Kompetenca e të nxënit:*** Parashtron pyetje dhe përgjigje në lidhje me temën. ➢ ***Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin:*** o Gjen të përbashkëtat dhe ndryshimet ndërmjet aktiviteteve që bën në klasë me ato në ambiente të tjera. o Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjete) dhe i përdor për kryerjen e një detyre në klasë/shtëpi.			
***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore** Nxënësi: ✚ Shqipton tingullin bashkëtingëllor **XH**. ✚ Të dallojë fjalë me **XH** në fillim ose që përmbajnë shkronjën XH në trup të tyre. (në pozicione të ndryshme). ✚ Lexon globalisht disa nga fjalët e dhëna. ✚ Komenton e përshkruan figura. ✚ Formon fjali me fjalët e faqes. ✚ Vizaton figura që përmbajnë shkronjën **XH** dhe i emërton ato me shkrim shtypi. ✚ Pasuron fjalorin me fjalë që përmbajnë Xh.		**Fjalë kyçe:** xhami, xhupi, xhuxhat, xhaketa, xhaxhi, xhepi, xhind, xhinse, xhiro. xhufkë, xhungla, valixhe, xhuxhmaxhuxh. **Teknika dhe strategji:** ❖ Bisedë ❖ Demonstrim ❖ Lexim – shkrim. ❖ Analizë-sintezë. ❖ Vizatim/Emërtim me shkrim global	
Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, modele shkronjash shtypi, grafiku i shkronjave **XH, xh** të shtypit, laptop dhe monitor, etiketa me fjalë me **XH**, poster i përrallës "Borëbardha dhe shtatë xhuxhat", figura dhe objekte si: xhami, xhupi, xhuxhat, xhaketa, xhinse, valixhe...		**Lidhja me fushat e tjera:** Lënda: Matematikë, Arte, Shoqëria dhe mjedisi.	
Përshkrimi kontekstual i situatës: ▪ ***Veprimtari paraprake:*** ***Hapi 1.*** Paraqiten përpara klasës fragmente nga filmi "Borëbardha dhe shtatë xhuxhat"./ose lexohet fragmenti nga revista i shoqëruar me figura. Diskutohet rreth personazheve dhe cilësive të tyre. (Borëbardha, xhuxhat, shtriga, princi...) ***Hapi 2.*** Mësuesja iu paraqet nxënësve emërtimet e fjalëve me shkronja të mëdha me simbolin e XH^{së} të ngjyrosur **XH**IMI, **XH**U**XH**MA**XH**U**XH**ËT, **XH**AKETA E **XH**U**XH**IT, **XH**U**XH**AT. Nxënësit tregojnë cilat janë pozicionet e shkronjave në çdo fjalë.(*I kopjojnë e ngjyrosin **xh** në to*). Tingulli i bashkëtingëllores XH është tingulli i ri. Sa shkronja Xh ngjyrosët? ▪ ***Veprimet në situatë***			

Hapi 3. Mësuesi/ja iu prezanton nxënësve fotot ose lodra të xhuxhave dhe iu kërkoj t'iu vënë emra atyre p.sh Xhoni, Xhimi, Xheni. Drejtohet biseda për to ose dramatizohet një fragment nga përralla e njohur për fëmijë. Cili ishte xhuxhi më i dashur për ju? Nxënësit argumentojnë përgjigjet me informacionet e ndryshme që ata kanë.
Lexohen globalisht fjalët e paraqitura në dërrasë XHUXHI, XHUPI, XHIMI, XHEZVE, XHEPI dhe iu kërkohet të veçojnë ato fjalë që kanë në trup shkronjën XH e t'i shkruajnë fjalët me të kopjuar në dërrasë. Kryhet procesi i analizës për shkëputjen e rrokjeve dhe shkronjës **XH**. (xhu-pi, xhu-xhi)
Hapi 4. Shkruaj fjalët: XHUXHI, XHAMI, XHAKETA, VALIXHE, XHINSE, XHAKETA. Kryhet procesi i analizës për shkëputjen e shkronjës XH (nxënësit ndajnë edhe fjalët në rrokje). Kalohet në ushtrime fonetike në shqiptimin e tingullit bashkëtingëllor XH. Listohen edhe emra që fillojnë me Xh. *Xhiljola.*
Hapi 5. Demonstron para klasës grafiku i shkronjave të vogla dhe të mëdha të shtypit. Nxit nxënësit të bëjnë ngjashmëritë dhe dallimet me shkronjën X e objekte të tjera rrethanore.
- Nxiten nxënësit të gjejnë fjalë që fillojnë me **XH** dhe e kanë në trup **xh**.
Hapi 6. Nxënësit punojnë individualisht për plotësimin gjysmës së faqes 23 të abetares së punës me qarkimin dhe shkrimin e XH^{së}. Bëhet leximi dhe ndarja në rrokje e fjalëve në të djathtë të faqes . Ngre disa nxënës që shkruajnë fjalët në tabelë, të tjerë i kopjojnë globalisht dhe i përdorin në fjali ato.

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 7. Nxënësit vizatojnë dhe emërtojnë figura me shkronja të mëdha të shtypit. (p.sh. XHUPI) Ndahen fjalët në rrokje. Individualisht nxënësit qarkojnë XH në fjalët e dhëna me etiketa apo libra e revista.
Lexohen e kopjohen globalisht nga nxënësit fjalët e faqes 23.

Vlerësimi i situatës:
Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Shqipton tingullin bashkëtingëllor **XH**.
- ✓ Gjen dhe thotë fjalë që fillojnë me **XH** ose që përmbajnë tingullin e **xh** në trup të tyre.
- ✓ Lexon globalisht fjalët e dhëna.
- ✓ Formon fjali me objekte e figura.
- ✓ Përshkruan mbi bazën e figurave.

Detyrë shtëpie:

1. Lexo dhe shkruaj nga 2-3 rreshta me fjalët në abetaren e punës.
2. Shkruaj 5 rreshta me shkronjat **XH, xh**.
3. Gjej, ngjit dhe vizato në A4 fjalë me shkronjën Xh në pozicione të ndryshme.
4. Vizato një xhep dhe mbushe atë me fjalë që kanë në trup shkronjën Xh.

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1	**Klasa:** 1
Tema mësimore: **Tingulli dhe shkronja V.**		**Situata e të nxënit:** Filmat vizatimorë	

***Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe**

Nxënësi:

- ***Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit:*** Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar.
- ***Kompetenca e të nxënit:*** Parashtron pyetje dhe përgjigje në lidhje me temën.
- ***Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin:*** Gjen të përbashkëtat dhe ndryshimet ndërmjet aktiviteteve që bën në klasë me ato në ambiente të tjera.

***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore**

Nxënësi:

- Shqipton tingullin bashkëtingëllor **V**.
- Të dallojë fjalë me **V** në fillim ose që përmbajnë shkronjat V në trup të tyre. (në pozicione të ndryshme)
- Lexon globalisht disa nga fjalët e dhëna.
- Komenton e përshkruan foto/figura.
- Luan me lojë roli.
- Formon fjali me fjalët e dhëna
- Shkruan globalisht disa fjalë me **V**.
- Vizaton figura që përmbajnë shkronjat **V** dhe i emërton ato me shkrim shtypi.

Fjalë kyçe: veza, violina, film vizatimor, viti, varka, veshi, vizore, volejboll, vetull, vëlla, veteriner, verë, verdhë, vendos

Teknika dhe strategji:

- Bisedë
- Demonstrim
- Lojë roli
- Analizë-sintezë
- Vizatim/Emërtim me shkrim global

Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, modele shkronjash shtypi, grafiku i shkronjës **V** të shtypit, tabela e shkronjave, alfabeti me fletë të fotokopjuara, magnetofon, etiketa me fjalë me V, figura të emërtuara si dhe objekte: veza, varka, vizatim, viza, violina, veshi, viti, varëse, shatërvan.

Lidhja me fushat e tjera:
Lënda: Matematikë, Arte, Shoqëria dhe mjedisi.

Përshkrimi kontekstual i situatës:

- ***Veprimtari paraprake:***

Hapi 1. Mësimi fillon me ndjekjen e një fragmenti të filmit vizatimor "Mamadhia, kecat dhe ujku" në youtube ose videokasetë. Kalohet në një lojë roli ku nxënësit dramatizojnë para klasës një fragment nga filmi vizatimor (mund të luhet edhe me elementë kukulla ose maska). Njëri nga nxënësit mund të luajë rolin e ujkut dhe të tjerë rolin e kecave mendjelehtë). Nxënësit listojnë titujt e filmave vizatimorë që kanë si më të preferuar "Tomi dhe Xheri"...

Hapi 2. Nxënësit nxiten të tregojnë cilat janë ndryshimet dhe ngjashmëritë mes filmave vizatimorë dhe atyre me personazhe njerëz. Komente e argumente për to. Paraqitet fjalia FILMA VIZATIMORË dhe kalohet në analizën e saj duke veçuar bashkëtingëlloren V.

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 3. Hapet libri dhe komentohen figurat e fq. 20. Nxiten nxënësit të qarkojnë me të kuqe shkronjat **U** (**u**jku) dhe me blu shkronjat **V** (**V**arka) te fjalët e dhëna në fletë të fotokopjuara që mund të punohen

në dyshe. Nxënësit i listojnë në tabelë. Sa të tilla janë? Nxënësit mund të veprojnë në dyshe për rreth 5 minuta.(urithi, miu, violina, veshi, varëse, buka, vëlla, vogël, ura, ujë, ulliri, vizatim, parku, veterineri, vizore, ujku)	
Shkronja **U**	Shkronja **V**

Hapi 4. Shkruaj disa nga fjalët në dërrasë: VARKA, VARËSE, VIOLINA, VESHI, VIZATIM, VËLLA dhe kryhet procesi i analizës për shkëputjen e tingullit dhe shkronjës V. (nxënësit ndajnë edhe fjalët në rrokje).

Kalohet në ushtrime fonetike në shqiptimin e tingullit bashkëtingëllor V .

Hapi 5. Demonstron para klasës grafiku i shkronjës së vogël dhe të madhe të shtypit. Nxit nxënësit të bëjnë ngjashmëritë dhe dallimet me U e objekte të tjera rrethanore.

- Nxiten nxënësit të gjejnë fjalë që fillojnë me **V** e kanë në trup atë.

Hapi 6. Nxënësit punojnë individualisht për plotësimin pjesës së parë të faqes 21 të abetares së punës me qarkimin dhe vizatimin e V. Bëhet leximi dhe ndarja në rrokje e fjalëve në të djathtë të faqes. Ngre disa nxënës të lexojnë e të tjerë të shkruajnë në fletë/tabelë fjalët duke i përdorur në fjali/ngjarje ato.

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 7. Shkruhen apo paraqiten me shkronja të mëdha të shtypit fjalët kryesore në tabelë. Ndahen fjalët në rrokje. Individualisht nxënësit qarkojnë V në fjalët e dhëna me fisha apo libra e revista.

Lexohen nga nxënësit në zinxhir fjalët e pjesës së parë të faqes 21 të abetares së punës apo ato të shkruara në dërrasë.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Shqipton tingullin **V**.
- ✓ Gjen dhe thotë fjalë që fillojnë me **V** ose që përmbajnë tingullin **V** në trup të tyre.
- ✓ Lexon globalisht fjalët.
- ✓ Formon fjali me objekte e figura të faqes.
- ✓ Shkruan shkronjën **V** e fjalë me **v** në pozicione të ndryshme.
- ✓ Improvizon situata.

Detyrë shtëpie:

1. Lexo dhe shkruaj nga një rresht me fjalët në abetaren e punës.
2. Shkruaj 5 rreshta me shkronjën **V**.
3. Gjej dhe ngjit në A4 fjalë me shkronjat V në pozicione të ndryshme.
4. Vizato një varkë që noton mbi fjalë që përmbajnë në pozicione të ndryshme shkronjën V.

Refleksione:

<table>
<tr><td>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla: 1</td><td>Klasa: 1</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore:
Tingulli dhe shkronja Y.</td><td colspan="2">Situata e të nxënit:
Ylberi i ngjyrave</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe
Nxënësi:
➢ Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar.
➢ Kompetenca e të nxënit: Parashtron pyetje dhe përgjigje në lidhje me temën.
➢ Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin:
○ Gjen të përbashkëtat dhe ndryshimet ndërmjet aktiviteteve që bën në klasë me ato në ambiente të tjera.
○ Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjete) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një aktiviteti, detyre në klasë, shtëpi.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore
Nxënësi:
✚ Shqipton tingullin zanor Y.
✚ Të dallojë fjalë me Y, në fillim ose që përmbajnë shkronjat Y në trup të tyre. (në pozicione të ndryshme).
✚ Lexon globalisht disa nga fjalët e dhëna.
✚ Komenton e përshkruan foto/figura.
✚ Luan me lojë roli.
✚ Formon fjali me fjalët e dhëna.
✚ Shkruan globalisht disa fjalë me Y.
✚ Vizaton figura që përmbajnë shkronjat Y dhe i emërton ato me shkrim shtypi.</td><td colspan="2">Fjalë kyçe:
Ylberi, ngjyrat, ylli, gjyshi, pylli, syze, syri, fytyra, byrek, dyshek

Teknika dhe strategji:
❖ Bisedë
❖ Demonstrim
❖ Marrëdhënie pyetje-përgjigje.
❖ Analizë-sintezë
❖ Vizatim/Emërtim me shkrim global</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, modele shkronjash shtypi, grafiku i shkronjës Y të shtypit, semafori me ngjyra, foto të ylberit për t'u ngjyrosur nga nxënësit, etiketa me fjalë me Y, figura të emërtuara poshtë si dhe objekte: ylberi, syri, syze, ngjyra, pylli, fytyra, byrek, ylli...</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera:
Lënda: Matematikë, Arte, Shoqëria dhe mjedisi.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Përshkrimi kontekstual i situatës:
▪ Veprimtari paraprake:
Hapi 1. Fillon me një gjëegjëzë: Kur pas shiut bie dielli
Ngjyra-ngjyra shndrit,
Po nga ju kush ma tregon,
Emrin atij si ja thonë? (ylberi)
Nxit nxënësit të listojnë ngjyrat e ylberit duke i renditur sipas radhës e kuqe, portokalli, e verdhë, e gjelbër, e kaltër, blu, vjollcë.
Hapi 2. Diskutohet për dukurinë e krijimit të ylberit dhe për kohën kur del ai. Nxënësit mund të tregojnë edhe histori që kanë parë apo lexuar për të.
▪ Veprimet në situatë</td></tr>
</table>

Hapi 3. Hapet foto ose piktura e ylberit dhe drejtohet biseda për pozicionet/radhën e ngjyrave në të . Ato vijnë si pasojë e zbërthimit të dritës. Cila është forma e tij? Cila ngjyrë është më e dukshme për ju? Paraqitet në dërrasë fjalia YLBERI I NGJYRAVE. Nxënësit qarkojnë shkronjat e mësuara deri më tani. Sa mbetën pa qarkuar? Është veçuar kështu shkronja **Y**.

Hapi 4. Shkruaj fjalët: YLBERI, SYZE, SYRI, YLLI, PYLLI, NATYRA. Kryhet procesi i analizës për shkëputjen e tingullit dhe shkronjës Y. (nxënësit ndajnë edhe fjalët në rrokje).

Kalohet në ushtrime fonetike në shqiptimin e tingullit zanor **Y**.

Hapi 5. Demonstron para klasës grafiku i shkronjës së vogël dhe të madhe të shtypit. Nxit nxënësit të bëjnë ngjashmëritë dhe dallimet me shkronja e objekte të tjera rrethanore.

- Nxiten nxënësit të gjejnë fjalë që fillojnë me **Y** e kanë në trup ose mbarojnë me **y**.

Hapi 6. Nxënësit punojnë individualisht për plotësimin pjesës së dytë të faqes 21 të abetares së punës me qarkimin, shkrimin dhe vizatimin e elementëve të **Y**. Bëhet leximi dhe ndarja në rrokje e fjalëve në të djathtë të faqes. Veprojnë në A4 për ngjyrosjen e vijave të ylberit në fletët e fotokopjuara si dhe emërtimin e tij e ngjyrave nëse munden.

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 7. Shkruhen apo paraqiten me shkronja të mëdha dhe fjalët kryesore në tabelë. Ndahen fjalët në rrokje. Individualisht nxënësit qarkojnë Y në fjalët e dhëna me fisha apo libra e revista.

Lexohen nga nxënësit në zinxhir fjalët e faqes 21 apo ato të shkruara në tabelë.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Shqipton tingullin **Y.**
- ✓ Gjen dhe thotë fjalë që fillojnë me **Y** ose që përmbajnë tingullin **y** në trup të tyre.
- ✓ Lexon globalisht fjalët.
- ✓ Formon fjali me objekte e figura të faqes.
- ✓ Shkruan shkronjën **Y** e fjalë me y në pozicione të ndryshme.
- ✓ Improvizon situata.

Detyrë shtëpie:

1. Lexo dhe shkruaj nga një rresht me fjalët në abetaren e punës.
2. Shkruaj 5 rreshta me shkronjën **Y**, **y**.
3. Gjej dhe ngjit në A4 fjalë me shkronjën Y në pozicione të ndryshme.
4. Vizato një ylber dhe shkruaj në çdo ngjyrë fjalë që përmbajnë në trup **Y**.

Refleksione:

<table>
<tr><td>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla: 1</td><td>Klasa: 1</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore:
Tingulli dhe shkronja Z.</td><td colspan="2">Situata e të nxënit:
Zemra</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe
Nxënësi:
➢ Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar.
➢ Kompetenca e të nxënit: Parashtron pyetje dhe përgjigje në lidhje me temën.
➢ Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin: Gjen të përbashkëtat dhe ndryshimet ndërmjet aktiviteteve që bën në klasë me ato në ambiente të tjera.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore
Nxënësi:
➕ Shqipton tingullin bashkëtingëllor Z.
➕ Të dallojë fjalë me Z në fillim ose që përmbajnë shkronjat z në trup të tyre. (në pozicione të ndryshme)
➕ Lexon globalisht disa nga fjalët e dhëna.
➕ Komenton e përshkruan foto/figura.
➕ Luan me lojë roli.
➕ Formon fjali me fjalët e dhëna
➕ Shkruan globalisht disa fjalë me Z.
➕ Vizaton figura që përmbajnë shkronjën Z dhe i emërton ato me shkrim shtypi.</td><td colspan="2">Fjalë kyçe: veza, zebra, vizatimor, vizore, zëri, zemra, zarf, zymbyl,

Teknika dhe strategji:
❖ Bisedë
❖ Demonstrim
❖ Lojë roli
❖ Analizë-sintezë
❖ Vizatim/Emërtim me shkrim global</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, modele shkronjash shtypi, grafiku i shkronjës Z të shtypit, tabela e shkronjave, magnetofon, etiketa me fjalë me Z, figura të emërtuara si dhe objekte: veza, zëri, vizatim, viza, zemër, zebra, zëri, zarf, zymbyl, gëzuar.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera:
Lënda: Matematikë, Arte, Shoqëria dhe mjedisi.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Përshkrimi kontekstual i situatës:
▪ Veprimtari paraprake:
Hapi 1. Mësimi fillon me një gjëegjëzë: Është e kuqe, formë vezake
Punon ditë e punon natë
Asnjëherë nuk ndalon
Edhe ndjenjat komandon. (Zemra)
Shkruhet përgjigjja në dërrasë. Iu kërkohet nxënësve të vizatojnë të gjithë A4 një zemër e ta ngjyrosin atë.
Hapi 2. Nxënësit nxiten të tregojnë informacionet që kanë për të. Paraqitet fjalët ZEMRA dhe ZEMËRMIRË e kalohet në analizën e tyre duke veçuar bashkëtingëlloren Z.
▪ Veprimet në situatë
Hapi 3. Hapet fletoret dhe iu kërkohet të listojnë fjalë që kanë në trup shkronjën Z. Nxënësit mund të veprojnë në dyshe për rreth 5 minuta. Në fund të punës bëhet edhe leximi i tyre global nëse munden.</td></tr>
</table>

Hapi 4. Shkruaj disa nga fjalët në dërrasë: ZANA, ZEBRA, DINOZAURI, ZËRI, MIZA dhe kryhet procesi i analizës për shkëputjen e tingullit dhe shkronjës Z nga shkronjat e tjera. (nxënësit ndajnë edhe fjalët në rrokje).

Kalohet në ushtrime fonetike në shqiptimin e tingullit bashkëtingëllor Z.

Hapi 5. Demonstron para klasës grafiku i shkronjës së vogël dhe të madhe të shtypit. Nxit nxënësit të bëjnë ngjashmëritë dhe dallimet me shkronja si p.sh. S e objekte të tjera rrethanore.

- Nxiten nxënësit të gjejnë fjalë që fillojnë me **Z** e kanë në trup atë.

Hapi 6. Nxënësit punojnë individualisht për plotësimin pjesës së parë të faqes 22 të abetares së punës me qarkimin dhe vizatimin e Z. Bëhet leximi dhe ndarja në rrokje e fjalëve në të majtë të faqes. Ngre disa nxënës të lexojnë e të tjerë të shkruajnë në fletë/tabelë fjalët duke i përdorur në fjali.

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 7. Shkruhen apo paraqiten me shkronja të mëdha të shtypit fjalët kryesore në tabelë. Ndahen fjalët në rrokje. Individualisht nxënësit qarkojnë Z në fjalët e dhëna me fisha apo libra e revista.

Lexohen nga nxënësit në zinxhir fjalët e pjesës së parë të faqes 22 të abetares së punës apo ato të shkruara në dërrasë.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Shqipton tingullin **Z**.
- ✓ Gjen dhe thotë fjalë që fillojnë me **Z** ose që përmbajnë tingullin **z** në trup të tyre.
- ✓ Lexon globalisht fjalët.
- ✓ Formon fjali me objekte e figura të faqes.
- ✓ Shkruan shkronjën **Z** e fjalë me **z** në pozicione të ndryshme.

Detyrë shtëpie:

1. Lexo dhe shkruaj nga një rresht me fjalët në abetaren e punës.
2. Shkruaj 5 rreshta me shkronjën **Z, z**.
3. Gjej dhe ngjit në A_4 fjalë me shkronjën Z në pozicione të ndryshme.

Refleksione:

<table>
<tr><td>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla: 1</td><td>Klasa: 1</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore:
Tingulli dhe shkronja Zh.</td><td colspan="2">Situata e të nxënit:
Zhytësit e talentuar</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe
Nxënësi:
➢ Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar.
➢ Kompetenca e të nxënit : Parashtron pyetje dhe përgjigje në lidhje me temën.
➢ Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin: Gjen të përbashkëtat dhe ndryshimet ndërmjet aktiviteteve që bën në klasë me ato në ambiente të tjera.</td></tr>
<tr><td colspan="2" rowspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore
Nxënësi:
✚ Shqipton tingullin bashkëtingëllor ZH.
✚ Të dallojë fjalë me ZH në fiillim ose që përmbajnë shkronjat zh në trup të tyre. (në pozicione të ndryshme)
✚ Lexon globalisht disa nga fjalët e dhëna.
✚ Komenton e përshkruan foto/figura.
✚ Luan me lojë roli.
✚ Formon fjali me fjalët e dhëna
✚ Shkruan globalisht disa fjalë me Zh.
✚ Vizaton figura që përmbajnë shkronjën Zh dhe i emërton ato me shkrim shtypi.</td><td>Fjalë kyçe:
zhezve, zhyt, zhytës, zhurmë, zhabë, zhavorr</td></tr>
<tr><td>Teknika dhe strategji:
❖ Bisedë
❖ Imagjinatë e drejtuar
❖ Lojë roli
❖ Analizë-sintezë
❖ Vizatim/Emërtim me shkrim global</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, modele shkronjash shtypi, grafiku i shkronjës Zh, zh të shtypit, tabela e shkronjave, alfabeti me fletë të fotokopjuara, etiketa me fjalë me Zh, figura të emërtuara si dhe objekte: zhezve, zhyt, zhytës, zhurmë, zhabë, zhavorr,</td><td>Lidhja me fushat e tjera:
Lënda: Matematikë, Arte, Shoqëria dhe mjedisi.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Përshkrimi kontekstual i situatës:
▪ Veprimtari paraprake:
Hapi 1. Mësimi fillon me dëgjimin me vëmendje të fragmentit të një tregimi.
Disa fëmijë ndodheshin në buzë të detit dhe po shëtisnin. Papritur pranë bregut ata panë të afrohej një anije. Nga anija u hodhën në det disa zhytës. Ata vazhduan për një kohë të gjatë të qëndronin të zhytur, sikur diçka kërkonin. Papritur njëri nga zhytësit hipi në anije dhe...
Mësuesi/ja iu kërkon nxënësve të përfundojnë sipas imagjinatës së tyre tregimin. Dëgjohen disa mbyllje.
Hapi 2. Nxënësit nxiten të tregojnë cilat janë ndryshimet dhe ngjashmëritë mes mendimeve të tyre dhe përzgjedhin mbylljen më tërheqëse. Pranohen komente e argumente për to. Paraqitet titulli i tregimit ZHYTËSIT E TALENTUAR dhe kalohet në analizën e saj duke veçuar bashkëtingëlloren ZH.
▪ Veprimet në situatë
Hapi 3. Punohen në dërrasë fjalët Zhyt dhe Zhytës komentohen ngjashmëritë dhe ndryshimet mes tyre.</td></tr>
</table>

Nxiten nxënësit të qarkojnë me të kuqe shkronjat **e njëjta** dhe me blu shkronjat **të ndryshmet** te fjalët e dhëna në fletë. Nxënësit listojnë në tabelën e dhënë fjalët. Nxënësit mund të veprojnë në dyshe për rreth 5 minuta.(zemra, zhapiku, vizore, zero, zhytës, zari, zhyt, zëri, zhurma, xhezve)

Shkronja **Z**	Shkronja **ZH**

Hapi 4. Shkruaj disa nga fjalët në dërrasë: ZHYT, ZHAPIKU, ZHYTËSI, ZHURMA, GOZHDA, PLAZHI dhe kryhet procesi i analizës për shkëputjen e tingullit dhe shkronjës ZH. (nxënësit ndajnë edhe fjalët në rrokje).

Kalohet në ushtrime fonetike në shqiptimin e tingullit bashkëtingëllor Zh.

Hapi 5. Demonstron para klasës grafiku i shkronjës së vogël dhe të madhe të shtypit. Nxit nxënësit të bëjnë ngjashmëritë dhe dallimet me Z e objekte të tjera rrethanore.

- Nxiten nxënësit të lexojnë shkronjat e alfabetit të fotokopjuar dhe të ngjyrosin me të kuqe zanoret dhe me blu bashkëtingëlloret e me të gjelbër shkronjat dyshe të alfabetit të gjuhës shqipe si p.sh., **Zh**, Xh.

Hapi 6. Nxënësit punojnë individualisht për plotësimin pjesës së dytë të faqes 22 të abetares së punës me qarkimin dhe vizatimin e Zh si dhe elementëve të shkrimit. Bëhet leximi dhe ndarja në rrokje e fjalëve në të majtë të faqes. Ngre disa nxënës të lexojnë e të tjerë të shkruajnë në fletë/tabelë fjalët duke i përdorur në fjali/ngjarje ato.

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 7. Shkruhen apo paraqiten me shkronja të mëdha të shtypit fjalët kryesore në tabelë. Ndahen fjalët në rrokje. Individualisht nxënësit qarkojnë **ZH** në fjalët e dhëna me fisha apo libra e revista.

Lexohen nga nxënësit në zinxhir fjalët e pjesës së dytë të faqes 22 të abetares së punës apo ato të shkruara në dërrasë.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Shqipton tingullin **Zh**.
- ✓ Gjen dhe thotë fjalë që fillojnë me **Zh** ose që përmbajnë tingullin **Zh** në trup të tyre.
- ✓ Lexon globalisht fjalët.
- ✓ Formon fjali me objekte e figura të faqes.
- ✓ Shkruan shkronjën **Zh** e fjalë me **zh** në pozicione të ndryshme.
- ✓ Improvizon situata.

Detyrë shtëpie:

1. Lexo dhe shkruaj nga dy rreshta me fjalët në abetaren e punës.
2. Shkruaj 5 rreshta me shkronjën **Zh**.
3. Gjej dhe ngjit në A_4 fjalë me shkronjat Zh në pozicione të ndryshme.

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1
Tema mësimore: Rimarrje, përsëritje, kontroll		**Klasa:** 1
Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe** Nxënësi: ➢ ***(3)Kompetenca e të nxënit: Ndjek udhëzimet e dhëna në një tekst për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë, që kërkohet ➢ ***(3)Kompetenca e të nxënit:*** Mbikëqyr në mënyrë të pavarur përparimin e vet në një detyrë, aktivitet duke përdorur teknika të ndryshme për gjetjen e gabimeve (si shënim të gabimeve - vështirësive) dhe i korrigjon ato derisa gjen zgjidhjen. ➢ ***(3)Kompetenca e të nxënit:*** Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes.		**Fjalë kyçe:** *Test, shkronja, fjalë, fjali.*
***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:** Nxënësi: - Lexon globalisht fjalë, fjali. - Dallon shkronjat e mëdha të shtypit. - Rendit sipas radhës së kryerjes së veprimeve fotot. - Emërton figurat, shkruan fjalët me shkronjat e mëdha të shtypit - Plotëson fjali me të dhëna personale.		**Teknika dhe strategji:** ❖ Diskutim paraprak ❖ Punë individuale ❖ Lexim-shkrim global
Burimet e informacionit dhe mjete: Njohuritë paraprake të nxënësve, fletë testimesh të përgatitura, shkronjat e mëdha të shtypit.		**Lidhja me fushat e tjera:** Matematikë

SITUATA E TË NXËNIT

Përshkrimi kontekstual i situatës:

- ***Veprimtari paraprake:***

Hapi 1. Mësuesi/ja njeh nxënësit me temën dhe shpjegon se çfarë është Testi, cili është qëllimi dhe rëndësia e tij. Shpjegon rregullat e sjelljes gjatë detyrës me shkrim dhe punës individuale.
Bëhet përsëritje e shkronjave të shytit të mësuara gjatë periudhës së paraabetares.

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 2. Mësuesi/ja ndan fletët e ushtrimeve.
Jep këshilla të qarta për çdo ushtrim. Nxit nxënësit që munden, të lexojnë vetë kërkesat. Këshillon ngadalë dhe saktë çdo etapë të ushtrimit duke i udhëzuar nxënësit dhe jo duke ia treguar ushtrimet.
Hapi 3. Nxënësit punojnë të pavarur testin. Mësuesi/ja kalon bankë më bankë dhe udhëzon nxënësit, sidomos ata që shfaqin vështirësi. Nxënësit duhet të shkruajnë me shkronjat e mëdha ose të vogla të shtypit.
Këshillohen që në ushtrimin e fundit nxënësit duhet të shkruajnë emrin e mësueses, kujton se emrat shkruhen me shkronjë të madhe.
U.1. Nxënësit duhet të lidhin fotot me figurën.
U.2. Nxënësit duhet të qarkojnë shkronjën dyshe **SH** te fjalët *SHITËS* dhe *SHESHI*.
U.3. Përgjigjet e sakta do të jenë.

3	*5*	*4*
1	*6*	*2*

U.4. Nxënësit emërtojnë figurat.

Libri(abetare) molla (mollë), çadra(çadër)

U.5.

Te fjali e fundit, nxënësit duhet të shkruajnë kohën e lindjes, pranohen të gjitha përgjigjet e tipit:

Unë kam lindur në pranverë.

Unë kam lindur në maj.

Unë kam lindur në 12 maj etj.

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 4. Mblidhen fletët, nxiten nxënësit të diskutojnë për vështirësitë dhe problemet që kanë pasur. Mësuesi/ja mban shënime, të cilat i ka parasysh në orët në vijim.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Nënvizon fjalë në tekste të ndryshme.
- ✓ Dallon fjalët që tregojnë emra njerëzish, sendesh dhe kafshësh.
- ✓ Gjen grupe fjalësh që emërtojnë njerëz, kafshë, sende.

Detyrë shtëpie:

Refleksione:

UNË JAM _____ *(1 pikë)* _____

Test Paraabetare

1. ***Lidh me shigjetë.*** *(3 pikë)*

PEMA QENI SHTËPIA

2. ***Qarko shkronjën*** **SH**. *(3 pikë)*

SHITËS SHESHI

3. ***Rendit veprimet sipas radhës.*** *(5 pikë)*

1		

4. ***Emërto figurat*** *(6 pikë)*

		

5. ***Plotëso fjalën që mungon. Kopjo fjalinë.*** *(8 pikë)*

MËSUESJA IME QUHET _____ .

_____

_____

UNË E KAM DITËLINDJEN NË _____ .

_____

_____

Shkallët e vlerësimit	**1** Arritje të pakënaqshme	**2** Arritje që kanë nevojë për përmirësim	**3** Arritje të kënaqshme	**4** Arritje shumë të kënaqshme	**5** Arritje të shkëlqyera
Vlerësimi sipas pikëve	0 - 6	7 - 12	12 - 16	17 - 21	22 - 26

PLANIFIKIMI DITOR PËR ABETAREN

<table>
<tr><td>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla: 1</td><td>Klasa: 1</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore: Punim i shkronjës A, a faqe 22 të Abetares</td><td colspan="2">Situata e të nxënit: Klasa ime</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe
Nxënësi:
➢ Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar.
➢ Kompetenca e të nxënit: Parashtron pyetje dhe përgjigje në lidhje me temën.
➢ Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin: Gjen të përbashkëtat dhe ndryshimet ndërmjet aktiviteteve që bën në klasë me ato në ambiente të tjera.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore
Nxënësi:
✚ Shqipton tingullin A
✚ Gjen dhe thotë fjalë që fillojnë me A ose që përmbajnë shkronjën A në trup të tyre. (në pozicione të ndryshme)
✚ Lexon fjalët e fjalorit të librit: akullorja, ariu, pema, anija.
✚ Përshkruan figurën qendrore.
✚ Plotëson sipas figurës shkronjën mungesore.
✚ Formon fjali me fjalët e faqes të faqes.
✚ Vizaton figura që përmbajnë shkronjën A, a dhe i emërton ato me shkrim shtypi.</td><td colspan="2">Fjalë kyçe:
Atdhe, ariu, akullore, arra, anija atlete, abetare, ananas, apartament...

Teknika dhe strategji:
❖ Bisedë
❖ Vëzhgim
❖ Demonstrim
❖ Punë individuale/Çift
❖ Vizatim/Emërtim</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, modele shkronjash individuale, grafiku i shkronjës A,a të shtypit, foto me pamje nga klasa të shkollës apo të shkollave të tjera, etiketa me fjalë të fjalorit.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera: Lënda: Edukim fizik, Matematikë, Arte, Shoqëria dhe mjedisi.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Përshkrimi kontekstual i situatës:
▪ Veprimtari paraprake:
Hapi 1. Fillon me një bisedë për mjedisin përreth. Nxënësit nxiten të tregojnë për ditën e parë të shkollës dhe futjen për herë të parë në bankat e klasës e njohjen me ambientet e shkollës (mund të shoqërohen edhe me foto). Listojnë edhe disa nga emrat e shokëve të klasës. Cilit nga ju i fillon emri me shkronjën A?
Hapi 2. Nxënësit nxiten të vërejnë ngjashmëritë dhe ndryshimet mes klasës së tyre dhe asaj të paraqitur në faqen e librit.
Veprimet në situatë
Hapi 3. Hapet libri dhe komentohet figura qendrore, biseda dhe komunikimi i shokëve në grup për pozicionet e nxënësve dhe të mësueses.
Lexohen dhe plotësohen fjalët e fjalorit me radhë nga nxënësit madje edhe emrat në fishe.
Shkruaj fjalët: Akullorja, abetare, ariu, anija. Kryhet procesi i analizës për shkëputjen e tingullit dhe shkronjës A, a (nxënësit ndajnë edhe fjalët në rrokje).
Hapi 4. Shkruaj fjalët: Akullorja, abetare, ariu, anija.. Kryhet procesi i analizës për shkëputjen e tingullit dhe shkronjës A, a (nxënësit ndajnë edhe fjalët në rrokje).
Ushtrohen në shqiptimin e tingullit të ri dhe theksohet se është tingull zanor. Gjejnë shkronjën a.
Hapi 5. Demonstron para klasës grafikun e shkronjës së vogël dhe të madhe të shtypit. Nxit nxënësit të bëjnë ngjashmëritë dhe dallimet me objekte të tjera rrethanore.</td></tr>
</table>

- Nxiten nxënësit të gjejnë fjalë që fillojnë me **A**, e kanë në trup ose mbarojnë me **a**.
Plotësohet tabela kolektivisht ose me fletë të fotokopjuara individuale.

A	**A**	**A**
Andi	ananasi	anija .....

Hapi 6. Nxënësit punojnë individualisht për plotësimin e shkronjave në fjalët mungesore dhe vizatimin e tyre. Bëhet leximi dhe ndarja e tyre në rrokje. Ngre disa nxënës që shkruajnë fjalët në tabelë.

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 7. Shkruan apo paraqiten fjalët kryesore në tabelë. Ndahet në etiketa dhe fjalët në rrokje. Individualisht nxënësit qarkojnë zanoren A në fjalët e dhëna me fisha apo libra e revista. Lexohen nga nxënësit në zinxhir fjalët e faqes 22.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Shqipton tingullin zanor **A**.
- ✓ Gjen dhe thotë fjalë që fillojnë me ***A*** ose që përmbajnë tingullin **A** në trup të tyre.
- ✓ Lexon fjalët e fjalorit të librit:
- ✓ Plotëson sipas figurës shkronjat mungesore.
- ✓ Formon fjali sipas figurës kryesore të faqes.
- ✓ Përshkruan mbi bazën e figurave.

Detyrë shtëpie:

1. Lexo dhe shkruaj fjalët e librit në fletore.
2. Shkruaj 10 fjalë me shkronjën **A, a.**

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1	**Klasa:** 1
Tema mësimore: Ushtrime aplikative. Abetare pune faqe 24, shkronjat A, a.		**Situata e të nxënit:** Klasa ime	

***Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe**

Nxënësi:

- ***Kompetenca e të nxënit:*** Ndjek udhëzimet e dhëna për të realizuar një veprim
- ***Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin:*** Identifikon burimet e nevojshme dhe i përdor në mënyrë të drejtë.

***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore**

Nxënësi:

- Shkruan shkronjës **A, a** të shtypit sipas modelit.
- Shkruan me të kopjuar rrokje, fjalë.
- Plotëson fjalët që ju mungojnë shkronja.
- I përgjigjet pyetjeve shkurt.
- Ndan fjalët në rrokje.

Fjalë kyçe:
Abetare, ananasi, avioni(emra të nxënësve të klasës që fillojnë me A) ose objekte e lodra që fillojnë me a.

Teknika dhe strategji:

- Diskutim për njohuritë paraprake.
- Imagjinatë e drejtuar
- Marrëdhënie pyetje-përgjigje.

Burimet e informacionit dhe mjete: Shkronjat individuale dhe kolektive, fletore pune, etiketa me rrokje, fjalë sipas nivelit në fletë të fotokopjuara, mjete vizatimi, magnetofon, Cd, fletë të fotokopjuara me fjalë që përmbajnë shkronjën a në pozicione të ndryshme.

Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë, Arte, Shoqëria dhe mjedisi

Përshkrimi kontekstual i situatës

- ***Veprimtari paraprake***

Hapi 1. Klasa është e ndarë në grupe me nivele të ndryshme. Mësuesja ka përgatitur etiketa me fjalë dhe figura të situatës (ananasi,avioni,abetare).Nxënësit lexojnë me zë të lartë. Nxiten nxënësit të korrigjojnë apo plotësojnë njëri – tjetrin.

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 2. Paraqet grafikun e shkronjës **A, a.** I nxis të thonë ndryshimet dhe ngjashmëritë me objekte apo ta krijojnë atë me pjesë të trupit.

Hapi 3. Ngre nxënës në tabelë që shkruajnë disa nga rrokjet, fjalët dhe fjalitë e etiketave që u shpërndanë në pjesën ë parë të orës.

Hapi 4. Punohet sipas kërkesave në fletoren e punës. Modelohet shkronja **A, a**, shkruhen fjalët me shkronja të mëdha të shtypit. Ndajnë fjalët në rrokje. Bëhet kontrolli individual i fletores/kontrollojnë njëri-tjetrin.

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 5. Nxënësit lexojnë fjalët e ushtrimeve në fletoren e punës.
Nxënësit më të përparuar mund të formojnë disa fjali të shkurtra në fletore më fjalët e fjalorit.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Shkruan shkronjës **A, a** të shtypit sipas modeli.
- ✓ Shkruan rrokje, fjalë.

✓ Formon fjalë duke plotësuar shkronjat. ✓ I përgjigjet pyetjeve shkurt.
Detyrë shtëpie: 1. Kopjo dy herë fjalët e faqes. Lexo ato. 2. Paraqit me vizatim pamje nga klasa juaj. 3. Shkruaj 10 fjalë që kanë në trup shkronjën a. (në pozicione të ndryshme).
Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1	**Klasa:** 1
Tema mësimore: Lexim dhe punim i shkronjës A, a faqe 22 të Abetares		**Situata e të nxënit:** Klasa ime	

***Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe**

Nxënësi:

- ✓ ***Kompetenca e komunikim dhe të shprehurit:*** Shpreh me gojë për 3-5 minuta para moshatarëve përjetimet dhe emocionet që e kanë shoqëruar gjatë dëgjimit të një kënge.
- ✓ ***Kompetenca e komunikim dhe të shprehurit:*** Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit.
- ✓ ***Kompetenca e të nxënit:*** Parashtron pyetje dhe përgjigje në lidhje me temën.

***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore**

Nxënësi:

- Lexon fjalë, fjali.
- I përgjigjet me fjali të thjeshtë pyetjeve rreth figurës së faqes.
- Rilexon fjalët e faqes.
- Lidh pjesën që lexon me filma që ka parë, me përvoja personale.

Fjalë kyçe: Ana, Ema, Bora, Ola, Albani, anija, akull, ariu, abetare

Teknika dhe strategji :

- ❖ Marrëdhënie pyetje-përgjigje
- ❖ Imagjinatë e drejtuar
- ❖ Punë në grup
- ❖ Lexim zinxhir
- ❖ Analizë-sintezë e fjalës

Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, modele shkronjash individuale, grafiku i shkronjës **A, a** të shtypit, foto me pamje nga dita e parë e shkollës.

Lidhja me fushat e tjera: Matematikë, muzikë

Përshkrimi kontekstual i situatës:

- ***Veprimtari paraprake***

Hapi 1: Dëgjohet në magnetofon kënga"Abetarja"dhe nxiten nxënësit të bisedojnë përmes pyetjeve.

- Çfarë emocionesh ju shoqërojnë gjatë dëgjimit të këngës?
- Po nga dita e parë e shkollës cilat janë momentet që mund të veçoni? Pse?..

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 2: Hapen librat. Nxit nxënësit të përshkruajnë figurën. Mësuesi/ja kështillon nxënësit të përfytyrojnë rreth ngjarjes të paraqitur në fq. 22.

Ani është te dera e klasës. Si mendoni çfarë ka ndodhur më tej? Bëhet krahasimi me krijimet e nxënësve.

Hapi 3: Lexon me intonacion 2 herë globalisht fjalia ANI E OLA ME ABETARE. Më pas pyet nxënësit:

- *Çfarë përfytyroni?*
- *Si veproi Ani?*
- *Çfarë do të bënit ju?*
- *Si u ndjeve kur dëgjove fjalët e Emës?*
- *A keni ndihmuar ju bashkëmoshatarë me AK?*
- *Cilën situatë do të veçonit? Pse?*

Hapi 4: Bëhet leximi në korr disa herë. Shpjegohen pozicionet e A në pozicione të ndryshme. Shpjegon përdorimin e pikës në fundi të fjalisë.

Hapi 5: Më pas lihen nxënësit të lexojnë në heshtje për disa minuta. Në varësi të numrit të nxënësve në klasë mësuesja bën leximin e faqes në zinxhir me nga një fjalë.

Mund të kërkohet nga nxënësit edhe të lexojnë fjalën e parë, të dytë e kështu me radhë ose me rend të ngatërruar. Nxënësit që paraqesin vështirësi mund t'i pyesë në fjalë të veçanta të thjeshta. Veprohet edhe për leximin global të fjalëve me fishe balta, apartamenti, aparati, arka, arra...

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 6: Diskutim rreth përmbajtjes.

- *Si e ka titullin tregimi apo ngjarja që krijuat?*
- *Si quhen fëmijët që marrin pjesë?*
- *Çfarë bënë ata?*

Hapi 7: Nxënësit në mënyrë individuale ndajnë fjalët në rrokje. Diskutojnë në dyshe më shokun e bankës ose në grup për përgjigjet e dhëna.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Lexon fjalë, fjali.
- ✓ I përgjigjet me fjali të thjeshtë pyetjeve rreth përmbajtjes së faqes.
- ✓ Rilexon fjalët e komenton përmbajtjen e tij.
- ✓ Lidh temën me filma që ka parë, me përvoja personale.

Detyrë shtëpie:

1. Lexo disa herë faqen.
2. Kopjo 2-3 rreshta me fjalët e faqes si dhe fjalinë.
3. Shkruaj 10 fjalë që të fillojnë me shkronjën A.

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1	**Klasa:** 1
Tema mësimore: **Ushtrime aplikative për shkrim dore. Abetare pune fq 24 shkronja A, a**		**Situata e të nxënit:** Klasa ime	

***Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe**

Nxënësi:

- ✓ ***Kompetenca e komunikim dhe të shprehurit*** Shpreh me gojë për 3-5 minuta para moshatarëve përjetimet dhe emocionet që e kanë shoqëruar gjatë dëgjimit të një kënge.
- ✓ ***Kompetenca e të nxënit:*** Mbikëqyr në mënyrë të pavarur përparimin e vet në një detyrë duke përdorur detyra të ndryshme. Korrigjon gabimet.
- ✓ ***Kompetenca qytetare:*** Bashkëpunon në grup dhe respekton rregullat e grupit.

***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore**

Nxënësi:

- Modelon bukur grafikun e shkronjës së madhe dhe të vogël të dorës *A,a.*
- Shkruan elementët e shkronjave të dorës.
- Shkruan shkronjat A,a të shtypit.
- Plotëson me shkrim shkronjën A,a në pozicione të ndryshme.

Fjalë kyçe:
Abetare, balta, Ani, ura, ananasi, avioni.

Teknika dhe strategji:

- Vetëdiktim
- Demonstrim
- Punë individuale
- Punë në çifte/punë në dyshe
- Shkrim i lirë

Burimet e informacionit dhe mjete: Fletore e punës, fletore shkrimi, modele shkronjash individuale, grafiku i shkronjës **A, a,** *A,a* të shtypit dhe të dorës

Lidhja me fushat e tjera:
Arte

Përshkrimi kontekstual i situatës

- ***Veprimtari paraprake***

Hapi 1. Dëgjohet kënga e shkronjës a "Në çdo gjuhë të botës mbarë unë A –jam e parë" apo edhe vjersha kushtuar shkronjës A.

- *Si ndjeheni kur këndohet?*
- *Çfarë mund të themi për të?*

Paraqitet shkronja A, a, në të gjitha format si shtypi dhe dore si dhe fjalë që përmbajnë shkronjën a në pozicione e lloje të ndryshme shkrimesh dhe diskutohet rreth tyre për ngjashmëritë dhe ndryshimet.

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 2. Përsëritje e shkronjave të mësuara të dorës. Lexim në korr.
Përsëriten shkronjat **A, a** të shtypit dhe grafiku i tyre.
Nxiten nxënësit të thonë fjalë që fillojnë me **A,** shkruaj disa prej tyre.

Hapi 3. Paraqes modelin e shkronjës së dorës *A,a.*

- Nxënësit ngrenë dorën në ajër dhe lëvizin nën drejtimin e mësueses sipas modelit të shkronjës së dorës A,a. Bëhet dallimi me shkronjën **A, a** të shtypit nga të dorës.
Ngre nxënës në tabelë që shkruajnë shkronjën dhe fjalë me a.

Hapi 4. Më pas nxënësit punojnë në fletoren e punës sipas modelit. paraqet lidhja e shkronjës me shkronjat e tjera. Vëzhgohet plotësimi i faqes. Kopjohen dy-katër rreshta me shkronjat *A,a* ose (plotësohet faqja e fotokopjuar).

Demonstrim i rezultateve të arritura

Hapi 5. Nxënësit veprojnë me vetëdiktim në formën *a,A,a,a,A,a,A*…(ose me kopjim nga modeli),ose në formën a,A, a, A.(shtypi, dore)

Vlerësimi i situatës: ***Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:*** ✓ Shkruan shkronjat **A, a** të dorës duke u ndihmuar nga modeli. ✓ Shkruan shkronjat **A, a** me të gjitha elementet duke respektuar hapësirën. ✓ Shkruan fjalë me të kopjuar duke përdorur shkronjën në **A, a** në fillim, në trup të fjalës. ✓ Lexon fjalë me shkrim shtypi.
Detyrë shtëpie: **1.**Shkrim nga 3-5 rreshta me shkronjën e madhe dhe të vogël të dorës A, a **2.**Shkrim fjalësh me shkronja shtypi që përmbajnë a. **3.**Vizatim dhe emërtim i fjalëve që përmbajnë A, a. **4.**Kopjo modelin e klasës.
Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1	**Klasa:** 1
Tema mësimore: **Punim i shkronjave I, i faqe 23 në Abetare**		**Situata e të nxënit:** Emri im	

***Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe**

Nxënësi:

- ***Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit:***
  - Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup.
  - Shpreh me gojë para shokëve dhe të tjerëve përjetimet dhe emocionet që e kanë shoqëruar gjatë shikimit të një filmi apo dëgjimit të një përralle.
- ***Kompetenca e të nxënit:*** Parashtron pyetje dhe përgjigje në lidhje me temën.
- ***Kompetenca qytetare:*** Gjen të përbashkëtat dhe ndryshimet ndërmjet aktiviteteve që bën në klasë me ato në ambiente të tjera.

***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore**

Nxënësi:

- Shqipton tingullin **I**
- Gjen dhe thotë fjalë që fillojnë me ***I*** ose që përmbajnë shkronjën **I** në trup të tyre.(në pozicione të ndryshme)
- Lexon fjalët e fjalorit të librit: libri, iriqi, topi, ariu, anija
- Përshkruan figurën qendrore.
- Plotëson sipas figurës shkronjën mungesore.
- Formon fjali me fjalët e faqes.
- Vizaton figura që përmbajnë shkronjën A, a dhe i emërton ato me shkrim shtypi.

Fjalë kyçe:
libri, iriqi, topi, ariu, anija

Teknika dhe strategji:

- Bisedë
- Vëzhgim
- Demonstrim
- Lexim global
- Punë individuale/Çift
- Vizatim/Emërtim

Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, modele shkronjash individuale, grafiku i shkronjës **I, i** të shtypit, foto me pamje nga klasa të shkollës apo të shkollave të tjera, fishe me fjalë të fjalorit dhe fjalë të tjera që kanë në trup në pozicione të ndryshme zanoren **I, i.**

Lidhja me fushat e tjera:
Lënda: Matematikë, art pamor

Përshkrimi kontekstual i situatës

- ***Veprimtari praktike***

Hapi 1. Gjëegjëzë ***Me vete e ke po me sy nuk e sheh.(emri)*** Fillon me një bisedë për emrat e mbiemrat e nxënësve të klasës si dhe disa nga objektet apo fotot e vendosura në muret e klasës si libri,topi,iriqi,ariu,ibriku etj. I listojnë e madje edhe shkruajnë globalisht fjalët që munden. Nxënësit që iu fillon emri me shkronjën I mund të shkruajnë edhe emrin e mbiemrin e tyre në dërrasë.

Hapi 2. Nxiten nxënësit që disa nga fjalët t'i përdorin edhe në fjali.

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 3. Hapet libri dhe komentohet figura qendrore, biseda dhe komunikimi i shokëve në grup për pozicionet e nxënësve në banka shokëve që po hyjë te dera dhe të mësueses.
Lexohen dhe plotësohen fjalët e fjalorit me radhë nga nxënësit madje edhe emrat në fishe.
Shkruaj fjalët: *libri, iriqi, topi, ariu, anija.* Kryhet procesi i analizës për shkëputjen e tingullit dhe shkronjës A,a (nxënësit ndajnë edhe fjalët në rrokje, to-pi dhe më pas veçimi i tingullit zanor).

Hapi 4. Demonstron para klasës grafikun e shkronjës së vogël dhe të madhe të shtypit. Nxit

nxënësit të bëjnë ngjashmëritë dhe dallimet me objekte të tjera rrethanore. (për nga drejtësia dhe gjatësia e madje dhe pika e shkronjës).

Hapi 5. Nxiten nxënësit të gjejnë fjalë që fillojnë me **I**, e kanë në trup ose mbarojnë me **i**.

Plotësohet tabela kolektivisht ose me fletë të fotokopjuara individuale.

I	**I**	**I**
Iliri.....	libri	iriqi .....

Hapi 6. Nxënësit punojnë individualisht për plotësimin e shkronjave në fjalët mungesore dhe vizatimin e tyre (aty ku munden sigurisht). Bëhet leximi dhe ndarja e tyre në rrokje. Ngre disa nxënës që shkruajnë fjalët në tabelë.

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 7. Shkruan apo paraqiten fjalët kryesore në tabelë. Ndahet në etiketa dhe fjalët në rrokje. Individualisht nxënësit qarkojnë zanoren I në fjalët e dhëna me fisha apo libra e revista. Lexohen nga nxënësit në zinxhir fjalët e faqes 23.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Shqipton tingullin zanor **I.**
- ✓ Gjen dhe thotë fjalë që fillojnë me ***I*** ose që përmbajnë tingullin **I** në trup të tyre.
- ✓ Lexon fjalët e fjalorit të librit.
- ✓ Plotëson sipas figurës shkronjat mungesore.
- ✓ Formon fjali ose tekst sipas figurës kryesore të faqes.
- ✓ Përshkruan mbi bazën e figurave.

Detyrë shtëpie:

1. Lexo dhe shkruaj fjalët e librit në fletore.
2. Shkruaj 10 fjalë me shkronjën **I,i.**

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1	**Klasa:** 1
Tema mësimore: Lexojmë **Ushtrime aplikative Abetare pune faqe 24, shkronjat I,i.**		**Situata e të nxënit:** Emri im	
Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe** Nxënësi: ➢ ***Kompetenca e të nxënit: Ndjek udhëzimet e dhëna për të realizuar një veprim. ➢ ***Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin :*** Identifikon burimet e nevojshme dhe i përdor në mënyrë të drejtë.			
***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore** Nxënësi: ✚ Shkruan shkronjës **I, i** të shtypit sipas modelit. ✚ Shkruan me të kopjuar rrokje, fjalë. ✚ Plotëson fjalët me shkronja mungesore. ✚ I përgjigjet pyetjeve shkurt. ✚ Ndan fjalët në rrokje.		**Fjalë kyçe:** libri,iriqi,topi,ariu,anija **Teknika dhe strategji:** ❖ Diskutim për njohuritë paraprake. ❖ Imagjinatë e drejtuar ❖ Marrëdhënie pyetje-përgjigje. ❖ Veprimtari e pavarur.	
Burimet e informacionit dhe mjete: Shkronjat individuale dhe kolektive, fletore pune, etiketa me rrokje, fjalë sipas nivelit në fletë të fotokopjuara, mjete vizatimi, magnetofon, Cd, fletë të fotokopjuara me fjalë që përmbajnë shkronjën i në pozicione të ndryshme.		**Lidhja me fushat e tjera:** Matematikë, Arte, Shoqëria dhe mjedisi	
Përshkrimi kontekstual i situatës ▪ ***Veprimtari paraprake*** **Hapi 1.** Klasa është e ndarë në grupe me nivele të ndryshme. Mësuesja ka përgatitur etiketa me fjalë dhe figura të situatës (libri, iriqi, topi, ariu, anija).Nxënësit lexojnë me zë të lartë. Nxiten nxënësit të korrigjojnë apo plotësojnë njëri – tjetrin. ▪ ***Veprimet në situatë*** **Hapi 2.** Paraqet grafikun e shkronjës **I, i.** (të shtypit) I nxis të thonë ndryshimet dhe ngjashmëritë me objekte apo ta krijojnë atë me pjesë të trupit. **Hapi 3.** Ngre nxënës në tabelë që shkruajnë disa nga rrokjet, fjalët dhe fjalitë e etiketave që u shpërndanë në pjesën e parë të orës. **Hapi 4.** Punohet sipas kërkesave në fletoren e punës. Modelohet shkronja **I, i**, shkruhen fjalët me shkronja të mëdha të shtypit. Ndajnë fjalët në rrokje. Bëhet kontrolli individual i fletores/kontrollojnë njëri-tjetrin. ▪ ***Demonstrim i rezultateve të arritura*** **Hapi 5.** Nxënësit lexojnë fjalët e ushtrimeve në fletoren e punës. Nxënësit më të përparuar mund të formojnë disa fjali të shkurtra në fletore më fjalët e fjalorit.			
Vlerësimi i situatës: ***Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:*** ✓ Shkruan shkronjës **I, i** të shtypit sipas modeli. ✓ Shkruan rrokje, fjalë.			

✓ Formon fjalë duke plotësuar shkronjat. ✓ I përgjigjet pyetjeve shkurt.
Detyrë shtëpie: 1. Kopjo dy herë fjalët e faqes. Lexo ato. 2. Paraqit me vizatim dhe emërto figura të sendeve që kanë në trup shkronjën i. 3. Shkruaj 10 fjalë që kanë në trup shkronjën i.(në pozicione të ndryshme).
Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1	**Klasa:** 1
Tema mësimore: **Punim e lexim i faqes 23 Abetare**		**Situata e të nxënit:** Emri im	

***Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe**

Nxënësi:

- ***Kompetenca e komunikim dhe të shprehurit:***
  - Shpreh me gojë për 3-5 minuta para moshatarëve përjetimet dhe emocionet që e kanë shoqëruar gjatë dëgjimit të një kënge.
  - Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit.
- ***Kompetenca e të nxënit:***
  - Parashtron pyetje dhe përgjigje në lidhje me temën.
  - Ndjek udhëzimet e dhëna në një tekst për të realizuar një aktivitet që kërkohet.

***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës** **sipas temës mësimore** Nxënësi: - Lexon fjalë, fjali. - I përgjigjet me fjali të thjeshtë pyetjeve rreth figurës së faqes. - Rilexon fjalët e faqes. - Lidh pjesën që lexon me filma që ka parë, me përvoja personale.	**Fjalë kyçe:** Alfabeti, Ani, Iliri, Beni, Tomi, iriqi, libri, topi, ilaç, bilbili **Teknika dhe strategji:** ❖ Marrëdhënie pyetje-përgjigje ❖ Imagjinatë e drejtuar ❖ Punë në grup ❖ Lexim zinxhir ❖ Analizë-sintezë e fjalës
Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, modele shkronjash individuale, grafiku i shkronjës **I, i** të shtypit, foto apo objekte si topi, libri, alfabeti i gjuhës shqipe, libra për fëmijë.	**Lidhja me fushat e tjera:** Lënda: Matematikë, art pamor

Përshkrimi kontekstual i situatës

- ***Veprimtari praktike***

Hapi 1. U paraqitet nxënësve gjëegjëza: Ara e bardhë/fara e zezë (libri). Iu kërkoj nxënësve të lexojnë titujt e librave që kanë me vete.

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 2. Hapen librat. Nxit nxënësit të përshkruajnë figurën. Mësuesja këshillon nxënësit të përfytyrojnë rreth ngjarjes të paraqitur në fq 23.

Ani është te dera e klasës.

- *Si mendoni çfarë ka ndodhur më tej?*
- *Pse ajo ka ardhur me vonesë në klasë?*
- *Po ju ka ndodhur të vini me vonesë?Pse?*

Bëhet krahasimi me krijimet e nxënësve.

Hapi 3. Bëhet leximi në korr disa herë. Shpjegohen pozicionet e I në pozicione të ndryshme. Kujtohet që të gjithë emrat e njerëzve shkruhen me shkronjë të madhe.(Përdoren disa në fjali)

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 4. Lexohet dhe komentohet fjalia ANI E OLA ME ABETARE.

- *Sa fjalë ka fjalia?*

- *Cila është fjala më e gjatë po më e shkurtër?*
- *Pse Ani e ka librin në dorë?*
- *Ku e ka çantën?*
- *Cili është sendi juaj më i preferuar në çantën e shkollës? Pse?*

Hapi 5. Nxënësit në mënyrë individuale ndajnë fjalët në rrokje. Diskutojnë në dyshe më shokun e bankës ose në grup për përgjigjet e dhëna. Kujtohet fakti që fjala ka aq rrokje sa zanore ka.

Hapi 6. Nxënësit veprojnë në grupe për të komunikuar sikurse personazhet e librit.(lojë roli)

Hapi 7. Lexohen fjalë me etiketa të vendosura në dërrasë e përdoren në fjali p.sh.: AI, LIBRI, ILIRI, BILBILI...

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Lexon fjalë, fjali.
- ✓ I përgjigjet me fjali të thjeshta pyetjeve rreth përmbajtjes së faqes.
- ✓ Rilexon fjalët e komenton përmbajtjen e tij.
- ✓ Lidh temën me përvoja personale.

Detyrë shtëpie:

1. Lexo disa herë faqen.
2. Kopjo 2-3 rreshta me fjalët e faqes si dhe fjalinë.
3. Shkruaj 10 fjalë që të fillojnë me shkronjën I.

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1	**Klasa:** 1
Tema mësimore: **Ushtrime dhe modeli i shkrimit të dorës *I,í.***		**Situata e të nxënit:** Emri im	

***Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe**

Nxënësi:

- ***Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit:*** Shpreh me gojë për 3-5 minuta para moshatarëve përjetimet dhe emocionet që e kanë shoqëruar gjatë dëgjimit të një kënge.
- ***Kompetenca e të nxënit:*** Mbikëqyr në mënyrë të pavarur përparimin e vet në një detyrë duke përdorur detyra të ndryshme. Korrigjon gabimet.
- ***Kompetenca qytetare:*** Bashkëpunon në grup dhe respekton rregullat e grupit.

***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore**

Nxënësi:

- Modelon bukur grafikun e shkronjës së madhe dhe të vogël të dorës *I,í.*
- Shkruan elementët e shkronjave të dorës.
- Shkruan shkronjat *I,í.* të shtypit.
- Plotëson me shkrim shkronjën *I,í* në pozicione të ndryshme.

Fjalë kyçe:

Iliri,iriqi,bilbili,ai,

Teknika dhe strategji:

- Dëgjim kënge/vjershë.
- Demonstrim
- Punë individuale
- Punë në çifte/punë në dyshe
- Shkrim i lirë

Burimet e informacionit dhe mjete: Fletore e punës, fletore shkrimi , modele shkronjash individuale, grafiku i shkronjës **I, i,** *I, í* të shtypit dhe të dorës.

Lidhja me fushat e tjera:

Lënda: Matematikë, art pamor, Muzikë.

Përshkrimi kontekstual i situatës

- ***Veprimtari paraprake***

Hapi 1. Dëgjohet kënga e shkronjës **i**

"Jam i drejtë si një shkop, sipër meje përmbi kokë, rri një pikë s'luan dot..." apo edhe vjersha kushtuar shkronjës I.

- *Si ndjeheni kur këndohet?*
- *Çfarë mund të themi për të?*

Paraqitet shkronja I,i, *I,í* në të gjitha format si shtypi dhe dore si dhe fjalë që përmbajnë shkronjën i në pozicione e lloje të ndryshme shkrimesh dhe diskutohet rreth tyre për ngjashmëritë dhe ndryshimet.

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 2. Përsëritje e shkronjës të mësuar të dorës(a). Lexim në korr i fjalëve.

Përsëriten shkronjat **I, i** të shtypit dhe grafiku i tyre.

Nxiten nxënësit të thonë fjalë që fillojnë me **I,** shkruaj disa prej tyre.(me shkrim shtypi)

Hapi 3. Paraqes modelin e shkronjës së dorës *I, í.*

-Nxënësit ngrenë dorën në ajër dhe lëvizin nën drejtimin e mësueses sipas modelit të shkronjës së dorës I,i. Bëhet dallimi me shkronjën **I, i** të shtypit nga të dorës.

Ngre nxënës në tabelë që shkruajnë shkronjën dhe fjalë me i.

Hapi 4. Më pas nxënësit punojnë në fletoren e punës sipas modelit paraqet lidhja e shkronjës me shkronjat e tjera apo elementët e shkronjave. Vëzhgohet plotësimi i faqes. Kopjohen dy-katër

rreshta me shkronjat *I,í* ose (plotësohet faqja e fotokopjuar). ***Demonstrim i rezultateve të arritura*** **Hapi 5.** Nxënësit veprojnë me vetëdiktim në formën *í,I,í,í,I,Aí,í,I*..(ose me kopjim nga modeli),ose në formën i,I, i, I.(shtypi, dore)
Vlerësimi i situatës: ***Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:*** ✓ Shkruan shkronjat *I,í* të dorës duke u ndihmuar nga modeli. ✓ Shkruan shkronjat *I,í* me të gjitha elementet duke respektuar hapësirën. ✓ Shkruan fjalë me të kopjuar duke përdorur shkronjën në *I,í* në fillim, në trup të fjalës. ✓ Lexon fjalë me shkrim shtypi.
Detyrë shtëpie: **1.** Shkrim nga 3-5 rreshta me shkronjën e madhe dhe të vogël të dorës *I,í* **2.** Shkrim fjalësh me shkronja shtypi që përmbajnë i. **3.** Vizatim dhe emërtim i fjalëve që përmbajnë I, i. **4.** Kopjo modelin e klasës. (me shkrim dore)
Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1	**Klasa:** 1
Tema mësimore: **Punim i shkronjave M, m faqe 24 të Abetares**		**Situata e të nxënit:** Mami im	

***Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe**

Nxënësi:

- ***Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit:***
  - Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup.
  - Shpreh me gojë para shokëve dhe të tjerëve përjetimet dhe emocionet që e kanë shoqëruar gjatë shikimit të një filmi apo dëgjimit të një përralle.
- ***Kompetenca e të nxënit:*** Parashtron pyetje dhe përgjigje në lidhje me temën.
- ***Kompetenca qytetare:*** Gjen të përbashkëtat dhe ndryshimet ndërmjet aktiviteteve që bën në klasë me ato në ambiente të tjera.

***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore**

Nxënësi:

- Shqipton tingullin **M**
- Gjen dhe thotë fjalë që fillojnë me ***M*** ose që përmbajnë shkronjën **m** në trup të tyre. (në pozicione të ndryshme)
- Lexon fjalët e fjalorit të librit: *mami im, molla, mali, makina, mace.*
- Përshkruan figurën qendrore.
- Plotëson sipas figurës shkronjën mungesore.
- Formon fjali me fjalët e faqes.
- Vizaton figura që përmbajnë shkronjën M, m dhe i emërton ato me shkrim shtypi.

Fjalë kyçe:
Mami, molla, mali, makina, mace.

Teknika dhe strategji:

- Bisedë
- Vëzhgim
- Demonstrim
- Lexim global
- Punë individuale/Çift
- Vizatim/Emërtim

Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, modele shkronjash individuale, grafiku i shkronjës **M, m** të shtypit, foto e fëmijëve me mamin, fishe me fjalë të fjalorit dhe fjalë të tjera që kanë në trup në pozicione të ndryshme bashkëtingëlloren **M, m,** mollë, lodra si mace, makinë.., magnetofon.

Lidhja me fushat e tjera:
Lënda: Matematikë, art pamor, muzikë

Përshkrimi kontekstual i situatës

- ***Veprimtari praktike***

Hapi 1. Dëgjohet në magnetofon kënga e shkronjës M. Vazhdon me një bisedë për emrat e mbiemrat e nxënësve të klasës si dhe disa nga objektet mace,makinë..apo fotot e vendosura në muret e klasës. I listojnë e madje edhe shkruajnë globalisht fjalët që munden. Nxënësit që iu fillon emri me shkronjën M mund të shkruajnë edhe emrin e mbiemrin e tyre në dërrasë. Sa nxënës kemi në klasë që iu fillon emri me shkronjën m?

Hapi 2. Nxiten nxënësit që disa nga fjalët t'i përdorin edhe në fjali.

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 3. Hapet libri dhe komentohet figura qendrore, biseda dhe komunikimi i shokëve në grup për bisedat e djalit me mamin. Lexohen dhe plotësohen fjalët e fjalorit me radhë nga nxënësit madje edhe emrat në fishe.

Shkruaj fjalët: *mali, mami, molla, mace, makina.* Kryhet procesi i analizës për shkëputjen e tingullit dhe shkronjës M,m (nxënësit ndajnë edhe fjalët në rrokje, ma-mi dhe më pas veçimi i tingullit

bashkëtingëllor).

Hapi 4. Demonstron para klasës grafikun e shkronjës së vogël dhe të madhe të shtypit. Nxit nxënësit të bëjnë ngjashmëritë dhe dallimet me objekte të tjera rrethanore.(për nga drejtësia dhe pjerrtësia e shkronjës duke ruajtur gjithnjë drejtimin).

Hapi 5. Nxiten nxënësit të gjejnë fjalë që fillojnë me **M** , e kanë në trup ose mbarojnë me **m**.

Plotësohet tabela kolektivisht ose me fletë të fotokopjuara individuale.

M	**M**	**M**
Miri.....	mami	im .....

Hapi 6. Nxënësit punojnë individualisht për plotësimin e shkronjave në fjalët mungesore dhe vizatimin e tyre (aty ku munden sigurisht). Bëhet leximi dhe ndarja e tyre në rrokje. Ngre disa nxënës që shkruajnë fjalët në tabelë.

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 7. Shkruan apo paraqiten fjalët kryesore në tabelë. Ndahet në etiketa dhe fjalët në rrokje. Individualisht nxënësit qarkojnë bashkëtingëlloren M në fjalët e dhëna me fisha apo libra e revista. Lexohen nga nxënësit në zinxhir fjalët e faqes 24.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Shqipton tingullin zanor **M.**
- ✓ Gjen dhe thotë fjalë që fillojnë me ***M*** ose që përmbajnë tingullin **m** në trup të tyre.
- ✓ Lexon fjalët e fjalorit të librit.
- ✓ Plotëson sipas figurës shkronjat mungesore.
- ✓ Formon fjali ose tekst sipas figurës kryesore të faqes.
- ✓ Përshkruan mbi bazën e figurave.

Detyrë shtëpie:

1. Lexo dhe shkruaj fjalët e librit në fletore.
2. Shkruaj 10-15 fjalë me shkronjën **m,M.**

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1	**Klasa:** 1
Tema mësimore: Ushtrime aplikative. Abetare pune faqe 24		**Situata e të nxënit:** Mami im	

***Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe**

Nxënësi:

- ***Kompetenca e të nxënit:*** Ndjek udhëzimet e dhëna për të realizuar një veprim
- ***Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin:*** Identifikon burimet e nevojshme dhe i përdor në mënyrë të drejtë.

***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore**

Nxënësi:

- Shkruan shkronjës **M, m** të shtypit sipas modelit.
- Shkruan me të kopjuar rrokje, fjalë.
- Plotëson fjalët që iu mungojnë shkronja.
- I përgjigjet pyetjeve shkurt.
- Ndan fjalët në rrokje.

Fjalë kyçe:
Mami, molla, mace, mali, im, mi, ma.

Teknika dhe strategji:

- Diskutim për njohuritë paraprake.
- Imagjinatë e drejtuar
- Marrëdhënie pyetje-përgjigje.

Burimet e informacionit dhe mjete: Shkronjat individuale dhe kolektive, fletore pune, etiketa me rrokje, fjalë sipas nivelit në fletë të fotokopjuara, mjete vizatimi, magnetofon, Cd, fletë të fotokopjuara me fjalë që përmbajnë shkronjën m në pozicione të ndryshme.

Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë, Arte, Shoqëria dhe mjedisi

Përshkrimi kontekstual i situatës

- ***Veprimtari paraprake***

Hapi 1. Klasa është e ndarë në grupe me nivele të ndryshme. Mësuesja ka përgatitur etiketa me fjalë dhe figura të situatës (mami,molla,mace,makinë,maskë,motër).Nxënësit prezantojnë edhe foto të mamit të tyre duke prezantuar edhe profesionet. Nxënësit lexojnë me zë të lartë. Nxiten nxënësit të korrigjojnë apo plotësojnë njëri-tjetrin gjatë leximit global.

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 2. Paraqet grafikun e shkronjës **M, m.** I nxis të thonë ndryshimet dhe ngjashmëritë me objekte apo ta krijojnë atë me pjesë të trupit,si dhe mënyra e lëvizjes së dorës gjatë shkrimit të saj.
Hapi 3. Ngre nxënës në tabelë që shkruajnë disa nga rrokjet, fjalët dhe fjalitë e etiketave që u shpërndanë në pjesën e parë të orës.(Mami im e mirë. Makina ime...)
Hapi 4. Punohet sipas kërkesave në fletoren e punës. Modelohet shkronja **M, m**, shkruhen fjalët me shkronja të mëdha të shtypit si dhe me të vogla të shtypit. Ndajnë fjalët në rrokje.
Hapi 5. Nxënësit veprojnë me analizën e sintezën e rrokjeve dhe shkronjave.(M+A=MA,MI=M+I)Bëhet kontrolli individual i fletores/kontrollojnë njëri-tjetrin.

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 6. Nxënësit lexojnë fjalët e ushtrimeve në fletoren e punës. I përdorin edhe në fjali ato. Nxënësit më të përparuar mund të formojnë disa fjali të shkurtra në fletore më fjalët e fjalorit.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Shkruan shkronjës **M, m** të shtypit sipas modelit.
- ✓ Shkruan rrokje, fjalë.

✓ Formon fjalë duke plotësuar shkronjat. ✓ I përgjigjet pyetjeve shkurt.
Detyrë shtëpie: 1. Kopjo dy herë fjalët e faqes. Lexo ato. 2. Paraqit me vizatim pamje nga klasa juaj. 3. Shkruaj 10 fjalë që kanë në trup shkronjën a. (në pozicione të ndryshme).
Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1	**Klasa:** 1
Tema mësimore: **Punim e lexim i faqes 24 në Abetare**		**Situata e të nxënit:** Mami im	

***Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe**

Nxënësi:

- ***Kompetenca e komunikim dhe të shprehurit :***
  - Shpreh me gojë për 3-5 minuta para moshatarëve përjetimet dhe emocionet që e kanë shoqëruar gjatë dëgjimit të një kënge/teksti.
  - Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit.
- ***Kompetenca e të nxënit:***
  - Parashtron pyetje dhe përgjigje në lidhje me temën.
  - Ndjek udhëzimet e dhëna në një tekst për të realizuar një aktivitet që kërkohet.

***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore**

Nxënësi:

- Lexon fjalë, fjali.
- I përgjigjet me fjali të thjeshtë pyetjeve rreth figurës së faqes.
- Rilexon fjalët e faqes.
- Lidh pjesën që lexon me filma që ka parë, me përvoja personale.

Fjalë kyçe:
Alfabeti, mami, molla, mali, makina, mace, Tomi,
Mami me Anin, Mami im, ma..

Teknika dhe strategji:

- Marrëdhënie pyetje-përgjigje
- Imagjinatë e drejtuar
- Punë në grup
- Lexim zinxhir
- Analizë- sintezë e fjalës

Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, modele shkronjash individuale, grafiku i shkronjës **M, m** të shtypit, foto apo objekte si makina, molla, maska, mace lodër, alfabeti i gjuhës shqipe, libra për fëmijë.

Lidhja me fushat e tjera:
Lënda: Matematikë, art pamor

Përshkrimi kontekstual i situatës

- ***Veprimtari praktike***

Hapi 1. U paraqitet nxënësve kënga apo vjersha e shkronjës M , madje dhe gjëegjëza e makinës. Iu kërkoj nxënësve të recitojnë vjersha kushtuar mamit të tyre apo edhe kartolina.

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 2. Hapen librat. Nxit nxënësit të përshkruajnë figurën. Mësuesja këshillon nxënësit të përfytyrojnë rreth ngjarjes të paraqitur në fq. 24.
Mami dhe Ani kanë dalë shëtitje në mal.

- *Si mendoni çfarë ka ndodhur me to?*
- *Po ju shkoni për piknik në mal?*
- *Me se udhëtoni?*
- *Çfarë ju pëlqen më shumë atje?Pse?*
- *Cilat janë disa nga malet e Shqipërisë?*

Bëhet krahasimi me krijimet e nxënësve.

Hapi 3. Bëhet leximi në korr disa herë. Shpjegohen pozicionet e M në pozicione të ndryshme. Kujtohet që të gjithë emrat e njerëzve dhe të maleve shkruhen me shkronjë të madhe.(Përdoren disa prej tyre në fjali).

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 4. Lexohet dhe komentohet fjalia MAMI ME ANIN.

- *Sa fjalë ka fjalia?*
- *Cila është fjala më e gjatë po më e shkurtër?*
- *Pse Ani e ka mollën në dorë?*
- *Çfarë nxori nëna nga çanta?*
- *Si e pastroni ju atë?*
- *Cilat janë disa nga cilësitë e frutit të mollës?*
- *E konsumoni ju shpesh atë?*
- *Në cilën stinë piqet ajo?*

Hapi 5. Nxënësit në mënyrë individuale ndajnë fjalët në rrokje. Diskutojnë në dyshe më shokun e bankës ose në grup për përgjigjet e dhëna. Kujtohet fakti që fjala ka aq rrokje sa zanore ka. Kujdes (AN-IN).

Hapi 6. Nxënësit veprojnë në grupe për të komunikuar sikurse personazhet e librit.(lojë roli e bisedës së mamit me djalin për pastërtinë e mollës).

Hapi 7. Lexohen fjalë me etiketa të vendosura në dërrasë e përdoren në fjali p.sh. AI, MAMI, IM, MALI, MAKINA...

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Lexon fjalë, fjali.
- ✓ I përgjigjet me fjali të thjeshta pyetjeve rreth përmbajtjes së faqes.
- ✓ Rilexon fjalët e komenton përmbajtjen e tij.
- ✓ Lidh temën me përvoja personale.

Detyrë shtëpie:

1. Lexo disa herë faqen.
2. Kopjo 2-3 rreshta me fjalët e faqes si dhe fjalinë.
3. Shkruaj 10 fjalë që të fillojnë me shkronjën M.

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1	**Klasa:** 1
Tema mësimore: Ushtrime dhe modeli i shkrimit të dorës. **Abetare pune fq. 25 shkronja** M,m		**Situata e të nxënit:** Mami im	

***Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe**

Nxënësi:

- ✓ ***Kompetenca e komunikim dhe të shprehurit*** Shpreh me gojë për 3-5 minuta para moshatarëve përjetimet dhe emocionet që e kanë shoqëruar gjatë dëgjimit të një kënge.
- ✓ ***Kompetenca e të nxënit:*** Mbikëqyr në mënyrë të pavarur përparimin e vet në një detyrë duke përdorur detyra të ndryshme. Korrigjon gabimet.
- ✓ ***Kompetenca qytetare:*** Bashkëpunon në grup dhe respekton rregullat e grupit.

***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore**

Nxënësi:

- Modelon bukur grafikun e shkronjës së madhe dhe të vogël të dorës M,m.
- Shkruan elementët e shkronjave të dorës.
- Shkruan shkronjat M, m të shtypit.
- Plotëson me shkrim dore shkronjën M,m në pozicione të ndryshme.

Fjalë kyçe:
mami, mollë, mace, mama, ma, mi, im, am.

Teknika dhe strategji:

- Vetëdiktim
- Demonstrim
- Punë individuale
- Punë në çifte/punë në dyshe
- Shkrim i lirë

Burimet e informacionit dhe mjete: Fletore e punës, fletore shkrimi, modele shkronjash individuale, grafiku i shkronjës **M, m,** M,m të shtypit dhe të dorës.

Lidhja me fushat e tjera:
Art pamor,matematikë,

Përshkrimi kontekstual i situatës

- ***Veprimtari paraprake***

Hapi 1. Dëgjohet kënga e shkronjës m "Mbledh gërmuq po syrin pishë,rri e fshehur e s'lëviz..." apo edhe vjersha kushtuar shkronjës M.

- *Si ndjeheni kur këndohet?*
- *Çfarë mund të themi për të?*

Paraqitet shkronja M, m, M,m në të gjitha format si shtypi dhe dore si dhe fjalë që përmbajnë shkronjën m në pozicione e lloje të ndryshme shkrimesh dhe diskutohet rreth tyre për ngjashmëritë dhe ndryshimet.

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 2. Përsëritje e shkronjave të mësuara të dorës. Lexim në korr.
Përsëriten shkronjat **M, m** të shtypit dhe grafiku i tyre.
Nxiten nxënësit të thonë fjalë që fillojnë me **M,** shkruaj disa prej tyre.

Hapi 3. Paraqes modelin e shkronjës së dorës M,m.
Nxënësit ngrenë dorën në ajër dhe lëvizin nën drejtimin e mësueses sipas modelit të shkronjës së dorës M,m. Bëhet dallimi mes shkronjave **M, m** të shtypit nga të dorës.
Ngre nxënës në tabelë që shkruajnë shkronjën dhe fjalë me m.

Hapi 4. Më pas nxënësit punojnë në fletoren e punës sipas modelit. paraqet lidhja e shkronjës me shkronjat e tjera. Vëzhgohet plotësimi i faqes. Kopjohen dy-katër rreshta me shkronjat M,m dhe rrokjet ma,mi ose (plotësohet faqja e fotokopjuar e shoqëruar edhe me ngjyrosjen e figurës së maces).

Demonstrim i rezultateve të arritura

Hapi 5. Nxënësit veprojnë me vetëdiktim në formën *m,M,m,m,M,M,m,M*…(ose me kopjim nga modeli),ose në formën m,M, m, M.(shtypi,dore)
Vlerësimi i situatës: ***Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:*** ✓ Shkruan shkronjat *M, m* të dorës duke u ndihmuar nga modeli. ✓ Shkruan shkronjat *M, m* me të gjitha elementet duke respektuar hapësirën. ✓ Shkruan fjalë me të kopjuar duke përdorur shkronjën në **M, m** në fillim, në trup të fjalës. ✓ Lexon fjalë me shkrim shtypi.
Detyrë shtëpie: **1.** Shkrim nga 3-5 rreshta me shkronjën e madhe dhe të vogël të dorës *m, M*. **2.** Shkrim fjalësh me shkronja shtypi që përmbajnë m. **3.** Vizatim dhe emërtim i fjalëve që përmbajnë M,m. **4.** Kopjo modelin e klasës.
Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	Shkalla:1	Klasa1
Tema mësimore: **Punim i shkronjave N,n faqe 25 të Abetares**		**Situata e të nxënit:** Nëna ime	

***Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe**

Nxënësi:

- ***Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit:***
  - Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup.
  - Shpreh me gojë para shokëve dhe të tjerëve përjetimet dhe emocionet që e kanë shoqëruar gjatë shikimit të një filmi apo dëgjimit të një përralle/kënge.
- ***Kompetenca e të nxënit:*** Parashtron pyetje dhe përgjigje në lidhje me temën.
- ***Kompetenca qytetare:*** Gjen të përbashkëtat dhe ndryshimet ndërmjet aktiviteteve që bën në klasë me ato në ambiente të tjera.

***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore**

Nxënësi:

- Shqipton tingullin **N.**
- Gjen dhe thotë fjalë që fillojnë me ***N*** ose që përmbajnë shkronjën **n** në trup të tyre. (në pozicione të ndryshme)
- Lexon fjalët e fjalorit të librit: nëna, numra, nënta, ena.
- Përshkruan figurën qendrore.
- Plotëson sipas figurës shkronjën mungesore.
- Formon fjali me fjalët e faqes.
- Vizaton figura që përmbajnë shkronjën N, n dhe i emërton ato me shkrim shtypi.

Fjalë kyçe:
nëna, numra, nënta, ena, nëntor, nata, qeni, Umin, numëratorja

Teknika dhe strategji:

- Bisedë
- Vëzhgim
- Demonstrim
- Lexim global
- Punë individuale/Çift
- Vizatim/Emërtim

Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, modele shkronjash individuale, grafiku i shkronjës **N, n** të shtypit, foto e nënës që tregon përralla, fishe me fjalë të fjalorit dhe fjalë të tjera që kanë në trup në pozicione të ndryshme bashkëtingëlloren **N,n**, ena, lodra si numra, banane, makinë.., magnetofon.

Lidhja me fushat e tjera:
Lënda: Matematikë, art pamor, Muzikë.

Përshkrimi kontekstual i situatës

- ***Veprimtari praktike***

Hapi 1. Dëgjohet në magnetofon kënga e shkronjës **N**/ apo Kënga e gjyshes. Vazhdon me një bisedë për emrat e mbiemrat e nxënësve të klasës si dhe disa nga objektet ena,makinë..apo fotot e vendosura në muret e klasës. I listojnë e madje edhe shkruajnë globalisht fjalët që munden. Nxënësit që iu fillon emri me shkronjën N mund të shkruajnë edhe emrin e mbiemrin e tyre në dërrasë. Sa nxënës kemi në klasë që iu fillon emri me shkronjën N?

Hapi 2. Nxiten nxënësit që disa nga fjalët ti përdorin edhe në fjali. Kujdes me emrat e njerëzve që fillojnë me shkronjë të madhe.

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 3. Hapet libri dhe komentohet figura qendrore, biseda e nxënësve në grup për bisedat e nënës me qenushin Umi si dhe për komunikimin Gjyshe nip/mbesë. Lexohen dhe plotësohen fjalët e fjalorit me radhë nga nxënësit madje edhe emrat në fishe.

Shkruaj fjalët: *nëna, nënta, nëntori, ena, makina.* Kryhet procesi i analizës për shkëputjen e tingullit dhe shkronjës **N, n** (nxënësit ndajnë edhe fjalët në rrokje, në-na dhe më pas veçimi i tingullit

bashkëtingëllor).

Hapi 4. Demonstron para klasës grafikun e shkronjës së vogël dhe të madhe të shtypit. Nxit nxënësit të bëjnë ngjashmëritë dhe dallimet me objekte të tjera rrethanore apo edhe me shkronjën m.(për nga drejtësia dhe pjerrtësia e shkronjës duke ruajtur gjithnjë drejtimin).

Hapi 5. Nxiten nxënësit të gjejnë fjalë që fillojnë me **N**, e kanë në trup ose mbarojnë me **n**.

Plotësohet tabela kolektivisht ose me fletë të fotokopjuara individuale.

N	**N**	**N**
Nerta.....	ena	Umin .....

Hapi 6. Nxënësit punojnë individualisht për plotësimin e shkronjave në fjalët mungesore dhe vizatimin e tyre (aty ku munden sigurisht). Bëhet leximi dhe ndarja e tyre në rrokje. Ngre disa nxënës që shkruajnë fjalët në tabelë.

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 7. Shkruan apo paraqiten fjalët kryesore në tabelë. Ndahet në etiketa dhe fjalët në rrokje. Individualisht nxënësit qarkojnë bashkëtingëlloren N në fjalët e dhëna me fisha apo libra e revista. Lexohen nga nxënësit fjalët e faqes 24.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Shqipton tingullin zanor **N.**
- ✓ Gjen dhe thotë fjalë që fillojnë me ***N*** ose që përmbajnë tingullin **n** në trup të tyre.
- ✓ Lexon fjalët e fjalorit të librit.
- ✓ Plotëson sipas figurës shkronjat mungesore.
- ✓ Formon fjali ose tekst sipas figurës kryesore të faqes.
- ✓ Përshkruan mbi bazën e figurave.

Detyrë shtëpie:

1. Lexo dhe shkruaj fjalët e librit në fletore.
2. Shkruaj 10-15 fjalë me shkronjën **n, N.**

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1	**Klasa:** 1
Tema mësimore: Ushtrime aplikative. Abetare pune faqe 25		**Situata e të nxënit:** Nëna ime	

***Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe**

Nxënësi:

- ***Kompetenca e të nxënit:*** Ndjek udhëzimet e dhëna për të realizuar një veprim
- ***Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin:*** Identifikon burimet e nevojshme dhe i përdor në mënyrë të drejtë.

***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore**

Nxënësi:

- Shkruan shkronjës **N, n** të shtypit sipas modelit.
- Shkruan me të kopjuar rrokje, fjalë.
- Plotëson fjalët që ju mungojnë shkronja.
- I përgjigjet pyetjeve shkurt.
- Ndan fjalët në rrokje.

Fjalë kyçe:
nëna,nënta,numra,na,ni,nina-nana,ena,

Teknika dhe strategji:

- Diskutim për njohuritë paraprake.
- Imagjinatë e drejtuar
- Marrëdhënie pyetje-përgjigje.

Burimet e informacionit dhe mjete: Shkronjat individuale dhe kolektive, fletore pune, etiketa me rrokje, fjalë sipas nivelit në fletë të fotokopjuara, mjete vizatimi, magnetofon, A_4, Cd, fletë të fotokopjuara me fjalë që përmbajnë shkronjën **n** në pozicione të ndryshme.

Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë, Arte, Shoqëria dhe mjedisi

Përshkrimi kontekstual i situatës

- ***Veprimtari paraprake***

Hapi 1. Klasa është e ndarë në grupe të ndryshme. Mësuesja ka përgatitur etiketa me fjalë dhe figura të situatës (nëna, numra, ena, nina-nana, numëratore).Nxënësit prezantojnë edhe foto të nënës me nipat e mbesat e tyre duke prezantuar edhe marrëdhënie personale. Ju ka ndodhur t'ju tregojë nëna përralla në mbrëmje? Si jeni ndier me to? Nxënësit lexojnë me zë të lartë fjalët e dhëna. Nxiten nxënësit të korrigjojnë apo plotësojnë njëri-tjetrin gjatë leximit global.

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 2. Paraqet grafikun e shkronjës **N, n.** I nxis të thonë ndryshimet dhe ngjashmëritë me objekte apo ta krijojnë atë me pjesë të trupit(gishta),si dhe mënyra e lëvizjes së dorës gjatë shkrimit të saj. Nxënësit veprojnë në A_4 për shkrimin e shkronjave N, n.

Hapi 3. Ngre nxënës në tabelë që shkruajnë disa nga rrokjet, fjalët dhe fjalitë e etiketave që u shpërndanë në pjesën e parë të orës.(Nëna ime e mirë. Natë me hënë...)

Hapi 4. Punohet sipas kërkesave në fletoren e punës. Modelohet shkronja **N, n**, shkruhen fjalët me shkronja të mëdha të shtypit si dhe me të vogla të shtypit. Nxënësit tregojnë ngjashmërinë e ndryshimet mes tyre. Ndajnë fjalët në rrokje. (na-të)

Hapi 5. Nxënësit veprojnë me analizën e sintezën e rrokjeve dhe shkronjave.(N + A = NA,NI = N + I.) Bëhet kontrolli individual i fletores/kontrollojnë njëri-tjetrin.

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 6. Nxënësit lexojnë fjalët e ushtrimeve në fletoren e punës. I përdorin edhe në fjali ato. Nxënësit më të përparuar mund të formojnë disa fjali të shkurtra në fletore më fjalët e fjalorit.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

✓ Shkruan shkronjës **N, n** të shtypit sipas modelit. ✓ Shkruan rrokje, fjalë. ✓ Formon fjalë duke plotësuar shkronjat. ✓ I përgjigjet pyetjeve shkurt.
Detyrë shtëpie: 1. Kopjo dy herë fjalët e faqes. Lexo ato. 2. Paraqit me vizatim pamje nga një natë me hënë. 3. Shkruaj 10 fjalë që kanë në trup shkronjën n. (në pozicione të ndryshme).
Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1	**Klasa:** 1
Tema mësimore: **Punim e lexim i faqes 25 në Abetare**		**Situata e të nxënit:** Nëna ime	

***Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe**

Nxënësi:

- ***Kompetenca e komunikim dhe të shprehurit:***
  - Shpreh me gojë për 3-5 minuta para moshatarëve përjetimet dhe emocionet që e kanë shoqëruar gjatë dëgjimit të një kënge/teksti.
  - Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit.
- ***Kompetenca e të nxënit:***
  - Parashtron pyetje dhe përgjigje në lidhje me temën.
  - Ndjek udhëzimet e dhëna në një tekst për të realizuar një aktivitet që kërkohet.

***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore**

Nxënësi:

- Lexon fjalë, fjali.
- I përgjigjet me fjali të thjeshtë pyetjeve rreth figurës së faqes.
- Rilexon fjalët e faqes.
- Lidh pjesën që lexon me filma që ka parë, me përvoja personale të dëgjuara apo jetuara.

Fjalë kyçe:
Alfabeti, nëna, nënë, numra, makina, ena, Nëna me Umin, Nëna ime, nina..

Teknika dhe strategji:

- Marrëdhënie pyetje-përgjigje
- Imagjinatë e drejtuar
- Punë në grup
- Lexim zinxhir
- Analizë- sintezë e fjalës

Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, modele shkronjash individuale, grafiku i shkronjës **N,n** të shtypit, foto apo objekte si makina, ena, numëratore, numri nëntë, alfabeti i gjuhës shqipe, libra për fëmijë.

Lidhja me fushat e tjera:
Lënda: Matematikë, art pamor

Përshkrimi kontekstual i situatës

- ***Veprimtari praktike***

Hapi 1. U paraqitet nxënësve kënga apo vjersha e shkronjës N, madje dhe gjëegjëza matematikore.

Unë kam shtatë lapsa ,
ndërsa ti dy më shumë.
Sa lapsa ke ti?

Iu kërkoj nxënësve të recitojnë vjersha kushtuar nënave (gjysheve) të tyre apo edhe të lexojë kartolina kushtuar tyre.

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 2. Hapen librat. Nxit nxënësit të përshkruajnë figurën. Mësuesja këshillon nxënësit të përfytyrojnë rreth ngjarjes të paraqitur në fq. 25.

Nëna ime ka dalë të mbledhë mollë në pyll.

- *Si mendoni çfarë ka ndodhur me nënën?*
- *Po ju keni mbledhur ndonjëherë mollë në mal/pyll?*
- *Me kë keni udhëtuar?*
- *Çfarë ju ka pëlqyer më shumë atje?Pse?*
- *Cilat janë disa nga fjalët që nëna mund ti ketë thënë qenushit Umi?*

Bëhet krahasimi mes krijimeve të nxënësve.

Hapi 3. Bëhet leximi në korr disa herë. Shpjegohen pozicionet e ndryshme të N. Kujtohet që të gjithë emrat e njerëzve dhe të kafshëve shkruhen me shkronjë të madhe. (Përdoren disa prej tyre në fjali).

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 4. Lexohet dhe komentohet fjalia NËNA ME UMIN. Sa fjalë ka fjalia? Cila është fjala më e gjatë po më e shkurtër? Pse nëna e ka shportën me mollë në prehër? Çfarë i thotë nëna qenit të vogël? Për cilët i ka mbledhur nëna mollët? I konsumoni ju shpesh ato?

Hapi 5. Nxënësit në mënyrë individuale ndajnë fjalët në rrokje. Diskutojnë në dyshe më shokun e bankës ose në grup për përgjigjet e dhëna. Kujtohet fakti që fjala ka aq rrokje sa zanore ka. Kujdes (NË-NA).

Hapi 6. Nxënësit veprojnë në grupe për të komunikuar sikurse personazhet e librit.(lojë roli e bisedës së nënës me Umin /apo meditimin e saj me vete).

Hapi 7. Lexohen fjalë me etiketa të vendosura në dërrasë e përdoren në fjali p.sh. NATA, NËNA, IN, NËNTA, MAKINA, NUMËRATORJA...

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Lexon fjalë, fjali.
- ✓ I përgjigjet me fjali të thjeshta pyetjeve rreth përmbajtjes së faqes.
- ✓ Rilexon fjalët e komenton përmbajtjen e tij.
- ✓ Lidh temën me përvoja personale.

Detyrë shtëpie:

1. Lexo disa herë faqen.
2. Kopjo 2-3 rreshta me fjalët e faqes si dhe fjalinë.
3. Shkruaj 10 fjalë që të fillojnë me shkronjën N.

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1	**Klasa:** 1
Tema mësimore: **Ushtrime dhe modeli i shkrimit të dorës. Abetare pune fq. 25 shkronja** *N,n*		**Situata e të nxënit:** Nëna ime	

***Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe**

Nxënësi:

- ✓ ***Kompetenca e komunikim dhe të shprehurit:*** Shpreh me gojë për 3-5 minuta para moshatarëve përjetimet dhe emocionet që e kanë shoqëruar gjatë dëgjimit të një kënge.
- ✓ ***Kompetenca e të nxënit:*** Mbikëqyr në mënyrë të pavarur përparimin e vet në një detyrë duke përdorur detyra të ndryshme. Korrigjon gabimet.
- ✓ ***Kompetenca qytetare:*** Bashkëpunon në grup dhe respekton rregullat e grupit.

***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore**

Nxënësi:

- Modelon bukur grafikun e shkronjës së madhe dhe të vogël të dorës *N,n.*
- Shkruan elementët e shkronjave të dorës.
- Shkruan shkronjat N,n të shtypit.
- Plotëson me shkrim dore shkronjën *N,n* në pozicione të ndryshme.

Fjalë kyçe:
Alfabeti,nëna,nënë,numra,makina,ena, Nina,Ana,Ani.

Teknika dhe strategji:

- ❖ Vetëdiktim
- ❖ Demonstrim
- ❖ Punë individuale
- ❖ Punë në çifte/punë në dyshe
- ❖ Shkrim i lirë

Burimet e informacionit dhe mjete: Fletore e punës, fletore shkrimi , modele shkronjash individuale, grafiku i shkronjës **N, n,** *N,n* të shtypit dhe të dorës

Lidhja me fushat e tjera:
Art pamor, matematikë.

Përshkrimi kontekstual i situatës

- ***Veprimtari paraprake***

Hapi 1. Dëgjohet kënga e shkronjës **N** "Kam tre këmbë, s'kam dy këmbë..." apo edhe vjersha kushtuar shkronjës N. Si ndjeheni kur këndohet? Çfarë mund të themi për të?

Paraqitet shkronja N,n, *N,n* në të gjitha format si shtypi dhe dore si dhe fjalë që përmbajnë shkronjën n në pozicione e lloje të ndryshme shkrimesh dhe diskutohet rreth tyre për ngjashmëritë dhe ndryshimet.

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 2. Përsëritje e shkronjave të dorës të mësuara deri më tani. Lexim në korr.
Përsëriten shkronjat **N, n** të shtypit dhe grafiku i tyre.
Nxiten nxënësit të thonë fjalë që fillojnë me **N,** shkruaj disa prej tyre.

Hapi 3. Paraqes modelin e shkronjës së dorës *N,n.*

Nxënësit ngrenë dorën në ajër dhe lëvizin nën drejtimin e mësueses sipas modelit të shkronjës së dorës N,n. Bëhet dallimi mes shkronjave **N, n** të shtypit nga të dorës.
Ngre nxënës në tabelë që shkruajnë shkronjën dhe fjalë me n.

Hapi 4. Më pas nxënësit punojnë në fletoren e punës sipas modelit. paraqet lidhja e shkronjës me shkronjat e tjera e kryesisht me M. Vëzhgohet plotësimi i faqes. Kopjohen dy-katër rreshta me shkronjat *N,n* dhe rrokjet *na,ni* ose (plotësohet faqja e fotokopjuar e shoqëruar edhe me ngjyrosjen e figurës së numrit nëntë).

Demonstrim i rezultateve të arritura

Hapi 5. Nxënësit veprojnë me vetëdiktim në formën *n,N,n,n,N,N,n,N…*(ose me kopjim nga

modeli),ose në formën n, N, n, N. (shtypi, dore)
Vlerësimi i situatës: ***Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:*** ✓ Shkruan shkronjat *N, n* të dorës duke u ndihmuar nga modeli. ✓ Shkruan shkronjat *N, n* me të gjitha elementet duke respektuar hapësirën. ✓ Shkruan fjalë me të kopjuar duke përdorur shkronjën në **N, n** në fillim, në trup të fjalës. ✓ Lexon fjalë me shkrim shtypi.
Detyrë shtëpie: **1.** Shkrim nga 3-5 rreshta me shkronjën e madhe dhe të vogël të dorës *n, N.* **2.** Shkrim fjalësh me shkronja shtypi që përmbajnë n. **3.** Vizatim dhe emërtim i fjalëve që përmbajnë N, n. **4.** Kopjo modelin e klasës.
Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1	**Klasa:** 1
Tema mësimore: **Punim i shkronjave E, e faqe 26 të Abetares**		**Situata e të nxënit:** Era e vjeshtës	

***Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe**

Nxënësi:

- ***Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit :***
  - Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup.
  - Shpreh me gojë para shokëve dhe të tjerëve përjetimet dhe emocionet që e kanë shoqëruar gjatë shikimit të një filmi apo dëgjimit të një përralle/kënge.
- ***Kompetenca e të nxënit:*** Parashtron pyetje dhe përgjigje në lidhje me temën.
- ***Kompetenca qytetare:*** Gjen të përbashkëtat dhe ndryshimet ndërmjet aktiviteteve që bën në klasë me ato në ambiente të tjera.

***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore**

Nxënësi:

- Shqipton tingullin **E.**
- Gjen dhe thotë fjalë që fillojnë me ***E*** ose që përmbajnë shkronjën **e** në trup të tyre.(në pozicione të ndryshme)
- Lexon fjalët e fjalorit të librit: era, elefanti, helikopteri, ena.
- Përshkruan figurën qendrore.
- Plotëson sipas figurës shkronjën mungesore.
- Formon fjali me fjalët e faqes.
- Vizaton figura që përmbajnë shkronjën **E, e** dhe i emërton ato me shkrim shtypi.

Fjalë kyçe:
era, elefanti, helikopteri, ena, Ema luan me Anin.

Teknika dhe strategji:

- Bisedë
- Vëzhgim
- Demonstrim
- Lexim global
- Punë individuale/Çift
- Vizatim/Emërtim

Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, modele shkronjash individuale, grafiku i shkronjës **E, e** të shtypit, foto të fëmijëve që luajnë me balonë, fishe me fjalë të fjalorit dhe fjalë të tjera që kanë në trup në pozicione të ndryshme zanoren **E, e,** ena, lodra si helikopteri, banane,.., magnetofon.

Lidhja me fushat e tjera:
Lënda: Matematikë, art pamor, edukim muzikor.

Përshkrimi kontekstual i situatës

- ***Veprimtari praktike***

Hapi 1. Dëgjohet në magnetofon kënga e shkronjës **E**/ apo vjersha e saj. Fillon me një bisedë për erën e stinës së vjershës që sjell rënien e gjetheve,vazhdon me një bisedë për emrat e mbiemrat e nxënësve të klasës si dhe disa nga objektet ena, elefanti, apo fotot e vendosura në muret e klasës. I listojnë e madje edhe shkruajnë globalisht fjalët që munden. Nxënësit që iu fillon emri me shkronjën E mund të shkruajnë edhe emrin e mbiemrin e tyre në dërrasë. Sa nxënës kemi në klasë që iu fillon emri me shkronjën E?

Hapi 2. Nxiten nxënësit që disa nga fjalët t'i përdorin edhe në fjali. Kujdes me emrat e njerëzve që fillojnë me shkronjë të madhe.

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 3. Hapet libri dhe komentohet figura qendrore, biseda e nxënësve në grup për lojën e Emës me Anin me balonë dhe për komunikimin e tyre Olën në helikopter. Lexohen dhe plotësohen fjalët e fjalorit me radhë nga nxënësit madje edhe emrat në fishe.

Shkruaj fjalët: *era, elefanti, helikopteri, ena.* Kryhet procesi i analizës për shkëputjen e tingullit dhe shkronjës E,e (nxënësit ndajnë edhe fjalët në rrokje, he-li-kop-te-ri dhe më pas veçimi i tingullit zanor dhe tregohet kujdes në artikulimin e saj).

Hapi 4. Demonstron para klasës grafikun e shkronjës së vogël dhe të madhe të shtypit. Nxit nxënësit të bëjnë ngjashmëritë dhe dallimet me objekte të tjera rrethanore. (për nga drejtësia e shkronjës duke ruajtur gjithnjë drejtimin).

Hapi 5. Nxiten nxënësit të gjejnë fjalë që fillojnë me **E**, e kanë në trup ose mbarojnë me **e**.

Plotësohet tabela kolektivisht ose me fletë të fotokopjuara individuale.

E	**E**	**E**
Erta.....	helikopteri	banane
.....	.....	.....

Hapi 6. Nxënësit punojnë individualisht për plotësimin e shkronjave në fjalët mungesore dhe vizatimin e tyre (aty ku munden sigurisht). Bëhet leximi dhe ndarja e tyre në rrokje. Ngre disa nxënës që shkruajnë fjalët në tabelë apo edhe fjalë të tjera që kanë në trup e.

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 7. Shkruan apo paraqiten fjalët kryesore në tabelë. Ndahet në etiketa dhe fjalët në rrokje.

Individualisht nxënësit qarkojnë zanoren E në fjalët e dhëna me fisha apo libra e revista.

Lexohen zinxhir nga nxënësit fjalët e faqes 26.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Shqipton tingullin zanor **E.**
- ✓ Gjen dhe thotë fjalë që fillojnë me ***E*** ose që përmbajnë tingullin **e** në trup të tyre.
- ✓ Lexon fjalët e fjalorit të librit.
- ✓ Plotëson sipas figurës shkronjat mungesore.
- ✓ Formon fjali ose tekst sipas figurës kryesore të faqes.
- ✓ Përshkruan mbi bazën e figurave.

Detyrë shtëpie:

1. Lexo dhe shkruaj fjalët e librit në fletore.
2. Shkruaj 10-15 fjalë me shkronjën **e, E.**

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	Shkalla:1	Klasa1
Tema mësimore: Ushtrime aplikative. Abetare pune faqe 26		**Situata e të nxënit:** Era e vjeshtës	

***Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe**

Nxënësi:

- ***Kompetenca e të nxënit:*** Ndjek udhëzimet e dhëna për të realizuar një veprim.
- ***Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin:*** Identifikon burimet e nevojshme dhe i përdor në mënyrë të drejtë.

***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore**

Nxënësi:

- Shkruan shkronjës **E, e** të shtypit sipas modelit.
- Shkruan me të kopjuar rrokje, fjalë.
- Plotëson fjalët që iu mungojnë disa shkronja.
- I përgjigjet pyetjeve shkurt.
- Ndan fjalët në rrokje.

Fjalë kyçe:
Ema, elefanti, helikopteri, era, Ema luan me Anin, telefoni, me, ne.

Teknika dhe strategji:

- Diskutim për njohuritë paraprake.
- Imagjinatë e drejtuar
- Marrëdhënie pyetje-përgjigje.

Burimet e informacionit dhe mjete: Shkronjat individuale dhe kolektive, fletore pune, etiketa me rrokje, mjete vizatimi, magnetofon, A4, Cd, fletë të fotokopjuara me fjalë që përmbajnë shkronjën **e** në pozicione të ndryshme madje dhe fjalë të shkruara në etiketa.

Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë, Arte, Shoqëria dhe mjedisi

Përshkrimi kontekstual i situatës

- ***Veprimtari paraprake***

Hapi 1. Mësuesja ka përgatitur etiketa me fjalë dhe figura të situatës(Ema, elefanti, helikopteri, era, telefoni). Nxënësit lexojnë me zë të lartë fjalët e dhëna. Nxiten nxënësit të korrigjojnë apo plotësojnë njëri-tjetrin gjatë leximit global. Mund të lexohen edhe fjalë e emra që fillojnë me E.

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 2. Paraqet grafikun e shkronjës **E, e.** I nxis të thonë ndryshimet dhe ngjashmëritë me objekte apo edhe me shkronja të tjera, si dhe mënyra e lëvizjes së dorës gjatë shkrimit të saj. Nxënësit veprojnë në A4 për shkrimin e shkronjave E, e. (njëri grup shkronjat e mëdha e tjetri të vogla apo edhe me model EEEeEeeEEEe..

Hapi 3. Ngre nxënës në tabelë që shkruajnë disa nga rrokjet, fjalët dhe fjalitë e etiketave që u shpërndanë në pjesën e parë të orës.(EM,ME,AE,NE,EN ...)

Hapi 4. Punohet sipas kërkesave në fletoren e punës. Modelohet shkronja **E, e**, shkruhen fjalët me shkronja të mëdha të shtypit si dhe me të vogla të shtypit si dhe rrokjet me, ne. Nxënësit tregojnë ngjashmërinë e ndryshimet mes tyre. Ndajnë fjalët në rrokje.(e-ra)...

Hapi 5. Nxënësit veprojnë me analizën e sintezën e rrokjeve dhe shkronjave. (N+E=NE,ME=M+E). Bëhet kontrolli individual i fletores/kontrollojnë njëri-tjetrin.

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 6. Nxënësit lexojnë fjalët e ushtrimeve në fletoren e punës. I përdorin edhe në fjali ato. Nxënësit më të përparuar mund të formojnë disa fjali të shkurtra në fletore më fjalët e fjalorit dhe të vizatojnë dhe emërtojnë ato.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi: ✓ Shkruan shkronjës **E, e** të shtypit sipas modelit. ✓ Shkruan rrokje, fjalë. ✓ Formon fjalë duke plotësuar shkronjat. ✓ I përgjigjet pyetjeve shkurt.
Detyrë shtëpie: **1.** Kopjo dy herë fjalët e faqes. Lexo ato. **2.** Paraqit me vizatim pamje nga një dite vjeshte me erë të fortë. **3.** Shkruaj 10 fjalë që kanë në trup shkronjën e. (në pozicione të ndryshme).
Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1	**Klasa:** 1
Tema mësimore: **Punim e lexim i faqes 26 në Abetare**		**Situata e të nxënit:** Era e vjeshtës	

***Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe**

Nxënësi:

- ***Kompetenca e komunikim dhe të shprehurit:***
  - Shpreh me gojë për 3-5 minuta para moshatarëve përjetimet dhe emocionet që e kanë shoqëruar gjatë dëgjimit të një kënge/teksti.
  - Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit.
- ***Kompetenca e të nxënit:***
  - Parashtron pyetje dhe përgjigje në lidhje me temën.
  - Ndjek udhëzimet e dhëna në një tekst për të realizuar një aktivitet që kërkohet.

***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore**

Nxënësi:

- Lexon fjalë, fjali.
- I përgjigjet me fjali të thjeshta pyetjeve rreth figurës së faqes.
- Rilexon fjalët e faqes.
- Lidh pjesën që lexon me filma që ka parë, me përvoja personale të dëgjuara apo jetuara.

Fjalë kyçe:
Ema, elefanti, helikopteri, era, Ema luan me Anin, telefoni, me, ne.

Teknika dhe strategji:

- Marrëdhënie pyetje-përgjigje
- Imagjinatë e drejtuar
- Punë në grup
- Lexim zinxhir
- Analizë- sintezë e fjalës

Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, modele shkronjash individuale, grafiku i shkronjës **E,e** të shtypit, foto apo objekte si helikopteri, ena, telefoni, numri tetë, alfabeti i gjuhës shqipe, libra për fëmijë.

Lidhja me fushat e tjera:
Lënda: Matematikë, art pamor

Përshkrimi kontekstual i situatës

- ***Veprimtari praktike***

Hapi 1. U paraqitet nxënësve kënga apo vjersha e shkronjës E, Nxënësit iu prezantohet me lexim nga mësuesja

Vjersha e erës

Eja erë ti më merr
dhe më ngjit lart në re
nëpër botë dua të bredh
dhe në qiell dhe në det
shkon kudo me krahë të lehtë
rend o erë në çdo vend.

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 2. Hapen librat. Nxit nxënësit të përshkruajnë figurën. Mësuesja këshillon nxënësit të përfytyrojnë rreth ngjarjes të paraqitur në fq. 26. Ju ka ndodhur ju të fluturoni me helikopter si vajza në foto?Imagjinoni një udhëtim të tillë (për 2-3minuta).Si u ndjetë apo do të ndiheshit? Po Ani çfarë mban në dorë? Ndikon era në fluturimin e balonës? Pse? (priten përgjigjet e argumentuara të nxënësve). Bëhet krahasimi mes krijimeve të nxënësve.

Hapi 3. Bëhet leximi në korr disa herë. Shpjegohen pozicionet e ndryshme të E në fjali. Kujtohet që të gjithë emrat e njerëzve dhe të kafshëve shkruhen me shkronjë të madhe. (Përdoren disa prej tyre në fjali).

Hapi 4. Lexohet dhe komentohet fjalia EMA LUAN ME ANIN. Sa fjalë ka fjalia? Cila është fjala më e gjatë po më e shkurtër? Pse Ani përshëndet me dorë? Çfarë loje po luajnë fëmijët? Po ju e përdorni këtë lojë? Ku luani? Po gjethet pse fluturojnë?

Hapi 5. Nxënësit në mënyrë individuale ndajnë fjalët në rrokje. Diskutojnë në dyshe më shokun e bankës ose në grup për përgjigjet e dhëna. Kujtohet fakti që fjala ka aq rrokje sa zanore ka. Kujdes (HE-LI-KOP-TE-RI).

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 6. Nxënësit veprojnë në grupe për të komunikuar sikurse personazhet e librit.(Biseda e Emës me Anin)

Hapi 7. Lexohen fjalë me etiketa të vendosura në dërrasë e përdoren në fjali p.sh. TETA, NE, ENA, EN, NEN, ERA, ME, EMA.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Lexon fjalë, fjali.
- ✓ I përgjigjet me fjali të thjeshta pyetjeve rreth përmbajtjes së faqes.
- ✓ Rilexon fjalët e komenton përmbajtjen e tij.
- ✓ Lidh temën me përvoja personale.

Detyrë shtëpie:

1. Lexo disa herë faqen.
2. Kopjo 2-3 rreshta me fjalët e faqes si dhe fjalinë.
3. Shkruaj 10-15 fjalë që të fillojnë me shkronjën E.

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	Shkalla:1	Klasa1
Tema mësimore: Ushtrime dhe modeli i shkrimit të dorës. Abetare pune fq. 26 shkronja *E,e*		**Situata e të nxënit:** Era e vjeshtës	

***Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe**

Nxënësi:

- ✓ ***Kompetenca e komunikim dhe të shprehurit*** Shpreh me gojë për 3-5 minuta para moshatarëve përjetimet dhe emocionet që e kanë shoqëruar gjatë dëgjimit të një kënge.
- ✓ ***Kompetenca e të nxënit:*** Mbikëqyr në mënyrë të pavarur përparimin e vet në një detyrë duke përdorur detyra të ndryshme. Korrigjon gabimet.
- ✓ ***Kompetenca qytetare:*** Bashkëpunon në grup dhe respekton rregullat e grupit.

***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore**

Nxënësi:

- Modelon bukur grafikun e shkronjës së madhe dhe të vogël të dorës *E,e.*
- Shkruan elementët e shkronjave të dorës.
- Shkruan shkronjat E, e të shtypit.
- Plotëson me shkrim dore shkronjën *E, e* në pozicione të ndryshme.

Fjalë kyçe:
Ema, elefanti, helikopteri, era, Eni me mamin, telefoni, me, ne.

Teknika dhe strategji:

- Vetëdiktim
- Demonstrim
- Punë individuale
- Punë në çifte/punë në dyshe
- Shkrim i lirë

Burimet e informacionit dhe mjete: Fletore e punës, fletore shkrimi, modele shkronjash individuale, grafiku i shkronjës **E, e, *E, e*** të shtypit dhe të dorës.

Lidhja me fushat e tjera:
Art pamor, matematikë.

Përshkrimi kontekstual i situatës

- ***Veprimtari paraprake***

Hapi 1. Dëgjohet kënga e shkronjës **E** "Kam dy pika përmbi kokë,janë dy e s'është një,ndaj më shajnë shoqe e shokë dhe më thonë e pa zë" apo edhe vjersha kushtuar shkronjës E. Si ndjeheni kur këndohet? Çfarë mund të themi për të?Mund të dëgjohet në magnetofon edhe një fshikullimë ere dhe zhvillohet një bisedë për të.

Paraqitet shkronja E,e, *E,e* në të gjitha format si shtypi dhe dore si dhe fjalë që përmbajnë shkronjën e në pozicione e lloje të ndryshme shkrimesh dhe diskutohet rreth tyre për ngjashmëritë dhe ndryshimet.

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 2. Përsëritje e shkronjave të dorës të mësuara deri më tani. Lexim në korr.
Përsëriten shkronjat **E, e** të shtypit dhe grafiku i tyre.
Nxiten nxënësit të thonë fjalë që fillojnë me **E,** shkruaj disa prej tyre.

Hapi 3. Paraqes modelin e shkronjës së dorës *E,e.* (edhe nëse ka mundësi modeli i grafikut të youtube)
Nxënësit ngrenë dorën në ajër dhe lëvizin nën drejtimin e mësueses sipas modelit të shkronjës së dorës E,e. Bëhet dallimi mes shkronjave **E, e** të shtypit nga të dorës.
Ngre nxënës në tabelë që shkruajnë shkronjën dhe fjalë me e.

Hapi 4. Më pas nxënësit punojnë në fletoren e punës sipas modelit. paraqet lidhja e shkronjës me shkronjat e tjera. Vëzhgohet plotësimi i faqes. Kopjohen dy-katër rreshta me shkronjat *E,e* dhe rrokjet *ne,me* ose (plotësohet faqja e fotokopjuar e shoqëruar edhe me ngjyrosjen e figurës së elefantit).

Demonstrim i rezultateve të arritura

Hapi 5. Nxënësit veprojnë me vetëdiktim në formën *e,E,e,e,E,E,e,E*…(ose me kopjim nga modeli),ose në formën e, E, *e, E* (shtypi,dore)
Vlerësimi i situatës: ***Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:*** ✓ Shkruan shkronjat *E, e* të dorës duke u ndihmuar nga modeli. ✓ Shkruan shkronjat *E, e* me të gjitha elementet duke respektuar hapësirën. ✓ Shkruan fjalë me të kopjuar duke përdorur shkronjën në **E, e** në fillim, në trup të fjalës. ✓ Lexon fjalë me shkrim shtypi.
Detyrë shtëpie: **1.** Shkrim nga 3-6 rreshta me shkronjën e madhe dhe të vogël të dorës **e, E**. **2.** Shkrim fjalësh me shkronja shtypi që përmbajnë e. **3.** Vizatim dhe emërtim i fjalëve që përmbajnë E, e. **4.** Kopjo modelin e klasës.
Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1	**Klasa:** 1
Tema mësimore: **Punim i shkronjave Ë, ë faqe 27 Abetare**		**Situata e të nxënit:** Qielli me hënë	

***Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe**

Nxënësi:

- ***Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit:***
  - Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup.
  - Shpreh me gojë para shokëve dhe të tjerëve përjetimet dhe emocionet që e kanë shoqëruar gjatë shikimit të një filmi apo dëgjimit të një përralle/ kënge.
- ***Kompetenca e të nxënit:*** Parashtron pyetje dhe përgjigje në lidhje me temën.
- ***Kompetenca qytetare:*** Gjen të përbashkëtat dhe ndryshimet ndërmjet aktiviteteve që bën në klasë me ato në ambiente të tjera.

***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore**

Nxënësi:

- Shqipton tingullin **Ë.**
- Gjen dhe thotë fjalë që fillojnë me ***Ë*** ose që përmbajnë shkronjën **ë** në trup të tyre. (në pozicione të ndryshme)
- Lexon fjalët e fjalorit të librit: pemë, hënë, nëntë, unë..
- Përshkruan figurën qendrore.
- Plotëson sipas figurës shkronjën mungesore.
- Formon fjali me fjalët e faqes.
- Vizaton figura që përmbajnë shkronjën **Ë, ë** dhe i emërton ato me shkrim shtypi.

Fjalë kyçe:
Hënë,pemë,nëntë,unë,nëna,në, nën,nënë

Teknika dhe strategji:

- Bisedë
- Vëzhgim
- Demonstrim
- Lexim global
- Punë individuale/Çift
- Vizatim/Emërtim

Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, modele shkronjash individuale, grafiku i shkronjës **Ë, ë** të shtypit, foto të fëmijëve që luajnë me balonë, fishe me fjalë të fjalorit dhe fjalë të tjera që kanë në trup në pozicione të ndryshme zanoren **Ë, ë,** hëna, lodra si hënë, nr. nëntë, magnetofon.

Lidhja me fushat e tjera:
Lënda: Matematikë, art pamor, edukim muzikor.

Përshkrimi kontekstual i situatës

- ***Veprimtari praktike***

Hapi 1. Dëgjohet në magnetofon kënga e shkronjës **Ë**/ apo vjersha e saj.

- *Fillon me një bisedë për hënën.*
- *Si duket hëna në mbrëmje?*
- *Po gjatë ditës ju ka rastisur të dalloni hënën lart në qiell?*
- *Keni vënë re që ka plot ditë e net pa hënë?*

Vazhdon me një bisedë për disa nga objektet pemë, ëmbëlsirë, këmbë, dorë apo fotot e vendosura në muret e klasës. I listojnë e madje edhe shkruajnë globalisht fjalët që munden. Nxënësit që iu kujtohen fjalë që fillojnë me **ë** ose e kanë në trup atë i listojnë ato fjalë.

Hapi 2. Nxiten nxënësit që disa nga fjalët t'i përdorin edhe në fjali. Kujtohet si bën një bebe kur qan - ëëë.

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 3. Hapet libri dhe komentohet figura qendrore, biseda e nxënësve në grup për hënën e

mbuluar që duket sikur fle. Po gjethet pse bien. Lexohen dhe plotësohen fjalët e fjalorit me radhë nga nxënësit madje edhe emrat në fishe.
Shkruaj fjalët: *erë,hënë,pemë,nëntë.* Kryhet procesi i analizës për shkëputjen e tingullit dhe shkronjës **Ë,ë** (nxënësit ndajnë edhe fjalët në rrokje, hë-në,pe-më dhe më pas veçimi i tingullit zanor dhe tregohet kujdes në artikulimin e saj).
Hapi 4. Demonstron para klasës grafikun e shkronjës së vogël dhe të madhe të shtypit. Nxit nxënësit të bëjnë ngjashmëritë dhe dallimet me objekte të tjera rrethanore si dhe me shkronjën binjake e (ndryshojnë vetëm pikat).Veprohet në formën e lojës një herë prezanton Ë e nxënësit ngrihen në këmbë dhe kur prezanton ë ulen. Përsëritet disa herë.
Hapi 5. Nxiten nxënësit të gjejnë fjalë që fillojnë me **Ë**, e kanë në trup ose mbarojnë me **ë**.
Plotësohet tabela kolektivisht ose me fletë të fotokopjuara individuale.

Ë	**Ë**	**Ë**
ëmbëlsirë.....	hënë	është .....

Hapi 6. Nxënësit punojnë individualisht për plotësimin e shkronjave në fjalët mungesore dhe vizatimin e tyre (aty ku munden siguristh). Bëhet leximi dhe ndarja e tyre në rrokje. Ngre disa nxënës që shkruajnë fjalët në tabelë apo edhe fjalë të tjera që kanë në trup **ë**.

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 7. Shkruan apo paraqiten fjalët kryesore në tabelë. Ndahet në etiketa dhe fjalët në rrokje.
Individualisht nxënësit qarkojnë zanoren **Ë** në fjalët e dhëna me fisha apo libra e revista.
Lexohen zinxhir nga nxënësit fjalët e faqes 27.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Shqipton tingullin zanor **Ë.**
- ✓ Gjen dhe thotë fjalë që fillojnë me ***Ë*** ose që përmbajnë tingullin **ë** në trup të tyre.
- ✓ Lexon fjalët e fjalorit të librit.
- ✓ Plotëson sipas figurës shkronjat mungesore.
- ✓ Formon fjali ose tekst sipas figurës kryesore të faqes.
- ✓ Përshkruan mbi bazën e figurave.

Detyrë shtëpie:

1. Lexo dhe shkruaj fjalët e librit në fletore.
2. Shkruaj 10-15 fjalë me shkronjën **ë, Ë.**

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	Shkalla:1	Klasa1
Tema mësimore: Ushtrime aplikative. Abetare pune faqe 26		**Situata e të nxënit:** Qielli me hënë	

***Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe**

Nxënësi:

- ***Kompetenca e të nxënit:*** Ndjek udhëzimet e dhëna për të realizuar një veprim
- ***Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin :*** Identifikon burimet e nevojshme dhe i përdor në mënyrë të drejtë.

***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore**

Nxënësi:

- Shkruan shkronjës **Ë, ë** të shtypit sipas modelit.
- Shkruan me të kopjuar rrokje, fjalë.
- Plotëson fjalët që iu mungojnë disa shkronja.
- I përgjigjet pyetjeve shkurt.
- Ndan fjalët në rrokje.

Fjalë kyçe:
Në, më, hënë, nënë, enë, nën, nënë, është, natë

Teknika dhe strategji:

- Diskutim për njohuritë paraprake.
- Imagjinatë e drejtuar.
- Marrëdhënie pyetje-përgjigje.

Burimet e informacionit dhe mjete: Shkronjat individuale dhe kolektive, fletore pune, etiketa me rrokje, mjete vizatimi, magnetofon, A4, Cd, fletë të fotokopjuara me fjalë që përmbajnë shkronjën **ë** në pozicione të ndryshme madje dhe fjalë të shkruara në etiketa.

Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë, Arte, Shoqëria dhe mjedisi

Përshkrimi kontekstual i situatës

- ***Veprimtari paraprake***

Hapi 1. Mësuesja ka përgatitur etiketa me fjalë dhe figura të situatës (Natë me hënë, Nëna me nipin). Nxënësit lexojnë me zë të lartë fjalët e dhëna. Nxiten nxënësit të korrigjojnë apo plotësojnë njëri-tjetrin gjatë leximit global. Mund të lexohen edhe fjalë e emra që fillojnë me Ë.

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 2. Paraqet grafikun e shkronjës **Ë, ë.** I nxis të thonë ndryshimet dhe ngjashmëritë me objekte apo edhe me shkronja të tjera, si dhe mënyra e lëvizjes së dorës gjatë shkrimit të saj. Nxënësit veprojnë në A4 për shkrimin e shkronjave Ë, ë. (Nxënësit veprojnë në grupe njëri grup shkronjat e mëdha e tjetri të vogla apo edhe me model ËëËËëëËËËë, ë, ë..

Hapi 3. Ngre nxënës në tabelë që shkruajnë disa nga rrokjet, fjalët dhe grupet e fjalëve në etiketa që u shpërndanë në pjesën e parë të orës. (ËM, MË, NË, ËN, IË, NËN...)

Hapi 4. Punohet sipas kërkesave në fletoren e punës. Modelohet shkronja **Ë, ë**, shkruhen fjalët me shkronja të mëdha të shtypit si dhe me të vogla të shtypit si dhe rrokjet më, në. Nxënësit tregojnë ngjashmërinë e ndryshimet mes tyre. Ndajnë fjalët në rrokje. (në-në)...

Hapi 5. Nxënësit veprojnë me analizën e sintezën e rrokjeve dhe shkronjave. (N+Ë=NË,MË=M+Ë). Bëhet kontrolli individual i fletores/kontrollojnë njëri-tjetrin.

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 6. Nxënësit lexojnë fjalët e ushtrimeve në fletoren e punës. I përdorin ato edhe në fjali. Nxënësit më të përparuar mund të formojnë disa fjali të shkurtra në fletore më fjalët e fjalorit dhe të vizatojnë dhe emërtojnë ato..*(në hënë. nënë e mirë..)*

Vlerësimi i situatës: ***Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:*** ✓ Shkruan shkronjës **Ë, ë** të shtypit sipas modelit. ✓ Shkruan rrokje, fjalë. ✓ Formon fjalë duke plotësuar shkronjat. ✓ I përgjigjet pyetjeve shkurt.
Detyrë shtëpie: **1.** Kopjo dy-tri herë fjalët e faqes. Lexo ato. **2.** Paraqit me vizatim pamje nga një natë me hënë apo qiell me hënë. **3.** Shkruaj 10 fjalë që kanë në trup shkronjën ë. (në pozicione të ndryshme me shkronja shtypi).
Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1	**Klasa:** 1
Tema mësimore: **Punim e lexim i faqes 27 në Abetare**		**Situata e të nxënit:** Qielli me hënë	

***Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe**

Nxënësi:

- ***Kompetenca e komunikim dhe të shprehurit:***
  - Shpreh me gojë për 3-5 minuta para moshatarëve përjetimet dhe emocionet që e kanë shoqëruar gjatë dëgjimit të një kënge/teksti.
  - Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit.
- ***Kompetenca e të nxënit:***
  - Parashtron pyetje dhe përgjigje në lidhje me temën.
  - Ndjek udhëzimet e dhëna në një tekst për të realizuar një aktivitet që kërkohet.

***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore**	**Fjalë kyçe:**
Nxënësi: - Lexon fjalë, fjali. - I përgjigjet me fjali të thjeshta pyetjeve rreth figurës së faqes. - Rilexon fjalët e faqes. - Lidh pjesën që lexon me filma që ka parë, me përvoja personale të dëgjuara apo jetuara.	Hënë, pemë, nëntë, unë, nëna, në, nën, nënë, Eni luan me Olën. **Teknika dhe strategji:** ❖ Marrëdhënie pyetje-përgjigje ❖ Imagjinatë e drejtuar ❖ Punë në grup ❖ Lexim zinxhir ❖ Analizë- sintezë e fjalës
Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, modele shkronjash individuale, grafiku i shkronjës **ë, Ë** të shtypit, foto apo objekte si nënë, enë, hënë, numër, nëntë, alfabeti i gjuhës shqipe, libra për fëmijë.	**Lidhja me fushat e tjera:** Lënda: Matematikë, art pamor

Përshkrimi kontekstual i situatës

- ***Veprimtari praktike***

Hapi 1. U paraqitet nxënësve kënga apo vjersha e shkronjës Ë, Nxënësit iu prezantohet me lexim nga mësuesja vjersha e hënës //*Hënë moj hënë pse s'dole mbrëmë?Fshati kishte drita shumë /Thotë hëna ç'duhem unë?*

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 2. Hapen librat. Nxit nxënësit të përshkruajnë figurën. Mësuesja kështillon nxënësit të përfytyrojnë rreth ngjarjes të paraqitur në fq. 27. Ju ka ndodhur të fluturoni mes ëndrrash në hënë? Me se?Imagjinoni një udhëtim të tillë me sy mbyllur (për 2-3minuta).

- *Si u ndjetë apo do të ndiheshit?*
- *Po Eni me Olën me çfarë po luajnë?(me top)*
- *Nëse luani ju ka ndodhur të rrëzoheni?*
- *Pse? Qani shpesh?*
- *Mund të improvizoni një situatë të tillë?*

(priten përgjigjet e argumentuara dhe simulimi i nxënësve).

Bëhet krahasimi mes krijimeve të nxënësve.

Hapi 3. Bëhet leximi në korr disa herë. Shpjegohen pozicionet e ndryshme të Ë në fjalë e fjali.

Kujtohet që emrat në gjuhën shqipe e kanë shpesh në fund zanoren ë. (p.sh këmbë, dorë, hundë, gojë, shkollë. Përdoren disa prej tyre në fjali).

Hapi 4. Lexohet dhe komentohet fjalia ENI LUAN ME OLËN.

- *Sa fjalë ka fjalia?*
- *Cila është fjala më e gjatë po më e shkurtër?*
- *Pse Ola nuk vrapon?(Ajo është veshur me fustan.)*
- *Çfarë loje po luajnë fëmijët?*
- *Po ju e përdorni këtë lojë?*
- *Ku luani?*
- *Po në mbrëmje luani?*
- *Kush ju ndriçon kur luani në mbrëmje në breg të detit?(Hëna lart në qiell)...*

Hapi 5. Nxënësit në mënyrë individuale ndajnë fjalët në rrokje. Diskutojnë në dyshe më shokun e bankës ose në grup për përgjigjet e dhëna .Kujtohet fakti që fjala ka aq rrokje sa zanore ka. Kujdes (NËN-TË).

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 6. Nxënësit veprojnë në grupe për të komunikuar sikurse personazhet e librit. (Biseda e Olës me Enin)

Hapi 7. Lexohen fjalë me etiketa të vendosura në dërrasë e përdoren në fjali p.sh. TETË, NË, ENË, ËN, NËN, ERË, MË, EMBËLSIRË...

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Lexon fjalë, fjali globalisht.
- ✓ I përgjigjet me fjali të thjeshta pyetjeve rreth përmbajtjes së faqes.
- ✓ Rilexon fjalët e komenton përmbajtjen e tij.
- ✓ Lidh temën me përvoja personale.

Detyrë shtëpie:

1. Lexo disa herë faqen.
2. Kopjo 2-3 rreshta me fjalët e faqes si dhe fjalinë.
3. Shkruaj 10-15 fjalë që të fillojnë me shkronjën Ë.

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1	**Klasa:** 1
Tema mësimore: Ushtrime dhe modeli i shkrimit të dorës. Abetare pune fq. 26 shkronja Ë,ë		**Situata e të nxënit:** Qielli me hënë	

***Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe**

Nxënësi:

- ✓ ***Kompetenca e komunikim dhe të shprehurit:*** Shpreh me gojë për 3-5 minuta para moshatarëve përjetimet dhe emocionet që e kanë shoqëruar gjatë dëgjimit të një kënge.
- ✓ ***Kompetenca e të nxënit:*** Mbikëqyr në mënyrë të pavarur përparimin e vet në një detyrë duke përdorur detyra të ndryshme. Korrigjon gabimet.
- ✓ ***Kompetenca qytetare:*** Bashkëpunon në grup dhe respekton rregullat e grupit.

***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore**

Nxënësi:

- Modelon bukur grafikun e shkronjës së madhe dhe të vogël të dorës Ë,ë.
- Shkruan elementët e shkronjave të dorës.
- Shkruan shkronjat Ë,ë të shtypit.
- Plotëson me shkrim dore shkronjën Ë,ë në pozicione të ndryshme.

Fjalë kyçe:
Hënë, pemë, nëntë, unë, nëna, në, nën, nënë

Teknika dhe strategji:

- Vetëdiktim
- Demonstrim
- Punë individuale
- Punë në çifte/punë në dyshe
- Shkrim i lirë

Burimet e informacionit dhe mjete: Fletore e punës, fletore shkrimi , modele shkronjash individuale, grafiku i shkronjës **Ë, ë, Ë,ë** të shtypit dhe të dorës.

Lidhja me fushat e tjera:
Art pamor, matematikë.

Përshkrimi kontekstual i situatës

- ***Veprimtari paraprake***

Hapi 1. Dëgjohet kënga e shkronjës **Ë** "Kam dy pika përmbi kokë, janë dy e s'është një, ndaj më shajnë shoqe e shokë dhe më thonë e pa zë" apo edhe vjersha kushtuar shkronjës Ë. Si ndjeheni kur këndohet? Çfarë mund të themi për të? Mund të dëgjohet në magnetofon edhe një tingull bulkthi në një natë me hënë dhe zhvillohet një bisedë për të.

Paraqitet shkronja Ë, ë, Ë, ë në të gjitha format si shtypi dhe dore si dhe fjalë që përmbajnë shkronjën ë në pozicione e lloje të ndryshme shkrimesh dhe diskutohet rreth tyre për ngjashmëritë dhe ndryshimet.

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 2. Përsëritje e shkronjave të dorës të mësuara deri më tani. Lexim në korr.
Përsëriten shkronjat **Ë, ë** të shtypit dhe grafiku i tyre.
Nxiten nxënësit të thonë fjalë që fillojnë me **Ë,** shkruhen disa prej tyre.

Hapi 3. Paraqes modelin e shkronjës së dorës **Ë, ë** (edhe nëse ka mundësi modeli i grafikut të youtube).
Nxënësit ngrenë dorën në ajër dhe lëvizin nën drejtimin e mësueses sipas modelit të shkronjës së dorës ë, Ë. Bëhet dallimi mes shkronjave **Ë, ë** të shtypit nga të dorës.
Ngre nxënës në tabelë që shkruajnë shkronjën dhe fjalë me ë.

Hapi 4. Më pas nxënësit punojnë në fletoren e punës sipas modelit. Paraqet lidhja e shkronjës me shkronjat e tjera. Vëzhgohet plotësimi i faqes. Kopjohen dy-katër rreshta me shkronjat Ë,ë dhe rrokjet *në, më* ose (plotësohet faqja e fotokopjuar e shoqëruar edhe me ngjyrosjen e figurës së ëmbëlsirës)

Demonstrim i rezultateve të arritura **Hapi 5.** Nxënësit veprojnë me vetëdiktim në formën **Ë,Ë,ë,ë,Ë,ë,e,Ë,Ë,Ë,ë,ë**…(ose me kopjim nga modeli), ose në formën **ë, Ë, ë, Ë** (shtypi, dore).
Vlerësimi i situatës: ***Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:*** ✓ Shkruan shkronjat **Ë, ë** të dorës duke u ndihmuar nga modeli. ✓ Shkruan shkronjat **Ë, ë** me të gjitha elementet duke respektuar hapësirën. ✓ Shkruan fjalë me të kopjuar duke përdorur shkronjën në **Ë, ë** në fillim, në trup të fjalës. ✓ Lexon fjalë me shkrim shtypi.
Detyrë shtëpie: **1.** Shkrim nga 3-6 rreshta me shkronjën e madhe dhe të vogël të dorës **ë, Ë**. **2.** Shkrim fjalësh me shkronja shtypi që përmbajnë **ë**. **3.** Vizatim dhe emërtim i fjalëve që përmbajnë **Ë, ë**. **4.** Kopjo modelin e shkrimit të dorës në klasë.
Refleksione:

<table>
<tr><td>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla:1</td><td>Klasa: 1</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore: Punim i faqes 28 të Abetares</td><td colspan="2">Situata e të nxënit:
Pema me shkronja</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe
Nxënësi:
➢ Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar.
➢ Kompetenca e të nxënit: Ndjek udhëzimet e dhëna për të realizuar një detyrë që i kërkohet.
➢ Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin: Identifikon burimet e nevojshme (materiale,mjete) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore
Nxënësi:
✚ Shqipton tingujt A, I, M, N, E, Ë.
✚ Gjen dhe thotë fjalë që fillojnë me A, I, M, N, E, Ë, ose që përmbajnë ato shkronja në trup të tyre.(në pozicione të ndryshme)
✚ Lexon rrokjet dhe fjalët e fjalorit të librit.
✚ Qarkon shkronja e figura sipas udhëzimit.
✚ Plotëson sipas modelit rrokjet nga bashkimi i shkronjave.
✚ Formon fjali me fjalët e faqes.
✚ Vizaton figura që përmbajnë shkronjat A, I, M, N, E, Ë, dhe i emërton ato me shkrim shtypi.</td><td colspan="2">Fjalë kyçe:
ariu, akullore, abetare, ananas, iriqi, miu, hëna, nëna, era, teta lule, makina, pema, nata, mami, libri...

Teknika dhe strategji:
❖ Bisedë
❖ Vëzhgim
❖ Demonstrim
❖ Punë individuale/Çift
❖ Vizatim/Emërtim
❖ Analizë-sintezë</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, modele shkronjash individuale, grafiku i shkronjave A, a, I, i, M, m, N, n, E, e, Ë, ë të shtypit, foto me pamje nga fjalë që fillojnë me a, i, m, n, e, ë fishe me fjalë të fjalorit.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera: Lënda: Edukim fizik, Matematikë, Arte, Shoqëria dhe mjedisi.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Përshkrimi kontekstual i situatës:
▪ Veprimtari paraprake:
Hapi 1. Fillon me një bisedë për alfabetin e gjuhës shqipe, si dhe raportin e zanoreve me bashkëtingëlloret në të. (7/29).
Listojnë edhe disa nga emrat e shokëve të klasës. Cilit nga ju i fillon emri me shkronjën
A? I? M? N? E? Ë?
Disa edhe mund të shkruhen në dërrasë. (3 min)
Hapi 2. Nxënësit nxiten të vërejnë ngjashmëritë dhe ndryshimet mes shkronjave të mëdha dhe të vogla të shtypit.
Veprimet në situatë
Hapi 3. Hapet libri dhe komentohet figura qendrore, biseda për pemën e shkronjave. Me nxënësit mund të krijohet një pemë me shkronjat e mësuara deri më tani, ku nxënësit ngjisin mollën me shkronjën në trungun e mollës.
Lexohen fjalët e fjalorit me radhë nga nxënësit madje edhe emrat në fishe apo etiketa.
Shkruaj fjalët: Ariu, Iriqi, Makina, Nëna, Era, Ëmbëlsira. Kryhet procesi i analizës për shkëputjen e tingujve dhe shkronjave A, I, M, N, E, Ë (nxënësit dallojnë tingujt zanor nga ata bashkëtingëllor nga artikulimi).</td></tr>
</table>

Hapi 4. Ushtrohen në shqiptimin e tingujve dhe si fillim qarkimi i figurave që fillojnë me ato shkronja. P.sh. A ariu, I iriqi, M makina, N nëna, E elefanti, Ë nëna.
Hapi 5. Nxit nxënësit të bëjnë qarkimin e shkronjave në fjalët e dhëna e madje edhe leximin e tyre. Nxiten nxënësit që disa prej fjalëve t'i përdorin edhe në fjali.
Lexohet tabela e rrokjeve kolektivisht ose individualisht.

AM	AN	IM	IN	EM	EN	ËM
M	N	M	n	M	N	M
A	A	I	I	E	E	Ë
Ma	NA	MI	NI	me	NE	MË

Hapi 6. Nxënësit punojnë individualisht për lidhjen e shkronjave e rrokjeve në trungut të mollës. Bëhet leximi dhe përdorimi në fjali i tyre. Ngre disa nxënës që shkruajnë fjalët në tabelë.

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 7. Shkruan apo paraqiten fjalët kryesore në tabelë.
Individualisht nxënësit qarkojnë zanoret A, I, E, Ë në fjalët e dhëna me fisha apo libra e revista.
Lexohen nga nxënësit në zinxhir fjalët e faqes 28.

Vlerësimi i situatës:
Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Shqipton tingujt zanor **A, I, E, Ë** dhe bashkëtingëllor **M, N.**
- ✓ Gjen dhe thotë fjalë që fillojnë me ***to*** ose që përmbajnë tingujt **a, i, m, n, e, ë** në trup të tyre.
- ✓ Lexon fjalët e librit dhe qarkon sipas udhëzimit.
- ✓ Qarkon shkronjat e mësuara.
- ✓ Formon fjali sipas figurës të faqes.
- ✓ Përshkruan figurat.

Detyrë shtëpie:

1. Lexo dhe shkruaj fjalët e librit në fletore.
2. Shkruaj nga 5 fjalë me shkronjat **A, I, M, N, E, Ë.**
3. Kopjo rrokjet me shkrim dore dhe shtypi.

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1	**Klasa:** 1
Tema mësimore: **Punim i faqes 27 në Abetare pune**		**Situata e të nxënit:** **Pema me shkronja**	

***Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe**

Nxënësi:

- ***Kompetenca e të nxënit:*** Ndjek udhëzimet e dhëna për të realizuar një veprim.
- ***Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin:*** Identifikon burimet e nevojshme dhe i përdor në mënyrë të drejtë.

***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore**

Nxënësi:

- Shkruan rrokje e fjalë me shkronja shtypi e dore duke i lidhur sipas modelit.
- Shkruan me të kopjuar rrokje, fjalë.
- Plotëson fjalët që iu mungojnë disa shkronja.
- I rendit fjalët e fjalisë sipas kuptimit.
- Ndan fjalët në rrokje dhe anasjelltas.

Fjalë kyçe:
Nëna, mami, ai, enë, ananasi, MAMI ME ENIN. ANA ME ENIN.

Teknika dhe strategji:

- Diskutim për njohuritë paraprake.
- Lexim global
- Marrëdhënie pyetje-përgjigje.
- Punë në dyshe.

Burimet e informacionit dhe mjete: Shkronjat individuale dhe kolektive, fletore pune, etiketa me rrokje e fjalë, mjete vizatimi, magnetofon, A4, fletë të fotokopjuara me fjalë që përmbajnë shkronjat e mësuara në pozicione të ndryshme madje dhe fjalë të shkruara në etiketa.

Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë, Arte, Shoqëria dhe mjedisi

Përshkrimi kontekstual i situatës

- ***Veprimtari paraprake***

Hapi 1. Lexohen tingujt e shkronjave në pemën e shkronjave. Mësuesja ka përgatitur etiketa me rrokje e fjalë dhe figura të situatës (ananasi, enë, ai, mami, nëna). Nxënësit lexojnë me zë të lartë fjalët e dhëna. Nxiten nxënësit të korrigjojnë apo plotësojnë njëri-tjetrin gjatë leximit global. Mund të lexohen edhe fjalë e emra që fillojnë me shkronjat e mësuara.

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 2. Paraqet fotot e faqes. I nxis nxënësit të thonë ndryshimet dhe ngjashmëritë mes shkronjave. Nxënësit veprojnë në A4 për shkrimin e shkronjave në dyshe A, a, I, i, M, m, N, n, E, e, Ë, ë.(Nxënësit mund të veprojnë edhe në grupe njëri grup shkronjat e mëdha e tjetri të vogla apo edhe me model Ëë, E, e, N, n, M, m, I, i, A, a.

Hapi 3. Ngre nxënës në tabelë që shkruajnë disa nga rrokjet, fjalët dhe grupet e fjalëve në etiketa që iu shpërndahen në tavolina.(AM, MË, NË, NA, IË, NI,...)

Hapi 4. Punohet sipas kërkesave në fletoren e punës. Lidhen dhe shkruhen fjalët me shkronja të shtypit si dhe në krahun e djathtë me shkronja të vogla dore. Nxënësit tregojnë ngjashmërinë e ndryshimet mes tyre.

Hapi 5. Nxënësit veprojnë me sintezën e rrokjeve dhe shkronjave.(EMA, AMI, MAMI, NËNA, INA). Veprohet edhe për shkrimin me shkrim dore të fjalisë. *Eni me mamim. Ana me Enin.* Bëhet kontrolli individual i fletores/kontrollojnë njëri-tjetrin.

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 6. Nxënësit lexojnë fjalët e ushtrimeve në fletoren e punës. I përdorin ato edhe në fjali.

Nxënësit më të përparuar mund të formojnë disa fjali të shkurtra në fletore më fjalët e fjalorit.
Vlerësimi i situatës: ***Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:*** ✓ Shkruan shkronjat e mësuara të shtypit e të dorës sipas modelit. ✓ Shkruan rrokje, fjalë. ✓ Formon fjalë duke bashkuar rrokjet me shkronjat. ✓ Lidh fjalët me figurat.
Detyrë shtëpie: **1.** Kopjo dy-tri herë fjalët e faqes. Lexo ato. **2.** Kopjo fjalitë me shkrim shtypi e dore. **3.** Shkruaj 10 fjalë që kanë në trup shkronjat e mësuara.(në pozicione të ndryshme me shkronja shtypi).
Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1	**Klasa:** 1
Tema mësimore: Punim i faqes 29 të Abetares		**Situata e të nxënit:** **Pema e shkronjave**	

***Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe**

Nxënësi:

- ***Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit:*** Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar.
- ***Kompetenca e të nxënit:*** Ndjek udhëzimet e dhëna për të realizuar një detyrë që i kërkohet.
- ***Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin:*** Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjete) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre.

***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore**

Nxënësi:

- Shqipton tingujt **A, I, M, N, E, Ë.**
- Gjen dhe thotë fjalë që fillojnë me **A, I, M, N, E, Ë.** ose që përmbajnë ato shkronja në trup të tyre.(në pozicione të ndryshme)
- Lexon rrokjet dhe fjalët e fjalorit të librit.
- Ndan fjalët nga njëra-tjetra sipas udhëzimit.
- Plotëson sipas modelit bashkimin e rrokjeve në fjalë.
- Analizon fjalinë në fjalë.
- Dallon fjalët në fjali dhe i lexon globalisht ato.

Fjalë kyçe:
Abetare, helikopteri, Ani, Ana, Ina, Eni, Luan, Umin

Teknika dhe strategji:

- Bisedë
- Vëzhgim
- Demonstrim
- Punë individuale/Çift
- Vizatim/Emërtim
- Analizë-sintezë

Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, modele të grafikut të shkronjave **A, a, I, i, M, m, N, n, E, e, Ë, ë** të shtypit, foto të disa kafshëve, fishe me fjalë e fjali të fjalorit,tabela e rrokjeve.

Lidhja me fushat e tjera: Lënda: Matematikë, Arte, Shoqëria dhe mjedisi.

Përshkrimi kontekstual i situatës:

- ***Veprimtari paraprake:***

Hapi 1. Fillon me një bisedë për alfabetin e gjuhës shqipe,si dhe raportin e zanoreve me bashkëtingëlloret në të. Ngjyrosjen e shkronjave që janë të simbolizuara në pemë. Listojnë edhe disa emrat kafshësh. Disa edhe mund të shkruhen në dërrasë. (3 min)

Hapi 2. Nxënësit nxiten të vërejnë fjalët në etiketa dhe të dallojnë shkronjat e vogla dhe të mëdha të shtypit.

Veprimet në situatë

Hapi 3. Hapet libri dhe komentohen figurat e ushtrimit të parë, biseda për shënimin e **V** ose **X** për mënyrën si komunikon macja, qeni, lopa. (mjau, mu, hum).

Lexohen fjalët dhe fjalitë me radhë duke ndarë fjalët nga njëra-tjetra.

ANI/KA/ABETARE. MAMI/LUAN/ME/INËN.
ENI/LUAN/ME/UMIN. ANI/LUAN/ME/ENIN.
ANI/KA/ARI. ANI/LUAN/ME/INËN/E/UMIN.

Kryhet procesi i analizës për shkëputjen e fjalëve nga njëra-tjetra. (nxënësit dallojnë fjalët e gjata nga ato të shkurtra).

Hapi 4. Ushtrohen në leximin e rrokjeve të rregullta mes shkronjave dhe sintezën e tyre në një fjalë të vetme HELIKOPTERI .

Hapi 5. Nxiten nxënësit që disa prej fjalëve t'i përdorin edhe në fjali. Lexohet tabela e rrokjeve individualisht.

Hapi 6. Nxënësit punojnë individualisht për shkrimin e fjalëve me shkrim të vogël shtypi dhe me shkrim dore. ANA,Ana,*Ana*. Kujtohet fakti që emrat e njerëzve shkruhen me shkronjë të madhe. Bëhet leximi dhe përdorimi në fjali i tyre. Ngre disa nxënës që shkruajnë fjalët në tabelë.

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 7. Shkruan apo paraqiten fjalët kryesore në tabelë.
Lexohen nga nxënësit në zinxhir fjalët e faqes 29.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Shqipton tingujt zanor **A, I, E, Ë** dhe bashkëtingëllor **M, N.**
- ✓ Gjen rrokjet mes shkronjave të çrregullta.
- ✓ Lexon fjalitë e librit dhe analizon sipas udhëzimit.
- ✓ Qarkon shkronjat e mësuara.
- ✓ Komenton figurat.
- ✓ Analizon fjalët e fjalisë.

Detyrë shtëpie:

1. Lexo dhe shkruaj fjalitë e librit në fletore
2. Shkruaj nga 5-7 fjalë me shkronjat **A, I, M, N, E, Ë.**
3. Kopjo emrat me shkrim shtypi dhe dore.

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1	**Klasa:** 1
Tema mësimore: **Veprimtari shkrimi (Diktim)**		**Situata e të nxënit:** **Pema me shkronja**	

***Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe**

Nxënësi:

- ✓ ***Kompetenca e komunikim dhe të shprehurit:*** Shpreh me gojë për 3-5 minuta para moshatarëve përjetimet dhe emocionet që e kanë shoqëruar gjatë dëgjimit të një kënge.
- ✓ ***Kompetenca e të nxënit:*** Mbikëqyr në mënyrë të pavarur përparimin e vet në një detyrë duke përdorur detyra të ndryshme. Korrigjon gabimet.
- ✓ ***Kompetenca qytetare:*** Bashkëpunon në grup dhe respekton rregullat e grupit.

***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore**

Nxënësi:

- Modelon bukur grafikun e shkronjave të mëdha dhe të vogla të dorës A,a,I,i,M,m,N,n,E,e,Ë,ë.
- Shkruan fjalë e fjali me shkronjat e dorës.
- Shkruan me shkronjat e shtypit dhe të dorës.
- Plotëson me shkrim shtypi e dore shkronjat mungesore në fjalë në pozicione të ndryshme.

Fjalë kyçe:
Abetare, alfabeti, balta, Ani, ura, ananasi, avioni.

Teknika dhe strategji:

- Vetëdiktim
- Demonstrim
- Punë individuale
- Punë në çifte/punë në dyshe
- Shkrim i lirë

Burimet e informacionit dhe mjete: Fletë të fotokopjuara, fletore shkrimi, modele shkronjash individuale, grafiku i shkronjave të mësuara **A, a, A,a**… të shtypit dhe të dorës.

Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë, Arte,Shoqëria dhe mjedisi,

Përshkrimi kontekstual i situatës

- ***Veprimtari paraprake***

Hapi 1. Dëgjohet kënga e Alfabetit të shkronjave.

”*Janë plot 36*
porsi motra rrinë bashkë
edhe një po të mungojë
Gjuha jonë do të çalojë....’

- Si ndjeheni kur këndohet?
- Çfarë mund të themi për të?

Paraqiten shkronjat A, I, M, N, E, Ë dhe kërkohet që nxënësit ta shkruajnë atë në të gjitha format si shtypi dhe dore si dhe dy fjalë që përmbajnë shkronjat në pozicione me lloje të ndryshme shkrimesh. Përsëritet veprimtaria për të gjashtë shkronjat e mësuara njëra pas tjetrës në mënyrë zinxhir apo edhe në dyshe.

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 2. Përsëritje leximi tek pema e shkronjave të mësuara. Lexim në korr. Përsëriten shkronjat e shtypit dhe grafiku i tyre. Nxiten nxënësit të thonë fjalë që fillojnë me **to,** shkruaj disa prej tyre.

Hapi 3. Ngre nxënës në tabelë që shkruajnë shkronjën dhe fjalë me të sipas radhës ose të çrregullt.

Hapi 4. Më pas nxënësit punojnë në fletët e punës sipas modelit. Plotësohet shkronja mungesore ose bëhet lidhja e fjalëve në fjali. Kopjohen dy-katër rreshta me shkronjat e mësuara në formën e vetëdiktimit ose (plotësohet faqja e fotokopjuar).

Demonstrim i rezultateve të arritura

Hapi 5. Nxënësit veprojnë me vetëdiktim në formën *a,A,i,I,m,M,n,N,e,E,ë,Ë*..(ose me kopjim nga modeli),ose në formën a,A, *a, A*,i,I,*i,I*……..(shtypi,dore).Me nxënësit veprohet edhe me diktim me shkrim dore për fjalët e fjalitë si p.sh., Ana, Eni, Mia, Mei, enë, Ami në anë. Ina nëna ime. Mami me nënën. Mina me mamin…
Vlerësimi i situatës: ***Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:*** ✓ Shkruan shkronjat e dorës duke u ndihmuar nga modeli. ✓ Shkruan shkronjat e mësuara me të gjitha elementet duke respektuar modelin. ✓ Shkruan fjalë me të kopjuar duke përdorur shkronjat në fillim, në trup të fjalës. ✓ Lexon fjalë me shkrim shtypi. ✓ Shkruan fjalë e fjali me të diktuar.
Detyrë shtëpie: **1.** Shkrim në rreshta me shkronjën e madhe dhe të vogël të dorës për të gjashta shkronjat **2.** Shkrim fjalësh me shkronja shtypi që përmbajnë ato. **3.** Vizatim dhe emërtim i fjalëve që përmbajnë gjashtë shkronjat. **4.** Kopjo modelin e klasës. **5.** Plotëso fletën e fotokopjuar.
Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	Shkalla:1	Klasa1
Tema mësimore: Punim i shkronjës R, r faqe 30 të Abetares		**Situata e të nxënit:** Në rërë	

***Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe**

Nxënësi:

- ***Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit:*** Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar.
- ***Kompetenca e të nxënit:*** Parashtron pyetje dhe përgjigje në lidhje me temën.
- ***Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin:*** Gjen të përbashkëtat dhe ndryshimet ndërmjet aktiviteteve që bën në shkollë me ato në shtëpi.

***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore**

Nxënësi:

- Shqipton tingullin **R**
- Gjen dhe thotë fjalë që fillojnë me ***R*** ose që përmbajnë shkronjën **R** në trup të tyre.
- Lexon fjalët e fjalorit të librit: *re, rëra, çadra, varka, ariu...*
- Plotëson sipas figurës fjalë mungesore.
- Analizon fjalë e fjali.
- Formon fjali/tekst sipas figurës kryesore të faqes.

Fjalë kyçe:

re, rëra, çadra, varka, ariu,era, ERA, RINA, RONI, ARMIRI, RINORI.

Teknika dhe strategji:

- Bisedë
- Marrëdhënie pyetje-përgjigje.
- Vëzhgim
- Demonstrim
- Punë individuale/ Çift

Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, modele shkronjash individuale, grafiku i shkronjës **R, r** të shtypit, foto me pamje nga një ditë në bregdet.

Lidhja me fushat e tjera: Lënda: Arte, matematikë, shkencë.

Përshkrimi kontekstual i situatës:

- ***Veprimtari paraprake:***

Hapi 1. Fillon me një vëzhgim të fotove nga një ditë në bregdet. Nxënësit këshillohen të vërejnë fotot dhe të komentojnë natyrën gjatë stinëve të ndryshme në bregdet, qiellin,detin dhe temperaturën. Sugjerohet edhe dëgjimi i këngës së shkronjës R.

Hapi 2. Në klasë nxënësit nxiten të diskutojnë për pushimet dhe të përshkruajnë stinën e verës që është aq e dashur për të gjithë. Shkruhet titulli në tabelë. ERA ME RINORIN.

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 3. Përsëritje në korr e 6 shkronjave të para. Dallimi i zanoreve dhe bashkëtingëlloreve. Nxënësit shkruajnë në A4 disa nga shkronjat e mësuara.

Hapi 4. Nxiten nxënësit të vërejnë figurën në libër dhe të formojnë fjali ose një tekst të shkurtër. Mësuesja ndihmon nxënësit me pyetje ndihmëse*: Në cilën stinë janë fëmijët në foto? Si është moti? Çfarë po bëjnë fëmijët? Çfarë dallojnë në det?Po ju kur shkoni me pushime si veproni?*

Hapi 5. Demonstron para klasës grafikun e shkronjës së vogël dhe të madhe të shtypit. Nxit nxënësit të bëjnë ngjashmëritë dhe dallimet me shkronjat e tjera dhe objekte të tjera rrethanore.

Nxiten nxënësit të gjejnë fjalë që fillojnë me **R**, e kanë në trup ose mbarojnë me **R**.
Plotësohet tabela kolektivisht.

R	**R**	**R**
Rona	ariu	hapur .....

Hapi 6. Nxënësit punojnë individualisht për plotësimin e shkronjave në fjalët mungesore.
Bëhet leximi dhe ndarja e tyre në rrokje. Ngre disa nxënës që shkruajnë fjalët në tabelë. VA□KA

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 7. Shkruan fjalinë kryesore në tabelë. *Era luan me Rinorin*. Ndahet në etiketa dhe fjalët në rrokje.
Individualisht nxënësit lidhin rrokjet në fjalë sipas kuptimit.
Lexohen nga nxënësit në zinxhir fjalët e fjalitë e formuara.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Shqipton tingullin **R.**
- ✓ Gjen dhe thotë fjalë që fillojnë me **R** ose që përmbajnë tingullin **R** në trup të tyre.
- ✓ Lexon fjalët e fjalorit të librit *re, rëra, çadra, varka, ariu, era...*
- ✓ Plotëson sipas figurës fjalë mungesore.
- ✓ Formon fjali/tekst sipas figurës kryesore të faqes.

Detyrë shtëpie:

1. Lexo dhe shkruaj fjalët e librit në fletore.
2. Shkruaj 10-15 fjalë me shkronjën **R.**

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	Shkalla:1	Klasa1
Tema mësimore: **Punim e shkrim i shkronjës R, r, Abetare pune faqe 28.**		**Situata e të nxënit:** Në rërë	

***Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe**

Nxënësi:

- ***Kompetenca e të nxënit:*** Ndjek udhëzimet e dhëna për të realizuar një veprim/detyrë.
- ***Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin:***
  - Identifikon burimet e nevojshme dhe i përdor në mënyrë të drejtë.
  - Grumbullon materialet e performancës së vet, për pasurimin e portofolit personal.

***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore**

Nxënësi:

- Shkruan shkronjës **R, r** të shtypit sipas modeli.
- Shkruan rrokje, fjalë.
- Formon fjalë duke lidhur rrokjet.
- I përgjigjet pyetjeve shkurt.
- Ndan fjalë në rrokje e shkronja.

Fjalë kyçe:

re, rëra, çadra, varka, ariu, era, ERA, RINA, RONI, ARMIRI, RINORI.

Teknika dhe strategji:

- Punë me grupe
- Analizë-sintezë
- Punë në grupe
- Shkrim i lirë

Burimet e informacionit dhe mjete: Shkronjat individuale dhe kolektive, fletore pune, etiketa me rrokje, fjalë sipas nivelit, shirita me fjalë me shkrim shtypi/figura që nxënësit mund të përdorin për të krijuar fjali.

Lidhja me fushat e tjera:

Lënda: Arte, matematikë

Përshkrimi kontekstual i situatës

- ***Veprimet paraprake***

Hapi 1. Klasa është e ndarë në grupe e punojnë me fishe sipas niveleve të ndryshme. Mësuesja ka përgatitur etiketa me rrokje, fjalë dhe fjali rreth situatës. Ia shpërndan nxënësve sipas nivelit. Nxënësit lexojnë me zë të lartë. Nxiten nxënësit të korrigjojnë njëri-tjetrin p.sh., *RA,RE. ARI, ERË, ORË M E RËRË.*

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 2. Paraqet grafikun e shkronjës **R, r.** Nxit të thonë ndryshimet dhe ngjashmëritë me shkronjat e tjera, p.sh me **P** ose objekte.

Hapi 3. Ngre nxënës në tabelë që shkruajnë disa nga rrokjet, fjalët dhe fjalitë e etiketa që u shpërndanë në pjesën e parë të orës.

Hapi 4. Punohet sipas kërkesave në fletoren e punës. Modelohet shkronja **R, r** shkruhen fjalët me shkronja mungesore dhe rrokjet me shkronja të vogla të shtypit. Nxënësit veprojnë me etiketat, duke u këshilluar të ndjekin drejtimin e shigjetave për ndarjen në rrokje e shkronja. Lidhin shkronjat në rrokje sipas akrepave të orës. Ndajnë fjalinë në etiketa dhe shkruajnë *Era e Rea me ariun e ri*. (Sa fjalë ka fjalia?). Bëhet kontrolli individual i fletores.

Hapi 5. Nxënësit shkruajnë me shkrim dore fjalët Miri, rërë, mimo...

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 6. Nxënësit lexojnë fjalët dhe fjalitë që krijuan gjatë ushtrimeve në fletoren e punës. Nxënësit më të përparuar mund të formojnë disa fjali në fletore më fjalët e fjalorit.*(re, rëra ,ariu.)*
Vlerësimi i situatës: ***Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:*** ✓ Shkruan shkronjës **R, r** të shtypit sipas modeli. ✓ Shkruan rrokje, fjalë. ✓ Formon fjalë duke bashkuar sipas kuptimit rrokjet. ✓ I përgjigjet pyetjeve shkurt.
Detyrë shtëpie: **1.** Formo nga fjali me fjalët: *re, rëra, çadra, varka, ariu, era.* **2.** Përgjigju me fjali të plotë pyetjeve. Ana luan (me kë?) *ariun*. Mami mori (çfarë?) orën. **3.** Kopjo bukur në fletore 2 ushtrimet e fundit të faqes 28.
Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1	**Klasa:** 1
Tema mësimore: **Punim e lexim i shkronjës R, r faqe 31 të Abetares**		**Situata e të nxënit:** Në rërë	

***Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe**

Nxënësi:

- ***Kompetenca e komunikim dhe të shprehurit:*** Dëgjon një tregim. Identifikon personazhet e një tregimi.
- ***Kompetenca e të nxënit:*** Parashtron pyetje dhe përgjigje në lidhje me temën.

***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore** Nxënësi: - Lexon fjalë, fjali. - I përgjigjet me fjali të thjeshtë pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit. - Rilexon tekstin për të kuptuar përmbajtjen e tij. - Lidh pjesën që lexon me filma që ka parë, ose me përvoja personale.	**Fjalë kyçe:** *rërë, rosa, roboti, re, rë, ra,mi, am, rosën, treni. roboti, Emën.* **Teknika dhe strategji :** ❖ Parashikim me terma paraprakë ❖ Marrëdhënie pyetje-përgjigje ❖ Lexim zinxhir ❖ Analizë-sintezë e fjalisë
Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, modele shkronjash individuale, grafiku i shkronjës **R, r** të shtypit, foto me pamje nga pushimet në stinën e verës, magnetofon, lodra për fëmijë ari, treni, rosa, roboti.	**Lidhja me fushat e tjera:** Matematikë, muzikë

Përshkrimi kontekstual i situatës:

- ***Veprimtari paraprake***

Hapi 1: Shkruaj në tabelë titullin e tregimit NË RËRË dhe nxit nxënësit të formojnë fjali ose një tekst të shkurtër sipas fantazisë ose një filmi apo përvojës personale. *(Këshillohen të mos përsëritin tregimin e librit nëse e kanë lexuar më parë, por të veprojnë me fantazi).*

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 2: Mësuesja këshillon nxënësit të mbyllin sytë dhe të përfytyrojnë një ditë të nxehtë vere në bregdet dhe ata janë duke luajtur. Bëhet krahasimi me krijimet e nxënësve.

Hapi 3: Lexon me intonacion 2-3 herë tregimin. Më pas pyet nxënësit:

Çfarë përfytyruat? Me kë ishit? Çfarë po bënit ju? Si u ndjeve kur dëgjove tregimin?

Në sfond mund të vihet melodia: 4 stinët e Vivaldit (vera).

Hapi 4: Hapen librat. Nxit nxënësit të përshkruajnë figurën. Bëhet leximi i rrokjeve RI, RA, RE, RË, MI... në korr. Lexohet tregimi disa herë. Kujtohen disa lojëra e mjete që fëmijët përdorin më shumë në bregdet. Shpjegohet përdorimi i pikës dhe shkronjës së madhe në emrat e përveçëm dhe në fillim të fjalisë.

Hapi 5: Më pas lihen nxënësit të lexojnë në heshtje për disa minuta tregimin. Në varësi të numrit të nxënësve në klasë mësuesja bën leximin e tregimit në zinxhir me nga një ose më shumë fjali.

Mund të kërkohet nga nxënësit edhe të lexojnë fjalinë e parë, të dytë e kështu me radhë ose me rend të ngatërruar. Nxënësit që paraqesin vështirësi mund t'i pyesë në fjalë të veçanta të thjeshta. ▪ ***Demonstrim i rezultateve të arritura*** **Hapi 6:** Diskutim rreth përmbajtjes. *Si e ka titullin tregimi? Si quhen fëmijët që marrin pjesë? Çfarë bënë ata? Me çfarë po luajnë?* **Hapi 7:** Nxënësit në mënyrë individuale plotësojnë fjalët me shkronja mungesore ROSA, TRENI, ROBOTI dhe i përdorin ato në fjali. Diskutojnë në dyshe më shokun e bankës për leximin e fjalive dhe ndarjen e fjalisë në fjalë.
Vlerësimi i situatës: ***Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:*** ✓ Lexon fjalë, fjali. ✓ I përgjigjet me fjali të thjeshtë pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit. ✓ Rilexon tekstin për të kuptuar përmbajtjen e tij. ✓ Lidh pjesën që lexon me filma që ka parë, me përvoja personale.
Detyrë shtëpie: **1.** Lexo tregimin disa herë. **2.** Kopjo 3 fjali që të pëlqejnë më shumë nga tregimi. **3.** Kopjo rrokjet me shkrim shtypi.
Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1	**Klasa:** 1
Tema mësimore **Ushtrime aplikative për shkrim dore, shkronja R,r.**		**Situata e të nxënit:** Në rërë	

***Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe**

Nxënësi:

- ***Kompetenca e të nxënit:*** Mbikëqyr në mënyrë të pavarur përparimin e vet në një detyrë duke përdorur detyra të ndryshme. Korrigjon gabimet.
- ***Kompetenca qytetare:*** Bashkëpunon në grup dhe respekton rregullat e grupit.

***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore**

Nxënësi:

- Shkruan shkronjat **R, r** të dorës duke u ndihmuar nga modeli.
- Shkruan shkronjat **R, r** me të gjitha elementet duke e lidhur me shkronjat e tjera.
- Shkruan fjalë me të kopjuar duke përdorur shkronjën **R, r** në fillim, në trup të fjalës.
- Lexon fjalë me shkrim dore.

Fjalë kyçe:

re, rë, rëra, Rea me Erën në rërë

Teknika dhe strategji:

- Vetëdiktim
- Lexim në korr
- Demonstrim
- Punë individuale
- Punë në çifte/punë në dyshe
- Lexim individual

Burimet e informacionit dhe mjete: Fletore e punës, fletore shkrimi, modele shkronjash individuale, grafiku i shkronjës **R, r** të shtypit dhe të dorës, fishe me fjalë të mësuara.

Lidhja me fushat e tjera:

Arte

Përshkrimi kontekstual i situatës

- ***Veprimtari paraprake***

Hapi 1. Mësuesja nxjerr para klasës disa foto me pamje të stinës së verës dhe nxënësit shkruajnë në fletore ose fletë pa folur, në formën e vetëdiktimit ose përgatit etiketa të gatshme për secilin nxënës. Lexojnë fjalët që kanë shkruar me shkrim shtypi. (rërë, re, ariu në rërë...)

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 2. Përsëritje e shkronjave të dorës të mësuara deri më tani. Lexim në korr.
Përsëriten shkronjat **R, r** të shtypit dhe grafiku i tyre.
Nxiten nxënësit të thonë fjalë që fillojnë me **R,** shkruaj disa prej tyre.

Hapi 3. Shpjegoj grafikun e shkronjës **R, r** të dorës dhe e shoqëruar me lëvizjen në ajër të nxënësve.
Shpjegohen elementet përbërës të saj.
Bëhet dallimi me shkronjën **R, r** të shtypit.
Ngre nxënës në tabelë që shkruajnë shkronjën dhe lidhjen e saj me shkronjat e tjera në fjalë. re, Era

Hapi 4. Më pas nxënësit punojnë në fletoren e punës sipas modelit. Vështirësi paraqet lidhja e shkronjës **r** me shkronjat e tjera/ose grepi në të majtë, vëzhgohet ky element dhe përforcohet. Kujdes edhe me shkronjën e madhe të dorës. Nxënësit lexojnë fjalët dhe fjalinë që shkruan me shkrim dore.

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 5. Diktim me shkronja dore.

ra, re, rë, ri, mirë, ora , Orë me rërë, Rea, Erë e mirë, Era me Rean rërë. Nxënësit lexojnë fjalët që shkruajnë me shkronja dore.
Vlerësimi i situatës: ***Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:*** ✓ Shkruan shkronjat **R, r** të dorës duke u ndihmuar nga modeli. ✓ Shkruan shkronjat **R, r** me të gjitha elementet duke e lidhur me shkronjat e tjera. ✓ Shkruan fjalë me të kopjuar duke përdorur shkronjën **r, R** në fillim, në trup të fjalës ✓ Lexon fjalë me shkrim dore.
Detyrë shtëpie: **1.** Shkruaj nga 3-5 rreshta me shkronja/ rrokje. **2.** Shkruaj fjalë ose fjali me shkronjën **R.r**. **3.** Kopjo 4 rreshta me modelin *a,a,A,A,i,I,N,m,e,R,r* **4.** Paraqit në forma të ndryshme shkronjën r, R.
Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1	**Klasa:** 1
Tema mësimore: **Punim i faqes 30-31 të Abetares. Në rërë**		**Situata e të nxënit:** Në rërë	

***Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe**

Nxënësi:

- ***Kompetenca e komunikim dhe të shprehurit:*** Shpreh mesazhin e një teksti të thjeshtë, nëpërmjet njërës nga format shprehëse: të folurit, shkrimit.
- ***Kompetenca e të nxënit:*** Parashtron pyetje dhe përgjigjet në pyetjet për temën në njërën nga format e të shprehurit.
- ***Kompetenca qytetare:*** Diskuton dhe bashkëpunon me anëtarët e grupit.

***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore**

Nxënësi:

- Qarkon shkronjën **R** në tekst të panjohur.
- Lidh sipas kuptimit fjalët për të krijuar fjali.
- Plotëson fjalë mungesore.
- Shkruan me të kopjuar ose të diktuar.
- Lexon fjalë, fjali me shkrim dore.

Fjalë kyçe:

Rërë, treni, rosa, roboti, ariun, tren, Rinori, Ema, Roni

Teknika dhe strategji:

- Punë individuale
- Lexim fjalësh, fjalish
- Analizë – sintezë
- Punë në dyshe/grup

Burimet e informacionit dhe mjete:

Libri i nxënësit, modele shkronjash individuale, grafiku i shkronjës R, r të shtypit, foto me pamje nga stina e verës.

Lidhja me fushat e tjera:

Lënda: Matematikë, art pamor

Përshkrimi kontekstual i situatës

- ***Veprimtari praktike***

Hapi 1. Mësuesja shpërndan një tekst *(mundësisht me temë sipas situatës)* në të cilën nxënësit duhet të qarkojnë shkronjën **R**, të lexojnë fjalë, fjali sipas nivelit të nxënësve.

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 2. Përsëritje në korr e shkronjave të shtypit dhe të dorës, të mësuara deri tani.
Nxënësit tregojnë se sa shkronja **R** kanë gjetur në tekstet e mësipërme.
Për nxënës më të përparuar mund t'u kërkohet të lexojnë fjalë ose fjali.

Hapi 3. Punohet me pjesën e fundit të faqeve **30** dhe **31.**
Rilexojnë fjalinë : ***Era luan me Rinorin.*** Bëhet ndarja e fjalëve në etiketa.
U kërkohet nxënësve të gjejnë sa fjalë ka fjalia të dallojnë fjalën e parë, të dytë e kështu me radhë si dhe në rend të ngatërruar.

Hapi 4. Lihen nxënësit të punojnë individualisht për lidhjen e fjalëve sipas kuptimit në fjali, fundi i faqes **30,** për ndarjen e fjalëve në rrokje e shkronja si dhe bashkimin e rrokjeve në fjalë në të djathë të faqes(a+rë,e+rë). Me të njëjtën mënyrë punohet për ushtrimet e fundit të faqes **31** ndarjen e fjalëve të fjalisë nga njëra-tjetra dhe përdorimi i shkronjës së madhe. ***Roni mori ariun.***
Mund të aplikohet dhe puna në dyshe ose grup sipas përbërjes së nxënësve të klasës.
Lexohen fjalitë dhe korrigjojnë ata që nuk i kanë lidhur ose ndarë saktë. Bëhet rileximi nga nxënësit që nuk e kishin shkruar saktë që në fillim.

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 5. Në fletoren e klasës, nxënësit shkruajnë me shkrim dore fjalët dhe fjalitë që formuan në fundin e faqes **30** dhe **31**. Lexojnë fjalitë me shkrim dore nga fletorja e tyre.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Qarkon shkronjën **R** në tekst të panjohur.
- ✓ Lidh sipas kuptimit fjalët për të krijuar fjali.
- ✓ Plotëson fjalë mungesore.
- ✓ Shkruan me të kopjuar ose të diktuar.
- ✓ Lexon fjalë fjali me shkrim dore.

Detyrë shtëpie:

1. Kopjo me shkronja dore fjalitë që formove në klasë.
2. Shkruaj 3 fjali për stinën e verës.
3. Vizato pamje nga stina e verës.
4. Përdor në fjali të thjeshta fjalët e librit.

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1	**Klasa:** 1
Tema mësimore: Punim i shkronjës U, u faqe 32 të Abetares		**Situata e të nxënit:** Në lumë	

***Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe**

Nxënësi:

- ***Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit:*** Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar.
- ***Kompetenca e të nxënit :*** Parashtron pyetje dhe përgjigje në lidhje me temën.
- ***Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin:*** Gjen të përbashkëtat dhe ndryshimet ndërmjet aktiviteteve që bën në shkollë me ato në shtëpi dhe ambiente dhe i përshkruan në mënyrë individuale përmes njërës nga format e të shprehurit në grup.

***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore**

Nxënësi:

- Shqipton tingullin **U**
- Gjen dhe thotë fjalë që fillojnë me **U** ose që përmbajnë shkronjën **U** në trup të tyre.
- Lexon fjalët e fjalorit të librit: *urë, gurë, miu, lumë, unë...*
- Plotëson sipas figurës fjalë me shkronja mungesore.
- Analizon fjalë e fjali.
- Formon rrokje, fjalë, fjali/ tekst sipas figurës kryesore të faqes.

Fjalë kyçe:

Guri, miu, ura, unë, lumë, Umi në lumë, mua më

Teknika dhe strategji:

- Bisedë
- Marrëdhënie pyetje-përgjigje.
- Vëzhgim
- Demonstrim
- Punë individuale/ Çift

Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, modele shkronjash individuale, grafiku i shkronjës **U, u** të shtypit, foto me pamje nga një ditë në breg të lumit, lodra si miu, guri, ariu...

Lidhja me fushat e tjera: Lënda: Arte, matematikë, shkencë.

Përshkrimi kontekstual i situatës:

- ***Veprimtari paraprake:***

Hapi 1. Fillon me një vëzhgim të fotove nga një ditë në breg të lumit. Nxënësit këshillohen të vërejnë fotot dhe të komentojnë natyrën në breg të lumit, nxënësit mund të listojnë emra lumenjsh të vendit tonë. Sugjerohet edhe dëgjimi i këngës së shkronjës **U**.(Ty, ty, ty/këmbët e një ure kam/ve⍰ të vëna mbrapsht,i kam,i kam.) *Mbi dy brigje, qëndron shtrirë,*

Këmbët n'ujë ngulur mirë,

Përmbi të ,makinat shkojnë,

Nën të ujërat gurgullojnë. Me nxënësit mund të punohet gjëegjëza për urën.

Hapi 2. Në klasë nxënësit nxiten të diskutojnë për ditët e pushimit si i organizojnë dhe ku i kalojnë(si dhe nxiten për praninë e kafshëve shtëpiake). Shkruhet titulli në tabelë. UMI NË LUMË.

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 3. Përsëritje në korr e 7 shkronjave të para. Dallimi i zanoreve dhe bashkëtingëlloreve nga njëra-tjetra. Nxënësit shkruajnë në A4 disa nga shkronjat e mësuara.

Hapi 4. Nxiten nxënësit të vërejnë figurën në libër dhe të formojnë fjali ose një tekst të shkurtër. Mësuesja ndihmon nxënësit me pyetje ndihmëse *: Në cilin vend janë fëmijët në foto? Ju ka ndodhur të kaloni mbi një urë? Çfarë po bëjnë fëmijët? Çfarë po kërkojnë fëmijët në lumë ?Po ju ju ka ndodhur të*

humbni ndonjë lodër në lumë? Cilat janë disa nga lodrat e preferuara që merrni gjithnjë me vete? Ku shkoni më shpesh për fundjavë? Dini të ndërtoni me letër varka që notojnë në lumë?

Hapi 5. Demonstron para klasës grafikun e shkronjës së vogël dhe të madhe të shtypit. Nxit nxënësit të bëjnë ngjashmëritë dhe dallimet me shkronjat e tjera dhe objekte të tjera rrethanore.

- Nxiten nxënësit të gjejnë fjalë që fillojnë me **U**, e kanë në trup ose mbarojnë me **U**.

Plotësohet tabela kolektivisht

U	U	U
Umi	lumë	ariu .....

Hapi 6. Nxënësit punojnë individualisht për plotësimin e shkronjave në fjalët që mungojnë.

Bëhet leximi dhe ndarja e tyre në rrokje. Ngre disa nxënës që shkruajnë fjalët në tabelë. C RI..

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 7. Shkruan fjalinë kryesore në tabelë. *Mbi lumë ka urë*. Ndahet fjalia në etiketa dhe fjalët në rrokje.

Individualisht nxënësit lidhin rrokjet në fjalë sipas kuptimit.

Lexohen nga nxënësit në zinxhir fjalët e fjalitë e formuara e madje përdoren ato në fjali.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Shqipton tingullin **U**
- ✓ Gjen dhe thotë fjalë që fillojnë me **U** ose që përmbajnë tingullin **U** në trup të tyre.
- ✓ Lexon fjalët e fjalorit të librit *miu, urë, gurë, urim, ariu, miu....*
- ✓ Plotëson sipas figurës fjalë mungesore.
- ✓ Formon fjali/ tekst sipas figurës kryesore të faqes.

Detyrë shtëpie:

1. Lexo dhe shkruaj fjalët e librit në fletore.
2. Shkruaj 10-15 fjalë me shkronjën **U.**
3. Shkruaj fjali me fjalë që kanë në trup shkronjën **U**.

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1	**Klasa:** 1
Tema mësimore: **Punim e shkrim i shkronjës U, u Abetare pune faqe 29**		**Situata e të nxënit:** Në lumë	

***Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe**

Nxënësi:

- ***Kompetenca e të nxënit:*** Ndjek udhëzimet e dhëna për të realizuar një veprim/detyrë.
- ***Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin:***
  - Identifikon burimet e nevojshme dhe i përdor në mënyrë të drejtë.
  - Grumbullon materialet e performancës së vet,për pasurimin e portofolit personal.

***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore**

Nxënësi:

- Shkruan shkronjës **U, u** të shtypit sipas modeli.
- Shkruan rrokje, fjalë.
- Formon fjalë duke lidhur rrokjet.
- I përgjigjet pyetjeve shkurt.
- Ndan fjalë në rrokje e shkronja.
- Plotëson falinë me fjalë sipas figurave.

Fjalë kyçe:

unë,urë,mi,mu,um,mi,im,muri, Ina mori ariun. Ana mori miun.

Teknika dhe strategji:

- Punë me grupe
- Analizë-sintezë
- Punë në grupe
- Shkrim i lirë

Burimet e informacionit dhe mjete: Shkronjat individuale dhe kolektive, fletore pune, etiketa me rrokje, fjalë sipas nivelit,shirita me fjalë me shkrim shtypi/figura(ose lodra) që nxënësit mund të përdorin për të krijuar fjali.

Lidhja me fushat e tjera:

Lënda: Arte, matematikë

Përshkrimi kontekstual i situatës

- ***Veprimet paraprake***

Hapi 1. Me nxënësit prezantohet foto e faqes *urë në lumë* dhe nxitet biseda rreth tyre.Ka lumë në qytetin/fshatin tuaj. Po urë mbi të ka? Si është ndërtuar ajo prej druri apo betoni?

Hapi 2. Klasa është e ndarë në grupe e punojnë me fishe sipas niveleve të ndryshme. Mësuesja ka përgatitur etiketa me rrokje, fjalë dhe fjali rreth situatës. Ia shpërndan nxënësve sipas nivelit. Nxënësit lexojnë me zë të lartë. Nxiten nxënësit të korrigjojnë njëri – tjetrin. p.sh *RU, UR, MU, UM, UNË,URË, MURI.*

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 2. Paraqet grafikun e shkronjës **U, u.** Nxit të thonë ndryshimet dhe ngjashmëritë me shkronjat e tjera, p.sh me **n** me kokë poshtë ose objekte me formë të ngjashme.

Hapi 3. Ngre nxënës në tabelë që shkruajnë disa nga rrokjet, fjalët dhe fjalitë e etiketave që u shpërndanë në pjesën e parë të orës.

Hapi 4. Punohet sipas kërkesave në fletoren e punës. Modelohet shkronja **u, U** shkruhen fjalët me shkronja mungesore dhe rrokjet me shkronja të vogla të shtypit. Nxënësit veprojnë me etiketat, duke u këshilluar të ndjekin drejtimin e shigjetave për ndarjen e fjalëve në rrokje e shkronja. Lidhin shkronjat në rrokje sipas shigjetave. Shënojnë me x fjalët që kanë në trup shkronjën **U**. Plotësojnë fjalinë me fjalët që janë paraqitur në figura dhe shkruajnë *Ina me ariun. e Ana me miun.* (Sa fjalë kanë fjalitë?). Bëhet kontrolli individual i fletores.

Hapi 5. Nxënësit shkruajnë me shkrim shtypi fjalët miu, ujku, ariu...(ato mund të përdoren në fjali nga nxënësit e tjerë. ▪ ***Demonstrim i rezultateve të arritura*** **Hapi 6.** Nxënësit lexojnë fjalët dhe fjalitë që krijuan gjatë ushtrimeve në fletoren e punës. Nxënësit më të përparuar mund të formojnë disa fjali në fletore më fjalët e fjalorit.*(unë,urë,miu..)*
Vlerësimi i situatës: ***Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:*** ✓ Shkruan shkronjës **U, u** të shtypit sipas modeli. ✓ Shkruan rrokje, fjalë. ✓ Formon fjalë duke bashkuar sipas kuptimit rrokjet. ✓ I përgjigjet pyetjeve shkurt.
Detyrë shtëpie: **1.** Formo nga fjali me fjalët : *unë, urë, miu, muri, ariu, ura.* **2.** Kopjo 2 herë fjalitë e faqes 28. **3.** Kopjo bukur në fletore tabelën e rrokjeve të faqes 28.
Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1	Klasa: 1
Tema mësimore: **Punim e lexim i shkronjës U, u faqe 33 të Abetares**		**Situata e të nxënit:** Në lumë	

***Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe**

Nxënësi:

- ***Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit:***
  - Dëgjon/krijon një tregim. Identifikon personazhet e një tregimi.
  - Shpreh mesazhin e një teksti të thjeshtë letrar, përmes një forme shprehjeje: të folurit, lojës me role.
- ***Kompetenca e të nxënit:*** Parashtron pyetje dhe përgjigje në lidhje me temën.

***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore**

Nxënësi:

- Lexon fjalë, fjali.
- I përgjigjet me fjali të thjeshtë pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit.
- Rilexon fjalitë/tekstin për të kuptuar përmbajtjen.
- Lidh pjesën që lexon me filma që ka parë, ose me përvoja personale.

Fjalë kyçe:*lumë,Umi,unë,Ani, urra,mami,miu,rërë,rera,muri, Ani,*

Teknika dhe strategji :

- Parashikim me terma paraprakë
- Marrëdhënie pyetje-përgjigje
- Lexim zinxhir
- Analizë- sintezë e fjalisë

Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, modele shkronjash individuale, grafiku i shkronjës **U, u** të shtypit, foto me pamje nga brigjet e një lumi e urës mbi të,magnetofon,lodra për fëmijë ariu,qeni,miu.

Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë, muzikë

Përshkrimi kontekstual i situatës:

- ***Veprimtari paraprake***

Hapi 1: Shkruaj në tabelë titullin e tregimit NË LUMË dhe nxit nxënësit të formojnë fjali ose një tekst të shkurtër sipas fantazisë ose një filmi apo përvojës personale. *(Këshillohen të mos përsëritin tregimin e librit nëse e kanë lexuar më parë por të veprojnë më fantazi.)*

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 2: Mësuesja këshillon nxënësit të mbyllin sytë dhe të përfytyrojnë një ditë në bregdet të lumit dhe ata janë duke luajtur. Njërit prej shokëve iu ra një qen/lodër në lumë. Si vepruat? Bëhet krahasimi me krijimet e nxënësve.

Hapi 3: Lexon me intonacion 2-3 herë tekstin. Më pas pyeten nxënësit:
Çfarë përfytyruat? Me kë ishit? Çfarë po bënit ju? Si u ndjeve kur dëgjove tregimin?
Në sfond mund të vihet melodia: 4 stinët e Vivaldit (pranvera/ose një gurgullimë uji në lumë).

Hapi 4: Hapen librat. Nxit nxënësit të përshkruajnë figurën. Bëhet leximi i fjalive në korr. Umi ra në lumë. Ani hyri në lumë. Ani mori Umin nga lumi. Lexohet teksti disa herë. Listohen disa lojëra sende që merr me vete lumi. Në figurat e vogla në të djathtë të faqes nxënësit shënojnë me x figurën që

plotëson kuptimin e fjalisë. Umi ra në lumë. Ani mori qenin. Kujtohet përdorimi i pikës dhe shkronjës së madhe në emrat e përveçëm dhe në fillim të fjalisë.

Hapi 5: Më pas i japin me gojë një fund të lumtur duke e shoqëruar me thirrjen URRA! Në varësi të numrit të nxënësve në klasë mësuesi/ja bën leximin e tekstit në zinxhir me nga një ose më shumë fjali. Mund të kërkohet nga nxënësit edhe të lexojnë fjalinë e parë, të dytë e kështu me radhë ose me rend të ngatërruar. Nxënësit që paraqesin vështirësi mund t'i pyesë në fjalë të veçanta të thjeshta.

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 6: Diskutim rreth përmbajtjes. *Si e ka titullin tregimi? Si quhen fëmijët që marrin pjesë? Çfarë bënë ata? Me çfarë po luajnë?Po qenushin Umi kush e ndihmoi të dilte nga lumi?...*

Hapi 7: Nxënësit në mënyrë individuale plotësojnë fjalën me shkronja mungesore MURI dhe bashkojnë rrokjet në fjalë në fund të faqes. I përdorin ato në fjali. Diskutojnë në dyshe më shokun e bankës për leximin e fjalive dhe formimin e fjalëve.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Lexon fjalë, fjali.
- ✓ I përgjigjet me fjali të thjeshtë pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit.
- ✓ Rilexon tekstin për të kuptuar përmbajtjen e tij.
- ✓ Lidh pjesën që lexon me filma që ka parë, me përvoja personale.

Detyrë shtëpie:

1. Lexo tregimin disa herë.
2. Kopjo 3 fjali nga teksti.
3. Kopjo rrokjet e fjalët me shkrim shtypi.

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1	**Klasa:** 1
Tema mësimore **Ushtrime aplikative për shkrim dore, shkronja** *U,u.*		**Situata e të nxënit:** Në lumë	

***Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe**

Nxënësi:

- ***Kompetenca e të nxënit:*** Mbikëqyr në mënyrë të pavarur përparimin e vet në një detyrë duke përdorur detyra të ndryshme. Korrigjon gabimet.
- ***Kompetenca qytetare:*** Bashkëpunon në grup dhe respekton rregullat e grupit.

***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore**

Nxënësi:

- Shkruan shkronjat **U, u** të dorës duke u ndihmuar nga modeli.
- Shkruan shkronjat **U, u** me të gjitha elementet duke e lidhur me shkronjat e tjera.
- Shkruan fjalë me të kopjuar duke përdorur shkronjën **U, u** në fillim, në trup të fjalës.
- Lexon fjalë me shkrim dore.

Fjalë kyçe:

urë,lumë,ura e re,muri i ri, Umi me Anin në urë.

Teknika dhe strategji:

- Vetëdiktim
- Lexim në korr
- Demonstrim
- Punë individuale
- Punë në çifte/punë në dyshe
- Lexim individual

Burimet e informacionit dhe mjete: Fletore e punës, fletore shkrimi, modele shkronjash individuale, grafiku i shkronjës **U, u** të shtypit dhe të dorës, etiketa me fjalë të mësuara, fletë të fotokopjuara.

Lidhja me fushat e tjera:

Arte, matematikë

Përshkrimi kontekstual i situatës

- ***Veprimtari paraprake***

Hapi 1. Mësuesi/ja nxjerr para klasës disa foto me pamje të murit dhe urës dhe nxënësit shkruajnë në fletore ose fletë, në formën e vetëdiktimit ose përgatit etiketa të gatshme për secilin nxënës. Lexojnë fjalët që kanë shkruar me shkrim shtypi.(urë,ariu,ura në lumë, muri i ri, ariu i ri...)

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 2. Përsëritje e shkronjave të dorës të mësuara deri më tani.Nxënësit i paraqesin me shkrim në dërrasë. Lexim në korr.

Përsëriten shkronjat **u, U** të shtypit dhe grafiku i tyre.

Nxiten nxënësit të thonë fjalë që fillojnë me **U,** shkruhen nga mësuesi/ja disa prej tyre.

Hapi 3. Shpjegoj grafikun e shkronjës **U, u** të dorës dhe e shoqëruar me lëvizjen në ajër të nxënësve. Sqarohen elementet përbërës të saj. Nëse ka mundësi mund të paraqitet edhe grafiku i shkronjës me video/projektor.

Bëhet dallimi me shkronjën **U, u** të shtypit.

Ngre nxënës në tabelë që shkruajnë shkronjën dhe lidhjen e saj me shkronjat e tjera në fjalë. *ru,Umi.*

Hapi 4. Më pas nxënësit punojnë në fletoren e punës sipas modelit. Vështirësi paraqet lidhja e shkronjës **u** me shkronjat e tjera/ose grepi në të majtë, vëzhgohet ky element dhe përforcohet. Kujdes edhe me shkronjën e madhe të dorës. Nxënësit lexojnë fjalët dhe fjalinë që shkruajnë me shkrim dore.

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 5. Diktim me shkronja dore.

ua, ru, urë, uri, muri, ariu , Muri i ri, Umi me Inën në urë,urim, Muri ruan mirë, miu.

Nxënësit lexojnë fjalët që shkruajnë me shkronja dore.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Shkruan shkronjat **U, u** të dorës duke u ndihmuar nga modeli.
- ✓ Shkruan shkronjat **U, u** me të gjitha elementet duke e lidhur me shkronjat e tjera .
- ✓ Shkruan fjalë me të kopjuar duke përdorur shkronjën **u, U** në fillim, në trup të fjalës.
- ✓ Lexon fjalë me shkrim dore.

Detyrë shtëpie:

1. Shkruaj nga 3-5 rreshta me shkronja/ rrokje.
2. Shkruaj fjalë ose fjali me shkronjën **U. u.**
3. Kopjo 4 rreshta me modelin *a,i,A,U,m,I,N,r,e,R,u*
4. Paraqit në forma të ndryshme shkronjën **u,U**.

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	Shkalla:1	Klasa1
Tema mësimore: **Punim i faqes 32-33 të Abetares . Në lumë.**		**Situata e të nxënit:** Në lumë	

***Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe**

Nxënësi:

- ***Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit :*** Shpreh mesazhin e një teksti të thjeshtë, nëpërmjet njërës nga format shprehëse: të folurit, shkrimit,dramatizimit.
- ***Kompetenca e të nxënit:*** Parashtron pyetje dhe përgjigjet në pyetjet për temën në njërën nga format e të shprehurit.
- ***Kompetenca qytetare:*** Diskuton dhe bashkëpunon me anëtarët e grupit.

***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore**

Nxënësi:

- Qarkon shkronjën **U** në tekst të panjohur.
- Lidh sipas kuptimit fjalët për të krijuar fjali.
- Plotëson fjalët me shkronja mungesore.
- Shkruan me të kopjuar ose të diktuar.
- Lexon fjalë, fjali me shkrim dore.

Fjalë kyçe:

urë, urimi,Urra, guri, ariun, lumin,
Umi ra, Umi në lumë, Ani

Teknika dhe strategji:

- Punë individuale
- Lexim fjalësh, fjalish
- Analizë – sintezë
- Punë në dyshe/grup

Burimet e informacionit dhe mjete:

Libri i nxënësit, modele shkronjash individuale, grafiku i shkronjës U, u të shtypit, foto me pamje nga brigjet e një lumi, kafshë lodra ariu, miu, qeni,varka prej letre...

Lidhja me fushat e tjera:

Lënda: Matematikë, art pamor

Përshkrimi kontekstual i situatës

- ***Veprimtari praktike***

Hapi 1. Mësuesja shpërndan një tekst *(mundësisht me temë sipas situatës)* në të cilën nxënësit duhet të qarkojnë shkronjën **U**, të lexojnë fjalë, fjali sipas nivelit të nxënësve. Mund të përdoren edhe varkat prej letre me shkronja e fjalë që lundrojnë mbi urë.

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 2. Përsëritje në korr e shkronjave të shtypit dhe të dorës, të mësuara deri tani.
Nxënësit tregojnë se sa shkronja **U** kanë gjetur në tekstet e mësipërme.
Për nxënës më të përparuar mund t'u kërkohet të lexojnë fjalë ose fjali në etiketa.
Hapi 3. Punohet me pjesën e fundit të faqeve **32** dhe **33**.
Rilexojnë fjalinë: ***Mbi lumë ka urë. Ani mori Umin nga lumi.*** Bëhet ndarja e fjalëve në etiketa.
U kërkohet nxënësve të gjejnë sa fjalë ka fjalia të dallojnë fjalën e parë, të dytë e kështu me radhë si dhe në rend të ngatërruar.
Hapi 4. Lihen nxënësit të punojnë individualisht për lidhjen e fjalëve e rrokjeve sipas kuptimit në fjali e fjalë, fundi i faqes **32,** për ndarjen e fjalëve në rrokje e shkronja. Me të njëjtën mënyrë punohet për ushtrimet e fundit të faqes **33** për lidhjen e rrokjeve në fjalë si dhe përdorimin në fjali.
Nxënësit përdorin shkronjën e madhe në shkrimin e fjalive. **P.sh.,** ***Mami në urë. Umi ra.***
Mund të aplikohet dhe puna në dyshe ose në grup sipas përbërjes së nxënësve të klasës.

Lexohen fjalitë dhe korrigjojnë ata që nuk i kanë lidhur ose ndarë saktë. Bëhet rileximi nga nxënësit që nuk e kishin shkruar saktë që në fillim si dhe stimulohen ato që krijuan fjali të ve anta. ▪ ***Demonstrim i rezultateve të arritura*** **Hapi 5.** Në fletoren e klasës, nxënësit shkruajnë me shkrim dore fjalët dhe fjalitë që formuan në fundin e faqes **32** dhe **33.** Lexojnë fjalitë me shkrim dore nga fletorja e tyre.
Vlerësimi i situatës: ***Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:*** ✓ Qarkon shkronjën **U** në tekste të panjohura. ✓ Lidh sipas kuptimit fjalët për të krijuar fjali. ✓ Plotëson fjalët me shkronja mungesore. ✓ Shkruan me të kopjuar ose të diktuar. ✓ Lexon fjalë fjali me shkrim dore.
Detyrë shtëpie: **1.** Kopjo me shkronja dore fjalitë që formove në klasë. **2.** Shkruaj 3 fjali për situata në lumë. **3.** Vizato pamje nga lumi nën urë. **4.** Përdor në fjali të thjeshta fjalët e librit.
Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1	**Klasa:** 1
Tema mësimore: **Punim i shkronjës L, l faqe 34 të Abetares**		**Situata e të nxënit:** Me lahutë	

***Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe**

Nxënësi:

- ***Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit:*** Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar.
- ***Kompetenca e të nxënit:*** Parashtron pyetje dhe përgjigje në lidhje me temën.
- ***Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin:*** Gjen të përbashkëtat dhe ndryshimet ndërmjet aktiviteteve që bën në shkollë me ato në shtëpi apo vende të ndryshme në natyrë.

***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore**

Nxënësi:

- Shqipton tingullin **L**
- Gjen dhe thotë fjalë që fillojnë me **L** ose që përmbajnë shkronjën **L** në trup të tyre.
- Lexon fjalët e fjalorit të librit: *mali, lopa, lahuta, luan,, lumi...*
- Plotëson sipas figurës fjalët me shkronja mungesore.
- Analizon fjalë e fjali.
- Formon fjali/ tekst sipas figurës kryesore të faqes.

Fjalë kyçe:

Lule, lopa, limoni, lumi, mali, luan, lahuta,LULI LUAN ME LAHUTË. Limon.

Teknika dhe strategji:

- Bisedë
- Marrëdhënie pyetje-përgjigje.
- Vëzhgim
- Demonstrim
- Punë individuale/ Çift

Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, modele shkronjash individuale, grafiku i shkronjës **L, l** të shtypit, foto me pamje nga një ditë në mal(foto të fëmijëve me veshje popullore), lahutë lodër.

Lidhja me fushat e tjera: Lënda: Arte, matematikë, shkencë.

Përshkrimi kontekstual i situatës:

- ***Veprimtari paraprake:***

Hapi 1. Fillon me një vëzhgim të fotove nga një ditë në mal. Nxënësit këshillohen të vërejnë fotot dhe të komentojnë natyrën në mal, kafshët, veshjet në malësi. Drejtohen pyetje keni shkuar ndonjëherë në malësi? Çfarë keni parë atje? Sugjerohet edhe dëgjimi i këngës së shkronjës L.(Veshët bishtin mban përpjetë.../lepurushi, lepurushi me sy hapur thonë fle.

Hapi 2. Në klasë nxënësit nxiten të diskutojnë për kafshët që kullosin në mal dhe të përshkruajnë elementët që njohin. Shkruhet titulli në tabelë. LULI ME LAHUTË. Sipas mundësive mund të dëgjohet edhe një pjesë e luajtur me lahutë.

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 3. Përsëritje në korr e shkronjave të mësuara. Dallimi i zanoreve dhe bashkëtingëlloreve. Nxënësit shkruajnë në A_4 disa nga shkronjat e mësuara, madje edhe rrokje me to.

Hapi 4. Nxiten nxënësit të vërejnë figurën në libër dhe të formojnë fjali ose një tekst të shkurtër. Mësuesi/ja ndihmon nxënësit me pyetje ndihmëse*: Në cilën stinë janë fëmijët në foto? Si janë veshur ata? Ç'vegël muzikore ka në dorë LULI? Çfarë dallon pranë gardhit?Po ju ju ka rastisur të shkoni me pushime/jetoni në malësi? Ç'mund të veçoni? ...*

Hapi 5. Demonstron para klasës grafikun e shkronjës së vogël dhe të madhe të shtypit. Nxit nxënësit të

bëjnë ngjashmëritë dhe dallimet me shkronjat e mësuara më parë dhe objekte të tjera rrethanore.
- Nxiten nxënësit të gjejnë fjalë që fillojnë me **L** , e kanë në trup ose mbarojnë me **L**.
Plotësohet tabela kolektivisht

L	**L**	**L**
Luli	lule	mal .....

Hapi 6. Nxënësit punojnë individualisht për plotësimin e shkronjave mungesore në fjalë.
Bëhet leximi dhe ndarja e tyre në rrokje. Ngre disa nxënës që shkruajnë fjalët në tabelë. MA□I...

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 7. Mësuesi/ja shkruan fjalitë kryesore në tabelë *Luli me lahutë.* Luli luan me lahutë. Ndahet në etiketa dhe fjalët në rrokje. Individualisht nxënësit shkruajnë sipas kuptimit fjalët me rrokje mungesore. Lexohen nga nxënësit në zinxhir fjalët e fjalitë e formuara.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Shqipton tingullin **L**
- ✓ Gjen dhe thotë fjalë që fillojnë me **L** ose që përmbajnë tingullin **L** në trup të tyre.
- ✓ Lexon fjalët e fjalorit të librit *lule, lopa,limoni,lumi, mali, luan...*
- ✓ Plotëson sipas figurës fjalë mungesore.
- ✓ Formon fjali/ tekst sipas figurës kryesore të faqes.

Detyrë shtëpie:

1.Lexo dhe shkruaj fjalët e librit në fletore.
2.Shkruaj 10-15 fjalë me shkronjën **L**.
3.Vizato e shkruaj fjalë që kanë në trup shkronjën **L.**

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1	**Klasa:** 1
Tema mësimore: **Punim e shkrim i shkronjës L, l Abetare pune faqe 30.**		**Situata e të nxënit:** Me lahutë	

***Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe**

Nxënësi:

- ***Kompetenca e të nxënit:*** Ndjek udhëzimet e dhëna për të realizuar një veprim/detyrë.
- ***Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin :***
  - Identifikon burimet e nevojshme dhe i përdor në mënyrë të drejtë.
  - Grumbullon materialet e performancës së vet, për pasurimin e portofolit personal.

***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore**

Nxënësi:

- Shkruan shkronjës **L, l** të shtypit sipas modeli.
- Shkruan rrokje, fjalë.
- Formon fjalë duke lidhur rrokjet.
- I përgjigjet pyetjeve shkurt.
- Ndan fjalë në rrokje e shkronja.
- Plotëson falinë me fjalë sipas kuptimit.

Fjalë kyçe:

Lumë, limon, lule, leu, lau,luan, Mali, lanë, lule me erë, Lira luan me lule mali. Alma u la në lumë.

Teknika dhe strategji:

- Punë me grupe
- Analizë-sintezë
- Punë në grupe
- Shkrim i lirë

Burimet e informacionit dhe mjete: Shkronjat individuale dhe kolektive, fletore pune, etiketa me rrokje, fjalë sipas nivelit, shirita me fjalë me shkrim shtypi/figura(ose lodra si: lahutë) që nxënësit mund të përdorin për të krijuar fjali.

Lidhja me fushat e tjera:

Lënda: Art pamor, matematikë

Përshkrimi kontekstual i situatës

- ***Veprimet paraprake***

Hapi 1. Me nxënësit prezantohet foto e djalit me lahutë/dëgjohet një melodi e luajtur me lahutë dhe nxitet biseda rreth tyre. Ka në qytetin/fshatin tonë grupe popullore që shoqërojnë këngët me lahutë? Keni parë festivale folklorike? Mund të luaji ndonjëri nga ju disa tinguj të thjeshtë me lahutë?

Hapi 2. Klasa është e ndarë në grupe e punojnë me fishe sipas niveleve të ndryshme. Mësuesja ka përgatitur etiketa me rrokje, fjalë dhe fjali rreth situatës. Ia shpërndan nxënësve sipas nivelit. Nxënësit lexojnë me zë të lartë. Nxiten nxënësit të korrigjojnë njëri-tjetrin. p.sh. *LU, U, LI, AL, LAHUTË, LUMË, LAU, LURË.*

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 2. Paraqet grafikun e shkronjës **L, l.** Nxit të thonë ndryshimet dhe ngjashmëritë me shkronjat e tjera, p.sh me **i** pa pikë ose objekte me formë të ngjashme.

Hapi 3. Ngre nxënës në tabelë që të shkruajnë disa nga rrokjet, fjalët dhe fjalitë e etiketave që u shpërndanë në pjesën e parë të orës. LA, LE, LË, LI, LU, LEU, LAU.

Hapi 4. Punohet sipas kërkesave në fletoren e punës. Modelohet shkronja **l, L** shkruhen rrokjet me shkronja të mëdha e të vogla të shtypit. Nxënësit veprojnë me etiketat, duke u këshilluar të ndjekin drejtimin e shigjetave për lidhjen e fjalëve me numrin e shkronjave përkatëse. Veprohet për ndarjen e fjalëve në rrokje e shkronja. Lidhin shkronjat në rrokje. Shënojnë me x fjalët që kanë në trup shkronjën

L dhe janë shkruar saktë. Plotësojnë fjalinë me fjalët që janë paraqitur në krahun e djathtë dhe shkruajnë *Lira luan me lule mali. Iliri e Luani u lanë në lumë.* (Sa fjalë kanë fjalitë? Kujdes në përdorimin e shkronjës së madhe tek emrat e njerëzve). Bëhet kontrolli individual i fletores. **Hapi 5.** Nxënësit shkruajnë me shkrim shtypi fjalët lahutë, lau, limoni, lule...(ato mund të përdoren në fjali nga nxënësit e tjerë/ shoqërohen me vizatime). ▪ ***Demonstrim i rezultateve të arritura*** **Hapi 6.** Nxënësit lexojnë fjalët dhe fjalitë që krijuan gjatë ushtrimeve në fletoren e punës. Nxënësit më të përparuar mund të formojnë disa fjali në fletore më fjalët e fjalorit.*(lumë, lau, lule..)*
Vlerësimi i situatës: ***Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:*** ✓ Shkruan shkronjës **L, l** të shtypit sipas modeli. ✓ Shkruan rrokje, fjalë. ✓ Formon fjalë duke bashkuar sipas kuptimit rrokjet. ✓ I përgjigjet pyetjeve shkurt.
Detyrë shtëpie: **1.** Formo nga fjali me fjalët: *lumë, limon, lule, mali.* **2.** Kopjo 2 herë fjalitë e faqes 30. **3.** Kopjo bukur në fletore tabelën e rrokjeve të faqes 30 e formo fjalë me to.
Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1	**Klasa:** 1
Tema mësimore: **Punim e lexim i shkronjës L, l faqe 35 të Abetares**		**Situata e të nxënit:** Me lahutë	

***Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe**

Nxënësi:

- ***Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit:***
  - Dëgjon/krijon një tregim. Identifikon personazhet e një tregimi.
  - Shpreh mesazhin e një teksti të thjeshtë letrar, përmes një forme shprehjeje:të të folurit, lojës me role.
- ***Kompetenca e të nxënit:*** Parashtron pyetje dhe përgjigje në lidhje me temën.

***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore**	**Fjalë kyçe:** *lumë, lule, luan, mal, u la, me Lirën, luan mirë, në lumë*
Nxënësi: - Lexon fjalë, fjali. - I përgjigjet me fjali të thjeshtë pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit. - Rilexon fjalitë/tekstin për të kuptuar përmbajtjen. - Lidh pjesën që lexon me filma që ka parë, ose me përvoja personale. - Rendit fjalët sipas kuptimit në fjali.	**Teknika dhe strategji :** - Parashikim me terma paraprakë - Marrëdhënie pyetje-përgjigje - Lexim zinxhir - Analizë-sintezë e fjalisë
Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, modele shkronjash individuale, grafiku i shkronjës **L, l** të shtypit, foto me pamje nga bjeshkët maleve, veshjeve popullore të krahinave të ndryshme, magnetofon, lahutë, lule.	**Lidhja me fushat e tjera:** Matematikë, muzikë, edukim për shoqërinë

Përshkrimi kontekstual i situatës:

- ***Veprimtari paraprake***

Hapi 1: Shkruaj në tabelë titullin e tregimit ME LAHUTË dhe nxit nxënësit të formojnë fjali ose një tekst të shkurtër sipas fantazisë nxitur nga foto /një film apo përvojës personale. *(Këshillohen të mos përsëritin tregimin e librit nëse e kanë lexuar më parë por të veprojnë më fantazi.)*

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 2: Mësuesi/ja këshillon nxënësit të mbyllin sytë dhe të përfytyrojnë një ditë në bjeshkë dhe lojërat që kanë kryer me njëri-tjetrin. Njëri prej shokëve ka lahutë, vajza mbledh lule bën kurora dhe lodron nën ritmin e melodisë. Si do të vepronit ju? Bëhet krahasimi me krijimet e nxënësve.

Hapi 3: Lexon me intonacion 2-3 herë tekstin. Më pas pyeten nxënësit:

Çfarë përfytyruat? Me kë do të lodronit? Çfarë po bënte vajza? Po djali? Si u ndjeve kur dëgjove tregimin?

Në sfond mund të vihet melodia e tingujve të lahutës.

Hapi 4: Hapen librat. Nxit nxënësit të përshkruajnë figurën. Bëhet leximi i fjalive në korr. *Luli luan me lahutë. Lira luan me Lulin. Luli ia la lahutën. Lira luan mirë me lahutë.* Lexohet teksti disa herë. Lidhen sipas kuptimit fjalët në petalet e luleve për të krijuar fjali. Luli u la në lumë. Laura u la me Lirën. Në figurat e vogla në të djathtë të faqes nxënësit plotësojnë fjalën me shkronja mungesore.

Kujtohet përdorimi i pikës dhe shkronjës së madhe në emrat e përveçëm dhe në fillim të fjalisë.

Hapi 5: Në varësi të numrit të nxënësve në klasë mësuesi/ja bën leximin e tekstit në zinxhir me nga një ose më shumë fjali. Mund të kërkohet nga nxënësit edhe të lexojnë fjalinë e parë, të dytë e kështu me radhë ose me rend të ngatërruar. Nxënësit që paraqesin vështirësi mund t'i pyesë në fjalë të veçanta të thjeshta.

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 6: Diskutim rreth përmbajtjes. *Si e ka titullin tregimi? Si quhen fëmijët që marrin pjesë? Çfarë bënë ata? Me çfarë po luajnë? Po Lira di të luajë me lahutë?...*

Hapi 7: Nxënësit në mënyrë individuale plotësojnë fjalinë me bashkimin e fjalëve në petalet e luleve të bardha. I shkruajnë ato në fjali. Diskutojnë në dyshe më shokun e bankës për bashkimin e fjalëve dhe formimin e fjalive.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Lexon fjalë, fjali.
- ✓ I përgjigjet me fjali të thjeshtë pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit.
- ✓ Rilexon tekstin për të kuptuar përmbajtjen e tij.
- ✓ Lidh pjesën që lexon me filma që ka parë, me përvoja personale.
- ✓ Rendit fjalët sipas kuptimit.

Detyrë shtëpie:

1. Lexo tregimin disa herë.
2. Kopjo 4 fjali nga teksti.
3. Kopjo e fjalitë e krijuara me shkrim shtypi.

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1	**Klasa:** 1
Tema mësimore **Ushtrime aplikative për shkrim dore, shkronja** *L,l.*		**Situata e të nxënit:** Me lahutë	
Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe** Nxënësi: ➢ ***Kompetenca e të nxënit: Mbikëqyr në mënyrë të pavarur përparimin e vet në një detyrë duke përdorur detyra të ndryshme. Korrigjon gabimet. ➢ ***Kompetenca qytetare:*** Bashkëpunon në grup dhe respekton rregullat e grupit.			
***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore** Nxënësi: ✚ Shkruan shkronjat **L, l** të dorës duke u ndihmuar nga modeli. ✚ Shkruan shkronjat **L, l** me të gjitha elementet duke e lidhur me shkronjat e tjera . ✚ Shkruan fjalë me të kopjuar duke përdorur shkronjën **L,l** në fillim, në trup të fjalës ✚ Lexon fjalë me shkrim dore. ✚ Shkruan fjalë nga shkrim shtypi në shkrim dore.		**Fjalë kyçe:** *lumë,lule me erë, Alma u la në lumë,luan me lule.* **Teknika dhe strategji:** ❖ Vetëdiktim ❖ Lexim në korr ❖ Demonstrim ❖ Punë individuale ❖ Punë në çifte/punë në dyshe ❖ Lexim individual	
Burimet e informacionit dhe mjete: Fletore e punës, fletore shkrimi , modele shkronjash individuale, grafiku i shkronjës **L, l** të shtypit dhe të dorës, etiketa me fjalë të mësuara, fletë të fotokopjuara, magnetofon, projektor.		**Lidhja me fushat e tjera:** Arte,matematikë	

Përshkrimi kontekstual i situatës

- ***Veprimtari paraprake***

Hapi 1. Mësuesi/ja nxjerr para klasës disa foto me pamje të kurorës me lule dhe lahutës dhe nxënësit shkruajnë në fletore ose fletë (fjalët /fjalitë përkatëse), në formën e vetëdiktimit ose përgatit etiketa të gatshme për secilin nxënës. Lexojnë fjalët që kanë shkruar me shkrim shtypi.(Lurë,Liria,ura në lumë, lau në lumë, luan me lule...)

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 2. Përsëritje e shkronjave të dorës të mësuara deri më tani. Nxënësit i paraqesin me shkrim në dërrasë. Lexim në korr. Përsëriten shkronjat **l, L** të shtypit dhe grafiku i tyre.
Nxiten nxënësit të thonë fjalë që fillojnë me **L,** shkruhen nga mësuesi/ja disa prej tyre.

Hapi 3. Shpjegoj grafikun e shkronjës **L, l** të dorës dhe veprojnë kolektivisht për ta shoqëruar me lëvizjen në ajër të nxënësve. Sqarohen elementet përbërës të saj. Nëse ka mundësi mund të paraqitet edhe grafiku i shkronjës me video/projektor.
Bëhet dallimi me shkronjën **L, l** të shtypit.
Ngre nxënës në tabelë që të shkruajnë shkronjën dhe të bëjnë lidhjen e saj me shkronjat e tjera në fjalë, p.sh., *lu,Anila...*

Hapi 4. Më pas nxënësit punojnë në fletoren e punës sipas modelit. Vështirësi paraqet lidhja e shkronjës **l** me shkronjat e tjera/ose grepi në të majtë tek shkronja e madhe e dorës, vëzhgohet ky element dhe përforcohet. Kujdes edhe me punën brenda rreshtit. Nxënësit lexojnë fjalët dhe fjalinë që shkruajnë me

shkrim dore.

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 5. Diktim me shkronja dore.

lau, lumë, Urë në lumë, líria, lau në lumë, lule, Alma u la në lumë, Amli me Lírën në lumë, Lule me erë, Lira e Luani u lanë në lumë.

Nxënësit lexojnë fjalët që shkruajnë me shkronja dore. Mund të jepet dhe shkrimi i fjalëve nga shkrim shtypi në shkrim dore/ puno me fletët e fotokopjuara për shkrimin e vizatimin e fjalëve.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Shkruan shkronjat **L, l** të dorës duke u ndihmuar nga modeli.
- ✓ Shkruan shkronjat **L, l** me të gjitha elementet duke e lidhur me shkronjat e tjera.
- ✓ Shkruan fjalë me të kopjuar duke përdorur shkronjën **l, L** në fillim, në trup të fjalës.
- ✓ Lexon fjalë me shkrim dore.
- ✓ Shkruan fjalë nga shkrim shtypi në shkrim dore.

Detyrë shtëpie:

1. Shkruaj nga 3-5 rreshta me shkronja/ rrokje.
2. Shkruaj fjalë ose fjali me shkronjën **L. l.**
3. Kopjo 4 rreshta me modelin **L,i,A,u,M,I,n,r,E,l,R,u.**
4. Paraqit në forma të ndryshme shkronjën **l, L**.
5. Puno fletë të fotokopjuara/modeluara.

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1	**Klasa:** 1
Tema mësimore: **Punim i faqes 34-35 të Abetares . Me lahutë.**		**Situata e të nxënit:** Me lahutë	

***Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe**

Nxënësi:

- ***Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit :*** Shpreh mesazhin e një teksti të thjeshtë, nëpërmjet njërës nga format shprehëse: të folurit, shkrimit, dramatizimit.
- ***Kompetenca e të nxënit:*** Parashtron pyetje dhe përgjigje në pyetjet për temën në njërën nga format e të shprehurit.
- ***Kompetenca qytetare:*** Diskuton dhe bashkëpunon me anëtarët e grupit.

***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore**	**Fjalë kyçe:**
Nxënësi: - Qarkon shkronjën **L** në tekste të panjohura. - Lidh sipas kuptimit fjalët për të krijuar fjali. - Plotëson fjalët me shkronja mungesore. - Shkruan me të kopjuar ose të diktuar. - Lexon fjalë, fjali me shkrim dore.	*lumë, lahutë,mali,lumi,limoni, lule,luan me lule, u la në lumë, Lira mori lule në mal.* **Teknika dhe strategji:** - Punë individuale - Lexim fjalësh, fjalish - Analizë – sintezë - Punë në dyshe/grup - Shkrim i lirë
Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, modele shkronjash individuale, grafiku i shkronjës **l, L** të shtypit, foto me pamje nga bjeshkët në zonat malore, kafshë lodra lopa, luani, lule me petale prej letre...	**Lidhja me fushat e tjera:** Lënda: Matematikë, art pamor

Përshkrimi kontekstual i situatës

- ***Veprimtari praktike***

Hapi 1. Mësuesja shpërndan një tekst *(mundësisht me temë sipas situatës)* në të cilën nxënësit duhet të qarkojnë shkronjën **L**, të lexojnë fjalë/fjali sipas nivelit të nxënësve. Mund të përdoren edhe lulet prej letre me shkronja e fjalë që formojnë fjalë.

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 2. Përsëritje në korr e shkronjave të shtypit dhe të dorës, të mësuara deri tani.
Nxënësit tregojnë se sa është numri i shkronjave **L** që kanë gjetur në tekstet e mësipërme.
Për nxënës më të përparuar mund t'u kërkohet të lexojnë fjalë ose fjali në etiketa.
Hapi 3. Punohet me pjesën e fundit të faqeve **34** dhe **35.**
Rilexojnë fjalinë: ***Luli luan me lahutë. Lira mori lule në mal.*** Bëhet ndarja e fjalive në etiketa.
U kërkohet nxënësve të gjejnë sa fjalë ka fjalia të dallojnë fjalën e parë, të dytë e kështu me radhë si dhe rindërtimi i fjalisë nga një rend i ngatërruar fjalësh.
Hapi 4. Lihen nxënësit të punojnë individualisht për plotësimin e fjalëve me rrokje sipas kuptimit që përftohet nga figura fundi i faqes **34**, për ndarjen e fjalëve në rrokje e shkronja. Me fjalinë në faqen **35** punohet për ndarjen në fjalë dhe shkrimin e fjalisë nga shkrim shtypi në shkrim dore. Nxënësit përdorin shkronjën e madhe në shkrimin e fjalive. **P.sh.,** ***Lira mori lule në mal.***

Mund të aplikohet dhe puna në dyshe ose grup sipas përbërjes së nxënësve të klasës për lidhjen e petaleve të luleve sipas kuptimit në fjalitë. ***Liri luan në lumë. Luli u la me Lirën***. Lexohen fjalitë dhe korrigjojnë ata që nuk i kanë lidhur ose ndarë saktë. Bëhet rileximi nga nxënësit që nuk e kishin shkruar saktë që në fillim si dhe stimulohen ato që krijuan fjali të veçanta. ▪ ***Demonstrim i rezultateve të arritura*** **Hapi 5.** Në fletoren e klasës, nxënësit shkruajnë me shkrim dore fjalët dhe fjalitë që formuan në fundin e faqes **34** dhe **35.** Lexojnë fjalitë me shkrim dore nga fletorja e tyre.
Vlerësimi i situatës: ***Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:*** ✓ Qarkon shkronjën **L** në tekste të panjohura. ✓ Lidh sipas kuptimit fjalët për të krijuar fjali. ✓ Plotëson fjalët me shkronja mungesore. ✓ Shkruan me të kopjuar ose të diktuar. ✓ Lexon fjalë fjali me shkrim dore.
Detyrë shtëpie: **1.** Kopjo me shkronja dore fjalitë që formove në klasë. **2.** Shkruaj 3-4 fjali për situatën "Luaj me lahutë". **3.** Vizato objekte që kanë në trup L dhe emërtoji ato. **4.** Përdor në fjali të thjeshta fjalët e librit.
Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1	**Klasa:** 1
Tema mësimore: Punim i shkronjës K, k faqe 36 të Abetares		**Situata e të nxënit:** Kali i Kelit	

***Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe**

Nxënësi:

- ***Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit:*** Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar.
- ***Kompetenca e të nxënit:*** Parashtron pyetje dhe përgjigje në lidhje me temën.
- ***Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin:*** Gjen të përbashkëtat dhe ndryshimet ndërmjet aktiviteteve që bën në shkollë me ato në shtëpi.

***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore**

Nxënësi:

- Shqipton tingullin **K.**
- Gjen dhe thotë fjalë që fillojnë me ***K*** ose që përmbajnë shkronjën **k** në trup të tyre.
- Lexon fjalët e fjalorit të librit: *kalë, koka, makina, buka, kala me rërë, kalëron...*
- Plotëson sipas figurës fjalët me rrokje mungesore.
- Analizon fjalë e fjali.
- Formon fjali/tekst sipas figurës kryesore të faqes.

Fjalë kyçe:

Keli, kalë, makina, kamera, buka, Kam, ke, ka, koka, në kala...

Teknika dhe strategji:

- Bisedë
- Marrëdhënie pyetje-përgjigje.
- Vëzhgim
- Demonstrim
- Punë individuale/ Çift

Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, modele shkronjash individuale, grafiku i shkronjës **K, k** të shtypit, foto me pamje nga një shëtitje me kalë.

Lidhja me fushat e tjera: Lënda: Art pamor, matematikë, shkencë.

Përshkrimi kontekstual i situatës:

- ***Veprimtari paraprake:***

Hapi 1. Fillon me një vëzhgim të fotove nga një shëtitje me kalë në mal. Mund të lexohet edhe gjëegjëza për kalin (dhe nxënësit të gjejnë atë). Nxënësit këshillohen të vërejnë fotot dhe të komentojnë duke e argumentuar edhe me raste e ngjarje konkrete të përjetuara për shëtitje me kalë. Sygjerohet edhe dëgjimi i këngës së shkronjës **K**.(*Kam një kalë pullali, si atë nuk ka njeri, është kalë për kalëri, me fre, shalë e yzengji...*)

Hapi 2. Në klasë nxënësit nxiten të diskutojnë për kalërimet me kalë dhe të përshkruajnë ndjenjat që përjetojnë në të tilla raste. Shkruhet titulli në tabelë. KELI ME KALË.

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 3. Përsëritje në korr e shkronjave të mësuara. Dallimi i zanoreve dhe bashkëtingëlloreve. Nxënësit shkruajnë në A4 disa nga shkronjat e mësuara madje edhe rrokje e fjalë me to.

Hapi 4. Nxiten nxënësit të vërejnë figurën në libër dhe të formojnë fjali ose një tekst të shkurtër. Mësuesja ndihmon nxënësit me pyetje ndihmëse *: Në cilën stinë janë fëmijët në foto? Si është moti? Çfarë po bëjnë fëmijët? Çfarë po bën Keli? Po ju keni kalëruar ndonjëherë me kalë? Si jeni ndjerë/Do të donit të kalëronit?*

Hapi 5. Demonstron para klasës grafikun e shkronjës së vogël dhe të madhe të shtypit. Nxit nxënësit

të bëjnë ngjashmëritë dhe dallimet me shkronjat e tjera p.sh., l dhe objekte të tjera rrethanore.

- Nxiten nxënësit të gjejnë fjalë që fillojnë me **K**, e kanë në trup ose mbarojnë me **K**.

Plotësohet tabela kolektivisht

K	**K**	**K**
Kelia	makina	brisk .....

Hapi 6. Nxënësit punojnë individualisht për plotësimin e shkronjave në fjalët mungesore.

Bëhet leximi dhe ndarja e tyre në rrokje. Ngre disa nxënës që shkruajnë fjalët në tabelë. KO□KA

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 7. Shkruan fjalinë kryesore në tabelë. *Keli ka kalë*. Ndahet në etiketa dhe fjalët në rrokje.

Individualisht nxënësit plotësojnë rrokjet në fjalë sipas figurave.

Lexohen nga nxënësit në zinxhir fjalët e fjalitë e formuara.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Shqipton tingullin **K.**
- ✓ Gjen dhe thotë fjalë që fillojnë me **K** ose që përmbajnë tingullin **K** në trup të tyre.
- ✓ Lexon fjalët e fjalorit të librit *kalë, ka, kalëron, koka, makina, buka....*
- ✓ Plotëson sipas figurës fjalët me rrokje mungesore.
- ✓ Formon fjali/ tekst sipas figurës kryesore të faqes.

Detyrë shtëpie:

1. Lexo dhe shkruaj fjalët e librit në fletore.
2. Shkruaj 10-15 fjalë me shkronjën **K.**
3. Kopjo fjalët e faqes dhe shoqëroji me vizatim ato.

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1	**Klasa:** 1
Tema mësimore: **Punim e shkrim i shkronjës K, k, Abetare pune faqe 31**		**Situata e të nxënit:** Kali i Kelit	

***Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe**

Nxënësi:

- ***Kompetenca e të nxënit:*** Ndjek udhëzimet e dhëna për të realizuar një veprim/detyrë.
- ***Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin:***
  - Identifikon burimet e nevojshme dhe i përdor në mënyrë të drejtë.
  - Grumbullon materialet e performancës së vet,për pasurimin e portofolit personal.

***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore**	**Fjalë kyçe:**
Nxënësi: - Shkruan shkronjës **K, k** të shtypit sipas modelit. - Shkruan rrokje, fjalë. - Formon fjalë duke lidhur rrokjet/shkronjat. - I përgjigjet pyetjeve shkurt. - Ndan fjalë në rrokje e shkronja. - Plotëson fjalitë me fjalë sipas kuptimit.	Ka, ki, ke, kë, ku, kalë, lekë, makinë, miku, armiku, kamerë, pako, kuti. **Teknika dhe strategji:** - Punë me grupe - Analizë-sintezë - Punë në grupe - Shkrim i lirë
Burimet e informacionit dhe mjete: Shkronjat individuale dhe kolektive, fletore pune, etiketa me rrokje, fjalë sipas nivelit, shirita me fjalë me shkrim shtypi/figura që nxënësit mund të përdorin për të krijuar fjali.	**Lidhja me fushat e tjera:** Lënda: Arte, matematikë

Përshkrimi kontekstual i situatës

- ***Veprimet paraprake***

Hapi 1. Klasa është e ndarë në grupe e punojnë me fishe sipas niveleve të ndryshme. Mësuesja ka përgatitur etiketa me rrokje, fjalë dhe fjali rreth situatës. Ia shpërndan nxënësve sipas nivelit. Nxënësit lexojnë me zë të lartë. Nxiten nxënësit të korrigjojnë njëri-tjetrin .p.sh. *KA, KE, KALI, LEKË,UNË KAM ERË, KELI KA KALË..*

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 2. Paraqet grafikun e shkronjës **K, k.** Nxit të thonë ndryshimet dhe ngjashmëritë me shkronjat e tjera, p.sh me **L** ose objekte.

Hapi 3. Ngre nxënës në tabelë që shkruajnë disa nga rrokjet, fjalët dhe fjalitë që u shpërndanë në pjesën e parë të orës.

Hapi 4. Punohet sipas kërkesave në fletoren e punës. Modelohet shkronja **K, k** shkruhen rrokjet me shkronja të vogla të shtypit dhe fjalët me shkronja mungesore. Nxënësit veprojnë me etiketat, duke u këshilluar të ndjekin drejtimin e shigjetave për shkëputjen e shkronjës së parë të fjalëve dhe lidhjen e tyre në fjalë (formohen *miku, leku*). Lexojnë fjalët në etiketat e kuqë dhe të gjelbër. Plotësojnë fjalitë dhe shkruajnë *Unë kam kamerë. Ai ka kalë. Ne kemi pako*. (Sa fjalë kanë fjalitë?). Bëhet kontrolli individual i fletores.

Hapi 5. Nxënësit shkruajnë me të diktuar me shkrim shtypi fjalitë: Makinë e re, Keli ka kalë, Ai ka mik të ri.

▪ ***Demonstrim i rezultateve të arritura*** **Hapi 6.** Nxënësit lexojnë fjalët dhe fjalitë që krijuan gjatë ushtrimeve në fletoren e punës. Nxënësit më të përparuar mund të formojnë disa fjali në fletore më fjalët e fjalorit.*(mik, kala, makina, armik)*.
Vlerësimi i situatës: ***Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:*** ✓ Shkruan shkronjës **K, k** të shtypit sipas modelit. ✓ Shkruan rrokje, fjalë. ✓ Formon fjalë duke bashkuar sipas kuptimit shkronjat. ✓ I përgjigjet pyetjeve shkurt. ✓ Plotësojnë fjalitë sipas kuptimit.
Detyrë shtëpie: **1.** Formo nga fjali me fjalët: *kalë, iku, lekë, makina, pako.* **2.** Përgjigju me fjali të plotë pyetjeve. Keli ka(çfarë?) *kalë*. Ai e ka kalin në(ku?) pako. **3.** Kopjo bukur në fletore 3 fjalitë e faqes 31.
Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1	**Klasa:** 1
Tema mësimore: **Punim e lexim i shkronjës K, k faqe 37 të Abetares**		**Situata e të nxënit:** Kali i Kelit	

***Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe**

Nxënësi:

- ***Kompetenca e komunikim dhe të shprehurit:*** Dëgjon një tregim. Identifikon personazhet e një tregimi.
- ***Kompetenca e të nxënit:*** Parashtron pyetje dhe përgjigje në lidhje me temën.

***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore**	**Fjalë kyçe:** *kalë, kalëron, iku me kalë, Unë nuk kam kalë. Kali e ka emrin Kik. Ai ka kalë.*
Nxënësi: - Lexon fjalë, fjali. - I përgjigjet me fjali të thjeshtë pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit/filmit. - Rilexon tekstin për të kuptuar përmbajtjen e tij. - Lidh pjesën që lexon me filma që ka parë, ose me përvoja personale. - Plotëson fjalitë duke përshtatur fjalët sipas kuptimit.	**Teknika dhe strategji :** - Parashikim me terma paraprakë - Fragmenti-komenti - Marrëdhënie pyetje-përgjigje - Lexim zinxhir - Analizë- sintezë e fjalisë
Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, modele shkronjash individuale, grafiku i shkronjës **k, K** të shtypit, foto me pamje nga kalërime me kalë si dhe gara me kuaj, magnetofon, videoprojektor, lodër për fëmijë kalë me kurdisje.	**Lidhja me fushat e tjera:** Matematikë, arte, edukim për shoqërinë

Përshkrimi kontekstual i situatës:

- ***Veprimtari paraprake***

Hapi 1: Shkruaj në tabelë titullin e tregimit KALI I KELIT dhe nxit nxënësit të formojnë fjali ose një tekst të shkurtër sipas fantazisë ose nxitur nga filmi *Beni ecën vetë* apo përvojës personale. Sipas kushteve mund të ndiqet edhe në videoprojektor pjesa e parë e filmit Beni ecën vetë.

(Nxënësit kështillohen të dramatizojnë një pjesë të filmit dhe të mos përsëritin tregimin e librit nëse e kanë lexuar më parë, por të veprojnë me fantazi).

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 2: Mësuesja kështillon nxënësit të dramatizojnë një garë me kuaj/ose të përfytyrojnë një ditë të nxehtë vere duke kalëruar me kalë. Bëhet krahasimi me krijimet e nxënësve.

Hapi 3: Lexohet me intonacion 2-3 herë tregimi. Më pas pyeten nxënësit:

Çfarë përfytyruat? Ku ishit? Çfarë po bënit ju? Po Keli çfarë po bën? Keni ju kalë? Si u ndjetë kur kalëruat? Si e ka emrin ai? Po kali i Kelit si e ka emrin?

Nxënësit mund të paraqesin edhe një kalë lodër që ecën me bateri apo kurdisje.

Hapi 4: Hapen librat. Nxit nxënësit të përshkruajnë figurën. Bëhet leximi i rrokjeve KI, KA, KE, KË... në korr. Lexohet tregimi disa herë. Kujtohen disa lojëra që fëmijët përdorin. Shpjegohet përdorimi i pikës dhe shkronjës së madhe në emrat e përveçëm dhe në fillim të fjalisë.

Hapi 5: Më pas lihen nxënësit të lexojnë në heshtje për disa minuta tregimin. Në varësi të numrit të

nxënësve në klasë, mësuesja bën leximin e tregimit në zinxhir me nga një ose më shumë fjali. Mund të kërkohet nga nxënësit edhe të lexojnë fjalinë e parë, të dytë e kështu me radhë ose me rend të ngatërruar. Nxënësit që paraqesin vështirësi mund t'i pyesë në fjalë të veçanta të thjeshta. ▪ ***Demonstrim i rezultateve të arritura*** **Hapi 6:** Diskutim rreth përmbajtjes. *Si e ka titullin tregimi? Si quhen djali që merr pjesë? Çfarë bën ai?* **Hapi 7:** Nxënësit në mënyrë individuale veprojnë zinxhir për plotësimin e fjalive *Unë kam kalë. Ai ka kalë. Ne kemi kalë. Unë nuk kam kalë.* Diskutojnë në dyshe më shokun e bankës për leximin e fjalive dhe ndarjen e tyre në fjalë.
Vlerësimi i situatës: ***Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:*** ✓ Lexon fjalë, fjali. ✓ I përgjigjet me fjali të thjeshtë pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit. ✓ Rilexon tekstin për të kuptuar përmbajtjen e tij. ✓ Lidh pjesën që lexon me filma që ka parë, me përvoja personale.
Detyrë shtëpie: 1. Lexo tregimin disa herë. 2. Kopjo 3-4 fjali që të pëlqejnë më shumë nga tregimi. 3. Kopjo rrokjet me shkrim shtypi. 4. Kopjo fjalitë e plotësuara.
Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1	**Klasa:** 1
Tema mësimore **Ushtrime aplikative për shkrim dore, shkronja** *K, k.*		**Situata e të nxënit:** Kali i Kelit	
Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe** Nxënësi: ➢ ***Kompetenca e të nxënit: Mbikëqyr në mënyrë të pavarur përparimin e vet në një detyrë duke përdorur detyra të ndryshme. Korrigjon gabimet. ➢ ***Kompetenca qytetare:*** Bashkëpunon në grup dhe respekton rregullat e grupit.			
***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore** Nxënësi: - Shkruan shkronjat **K, k** të dorës duke u ndihmuar nga modeli. - Shkruan shkronjat **K, k** me të gjitha elementet duke e lidhur me shkronjat e tjera. - Shkruan fjalë me të kopjuar duke përdorur shkronjën **K, k** në fillim, në trup të fjalës. - Lexon fjalë e fjali me shkrim dore.		**Fjalë kyçe:** *ke, së, kalëron, Keli iku me makinë, kali im, kinema* **Teknika dhe strategji:** ❖ Vetëdiktim ❖ Lexim në korr ❖ Demonstrim ❖ Punë individuale ❖ Punë në çifte/punë në dyshe ❖ Lexim individual	
Burimet e informacionit dhe mjete: Fletore e punës, fletore shkrimi , modele shkronjash individuale, grafiku i shkronjës **K, k** të shtypit dhe të dorës, etiketa me fjalë të mësuara, videoprojektor.		**Lidhja me fushat e tjera:** Arte	
Përshkrimi kontekstual i situatës ▪ ***Veprimtari paraprake*** **Hapi 1.** Mësuesja nxjerr para klasës disa foto të garave me kuaj dhe nxënësit shkruajnë 2-3 fjali në fletore ose fletë, në formën e vetëdiktimit ose përgatit etiketa të gatshme për secilin nxënës. Lexojnë fjalët që kanë shkruar me shkrim shtypi.(kalë, makinë, kali im i ri, kamera, kinema...) ▪ ***Veprimet në situatë*** **Hapi 2.** Përsëritje e shkronjave të dorës të mësuara deri më tani. Lexim i tyre në korr. Përsëriten shkronjat **K, k** të shtypit dhe grafiku i tyre. Nxiten nxënësit të thonë fjalë ose emra që fillojnë me **K,** shkruaj disa prej tyre. Kledisa **Hapi 3.** Shpjegoj grafikun e shkronjës **K, k** të dorës dhe e shoqëruar me lëvizjen në ajër të nxënësve. Shpjegohen elementet përbërës të saj. Nëse ka mundësi mund të ndiqet një grafik i shkronjës nga youtube. Bëhet dallimi me shkronjën **K, k** të shtypit. Ngre nxënës në tabelë që shkruajnë shkronjën dhe lidhjen e saj me shkronjat e tjera në fjalë. *ke, ika, kam...* **Hapi 4.** Më pas nxënësit punojnë në fletoren e punës sipas modelit. Vështirësi paraqet pjesa e djathtë e shkronjës **k,** vëzhgohet ky element dhe përforcohet deri në përvetësimin e tij. Kujdes edhe me shkronjën e madhe të dorës. Nxënësit tregojnë ngjashmërinë me I, lexojnë fjalët dhe fjalitë që shkruhen me shkrim dore.			

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 5. Diktim me shkronja dore.

ka, ke, kë, ki, kinema, lau , Keli me kalë, Keira, Keli ka mik Kikun, Kali i Kelit iku në mal.

Nxënësit lexojnë fjalët që shkruajnë me shkronja dore.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Shkruan shkronjat **K, k** të dorës duke u ndihmuar nga modeli.
- ✓ Shkruan shkronjat **K, k** me të gjitha elementet duke e lidhur me shkronjat e tjera.
- ✓ Shkruan fjalë me të kopjuar duke përdorur shkronjën **k, K** në fillim, në trup të fjalës.
- ✓ Lexon fjalë me shkrim dore.

Detyrë shtëpie:

1. Shkruaj nga 3-5 rreshta me shkronja/ rrokje.
2. Shkruaj fjalë ose fjali me shkronjën *K. k.*
3. Kopjo 4 rreshta me modelin *K,a,E,A,i,M,N,m,ë,R,u*
4. Paraqit në forma të ndryshme shkronjën k, K .
5. Kopjo modelet e rreshtave në faqen 31 të fletores së punës.

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1	**Klasa:** 1
Tema mësimore: **Punim i faqes 36-37 të Abetares. Kali i Kelit**		**Situata e të nxënit:** Kali i Kelit	

***Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe**

Nxënësi:

- ***Kompetenca e komunikim dhe të shprehurit:*** Shpreh mesazhin e një teksti të thjeshtë, nëpërmjet njërës nga format shprehëse: të folurit, shkrimit.
- ***Kompetenca e të nxënit:*** Parashtron pyetje dhe përgjigjet në pyetjet për temën në njërën nga format e të shprehurit.
- ***Kompetenca qytetare:*** Diskuton dhe bashkëpunon me anëtarët e grupit.

***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore**

Nxënësi:

- Qarkon shkronjën **K** në tekste të panjohura.
- Lidh sipas kuptimit fjalët për të krijuar fjali.
- Plotëson fjalë mungesore.
- Shkruan me të kopjuar ose të diktuar.
- Lexon fjalë, fjali me shkrim dore.
- Interpreton shkrimin e shtypit në shkrim dore.

Fjalë kyçe:

ke, kë, kalëron, Keli iku me makinë, kali im, kinema, KELI KËRKON KALIN KIK.

Teknika dhe strategji:

- Punë individuale
- Lexim fjalësh, fjalish
- Analizë – sintezë
- Punë në dyshe/grup

Burimet e informacionit dhe mjete:

Libri i nxënësit, modele shkronjash individuale, grafiku i shkronjës K, k të shtypit, foto me pamje nga garat me kuaj/faqe e albumit të abetares.

Lidhja me fushat e tjera:

Lënda: Matematikë, art pamor

Përshkrimi kontekstual i situatës

- ***Veprimtari praktike***

Hapi 1. Mësuesi/ja shpërndan një tekst *(mundësisht me temë sipas situatës)* në të cilën nxënësit duhet të qarkojnë shkronjën **K**, të lexojnë fjalë, fjali sipas nivelit të nxënësve.

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 2. Përsëritje në korr e shkronjave të shtypit dhe të dorës, të mësuara deri tani.
Nxënësit tregojnë se sa shkronja **K, k** kanë gjetur në tekstet e mësipërme.
Për nxënës më të përparuar mund t'u kërkohet të lexojnë fjalë ose fjali nga teksti.

Hapi 3. Punohet me pjesën e fundit të faqeve **36** dhe **37**.
Rilexojnë nxënësit fjalitë : ***Keli ka kalë. Keli me kalë. Kali i Kelit.*** Bëhet krahasimi i fjalive për gjetjen e ngjashmërive dhe ndryshimeve mes tyre. Bëhet ndarja e fjalive në etiketa.
U kërkohet nxënësve të gjejnë sa fjalë kanë fjalitë dhe të dallojnë fjalët e ngjashme dhe pozicionet e tyre në fjali të ndryshme.

Hapi 4. Lihen nxënësit të punojnë individualisht për plotësimin (me shkronja të vogla të shtypit) të fjalëve (foljeve) sipas radhës të paraqitur me shkronja të mëdha të shtypit, fundi i faqes **36.** Punohet për ndarjen e fjalëve në rrokje si dhe bashkimin e rrokjeve në fjalë. Më tej punohet për ushtrimet e fundit të faqes **37** për plotësimin e fjalive me fjalët e dhëna në të djathtë. Keli kalëron me kalë. Keli iku me kalë në mal. Kali i Kelit e ka emrin Kik. Më tej veprohet për ndarjen e fjalëve të fjalisë nga njëra-tjetra dhe shkrimin e saj me shkronjat e dorës. ***Keli kërkon kalin Kik.***

Hapi 5. Mund të aplikohet dhe puna në dyshe ose grup sipas përbërjes së nxënësve të klasës. Lexohen fjalitë dhe korrigjojnë ata që nuk i kanë lidhur ose ndarë saktë. Bëhet rileximi nga nxënësit që nuk e kishin shkruar saktë që në fillim.

Hapi 6. Pasi lexojnë tekstin e faqes 37 nxënësit iu përgjigjen pyetjeve që ua drejtojnë njëri-tjetrit: Kur? Ku? Me kë?

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 7. Në fletoren e klasës, nxënësit shkruajnë me shkrim dore fjalët dhe fjalitë që formuan në fundin e faqes **36** dhe **37**. Nxënësit lexojnë fjalitë me shkrim dore nga fletorja e tyre.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Qarkon shkronjën **K** në tekste të panjohura.
- ✓ Lidh sipas kuptimit fjalët për të krijuar fjali.
- ✓ Plotëson fjalë mungesore.
- ✓ Shkruan me të kopjuar ose të diktuar.
- ✓ Lexon fjalë, fjali me shkrim dore.

Detyrë shtëpie:

1. Kopjo me shkronja dore fjalitë që formove në klasë.
2. Shkruaj 3 fjali kalin e Kelit.
3. Vizato pamje nga pistat e kalërimit.
4. Përdor në fjali të thjeshta fjalët e librit.

Refleksione:

<table>
<tr><td>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla: 1</td><td>Klasa: 1</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore: Punim i shkronjës O, o faqe 38 të Abetares</td><td colspan="2">Situata e të nxënit:
Ola mëson me orar.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe
Nxënësi:
➢ Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar.
➢ Kompetenca e të nxënit: Parashtron pyetje dhe përgjigje në lidhje me temën.
➢ Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin: Gjen të përbashkëtat dhe ndryshimet ndërmjet aktiviteteve që bën në shkollë me ato në shtëpi.</td></tr>
<tr><td colspan="2" rowspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore
Nxënësi:
➢ Shqipton tingullin O.
➢ Gjen dhe thotë fjalë që fillojnë me O ose që përmbajnë shkronjën O në trup të tyre.
➢ Lexon fjalët e fjalorit të librit: ora, bora, roboti, orari, numërori, mori, kaloi...
➢ Plotëson sipas figurës fjalët me shkronja mungesore.
➢ Lidh rrokjet në fjalë.
➢ Analizon fjalë e fjali.
➢ Formon fjali/tekst sipas figurës kryesore të faqes.</td><td colspan="2">Fjalë kyçe: ora, bora, roboti, orari, numërori, mori,kaloi, Ola luan me robot.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Teknika dhe strategji:
❖ Bisedë
❖ Marrëdhënie pyetje-përgjigje.
❖ Vëzhgim
❖ Demonstrim
❖ Punë individuale/Çift</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, modele shkronjash individuale, grafiku i shkronjës O, o të shtypit, fotokopje e orarit mësimor dhe planifikimi i orarit ditor, lodra për fëmijë: robot, orë, numëratore, fletë të fotokopjuara.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera: Lënda: Art pamor, matematikë, shkencë.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Përshkrimi kontekstual i situatës:
▪ Veprimtari paraprake:
Hapi 1. Fillon me leximin e gjëegjëzës për orën (nxënësit të gjejnë atë). Nxënësit këshillohen të vërejnë fotot dhe të komentojnë duke argumentuar edhe me raste e ngjarje konkrete të përjetuara për lojërat me robot. Nxënësit tregojnë kur e kanë orarin e tyre të lojës. Listojnë lodrat me të cilat luajnë më shumë. Një nxënës mund edhe të bëjë si robot. Sugjerohet edhe dëgjimi i këngës së shkronjës O. (Ore ore lulebore/jemi shembullore/vërtet si lulebore...)/vjersha e shkronjës O.
Hapi 2. Në klasë nxënësit nxiten të diskutojnë për veprimtaritë ditore dhe oraret përkatëse (Kur zgjohesh? Kur nisesh për në shkollë? Në cilën orë e mbaron mësimin?...). Shkruhet titulli në tabelë. OLA ME ROBOT. Nxënësit tregojnë edhe informacionet që kanë për robotin si objekt teknologjik në ndihmë të shoqërisë.(p.sh roboti automatik i drejtimit të avionit, robot pastrues...)
▪ Veprimet në situatë
Hapi 3. Përsëritje në korr e shkronjave të mësuara. Dallimi i zanoreve dhe bashkëtingëlloreve. Nxënësit shkruajnë në A4 disa nga shkronjat e mësuara madje edhe rrokje e fjalë me to. Shkruhen vetëm zanoret në dërrasë ku shtohet edhe tingulli i ditës.
Hapi 4. Nxiten nxënësit të vërejnë figurën në libër dhe të formojnë fjali ose një tekst të shkurtër.</td></tr>
</table>

Mësuesja ndihmon nxënësit me pyetje ndihmëse*: Me çfarë po luan Ola? Çfarë bën roboti? Si është komunikimi i qenushit Umi me roboti? Çfarë po bën Ola? Sa është ora në figurë?(nëse nxënësit nuk e lexojnë ndihmohen nga mësuesi/sja? Çfarë lodrash pëlqen më shumë Umi (dinosaurin dhe kërmillin)? Po ju keni robot në shtëpi? Do të donit të kishit një robot në shtëpi? Pse?*

Hapi 5. Demonstron para klasës grafikun e shkronjës së vogël dhe të madhe të shtypit. Nxit nxënësit të bëjnë ngjashmëritë dhe dallimet me shkronjat e tjera p.sh. a dhe objekte të tjera rrethanore.

- Nxiten nxënësit të gjejnë fjalë që fillojnë me **O**, e kanë në trup ose mbarojnë me **O**.

Plotësohet tabela kolektivisht

O	**O**	**O**
Ola	robot	numëro .....

Hapi 6. Nxënësit punojnë individualisht për plotësimin e shkronjave në fjalët mungesore.

Bëhet leximi dhe ndarja e tyre në rrokje. Ngre disa nxënës që shkruajnë fjalët në tabelë. B RA.

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 7. Shkruan fjalinë kryesore në tabelë. *Ola me robot*. Ndahet në etiketa dhe fjalët në rrokje.

Individualisht nxënësit plotësojnë lidhjet e rrokjeve në fjalë sipas figurave e shigjetave. o+ra=ora, o+ra+ri=orari, nu+rë+ron=numëron. Nxënësi tregon që numëron në numëratore.

Lexohen nga nxënësit në zinxhir fjalët e fjalitë e formuara.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Shqipton tingullin zanor **O**.
- ✓ Gjen dhe thotë fjalë që fillojnë me **O** ose që përmbajnë tingullin **o** në trup të tyre.
- ✓ Lexon fjalët e fjalorit të librit*: ora, bora, roboti, orari...*
- ✓ Plotëson sipas figurës fjalët me rrokje mungesore.
- ✓ Formon fjali/ tekst sipas figurës kryesore të faqes.

Detyrë shtëpie:

1. Lexo dhe shkruaj fjalët e librit në fletore.
2. Shkruaj 10-15 fjalë me shkronjën **O**.
3. Kopjo fjalët e faqes dhe shoqëroji me vizatim ato.

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1	**Klasa:** 1
Tema mësimore: **Punim e shkrim i shkronjës O, o, Abetare pune faqe 32**		**Situata e të nxënit:** Ola mëson me orar.	

***Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe**

Nxënësi:

- ***Kompetenca e të nxënit:*** Ndjek udhëzimet e dhëna për të realizuar një veprim/detyrë.
- ***Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin:***
  - Identifikon burimet e nevojshme dhe i përdor në mënyrë të drejtë.
  - Grumbullon materialet e performancës së vet, për pasurimin e portofolit personal.

***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore**

Nxënësi:

- Shkruan shkronjës **O, o** të shtypit sipas modelit.
- Shkruan rrokje, fjalë.
- Formon fjalë duke lidhur rrokjet/shkronjat.
- I përgjigjet pyetjeve shkurt.
- Krijon rrokje me kombinimin e shkronjave.
- Ndan fjalë në rrokje e shkronja.
- Plotëson fjalitë me fjalë sipas kuptimit.

Fjalë kyçe:

Ko, ro, mo, orë , kokë, balonë, mori, Aulona, mora, Ola luan me orë, Nora ka orë

Teknika dhe strategji:

- Punë me grupe
- Analizë-sintezë
- Punë në grupe
- Shkrim i lirë

Burimet e informacionit dhe mjete: Shkronjat individuale dhe kolektive, fletore pune, etiketa me rrokje e fjalë sipas nivelit, shirita me fjalë me shkrim shtypi/figura që nxënësit mund të përdorin për të krijuar fjali.

Lidhja me fushat e tjera:

Lënda: Arte, matematikë

Përshkrimi kontekstual i situatës

- ***Veprimet paraprake***

Hapi 1. Klasa është e ndarë në grupe e punojnë me etiketa sipas niveleve të ndryshme. Mësuesi/ja ka përgatitur etiketa me rrokje, fjalë dhe fjali rreth situatës. Ia shpërndan nxënësve sipas nivelit. Nxënësit lexojnë me zë të lartë. Nxiten nxënësit të korrigjojnë njëri-tjetrin, p.sh *KO, MO, LO, RO, NO, ORË, BALONË, KOKË, KALËRON ME KALË, OLA MORI ORË, NORA, LOLA...*

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 2. Paraqet grafikun e shkronjës **O, o.** Nxit të thonë ndryshimet dhe ngjashmëritë me shkronjat e tjera, p.sh me **A** ose objekte.

Hapi 3. Ngre nxënës në tabelë që shkruajnë disa nga rrokjet, fjalët dhe fjalitë që u shpërndanë në pjesën e parë të orës. Të tjerët mund ti përdorin në fjali ato.

Hapi 4. Punohet sipas kërkesave në fletoren e punës. Modelohet shkronja **O, o** dhe shkruhen rrokjet me shkronja të vogla të shtypit dhe fjalët me shkronja mungesore(orë, balonë, kokë). Nxënësit veprojnë me etiketat, duke u këshilluar të ndjekin drejtimin e shigjetave për lidhjen e rrokjeve në fjalë(formohen *mori, balona, kolona, Aulona...*) dhe plotësimin e zanores në rrokjen e dhënë. Nxënësit lexojnë fjalët e krijuara në etiketat e kuqë dhe blu. Plotësojnë fjalitë sipas figurave dhe shkruajnë *Nora ka orë. Ola mori orën. Nora luan me orë/Ola luan me orë/lola luan me orë.* (Sa fjalë kanë fjalitë?). Bëhet kontrolli individual i fletores.

Hapi 5. Nxënësit shkruajnë me të diktuar me shkrim shtypi fjalitë: Kolona e re, Balona më ra në lumë, Ai mori orën e re.

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 6. Nxënësit lexojnë fjalët dhe fjalitë që krijuan gjatë ushtrimeve në fletoren e punës.
Nxënësit mund të formojnë rrokje, fjalë dhe disa fjali (sipas niveleve) në fletore më fjalët e fjalorit.
(kokë, kolona, ora, balona).

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Shkruan shkronjës **O, o** të shtypit sipas modelit.
- ✓ Shkruan rrokje, fjalë.
- ✓ Formon fjalë duke bashkuar sipas kuptimit shkronjat, rrokjet.
- ✓ I përgjigjet pyetjeve shkurt.
- ✓ Plotësojnë fjalitë sipas kuptimit.
- ✓ Analizon fjalë e fjali.

Detyrë shtëpie:

1. Formo nga fjali me fjalët : *kokë, mori, balonë, kamion, pako.*
2. Përgjigju me fjali të plotë pyetjeve. Nora ka(çfarë?) *orë*. Ola mori (kë?) orën.
3. Kopjo bukur në fletore 3 fjalitë e faqes 32.

Refleksione:

<table>
<tr><td>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla: 1</td><td>Klasa: 1</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore:
Punim e lexim i shkronjës O, o faqe 39 të Abetares</td><td colspan="2">Situata e të nxënit:
Ola mëson me orar</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe
Nxënësi:
➢ Kompetenca e komunikim dhe të shprehurit: Dëgjon një tregim. Identifikon personazhet e një tregimi.
➢ Kompetenca e të nxënit: Parashtron pyetje dhe përgjigje në lidhje me temën.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore
Nxënësi:
✚ Lexon rrokje, fjalë, fjali.
✚ I përgjigjet me fjali të thjeshtë pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit/filmit.
✚ Lidh rrokjet në fjalë.
✚ Rilexon tekstin për të kuptuar përmbajtjen e tij.
✚ Lidh pjesën që lexon me filma që ka parë, ose me përvojat personale.
✚ Plotëson fjalitë duke përshtatur fjalët sipas kuptimit.</td><td colspan="2">Fjalë kyçe: koka. kalon, orari, Në orën 7, Ola luan me robot, Ola mëson me orar, mora, bora, me numra, kamion, limon. kroi.
Teknika dhe strategji :
❖ Parashikim me terma paraprakë
❖ Fragmenti-komenti
❖ Marrëdhënie pyetje-përgjigje
❖ Lexim zinxhir
❖ Analizë- sintezë e fjalisë</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, modele shkronjash individuale, grafiku i shkronjës O, o të shtypit, foto me pamje nga nxënësit gjatë studimit, magnetofon, videoprojektor, lodër për fëmijë orë me kurdisje, orari i klasës .</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë, arte, edukim për shoqërinë</td></tr>
<tr><td colspan="4">Përshkrimi kontekstual i situatës:
▪ Veprimtari paraprake
Hapi 1: Shkruaj në tabelë titullin e tregimit OLA MËSON ME ORAR dhe nxit nxënësit të formojnë fjali/ një tekst të shkurtër sipas fantazisë ose nxitur nga përvoja personale gjatë studimit. Sipas kushteve mund të ndiqet edhe në videoprojektor pjesa nga filmi Kur xhirohej një film(fragmenti i studimit dhe pak nga xhirimi).
(Nxënësit kështillohen të dramatizojnë një pjesë të filmit dhe të mos përsëritin tregimin e librit nëse e kanë lexuar më parë, por të veprojnë me fantazi).
▪ Veprimet në situatë
Hapi 2: Mësuesja kështillon nxënësit të dramatizojnë një situatë studimi të nënës me fëmijën. Bëhet krahasimi me krijimet e komunikimin mes nxënësve.
Hapi 3: Lexohet me intonacion 2-3 herë tregimi. Më pas pyeten nxënësit:
Çfarë përfytyruat? Ku ishit duke studiuar? Çfarë detyrash po bënit ju? Po Ola çfarë detyrash po bënte? Keni ju një orar të rregullt studimi? Si ndjeheni kur studioni mirë? Po kur nuk mbaroni studimin në kohën e duhur? Studimi ju pengon në shfrytëzimin e kohës tuaj të lirë? Pse?
Nxënësit mund të përdorin edhe një orë me bateri apo kurdisje duke provuar herë pas here gjatë orës sa minuta harxhojnë nxënësit për kryerjen e një detyre.</td></tr>
</table>

Hapi 4: Hapen librat. Nxit nxënësit të përshkruajnë figurën. Bëhet leximi i rrokjeve në tabelën e rrokjeve RO, KRO, MO, DO... në korr. Lexohet tregimi disa herë. Listohen disa lëndë që fëmijët studiojnë në klasën e parë. Cila lëndë ju pëlqen më shumë? Shpjegohet përdorimi i pikës dhe shkronjës së madhe në emrat e përveçëm dhe në fillim të fjalisë.

Hapi 5: Më pas lihen nxënësit të lexojnë në heshtje për disa minuta tregimin. Në varësi të numrit të nxënësve në klasë mësuesi/ja bën leximin e tregimit në zinxhir me nga një ose më shumë fjali.

Mund të kërkohet nga nxënësit edhe të lexojnë fjalinë e parë, të dytë e kështu me radhë ose me rend të ngatërruar. Nxënësit që paraqesin vështirësi mund të pyeten për fjalë të veçanta më të thjeshta.

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 6: Diskutim rreth përmbajtjes. *Si e ka titullin tregimi? Sa orë studion Ola? Po ju? Kush ju ndihmon gjatë studimit? Cila lëndë ju pëlqen më shumë?A e studioni ju atë më shpejt? Pse?*

Hapi 7: Nxënësit në mënyrë individuale veprojnë zinxhir për plotësimin e fjalive *Ola mëson me orar. Ola luan me robot. Ola mëson 2 orë.* Diskutojnë në dyshe më shokun e bankës për leximin e fjalive dhe analizën e tyre.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Lexon fjalë, fjali.
- ✓ I përgjigjet me fjali të thjeshtë pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit.
- ✓ Rilexon tekstin për të kuptuar përmbajtjen e tij.
- ✓ Lidh pjesën që lexon me filma që ka parë ose me përvojat personale.

Detyrë shtëpie:

1. Lexo tregimin disa herë.
2. Kopjo 3-4 fjali që të pëlqejnë më shumë nga tregimi.
3. Kopjo rrokjet me shkrim shtypi.
4. Kopjo fjalitë e plotësuara.
5. Krijo 3-4 fjali të thjeshta me fjalët e mësuara.

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	Shkalla: 1	Klasa: 1
Tema mësimore **Ushtrime aplikative për shkrim dore, shkronja O,o.**		**Situata e të nxënit:** Ola mëson me orar	

***Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe**

Nxënësi:

- ***Kompetenca e të nxënit:*** Mbikëqyr në mënyrë të pavarur përparimin e vet në një detyrë duke përdorur detyra të ndryshme. Korrigjon gabimet.
- ***Kompetenca qytetare:*** Bashkëpunon në grup dhe respekton rregullat e grupit.

***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore**	**Fjalë kyçe:**
Nxënësi: - Shkruan shkronjat O, o të dorës duke u ndihmuar nga modeli. - Shkruan shkronjat **O, o** me të gjitha elementet duke e lidhur me shkronjat e tjera . - Shkruan fjalë me të kopjuar duke përdorur shkronjën **O, o** në fillim, në trup të fjalës - Lexon fjalë e fjali me shkrim dore.	*ora, mora, orar, Ola ka orë, Ola luan me orë* **Teknika dhe strategji:** ❖ Vetëdiktim ❖ Lexim në korr ❖ Demonstrim ❖ Punë individuale ❖ Punë në çifte/punë në dyshe ❖ Lexim individual
Burimet e informacionit dhe mjete: Fletore e punës, fletore shkrimi , modele shkronjash individuale, grafiku i shkronjës **O, o** të shtypit dhe të dorës, etiketa me fjalë të mësuara, videoprojektor, fletë të fotokopjuara.	**Lidhja me fushat e tjera:** Arte

Përshkrimi kontekstual i situatës

- ***Veprimtari paraprake***

Hapi 1. Mësuesja nxjerr para klasës disa foto objektesh që kanë në trup O (robot, kamion, karton, orë) dhe nxënësit shkruajnë 2-3 fjali në fletore ose fletë, në formën e vetëdiktimit ose përgatit etiketa të gatshme për secilin nxënës/ ose dyshe nxënësish. Lexojnë fjalët që kanë shkruar me shkrim shtypi.(kamion, mori orën, koka ime, balonë, kolonë e re...)

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 2. Përsëritje e shkronjave të dorës të mësuara deri më tani. Lexim i tyre në korr.
Përsëriten shkronjat **O, o** të shtypit dhe grafiku i tyre.
Nxiten nxënësit të thonë fjalë ose emra që fillojnë me **O,** shkruaj disa prej tyre. Otjela, Olti...

Hapi 3. Shpjegoj grafikun e shkronjës **O, o** të dorës dhe e shoqëruar me lëvizjen në ajër të nxënësve. Shpjegohen elementet përbërës të saj. Nëse ka mundësi mund të ndiqet një grafik i shkronjës në videoprojektor. Bëhet dallimi me shkronjën **O, o** të shtypit.

Ngre nxënës në tabelë që shkruajnë shkronjën dhe lidhjen e saj me shkronjat e tjera në fjalë.*ko, orë, kalon...*

Hapi 4. Më pas nxënësit punojnë në fletoren e punës sipas modelit. Vështirësi paraqet rrumbullakimi i shkronjës **O,** vëzhgohet ky element dhe përforcohet deri në përvetësimin e tij. Kujdes edhe me

shkronjën e madhe të dorës. Nxënësit tregojnë ngjashmërinë me a, lexojnë fjalët dhe fjalitë që shkruhen me shkrim dore.

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 5. Diktim me shkronja dore.

ko, ro, mo, kro, kolona, ora, Ola ka orë, mora, Nora luan me orën e re, Koli iku me kamion.

Nxënësit lexojnë fjalët që shkruajnë me shkronja dore.

Hapi 6. Nxënësit plotësojnë fletët e fotokopjuara me shkrim dore dhe ngjyrosjen e emërtimin e figurave.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Shkruan shkronjat **O, o** të dorës duke u ndihmuar nga modeli.
- ✓ Shkruan shkronjat **O, o** me të gjitha elementet duke e lidhur me shkronjat e tjera .
- ✓ Shkruan fjalë me të kopjuar duke përdorur shkronjën **O, o** në fillim, në trup të fjalës.
- ✓ Lexon fjalë me shkrim dore.

Detyrë shtëpie:

1. Shkruaj nga 3-5 rreshta me shkronja/ rrokje.
2. Shkruaj fjalë me shkronjën *O. o* dhe vizato ato.
3. Kopjo 4 rreshta me modelin *O,a,K,A,i,M,o,n,Ë,R.*
4. Paraqit në forma të ndryshme shkronjën o,O.
5. Kopjo modelet e rreshtave në faqen 32 të fletores së punës.

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1	**Klasa:** 1

Tema mësimore: **Punim i faqes 38-39 të Abetares. Ola mëson me orar.**	**Situata e të nxënit:** Ola mëson me orar

***Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe**

Nxënësi:

- ***Kompetenca e komunikim dhe të shprehurit:***
  - Shpreh mesazhin e një teksti të thjeshtë, nëpërmjet njërës nga format shprehëse: të folurit, shkrimit.
  - Shpreh me gojë para të tjerëve përjetimet dhe emocionet që e kanë shoqëruar gjatë shikimit të një filmi apo dëgjimit të një përralle.
- ***Kompetenca e të nxënit:*** Parashtron pyetje dhe përgjigje për temën në njërën nga format e të shprehurit.
- ***Kompetenca qytetare:*** Diskuton dhe bashkëpunon me anëtarët e grupit.

***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore** Nxënësi: - Qarkon shkronjën **O** në tekste të panjohura. - Lidh sipas kuptimit fjalët për të krijuar fjali. - Plotëson fjalitë me fjalë mungesore. - Shkruan me të kopjuar ose të diktuar. - Lexon fjalë, fjali me shkrim dore. - Interpreton shkrimin e shtypit në shkrim dore.	**Fjalë kyçe:** *ora, orari, orari i mësimeve, roboti, kalon, koka, mora, bora, kamion.* **Teknika dhe strategji:** - Punë individuale - Lexim fjalësh, fjalish - Analizë – sintezë - Punë në dyshe/grup
Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, modele shkronjash individuale, grafiku i shkronjës O, o të shtypit, foto me pamje nga zbatimi i orarit ditor nga mëngjesi deri në mbrëmje/faqe e albumit të abetares, etiketa me fjalë të fjalorit.	**Lidhja me fushat e tjera:** Lënda: Matematikë, art pamor

Përshkrimi kontekstual i situatës

- ***Veprimtari praktike***

Hapi 1. Mësuesi/ja shpërndan një tekst *(mundësisht me temë sipas situatës)* në të cilën nxënësit duhet të qarkojnë shkronjën **O**, të lexojnë fjalë, fjali sipas nivelit të kompetencave të nxënësve.

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 2. Përsëritje në korr e shkronjave të shtypit dhe të dorës, të mësuara deri tani.
Nxënësit tregojnë se sa shkronja **O, o** kanë gjetur në tekstet e mësipërme.
Për nxënës më të përparuar mund t'u kërkohet të lexojnë fjalë ose fjali nga teksti.

Hapi 3. Punohet me pjesën e fundit të faqeve **38** dhe **39**.
Rilexojnë nxënësit fjalitë : ***Ola luan me robot. Ori kaloi me makinë. Ola mori orarin. Nora luan me numra. Ola mëson me orar.*** Bëhet krahasimi i fjalive për gjetjen e ngjashmërive dhe ndryshimeve mes tyre. Bëhet ndarja e fjalive në etiketa. U kërkohet nxënësve të gjejnë sa fjalë kanë fjalitë dhe të dallojnë fjalët e ngjashme dhe pozicionet e tyre në fjali të ndryshme.

Hapi 4. Lihen nxënësit të punojnë individualisht për plotësimin e fjalëve sipas shigjetave dhe të lidhin sipas kuptimit fjalët e fjalive, fundi i faqes **38.** Leximi i tyre zinxhir. Më tej punohet për

ushtrimet e fundit të faqes **39** për plotësimin e fjalive me fjalët e dhëna në të djathtë**.** Ola mëson me orar. Ola luan me robot. Ola mëson 2 orë. Më tej veprohet për lidhjen e rrokjeve sipas shigjetave në fjalë dhe shkrimin e tyre në fletore**.** Shkruhen me të kopjuar dhe lexohen fjalët e fundit të faqes **39** ***kroi, karota, ora, orari.***

Hapi 5. Mund të aplikohet dhe puna në dyshe ose grup sipas përbërjes së nxënësve të klasës. Lexohen fjalitë dhe korrigjojnë ata që nuk i kanë lidhur ose shkruar saktë. Bëhet rileximi nga nxënësit që nuk e kishin shkruar saktë që në fillim.

Hapi 6. Pasi lexojnë tekstin e faqes **39** nxënësit iu përgjigjen pyetjeve që ua drejtojnë njëri-tjetrit: Kur mëson Ola? Me kë mëson? Cilën lëndë mëson më shumë, po më shpejt?

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 7. Në fletoren e klasës, nxënësit shkruajnë me shkrim dore/shtypi fjalët dhe fjalitë që formuan në fundin e faqeve **38** dhe **39.** Nxënësit lexojnë fjalitë nga fletorja e tyre.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Qarkon shkronjën **O** në tekste të panjohura.
- ✓ Lidh sipas kuptimit fjalët për të krijuar fjali.
- ✓ Plotëson fjalë mungesore.
- ✓ Shkruan me të kopjuar ose të diktuar.
- ✓ Lexon fjalë, fjali me shkrim dore.
- ✓ Lexon tekste të shkurtra.

Detyrë shtëpie:

1. Kopjo me shkronja dore fjalitë që formove në klasë faqe 38.
2. Shkruaj 3 fjali nga teksti i faqes 39.
3. Vizato objekte që kanë në trup **O** dhe emërto ato.
4. Përdor në fjali të thjeshta fjalët e librit.

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1	**Klasa:** 1
Tema mësimore: **Punim i shkronjës P, p faqe 40 të Abetares**		**Situata e të nxënit:** Në shitore	

***Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe**

Nxënësi:

- ***Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit:*** Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar.
- ***Kompetenca e të nxënit:*** Parashtron pyetje dhe përgjigje në lidhje me temën.
- ***Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin:*** Gjen të përbashkëtat dhe ndryshimet ndërmjet aktiviteteve që bën në shkollë me ato në shtëpi.

***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore**

Nxënësi:

- Shqipton tingullin **P.**
- Gjen dhe thotë fjalë që fillojnë me **P** ose që përmbajnë shkronjën **p** në trup të tyre.
- Lexon fjalët e fjalorit të librit: *pula, peceta, piperi, patate...*
- Plotëson sipas figurës fjalët me shkronja mungesore.
- Lidh rrokjet në fjalë.
- Analizon fjalë e fjali.
- Formon fjali/ tekst sipas figurës kryesore të faqes.

Fjalë kyçe: *pula, peceta, piperi, patate, piruni, ushqime të shëndetshme.*

Teknika dhe strategji:

- Bisedë
- Marrëdhënie pyetje-përgjigje
- Vëzhgim
- Demonstrim
- Punë individuale/Çift

Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, modele shkronjash individuale, grafiku i shkronjës **P, p** të shtypit, foto ushqimesh, foto e madhe e piramidës ushqimore, mbulesë, pecetë, pirun dhe thikë plastike. fletë të fotokopjuara.

Lidhja me fushat e tjera: Lënda: Art pamor, matematikë, shkencë, edukim për shoqërinë.

Përshkrimi kontekstual i situatës:

- ***Veprimtari paraprake:***

Hapi 1. - Improvizohet një situatë të ngrëni, ku nxënësit demonstrojnë përdorimin e pirunit dhe thikës në tryezë. Bisedë për rëndësinë e ushqyerjes së shëndetshme dhe rregullat e ngrënies në tryezë. Shkruhen disa emra ushqimesh që fillojnë me P ose e kanë në trup shkronjën p.

- Mësuesja tregon para klasës piramidën ushqimore dhe foto të ushqimeve të ndryshme. Kujtojmë ç'kemi mësuar për ushqime të shëndetshme dhe ushqime jo të shëndetshme. Përmendi disa ushqime të shëndetshme. Shkruhen disa emra ushqimesh që fillojnë me P ose e kanë në trup shkronjën P.(Sugjerohet përdorimi i njërës nga situatat sipas kushteve dhe mundësive.)

Nxënësit këshillohen të vërejnë fotot dhe të komentojnë duke argumentuar edhe me raste e ngjarje konkrete. Nxënësit listojnë ushqimet që preferojnë më shumë. Sugjerohet edhe dëgjimi i këngës së shkronjës **P**. (*Qafëgjatë e kokëvogël/që i duket sa një gogël. Pendë boll sa s'ke ç'i thua, por patoku s'është pallua...)*/vjersha e shkronjës **P**.

Hapi 2. Në klasë nxënësit nxiten të diskutojnë për veprimtaritë ditore në lidhje me ushqimin dhe

mënyrat e konsumimit.(përdorimi dhe vendosja e lugës, pirunit, thikës.)

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 3. Përsëritje në korr e shkronjave të mësuara. Dallimi i zanoreve dhe bashkëtingëlloreve. Nxënësit shkruajnë në A4 disa nga shkronjat e mësuara madje edhe rrokje e fjalë me to. Shkruhen vetëm bashkëtingëlloret në dërrasë ku shtohet edhe tingulli i ditës.

Hapi 4. Nxiten nxënësit të vërejnë figurën në libër dhe të formojnë fjali ose një tekst të shkurtër. Mësuesja ndihmon nxënësit me pyetje ndihmëse *: Çfarë konsumoni ju gjatë ditës sipas vakteve? Sa është ora në figurë?(mund të lexohet një dietë ditore nga mësuesi/ja?) Çfarë ushqimesh ju pëlqejnë më shumë (fruta ose perime)? Po ushqimet e paraqitura në tryezë i konsumoni ju? Do të donit të kishit një tjetër ushqim në tryezën tuaj? Pse? Kë?*

Hapi 5. Demonstron para klasës grafikun e shkronjës së vogël dhe të madhe të shtypit. Nxit nxënësit të bëjnë ngjashmëritë dhe dallimet me shkronjat e tjera p.sh R dhe objekte të tjera rrethanore.
Nxiten nxënësit të gjejnë fjalë që fillojnë me **P**, e kanë në trup ose mbarojnë me **p**.
Plotësohet tabela kolektivisht

P	**P**	**P**
Petriti	supë	turp .....

Hapi 6. Nxënësit punojnë individualisht për plotësimin e shkronjave në fjalët mungesore.
Bëhet leximi dhe ndarja e tyre në rrokje. Ngre disa nxënës që shkruajnë fjalët në tabelë. ULA.

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 7. Shkruan fjalinë kryesore në tabelë. *Pjatë me perime*. Ndahet në etiketa dhe fjalët në rrokje.
Individualisht nxënësit plotësojnë ndarjen e fjalëve në rrokjeve.
Lexohen nga nxënësit në zinxhir fjalët e fjalitë e formuara.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Shqipton tingullin zanor **P.**
- ✓ Gjen dhe thotë fjalë që fillojnë me **P** ose që përmbajnë tingullin **p** në trup të tyre.
- ✓ Lexon fjalët e fjalorit të librit: *pula, peceta, piperi, patate...*
- ✓ Plotëson sipas figurës fjalët me rrokje mungesore.
- ✓ Formon fjali/ tekst sipas figurës kryesore të faqes.

Detyrë shtëpie:

1. Lexo dhe shkruaj fjalët e librit në fletore.
2. Shkruaj 10-15 fjalë me shkronjën **P.**
3. Kopjo fjalët e faqes dhe shoqëroji me vizatim ato.

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikim	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1	**Klasa:** 1
Tema mësimore: **Punim e shkrim i shkronjës P, p, Abetare pune faqe 33**		**Situata e të nxënit:** Në shitore.	

***Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe**

Nxënësi:

- ***Kompetenca e të nxënit:*** Ndjek udhëzimet e dhëna për të realizuar një veprim/detyrë.
- ***Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin:***
  - Identifikon burimet e nevojshme dhe i përdor në mënyrë të drejtë.
  - Grumbullon materialet e performancës së vet, për pasurimin e portofolit personal.

***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore**

Nxënësi:

- Shkruan shkronjës **P, p** të shtypit sipas modelit.
- Shkruan rrokje, fjalë.
- Formon fjalë duke lidhur rrokjet/shkronjat.
- I përgjigjet pyetjeve shkurt.
- Krijon rrokje me kombinimin e shkronjave.
- Ndan fjalë në rrokje e shkronja.
- Plotëson fjalitë me fjalë sipas kuptimit.
- Analizon fjalinë në fjalë.

Fjalë kyçe: *pa, pe, pë, po, pu, pro, pema, parku, kapele, palma, përpara, panorama, pranë,pak, prapa*

Teknika dhe strategji:

- Punë me grupe
- Analizë-sintezë
- Punë në grupe
- Shkrim i lirë

Burimet e informacionit dhe mjete: Shkronjat individuale dhe kolektive, fletore pune, etiketa me rrokje e fjalë sipas nivelit, shirita me fjalë me shkrim shtypi/figura, objekte, lodra që nxënësit mund të përdorin për të krijuar fjali.

Lidhja me fushat e tjera:
Lënda: Arte, matematikë

Përshkrimi kontekstual i situatës

- ***Veprimet paraprake***

Hapi 1. Klasa është e ndarë në grupe e punojnë me etiketa sipas niveleve të ndryshme. Mësuesi/ja ka përgatitur etiketa me rrokje, fjalë dhe fjali rreth situatës. Ua shpërndan ato nxënësve sipas nivelit. Nxënësit lexojnë me zë të lartë. Nxiten nxënësit të korrigjojnë njëri-tjetrin. p.sh., *PO, PI. PA, PE, PË, PEMË, KAPELE, PAKO, PARKU, PALMË, PËRPARA, PAK, PRAPA...*

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 2. Paraqet grafikun e shkronjës **P, p.** Nxit të thonë ndryshimet dhe ngjashmëritë me shkronjat e tjera, p.sh me **R** ose objekte.

Hapi 3. Ngre nxënës në tabelë që shkruajnë disa nga rrokjet, fjalët dhe fjalitë që u shpërndanë në pjesën e parë të orës. Të tjerët mund ti përdorin në fjali ato.

Hapi 4. Punohet sipas kërkesave në fletoren e punës. Modelohet shkronja **P, p** dhe shkruhen rrokjet me shkronja të vogla të shtypit dhe fjalët me shkronja mungesore (pema, parku, kapele). Nxënësit veprojnë me etiketat, duke u këshilluar të ndjekin drejtimin e shigjetave për lidhjen e shkronjave në rrokje. Analizohen fjalët (*palma, panorama, përpara...*) në rrokje e shkronja. Nxënësit lexojnë fjalët e krijuara në etiketat me ngjyra. (Sa fjalë kanë fjalitë?).Komentojnë figurat dhe iu përgjigjen pyetjeve që iu drejtojnë njëri-tjetrit. Bëhet kontrolli individual i fletores.

Hapi 5. Nxënësit shkruajnë me të diktuar me shkrim shtypi fjalitë: Pema e re, Parku me lule, Pula me pupla. ▪ ***Demonstrim i rezultateve të arritura*** **Hapi 6.** Nxënësit lexojnë fjalët dhe fjalitë që krijuan gjatë ushtrimeve në fletoren e punës. Nxënësit mund të formojnë rrokje, fjalë dhe disa fjali (sipas niveleve) në fletore më fjalët e fjalorit. *(pemë, kapele, parku, palma)*
Vlerësimi i situatës: ***Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:*** ✓ Shkruan shkronjës **P, p** të shtypit sipas modelit. ✓ Shkruan rrokje, fjalë. ✓ Formon fjalë duke bashkuar sipas kuptimit shkronjat, rrokjet. ✓ I përgjigjet pyetjeve shkurt. ✓ Plotësojnë fjalitë sipas kuptimit. ✓ Analizon fjalë e fjali.
Detyrë shtëpie: 1. Formo nga fjali me fjalët : *pemë, parku, kapele, pako.* 2. Përgjigju me fjali të plotë pyetjeve. Parku ka(çfarë?) *pemë*. Ola mori (kë?) kapelën. 3. Kopjo bukur në fletore 3 rreshta me fjalët e faqes 33.
Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1	**Klasa:** 1
Tema mësimore: **Punim e lexim i shkronjës P, p faqe 41 të Abetares**		**Situata e të nxënit:** Në shitore	

***Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe**

Nxënësi:

- ***Kompetenca e komunikim dhe të shprehurit:***
  - Dëgjon një tregim. Identifikon personazhet e një tregimi.
  - Lexon me zë një tekst së paku prej gjysmë faqeje të pa lexuar më parë.
- ***Kompetenca e të nxënit:*** Parashtron pyetje dhe përgjigje në lidhje me temën.

***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore**

Nxënësi:

- Lexon rrokje, fjalë, fjali.
- I përgjigjet me fjali të thjeshtë pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit/filmit.
- Lidh rrokjet në fjalë.
- Rilexon tekstin për të kuptuar përmbajtjen e tij.
- Lidh pjesën që lexon me filma që ka parë, ose me përvojat personale.
- Plotëson fjalitë duke përshtatur fjalët sipas kuptimit.

Fjalë kyçe: *perime, fruta, qepë, presh, patate, panxhar, pula, pupla.*

Teknika dhe strategji:

- Parashikim me terma paraprakë
- Fragmenti-komenti
- Marrëdhënie pyetje-përgjigje
- Lexim zinxhir.
- Analizë-sintezë e fjalisë

Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, modele shkronjash individuale, grafiku i shkronjës **P, p** të shtypit, foto me pamje nga një shitore, magnetofon, videoprojektor, lodër kasë dyqani, lloje të ndryshme frutash dhe perimesh.

Lidhja me fushat e tjera: Matematikë, arte, edukim për shoqërinë

Përshkrimi kontekstual i situatës:

- ***Veprimtari paraprake***

Hapi 1: Shkruaj në tabelë titullin e tregimit NË SHITORE dhe nxit nxënësit të formojnë fjali/një tekst të shkurtër sipas fantazisë ose nga përvoja personale gjatë një vizite në shitore. Sipas kushteve mund të ndiqet edhe në videoprojektor një fragment apo foto nga një ditë me prindërit në shitore.*(Nxënësit këshillohen të dramatizojnë një pjesë të vizitës në shitore dhe të mos përsëritin tregimin e librit nëse e kanë lexuar më parë, por të veprojnë me fantazi).*

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 2: Mësuesja këshillon nxënësit të dramatizojnë një situatë në shitore/supermarket të nënës me fëmijën. Bëhet krahasimi me krijimet e komunikimin mes nxënësve.

Hapi 3: Lexohet me intonacion 2-3 herë tregimi. Më pas pyeten nxënësit:

Çfarë përfytyruat? Ku ishit duke bërë pazar? Me kë ishte Ola në shitore? Çfarë perimesh po blinin ata? Po Ola çfarë kishte në dorë? Dilni ju shpesh me prindërit për pazar? Si ndjeheni? Po kur prindërit nuk ju blenë gjërat që dëshironi? Si veproni? Pse?

Nxënësit mund të përdorin edhe një peshore apo shportë me fruta për të konkretizuar një situatë në shitore.

Hapi 4: Hapen librat. Nxit nxënësit të përshkruajnë figurën. Bëhet leximi i rrokjeve në tabelën e

rrokjeve PRO, PRA, PO, APO, PI... në korr. Lexohet tregimi disa herë. Listohen disa fruta që fëmijët konsumojnë më shumë. Cili/a frut/perime ju pëlqen më shumë? Cilat janë disa nga ushqimet që ju blini në shitoret pranë shtëpisë?

Hapi 5: Më pas lihen nxënësit të lexojnë në heshtje për disa minuta tregimin. Nxënësit në klasë të ndarë në grupe bëjnë leximin me role të tregimit. (Ani, Ola)

Mund të kërkohet nga nxënësit edhe të lexojnë fjalinë e parë, të dytë e kështu me radhë ose me rend të ngatërruar. Nxënësit që paraqesin vështirësi mund të pyeten për fjalë të veçanta më të thjeshta.

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 6: Diskutim rreth përmbajtjes. *Si e ka titullin tregimi? Çfarë bleu mami Pranvera në shitore? Po ju? Kush ju shoqëron në shitore? Cilat perime ju pëlqejnë më shumë? Po frutat e preferuara cilat janë?*

Hapi 7: Nxënësit në mënyrë individuale veprojnë për plotësimin e pyetjeve: *Ku është Ana? Ku është Umi? Ku është Ani?* Diskutojnë në dyshe më shokun e bankës për leximin e fjalive të plotësuara.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Lexon fjalë, fjali.
- ✓ I përgjigjet me fjali të thjeshtë pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit.
- ✓ Rilexon tekstin për të kuptuar përmbajtjen e tij.
- ✓ Lidh pjesën që lexon me filma që ka parë ose me përvojat personale.

Detyrë shtëpie:

1. Lexo tregimin disa herë.
2. Kopjo 3-4 fjali që të pëlqejnë më shumë nga tregimi.
3. Kopjo rrokjet me shkrim shtypi.
4. Kopjo fjalitë e plotësuara.
5. Krijo 3-4 fjali të thjeshta me fjalët e mësuara.

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1	**Klasa:** 1
Tema mësimore **Ushtrime aplikative për shkrim dore, shkronja *P, p*.**		**Situata e të nxënit:** Në shitore.	

***Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe**

Nxënësi:

- ***Kompetenca e të nxënit:*** Mbikëqyr në mënyrë të pavarur përparimin e vet në një detyrë duke përdorur detyra të ndryshme. Korrigjon gabimet.
- ***Kompetenca qytetare:*** Bashkëpunon në grup dhe respekton rregullat e grupit.

***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore**	**Fjalë kyçe:** *pula, pupla, pema, ka, Parku ka pemë, panorama, prapa*
Nxënësi: - Shkruan shkronjat *P, p* të dorës duke u ndihmuar nga modeli. - Shkruan shkronjat **P, p** me të gjitha elementet duke e lidhur me shkronjat e tjera. - Shkruan fjalë me të kopjuar duke përdorur shkronjën **P, p** në fillim, në trup të fjalës. - Lexon fjalë e fjali me shkrim dore.	**Teknika dhe strategji:** - Vetëdiktim - Lexim në korr - Demonstrim - Punë individuale - Punë në çifte/punë në dyshe - Lexim individual
Burimet e informacionit dhe mjete: Fletore e punës, fletore shkrimi , modele shkronjash individuale, grafiku i shkronjës **P, p** të shtypit dhe të dorës, etiketa me fjalë të mësuara, videoprojektor, fletë të fotokopjuara.	**Lidhja me fushat e tjera:** Arte

Përshkrimi kontekstual i situatës

- ***Veprimtari paraprake***

Hapi 1. Mësuesi/ja nxjerr para klasës disa foto objektesh që kanë në trup P (pemë, perime, park, papion, pata) dhe nxënësit shkruajnë 2-3 fjali në fletore ose fletë, në formën e vetëdiktimit ose përgatit etiketa të gatshme për secilin nxënës/ose dyshe nxënësish. Lexojnë fjalët që kanë shkruar me shkrim shtypi.
(perime, parkon, para, parku, koka, pula me pupla, kapele e re...)

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 2. Përsëritje e shkronjave të dorës të mësuara deri më tani. Lexim i tyre në korr.
Përsëriten shkronjat **P, p** të shtypit dhe grafiku i tyre. Nxiten nxënësit të thonë perime ose emra që fillojnë me **P,** shkruaj disa prej tyre. Platoni, Pranvera, patate, presh, panxhar...

Hapi 3. Shpjegoj grafikun e shkronjës **P, p** të dorës dhe e shoqëruar me lëvizjen në ajër të nxënësve. Shpjegohen elementet përbërës të saj. Nëse ka mundësi mund të ndiqet një grafik i shkronjës në videoprojektor. Bëhet dallimi me shkronjën **P, p** të shtypit.

Ngre nxënës në tabelë që shkruajnë shkronjën dhe lidhjen e saj me shkronjat e tjera në fjalë. *po, pra..*

Hapi 4. Më pas nxënësit punojnë në fletoren e punës sipas modelit. Vështirësi paraqet grepi lidhës i shkronjës **P,** vëzhgohet ky element dhe përforcohet deri në përvetësimin e tij. Kujdes edhe me shkronjën e madhe të dorës. Nxënësit tregojnë ngjashmërinë me u, n lexojnë fjalët dhe fjalitë që shkruhen me shkrim dore.

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 5. Diktim me shkronja dore.

po, pro, pema, parku, kapele, kapak , Ola iku në park, panorama, Nora luan pranë palmës, Kela preu pemën.

Nxënësit lexojnë fjalët që shkruajnë me shkronja dore.

Hapi 6. Nxënësit plotësojnë fletët e fotokopjuara me shkrim dore dhe ngjyrosjen e emërtimin e figurave/ shkruajnë 2-3 rreshta me shkronjat e dorës e vizatojnë dhe emërtojnë ato.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Shkruan shkronjat **P, p** të dorës duke u ndihmuar nga modeli.
- ✓ Shkruan shkronjat **P, p** me të gjitha elementet duke e lidhur me shkronjat e tjera.
- ✓ Shkruan fjalë me të kopjuar duke përdorur shkronjën **P, p** në fillim, në trup të fjalës.
- ✓ Lexon fjalë me shkrim dore.

Detyrë shtëpie:

1. Shkruaj nga 3-5 rreshta me shkronja/rrokje.
2. Shkruaj fjalë me shkronjën *P. p* dhe vizato ato.
3. Kopjo 5 rreshta me modelin *O,r,P,A,p,M,o,n,Ë,R.*
4. Paraqit në forma të ndryshme shkronjën p, P .
5. Kopjo modelet e rreshtave në faqen 33 të fletores së punës.

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1	**Klasa:** 1
Tema mësimore: **Punim i faqes 40-41 të Abetares. Në shitore.**		**Situata e të nxënit:** Në shitore.	

***Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe**

Nxënësi:

- ***Kompetenca e komunikim dhe të shprehurit:***
  - Shpreh mesazhin e një teksti të thjeshtë, nëpërmjet njërës nga format shprehëse: të folurit, shkrimit.
  - Shpreh me gojë para të tjerëve përjetimet dhe emocionet që e kanë shoqëruar gjatë shikimit të një filmi apo dëgjimit të një përralle.
- ***Kompetenca e të nxënit:*** Parashtron pyetje dhe përgjigje për temën në njërën nga format e të shprehurit.
- ***Kompetenca qytetare:*** Diskuton dhe bashkëpunon me anëtarët e grupit.

***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore**

Nxënësi:

- Qarkon shkronjën **P** në tekste të panjohura.
- Lidh sipas kuptimit fjalët për të krijuar fjali.
- Plotëson fjalët me shkronja mungesore.
- Shkruan me të kopjuar ose të diktuar.
- Lexon fjalë, fjali me shkrim shtypi e dore.
- Interpreton shkrimin e shtypit në shkrim dore.

Fjalë kyçe:

pulë, patate, presh, spec, pula ka pupla, para, pranë, prapa, pas, fruta e perime

Teknika dhe strategji:

- Punë individuale
- Lexim fjalësh, fjalish
- Analizë – sintezë
- Punë në dyshe/grup

Burimet e informacionit dhe mjete:

Libri i nxënësit, modele shkronjash individuale, grafiku i shkronjës P, p të shtypit, foto me pamje nga një shitore, etiketa me fjalë të fjalorit apo fjali, lloje perimesh të stinës.

Lidhja me fushat e tjera:

Lënda: Matematikë, art pamor

Përshkrimi kontekstual i situatës

- ***Veprimtari praktike***

Hapi 1. Mësuesi/ja shpërndan një tekst *(mundësisht me temë sipas situatës)* në të cilën nxënësit duhet të qarkojnë shkronjën **P**, të lexojnë fjalë, fjali sipas nivelit të kompetencave të nxënësve.

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 2. Përsëritje në korr e shkronjave të shtypit dhe të dorës, të mësuara deri tani.

Nxënësit tregojnë se sa shkronja **P, p** kanë gjetur në tekstet e mësipërme/një grup të voglat e shtypit e tjetra shkronjat e mëdha. Për nxënës më të përparuar mund t'u kërkohet të lexojnë fjalë ose fjali nga teksti.

Hapi 3. Punohet me pjesën e fundit të faqeve **40** dhe **41**.

Rilexojnë nxënësit fjalitë: ***Në pjatë ka plot perime. Në shitore ka plot fruta e perime. Pula ka pupla.*** Bëhet krahasimi i fjalive për gjetjen e ngjashmërive dhe ndryshimeve mes tyre. Bëhet ndarja e fjalive në etiketa. U kërkohet nxënësve të gjejnë sa fjalë kanë fjalitë dhe të dallojnë fjalët e ngjashme dhe pozicionet e tyre në fjali të ndryshme.

Hapi 4. Lihen nxënësit të punojnë individualisht për plotësimin e fjalëve me shkronja mungesore

dhe të lidhjen sipas kuptimit të fjalëve në fjali, fundi i faqes **40**. (Unë ha pulë...) Leximi i tyre zinxhir. Më tej punohet për ushtrimet e fundit të faqes **41** për plotësimin e fjalive nxitur nga figura dhe duke iu përgjigjur pyetjeve**.** Ana është para pemës. Umi është pranë Anës. Ani është pas pemës. Më tej veprohet për leximin e fjalëve në etiketat me ngjyra dhe shkrimin e tyre në fletore. Shkruhet me të kopjuar nga shkrim shtypi në dore fjalia e fundit të faqes **41** ***Pula ka pupla.***

Hapi 5. Mund të aplikohet dhe puna në dyshe ose grup sipas përbërjes së nxënësve të klasës. Lexohen fjalitë dhe korrigjojnë ata që nuk i kanë lidhur ose shkruar saktë. Bëhet rileximi nga nxënësit që nuk ishin të saktë në fillim.

Hapi 6. Pasi lexojnë me role tekstin e faqes **41** nxënësit iu përgjigjen pyetjeve që ua drejtojnë njëri-tjetrit: Ku shkoi Ola me Anin? Me kë ishin në shitore? Cilat perime e fruta konsumoni më shumë, po më pak?

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 7. Në fletoren e klasës, nxënësit shkruajnë me shkrim dore/shtypi fjalët dhe fjalitë që formuan në fundin e faqeve **40** dhe **41**. Nxënësit lexojnë fjalitë nga fletorja e tyre.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Qarkon shkronjën **P** në tekste të panjohura.
- ✓ Lidh sipas kuptimit fjalët për të krijuar fjali.
- ✓ Plotëson fjalë mungesore.
- ✓ Shkruan me të kopjuar ose të diktuar.
- ✓ Lexon fjalë, fjali me shkrim shtypi e dore.
- ✓ Lexon me role tekste të shkurtra.

Detyrë shtëpie:

1. Kopjo me shkronja dore fjalitë që formove në klasë faqe 40.
2. Shkruaj 3-5 fjali nga teksti i faqes 41.
3. Vizato objekte që kanë në trup **P** dhe emërtoi ato.
4. Përdor në fjali të thjeshta fjalët e librit.

Refleksione:

PËRSËRITJE E GRUPIT TË DYTË TË SHKRONJAVE

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1	**Klasa:** 1

Tema mësimore: **Punim i faqes 42 të Abetares.**	**Situata e të nxënit:** Pema e shkronjave

***Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe**

Nxënësi:

- ***Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit:*** Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar.
- ***Kompetenca e të nxënit:*** Ndjek udhëzimet e dhëna për të realizuar një detyrë që i kërkohet.
- ***Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin:*** Identifikon burimet e nevojshme (materiale,mjete) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre.

***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore** Nxënësi: - Shqipton tingujt **R, U, L, K, O, P.** - Gjen dhe thotë fjalë që fillojnë me **R, U, L, K, O, P.** ose që përmbajnë ato shkronja në trup të tyre.(në pozicione të ndryshme) - Lexon rrokje dhe fjalët e fjalorit të librit. - Ndan fjalët në rrokje sipas udhëzimit. - Plotëson sipas modelit bashkimin e rrokjeve në fjalë. - Analizon fjalinë në fjalë. - Dallon fjalët në fjali dhe i lexon globalisht ato.	**Fjalë kyçe:** kali, kaltra, ariu, miu, Mira, Rei, Rona, Ola, patate, perime, muri, pula, urim, topi, mali **Teknika dhe strategji:** ❖ Bisedë ❖ Vëzhgim ❖ Demonstrim ❖ Punë individuale/Çift ❖ Vizatim/Emërtim ❖ Analizë-sintezë

Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, modele të grafikut të shkronjave **R, r, U, u, L, l, K, k, O, o, P, p** të shtypit, foto të disa perimeve, etiketa me fjalë e fjali të fjalorit, tabela e rrokjeve.	**Lidhja me fushat e tjera:** Lënda: Matematikë, Arte,Shoqëria dhe mjedisi.

Përshkrimi kontekstual i situatës:

- ***Veprimtari paraprake:***

Hapi 1. Fillon me një bisedë për alfabetin e gjuhës shqipe si dhe raportin e zanoreve me bashkëtingëlloret në të. Ngjyrosjen e shkronjave që janë mësuar deri më tani në alfabetin e shqipes. Shtohen simbolet R, r e shkronjave të mësuara në pemë. Listojnë edhe disa emra perimesh. Disa prej tyre edhe mund të shkruhen në dërrasë.(3 min)

Hapi 2. Nxënësit nxiten të vërejnë fjalët në etiketa dhe të dallojnë shkronjat e vogla nga të mëdha të shtypit.

Veprimet në situatë

Hapi 3. Hapet libri dhe lexohen shkronjat e mësuara deri më tani në ushtrimin 1. Emërtohen figurat e ushtrimit të dytë, bisedë e udhëzime për qarkimin e figurave që përmbajnë në trup shkronjat R,U,L,K,O,P. Nxënësit mund të përdorin në fjali disa prej tyre.

Lexohen fjalët dhe fjalitë me radhë duke ndarë fjalët nga njëra-tjetra. Punohet në grupe me etiketa ose në dërrasë me disa fjali p.sh.

MIRI/KA/ORË/ME/RËRË. MARA/LUAN/ME/LEPURIN.
EMI/LUAN/ME/REIN. KOLI/KA/TOP/TË/RI.
ANI/PA/PERIME/NË/ARË. PEMA/KA/ LULE/ME/ERË.

Kryhet procesi i analizës për shkëputjen e fjalëve nga njëra-tjetra. (nxënësit dallojnë fjalët e gjata nga ato të shkurtra).

Hapi 4. Ushtrohen në leximin e rrokjeve të rregullta mes shkronjave dhe sintezën e tyre në një fjalë të vetme në fjalë të gjata p.sh., KINEMA, KINKALERI, MAKARONA, KARAMELE.
Hapi 5. Nxiten nxënësit që disa prej fjalëve t'i përdorin edhe në fjali. Lexohet tabela e rrokjeve individualisht zinxhir.
Hapi 6. Nxënësit punojnë individualisht për shkrimin e fjalëve të dhëna me shkrim të vogël shtypi dhe me shkrim dore. p.sh., RINA-Rina,*Rína.* Kujtohet fakti që emrat e njerëzve shkruhen me shkronjë të madhe. Bëhet leximi dhe përdorimi në fjali i tyre (nëse premton koha). Ngre disa nxënës që të shkruajnë fjalët në tabelë.

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 7. Shkruhen apo paraqiten fjalët kryesore në tabelë.
Lexohen nga nxënësit në zinxhir fjalët e faqes 42 apo ato në etiketa.

Vlerësimi i situatës:
Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Shqipton tingujt zanor **A,I,E,Ë,U,O** dhe bashkëtingëlloret **M,N,R,L,K,P.**
- ✓ Lexon rrokjet.
- ✓ Lexon fjalët e librit dhe analizon sipas udhëzimit.
- ✓ Qarkon shkronjat e mësuara.
- ✓ Komenton figurat.
- ✓ Analizon fjalët e fjalisë.

Detyrë shtëpie:

1. Lexo dhe shkruaj fjali me fjalët e librit në fletore.
2. Shkruaj nga 3-5 fjalë me shkronjat **R, U, L, K, O, P.**
3. Kopjo emrat e dy rreshtave faqe 42 me shkrim shtypi ose dore.

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikim	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1	**Klasa:** 1
Tema mësimore: **Punim i faqes 34 të Abetares së punës**		**Situata e të nxënit:** Pema e shkronjave	
Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe** Nxënësi: ➢ ***Kompetenca e të nxënit: Ndjek udhëzimet e dhëna për të realizuar një veprim. ➢ ***Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin:*** Identifikon burimet e nevojshme dhe i përdor në mënyrë të drejtë.			
***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore** Nxënësi: - Shkruan rrokje e fjalë me shkronja shtypi e dore duke i lidhur sipas modelit. - Shkruan me të kopjuar rrokje, fjalë. - Plotëson fjalët që iu mungojnë disa shkronja. - I plotëson fjalët e fjalisë sipas kuptimit. - Ndan fjalët në rrokje dhe anasjelltas.		**Fjalë kyçe:** kali, erë, kamion, makinë, pako, karamele, perime, kapele, park, lumë, orë **Teknika dhe strategji:** ❖ Diskutim për njohuritë paraprake. ❖ Lexim global. ❖ Marrëdhënie pyetje-përgjigje. ❖ Punë në dyshe.	
Burimet e informacionit dhe mjete: Shkronjat individuale dhe kolektive, fletore pune, etiketa me rrokje e fjalë, mjete vizatimi, magnetofon, A4, fletë të fotokopjuara me fjalë që përmbajnë shkronjat e mësuara në pozicione të ndryshme madje dhe fjalë të shkruara në etiketa, lodra për demostrim: kalë, kamion, orë, karamele, lepur...		**Lidhja me fushat e tjera:** Matematikë, Arte, Shoqëria dhe mjedisi	
Përshkrimi kontekstual i situatës ▪ ***Veprimtari paraprake*** **Hapi 1.** Lexohen tingujt e shkronjave në pemën e shkronjave që qëndron e varur në muret e klasës. Mësuesja ka përgatitur etiketa me rrokje e fjalë dhe figura të situatës (kalë, kamion, orë, karamele, lepur). Nxënësit lexojnë me zë të lartë fjalët e dhëna. Nxiten nxënësit të korrigjojnë apo plotësojnë njëri – tjetrin gjatë leximit global. Mund të lexohen edhe fjalë e emra që fillojnë me shkronjat e mësuara. ▪ ***Veprimet në situatë*** **Hapi 2.** Paraqiten fotot e faqes. I nxis nxënësit të thonë ndryshimet dhe ngjashmëritë mes shkronjave. Nxënësit veprojnë në A4 për shkrimin e shkronjave në dyshe R,r,U,u,L,l,K,k,O,o, P,p.(Nxënësit mund të veprojnë edhe në grupe njëri grup shkronjat e mëdha e tjetri të vogla apo edhe me model. **Hapi 3.** Ngre nxënës në tabelë që të shkruajnë disa nga rrokjet, fjalët dhe grupet e fjalëve në etiketa që iu shpërndahen në tavolina.(KA,MO,PE,PA,LË,RI,KRI...) **Hapi 4.** Punohet sipas kërkesave në fletoren e punës. Plotësohen rrokje mungesore me shkronja të shtypit në fjalë sipas figurave p.sh., kali, muri. Nxënësit lexojnë ngjashmërinë e ndryshimet mes tyre. **Hapi 5.** Nxënësit veprojnë me sintezën e rrokjeve në fjalë.(LEPURI, KARAMELE, MAKARONA, PERIME).Veprohet edhe për shkrimin me shkrim dore të tyre. E njëjta procedurë ndiqet për plotësimin e fjalive me fjalë sipas figurave dhe kopjimi i tyre me shkrim dore në fund të faqes. Keli iku në park. *Keli iku në park.*			

Bëhet kontrolli individual i fletores/kontrollojnë njëri-tjetrin. ▪ ***Demonstrim i rezultateve të arritura*** **Hapi 6.** Nxënësit lexojnë fjalët e ushtrimeve në fletoren e punës. I përdorin ato edhe në fjali. Nxënësit më të përparuar mund të formojnë disa fjali të shkurtra në fletore më fjalët e fjalorit.(sipas kohës)
Vlerësimi i situatës: ***Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:*** ✓ Shkruan shkronjat e mësuara të shtypit e të dorës sipas modelit. ✓ Shkruan rrokje, fjalë. ✓ Formon fjalë duke bashkuar rrokjet me shkronjat. ✓ Plotëson fjalët sipas figurave.
Detyrë shtëpie: **1.** Kopjo dy-tri herë fjalët e faqes. Lexo ato. **2.** Kopjo fjalitë me shkrim shtypi e dore. **3.** Shkruaj 10 fjalë që kanë në trup shkronjat e mësuara. (në pozicione të ndryshme me shkronja shtypi).
Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1	**Klasa:** 1
Tema mësimore: **Punim i faqes 43 të Abetares.**		**Situata e të nxënit:** Iriqi e molla	

***Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe**

Nxënësi:

- ***Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit:*** Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar.
- ***Kompetenca e të nxënit:*** Ndjek udhëzimet e dhëna për të realizuar një detyrë që i kërkohet.
- ***Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin:*** Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjete) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre.

***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore**	**Fjalë kyçe:** Iriqi, molla, shokët, numra, kapelë, orari, mori
Nxënësi: - Shqipton tingujt **R,U,L,K,O,P.** - Gjen dhe thotë fjalë që fillojnë me **R,U,L,K,O,P.** ose që përmbajnë ato shkronja në trup të tyre. (në pozicione të ndryshme) - Lexon rrokjet dhe fjalët e fjalorit të librit. - Ndan fjalët nga njëra-tjetra sipas udhëzimit. - Plotëson sipas modelit përgjigjet e pyetjeve. - Analizon fjalinë në fjalë. - Parashikon sipas figurave të dhëna. - Rendit shkronjat e dhëna për të krijuar fjalë.	**Teknika dhe strategji:** - Bisedë - Vëzhgim - Parashikim me foto - Punë individuale/Çift - Vizatim/Emërtim - Analizë-sintezë
Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, modele të grafikut të shkronjave **R,r,U,u,L,l,K,k,O,o,P,p** të shtypit, foto të disa objekteve (ora,ariu,numra,) etiketa me fjalë e fjali të fjalorit, tabela e rrokjeve.	**Lidhja me fushat e tjera:** Lënda: Matematikë, Arte, Shoqëria dhe mjedisi.

Përshkrimi kontekstual i situatës:

- ***Veprimtari paraprake:***

Hapi 1. Fillon me një bisedë për alfabetin e gjuhës shqipe, si dhe raportin e zanoreve me bashkëtingëlloret në të. Ngjyrosjen e shkronjave të mësuara në alfabet. Listojnë edhe disa emra frutash dhe perimesh. Disa edhe mund të shkruhen në dërrasë.(3 min)

Hapi 2. Nxënësit nxiten të vërejnë fjalët në etiketa dhe leximi i tyre PULA, LUANI, LUMË, PERIME, PAKO, MAKARONA.

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 3. Hapet libri dhe komentohen figurat e ushtrimit të parë. Biseda për figurat e faqes dhe komente rreth tyre. Nxiten nxënësit të krijojnë një tekst sipas figurave të dhëna. Tregohen disa ngjarje. Më pas kalohet në leximin e fjalive nga mësuesi/ja.

Kryhet procesi i analizës për shkëputjen e fjalëve nga njëra-tjetra. (nxënësit dallojnë fjalët e gjata nga ato të shkurtra).

Hapi 4. Ushtrohen në leximin e fjalive të tekstit zinxhir.

Hapi 5. Nxiten nxënësit që tu përgjigjen pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit. Ku shkoi iriqi? Ku e mori iriqi mollën? Me kë e ndau mollën? Po ju keni ndarë fruta me miqtë tuaj? Si jeni ndierë?

Hapi 6. Nxënësit punojnë individualisht për shkrimin e fjalëve me shkrim shtypi duke i lidhur me

figurat përkatëse si dhe përdorimi në fjali i tyre . Veprohet edhe për shkrimin drejt të fjalëve me shkronjat e dhëna.(*makina, orari, libri)*

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 7. Shkruan apo paraqet fjalët e fundit të faqes 43 në tabela sipas numrit të shkronjave.

N	U	M	R	A	M	A	L	I

Lexohen nga nxënësit në zinxhir fjalët e faqes 43.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Shqipton tingujt zanor **U, O** dhe bashkëtingëllor **R,L,K,P**.
- ✓ Lexon fjalitë e librit dhe analizon sipas pyetjeve.
- ✓ Qarkon shkronjat e mësuara.
- ✓ Komenton dhe emërton figurat.
- ✓ Analizon fjalët e dhëna.

Detyrë shtëpie:

1. Lexo dhe shkruaj fjalitë e librit në fletore.
2. Përgjigju pyetjeve të dhëna.
3. Shkruaj nga 5-7 fjalë me shkronjat **R,U,L,K,O,P.**
4. Kopjo emrat me shkrim shtypi dhe dore.

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla: 1**
Tema mësimore: **Vlerësim përmbledhës**		**Klasa: 1**
Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe** Nxënësi: ➢ ***(3)Kompetenca e të nxënit: Ndjek udhëzimet e dhëna në një tekst për të realizuar një veprim /aktivitet /detyrë, që kërkohet ➢ ***(3)Kompetenca e të nxënit:*** ○ Mbikëqyr në mënyrë të pavarur përparimin e vet në një detyrë, aktivitet duke përdorur teknika të ndryshme për gjetjen e gabimeve (si shënim të gabimeve-vështirësive) dhe i korrigjon ato derisa gjen zgjidhjen ○ Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes.		**Fjalë kyçe:** *Test, shkronja, fjalë, fjali.*
***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:** Nxënësi: ➕ Lexon kërkesat e ushtrimeve në mënyrë të vetëdijshme. ➕ Shkruam fjalë, fjali me shkronjat e mësuara. ➕ Bën analizë-sintezë të fjalëve, fjalive.		**Teknika dhe strategji:** ❖ Diskutim paraprak ❖ Punë individuale ❖ Analizë–sintezë e fjalëve, fjalive
Burimet e informacionit dhe mjete: Njohuritë paraprake të nxënësve, fletë testimesh të përgatitura, shkronjat kolektive		**Lidhja me fushat e tjera:** Matematikë

SITUATA E TË NXËNIT

Përshkrimi kontekstual i situatës:

- ***Veprimtari paraprake:***

Hapi 1. Mësuesi/ja njeh nxënësit me temën dhe kujton se çfarë është Testi, cili është qëllimi dhe rëndësia e tij. Përsëriten rregullat e sjelljes gjatë detyrës me shkrim dhe punës individuale.
Bëhet përsëritje e shkronjave të shtypit dhe të dorës të grupit të parë dhe të dytë.

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 2. Ndan klasën në grupe. Mësuesi/ja ndan fletët e ushtrimeve të fotokopjuara më parë.
Jep këshilla të qarta për çdo ushtrim. Nxit nxënësit të lexojnë vetë kërkesat. Këshillon ngadalë dhe saktë çdo etapë të ushtrimit duke i udhëzuar nxënësit .
Hapi 3. Nxënësit punojnë të pavarur testin. Mësuesi/ja kalon bankë më bankë dhe udhëzon nxënësit, sidomos ata që shfaqin vështirësi. Nxënësit duhet të shkruajnë me shkronjat e shtypit ose të dorës, sipas dëshirës me përjashtim të ushtrimit 3, i cili duhet të plotësohet me shkrim dore.
Megjithatë është mirë që nxënësit të ushtrohen më shumë në punën me shkrim dore.

Ushtrimi 1. Nxënësit duhet të plotësojnë shkronjat që mungojnë:

Grupi A	***Grupi B***
Roboti, makina, pema.	*Piruni, kalë, kapelë.*

Ushtrimi 2. Nxënësit duhet të ndajë në rrokje dhe më pas në shkronja fjalët

Grupi A

perime					
pe		*ri*		*me*	
p	*e*	*r*	*i*	*m*	*e*

Grupi B

Patate					
pa		*ta*		*te*	
p	*a*	*t*	*t*	*t*	*e*

Ushtrimi 3. Nxënësit duhet të shkruajnë me shkrim dore fjalitë. Kujtohen se duhet të përdorin shkronjën e madhe në fillim të fjalisë dhe në fund të vendosin pikë.

Ushtrimi 4. Nxënësit duhet të renditin fjalët në fjali. Këshillohen që t'i vendosin numra etiketa për të pasur më të lehtë renditjen.

Grupi A

Ola mëson me orar.

Në pjatë ka perime.

Grupi B

Keli iku me makinë.

Parku ka pemë.

Ushtrimi 5. Nxënësit duhet të plotësojnë fjalitë me fjalë të dhëna.

Grupi A

Keli iku në park.

Ai iku me Enin.

Në kokë kanë kapelë.

Grupi B

Ola mëson me orar.

Në orën 6, mbaroi matematikën.

Ola mëson mirë.

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 4. Mblidhen fletët, nxiten nxënësit të diskutojnë për vështirësitë dhe problemet që kanë pasur. Mësuesi/ja mban shënime, të cilat i ka parasysh në orët në vijim.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

Nxënësi:

1. Lexon kërkesat e ushtrimeve në mënyrë të vetëdijshme.
2. Shkruam fjalë, fjali me shkronjat e mësuara.
3. Bën analizë-sintezë të fjalëve, fjalive.

Detyrë shtëpie:

Shkruaj nga një rresht me shkronjat e mësuara. A, a, A, a...

Refleksione:

TEST Abetare (Vlerësimi I) **Grupi A**

1. **Plotëso shkronjat që mungojnë.** *(6 pikë)*

__ ___ boti ma__ __ na pe __ __

2. **Ndaj fjalën në rrokje e shkronja.** *(9 pikë)*

perime					

3. **Kopjo me shkronja dore.** *(9 pikë)*

Eni luan me Anin.	
Mira ka robot.	
Keli iku me kalë.	

4. **Rendit si duhet fjalitë.** *(6 pikë)*

orar	mëson	Ola	me

_____

_____

perime	Pjata	ka

_____

_____

5. **Plotëso fjalën që mungon.** *(15 pikë)*

Keli iku në ___ ___ ___ ___.

Ai iku me ___ __ __ __ .

Në kokë kanë ___ __ __ ___ __ __.

Enin, park, kapelë

Shkallët e vlerësimit	**1** Arritje të pakënaqshme	**2** Arritje që kanë nevojë për përmirësim	**3** Arritje të kënaqshme	**4** Arritje shumë të kënaqshme	**5** Arritje të shkëlqyera
Vlerësimi sipas pikëve	0 - 11	12 - 22	23 - 33	34 - 39	40 - 45

TEST Abetare (Vlerësimi I) **Grupi B**

1. **Plotëso shkronjat që mungojnë.** *(6 pikë)*

piru __ ___



___ ___ li

ka __ __lë

2. **Ndaj fjalën në rrokje e shkronja.** *(9 pikë)*

patate					

3. **Kopjo me shkronja dore.** *(9 pikë)*

Umi ra në lumë.	
Lira mori lule.	
Keli ka kalë.	

4. **Rendit si duhet fjalitë.** *(6 pikë)*

iku	Keli	makinë	me

_____

_____

pemë	Parku	ka

_____

_____

5. **Plotëso fjalën që mungon.** *(15 pikë)*

Ola mëson me ___ ___ ___ ___.

Në orën 6, mbaroi __ __ __ __ __ __ __ __ .

Ola mëson __ __ __ __ .

mirë, Abetaren, orar

Shkallët e vlerësimit	**1** Arritje të pakënaqshme	**2** Arritje që kanë nevojë për përmirësim	**3** Arritje të kënaqshme	**4** Arritje shumë të kënaqshme	**5** Arritje të shkëlqyera
Vlerësimi sipas pikëve	0 - 11	12 - 22	23 - 33	34 - 39	40 - 45

Shënim : *Për këngët e shkronjave mësuesve mund t'ju vijë në ndihmë si youtube ashtu edhe Cd e video DVD e Digitalb me këngët për çdo shkronjë.*

Disa fletë të modeluara në ndihmë të mësuesve

UNË JAM _____

VENDOS SHKRONJAT QË MUNGOJNË

	Ë		T	Ë

	A		I		A

P		SH	K	U

	R	A

U		

	Ë		T	O	R	I

	E		A

	U		R		T

	Ë		T	Ë

	Ë		A

	L		F	A	N	T	

PLOTËSO FJALITË

ENEA ME _____.

N ËNA KA _____.

ËMBËL

SHKRUAJ SI MODELI

E ____e_____

_____

_Ë_____

_____

NËNA E MAMI. _____

UNË JAM _____

VENDOS SHKRONJAT QË MUNGOJNË

P		SH	K	U

	R	A

U		

	Ë		A

	L		F	A	N	T	

	U		R		T

	Ë		T	Ë

	Ë		T	Ë

	A		I		A

	Ë		T	O	R	I

	E		A

SHKRUAJ SI MODELI

E ____e_____

_____

_Ë_____

_____

N ËNA E MAMI. _____

PLOTËSO FJALITË

ENEA ME _____.

N ËNA KA _____.

UNË JAM _____

ËMBËL

VENDOS SHKRONJAT QË MUNGOJNË

	Ë		T	Ë

	A		I		A

	A	C	J	

	O	LL	

	Ë		T	O	R	I

	A		A

	U		R		T

	Ë		T	Ë

	Ë		A

	B		T		R	J	

PLOTËSO FJALITË

MAMI ME _____.

ANI KA _____.

N ËNA

SHKRUAJ SI MODELI

M m _____



N n _____



MAMI IM _____

UNË JAM _____

VENDOS SHKRONJAT QË MUNGOJNË

	R		**U**

	N	**I**	**J**	

A	**N**		**N**		**S**	**I**

	B	**E**	**T**		**R**	**J**	

	K	**U**	**LL**	**O**	**R**	**J**	

	b	**e**	**t**		**r**	**j**	

A_____**A**_____

UNË JAM _____

VENDOS SHKRONJAT QË MUNGOJNË

	N	**I**	**J**	

	R		**U**

	B	**E**	**T**		**R**	**J**	

	K	**U**	**LL**	**O**	**R**	**J**	

A	**N**		**N**		**S**	**I**

	b	**e**	**t**		**r**	**j**	

A_____**A**_____

UNË JAM _____

VENDOS SHKRONJAT QË MUNGOJNË

L		B	R	

	R		Q	

	B		T		R	J	

A	

M		U

ANA KA _____.

ILIRI KA _____.

A a _____

_____

I i _____

_____

UNË JAM _____

VENDOS SHKRONJAT QË MUNGOJNË

	B		T		R	J	

	R		Q	

A	

L		B	R	

M		U

ANA KA _____.

ILIRI KA _____.

A a _____

_____

I i _____

_____

<table>
<tr><td>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla: 1</td><td>Klasa: 1</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore: Punim i shkronjës B, b faqe 44 të Abetares</td><td colspan="2">Situata e të nxënit: Në dimër</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe
Nxënësi:
➢ (1)Kompetenca e komunikim dhe të shprehurit: Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar.
➢ (3)Kompetenca e të nxënit: Parashtron pyetje dhe përgjigje në lidhje me temën.
➢ (4)Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin: Gjen të përbashkëtat dhe ndryshimet ndërmjet aktiviteteve që bën në shkollë me ato në shtëpi.</td></tr>
<tr><td colspan="2" rowspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore
Nxënësi:
- Shqipton tingullin B.
- Gjen dhe thotë fjalë që fillojnë me B ose që përmbajnë shkronjën B në trup të tyre.
- Lexon fjalët e fjalorit të librit: banane, buka, bebe, bredh, bilbili.
- Plotëson sipas figurës fjalë mungesore.
- Formon fjali/tekst sipas figurës kryesore të faqes.</td><td>Fjalë kyçe:
balona, bora,banane, buka, bebe, bredh, bilbili.</td></tr>
<tr><td>Teknika dhe strategji:
❖ Shëtitje
❖ Vëzhgim
❖ Demonstrim
❖ Punë individuale/Çift</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, modele shkronjash individuale, grafiku i shkronjës B, b të shtypit, foto me pamje nga dimri.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera: Lënda: Edukim fizik, Dituri natyre, Matematikë.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Përshkrimi kontekstual i situatës:
▪ Veprimtari paraprake:
Hapi 1.
Fillon me një shëtitje në mjediset përreth shkollës. Nxënësit këshillohen të vërejnë natyrën, gjethet që kanë rënë, pemët, qiellin, motin dhe temperaturën.
▪ Veprimet në situatë
Hapi 2. Në klasë nxënësit nxiten të diskutojnë për sa panë dhe përshkruajnë stinën e dimrit që sapo ka hyrë.
Shkruhet titulli në tabelë. Bora e parë.
Hapi 3. Nxiten nxënësit të vërejnë figurën në libër dhe të formojnë fjali ose një tekst të shkurtër.
Mësuesja ndihmon nxënësit me pyetje ndihmëse:
○ Në cilën stinë jemi?
○ Si është moti?
○ Çfarë po bëjnë fëmijët?
○ Çfarë kanë veshur fëmijët?
Hapi 4. Demonstron para klasës grafikun e shkronjës së vogël dhe të madhe të shtypit. Nxit nxënësit të bëjnë ngjashmëritë dhe dallimet me shkronjat e tjera dhe objekte të tjera rrethanore.
Nxiten nxënësit të gjejnë fjalë që fillojnë me B, e kanë në trup ose mbarojnë me B.
Plotësohet tabela kolektivisht.</td></tr>
</table>

B	B	B
Bora	Këmbë	Humb .....

Hapi 5. Nxënësit punojnë individualisht për plotësimin e shkronjave në fjalët mungesore.
Bëhet leximi dhe ndarja e tyre në rrokje. Ngre disa nxënës që shkruajnë fjalët në tabelë.

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 6. Shkruan fjalinë kryesore në tabelë.
Po bie bora e parë.
Ndahet në etiketa dhe fjalët në rrokje. *Bie, borë*
Individualisht nxënësit lidhin fjalët sipas kuptimit në fjali.

- *Në mal bie borë.*
- *Bora mbuloi tokën.*
- *Babi bleu bukë.*
- *Beni bëri burrë bore.*

Lexohen nga nxënësit në zinxhir fjalitë e formuara.

Vlerësimi i situatës:
Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Shqipton tingullin **B**.
- ✓ Gjen dhe thotë fjalë që fillojnë me ***B*** ose që përmbajnë tingullin **B** në trup të tyre.
- ✓ Lexon fjalët e fjalorit të librit: *banane, buka, bebe, bredh, bilbili.*
- ✓ Plotëson sipas figurës fjalë mungesore.
- ✓ Formon fjali/tekst sipas figurës kryesore të faqes.

Detyrë shtëpie:

1. Lexo dhe shkruaj fjalët e librit në fletore.
2. Shkruaj 10 fjalë me shkronjën **B**.

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla: 1**	**Klasa:** 1
Tema mësimore: Punim e shkrim i shkronjës **B, b**, Abetare pune faqe 35		**Situata e të nxënit:** Në dimër	

***Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe**

Nxënësi:

- ***(3)Kompetenca e të nxënit:*** Ndjek udhëzimet e dhëna për të realizuar një veprim
- ***(4)Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin:*** Identifikon burimet e nevojshme dhe i përdor në mënyrë të drejtë.

***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore** Nxënësi: - Shkruan shkronjës **B, b** të shtypit sipas modeli. - Shkruan rrokje, fjalë. - Formon fjalë duke lidhur rrokjet. - I përgjigjet pyetjeve shkurt. - Ndan fjalinë në etiketa	**Fjalë kyçe:** *bletë, bebe, banane, babi, bleu.* **Teknika dhe strategji:** - Punë me grupe - Demonstrim - Punë individuale - Analizë – sintezë fjalësh, fjalish.
Burimet e informacionit dhe mjete: Shkronjat individuale dhe kolektive, fletore pune, etiketa me rrokje, fjalë sipas nivelit	**Lidhja me fushat e tjera:** Edukim, për shoqërinë

Përshkrimi kontekstual i situatës

- ***Veprimet paraprake***

Hapi 1. Klasa është e ndarë në grupe me nivele të ndryshme. Mësuesja ka përgatitur etiketa me fjalë dhe fjali rreth situatës. Ia shpërndan nxënësve sipas nivelit. Nxënësit lexojnë me zë të lartë. Nxiten nxënësit të korrigjojnë njëri-tjetrin.

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 2. Paraqet grafikun e shkronjës **B, b.** Nxit të thonë ndryshimet dhe ngjashmëritë me shkronjat e tjera, p.sh me **P** dhe **D.**

Hapi 3. Ngre nxënës në tabelë që shkruajnë disa nga rrokjet, fjalët dhe fjalitë e etiketa që u shpërndanë në pjesën ë parë të orës.

Hapi 4. Punohet sipas kërkesave në fletoren e punës. Modelohet shkronja **B,b**, shkruhen fjalët me shkronja të vogla të shtypit. Lidhen etiketat, duke këshilluar nxënësit të ndjekin drejtimin e shigjetave.

Balona, tabela, balena,

Lidhin rrokjet në fjalë dhe i përgjigjen pyetjeve.

Banane, harabel, biberon, banane.

Arbri luna me bubin. ose *Arbri luna me bebin.*

Mami bleu bukë. ose *Mami bleu banane.*

Ndajnë fjalinë në etiketa.

Bora luan me bubin.

Babi im bleu makinë.

Bëhet kontrolli individual i fletores.

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 5. Nxënësit lexojnë fjalët dhe fjalitë që krijuan gjatë ushtrimeve në fletoren e punës. Nxënësit më të përparuar mund të formojnë disa fjali në fletore më fjalët e fjalorit.*(Bletë, bebe, banane)*
Vlerësimi i situatës: ***Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:*** ✓ Shkruan shkronjës **B, b** të shtypit sipas modeli. ✓ Shkruan rrokje, fjalë. ✓ Formon fjalë duke lidhur rrokjet. ✓ I përgjigjet pyetjeve shkurt.
Detyrë shtëpie: **1.** Formo nga fjali me fjalët : *bletë, bebe, banane,* **2.** Përgjigju me fjali të plotë pyetjeve. Arbri luan (me kë?) ____. mami bleu (?) ____. **3.** Kopjo bukur në fletore 2 fjalitë e fundit.
Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla: 1**	**Klasa:** 1
Tema mësimore: Punim e lexim i shkronjës **B, b** faqe **45** të Abetares		**Situata e të nxënit:** Në dimër	
Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe** Nxënësi: ➢ ***Kompetenca e komunikim dhe të shprehurit: Dëgjon një tregim. ➢ ***Kompetenca e komunikim dhe të shprehurit:*** Identifikon personazhet e një tregimi. ➢ ***Kompetenca e të nxënit :*** Parashtron pyetje dhe përgjigje në lidhje me temën.			
***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore** Nxënësi: - Lexon fjalë, fjali. - I përgjigjet me fjali të thjeshtë pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit. - Rilexon tekstin për të kuptuar përmbajtjen e tij. - Lidh pjesën që lexon me filma që ka parë, me përvoja personale.		**Fjalë kyçe:** *tregim, titull, pyetje, përgjigje, burrë bore, etj.* **Teknika dhe strategji :** ❖ Parashikim me terma paraprakë ❖ Marrëdhënie pyetje-përgjigje ❖ Lexim zinxhir ❖ Analizë-sintezë e fjalës	
Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, modele shkronjash individuale, grafiku i shkronjës **B, b** të shtypit, foto me pamje nga dimri.		**Lidhja me fushat e tjera:** Matematikë, muzikë	

Përshkrimi kontekstual i situatës:

- ***Veprimtari paraprake***

Hapi 1: Shkruaj në tabelë titullin e tregimit dhe nxit nxënësit të formojnë fjali ose një tekst të shkurtër sipas fantazisë ose një filmi apo përvojës personale. *(Këshillohen të mos përsëritin tregimin e librit nëse e kanë lexuar më parë)*

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 2: Mësuesja këshillon nxënësit të mbyllin sytë dhe të përfytyrojnë një ditë dimri me borë dha ata janë duke lozur në oborr. Bëhet krahasimi me krijimet e nxënësve.

Hapi 3: Lexon me intonacion 2 herë tregimin. Më pas pyet nxënësit:

- *Çfarë përfytyruat?*
- *Me kë ishit?*
- *Çfarë po bënit ju?*
- *Si u ndjeve kur dëgjove tregimin?*

Në sfond mund të vihet melodia: 4 stinët e Vivaldit (dimri)

Hapi 4: Hapen librat. Nxit nxënësit të përshkruajnë figurën. Bëhet leximi në korr i tregimit disa herë. Shpjegon fjalën *flokë – flokë*, që nuk mund të jetë hasur më parë nga nxënësit. Shpjegon përdorimin e pikë çuditëses te fjalia e fundit.

Hapi 5: Më pas lihen nxënësit të lexojnë në heshtje për disa minuta tregimin. Në varësi të numrit të nxënësve në klasë mësuesja bën leximin e tregimit në zinxhir me nga një ose më shumë fjali.

Mund të kërkohet nga nxënësit edhe të lexojnë fjalinë e parë, të dytë e kështu me radhë ose me rend të

ngatërruar. Nxënësit që paraqesin vështirësi mund t'i pyesë në fjalë të veçanta të thjeshta.

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 6: Diskutim rreth përmbajtjes.

- *Si e ka titullin tregimi?*
- *Si quhen fëmijët që marrin pjesë?*
- *Çfarë bënë ata?*
- *Me çfarë e bënë?*
- *Po ju keni lozur me borë?*
- *Çfarë të pëlqen më shumë të bësh, kur bie borë?*

Hapi 7: Nxënësit në mënyrë individuale lidhin rrokjen me fjalën sipas llojit të rrokjes dhe gjejnë përgjigjen e saktë për dy pyetjet që janë në libër.

Diskutojnë në dyshe më shokun e bankës ose në grup për përgjigjet e dhëna.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Lexon fjalë, fjali.
- ✓ I përgjigjet me fjali të thjeshtë pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit.
- ✓ Rilexon tekstin për të kuptuar përmbajtjen e tij.
- ✓ Lidh pjesën që lexon me filma që ka parë, me përvoja personale.

Detyrë shtëpie:

1. Lexo tregimin.
2. Kopjo 3 fjali që të pëlqejnë më shumë nga tregimi.

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla: 1**	**Klasa:** 1
Tema mësimore: Ushtrime aplikative për shkrim dore, shkronja **B, b**.		**Situata e të nxënit:** Në dimër	

***Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe**

Nxënësi:

- ***Kompetenca e të nxënit:*** Mbikëqyr në mënyrë të pavarur përparimin e vet në një detyrë duke përdorur detyra të ndryshme. Korrigjon gabimet.
- ***Kompetenca qytetare:*** Bashkëpunon në grup dhe respekton rregullat e grupit.

***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore**

Nxënësi:

- Shkruan shkronjat **B, b** të dorës duke u ndihmuar nga modeli.
- Shkruan shkronjat **B, b** me të gjitha elementet duke e lidhur me shkronjat e tjera.
- Shkruan fjalë me të kopjuar duke përdorur shkronjën **B, b** në fillim, në trup të fjalës.
- Lexon fjalë me shkrim dore.

Fjalë kyçe:
babi, bubi, makinë, banane, bleu, etj.

Teknika dhe strategji:

- Vetëdiktim
- Lexim në korr
- Demonstrim
- Punë individuale
- Punë në çifte/punë në dyshe
- Lexim individual

Burimet e informacionit dhe mjete: Fletore e punës, fletore shkrimi, modele shkronjash individuale, grafiku i shkronjës **B, b** të shtypit dhe të dorës.

Lidhja me fushat e tjera: Arte

Përshkrimi kontekstual i situatës

- ***Veprimtari paraprake***

Hapi 1. Mësuesja nxjerr para klasës disa foto me pamje të stinës së dimrit dhe nxënësit shkruajnë në fletore ose fletë pa folur, në formën e vetëdiktimit ose përgatit fisha të gatshme për secilin nxënës. Lexojnë fjalët që kanë shkruar.

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 2. Përsëritje e shkronjave të mësuara të dorës. Lexim në korr.
Përsëriten shkronjat **B, b** të shtypit dhe grafiku i tyre.
Nxiten nxënësit të thonë fjalë që fillojnë me **B,** shkruaj disa prej tyre.
Hapi 3. Shpjegoj grafikun e shkronjës **B, b** të dorës dhe e shoqëruar me lëvizjen në ajër të nxënësve.
Shpjegohen elementet përbërës të saj.
Bëhet dallimi me shkronjën **B, b** të shtypit.
Ngre nxënës në tabelë që shkruajnë shkronjën dhe lidhjen e saj me shkronjat e tjera në fjalë.
Hapi 4. Më pas nxënësit punojnë në fletoren e punës sipas modelit. Vështirësi paraqet lidhja e shkronjës **b** me shkronjat e tjera, vëzhgohet ky element dhe përforcohet. Nxënësit lexojnë fjalët dhe fjalinë që shkruan me shkrim dore.

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 5. Diktim me shkronja dore.
Ba, be, bë, bi, bru, bla, Bora, blen, bilbili, Bora mbuloi tokën.
Nxënësit lexojnë fjalët që shkruan me shkronja dore.

Vlerësimi i situatës: ***Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:*** ✓ Shkruan shkronjat **B, b** të dorës duke u ndihmuar nga modeli. ✓ Shkruan shkronjat **B, b** me të gjitha elementet duke e lidhur me shkronjat e tjera. ✓ Shkruan fjalë me të kopjuar duke përdorur shkronjën **B, b** në fillim, në trup të fjalës. ✓ Lexon fjalë me shkrim dore.
Detyrë shtëpie: **1.** Shkruaj nga 3 rreshta me shkronja/rrokje/fjalë ose fjali me shkronjën **B, b**.
Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla: 1**	**Klasa:** 1
Tema mësimore: Punim i faqes 44-45 të Abetares. Burrë bore		**Situata e të nxënit:** Në dimër	

***Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe**

Nxënësi:

- ***Kompetenca e komunikim dhe të shprehurit:*** Shpreh mesazhin e një teksti të thjeshtë, nëpërmjet njërës nga format shprehëse: të folurit, shkrimit.
- ***Kompetenca e të nxënit:*** Parashtron pyetje dhe përgjigjet në pyetjet për temën në njërën nga format e të shprehurit.
- ***Kompetenca qytetare:*** diskuton dhe bashkëpunon me anëtarët e grupit.

***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore**

Nxënësi:

- Qarkon shkronjën **B** në tekst të panjohur.
- Lidh sipas kuptimit fjalët për të krijuar fjali.
- Plotëson fjalë mungesore.
- Shkruan me të kopjuar ose të diktuar.
- Lexon fjalë fjali me shkrim dore

Fjalë kyçe:

balona, bora, banane, buka, bebe, bredh, bilbili.

Teknika dhe strategji:

- Punë individuale
- Lexim fjalësh, fjalish
- Analizë – sintezë
- Punë në dyshe/ grup

Burimet e informacionit dhe mjete:

Libri i nxënësit, modele shkronjash individuale, grafiku i shkronjës B,b të shtypit, foto me pamje nga dimri.

Lidhja me fushat e tjera:

Lënda: Matematikë, art pamor

Përshkrimi kontekstual i situatës

- ***Veprimtari praktike***

Hapi 1. Mësuesja shpërndan një tekst *(me temë sipas situatës)* në të cilën nxënësit duhet të qarkojnë shkronjën **B**, të lexojnë fjalë, fjali sipas nivelit të nxënësve.

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 2. Përsëritje në korr e shkronjave të shtypit dhe të dorës, të mësuara deri tani.
Nxënësit tregojnë se sa shkronja **B** kanë gjetur në përrallën e mësipërme.
Për nxënës më të përparuar mund t'u kërkohet të lexojnë fjalë ose fjali.

Hapi 3. Punohet me pjesën e fundit të faqes **44** dhe **45**.
Rilexojnë fjalinë : ***Po bie bora e parë.*** Bëhet ndarja e fjalëve në etiketa.
U kërkohet nxënësve të gjejnë fjalën e parë, të dytë e kështu me radhë si dhe në rend të ngatërruar.

Hapi 4. Lihen të punojnë individualisht për lidhjen e fjalëve sipas kuptimit në fjali, fundi i faqes **44**.
Në të njëjtën mënyrë punohet për ushtrimet e fundit të faqes **45**.

- *Bora mbuloi tokën.*
- *Blerina bleu biberon.*
- *Mami mbuloi bebin.*
- *Babi bleu bukë.*

Mund të aplikohet dhe puna në dyshe ose grup sipas përbërjes së klasës.
Lexohen fjalitë dhe korrigjojnë ata që nuk i kanë lidhur saktë. Bëhet rileximi nga nxënësit që nuk e kishin shkruar saktë që në fillim.

▪ ***Demonstrim i rezultateve të arritura*** **Hapi 5.** Në fletoren e klasës, nxënësit shkruajnë me shkrim dore fjalitë që formuan në fundin e faqes **44** dhe **45**. *Babi me Benin bënë burrë bore.* Lexojnë fjalitë me shkrim dore nga fletorja e tyre.
Vlerësimi i situatës: ***Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:*** ✓ Qarkon shkronjën **B** në tekst të panjohur. ✓ Lidh sipas kuptimit fjalët për të krijuar fjali. ✓ Plotëson fjalë mungesore. ✓ Shkruan me të kopjuar ose të diktuar. ✓ Lexon fjalë fjali me shkrim dore.
Detyrë shtëpie: **1.** Kopjo me shkronja dore fjalitë që formove në klasë. **2.** Shkruaj 3 fjali për stinën e dimrit. **3.** Vizato pamje nga dimri.
Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla: 1**	**Klasa:** 1
Tema mësimore: Punim i shkronjës **H, h** faqe 46 të Abetares.		**Situata e të nxënit:** Natë me hënë	

***Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe**

Nxënësi:

- ***Kompetenca e komunikim dhe të shprehurit:*** Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar.
- ***Kompetenca e të nxënit :*** Parashtron pyetje dhe përgjigje në lidhje me temën.
- ***Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin:*** kontrollon kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një aktiviteti.

***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore**

Nxënësi:

- Shqipton tingullin **H**
- Gjen dhe thotë fjalë që fillojnë me **H** ose që përmbajnë tingullin **H** në trup të tyre.
- Lexon fjalët e fjalorit të librit: *hëna, harta, krahu, helikopteri.*
- Plotëson sipas figurës fjalë mungesore.
- Formon fjali/ tekst sipas figurës kryesore të faqes

Fjalë kyçe:

hëna, harta, krahu, helikopteri.

Teknika dhe strategji:

- Diskutim
- Vëzhgim
- Demonstrim
- Analizë – sintezë e fjalëve, fjalive
- Punë individuale/Çift

Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, modele shkronjash individuale, grafiku i shkronjës **H ,h** të shtypit, foto me pamje nga një natë me hënë dhe yje.

Lidhja me fushat e tjera: Lënda: Dituri natyre, Matematikë, Arte

Përshkrimi kontekstual i situatës:

- ***Veprimtari paraprake:***

Hapi 1. Nxënësit janë porositur një ditë më parë, të vëzhgojnë qiellin natën.

Nxiten të flasin se çfarë kanë parë një natë më parë. Plotësohen mendimet nga njëri-tjetri duke parë fotot.

Hapi 2. Nxiten nxënësit të vërejnë figurën në libër dhe të formojnë fjali ose një tekst të shkurtër. Shkruhet titulli në tabelë.

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 3. Demonstron para klasës grafikun e shkronjës së vogël dhe të madhe të shtypit. Nxit nxënësit të bëjnë ngjashmëritë dhe dallimet me shkronjat e tjera dhe objekte të tjera rrethanore.

Hapi 4. Nxiten nxënësit të gjejnë fjalë që fillojnë me **H** , e kanë në trup ose mbarojnë me **H**.

H	**H**	**H**
Hëna	Koha	Krah .....

Hapi 6. Nxënësit punojnë individualisht për plotësimin shkronjave në fjalët mungesore.

Bëhet leximi dhe ndarja e tyre në rrokje. Ngre disa nxënës që shkruajnë fjalët në tabelë. Punohet fjalia. **Unë e kam emrin Hëna.** Ndahen në rrokje fjalët *Hëna* dhe *emri.*

Hapi 7. Prezanton para nxënësve një hartë dhe tregon çfarë është ajo. Nxit nxënësit të tregojnë çfarë

dinë për hartën. Lexohen nga nxënësit në zinxhir fjalitë e formuara. ▪ ***Demonstrim i rezultateve të arritura*** ***Hapi 8***. Nxënësit në dyshe punojnë për formimin e fjalive: *Umi ha kocka. Era ha hurma. Holta hap hartën. Era hap librin.* Nxënësit lexojnë me zë të lartë fjalitë.
Vlerësimi i situatës: ***Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:*** ✓ Shqipton tingullin **H** ✓ Gjen dhe thotë fjalë që fillojnë me **H** ose që përmbajnë tingullin **H** në trup të tyre. ✓ Lexon fjalët e fjalorit të librit: *hëna, harta, krahu, helikopteri.* ✓ Plotëson sipas figurës fjalë mungesore. ✓ Formon fjali/tekst sipas figurës kryesore të faqes.
Detyrë shtëpie: **1.** Kopjo fjalët e fjalorit. **2.** Kopjo fjalitë që formove në fund të faqes së librit.
Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla: 1**	**Klasa:** 1
Tema mësimore: Punim e shkrim i shkronjës **H, h,** Abetare pune faqe 36		**Situata e të nxënit:** Natë me hënë	

***Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe**

Nxënësi:

- ***Kompetenca e të nxënit:*** Ndjek udhëzimet e dhëna për të realizuar një veprim.
- ***Kompetenca e të nxënit:*** Zgjidh në mënyrë të pavarur detyrën e dhënë.
- ***Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin:*** Identifikon burimet e nevojshme dhe i përdor në mënyrë të drejtë.

***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore**

Nxënësi:

- Shkruan shkronjës **H,h** të shtypit sipas modelit
- Lidh rrokjet për të krijuar fjalë.
- Formon fjalë duke lidhur rrokjet.
- Ndan fjalët në rrokje
- Plotëson fjalitë mungesore

Fjalë kyçe:
Krahu, hark, hekuri, harabel, helikopteri, hinka, harta.

Teknika dhe strategji:

- Punë me grupe
- Demonstrim
- Punë individuale
- Analizë–sintezë fjalësh, fjalish.

Burimet e informacionit dhe mjete: Shkronjat individuale dhe kolektive, fletore pune, etiketa me rrokje, fjalë sipas nivelit.

Lidhja me fushat e tjera:
Edukim, për shoqërinë

Përshkrimi kontekstual i situatës

- ***Veprimet paraprake***

Hapi 1. Mësuesja i cakton detyrë nxënësve të shkruajnë në disa fjalë që lidhen me natën që kaloi mbrëmë. Përdorni fjalën hënë, herët, qiell i hapur.

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 2. Paraqet grafikun e shkronjës **H, h.** Nxit të thonë ndryshimet dhe ngjashmëritë me shkronjat e tjera. Ngre nxënës në tabelë që shkruajnë disa nga rrokjet, fjalët dhe fjalitë e etiketa që u shpërndanë në pjesën e parë të orës.

Hapi 4. Punohet sipas kërkesave në fletoren e punës.

Vërehen figurat. Bëhet emërtimi i tyre. Diskutohet për to.

Modelohet shkronja **H,h,** shkruhen fjalët me shkronja të vogla të shtypit. Lidhen etiketat, duke këshilluar nxënësit të ndjekin drejtimin e shigjetave.

Harabel, helikopter, hinka

Ndajnë fjalën në etiketa.

Plotësohen fjalitë mungesore, duke u ndihmuar nga figura.

- *Hëna hapi krahët.*
- *Hëna ha bukë.*
- *Hëna e Ana hapin harkun.*
- *Ana e Hëna lahen në lumë.*

Bëhet kontrolli individual i fletores.

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 5. Nxënësit lexojnë fjalët dhe fjalitë që krijuan gjatë ushtrimeve në fletoren e punës.
Ndan fjalinë në etiketa. Nëse mjafton koha, mund të bëhet dhe një diktim i shkurtër me disa nga fjalët e punuara në fletoren e punës.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Shkruan shkronjës **H, h** të shtypit sipas modelit.
- ✓ Lidh rrokjet për të krijuar fjalë.
- ✓ Formon fjalë duke lidhur rrokjet.
- ✓ Ndan fjalët në rrokje.
- ✓ Plotëson fjalitë mungesore.

Detyrë shtëpie:

1. Formo nga fjali me fjalët: *krah, hark, hekuri, harabel, helikopter.*
2. Lexo dhe shkruaj bukur në fletore fjalët:
   Helikopteri, hekuri, harabeli, harta.
   Hëna hapi krahun.
   Hëna ha bukë.
   Hëna e Ana hapin harkun.
   Ana e hëna u lanë në lumë.

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla: 1**	**Klasa:** 1
Tema mësimore: Punim e lexim i shkronjës **H, h** faqe 47 të Abetares		**Situata e të nxënit:** Natë me hënë	

***Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe**

Nxënësi:

- ***Kompetenca e komunikim dhe të shprehurit:*** Dëgjon një tregim.
- ***Kompetenca e komunikim dhe të shprehurit:*** Identifikon personazhet e një tregimi.
- ***Kompetenca e të nxënit:*** Parashtron pyetje dhe përgjigje në lidhje me temën.

***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore**

Nxënësi:

- Lexon fjalë, fjali.
- I përgjigjet me fjali të thjeshtë pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit.
- Rilexon tekstin për të kuptuar përmbajtjen e tij.
- Lidh pjesën që lexon me filma që ka parë, me përvoja personale.
- Lexon me intonacion në mënyrë intuitive, fjalitë pyetëse dhe thirrmore.

Fjalë kyçe: *Dialog, pikëpyetje, pikëçuditëse, hëna, Tokë*

Teknika dhe strategji :

- Diskutim paraprak
- Marrëdhënie pyetje-përgjigje
- Lexim me role

Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, modele shkronjash individuale, grafiku i shkronjës **H, h** të shtypit, foto të hënës si planet dhe të qiellit natën, glob.

Lidhja me fushat e tjera: Dituri natyre, Arte

Përshkrimi kontekstual i situatës:

- ***Veprimtari paraprake***

Hapi 1: Diskutim për hënën dhe natën me yje.

- *Si duket hëna natën?*
- *A duket çdo natë njësoj?*
- *E dini ju nga e merr hëna dritën?*
- *Po yjet aq të vegjël janë?*

Plotësohen njohuritë e nxënësve me disa të dhëna fillestare për hënën dhe yjet.

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 2: Hapen librat. Komentohen figurat. Mësuesja sqaron se teksti është në formën e dialogut, midis dy personazheve, një vajze me emrin Hëna dhe Hënës. Mësuesja lexon tekstin me intonacion dhe tërheq vëmendjen e nxënësve te leximi i fjalive pyetëse dhe thirrmore.

Hapi 3: Bëhet leximi në korr i tekstit. Lihen nxënësit për disa minuta të lexojnë ne heshtje tekstin. Diskutohet rreth përmbajtjes.

- *Si është titulli i pjesës?*
- *Cilët janë personazhet?*
- *Kush ia ka vënë emrin vajzës?*
- *Po Hënës kush ia ka vënë emrin?*
- *A e dini cilët janë motrat e Hënës?*

Hapi 4: Leximi i pjesës në role. Caktohen disa grupe me nga dy nxënës dhe bëjnë leximin e dialogut. Caktohen interpretuesit më të mirë.

▪ ***Demonstrim i rezultateve të arritura*** **Hapi 5:** nxit nxënësit të bëjnë një vizatim sipas fantazisë të natës me hënë dhe yje. Më pas shkruajnë 1 -2 fjalë/fjali në përshtatje me figurën. Lexohen me zë të lartë fjalitë.
Vlerësimi i situatës: ***Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:*** ✓ Lexon fjalë, fjali. ✓ I përgjigjet me fjali të thjeshtë pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit. ✓ Rilexon tekstin për të kuptuar përmbajtjen e tij. ✓ Lidh pjesën që lexon me filma që ka parë, me përvoja personale. ✓ Lexon me intonacion në mënyrë intuitive, fjalitë pyetëse dhe thirrmore.
Detyrë shtëpie: 1. Lexo pjesën dhe mësoje ta interpretosh. 2. Kopjo 2 ose 3 fjali që të pëlqejnë më shumë.
Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla: 1**	**Klasa:** 1
Tema mësimore: Ushtrime aplikative për shkrim dore, shkronja **H, h.**		**Situata e të nxënit:** Natë me hënë	

***Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe**

Nxënësi:

- ***Kompetenca e të nxënit:*** Mbikëqyr në mënyrë të pavarur përparimin e vet në një detyrë duke përdorur detyra të ndryshme. Korrigjon gabimet.
- ***Kompetenca qytetare:*** Bashkëpunon në grup dhe respekton rregullat e grupit.

***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore**

Nxënësi:

- Shkruan shkronjat **H, h** të dorës duke u ndihmuar nga modeli.
- Respekton hapësirën midis fjalëve.
- Shkruan shkronjat **H, h** me të gjitha elementet duke e lidhur me shkronjat e tjera.
- Shkruan fjalë me të kopjuar duke përdorur shkronjën **H, h** në fillim, në trup të fjalës.
- Lexon fjalë me shkrim dore.

Fjalë kyçe:

Hëna, krahu, hark, hekuri, harabel, helikopteri, hinka, harta.

Teknika dhe strategji:

- Vetëdiktim
- Lexim në korr
- Demonstrim
- Punë individuale
- Punë në çifte/punë në dyshe
- Lexim individual

Burimet e informacionit dhe mjete: Fletore e punës, fletore shkrimi, modele shkronjash individuale, grafiku i shkronjës **H, h** të shtypit dhe të dorës.

Lidhja me fushat e tjera: Arte

Përshkrimi kontekstual i situatës

- ***Veprimtari paraprake***

Hapi 1. Mësuesja nxjerr para klasës disa foto me pamje të hënës dhe qiellit me yje dhe hënë. Nxënësit shkruajnë në fletore ose fletë pa folur, në formën e vetëdiktimit (fjalë ose fjali) ose përgatit fisha të gatshme për secilin nxënës. Lexohen çfarë kanë shkruar.

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 2. Përsëritje e shkronjave të mësuara të dorës. Lexim në korr.

Përsëriten shkronjat **H,h** të shtypit dhe grafiku i tyre.

Nxiten nxënësit të thonë fjalë që fillojnë me **h** shkruajnë disa prej tyre.

Hapi 3. Shpjegoj grafikun e shkronjës **H,h** të dorës dhe e shoqëruar me lëvizjen në ajër të nxënësve. Shpjegohen elementet përbërës të saj.

Bëhet dallimi me shkronjën **H,h** të shtypit.

Ngre nxënës në tabelë që shkruajnë shkronjën dhe lidhjen e saj me shkronjat e tjera në fjalë.

Hapi 4. Më pas nxënësit punojnë në fletoren e punës sipas modelit. Nxënësit mund të ngatërrojnë **k** e dorë me **h** e dorës, theksohet ky element. Nxënësit lexojnë fjalët dhe fjalinë që shkruan me shkrim dore.

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 5. Diktim me shkronja dore.

Diktim me shkronja dore.

Ha, he, hi, hu, krah, krihu, krihuni, hekuros, Hektori hapi harkun.

Nëse mjafton koha, nxënësit lexojnë rrokjet, fjalët dhe fjalinë me shkrim dore.

Vlerësimi i situatës: ***Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:*** ✓ Shkruan shkronjat **H, h** të dorës duke u ndihmuar nga modeli. ✓ Respekton hapësirën midis fjalëve. ✓ Shkruan shkronjat **H, h** me të gjitha elementet duke e lidhur me shkronjat e tjera . ✓ Shkruan fjalë me të kopjuar duke përdorur shkronjën **H, h** në fillim, në trup të fjalës ✓ Lexon fjalë me shkrim dore.
Detyrë shtëpie: **1.** Shkruaj 6 fjalë që përmbajnë shkronjën h, **2.** Formo fjali me fjalët *hëna, helikopter, harku.*
Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla: 1**	**Klasa:** 1
Tema mësimore: Punim i faqes 46-47 të Abetares. Bisedë me Hënën.		**Situata e të nxënit:** Natë me hënë	

***Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe**

Nxënësi:

- ***Kompetenca e komunikim dhe të shprehurit:*** Shpreh mesazhin e një teksti të thjeshtë, nëpërmjet njërës nga format shprehëse: të folurit, shkrimit.
- ***Kompetenca e komunikim dhe të shprehurit:*** Identifikon personazhet kryesore të një tregimi, drame dhe luan rolin e njërit prej personazheve.
- ***Kompetenca e të nxënit:*** Parashtron pyetje dhe përgjigjet në pyetjet për temën në njërën nga format e të shprehurit.
- ***Kompetenca qytetare:*** Diskuton dhe bashkëpunon me anëtarët e grupit.

***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore**

Nxënësi:

- Qarkon shkronjën **H** në tekst të panjohur.
- Lidh sipas kuptimit fjalët për të krijuar fjali.
- Plotëson fjalë mungesore.
- Interpreton me role një dialog.
- Shkruan me të kopjuar ose të diktuar.
- Lexon fjalë fjali me shkrim dore.

Fjalë kyçe:

Hëna, krahu, hark, hekuri, harabel, helikopteri, hinka, harta.

Teknika dhe strategji:

- Punë individuale
- Lexim fjalësh, fjalish
- Analizë – sintezë
- Punë në dyshe/grup

Burimet e informacionit dhe mjete:

Libri i nxënësit, modele shkronjash individuale, grafiku i shkronjës **H, h** të shtypit, foto të hënës ose të natës me yje, glob

Lidhja me fushat e tjera:

Lënda: Matematikë, art pamor

Përshkrimi kontekstual i situatës

- ***Veprimtari praktike***

Hapi 1. Mësuesja shpërndan një tekst *(me temë sipas situatës)* në të cilën nxënësit duhet të qarkojnë shkronjën **H,** të lexojnë fjalë, fjali sipas nivelit të nxënësve. (ose ka përgatitur fletë me grafikun e **H** të dorës dhe shtypit për të përforcuar.

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 2. Përsëritje në korr e shkronjave të shtypit dhe të dorës, të mësuara deri tani.
Nxënësit tregojnë se sa shkronja **H** kanë gjetur në pjesën që sapo kanë parë.
Për nxënës më të përparuar mund t'u kërkohet të lexojnë fjalë ose fjali.
Hapi 3. Punohet me pjesën e fundit të faqes **46** dhe **47**.
Rilexojnë fjalinë: **Unë e kam emrin Hënë** Bëhet ndarja e fjalëve në etiketa.
U kërkohet nxënësve të gjejnë fjalën e parë, të dytë e kështu me radhë si dhe në rend të ngatërruar.
Hapi 4. Lihen të punojnë individualisht për lidhjen e fjalëve sipas kuptimit në fjali, fundi i faqes **46**. Në të njëjtën mënyrë punohet për ushtrimet e fundit të faqes **47**. Mund të aplikohet dhe puna në dyshe ose grup sipas përbërjes së klasës. Nxënësit lexojnë fjalët dhe fjalitë e formuara.

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 5. Bëhet dramatizimi i pjesës *"Bisedë me Hënën",* ose leximi me role sipas përbërjes dhe nivelit të klasës. Rolet i janë caktuar një ditë më parë. Fillojnë grupet e nxënësve që nuk lexuan

gjatë orës së parë të punimit të faqes.
Vlerësimi i situatës: ***Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:*** ✓ Qarkon shkronjën **H** në tekst të panjohur. ✓ Lidh sipas kuptimit fjalët për të krijuar fjali. ✓ Plotëson fjalë mungesore. ✓ Shkruan me të kopjuar ose të diktuar. ✓ Lexon fjalë fjali me shkrim dore
Detyrë shtëpie: **1.** Kopjo me shkronja dore fjalitë që formove në klasë. **2.** Shkruaj 2 fjali për bisedën e vajzës me Hënën.
Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla: 1**	**Klasa:** 1
Tema mësimore: Punim i shkronjës **T, t** faqe 48 të Abetares		**Situata e të nxënit:** Objektet që na pëlqejnë	

***Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe**

Nxënësi:

- ***(1)Kompetenca e komunikim dhe të shprehurit:*** Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar.
- ***(3)Kompetenca e të nxënit:*** Parashtron pyetje dhe përgjigje në lidhje me temën.
- ***(4)Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin:*** Gjen të përbashkëtat dhe ndryshimet ndërmjet aktiviteteve, që organizohen në shkollë me ato në shtëpi.

***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore**

Nxënësi:

- Shqipton tingullin **T.**
- Gjen dhe thotë fjalë që fillojnë me **T** ose që përmbajnë tingullin **T** në trup të tyre.
- Lexon fjalët e fjalorit të librit.
- Plotëson sipas figurës fjalë mungesore.
- Formon fjali/tekst sipas figurës kryesore të faqes.
- Ndan fjalë, fjali në etiketa.

Fjalë kyçe:

harta, tavolina, atlete, teta, topi, kompjuteri, Artani, Teuta.

Teknika dhe strategji:

- Diskutim paraprak
- Vëzhgim
- Demonstrim
- Analizë – sintezë e fjalëve, fjalive
- Punë individuale/Çift

Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, modele shkronjash individuale, grafiku i shkronjës **T,t** të shtypit, lodra dhe objekte të ndryshme që fëmijët i pëlqejnë.

Lidhja me fushat e tjera: Lënda: Edukim fizik, Matematikë, Art, pamor

Përshkrimi kontekstual i situatës:

- ***Veprimtari paraprake:***

Hapi 1. Njoh nxënësit me situatën. Nxit ata të flasin për lodrat e preferuara dhe objekte të tjera që ata i kanë për zemër. I orienton ata drejt lojës dhe kohës që kalojnë me kompjuter.

Hapi 2. Nxiten nxënësit të vërejnë figurën në libër dhe të formojnë fjali ose një tekst të shkurtër. Udhëzon nxënësit t'i vendosin emra fëmijëve. Shkruhet titulli në tabelë.

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 3. Demonstron para klasës grafikun e shkronjës së vogël dhe të madhe të shtypit. Nxit nxënësit të bëjnë ngjashmëritë dhe dallimet me shkronjat e tjera dhe objekte të tjera rrethanore. Shqiptohet tingulli **T,** thekson qe mund te ngatërrohet në shqiptim me **D**. Bëhet përsëritje e bashkëtingëlloreve të mësuara deri tani.

Hapi 4. Nxiten nxënësit të gjejnë fjalë që fillojnë me **T** , e kanë në trup ose mbarojnë me **T**.

T	**T**	**T**
Toka	Harta	Mot .....

Hapi 5. Nxënësit punojnë individualisht për plotësimin shkronjave në fjalët mungesore.

Bëhet leximi dhe ndarja e tyre në rrokje. Ngre disa nxënës që shkruajnë fjalët në tabelë. Punohet

fjalia. **Artani e Teuta kanë kompjuter të ri.** Ndahen në rrokje fjalët *Artani, Teuta, kompjuter.* ▪ ***Demonstrim i rezultateve të arritura*** ***Hapi 7.*** Individualisht nxënësit qarkojnë rrokjet në fjalët e shkruara. Lexohen nga nxënësit në zinxhir fjalët e fundit të faqes. ***Hapi 8***. Nxënësit vizatojnë një kompjuter ose lodrën e tyre të preferuar.
Vlerësimi i situatës: ***Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:*** ✓ Shqipton tingullin **T**. ✓ Gjen dhe thotë fjalë që fillojnë me **T** ose që përmbajnë tingullin **T** në trup të tyre. ✓ Lexon fjalët e fjalorit të librit. ✓ Plotëson sipas figurës fjalë mungesore. ✓ Formon fjali/ tekst sipas figurës kryesore të faqes. ✓ Ndan fjalë, fjali në etiketa.
Detyrë shtëpie: **1.** Kopjo fjalët e fjalorit. **2.** Formo fjali me 5 nga fjalët e fundit të faqes.
Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla: 1**	**Klasa:** 1
Tema mësimore: Punim e shkrim i shkronjës **T, t**, Abetare pune faqe **37**		**Situata e të nxënit:** Objektet që na pëlqejnë.	

***Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe**

Nxënësi:

- ***(3)Kompetenca e të nxënit:*** Ndjek udhëzimet e dhëna për të realizuar një veprim.
- ***(3)Kompetenca e të nxënit:*** mbikëqyr në mënyrë të pavarur përparimin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes.
- ***(4)Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin:*** Identifikon burimet e nevojshme dhe i përdor në mënyrë të drejtë.

***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore**

Nxënësi:

- Shkruan shkronjës **T,t** të shtypit sipas modelit.
- Shkruan rrokje, fjalë, fjali.
- Lidh rrokjet për të krijuar fjalë.
- Lidh fjalët për të krijuar fjali.

Fjalë kyçe:
Top, tren, patina, atlete, patatina, Tirana, toka .teli, peta.

Teknika dhe strategji:

- Lojë
- Demonstrim
- Punë individuale
- Analizë – sintezë fjalësh, fjalish.

Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, modele shkronjash individuale, grafiku i shkronjës **T, t** të shtypit, objekte të ndryshme që i kanë sjellë fëmijët, lodra etj.

Lidhja me fushat e tjera:
Edukim, për shoqërinë

Përshkrimi kontekstual i situatës

- ***Veprimet paraprake***

Hapi 1. Nxënësit janë porositur të sjellin në klasë objektin e tyre të preferuar. Bëjnë prezantimin e tyre, shkruajnë emërtimin ose një fjali për të. Mund të improvizohet një lojë e shkurtër me top ose lodra të tjera që nxënësit kanë sjellë në klasë.

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 2. Paraqet grafikun e shkronjës **T, t.** Nxit të thonë ndryshimet dhe ngjashmëritë me shkronjat e tjera,

Ngre nxënës në tabelë që shkruajnë disa nga rrokjet, fjalët dhe fjalitë e përdorura gjatë pjesës së parë të orës.

Hapi 4. Punohet sipas kërkesave në fletoren e punës. Modelohet shkronja **T, t.** Shkruhen fjalët me shkronja të vogla të shtypit. Lidhen etiketat, duke këshilluar nxënësit të ndjekin drejtimin e shigjetave. Lidhin etiketat për formuar fjali, lidhin rrokjet për të formuar fjalë. Lidh fjalët për të krijuar fjali me kuptim.

Bëhet kontrolli individual i fletores.

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 5. Nxënësit lexojnë fjalët dhe fjalitë që krijuan gjatë ushtrimeve në fletoren e punës.

Ndan fjalinë në etiketa. Nëse mjafton koha, mund të bëhet dhe një diktim i shkurtër me disa nga fjalët e punuara në fletoren e punës.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi: ✓ Shkruan shkronjës **T, t** të shtypit sipas modelit. ✓ Shkruan rrokje, fjalë, fjali. ✓ Formon fjalë duke lidhur rrokjet. ✓ Formon fjali duke lidhur fjalët.
Detyrë shtëpie: • Formo nga fjali me fjalët : *top, tren, patina, Tirana,* • Lexo dhe shkruaj bukur në fletore fjalitë: *Titi mat me metër.* *Trina takoi Tomin.* *Entela pret bukën.*
Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla: 1**	**Klasa:** 1
Tema mësimore: Punim e lexim i shkronjës **T, t** faqe 49 të Abetares.		**Situata e të nxënit:** Objektet që na pëlqejnë.	

***Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe**

Nxënësi:

- ***(1)Kompetenca e komunikim dhe të shprehurit:*** Dëgjon një tregim.
- ***(1)Kompetenca e komunikim dhe të shprehurit:*** Identifikon personazhet e një tregimi.
- ***(3)Kompetenca e të nxënit:*** Parashtron pyetje dhe përgjigje në lidhje me temën.

***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore**

Nxënësi:

- Lexon fjalë, fjali.
- I përgjigjet me fjali të thjeshtë pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit.
- Rilexon tekstin për të kuptuar përmbajtjen e tij.
- Lidh pjesën që lexon me përvoja personale.

Fjalë kyçe: *Kompjuter, taste, temperaturë, moti, internet*

Teknika dhe strategji:

- Diskutim paraprak
- Marrëdhënie pyetje-përgjigje
- Lexim zinxhir
- Rrjeti i diskutimit

Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, modele shkronjash individuale, grafiku i shkronjës **T, t** të shtypit, foto të kompjuterit dhe pjesëve të tij, laptop.

Lidhja me fushat e tjera: Dituri natyre, Arte

Përshkrimi kontekstual i situatës:

- ***Veprimtari paraprake***

Hapi 1: Mësuesja prezanton laptopin, kompjuter ose në mungesë foto dhe nxit nxënësit të bëjnë emërtimin e pjesëve. Shkruan në tabelë: *Kompjuter, tastierë, ekran.* Lexohen me zë të lartë nga nxënësit.

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 2: Hapen librat. Komentohen figurat.

Bëhet leximi në korr i pjesës Shpjegohen fjalët *temperaturë, temperatura të larta, mot, internet.* Lihen nxënësit të lexojnë në heshtje pjesën. Shpjegohet thjesht përdorimi i thonjëzave.

Hapi 3: Bëhet leximi i saj me fjali në formë zinxhiri. Plotësohet individualisht pyetja se çfarë bën Artani në kompjuter?

Diskutohet me nxënësit. *Po ju çfarë bëni në kompjuter? Sa kohë harxhoni me kompjuter ose lodra të tjera elektronike?*

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 4: Diskutohet rreth përmbajtjes.

- *Cilët po punonin në kompjuter?*
- *Çfarë bëri Artani?*
- *Po Teuta çfarë kërkoi në internet?*
- *Çfarë mësuan ata në internet?*

Hapi 5:

PO	**Të kalosh kohë në kompjuter është mirë apo keq? Pse?**	**JO**

U kërkohet nxënësve të argumentojnë mendimet e tyre.
Vlerësimi i situatës: ***Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:*** ✓ Lexon fjalë, fjali. ✓ I përgjigjet me fjali të thjeshtë pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit. ✓ Rilexon tekstin për të kuptuar përmbajtjen e tij. ✓ Lidh pjesën që lexon me filma që ka parë, me përvoja personale.
Detyrë shtëpie: **1.** Lexo pjesën me intonacion. **2.** Kopjo/Shkruaj 3 fjali për tekstin.
Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla: 1**	**Klasa:** 1
Tema mësimore: Ushtrime aplikative për shkrim dore, shkronja **T, t.**		**Situata e të nxënit:** Objektet që na pëlqejnë.	

***Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe**

Nxënësi:

- ***(3)Kompetenca e të nxënit:*** Mbikëqyr në mënyrë të pavarur përparimin e vet në një detyrë duke përdorur detyra të ndryshme.
- ***(3)Kompetenca e të nxënit:*** Korrigjon gabimet.
- ***(4) Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin:*** Identifikon burimet e nevojshme dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre në klasë.
- ***(6) Kompetenca qytetare:*** Bashkëpunon në grup dhe respekton rregullat e grupit.

***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore**

Nxënësi:

- Shkruan shkronjat **T,t** të dorës duke u ndihmuar nga modeli.
- Respekton hapësirën midis fjalëve.
- Shkruan shkronjat **T,t** me të gjitha elementet duke e lidhur me shkronjat e tjera .
- Shkruan fjalë me të kopjuar duke përdorur shkronjën **T,t** në fillim, në trup të fjalës
- Lexon fjalë me shkrim dore.

Fjalë kyçe:

Top, tren, patina, atlete, patatina, Tirana, toka .teli, peta.

Teknika dhe strategji:

- Lojë me top
- Lexim në korr
- Demonstrim
- Punë individuale
- Punë në çifte/punë në dyshe
- Lexim individual

Burimet e informacionit dhe mjete: Fletore e punës, fletore shkrimi , modele shkronjash individuale, grafiku i shkronjës **T, t** të shtypit dhe të dorës.

Lidhja me fushat e tjera: Arte, Edukim fizik.

Përshkrimi kontekstual i situatës

- ***Veprimtari paraprake***

Hapi 1. Zhvillohet një lojë me top. Nxënësit kalojnë topin dorë më dorë dhe ata që kapin topin duhet të thonë një fjalë që përmban shkronjën **T**. Disa nga fjalët shkruhen në tabelë.

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 2. Përsëritje e shkronjave të mësuara të dorës. Lexim në korr.

Përsëriten shkronjat **T, t** të shtypit dhe grafiku i tyre.

Nxiten nxënësit të thonë fjalë që fillojnë me **t** shkruajnë disa prej tyre.

Hapi 3. Shpjegoj grafikun e shkronjës **T, t** të dorës dhe e shoqëruar me lëvizjen në ajër të nxënësve. Shpjegohen elementet përbërës të saj. Bëhet dallimi me shkronjën **T, t** të shtypit.

Ngre nxënës në tabelë që shkruajnë shkronjën dhe lidhjen e saj me shkronjat e tjera në fjalë.

Hapi 4. Më pas nxënësit punojnë në fletoren e punës sipas modelit. Nxënësit lexojnë fjalët dhe fjalinë që shkruan me shkrim dore.

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 5. Diktim me shkronja dore.

Diktim me shkronja dore.

Ta, te, ti, tu, tra, tre, tri, topi, treni, Teuta. Taulanti luan me motor.

Nëse mjafton koha, nxënësit lexojnë rrokjet, fjalët dhe fjalinë me shkrim dore.
Vlerësimi i situatës: ***Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:*** ✓ Shkruan shkronjat **T, t** të dorës duke u ndihmuar nga modeli. ✓ Respekton hapësirën midis fjalëve. ✓ Shkruan shkronjat **T,t** me të gjitha elementet duke e lidhur me shkronjat e tjera. ✓ Shkruan fjalë me të kopjuar duke përdorur shkronjën **T,t** në fillim, në trup të fjalës ✓ Lexon fjalë me shkrim dore.
Detyrë shtëpie: **1.** Shkruaj 6 fjalë që përmbajnë shkronjën **t**. **2.** Formo fjali me fjalët *Top, tren, patina, atlete, Tetova, toka, teli.*
Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla: 1**	**Klasa:** 1
Tema mësimore: Punim i faqes **48-49** të Abetares. **Kompjuteri**		**Situata e të nxënit:** Objektet që na pëlqejnë.	

***Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe**

Nxënësi:

- ***(1)Kompetenca e komunikim dhe të shprehurit:*** Ritregon ngjarjen e një teksti të dëgjuar.
- ***(1)Kompetenca e komunikim dhe të shprehurit:*** Shpreh mesazhin e një teksti të thjeshtë, nëpërmjet njërës nga format shprehëse: të folurit, shkrimit.
- ***(3)Kompetenca e të nxënit:*** Parashtron pyetje dhe përgjigjet në pyetjet për temën në njërën nga format e të shprehurit.
- ***(6)Kompetenca qytetare:*** Diskuton dhe bashkëpunon me anëtarët e grupit.

***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore**

Nxënësi:

- Dallon bashkëtingëlloret nga zanoret.
- Lidh sipas kuptimit fjalët për të krijuar fjali.
- Plotëson fjalë mungesore.
- Shkruan me të kopjuar ose të diktuar.
- Lexon fjalë, fjali me shkrim dore.

Fjalë kyçe:

kompjuteri, Artani, Teuta. Metër, trokiti, mbeti etj.

Teknika dhe strategji:

- Punë individuale
- Lexim fjalësh, fjalish
- Analizë – sintezë
- Punë në dyshe/grup

Burimet e informacionit dhe mjete:

Libri i nxënësit, modele shkronjash individuale, grafiku i shkronjës **T, t** të shtypit, foto të kompjuterit dhe pjesëve të tij, laptop.

Lidhja me fushat e tjera:

Lënda: Matematikë, art pamor

Përshkrimi kontekstual i situatës

- ***Veprimtari praktike***

Hapi 1. Në fisha mësuesja ka shkruar të gjitha shkronjat e mësuara deri tani. Qarkojnë me të kuqe zanoret dhe me blu bashkëtingëlloret. Shqiptohen shkronjat e mësuara.

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 2. Diskutohet rreth përmbajtjes së tekstit.

Cilët po punonin në kompjuter? Çfarë bëri Artani? Po Teuta çfarë kërkoi në internet? Çfarë mësuan ata në internet?

Hapi 3. Pyet nxënësit për leximin e pjesë. U kërkohet nxënësve të gjejnë fjalën e parë, të dytë e kështu me radhë si dhe në rend të ngatërruar.

Për nxënës me nivel të përparuar, mund të kërkohet të thonë 2-3 fjali rreth përmbajtjes.

Hapi 4. Lihen të punojnë individualisht për ushtrimet e fundit të faqes **49**. Mund të aplikohet dhe puna në dyshe ose grup sipas përbërjes së klasës. Nxënësit lexojnë fjalët dhe fjalitë e formuara. Bëjnë vetë korrigjimin e ushtrimeve.

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 5. Në fletoren e klasës shkruajnë fjalitë me shkrim dore: *Tina trokiti fort. Tani takoi motrën. Meti mbeti në park. Titi mat me metër.*

Lexojnë fjalitë nga fletoret e veta me shkrim dore.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

✓ Dallon bashkëtingëlloret nga zanoret. ✓ Lidh sipas kuptimit fjalët për të krijuar fjali. ✓ Plotëson fjalë mungesore. ✓ Shkruan me të kopjuar ose të diktuar. ✓ Lexon fjalë fjali me shkrim dore.
Detyrë shtëpie: **1.** Rilexo tekstin. **2.** Mëso përmbajtjen. **3.** Kopjo disa fjali që të pëlqejnë më shumë.
Refleksione:

<table>
<tr><td>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla: 1</td><td>Klasa: 1</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore: Punim i shkronjës S, s faqe 50 të Abetares</td><td colspan="2">Situata e të nxënit: Qarkullimi rrugor</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe
Nxënësi:
➢ (1)Kompetenca e komunikim dhe të shprehurit: Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar.
➢ (3)Kompetenca e të nxënit: Parashtron pyetje dhe përgjigje në lidhje me temën.
➢ (4)Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin: Gjen të përbashkëtat dhe ndryshimet ndërmjet aktiviteteve, që organizohen në shkollë me ato në shtëpi.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore
Nxënësi:
- Shqipton tingullin S
- Gjen dhe thotë fjalë që fillojnë me S ose që përmbajnë shkronjën S në trup të tyre.
- Lexon fjalët e fjalorit të librit
- Plotëson sipas figurës fjalë mungesore.
- Formon fjali/ tekst sipas figurës kryesore të faqes.</td><td colspan="2">Fjalë kyçe:
Semafori, sportisti, sandale,, stop, sapuni, sporti, sita, skiatori, supa.
Teknika dhe strategji:
❖ Diskutim paraprak
❖ Vëzhgim
❖ Demonstrim
❖ Analizë – sintezë e fjalëve, fjalive
❖ Punë individuale/Çift</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, modele shkronjash individuale, grafiku i shkronjës S, s të shtypit, shenja të qarkullimit rrugor.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera: Lënda: Edukim fizik, Matematikë, Edukim për shoqërinë.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Përshkrimi kontekstual i situatës:
▪ Veprimtari paraprake:
Hapi 1. Mund të zhvillohet një shëtitje e shkurtër në rrugën që është pranë shkollës, nëse shkolla është në zonë urbane. Nxiten nxënësit të shikojnë shenjat e qarkullimit rrugor dhe kështillon se si t’i zbatojnë ato. Nëse shkolla ndodhet në zonë rurale, mësuesja njeh me disa shenja kryesore të qarkullit rrugor dhe diskuton me ta për 2 -3 rregulla të thjeshta të qarkullit rrugor.
Hapi 2. Nxiten nxënësit të vërejnë figurën në libër dhe të formojnë fjali ose një tekst të shkurtër. Udhëzon nxënësit t’i vendosin emra fëmijëve. Shkruhet titulli në tabelë.
▪ Veprimet në situatë
Hapi 3. Demonstron para klasës grafikun e shkronjës së vogël dhe të madhe të shtypit. Nxit nxënësit të bëjnë ngjashmëritë dhe dallimet me shkronjat e tjera dhe objekte të tjera rrethanore. Shqiptohet tingulli S, Tërheq vëmendjen e nxënësve që kanë vështirësi në artikulim dhe kanë vështirësi në shqiptim. Bëhet përsëritje e bashkëtingëlloreve të mësuara deri tani.
Hapi 4. Nxiten nxënësit të gjejnë fjalë që fillojnë me S, e kanë në trup ose mbarojnë me S.
Nxënësit punojnë individualisht për plotësimin shkronjave në fjalët mungesore.
Bëhet leximi dhe ndarja e tyre në rrokje. Ngre disa nxënës që shkruajnë fjalët në tabelë.
Hapi 5. Punohet fjalia. Sot mësuam për semaforin. Lexo etiketën e parë, të dytë e kështu me radhë. Nxënësit punojnë me etiketa individuale. Ndahen në rrokje fjalët mësuam, semafor.</td></tr>
</table>

▪ ***Demonstrim i rezultateve të arritura*** ***Hapi 6.*** Individualisht nxënësit, plotësojnë fjalët mungesore dhe i lexojnë me zë të lartë: *sapuni, sporti, sita, skiatori, supa.* Shkruajnë 3 rreshta me shkronjën **S, s** në fletore dhe fjalinë dhe fjalët kryesore. Disa nxënës shkruajnë fjalët në tabelë.
Vlerësimi i situatës: ***Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:*** ✓ Shqipton tingullin **S.** ✓ Gjen dhe thotë fjalë që fillojnë me ***S*** ose që përmbajnë shkronjën **S** në trup të tyre. ✓ Lexon fjalët e fjalorit të librit; ✓ Plotëson sipas figurës fjalë mungesore. ✓ Formon fjali/tekst sipas figurës kryesore të faqes.
Detyrë shtëpie: **1.** Vizato disa shenja të qarkullit rrugor. **2.** Shkruaj 10 fjalë që përmbajnë shkronjën **S**.
Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla: 1**	**Klasa:** 1
Tema mësimore: Punim e shkrim i shkronjës **S, s**, Abetare pune faqe **38**		**Situata e të nxënit:** Qarkullimi rrugor	

***Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe**

Nxënësi:

- ***(3)Kompetenca e të nxënit:*** Ndjek udhëzimet e dhëna për të realizuar një veprim.
- ***(3)Kompetenca e të nxënit:*** Mbikëqyr në mënyrë të pavarur përparimin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes.
- ***(4)Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin:*** Identifikon burimet e nevojshme dhe i përdor në mënyrë të drejtë.

***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore**

Nxënësi:

- Shkruan shkronjës **S, s** të shtypit sipas modelit.
- Shkruan rrokje, fjalë.
- Formon fjalë duke lidhur rrokjet.
- Plotëson fjalinë mungesore.

Fjalë kyçe:
Stop, kopsa, sëpata, sirena, pasnesër, sapuni, mësuesi.

Teknika dhe strategji:

- Turi i galerisë.
- Demonstrim
- Punë individuale
- Analizë – sintezë fjalësh, fjalish.

Burimet e informacionit dhe mjete: Shkronjat individuale dhe kolektive, fletore pune, etiketa me rrokje, fjalë sipas nivelit. Shenja të qarkullit rrugor.

Lidhja me fushat e tjera:
Edukim për shoqërinë, Matematikë, Art pamor.

Përshkrimi kontekstual i situatës

- ***Veprimet paraprake***

Hapi 1. Shkruaj një rregull të qarkullimit rrugor di. Vizato një simbol të qarkullimit rrugor. Nxënësit punojnë me etiketat individuale. Paraqiten punimet më të mira.

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 2. Paraqet grafikun e shkronjës **S, s.** Nxit të thonë ndryshimet dhe ngjashmëritë me shkronjat e tjera,
Ngre nxënës në tabelë që shkruajnë disa nga rrokjet, fjalët dhe fjalitë e përdorura gjatë pjesës së parë të orës.

Hapi 3. Punohet sipas kërkesave në fletoren e punës. Modelohet shkronja **S,s.** Shkruhen fjalët me shkronja të vogla të shtypit. Lidhen etiketat, duke këshilluar nxënësit të ndjekin drejtimin e shigjetave. Lidhin etiketat për formuar fjali, lidhin rrokjet për të formuar fjalë. Plotësohet fjalia mungesore duke përshtatur në mënyrë intuitive ndajfoljet e kohës me kohët e foljeve.
Bëhet kontrolli individual i fletores.

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 4. Nxënësit lexojnë fjalët dhe fjalitë që krijuan gjatë ushtrimeve në fletoren e punës.
Ndan fjalinë në etiketa. Nëse mjafton koha, mund të bëhet dhe një diktim i shkurtër me disa nga fjalët e punuara në fletoren e punës.

Vlerësimi i situatës:
Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

✓ Shkruan shkronjës **S, s** të shtypit sipas modelit. ✓ Shkruan rrokje, fjalë. ✓ Formon fjalë duke lidhur rrokjet. ✓ Plotëson fjalinë mungesore.
Detyrë shtëpie: **1.** Formo nga fjali me fjalët: *stop, kopsa, sëpatë, mësues.* **2.** Lexo dhe shkruaj bukur në fletore fjalitë. *Sapo mora lapsin e letrën.* *Sot ika me Suelën.* *Nesër kam kurs pikture.* *Pasnesër Sokoli ikën në Prishtinë.*
Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla: 1**	**Klasa:** 1
Tema mësimore: Punim e lexim i shkronjës **S, s** faqe **51** të Abetares		**Situata e të nxënit:** Qarkullimi rrugor	

***Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe**

Nxënësi:

- ***(1)Kompetenca e komunikim dhe të shprehurit:*** Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup
- ***(2) Kompetenca e të menduarit:*** Sqaron me anë të të folurit hapat e zgjidhjes së një problemi të thjeshtë, me të cilin ballafaqohet në një situatë jetësore
- ***(5)Kompetenca personale:*** Bashkëpunon me të tjerët pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitetet në klasë, shkollë apo jashtë saj;
- ***(6)Kompetenca qytetare:*** Diskuton dhe në bashkëpunim me anëtarët e grupit vendos rregullat e punës në grup

***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore**

Nxënësi:

- Lexon fjalë, fjali.
- Përdor gjatë prezantimit elemente si foto, piktura etj.
- Lidh pjesën që lexon me përvoja personale.
- Diskuton në grupe të vogla për tema që i interesojnë.

Fjalë kyçe: *Kompjuter, taste, temperaturë, moti, internet.*

Teknika dhe strategji :

- Lojë me role
- Marrëdhënie pyetje-përgjigje
- Lexim zinxhir
- Punë me grupe

Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, modele shkronjash individuale, grafiku i shkronjës **S,s** të shtypit, abazhur, letra me ngjyrë të kuqe, të verdhë, të gjelbër.

Lidhja me fushat e tjera: Edukim për shoqërinë, Arte

Përshkrimi kontekstual i situatës:

- ***Veprimtari paraprake***

Hapi 1: Improvizohet një situatë, ku nxënësit luajnë me role kapërcimin e rrugës sipas sinjaleve të semaforit. Krijohet hapësira e kryqëzimit dhe nëpërmjet abazhurit dhe letrave me ngjyra që i vendosen, improvizohet semafori me tre ngjyrat e tij.

Hapi 2: Nxënësit përsëritin rregullat e kalimit të rrugës kur ka semafor. Mësuesja shkruan në tabelë me ngjyra të dukshme tre rregullat kryesore të përdorimit të semaforit.

Veprimet në situatë

Hapi 3: Mësuesja lexon me intonacion, tekstin. Thekson mënyrën e të lexuarit të fjalive thirrmore. Bëhet leximi në korr. Ngre nxënës që lexojnë zinxhir tekstin.

Hapi 4: Ndahet klasa në 3 grupe: *grupi i kuq, i gjelbër, i verdhë.*

Sipas ndarjes së grupeve, grupet janë pajisur me kartonë me ngjyra dhe lapustila me ngjyrat përkatëse sipas grupeve.

Secili grup duhet të vizatojë shenjën përkatëse të semaforit dhe të shkruajë 3 rregullat.

Mos kalo!

Nisu tani! **Prit pak!** ***Demonstrim i rezultateve të arritura*** **Hapi 5:** Secili grup prezanton punën e tij dhe jep mendime për punën e grupeve të tjera. U kërkohet nxënësve të argumentojnë mendimet e tyre. Vendosen posterat në muret e klasës.
Vlerësimi i situatës: ***Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:*** ✓ Lexon fjalë, fjali. ✓ Përdor gjatë prezantimit elemente si foto, piktura etj. ✓ Lidh pjesën që lexon me përvoja personale. ✓ Diskuton në grupe të vogla për tema që i interesojnë.
Detyrë shtëpie: 1. Lexo pjesën me intonacion. 2. Vizato semaforin.
Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla: 1**	**Klasa:** 1
Tema mësimore: Ushtrime aplikative për shkrim dore, shkronja **S, s.**		**Situata e të nxënit:** Qarkullimi rrugor	

***Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe**

Nxënësi:

- ***(3)Kompetenca e të nxënit:*** Mbikëqyr në mënyrë të pavarur përparimin e vet në një detyrë duke përdorur detyra të ndryshme.
- ***(3)Kompetenca e të nxënit:*** Korrigjon gabimet.
- ***(4) Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin:*** Identifikon burimet e nevojshme dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre në klasë.

***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore**

Nxënësi:

- Shkruan shkronjat **S, s** të dorës duke u ndihmuar nga modeli.
- Respekton hapësirën midis fjalëve.
- Shkruan shkronjat **S, s** me të gjitha elementet duke e lidhur me shkronjat e tjera.
- Shkruan fjalë me të kopjuar duke përdorur shkronjën **S, s** në fillim, në trup të fjalës
- Lexon fjalë me shkrim dore.

Fjalë kyçe:

Sot, nesër, pasnesër, Kukës

Teknika dhe strategji:

- Lojë
- Lexim në korr
- Demonstrim
- Punë individuale
- Punë në çifte/punë në dyshe
- Lexim individual

Burimet e informacionit dhe mjete: Fletore e punës, fletore shkrimi, modele shkronjash individuale, grafiku i shkronjës **S, s** të shtypit dhe të dorës.

Lidhja me fushat e tjera: Arte, Edukim fizik.

Përshkrimi kontekstual i situatës

- ***Veprimtari paraprake***

Hapi 1. Loja zhvillohet në oborr. Nxënësit vihen në rresht për një dhe bëjnë vrap të lehtë nën udhëheqjen e mësuesit sipas formës së shkronjës **S, s** të dorës. Përsëritet 2-3 herë veprimtaria.

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 2. Përsëritje e shkronjave të mësuara të dorës. Lexim në korr.

Përsëriten shkronjat **S, s** të shtypit dhe grafiku i tyre.

Nxiten nxënësit të thonë fjalë që fillojnë me **s** shkruajnë disa prej tyre.

Hapi 3. Shpjegoj grafikun e shkronjës **S, s** të dorës dhe e shoqëruar me lëvizjen në ajër të nxënësve. Shpjegohen elementet përbërës të saj. Bëhet dallimi me shkronjën **S, s** të shtypit.

Ngre nxënës në tabelë që shkruajnë shkronjën dhe lidhjen e saj me shkronjat e tjera në fjalë.

Hapi 4. Më pas nxënësit punojnë në fletoren e punës sipas modelit. Nxënësit lexojnë fjalët dhe fjalinë që shkruan me shkrim dore.

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 5. Diktim me shkronja dore.

Diktim me shkronja dore.

Sa, se,si, së, so, su, rosa, supa, mësuese, mësimi,

Sokoli mëson mirë.

Nëse mjafton koha, nxënësit lexojnë rrokjet, fjalët dhe fjalinë me shkrim dore.
Vlerësimi i situatës: ***Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:*** ✓ Shkruan shkronjat **S, s** të dorës duke u ndihmuar nga modeli. ✓ Respekton hapësirën midis fjalëve. ✓ Shkruan shkronjat **S, s** me të gjitha elementet duke e lidhur me shkronjat e tjera . ✓ Shkruan fjalë me të kopjuar duke përdorur shkronjën **S, s** në fillim, në trup të fjalës ✓ Lexon fjalë me shkrim dore.
Detyrë shtëpie: **1.** Shkruaj 3 rreshta me shkronjën **S, s** të dorës. **2.** Shkruaj 10 fjalë me shkronjën S. **3.** Formo fjali me fjalët *semafor, lapsi, sapuni, syri.*
Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla: 1**	**Klasa:** 1
Tema mësimore: Punim i faqes **48-49** të Abetares. **Kompjuteri**		**Situata e të nxënit:** Qarkullimi rrugor	

***Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe**

Nxënësi:

- ***(1)Kompetenca e komunikim dhe të shprehurit:*** Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup.
- ***(1)Kompetenca e komunikim dhe të shprehurit:*** Lexon me zë një tekst së paku prej gjysmë faqeje të pa lexuar më parë.
- ***(3)Kompetenca e të nxënit:*** Parashtron pyetje dhe përgjigjet në pyetjet për temën në njërën nga format e të shprehurit.
- ***(6)Kompetenca qytetare:*** Diskuton dhe bashkëpunon me anëtarët e grupit.

***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore**

Nxënësi:

- Lexon fjalë, fjali, tekst të panjohur.
- Lidh sipas kuptimit rrokjet për të krijuar fjalë.
- Plotëson fjali mungesore.
- Shkruan me të kopjuar ose të diktuar.
- Lexon fjalë/fjali me shkrim dore.

Fjalë kyçe:

Semafori, respekto, sot, nesër, pasnesër.

Teknika dhe strategji:

- Punë individuale
- Marrëdhënie pyetje-përgjigje.
- Lexim fjalësh, fjalish
- Analizë – sintezë
- Punë në dyshe/grup

Burimet e informacionit dhe mjete:

Libri i nxënësit, modele shkronjash individuale, grafiku i shkronjës **S, s** të shtypit, të dorës, simbole të qarkullimit rrugor.

Lidhja me fushat e tjera:

Lënda: Matematikë, art pamor

Përshkrimi kontekstual i situatës

- ***Veprimtari praktike***

Hapi 1. Mësuesja ka përgatitur për nxënësin vjershën " Semafori flet me sy" të Ymer Elshanit, ose diçka tjetër në përputhje me temën. I lë nxënësit për disa minuta të qarkojnë shkronjën **S**, të lexojnë fjalët, vjershën. *(sipas nivelit të nxënësve)*

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 2. Diskutohet rreth temës.

- *Përse shërben semafori?*
- *Çfarë tregon ngjyra e kuqe, e verdhë, e gjelbër?*
- *Pse duhet ta respektojmë semaforin?*
- *Thoni disa rregulla të tjera të qarkullimit rrugor.*
- *Trego se si i zbaton ti rregullat e qarkullimit rrugor.*

Hapi 3. Lihen të punojnë individualisht për ushtrimet e fundit të faqes **51**. Mund të aplikohet dhe puna në dyshe ose grup sipas përbërjes së klasës. Nxënësit lexojnë fjalët dhe fjalitë e formuara. Bëjnë vetë korrigjimin e ushtrimeve.

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 4. Formo fjali me fjalët: *sot, nesër, pasnesër.* Nxënësit përdorin kohet e foljeve në mënyrë intuitive. Lexojnë fjalitë nga fletoret e veta me shkrim dore.
Vlerësimi i situatës: ***Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:*** ✓ Lexon fjalë, fjali, tekst të panjohur. ✓ Lidh sipas kuptimit rrokjet për të krijuar fjalë. ✓ Plotëson fjali mungesore. ✓ Shkruan me të kopjuar ose të diktuar. ✓ Lexon fjalë/fjali me shkrim dore.
Detyrë shtëpie: **1.** Mëso përmendësh vjershën: *"Semafori flet me sy"* **2.** Kopjo tekstin: *"Respekto semaforin"* me shkronja dore.
Refleksione:

<table>
<tr><td>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla: 1</td><td>Klasa: 1</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore: Punim i shkronjës Sh, sh faqe 52 të Abetares</td><td colspan="2">Situata e të nxënit: Luajmë me shkronja</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe
Nxënësi:
➢ (1)Kompetenca e komunikim dhe të shprehurit: Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar.
➢ (3)Kompetenca e të nxënit: Parashtron pyetje dhe përgjigje në lidhje me temën.
➢ (4)Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin: Gjen të përbashkëtat dhe ndryshimet ndërmjet aktiviteteve, që organizohen në shkollë me ato në shtëpi.
➢ (5) Kompetenca personale: Bashkëpunon me të tjerët pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitetet në klasë, shkollë apo jashtë saj;</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore
Nxënësi:
✚ Shqipton tingullin SH.
✚ Gjen dhe thotë fjalë që fillojnë me SH ose që përmbajnë shkronjën SH në trup të tyre.
✚ Lexon fjalët e fjalorit të librit.
✚ Plotëson sipas figurës fjalë mungesore.
✚ Formon fjali/tekst sipas figurës kryesore të faqes.</td><td colspan="2">Fjalë kyçe:
Shkronjat, shi, shalli, shporta, shkollë, peshore, sheshi, peshku.
Teknika dhe strategji:
❖ Këndim
❖ Vëzhgim
❖ Diskutim
❖ Analizë – sintezë e fjalëve, fjalive
❖ Punë individuale/Çift</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, modele shkronjash individuale, grafiku i shkronjës Sh, sh të shtypit, Cd, magnetofon.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera: Lënda: Muzikë, Matematikë, Edukim për shoqërinë.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Përshkrimi kontekstual i situatës:
▪ Veprimtari paraprake:
Hapi 1. Këndohet kënga: “Shi, shi lagashi”. Mësuesi mund ta gjejë në këtë link: https://www.youtube.com/watch?v=5l7o6NkM61k.
Nxiten nxënësit të flasin për stinën e vjeshtës dhe karakteristikat e stinës.
Hapi 2. Nxiten nxënësit të vërejnë figurën në libër dhe të formojnë fjali ose një tekst të shkurtër. Diskutohet rreth figurës.
Kë shihni? Çfarë kanë shkronjat? Pse ankohen ato? Po fjalët që i gjetët të shkruara gabim, çfarë mund të thonë?
▪ Veprimet në situatë
Hapi 3. Demonstron para klasës grafikun e shkronjës së vogël dhe të madhe të shtypit. Nxit nxënësit të bëjnë ngjashmëritë dhe dallimet me shkronjat e tjera dhe objekte të tjera rrethanore. Shqiptohet tingulli Sh. Tërheq vëmendjen e nxënësve që kanë vështirësi në artikulim dhe kanë vështirësi në shqiptim. Bëhet përsëritje e bashkëtingëlloreve të mësuara deri tani. Bëhet dallimi dhe ngjashmëria me shkronjën S,s.</td></tr>
</table>

Hapi 4. Nxiten nxënësit të gjejnë fjalë që fillojnë me **Sh** , e kanë në trup ose mbarojnë me **Sh**.
Nxënësit punojnë individualisht për plotësimin shkronjave në fjalët mungesore.
Bëhet leximi dhe ndarja e tyre në rrokje. Ngre disa nxënës që shkruajnë fjalët në tabelë.
Hapi 5. Punohet fjalia. **Shkronjat nuk shkuan në shkollë.** Lexo etiketën e parë, të dytë e kështu me radhë. Nxënësit punojnë me etiketa individuale. Ndahen në rrokje fjalët*: shkronjat, shkuan, shkollë.*

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 6. Individualisht nxënësit, lexojnë rrokjet me ngjyra dhe i qarkojnë ato në fjalët. I lexojnë me zë të lartë*: shami, shumë, pesha, pishinë, shkalla, peshore, sheshi, peshku, shkolla.*
Diskutojnë me njëri – tjetrin për lidhjen e fjalive sipas kuptimit.
Kreshniku mbushi shportën.
Shokët shkuan në Shkodër.
Shpresa shkoi në Prishtinë.
Shkruajnë 3 rreshta me shkronjën **Sh, sh** në fletore dhe fjalinë dhe fjalët kryesore.
Disa nxënës shkruajnë fjalët në tabelë.

Vlerësimi i situatës:
Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Shqipton tingullin **Sh.**
- ✓ Gjen dhe thotë fjalë që fillojnë me **Sh** ose që përmbajnë shkronjën **Sh** në trup të tyre.
- ✓ Lexon fjalët e fjalorit të librit.
- ✓ Plotëson sipas figurës fjalë mungesore.
- ✓ Formon fjali/tekst sipas figurës kryesore të faqes.

Detyrë shtëpie:

- Shkruaj 10 fjalë që përmbajnë shkronjën **Sh**.
- Shkruaj bukur të gjitha shkronjat e dorës të mësuara deri tani.
- Shkruaj fjalitë e ushtrimit të fundit.

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla: 1**	**Klasa:** 1
Tema mësimore: Punim e shkrim i shkronjës **Sh, sh**, Abetare pune faqe **39**		**Situata e të nxënit:** Luajmë me shkronja	

***Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe**

Nxënësi:

- ***(3)Kompetenca e të nxënit:*** Ndjek udhëzimet e dhëna për të realizuar një veprim.
- ***(4)Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin:*** Identifikon burimet e nevojshme dhe i përdor në mënyrë të drejtë.
- ***(5) Kompetenca qytetare:*** Diskuton dhe në bashkëpunim me anëtarët e grupit vendos rregullat e punës në grup.

***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore** Nxënësi: - Shkruan shkronjës **Sh, sh** të shtypit sipas modelit. - Shkruan rrokje, fjalë. - Plotëson fjalë mungesore. - Plotëson fjalinë mungesore.	**Fjalë kyçe:** *Shportë, shkronja, shtata.* **Teknika dhe strategji:** - Lojë me shkronja - Demonstrim - Punë individuale - Analizë – sintezë fjalësh, fjalish.
Burimet e informacionit dhe mjete: Shkronjat individuale dhe kolektive, fletore pune, etiketa me rrokje, fjalë sipas nivelit. Letra format, lapsa me ngjyra.	**Lidhja me fushat e tjera:** Edukim për shoqërinë, Matematikë , Art pamor.

Përshkrimi kontekstual i situatës

- ***Veprimet paraprake***

Hapi 1. Ndahet klasa në dy grupe. Gjysma shkruan në fletë formati A4 shkronjën **Sh** të madhe të shtypit, gjysma tjetër shkruan shkronjën **sh** të vogël të shtypit. Kur mësuesi jep sinjalin, nxënësit lëvizin në klasë dhe formojnë çifte të shkronjave (**Sh, sh**).

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 2. Mësuesi kërkon nga nxënësit të komentojnë figurat *(shporta, shkronja, shtata).* Për secilën bëhet pyetja:

Çfarë është ? Për çfarë nevojitet? Pse?

Hapi 3. Punohet sipas kërkesave në fletoren e punës. Modelohet shkronja **Sh, sh.** Shkruhen fjalët me shkronja të vogla të shtypit. Plotësohen fjalët me shkronja mungesore dhe fjalitë me fjalë mungesore. Nxënësit diskutojnë me njëri – tjetrin për plotësimin e fletores së punës. Kontrollohen rezultatet e punës.

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 4. Nxënësit lexojnë fjalët dhe fjalitë që krijuan gjatë ushtrimeve në fletoren e punës.

Ndan fjalinë në etiketa.

Nëse mjafton koha, mund të bëhet dhe një diktim i shkurtër me disa nga fjalët e punuara në fletoren e punës.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi: ✓ Shkruan shkronjës **Sh, sh** të shtypit sipas modelit. ✓ Shkruan rrokje, fjalë. ✓ Plotëson fjalë mungesore. ✓ Plotëson fjalinë mungesore.
Detyrë shtëpie: Formo nga fjali me fjalët: 1. *Shportë, shkronja, shtata.* 2. Lexo dhe shkruaj bukur në fletore fjalitë që formove në fletoren e punës.
Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla: 1**	**Klasa: 1**
Tema mësimore: Punim e lexim i shkronjës **Sh, sh** faqe 53 të Abetares		**Situata e të nxënit:** Luajmë me shkronja	

***Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe**

Nxënësi:

- ***(1) Kompetenca e komunikim dhe të shprehurit:*** Ritregon ngjarjen e një teksti të dëgjuar, përmbajtja e të cilit nuk është më shumë se një faqe teksti.
- ***(5) Kompetenca personale:*** Bashkëpunon me të tjerët pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitetet në klasë, shkollë apo jashtë saj.

***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore**

Nxënësi:

- Lexon fjalë, fjali.
- I përgjigjet me fjali të thjeshtë pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit.
- Rilexon tekstin për të kuptuar përmbajtjen e tij.
- Lidh pjesën që lexon me filma që ka parë, me përvoja personale.

Fjalë kyçe: *Kreshniku, Shpresa, ankesa, shkronja.*

Teknika dhe strategji :

- Lojë me shkronja
- Lexim i drejtuar
- Marrëdhënie pyetje-përgjigje
- Lexim zinxhir
- Punë me grupe

Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, modele shkronjash individuale, grafiku i shkronjës **Sh, sh** të shtypit, etiket me fjalë të shkruara gabim dhe saktë.

Lidhja me fushat e tjera: Edukim për shoqërinë, Arte

Përshkrimi kontekstual i situatës:

- ***Veprimtari paraprake***

Hapi 1: Mësuesi shpërndan etiketat, në të cilat janë shkruar fjalë të ndryshme me shkronja të njohura saktë ose gabim. Mësuesi udhëzon nxënësit të shkruajnë saktë fjalët të cilat janë shkruar gabim. Të gjitha fjalët e sakta shkruhen në tabelë.

Veprimet në situatë

Hapi 2: Mësuesja lexon me ndalesa tekstin: " Ankesat e shkronjave". Këshillon nxënësit të dëgjojnë me vëmendje sepse do të përgjigjen në pyetjet e bëra.

Ndalesa e parë: Shkronjat ..... Shkollë.

Mësuesi pyet:

- *Çfarë ndodhi me shkronjat?*
- *Pse nuk shkruan ato në shkollë?*

Ndalesa e dytë: Shota .... shkruar shkroj.

Mësuesi pyet:

- *Çfarë kishte ndodhur?*
- *Cilat fjalë i kishin shkruar fëmijët gabim?*
- *A bëni dhe ju gabime të tilla?*

Ndalesa e tretë: Shkronjat ... në klasë.

- *Çfarë ndodhi?*

- *Çfarë kishin shkruar shkronjat në letër?*
- *Ku shkoi mësuese Shpresa më nxënësit?*
- *Çfarë ndodhi më pas?*
- *Si do të kishit vepruar ju po të ndodhte e njëjta gjë?*

Hapi 3: Lihen nxënësit të lexojnë për disa minuta pjesën. Ngre disa nxënës që e lexojnë atë duke respektuar shenjat e pikësimit.

Demonstrim i rezultateve të arritura

Hapi 4: Mësuesi u kërkon nxënësve të thonë disa fjali rreth përmbajtjes së tekstit. Ndihmon nxënësit të ritregojnë përmbajtjen me pyetje ndihmëse.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Lexon fjalë, fjali.
- ✓ I përgjigjet me fjali të thjeshtë pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit.
- ✓ Rilexon tekstin për të kuptuar përmbajtjen e tij.
- ✓ Lidh pjesën që lexon me filma që ka parë, me përvoja personale..

Detyrë shtëpie:

1. Lexo pjesën me intonacion.
2. Kopjo bukur dy fjalitë e fundit.

Refleksione:

<table>
<tr><td>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla: 1</td><td>Klasa: 1</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore: Ushtrime aplikative për shkrim dore, shkronja Sh, sh.</td><td colspan="2">Situata e të nxënit:
Luajmë me shkronja</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe
Nxënësi:
➢ (3)Kompetenca e të nxënit: Mbikëqyr në mënyrë të pavarur përparimin e vet në një detyrë duke përdorur detyra të ndryshme.
➢ (3)Kompetenca e të nxënit: Ndjek udhëzimet e dhëna në një tekst për të realizuar një veprim / aktivitet/detyrë, që kërkohet;
➢ (4) Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin: Identifikon burimet e nevojshme dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre në klasë.</td></tr>
<tr><td colspan="3">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore
Nxënësi:
✚ Shkruan shkronjat Sh, sh të dorës duke u ndihmuar nga modeli.
✚ Respekton hapësirën midis fjalëve.
✚ Shkruan shkronjat Sh, sh me të gjitha elementet duke e lidhur me shkronjat e tjera.
✚ Shkruan fjalë me të kopjuar duke përdorur shkronjën Sh, sh në fillim, në trup të fjalës.
✚ Lexon fjalë me shkrim dore.</td><td>Fjalë kyçe:
Shkronjë e madhe, shkronjë e vogël, diktim,

Teknika dhe strategji:
❖ Lojë
❖ Demonstrim
❖ Punë individuale
❖ Punë në çifte/punë në dyshe
❖ Lexim individual</td></tr>
<tr><td colspan="3">Burimet e informacionit dhe mjete: Fletore e punës, fletore shkrimi, modele shkronjash individuale, grafiku i shkronjës Sh, sh të shtypit dhe të dorës.</td><td>Lidhja me fushat e tjera:
Arte</td></tr>
<tr><td colspan="4">Përshkrimi kontekstual i situatës
▪ Veprimtari paraprake
Hapi 1. U kërkohet nxënësve të mbyllin sytë dhe duke ngritur dorën lart, të veprojnë ashtu si i thotë ai. Thotë: “ Mbyllni sytë, ngrini dorën lart me të cilën shkruani, uleni duke bërë një lakim majtas, pastaj përsëriteni djathtas, bëni dy vija paralele dhe një vijë në mes.”
Në këtë mënyrë i orienton të bëjnë lëvizjen e dorës në ajër, ashtu siç janë shkronja e madhe dhe e vogël e shkrimit të dorës. Përsëritet 2-3 herë veprimtaria.
▪ Veprimet në situatë
Hapi 2. Shpjegon grafikun e shkronjës Sh, sh të dorës. Shpjegohen elementet përbërës të saj. Bëhet dallimi me shkronjën Sh, sh të shtypit.
I udhëzon nxënësit që t’i shkruajnë shkronjat në fletë ta bardha me ngjyra. Ngre nxënës në tabelë që shkruajnë shkronjën dhe lidhjen e saj me shkronjat e tjera në fjalë.
Hapi 3. Më pas nxënësit punojnë në fletoren e punës sipas modelit. Nxënësit lexojnë fjalët dhe fjalinë që shkruan me shkrim dore.
▪ Demonstrim i rezultateve të arritura
Hapi 4. Diktim me shkronja dore.</td></tr>
</table>

Diktim me shkronja dore. *Sha, she,shi, shë, sho, shu, shkollë, shtat, shkumës, shtëpi, Shkodër, Prishtinë.* *Shpëtimi është shoku i Shpresës.* Nëse mjafton koha, nxënësit lexojnë rrokjet, fjalët dhe fjalinë me shkrim dore.
Vlerësimi i situatës: ***Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:*** ✓ Shkruan shkronjat **Sh, sh** të dorës duke u ndihmuar nga modeli. ✓ Respekton hapësirën midis fjalëve. ✓ Shkruan shkronjat **Sh, sh** me të gjitha elementet duke e lidhur me shkronjat e tjera. ✓ Shkruan fjalë me të kopjuar duke përdorur shkronjën **Sh, sh** në fillim, në trup të fjalës ✓ Lexon fjalë me shkrim dore.
Detyrë shtëpie: **1.** Shkruaj 3 rreshta me shkronjën **Sh, sh** të dorës. **2.** Shkruaj 10 fjalë me shkronjën **Sh**. **3.** Formo fjali me fjalët *shkollë, shtatë, shtrat.*
Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla: 1**	**Klasa:** 1
Tema mësimore: Punim i faqes **52-53** të Abetares. ***Ankesat e shkronjave***		**Situata e të nxënit:** Luajmë me shkronja	

***Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe**

Nxënësi:

- ***(1)Kompetenca e komunikim dhe të shprehurit:*** Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup.
- ***(1)Kompetenca e komunikim dhe të shprehurit:*** Lexon me zë një tekst së paku prej gjysmë faqeje të pa lexuar më parë.
- ***(3)Kompetenca e të nxënit:*** Parashtron pyetje dhe përgjigjet në pyetjet për temën në njërën nga format e të shprehurit.
- ***(6)Kompetenca qytetare:*** Diskuton dhe bashkëpunon me anëtarët e grupit.

***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore**

Nxënësi:

- Lexon për të kuptuar përmbajtjen.
- Plotëson fjali mungesore.
- Shkruan me të kopjuar ose të diktuar.
- Lexon fjalë/fjali me shkrim dore.

Fjalë kyçe:

Shkronjë, peshkatar, shitës, shofer.

Teknika dhe strategji:

- Lojë me role
- Lexim fjalësh, fjalish
- Analizë – sintezë
- Punë në dyshe/grup

Burimet e informacionit dhe mjete:

Libri i nxënësit, modele shkronjash individuale, grafiku i shkronjës **Sh, sh** të shtypit, të dorës, letra format, ngjyra, Vjersha " Për një shkronjë" e shkrimtarit T. Gjokutaj.

Lidhja me fushat e tjera:

Lënda: Art pamor

Përshkrimi kontekstual i situatës

- ***Veprimtari praktike***

Hapi 1. Mësuesi ka përgatitur etiketa në të cilat ka shkruar me ngjyra dhe në mënyrë të dukshme ankesat e shkronjave.

U – Pse na shtrembëroni?

E – Më shkruani mirë!

I – Më shumë kujdes me mua!

A – Ku është vendi im?

O – Mos më ngatërroni!

Ë – Mos më harroni!

Të gjitha këto vendosen në një vend të klasës dhe titullohen: ***" Ankesat e shkronjave".***

Nxënësit lexojnë ankesat e shkronjave duke respektuar shenjat e pikësimit.

Hapi 2. Mësuesja lexon vjershën " Për një shkronjë" të shkrimtarit T. Gjokutaj. Thekson rëndësinë që ka shkrimi i saktë i gjuhës shqipe.

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 3. Lihen nxënësit për disa minuta në grupe me nga 3 -4 nxënës , të diskutojnë për gabime të tjera që mund të bëjnë nxënësit gjatë shkrimit dhe të shkruajnë ankesa të tjera të shkronjave sipas

modelit të mësuesit. Vendosen në këndin e klasës " Ankesat e shkronjave". **Hapi 4:** Nxënësve u është dhënë detyrë më parë që të lexojnë pjesën dhe të mësojnë ta ritregojnë atë. Ngre nxënës që ritregojnë pjesën. Këshillohen nxënësit të mos thonë përmendësh fjalitë e tekstit. **Hapi 5:** Lihen të punojnë individualisht për ushtrimet e fundit të faqes **53**. Nxënësit lexojnë dhe fjalitë e formuara. Bëjnë vetë korrigjimin e ushtrimeve. ▪ ***Demonstrim i rezultateve të arritura*** **Hapi 6:** Formo fjali me fjalët: *shi, shkronjë, shkruaj.* Lexojnë fjalitë nga fletoret e veta me shkrim dore.
Vlerësimi i situatës: ***Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:*** ✓ Lexon për të kuptuar përmbajtjen. ✓ Plotëson fjali mungesore. ✓ Shkruan me të kopjuar ose të diktuar. ✓ Lexon fjalë/fjali me shkrim dore.
Detyrë shtëpie: **1.** Kopjo fjalitë e rubrikës "Plotëso".
Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla: 1**	**Klasa:** 1
Tema mësimore: Punim i shkronjës **F, f** faqe **54** të Abetares.		**Situata e të nxënit:** Flamuri ynë	

***Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe**

Nxënësi:

- ***(1)Kompetenca e komunikim dhe të shprehurit:*** Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar.
- ***(3)Kompetenca e të nxënit:*** Parashtron pyetje dhe përgjigje në lidhje me temën.
- ***(5) Kompetenca personale:*** Bashkëpunon me të tjerët pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitetet në klasë, shkollë apo jashtë saj;
- ***(6) Kompetenca qytetare:*** respekton mendimin e anëtarëve të grupit , duke i dëgjuar në mënyrë aktive

***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore**

Nxënësi:

- Shqipton tingullin **F.**
- Gjen dhe thotë fjalë që fillojnë me **F** ose që përmbajnë shkronjën **F** në trup të tyre.
- Flet për situatën e dhënë në libër.
- Shkruan shkronjën **F, f** të shtypit dhe fjalë sipas modelit.
- Lexon fjalë me shkronjën **F, f** globalisht.
- Bën analizë dhe sintezë të fjalëve.

Fjalë kyçe:
Abetarja, shkronja F, f, flamuri, festa, flaka, flutura.

Teknika dhe strategji:

- Këndim
- Vëzhgim
- Diskutim
- Analizë – sintezë e fjalëve, fjalive
- Punë individuale/ Çift

Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, modele shkronjash kolektive dhe individuale, grafiku i shkronjës **F,f** të shtypit, Cd, magnetofon, Flamuri kombëtar në përmasa standarde.

Lidhja me fushat e tjera: Lënda: Muzikë, Matematikë, Edukim për shoqërinë.

Përshkrimi kontekstual i situatës:

- ***Veprimtari paraprake:***

Hapi 1. Këndohet kënga*: " Himni i flamurit"*. Mësuesja ka vendosur në një vend të dukshëm flamurin kombëtar. Gjithashtu dhe nxënësit janë porositur të mbajnë veshur bluza me simbolin kombëtar ose të kenë flamurë të vegjël në tavolina.

Hapi 2. Nxiten nxënësit të vërejnë figurën në libër dhe të formojnë fjali ose një tekst të shkurtër. Diskutohet rreth figurës.

Kë shihni? Çfarë kanë fëmijët në duar? Çfarë dite është? Si ndihen ata? Kur është Festa e flamurit?. Mësuesi/ja shpjegon se Flamuri është simboli ynë kombëtar.

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 3. Shkruhet titulli i mësimit **FESTA E FLAMURIT**. Analizohet dhe veçohet shkronja **F.** Mësuesi/ja prezanton tingullin dhe shkronjën F,f. Bëhet dallimet dhe ngjashmëritë me shkronjat e tjera. Në shqiptim me **V** dhe në paraqitje me **T** dhe **E**.

Hapi 4. Nxiten nxënësit të gjejnë fjalë që fillojnë me **F**, e kanë në trup ose mbarojnë me **F.**

Nxënësit punojnë individualisht për plotësimin shkronjave në fjalët mungesore.
Bëhet leximi dhe ndarja e tyre në rrokje. Ngre disa nxënës që shkruajnë fjalët në tabelë.
Hapi 5. Punohet fjalia. **Fëmijët festojnë festën.** Lexo etiketën e parë, të dytë e kështu me radhë. Nxënësit punojnë me etiketa individuale. Ndahen në rrokje fjalët*: fëmijët, festojnë, festë.*

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 6. Individualisht nxënësit, lexojnë rrokjet dhe i lidhin ato për të formuar fjalë.
Flakë, fjalë, festë, tufë.
Shkruajnë 3 rreshta me shkronjën **F, f** në fletore dhe fjalinë dhe fjalët që formuan.
Disa nxënës shkruajnë fjalët në tabelë.

Vlerësimi i situatës:
Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Shqipton tingullin **F.**
- ✓ Gjen dhe thotë fjalë që fillojnë me **F** ose që përmbajnë shkronjën **F** në trup të tyre.
- ✓ Flet për situatën e dhënë në libër.
- ✓ Shkruan shkronjën **F, f** të shtypit dhe fjalë sipas modelit.
- ✓ Lexon fjalë me shkronjën F, f globalisht.
- ✓ Bën analizë dhe sintezë të fjalëve.

Detyrë shtëpie:

1. Vizato qytetin tënd në Ditën e Flamurit.
2. Shkruaj fjalët e librit dhe ato që formove.
3. Shkruaj 2 fjali për flamurin.

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla: 1**	**Klasa:** 1
Tema mësimore: Punim e shkrim i shkronjës **F, f**, Abetare pune faqe **40**		**Situata e të nxënit:** Flamuri ynë	

***Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe**

Nxënësi:

- ***(3)Kompetenca e të nxënit:*** Ndjek udhëzimet e dhëna për të realizuar një veprim.
- ***(3)Kompetenca e të nxënit:*** Zgjidh në mënyrë të pavarur detyrën e dhënë në njërën nga format e të shprehurit.
- ***(4)Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin:*** Identifikon burimet e nevojshme dhe i përdor në mënyrë të drejtë.

***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore**	**Fjalë kyçe:** *Flamuri, flutura, fruta, flaka*
Nxënësi: - Shkruan shkronjës **F, f** të shtypit sipas modelit. - Shkruan rrokje, fjalë. - Plotëson fjalë mungesore. - Plotëson fjalinë mungesore.	**Teknika dhe strategji:** - Punë me etiketa. - Demonstrim - Punë individuale - Analizë – sintezë fjalësh, fjalish.
Burimet e informacionit dhe mjete: Shkronjat individuale dhe kolektive, fletore pune, etiketa me rrokje, fjalë sipas nivelit. Letra format, lapsa me ngjyra.	**Lidhja me fushat e tjera:** Edukim për shoqërinë, Matematikë , Art pamor.

Përshkrimi kontekstual i situatës

- ***Veprimet paraprake***

Hapi 1. Mësuesi/ja ka përgatitu etiketa për secilin nxënës ose i shkruan në tabelë fjalët.

feston	Fatosi	Flamurit	e	festën

Nxënësit duhet të renditi si duhet etiketa dhe të rishkruajnë fjalinë.

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 2. Mësuesi kërkon nga nxënësit të komentojnë figurat *(flamuri, flutura, fruta, flaka)*. Për secilën bëhet pyetja:

- *Çfarë është ?*
- *A ju pëlqen flutura?*
- *Kur i shohim më shpesh ato?*
- *Cilat fruta ju pëlqejnë më shumë?*
- *Pse duhet të hamë fruta?*
- *Kur ndizet flaka?*

Hapi 3. Punohet sipas kërkesave në fletoren e punës. Modelohet shkronja **F, f.** Shkruhen fjalët me shkronja të vogla të shtypit. Plotësohen fjalët me shkronja mungesore dhe fjalitë me fjalë mungesore. *Flamuri, flota ,flaka, floriri, fermer, nafta, fiku, fama, flamuri, Tefta.*

Fatosi iku në fshat me familjen.

- *Fatma ftoi shokët.*
- *Në fermë ka fruta e perime.*
- *Në fshat shkuan shumë fëmijë.*

Nxënësit diskutojnë me njëri-tjetrin për plotësimin e fletores së punës. Kontrollohen rezultatet e punës.

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 4. Nxënësit lexojnë fjalët dhe fjalitë që krijuan gjatë ushtrimeve në fletoren e punës.
Ndan fjalinë në etiketa.
Nëse mjafton koha, mund të bëhet dhe një diktim i shkurtër me disa nga fjalët e punuara në fletoren e punës.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Shkruan shkronjës **F, f** të shtypit sipas modelit.
- ✓ Shkruan rrokje, fjalë.
- ✓ Plotëson fjalë mungesore.
- ✓ Plotëson fjalinë mungesore.

Detyrë shtëpie:

1. Formo nga fjali me fjalët: *Flamuri, flutura, fruta.*
2. Lexo dhe shkruaj bukur në fletore fjalitë që formove në fletoren e punës.

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla: 1**	**Klasa:** 1
Tema mësimore: Punim e lexim i shkronjës **F, f** faqe **55** të Abetares		**Situata e të nxënit:** Flamuri ynë	

***Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe**

Nxënësi:

- ***(1)Kompetenca e komunikim dhe të shprehurit:*** Ritregon ngjarjen e një teksti të dëgjuar, përmbajtja e të cilit nuk është më shumë se një faqe teksti.
- ***(5)Kompetenca personale :*** Bashkëpunon me të tjerët pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitetet në klasë, shkollë apo jashtë saj.

***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore**

Nxënësi:

- Lexon qartë fjalë, fjali.
- I përgjigjet me fjali të thjeshtë pyetjeve rreth përmbajtjes së vjershës.
- Shpreh emocionet dhe diskuton për tema që i interesojnë.
- Dallon elemente të tekstit si strofa.

Fjalë kyçe: *flamur, festë, vjershë, strofa.*

Teknika dhe strategji:

- Turi i galerisë
- Diskutim
- Lexim zinxhir
- Lojë me etiketa

Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, modele shkronjash individuale, grafiku i shkronjës **F, f** të shtypit, etiketa me vargjet e vjershës, modeli i flamurit, laps i kuq.

Lidhja me fushat e tjera: Edukim për shoqërinë, Arte

Përshkrimi kontekstual i situatës:

- ***Veprimtari paraprake***

Hapi 1: Mësuesi/ja shpërndan modele të gatshme të flamurit me shqiponjë dhe nxënësit e ngjyrosin me ngjyrën e kuqe. Kopjojnë bukur fjalinë

Jam krenar për flamurin tim.

Vendosen punët më të mira në muret e klasës. Ata që nuk arrijnë ta mbarojnë në klasë e përfundojnë në shtëpi.

Veprimet në situatë

Hapi 2: Mësuesi/ja lexon me intonacion vjershën dhe shpjegon fjalët e reja: *krerë, besë, nder, gaz.* Bën dallimin e vjershës nga tregimi. Vjersha ka rimë dhe shkruhet me strofa.

Hapi 3: Lihen nxënësit të lexojnë për disa minuta vjershën. Ngre disa nxënës që e lexojnë atë duke respektuar shenjat e pikësimit dhe intonacionin.

Hapi 4: Diskutim rreth përmbajtjes së vjershës:

- *Si e ka titullin vjersha?*
- *Sa strofa ka?*
- *Për çfarë flitet në strofën e parë?*
- *Po në strofën e dytë?*
- *Cilat janë ngjyrat e flamurit tonë?*
- *Si ndjehesh kur mban flamurin kombëtar në dorë?*

Demonstrim i rezultateve të arritura **Hapi 5:** Mësuesi/ja u shpërndan etiketa, ku janë shkruar vargjet e vjershës veç e veç dhe i udhëzon ata t'i renditin sipas radhës dhe kuptimit. Pas kësaj hapin librat dhe krahasojnë atë që kanë bërë me atë që është në libër.
Vlerësimi i situatës: ***Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:*** ✓ Lexon qartë fjalë, fjali. ✓ I përgjigjet me fjali të thjeshtë pyetjeve rreth përmbajtjes së vjershës. ✓ Shpreh emocionet dhe diskuton për tema që i interesojnë. ✓ Dallon elemente të tekstit si strofa.
Detyrë shtëpie: **1.** Mëso vjershën përmendësh. **2.** Kopjo bukur strofën e fundit.
Refleksione:



Jam krenar për flamurin tim.

_____

_____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1	**Klasa:** 1
Tema mësimore: Ushtrime aplikative për shkrim dore, shkronja **F, f.**		**Situata e të nxënit:** Flamuri ynë	

***Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe**

Nxënësi:

- ***(3)Kompetenca e të nxënit:*** Mbikëqyr në mënyrë të pavarur përparimin e vet në një detyrë duke përdorur detyra të ndryshme.
- ***(3)Kompetenca e të nxënit:*** Ndjek udhëzimet e dhëna në një tekst për të realizuar një veprim / aktivitet/detyrë, që kërkohet;
- ***(4) Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin:*** Identifikon burimet e nevojshme dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre në klasë.

***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore**

Nxënësi:

- Shkruan shkronjat **F, f** të dorës duke u ndihmuar nga modeli.
- Shkruan shkronjat **F, f** me të gjitha elementet duke e lidhur me shkronjat e tjera.
- Shkruan fjalë me të kopjuar duke përdorur shkronjën **F, f** në fillim, në trup të fjalës
- Lexon fjalë me shkrim dore.

Fjalë kyçe:
Shkronjë e madhe, shkronjë e vogël, diktim,

Teknika dhe strategji:

- Lojë
- Demonstrim
- Punë individuale
- Punë në çifte/punë në dyshe
- Lexim individual

Burimet e informacionit dhe mjete: Fletore e punës, fletore shkrimi , modele shkronjash kolektive dhe individuale, grafiku i shkronjës **F,f** të shtypit dhe të dorës.

Lidhja me fushat e tjera:
Arte

Përshkrimi kontekstual i situatës

- ***Veprimtari paraprake***

Hapi 1. Mësuesi/ ja nxjerr para klasës disa foto si :*flutura, flamuri, karafili, fletore* dhe nxënësit shkruajnë në fletore ose fletë pa folur, në formën e vetëdiktimit ose përgatit fisha të gatshme me foto për secilin nxënës. Lexojnë fjalët që kanë shkruar.

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 2. Shpjegon grafikun e shkronjës **F, f** të dorës. Shpjegohen elementet përbërës të saj. Bëhet dallimi me shkronjën **F, f** të shtypit.

I udhëzon nxënësit që t'i shkruajnë shkronjat në fletë ta bardha me ngjyra. Ngre nxënës në tabelë që shkruajnë shkronjën dhe lidhjen e saj me shkronjat e tjera në fjalë.

Hapi 3. Më pas nxënësit punojnë në fletoren e punës sipas modelit. Nxënësit lexojnë fjalët dhe fjalinë që shkruan me shkrim dore.

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 4. Diktim me shkronja dore.

Diktim me shkronja dore.

fa, fe, fi, fë, fo, fu, fjalë, fle, fjeta, fest, Fier,

Festa e Flamurit është festa ime.

Nëse mjafton koha, nxënësit lexojnë rrokjet, fjalët dhe fjalinë me shkrim dore.

Vlerësimi i situatës: ***Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:*** ✓ Shkruan shkronjat **F, f** të dorës duke u ndihmuar nga modeli. ✓ Shkruan shkronjat **F, f** me të gjitha elementet duke e lidhur me shkronjat e tjera. ✓ Shkruan fjalë me të kopjuar duke përdorur shkronjën **F, f** në fillim, në trup të fjalës ✓ Lexon fjalë me shkrim dore.
Detyrë shtëpie: • Shkruaj 3 rreshta me shkronjën **F, f** të dorës. • Shkruaj 10 fjalë me shkronjën **F**. • Formo fjali me fjalët*: fletore, flutur, karafili, telefoni.*
Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1	**Klasa:** 1
Tema mësimore: Punim i faqes **54 -55** të Abetares. ***Flamuri***		**Situata e të nxënit:** Flamuri ynë	

***Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe**

Nxënësi:

- ✓ ***(1)Kompetenca e komunikim dhe të shprehurit:*** Shpreh me gojë për 3-5 minuta para moshatarëve dhe të tjerëve përjetimet dhe emocionet që e kanë gjatë dëgjimit të një tregimi apo përralle, shikimit të një vallëzimi; dëgjimit të një kënge apo melodie.
- ✓ ***(3)Kompetenca e të nxënit:*** Parashtron pyetje dhe përgjigjet në pyetjet për temën në njërën nga format e të shprehurit.
- ➢ ***(4) Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin***: Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) Dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë,

***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore**

Nxënësi:

- Lexon për të kuptuar përmbajtjen.
- Bën analizë – sintezë të fjalëve, fjalive.
- Shkruan me të kopjuar ose të diktuar.
- Lexon fjalë/fjali me shkrim dore.

Fjalë kyçe:

Flaka, filmi, foka, floku, fleta.

Teknika dhe strategji:

- ❖ Konkurs
- ❖ Lexim fjalësh, fjalish
- ❖ Analizë – sintezë
- ❖ Punë në dyshe/ grup

Burimet e informacionit dhe mjete:

Libri i nxënësit, modele shkronjash individuale, grafiku i shkronjës **F, f** të shtypit, të dorës, letra format, ngjyra.

Lidhja me fushat e tjera:

Lënda: Art pamor

Përshkrimi kontekstual i situatës

- ***Veprimtari praktike***

Hapi 1. Konkurs recitimi për vjershën "Flamuri". Nxënësit recitojnë dhe të tjerët do të votojnë (shkruajnë në një fletë emrin e shokut apo shoqes që ka recituar më mirë).

Në fund mblidhen votat dhe zgjidhen nxënësit që recituan më mirë.

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 2. Nxënësit lidhin rrokjet dhe formojnë fjalët në krahët e fluturës. Lexohen nga disa nxënës fjalët e fluturës.

Më pas në dyshe diskutojnë për lidhjen e etiketave dhe krijimin e fjalive.

Flutura fluturon mbi lule.

Fatmiri fik flakën.

Fitorja feston me Florën

Flora flet bukur.

Nxënësit lexojnë me zë të lartë fjalitë që formuan.

Hapi 3: Individualisht nxënësit ndajnë fjalinë në etiketa dhe e shkruajnë bukur me shkronja dore fjalinë duke respektuar hapësirën midis fjalëve.

Fatma shkoi në festë.

Demonstrim i rezultateve të arritura

Hapi 4: Formo fjali me fjalët: *Flaka, filmi, foka, floku, fleta,* Nxënësit i lexojnë fjalitë me zë të lartë në klasë. Zgjidhen fjalitë më të bukura. Lexojnë fjalitë nga fletoret e veta me shkrim dore.
Vlerësimi i situatës: ***Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:*** ✓ Lexon për të kuptuar përmbajtjen. ✓ Bën analizë – sintezë të fjalëve, fjalive. ✓ Shkruan me të kopjuar ose të diktuar. ✓ Lexon fjalë/fjali me shkrim dore
Detyrë shtëpie: **1.** Vizato flamurin kombëtar. **2.** Me ndihmën e prindërve plotëso fjalitë dhe mëso. *Flamuri shqiptar u ngrit në* _____ *më*_____ . *Flamurin e ngriti* _____ .
Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1	**Klasa:** 1
Tema mësimore: Punim i faqes **56** të Abetares		**Situata e të nxënit:** Lojë me fjalët	

***Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe**

Nxënësi:

- ***(1)Kompetenca e komunikim dhe të shprehurit:*** Lexon me zë një tekst së paku prej gjysmë faqeje të pa lexuar më parë
- ***(3)Kompetenca e të nxënit:*** Ndjek udhëzimet e dhëna në një tekst për të realizuar një veprim/ aktivitet/detyrë, që kërkohet.
- ***(3)Kompetenca e të nxënit:*** Mbikëqyr në mënyrë të pavarur përparimin e vet në një detyrë, aktivitet duke përdorur teknika të ndryshme për gjetjen e gabimeve (si shënim të gabimeve - vështirësive) dhe i korrigjon ato derisa gjen zgjidhjen

***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore**

Nxënësi:

- Gjen dhe thotë fjalë që fillojnë me **B, H, T, S, SH, F** ose që përmbajnë shkronjën **B, H, T, S, SH, F** në trup të tyre.
- Bën analizë dhe sintezë të fjalëve
- Shqipton saktë dhe me intonacionin e theksin e duhur fjalët dhe fjalitë.
- Parashikon rreth përmbajtjes së tekstit duke u mbështetur te titulli, ilustrimet dhe fjalët kyçe të tekstit.
- Rilexon tekstin për ta kuptuar më mirë atë.

Fjalë kyçe:

Fjalë, tren, lojë

Teknika dhe strategji:

- Loja e shkronjave
- Analizë – sintezë e fjalëve, fjalive
- Punë individuale/Çift
- Diskutim me terma paraprakë
- Punë në grupe

Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, modele shkronjash kolektive dhe individuale, grafiku i shkronjave **B, H, T, S, SH, F** të shtypit, fletë me ngjyra.

Lidhja me fushat e tjera: Lënda: Edukim fizik, Matematikë

Përshkrimi kontekstual i situatës:

- ***Veprimtari paraprake:***

Hapi 1. Mësuesi/ ja shkruan në tabelë shkronjat **B, H, T, S, SH, F.**

Nxënësit lexojnë në korr shkronjat e mësuara.

Hapi 2: Lojë me top. Nxënësit vihen në rreth dhe i kalojnë topin njëri- tjetrit duke i thënë njërën nga shkronjat **B, H, T, S, SH, F,** shoku/shoqja që pret topin duhet të thotë një fjalë që fillon me të ose që e përmban njërën nga shkronjat e shënuara në tabelë. Disa prej fjalëve shkruhen në tabelë.

Veprimet në situatë

Hapi 3. Mësuesi/ja nxit nxënësit të emërtojnë figurat dhe të thonë nga një koment të shkurtër për to, duke i ndihmuar me pyetej ndihmëse. P.sh.

- *Të pëlqen të luash me balonë?*
- *Ku jeton balena?*
- *Kur del hëna?*
- *Çfarë loje luajmë me top?*
- *Çfarë tregon harta?*
- *Cilat janë ngjyrat e semaforit?*

○ *Në cilën stinë piqet fiku? Etj.* ***Hapi 4.*** Nxënësit punojnë në mënyrë individuale për shkrimin e fjalëve poshtë figurave. Në çifte kontrollojnë punët e njëri-tjetrin. Lexohen me zë të lartë fjalët. Bëhet ndarja e tyre në rrokje. ***Hapi 5.*** Mësuesi/ ja shkruan në tabelë titullin e tregimit "Treni i fjalëve" dhe nxit nxënësit të japin mendime për përmbajtjen e tekstit pa e lexuar më parë atë. ***Hapi 6.*** Lexon tekstin me intonacion. Nxënësit ndjekin leximin në libër. Lihen nxënësit të lexojnë për disa minuta tekstin, më pas e lexojnë me zë të lartë atë. ***Demonstrim i rezultateve të arritura*** ***Hapi 7.*** Në fletë me ngjyra nxënësit të ndarë në grupe krijojnë tren fjalësh si modeli i librit. Ngjiten në muret e klasës.
Vlerësimi i situatës: ***Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:*** ✓ Gjen dhe thotë fjalë që fillojnë me **B, H, T, S, SH, F** ose që përmbajnë shkronjën **B, H, T, S, SH, F** në trup të tyre. ✓ Bën analizë dhe sintezë të fjalëve ✓ Shqipton saktë dhe me intonacionin e theksin e duhur fjalët dhe fjalitë. ✓ Parashikon rreth përmbajtjes së tekstit duke u mbështetur te titulli, ilustrimet dhe fjalët kyçe të tekstit. ✓ Rilexon tekstin për ta kuptuar më mirë atë.
Detyrë shtëpie: • Lexo bukur dhe rrjedhshëm tekstin. • Kopjo bukur në fletore fjalët që ke shkruar në klasë. • Krijo një tren fjalësh me shkronja të njohura.
Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1	**Klasa:** 1
Tema mësimore: Punim i faqes **41** të Abetares së punës		**Situata e të nxënit:** Lojë me fjalët	

***Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe**

Nxënësi:

- ***(3)Kompetenca e të nxënit:*** Ndjek udhëzimet e dhëna për të realizuar një veprim.
- ***(3)Kompetenca e të nxënit:*** Zgjidh në mënyrë të pavarur detyrën e dhënë në njërën nga format e të shprehurit.
- ***(4)Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin:*** Identifikon burimet e nevojshme dhe i përdor në mënyrë të drejtë.

***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore**	**Fjalë kyçe:** *banane, buka, stop, treni, teta, torta, shpata, shishe, flaka*
Nxënësi: - Shkruan shkronjat **B, H, T, S, SH, F** të shtypit dhe të dorës. - Plotëson fjalë mungesore. - Plotëson fjalinë mungesore. - Lidh rrokjet për të formuar fjalë - Shkruan fjali me shkrim dore.	**Teknika dhe strategji:** - Lojë gjëzë - Punë me etiketa - Punë individuale - Analizë – sintezë fjalësh, fjalish.
Burimet e informacionit dhe mjete: Shkronjat individuale dhe kolektive, fletore pune, etiketa me rrokje, fjalë sipas nivelit. Letra format, lapsa me ngjyra.	**Lidhja me fushat e tjera:** Edukim për shoqërinë, Matematikë , Art pamor.

Përshkrimi kontekstual i situatës

- ***Veprimet paraprake***

Hapi 1. Mësuesi i thotë nxënësve disa gjëegjëza, përgjigjet e të cilave janë fjalë me shkronja të mësuara.

Lluqe – lluqe, papallluqe, Hyn e bardhë , e del e kuqe. *(Buka)*	Ku shkel kuqali, nuk mbin as bari. *(flaka)*	Një copë bukë e ndritshme mbi dhe, Ikën nëpër qiell Fluturon nëpër re. *(hëna)*

Nxënësit përpiqen të gjejnë përgjigjet. Ai/ajo që e gjen, shkruan përgjigjen në tabelë. Nxiten nxënësit të thonë gjëegjëza të tjera.

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 2. Mësuesi kërkon nga nxënësit të komentojnë figurat *(banane, buka, stop, treni, teta, torta, shpata, shishe, flaka)*. Për secilën bëhet pyetja:

- *Çfarë është ?*
- *Kur ndizet flaka?*
- *Ku ecën treni?*
- *Cili numër ndodhet para tetës? Po pas?*
- *A është e shëndetshme banania?*
- *Kush ka luftuar me shpatë?*

Hapi 3. Punohet sipas kërkesave në fletoren e punës. Nxënësit shkruajnë shkronjat e dorës poshtë atyre të

shtypit. Plotësohen fjalët me shkronja mungesore dhe fjalitë me fjalë mungesore. Lidhin rrokjet për të krijuar fjalë. Nxënësit diskutojnë me njëri-tjetrin për plotësimin e fletores së punës. Kontrollohen rezultatet e punës. ▪ ***Demonstrim i rezultateve të arritura*** **Hapi 4.** Nxënësit lexojnë fjalët dhe fjalitë që krijuan gjatë ushtrimeve në fletoren e punës. Ndan fjalinë në etiketa. Nëse mjafton koha, mund të bëhet dhe një diktim i shkurtër me disa nga fjalët e punuara në fletoren e punës.
Vlerësimi i situatës: ***Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:*** ✓ Shkruan shkronjat **B, H, T, S, SH, F** të shtypit dhe të dorës. ✓ Plotëson fjalë mungesore. ✓ Plotëson fjalinë mungesore. ✓ Lidh rrokjet për të formuar fjalë. ✓ Shkruan fjali me shkrim dore.
Detyrë shtëpie: **1.** Formo nga fjali me fjalët: *banane, buka, treni, teta, torta, shishe.* **2.** Lexo dhe shkruaj bukur në fletore fjalitë që formove në fletoren e punës.
Refleksione:

<table>
<tr><td>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla: 1</td><td>Klasa: 1</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore: Punim i faqes 57 të Abetares</td><td colspan="2">Situata e të nxënit:
Lojë me fjalët</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe
Nxënësi:
➢ (1) Kompetenca e komunikim dhe të shprehurit: Lexon me zë një tekst së paku prej gjysmë faqeje të pa lexuar më parë.
➢ (4) Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin : Gjen të përbashkëtat dhe ndryshimet ndërmjet aktiviteteve, që organizohen në shkollë me ato në shtëpi dhe i përshkruan në mënyrë individuale përmes njërës nga format e të shprehurit duke i diskutuar në grup.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore
Nxënësi:
- Shqipton saktë dhe me intonacionin e theksin e duhur fjalët dhe fjalitë.
- Përqendrohet në çështjet kryesore, kur rrëfen një ngjarje ose një përvojë të tijën para shokëve dhe shoqeve, mësuesve.
- Shpreh emocionet dhe diskuton për tema që i interesojnë.
- Shkruan tekste të shkurtra si: një urim, një kartolinë, një letër drejtuar një shoku duke përdorur një model të thjeshtë.</td><td colspan="2">Fjalë kyçe: flamur, festë, vjershë, strofa.

Teknika dhe strategji:
❖ Treni i fjalëve
❖ Punë në dyshe
❖ Stuhi mendimesh
❖ Diskutim
❖ Shkrim i lirë</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, modele shkronjash individuale dhe kolektive të shtypit dhe të dorës, modele letrash të shkruara, të zmadhuara.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera:
Edukim për shoqërinë, Arte</td></tr>
<tr><td colspan="4">Përshkrimi kontekstual i situatës:
▪ Veprimtari paraprake
Hapi 1: Kujtohet teksti “Treni i fjalëve” diskutohet për të.
o Pse ishin të trishtuara fjalët?
o Me cilën fjalë u bashkua fjala lapsi?
o Ku i gjeti libri fjalët e reja?
Hapi 2: Nxënësit në dyshe plotësojnë trenin e fjalëve që është në libër. Lexojnë dhe diskutojnë për fjalët që krijuan. Disa nxënës shkruajnë fjalët në tabelë.
Veprimet në situatë
Hapi 3 : Mësuesi/ja paraqet një letër të shkruar para klasës dhe nxit nxënësit me pyetje:
o Çfarë është kjo?
o Kush e ka shkruar?
o Pse e ka shkruar?
o Po ju, keni shkrua ndonjë letër?
o Kujt ia keni dërguar?
o Keni marrë ndonjë letër?
o Kush ua ka dërguar?
Hapi 4: Mësuesi shpjegon që letra është një mjet komunikimi, ka disa pjesë:</td></tr>
</table>

- *Kujt i drejtohet.*
- *Hyrja.*
- *Zhvillimi*
- *Mbyllja*
- *Përshëndetje nga dërguesi*

Hapi 5: Lihen nxënësit të lexojnë për disa minuta letra e shkruar në libër. Nxënësit individualisht duhet të plotësojnë fjalët që mungojnë. Ngre disa nxënës që e lexojnë atë duke respektuar shenjat e pikësimit dhe intonacionin.

Demonstrim i rezultateve të arritura

Hapi 6: Nxënësit shkruajnë një letër sipas modelit për person të dashur. Nëse koha nuk mjafton, detyra vazhdon në shtëpi.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:.

- ✓ Shqipton saktë dhe me intonacionin e theksin e duhur fjalët dhe fjalitë.
- ✓ Përqendrohet në çështjet kryesore, kur rrëfen një ngjarje ose një përvojë të tijën para shokëve dhe shoqeve, mësuesve.
- ✓ Shpreh emocionet dhe diskuton për tema që i interesojnë.
- ✓ Shkruan tekste të shkurtra si: një urim, një kartolinë, një letër drejtuar një shoku duke përdorur një model të thjeshtë.

Detyrë shtëpie:

1. Lexo bukur letrat.
2. Shkruaj një letër për një person të dashur që e ke larg.

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1	**Klasa:** 1
Tema mësimore: Veprimtari shkrimi (diktim)		**Situata e të nxënit:** Lojë me fjalët	

***Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe**

Nxënësi:

- ***(3)Kompetenca e të nxënit:*** Ndjek udhëzimet e dhëna në një tekst për të realizuar një veprim / aktivitet/detyrë, që kërkohet.
- ***(3)Kompetenca e të nxënit:*** Mbikëqyr në mënyrë të pavarur përparimin e vet në një detyrë, aktivitet duke përdorur teknika të ndryshme për gjetjen e gabimeve.
- ***(4) Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin:*** Identifikon burimet e nevojshme dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre në klasë.

***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore**

Nxënësi:

- Shkruan shkronjat **B, H, T, S, SH, F** me të gjitha elementet duke e lidhur me shkronjat e tjera.
- Shkruan fjalë me të kopjuar duke përdorur shkronjën **B, H, T, S, SH, F** në fillim, në trup të fjalës.
- Lexon fjalë, fjali me shkrim dore.

Fjalë kyçe:
Shkronjë e madhe, shkronjë e vogël, rrokje, diktim,

Teknika dhe strategji:

- Veprimtari bukurshkrimi
- Demonstrim
- Punë individuale
- Punë në çifte/punë në dyshe
- Lexim individual

Burimet e informacionit dhe mjete: Fletore e punës, fletore shkrimi, modele shkronjash kolektive dhe individuale, grafiku i shkronjave **B, H, T, S, SH, F** të shtypit dhe të dorës.

Lidhja me fushat e tjera:
Arte

Përshkrimi kontekstual i situatës

- ***Veprimtari paraprake***

Hapi 1. Përsëritje 6 shkronjave të treta **B, H, T, S, SH, F** të shtypit dhe të dorës. Nxënësit shkruajnë në fletore bukur grafikun e 6 shkronjave të mësuara të shtypit dhe të dorës. Mësuesi këshillon nxënësit të ruajnë hapësirën midis shkronjave, të mbajnë trupin drejt gjatë shkrimit, të shkruajnë pastër dhe bukur. Punët më të mira vendosen në një vend të dukshëm.

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 2. Mësuesi shkruan në tabelë një tekst me shkronja shtypi dhe nxënësit duhet ta kopjojnë me shkronja dore, ose përgatit fisha për secilin nxënës ku ka shkruar fjalë, fjali, tekst dhe i shpërndan sipas niveleve. Nxënësit punojnë të pavarur. Lihen nxënësit të lexojnë fjalët, fjalitë apo tekstin që ka shkruar.

Hapi 3. Përsëri duke kopjuar nga tabela ose në fletë ushtrimesh të përgatitura, mund të punohen këto ushtrime.

1. ***Ndaj fjalët në rrokje.***

harta = _____ + ____ , banane = _____ + ____ + ____ , krahu = ____+____ , shkronjat = ____ +____

2. Plotëso:

Fla ___ ___ ri, s___ ___ p , __ __ __tura, shpor___ __ , sema ___ ___ ri, lap___ ___,

3. ***Plotëso fjalinë.*** *(hëna, flamuri, semaforin)*

_____ duket natën.
_____ ynë është kuq e zi.
Duhet të respektosh _____.

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 5. Diktim me shkronja dore.
Diktim me shkronja dore.
Bora mbulon tokën.
Artani ka kompjuter.
Punën e sotme mos e lër për nesër.
Nëse mjafton koha, nxënësit lexojnë rrokjet, fjalët dhe fjalinë me shkrim dore.

Vlerësimi i situatës:
Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Shkruan shkronjat **B, H, T, S, SH, F** me të gjitha elementet duke e lidhur me shkronjat e tjera
- ✓ Shkruan fjalë me të kopjuar duke përdorur shkronjën **B, H, T, S, SH, F** në fillim, në trup të fjalës
- ✓ Lexon fjalë, fjali me shkrim dore.

Detyrë shtëpie:

1. Shkruaj 3 rreshta me shkronjat **B, H, T, S, SH, F** të dorës.
2. Shkruaj 10 fjalë me shkronjat **B, H, T, S, SH, F**.
3. Formo fjali me fjalët*: semafori, bora, flamuri, hëna, shkronjat.*

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1	**Klasa:** 1
Tema mësimore: Përforcim i shkronjave të mësuara		**Situata e të nxënit:** Lojë me fjalët	

***Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe**

Nxënësi:

- ✓ ***(1)Kompetenca e komunikim dhe të shprehurit:*** Lexon me zë një tekst së paku prej gjysmë faqeje të pa lexuar më parë
- ➢ ***(3)Kompetenca e të nxënit:*** Ndjek udhëzimet e dhëna në një tekst për të realizuar një veprim / aktivitet/detyrë, që kërkohet
- ➢ ***(4) Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin***: Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) Dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë,

***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore**

Nxënësi:

- Lexon për të kuptuar përmbajtjen.
- Bën analizë – sintezë të fjalëve, fjalive.
- Shkruan me të kopjuar ose të diktuar.
- Lexon fjalë / fjali me shkrim dore.
- Përgjigjet pyetjeve rreth përmbajtjes me fjali të plotë.

Fjalë kyçe:
Shkronjë e madhe, shkronjë e vogël, rrokje,stofë.

Teknika dhe strategji:

- ❖ Lojë me fjalët.
- ❖ Lexim fjalësh, fjalish
- ❖ Analizë – sintezë
- ❖ Punë në dyshe/ grup

Burimet e informacionit dhe mjete:
Libri i nxënësit, modele shkronjash individuale, grafiku i shkronjës **Sh ,sh** të shtypit, të dorës, letra format, ngjyra.

Lidhja me fushat e tjera:
Lënda: Art pamor

Përshkrimi kontekstual i situatës

- ***Veprimtari praktike***

Hapi 1. Zhvillohet loja ”treni i fjalëve”:



- ***Veprimet në situatë***

Hapi 2. Mësuesi/ja përgatit etiketa me tekste të thjeshta për fëmijë ose vjershën e mëposhtme.

Abetare Një libër kam. Emrin a e di? Mik me të jam, Në shkollë dhe në shtëpi.	Fletë pas flete, oh sa më mëson, quhet ABETARE, libri i gjuhës sonë. *Autori: Dhimitër Gjoka*
Me të unë flas, njësoj si Ai, me mësuesen në klasë, me prindërit e mi.	

I lë nxënësit të lexojnë në mënyrë të pavarur.

Hapi 3: Sipas nivelit të klasës, mësuesi/ja shpërndan detyra të ndryshme, p.sh.

1. *Lexo dhe kopjo me shkronja dore strofën e parë.*
2. *Lexo dhe kopjo me shkronja dore vjershën.*
3. *Përgjigju me fjali të plotë pyetjeve rreth përmbajtjes së vjershës.*
   - *Si e ka titullin vjersha?*
   - *Çfarë mësoni nga libri i Abetares?*
   - *Po ju e doni shumë abetaren?*

Demonstrim i rezultateve të arritura

Hapi 4: Nxënësit përgjigjen sipas detyrave që ka shpërndarë mësuesi/ja.

Grupi 1: Lexojnë aq sa kanë arritur të mësojnë me shkrim shtypi ose dore.

Grupi 2: Lexojnë të gjithë vjershën ose strofa të shkëputura të saj.

Grupi 3: I përgjigjen pyetjeve rreth përmbajtjes së vjershës.

Mund të ketë nxënës të përparuar që e mësojnë përmendësh që në klasë. Stimulohen këta nxënës dhe e recitojnë para klasës.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Lexon për të kuptuar përmbajtjen.
- ✓ Bën analizë – sintezë të fjalëve, fjalive.
- ✓ Shkruan me të kopjuar ose të diktuar.
- ✓ Lexon fjalë/fjali me shkrim dore.
- ✓ Përgjigjet pyetjeve rreth përmbajtjes me fjali të plotë.

Detyrë shtëpie:

1. Vizato një tren fjalësh duke nisur nga fjala *topi.*
2. Shkruaj bukur shkronjat e mëdha dhe të vogla të dorës: **B, H, T, S, SH, F.**
3. Mëso strofën e parë/vjershën përmendësh.

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1	**Klasa:** 1
Tema mësimore: Punim i shkronjës Rr, rr faqe 58 të Abetares		**Situata e të nxënit:** Frutat	

***Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe**

Nxënësi:

- ***Kompetenca e komunikim dhe të shprehurit:*** Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar.
- ***Kompetenca e të nxënit:*** Parashtron pyetje dhe përgjigje në lidhje me temën.
- ***Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin:*** Gjen të përbashkëtat dhe ndryshimet ndërmjet aktiviteteve që bën në shkollë me ato në shtëpi.

Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore** Nxënësi: - Shqipton tingullin **Rr.** - Gjen dhe thotë fjalë që fillojnë me ***Rr ose që përmbajnë shkronjën **Rr** në trup të tyre. - Lexon fjalë globalisht. - Plotëson sipas figurës fjalë mungesore. - Formon fjali/tekst sipas figurës kryesore të faqes.	**Fjalë kyçe:** *Rrushi, burri, rrepa, rrota* **Teknika dhe strategji:** ❖ Stuhi mendimesh ❖ Marrëdhënie pyetje-përgjigje ❖ Vëzhgim ❖ Demonstrim ❖ Punë individuale/ Çift
Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, modele shkronjash individuale, grafiku i shkronjës **Rr,rr** të shtypit, foto me pamje të frutave të ndryshme, fruta të ndryshme të freskëta.	**Lidhja me fushat e tjera:** Lënda: Matematikë, **arte**

Përshkrimi kontekstual i situatës:

- ***Veprimtari paraprake:***

Hapi 1. Shkruan në tabelë fjalën *fruta* dhe nxit nxënësit të flasin për to.

- *Cilat fruta njihni ju?*
- *Cilat pëlqeni më shumë?*
- *Pse duhet të hani fruta?*
- *Si janë frutat?*

Hapi 2. Mësuesi/ja bën prezantimin e situatës së të nxënit dhe shkruan në tabelë titullin e mësimit **"Rrushi u poq".**

I bën pyetje nxënësve:

- *Kur piqet rrushi?*
- *Fare ngjyre ka rrushi?*
- *Si është nga pamja?*

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 3. Nxiten nxënësit të vërejnë figurën në libër dhe të formojnë fjali ose një tekst të shkurtër. Udhëzohen nxënësit të përdorin fantazinë ose të përshkruajnë një përvojë jetësore.

Mësuesi/ja ndihmon nxënësit me pyetje ndihmëse:

- *Në cilën stinë jemi?*

- *Si është moti?*
- *Çfarë po bën Rita?*
- *Ku ndodhen ata?*

Hapi 4. Demonstron para klasës grafikun e shkronjës së vogël dhe të madhe të shtypit. Nxit nxënësit të bëjnë ngjashmëritë dhe dallimet me shkronjat e tjera dhe objekte të tjera rrethanore. Thekson shqiptimin e saj dhe nxit nxënësit që kanë vështirësi në shqiptim ta përsërisin atë në fillim dhe mes të fjalës.

- Nxiten nxënësit të gjejnë fjalë që fillojnë me **Rr**, e kanë në trup ose mbarojnë me **Rr**.

Plotësohet tabela kolektivisht

rr	**rr**	**rr**
rrushi	burrë	korr .....

Hapi 5. Nxënësit punojnë individualisht për plotësimin e shkronjave në fjalët mungesore.
Bëhet leximi dhe ndarja e tyre në rrokje. Ngre disa nxënës që shkruajnë fjalët në tabelë.
Mësuesi/ja shkruan fjalinë kryesore në tabelë.
Nxënësit ndajnë në etiketa dhe fjalët në rrokje.

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 6.
Individualisht nxënësit plotësojnë fjalët me rrokje mungesore si dhe lidhin rrokjet për të krijuar fjalë.
Nëse mjafton koha fjalët shkruhen në libër ose detyra përfundon në shtëpi.
Lexohen nga nxënësit në zinxhir fjalitë e formuara.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Shqipton tingullin **Rr.**
- ✓ Gjen dhe thotë fjalë që fillojnë me ***Rr*** ose që përmbajnë shkronjën **Rr** në trup të tyre.
- ✓ Lexon fjalë globalisht.
- ✓ Plotëson sipas figurës fjalë mungesore.
- ✓ Formon fjali/tekst sipas figurës kryesore të faqes.

Detyrë shtëpie:

1. Lexo dhe shkruaj fjalët që formove nga bashkimi i rrokjeve.
2. Shkruaj 10 fjalë me shkronjën **Rr**.

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1	**Klasa:** 1
Tema mësimore: Punim e shkrim i shkronjës **Rr, rr,** Abetare pune faqe **42**		**Situata e të nxënit:** Frutat	

***Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe**

Nxënësi:

- ***Kompetenca e të nxënit:*** Ndjek udhëzimet e dhëna për të realizuar një veprim
- ***Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin:*** Identifikon burimet e nevojshme dhe i përdor në mënyrë të drejtë.

***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore**

Nxënësi:

- Shkruan shkronjës **Rr, rr** të shtypit sipas modeli.
- Shkruan rrokje, fjalë.
- Plotëson fjalë dhe fjali mungesore.

Fjalë kyçe:
Rrushi, rrethi, rrota.

Teknika dhe strategji:

- Punë me grupe
- Demonstrim
- Punë individuale
- Analizë – sintezë fjalësh, fjalish.

Burimet e informacionit dhe mjete: Shkronjat individuale dhe kolektive, fletore pune, etiketa me rrokje, fjalë sipas nivelit.

Lidhja me fushat e tjera:
Edukim, për shoqërinë

Përshkrimi kontekstual i situatës

- ***Veprimet paraprake***

Hapi 1. Klasa është e ndarë në grupe me nivele të ndryshme. Mësuesja ka përgatitur etiketa me fjalë dhe fjali rreth situatës, që të kenë shkronjën **rr**. Ia shpërndan nxënësve sipas nivelit. Nxënësit lexojnë me zë të lartë. Nxiten nxënësit të korrigjojnë njëri-tjetrin.

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 2. Mësuesi/ ja paraqet grafikun e shkronjës **Rr, rr.** Nxit të thonë ndryshimet dhe ngjashmëritë me shkronjat e tjera.

Hapi 3. Ngre nxënës në tabelë që shkruajnë disa nga rrokjet, fjalët dhe fjalitë e etiketa që u shpërndanë në pjesën ë parë të orës.

Hapi 4. Punohet sipas kërkesave në fletoren e punës. Modelohet shkronja **Rr, rr**, shkruhen fjalët me shkronja të vogla të shtypit.

Plotësojnë shkronjën që mungon te fjalët mungesore sipas figurave përkatëse.

Plotësojnë fjalët me rrokjet që mungojnë dhe fjalitë me fjalët që mungojnë.

Mësuesi/ja shpjegon fjalë që nxënësit i kanë të vështira p.sh. *rrapi, karro, fermeri, korr.*

Bëhet kontrolli individual i fletores.

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 5. Nxënësit lexojnë fjalët dhe fjalitë që krijuan gjatë ushtrimeve në fletoren e punës.

Nxënësit më të përparuar mund të formojnë disa fjali në fletore më fjalët e fjalorit.*(rrufe, rroba, rrota)*

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Shkruan shkronjës **Rr, rr** të shtypit sipas modeli.
- ✓ Shkruan rrokje, fjalë.

✓ Plotëson fjalë dhe fjali mungesore.
Detyrë shtëpie: **1.** Formo nga fjali me fjalët: *rrushi, rrethi, rrota.* **2.** Kopjo bukur në fletore 4 fjalitë e fundit. - *Fermeri korr barin.* - *Ai punon me karro.* - *Blerta ha kokrra rrushi.* - *Pema ka rrush.*
Refleksione:

<table>
<tr><td>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla: 1</td><td>Klasa: 1</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore: Punim e lexim i shkronjës Rr, rr faqe 59 të Abetares.</td><td colspan="2">Situata e të nxënit:
Frutat</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe
Nxënësi:
➢ Kompetenca e komunikim dhe të shprehurit: Lexon me zë një tekst së paku prej gjysmë faqeje të pa lexuar më parë
➢ Kompetenca e komunikim dhe të shprehurit: Identifikon personazhet e një tregimi.
➢ Kompetenca e të nxënit: Parashtron pyetje dhe përgjigjet në pyetjet për temën /problemin/detyrën e dhënë në njërën nga format e të shprehurit.</td></tr>
<tr><td colspan="2" rowspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore
Nxënësi:
➕ Lexon fjalë, fjali, tekst.
➕ Pyet, përgjigjet, shpreh mendimet, ndjenjat dhe emocionet e tij, si dhe diskuton në grupe të vogla për tema që i interesojnë
➕ Rilexon tekstin për të kuptuar përmbajtjen e tij.
➕ Parashikon rreth përmbajtjes së tekstit duke u mbështetur te titulli, ilustrimet dhe fjalët kyçe të tekstit.</td><td colspan="2">Fjalë kyçe: tregim, titull, pyetje, përgjigje, fëmijë me aftësi të kufizuar, etj.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Teknika dhe strategji :
❖ Parashikim me terma paraprakë
❖ Marrëdhënie pyetje-përgjigje
❖ Lexim zinxhir
❖ Analizë- sintezë e fjalës</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, modele shkronjash individuale, grafiku i shkronjës Rr,rr të shtypit, foto me pamje nga vjelja e rrushit, pamje nga vreshtat.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë, Edukim për shoqërinë</td></tr>
<tr><td colspan="4">Përshkrimi kontekstual i situatës:
▪ Veprimtari paraprake
Hapi 1: Shkruaj në tabelë titullin e tregimit dhe nxit nxënësit të formojnë fjali ose një tekst të shkurtër sipas fantazisë ose një filmi apo përvojës personale. (Këshillohen të mos përsëritin tregimin e librit nëse e kanë lexuar më parë).
Nxënësit krijojnë një tregim të shkurtër. Mësuesi/ja ndihmon me pyetje ndihmëse për nxënësit që kanë vështirësi.
▪ Veprimet në situatë
Hapi 2: Mësuesi/ja lexon me intonacion 2 herë tregimin.
Hapen librat. Nxit nxënësit të përshkruajnë figurën. Bëhet leximi në korr i tregimit disa herë.
Shpjegon rastin e përdorimit të karrocës dhe shpjegon me fjalë të thjeshta se çfarë janë fëmijët me aftësi të kufizuar. Nxit nxënësit të diskutojnë se duhet të ndihmojmë fëmijët që janë me aftësi të kufizuar dhe kanë nevojë për mbështetje.
Hapi 3: Më pas lihen nxënësit të lexojnë në heshtje për disa minuta tregimin. Në varësi të numrit të nxënësve në klasë mësuesja bën leximin e tregimit në zinxhir me nga një ose më shumë fjali.
Mund të kërkohet nga nxënësit edhe të lexojnë fjalinë e parë, të dytë e kështu me radhë ose me rend të ngatërruar. Nxënësit që paraqesin vështirësi mund t’i pyesë në fjalë të veçanta të thjeshta.</td></tr>
</table>

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 4: Diskutim rreth përmbajtjes.

- *Si e ka titullin tregimi?*
- *Si quhen fëmijët që marrin pjesë?*
- *Ku po bisedonin?*
- *Çfarë bëri mami i Reas?*
- *Çfarë mësoni nga tregimi?*

Hapi 5: Nxënësit në mënyrë individuale gjejnë përgjigjen e saktë për dy pyetjet që janë në libër. Diskutojnë në dyshe më shokun e bankës ose në grup për përgjigjet e dhëna.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Lexon fjalë, fjali, tekst.
- ✓ Pyet, përgjigjet, shpreh mendimet, ndjenjat dhe emocionet e tij, si dhe diskuton në grupe të vogla për tema që i interesojnë.
- ✓ Rilexon tekstin për të kuptuar përmbajtjen e tij.
- ✓ Parashikon rreth përmbajtjes së tekstit duke u mbështetur te titulli, ilustrimet dhe fjalët kyçe të tekstit.

Detyrë shtëpie:

1. Lexo tregimin.
2. Kopjo 3 fjali që të pëlqejnë më shumë nga tregimi.

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1	**Klasa:** 1
Tema mësimore: Ushtrime aplikative për shkrim dore, shkronja **Rr, rr.**		**Situata e të nxënit:** Frutat	

***Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe**

Nxënësi:

- ***Kompetenca e të nxënit:*** Mbikëqyr në mënyrë të pavarur përparimin e vet në një detyrë duke përdorur detyra të ndryshme. Korrigjon gabimet.
- ***Kompetenca qytetare:*** Bashkëpunon në grup dhe respekton rregullat e grupit.

***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore**

Nxënësi:

- Shkruan shkronjat **Rr, rr** të dorës duke u ndihmuar nga modeli.
- Shkruan shkronjat **Rr, rr** me të gjitha elementet duke e lidhur me shkronjat e tjera.
- Shkruan fjalë me të kopjuar ose diktuar duke përdorur shkronjën **Rr ,rr** në fillim, në trup të fjalës.
- Respekton hapësirën mes shkronjave, fjalëve dhe fjalive.

Fjalë kyçe:

Kokrra rrushi, arra, rrepa, karrocë, oborr, etj.

Teknika dhe strategji:

- Vetëdiktim
- Lexim në korr
- Demonstrim
- Punë individuale
- Punë në çifte/punë në dyshe
- Lexim individual

Burimet e informacionit dhe mjete: Fletore e punës, fletore shkrimi, modele shkronjash individuale, grafiku i shkronjës **Rr, rr** të shtypit dhe të dorës, pamje me foto të frutave të ndryshme ose të vjeljes së rrushit.

Lidhja me fushat e tjera: Arte

Përshkrimi kontekstual i situatës

- ***Veprimtari paraprake***

Hapi 1. Mësuesja nxjerr para klasës disa foto me pamje të vjeljes së rrushit ose të frutave të ndryshme. Nxënësit shkruajnë në fletore ose fletë pa folur, në formën e vetëdiktimit ose përgatit fisha të gatshme për secilin nxënës. Lexojnë fjalët që kanë shkruar.

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 2. Përsëritje e shkronjave të mësuara të dorës. Lexim në korr.

Përsëriten shkronjat **Rr, rr** të shtypit dhe grafiku i tyre.

Nxiten nxënësit të thonë fjalë që fillojnë me **Rr,** shkruajnë disa prej tyre.

Hapi 3. Shpjegoj grafikun e shkronjës **Rr, rr** të dorës dhe e shoqëruar me lëvizjen në ajër të nxënësve. Shpjegohen elementet përbërës të saj.

Bëhet dallimi me shkronjën **rr** të shtypit, si dhe i **rr** së madhe dhe të vogël të dorës.

Ngre nxënës në tabelë që shkruajnë shkronjën dhe lidhjen e saj me shkronjat e tjera në fjalë.

Hapi 4. Më pas nxënësit punojnë në fletoren e punës sipas modelit. Nxënësit lexojnë fjalët dhe fjalinë që shkruan me shkrim dore.

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 5. Diktim me shkronja dore.

Rra,rri, rrre, rru, rr Kokrra rrushi, arra, rrepa, karrocë, oborr.

Rita mbushi shportën me rrush e arra.

Nxënësit lexojnë fjalët që shkruan me shkronja dore.

Vlerësimi i situatës: ***Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:*** ✓ Shkruan shkronjat **Rr, rr** të dorës duke u ndihmuar nga modeli. ✓ Shkruan shkronjat **Rr, rr** me të gjitha elementet duke e lidhur me shkronjat e tjera. ✓ Shkruan fjalë me të kopjuar ose diktuar duke përdorur shkronjën **Rr ,rr** në fillim, në trup të fjalës. ✓ Respekton hapësirën mes shkronjave, fjalëve dhe fjalive.
Detyrë shtëpie: **1.** Shkruaj nga 3 rreshta me shkronja/rrokje/fjalë ose fjali me shkronjën **Rr, rr.**
Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1	**Klasa:** 1
Tema mësimore: Punim i faqes **58-59** të Abetares. ***Shporta me rrush***		**Situata e të nxënit:** Frutat	

***Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe**

Nxënësi:

- ***Kompetenca e komunikim dhe të shprehurit :*** Shpreh mesazhin e një teksti të thjeshtë, nëpërmjet njërës nga format shprehëse: të folurit, shkrimit.
- ***Kompetenca e të nxënit:*** Parashtron pyetje dhe përgjigjet në pyetjet për temën në njërën nga format e të shprehurit.
- ***Kompetenca e të nxënit:*** Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes.
- ***Kompetenca qytetare:*** Diskuton dhe bashkëpunon me anëtarët e grupit.

***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore**

Nxënësi:

- Pyet, përgjigjet, shpreh mendimet, ndjenjat dhe emocionet e tij, si dhe diskuton në grupe të vogla për tema që i interesojnë.
- Tregon që e ka kuptuar tekstin e lexuar: *duke ritreguar shkurtimisht dhe me fjalë të thjeshta brendinë; duke përmendur çështjet kryesore; duke dhënë shembuj ose ilustrime nga teksti.*
- Qarkon rrokjet me shkronjën **rr** në fjalë të ndryshme.

Fjalë kyçe:

Rrushi, rrumbullak, kokrra, karrocë, rrota, etj.

Teknika dhe strategji:

- Marrëdhënie pyetje – përgjigje
- Punë individuale
- Lexim fjalësh, fjalish
- Analizë – sintezë
- Punë në dyshe/grup

Burimet e informacionit dhe mjete:

Libri i nxënësit, modele shkronjash individuale, grafiku i shkronjës **Rr, rr** të shtypit.

Lidhja me fushat e tjera:

Lënda: Matematikë, Edukim për shoqërinë, Art pamor

Përshkrimi kontekstual i situatës

- ***Veprimtari praktike***

Hapi 1. Diskutim rreth përmbajtjes se tregimit: "Shporta me rrush".

- *Kë takoi Rea dhe Arbri?*
- *Pse Teuta ishte ulur në karrocë?*
- *Kush e ndihmonte Teutën?*
- *Kush e solli shportën me kokrra rrushi?*

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 2. Përsëritje në korr e shkronjave të shtypit dhe të dorës, të mësuara deri tani.

Nxënësit tregojnë se sa shkronja **rr** kanë gjetur në tekstin e mësipërme.

Për nxënës më të përparuar mund t'u kërkohet të lexojnë fjalë ose fjali.

Hapi 3. Punohet me pjesën e fundit të faqes **58** dhe **59.**

Rilexojnë fjalinë: ***Rita mori shportën me rrush.*** Bëhet ndarja e fjalëve në etiketa.

U kërkohet nxënësve të gjejnë fjalën e parë, të dytë e kështu me radhë si dhe në rend të ngatërruar.

Hapi 4. Lihen të punojnë individualisht për ushtrimet e fundit të faqes **59.** Nxënësit duhet të qarkojnë rrokjen që përmban shkronjën **rr.** Mund të aplikohet dhe puna në dyshe ose grup sipas

përbërjes së klasës. Mësuesi/ja shpjegon rastet e përdorimit të **r** dhe **rr** në fjalë të ndryshme, të cilat shpesh ngatërrohen në shqiptim nga nxënësit. *Korrik* - *korik*, *rrugë* – *rugë* etj. ▪ ***Demonstrim i rezultateve të arritura*** **Hapi 5.** Në fletoren e klasës, nxënësit shkruajnë me shkrim dore fjalitë që formuan në fundin e faqes **59**. Lexojnë fjalitë me shkrim dore nga fletorja e tyre.
Vlerësimi i situatës: ***Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:*** ✓ Pyet, përgjigjet, shpreh mendimet, ndjenjat dhe emocionet e tij, si dhe diskuton në grupe të vogla për tema që i interesojnë. ✓ Tregon që e ka kuptuar tekstin e lexuar: *duke ritreguar shkurtimisht dhe me fjalë të thjeshta brendinë; duke përmendur çështjet kryesore; duke dhënë shembuj ose ilustrime nga teksti*. ✓ Qarkon rrokjet me shkronjën **rr** në fjalë të ndryshme.
Detyrë shtëpie: **1.** Kopjo me shkronja dore fjalitë që formove në klasë. **2.** Vizato frutat që të pëlqejnë.
Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1	**Klasa:** 1
Tema mësimore: Punim i shkronjës **J, j** faqe **60** të Abetares		**Situata e të nxënit:** Në botën e përrallave	

***Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe**

Nxënësi:

- ***(1)Kompetenca e komunikim dhe të shprehurit:*** Shpreh me gojë dhe me shkrim për 3-5 minuta para moshatarëve dhe të tjerëve përjetimet dhe emocionet që e kanë shoqëruar gjatë shikimit të një filmi ose dokumentari, dëgjimit të një tregimi apo përralle;
- ***(3)Kompetenca e të nxënit :*** Parashtron pyetje dhe përgjigje në lidhje me temën.
- ***(4)Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin:*** Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në shtëpi.

***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore**

Nxënësi:

- Shqipton tingullin **J**
- Gjen dhe thotë fjalë që fillojnë me ***J*** ose që përmbajnë shkronjën **J** në trup të tyre.
- Lexon fjalë globalisht.
- Plotëson sipas figurës fjalë mungesore.
- Formon fjali/tekst sipas figurës kryesore të faqes.

Fjalë kyçe:

ujku, pjeshka, majmuni

Teknika dhe strategji:

- Filmi për fëmijë *"Kësulëkuqja dhe ujku"*
- Marrëdhënie pyetje-përgjigje
- Vëzhgim
- Demonstrim
- Punë individuale/Çift

Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, modele shkronjash individuale, grafiku i shkronjës **J, j** të shtypit, DVD me filmin për fëmijë *"Kësulëkuqja dhe ujku*", në mungesë libri "*Kësulëkuqja dhe ujku*".

Lidhja me fushat e tjera: Lënda: Matematikë, Arte

Përshkrimi kontekstual i situatës:

- ***Veprimtari paraprake:***

Hapi 1. Mësuesi/ja lexon përrallën "*Kësulëkuqja dhe ujku*", ose i krijon mundësinë nxënësve të shohin filmin ose pjesë të tij me videoprojektor.

Hapi 2. Mësuesi/ja bën prezantimin e situatës së të nxënit dhe shkruan në tabelë titullin e mësimit **Kësulëkuqja**

I bën pyetje nxënësve:

- *Kush është Kësulëkuqja?*
- *Pse e quajnë ashtu?*
- *Ku po shkonte ajo?*
- *Kë takoi rrugës?*

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 3. Nxiten nxënësit të vërejnë figurën në libër dhe të formojnë fjali ose një tekst të shkurtër. Disa

mund të ritregojnë përrallën.

Hapi 4. Demonstron para klasës grafikun e shkronjës së vogël dhe të madhe të shtypit. Nxit nxënësit të bëjnë ngjashmëritë dhe dallimet me shkronjat e tjera dhe objekte të tjera rrethanore. Thekson shqiptimin e saj dhe nxit nxënësit që kanë vështirësi në shqiptim ta përsërisin atë në fillim dhe mes të fjalës. Nxiten nxënësit të gjejnë fjalë që fillojnë me **J**, e kanë në trup ose mbarojnë me **J**.

Hapi 5. Nxënësit punojnë individualisht për plotësimin e shkronjave në fjalët mungesore.

ujku, pjeshka, majmuni.

Bëhet leximi dhe ndarja e tyre në rrokje. Ngre disa nxënës që shkruajnë fjalët në tabelë.

Mësuesi/ja shkruan fjalinë kryesore në tabelë.

Kësulëkuqja u takua me ujkun.

Nxënësit ndajnë në etiketa.

Mësuesi/ja shpjegon ndërtimin e fjalës kësulëkuqja nga dy fjalë të tjera.

Kësulëkuqja = kësulë + kuqja

Bëhet ndarja e fjalës në rrokje.

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 6.

Individualisht nxënësit lidhin rrokjet për të krijuar fjalë. Udhëzohen të ndihmohen nga ngjyrat e përdorura.

Jaka, fjala, bjeshkë, jeta, lojtar.

Lexohen nga nxënësit në zinxhir fjalitë e formuara.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Shqipton tingullin **J**.
- ✓ Gjen dhe thotë fjalë që fillojnë me ***J*** ose që përmbajnë shkronjën **J** në trup të tyre.
- ✓ Lexon fjalë globalisht.
- ✓ Plotëson sipas figurës fjalë mungesore.
- ✓ Formon fjali/tekst sipas figurës kryesore të faqes.

Detyrë shtëpie:

- Lexo dhe shkruaj fjalët që formove nga bashkimi i rrokjeve.
- Shkruaj 10 fjalë me shkronjën **J**.

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1	**Klasa:** 1
Tema mësimore: Punim e shkrim i shkronjës **J, j,** Abetare pune faqe **43**		**Situata e të nxënit:** Në botën e përrallave	

***Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe**

Nxënësi:

- ***(3)Kompetenca e të nxënit:*** Ndjek udhëzimet e dhëna për të realizuar një veprim.
- ***(4) Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin :*** Identifikon burimet e nevojshme dhe i përdor në mënyrë të drejtë.
- ***6)Kompetenca qytetare:*** Diskuton dhe në bashkëpunim me anëtarët e grupit vendos rregullat e punës në grup.

***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore**

Nxënësi:

- Shkruan shkronjës **J, j** të shtypit sipas modelit.
- Lidh fjalët për të krijuar grupe fjalësh sipas kuptimit.
- Shkruan rrokje, fjalë, fjali.
- Plotëson pjesët që u mungojnë fjalëve ose fjalive.

Fjalë kyçe:
Janar, ujku, lejleku, fjalor

Teknika dhe strategji:

- Punë me grupe
- Demonstrim
- Punë individuale
- Analizë – sintezë fjalësh, fjalish.

Burimet e informacionit dhe mjete: Shkronjat individuale dhe kolektive, fletore pune, etiketa me rrokje, fjalë sipas nivelit.

Lidhja me fushat e tjera:
Edukim për shoqërinë

Përshkrimi kontekstual i situatës

- ***Veprimet paraprake***

Hapi 1. Klasa është e ndarë në grupe me nivele të ndryshme. Mësuesja ka përgatitur etiketa me fjalë dhe fjali rreth situatës, që të kenë shkronjën **j**. Ia shpërndan nxënësve sipas nivelit.
Nxënësit lexojnë me zë të lartë. Nxiten nxënësit të korrigjojnë njëri-tjetrin.

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 2. Mësuesi/ ja paraqet grafikun e shkronjës **J, j.** Nxit të thonë ndryshimet dhe ngjashmëritë me shkronjat e tjera. Bëhet dallimi dhe ngjashmëria me shkronjën **I, i.**
Hapi 3. Ngre nxënës në tabelë që shkruajnë disa nga rrokjet, fjalët dhe fjalitë e etiketa që u shpërndanë në pjesën e parë të orës.
Hapi 4. Punohet sipas kërkesave në fletoren e punës. Modelohet shkronja **J, j** shkruhen fjalët me shkronja të vogla të shtypit. *Jam, je, jemi, jeni, janë, luaj, luajnë, lojtar etj.*
Plotësojnë shkronjën që mungon te fjalët mungesore sipas figurave përkatëse.
Janari, ujku, lejleku
Lidh fjalët për të krijuar grupe fjalësh sipas kuptimit.
Babi im, nëna jonë, motra juaj, libri i tij, jam lojtar, jeni në punë, jemi në shkollë, je piktor.
Nxënësit plotësojnë fjalitë me fjalë mungesore.

- *Jeta ka fjalor të madh.*
- *Joni ka libër të bukur.*
- *Fëmijët janë lojtarë të mirë.*
- *Libri juaj ka shumë fjalë.*

Bëhet kontrolli individual i fletores. ▪ ***Demonstrim i rezultateve të arritura*** **Hapi 5.** Nxënësit lexojnë fjalët dhe fjalitë që krijuan gjatë ushtrimeve në fletoren e punës. Nxënësit më të përparuar mund të formojnë disa fjali në fletore më fjalët e fjalorit. *(janar, fjalor, fjalë)* Mund të bëhet dhe zgjedhimi i foljes ***jam*** në mënyrë intuitive dhe përdorimi i saj në fjali..
Vlerësimi i situatës: ***Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:*** ✓ Shkruan shkronjës **J, j** të shtypit sipas modelit. ✓ Lidh fjalët për të krijuar grupe fjalësh sipas kuptimit. ✓ Shkruan rrokje, fjalë, fjali. ✓ Plotëson pjesët që u mungojnë fjalëve ose fjalive.
Detyrë shtëpie: • Formo nga fjali me fjalët: *janar, ujku, lejleku, lojtar.* • Kopjo bukur në fletore 4 fjalitë e fundit.
Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1	**Klasa:** 1
Tema mësimore: Punim e lexim i shkronjës **J, j** faqe **61** të Abetares		**Situata e të nxënit:** Në botën e përrallave	

***Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe**

Nxënësi:

- ***(1)Kompetenca e komunikim dhe të shprehurit:*** Identifikon personazhet kryesore të një tregimi, drame apo filmi dhe luan rolin e njërit prej personazheve në bashkëveprim me moshatarët.
- ***(3)Kompetenca e të nxënit :*** Parashtron pyetje dhe përgjigjet në pyetjet për temën /problemin/ detyrën e dhënë në njërën nga format e të shprehurit.
- ***(4)Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin:*** Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) Dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në shtëpi.

***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore**

Nxënësi:

- Lexon fjalë, fjali, tekst.
- Pyet, përgjigjet, shpreh mendimet, ndjenjat dhe emocionet e tij, si dhe diskuton në grupe të vogla për tema që i interesojnë
- Përshkruan me fjalë të thjeshta personazhet dhe tregon se cilët janë personazhet e preferuara.
- Merr pjesë në lojë me role (me ndihmën e mësuesit ose të një të rrituri) dhe shpreh opinionet e tij rreth interpretimit të shokëve dhe shoqeve të klasës.

Fjalë kyçe: *përrallë, personazhe, kësulëkuqja, ujku, rojtari, gjyshja.*

Teknika dhe strategji :

- Diskutim paraprak
- Lojë me role
- Marrëdhënie pyetje-përgjigje
- Punë individuale/ çifte

Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, modele shkronjash individuale, grafiku i shkronjës **J, j** të shtypit, libri *"Kësulëkuqja dhe ujku"*, veshje të personazheve.

Lidhja me fushat e tjera: Matematikë, Edukim për shoqërinë, Arte

Përshkrimi kontekstual i situatës:

- ***Veprimtari paraprake***

Hapi 1: Mësuesi/ ja shkruan në tabelë titullin e përrallës, gjithashtu në vende të dukshme ka vendosur foto të personazheve si dhe foto nga libri *"Kësulëkuqja dhe ujku"*. Nxit nxënësit të flasin rreth përrallës dhe të dallojnë dhe përshkruajnë personazhet.

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 2: Mësuesi/ja lexon me intonacion përrallën. Nxënësit vërejnë figurat dhe ndjekin leximin. Më pas lihen nxënësit të lexojnë në heshtje për disa minuta përrallën. Në varësi të numrit të nxënësve në klasë mësuesja bën leximin e tregimit në zinxhir me nga një ose më shumë fjali.

Mund të kërkohet nga nxënësit edhe të lexojnë fjalinë e parë, të dytë e kështu me radhë ose me rend të ngatërruar. Nxënësit që paraqesin vështirësi mund t'i pyesë në fjalë të veçanta të thjeshta.

Hapi 3: Nxënësit janë porositur më parë të marrin veshje të personazheve. Të ndarë në role nxënësit interpretojnë përrallën. Në varësi të kohës dhe përbërjes së klasës mund të përsëritet disa herë në grupe

të ndryshme. ▪ ***Demonstrim i rezultateve të arritura*** **Hapi 4:** Diskutim rreth përmbajtjes. ○ *Si e ka përralla?* ○ *Pse quhet përrallë?* ○ *Nga ndryshon përralla nga tregimi?* ○ *Cilët janë personazhet?* ○ *Ku do të shkonte Kësulëkuqja?* ○ *Kë takoi rrugës?* ○ *Kush e ndihmoi?* ○ *Çfarë mësoni nga përralla?* **Hapi 5:** Nxënësit në mënyrë individuale gjejnë përgjigjen e saktë për pyetjet që janë në libër. Diskutojnë në dyshe më shokun e bankës ose në grup për përgjigjet e dhëna.
Vlerësimi i situatës: ***Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:*** ✓ Lexon fjalë, fjali, tekst. ✓ Pyet, përgjigjet, shpreh mendimet, ndjenjat dhe emocionet e tij, si dhe diskuton në grupe të vogla për tema që i interesojnë. ✓ Përshkruan me fjalë të thjeshta personazhet dhe tregon se cilët janë personazhet e preferuara. ✓ Merr pjesë në lojë me role (me ndihmën e mësuesit ose të një të rrituri) dhe shpreh opinionet e tij rreth interpretimit të shokëve dhe shoqeve të klasës.
Detyrë shtëpie: ● Lexo përrallën. ● Kopjo 3 fjali që të pëlqejnë më shumë nga përralla. ● Vizato personazhin që të pëlqen më shumë.
Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1	**Klasa:** 1
Tema mësimore: Ushtrime aplikative për shkrim dore, shkronja **J, j.**		**Situata e të nxënit:** Në botën e përrallave	

***Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe**

Nxënësi:

- ***Kompetenca e të nxënit:*** Mbikëqyr në mënyrë të pavarur përparimin e vet në një detyrë duke përdorur detyra të ndryshme. Korrigjon gabimet.
- ***Kompetenca qytetare:*** Shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive, vendos duke bashkëpunuar me të gjithë anëtarët për mënyrat që çojnë drejt përfundimit të një aktiviteti të caktuar.

***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore**

Nxënësi:

- Shkruan shkronjat **J, j** të dorës duke u ndihmuar nga modeli.
- Shkruan shkronjat **J, j** me të gjitha elementet duke e lidhur me shkronjat e tjera.
- Shkruan fjalë me të kopjuar ose diktuar duke përdorur shkronjën **J, j** në fillim, në trup të fjalës.
- Respekton hapësirën mes shkronjave, fjalëve dhe fjalive.

Fjalë kyçe:

Shkronjë e madhe, shkronjë e vogël e dorës,
Ujku, jeta, fjalë, ujë,

Teknika dhe strategji:

- Lojë me shkronja
- Demonstrim
- Punë individuale
- Punë në çifte/punë në dyshe
- Lexim individual

Burimet e informacionit dhe mjete: Fletore e punës, fletore shkrimi , modele shkronjash individuale, grafiku i shkronjës **J, j** të shtypit dhe të dorës, etiketa me fjalë me shkronjën **J**.

Lidhja me fushat e tjera: Edukim fizik, arte ej.

Përshkrimi kontekstual i situatës

- ***Veprimtari paraprake***

Hapi 1. Mësuesja nxjerr para klasës disa etiketa në të cilat janë shkruar fjalë që përmbajnë ose jo shkronjën **J, j**. Kujdeset që etiketat të jenë me shkrim të dukshëm dhe të qartë për të gjithë nxënësit. Sapo paraqet etiketën, nxënësit lexojnë individualisht fjalën dhe duartrokasin nëse përmban shkronjën **j**. Në të kundërt duhet të qëndrojnë në heshtje.

Disa nga etiketat qe mund të paraqesë mësuesi/ja para klasës.

Ujku	Motra	Anija
Rrjeta	Lejleku	Babai

Hapi 2. Nxënësit shkruajnë në fletore ose tabelë fjalët që përmbajnë shkronjën **j**.
I lexojnë ato me zë të lartë. Me disa prej tyre mund të formojnë fjali.

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 3. Përsëritje e shkronjave të mësuara të dorës. Lexim në korr.
Përsëriten shkronjat **J, j** të shtypit dhe grafiku i tyre.

Hapi 4. Shpjegoj grafikun e shkronjës **J, j** të dorës dhe e shoqëruar me lëvizjen në ajër të nxënësve. Shpjegohen elementet përbërës të saj.
Bëhet dallimi me shkronjën **j** të shtypit, si dhe i **j** së madhe dhe të vogël të dorës. Bëhet dallimi i shkronjës **J, j** të madhe dhe asaj të vogël të dorës.
Ngre nxënës në tabelë që shkruajnë shkronjën dhe lidhjen e saj me shkronjat e tjera në fjalë.
Hapi 5. Më pas nxënësit punojnë në fletoren e punës sipas modelit. Nxënësit lexojnë fjalët dhe fjalinë që shkruan me shkrim dore. Bëhet kontrolli individual i detyrës.

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 6. Diktim me shkronja dore.
Ja, je, ji, jo, ju, janari, luaj, luajnë, mësojnë,
Jetoni e Joni luajnë me ujë.
Nxënësit lexojnë fjalët që shkruan me shkronja dore.

Vlerësimi i situatës:
Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Shkruan shkronjat **J, j** të dorës duke u ndihmuar nga modeli.
- ✓ Shkruan shkronjat **J, j** me të gjitha elementet duke e lidhur me shkronjat e tjera.
- ✓ Shkruan fjalë me të kopjuar ose diktuar duke përdorur shkronjën **J, j** në fillim, në trup të fjalës
- ✓ Respekton hapësirën mes shkronjave, fjalëve dhe fjalive.

Detyrë shtëpie:

1. Shkruaj nga 3 rreshta me shkronja/rrokje/ fjalë ose fjali me shkronjën **J, j.**

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1	**Klasa:** 1
Tema mësimore: Punim i faqes **60-61** të Abetares. ***Kësulëkuqja dhe ujku***		**Situata e të nxënit:** Në botën e përrallave	

***Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe**

Nxënësi:

- ***Kompetenca e komunikim dhe të shprehurit:*** Shpreh mesazhin e një teksti të thjeshtë, nëpërmjet njërës nga format shprehëse: të folurit, shkrimit.
- ***Kompetenca e të nxënit:*** Parashtron pyetje dhe përgjigjet në pyetjet për temën në njërën nga format e të shprehurit.
- ***Kompetenca e të nxënit:*** Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes.
- ***Kompetenca qytetare:*** Diskuton dhe bashkëpunon me anëtarët e grupit.

***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore**

Nxënësi:

- Merr pjesë në lojë me role (me ndihmën e mësuesit ose të një të rrituri) dhe shpreh opinionet e tij rreth interpretimit të shokëve dhe shoqeve të klasës.
- Tregon që e ka kuptuar tekstin e lexuar: *duke ritreguar shkurtimisht dhe me fjalë të thjeshta brendinë; duke përmendur çështjet kryesore; duke dhënë shembuj ose ilustrime nga teksti.*
- Lidh fjalët për të krijuar fjali me kuptim.
- Qarkon fjalën e shkruar saktë.

Fjalë kyçe:

Janari, bjeshkë,jam, luajmë, jepni, janë.

Teknika dhe strategji:

- Lojë me role
- Marrëdhënie pyetje – përgjigje
- Punë individuale
- Lexim fjalësh, fjalish
- Analizë – sintezë
- Punë në dyshe/grup

Burimet e informacionit dhe mjete:

Libri i nxënësit, modele shkronjash individuale, grafiku i shkronjës **J, j** të shtypit, veshje të personazheve.

Lidhja me fushat e tjera:

Lënda: Matematikë, Edukim për shoqërinë, Arte

Përshkrimi kontekstual i situatës

- ***Veprimtari praktike***

Hapi 1. Mësimi nis me interpretimin në role të përrallës e cila ka nisur në orën e kaluar.
Përfundojnë interpretimin dhe grupet që kanë mbetur pa interpretuar ose mund të ndërrohen rolet nëse nxënësit kanë dëshirë.
Zgjidhen interpretuesit më të mirë në formën e votimit nga vetë nxënësit.

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 2. Punohet me pjesën e fundit të faqes **60** dhe **61**.
Rilexojnë fjalinë : ***Kësulëkuqja u takua me ujkun.*** Bëhet ndarja e fjalëve në etiketa.
U kërkohet nxënësve të gjejnë fjalën e parë, të dytë e kështu me radhë si dhe në rend të ngatërruar.
Hapi 3. Lihen të punojnë individualisht për ushtrimet e fundit të faqes **60**. Nxënësit duhet të lidhin në rrokje fjalët për të krijuar fjali.

- *Jetmiri jeton në bjeshkë.*
- *Fjalori ka shumë fjalë.*
- *Janari është muaji i ftohtë.*

- *Joni ujit lulet.*

Mund të aplikohet dhe puna në dyshe ose grup sipas përbërjes së klasës. Në të njëjtën mënyrë punohet me ushtrimin e fundit të faqes **61**. Nxënësit lidhin në mënyrë intuitive përemrat vetorë me foljet dhe e plotësojnë në fjali sipas dëshirës.

- *Unë jam në shkollë.*
- *Ti jeton në fshat.*
- *Ai lëpin akulloren.*
- *Ne luajmë në oborr.*
- *Ju jepni fjalën.*
- *Ata janë fëmijë.*

Hapi 4.

Mësuesi/ja shpjegon rastet e mospërdorimit të shkronjës j ose të përdorimit gabim p.sh., në fjalët: *ujë, fëmijë, shamia, shtëpia* etj. Qarkojnë fjalët e shkruara saktë.

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 5. Në fletoren e klasës, nxënësit shkruajnë me shkrim dore fjalitë që formuan në fundin e faqes **60** Lexojnë fjalitë me shkrim dore nga fletorja e tyre.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Pyet, përgjigjet, shpreh mendimet, ndjenjat dhe emocionet e tij, si dhe diskuton në grupe të vogla për tema që i interesojnë.
- ✓ Tregon që e ka kuptuar tekstin e lexuar: *duke ritreguar shkurtimisht dhe me fjalë të thjeshta brendinë; duke përmendur çështjet kryesore; duke dhënë shembuj ose ilustrime nga teksti.*
- ✓ Qarkon rrokjet me shkronjën **j** në fjalë të ndryshme.

Detyrë shtëpie:

1. Kopjo me shkronja dore fjalitë që formove në klasë. Fq. **61**.
2. Formo fjali me fjalët: ***jam, janë, luajmë, mësojnë***. *(Nxënësit në mënyrë intuitive duhet të përshtatë kryefjalën me vetën e foljes.)*

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1	**Klasa:** 1
Tema mësimore: Punim i shkronjës V, v faqe 62 të Abetares.		**Situata e të nxënit:** Viti dhe stinët	

***Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe**

Nxënësi:

- ***(3)Kompetenca e të nxënit:*** Parashtron pyetje dhe përgjigje në lidhje me temën.
- ***(4)Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin:*** Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në shtëpi.

***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore**

Nxënësi:

- Shqipton tingullin **V.**
- Gjen dhe thotë fjalë që fillojnë me *V* ose që përmbajnë shkronjën **V** në trup të tyre.
- Lexon fjalë globalisht.
- Plotëson sipas figurës fjalë mungesore.
- Pyet, përgjigjet, shpreh mendimet, ndjenjat dhe emocionet e tij, si dhe diskuton në grupe të vogla për tema që i interesojnë.

Fjalë kyçe:

Viti, stinët, avioni, kova, violina, veshi

Teknika dhe strategji:

- Lojë me gjëza
- Marrëdhënie pyetje-përgjigje
- Vëzhgim
- Demonstrim
- Punë individuale/Çift

Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, modele shkronjash individuale, grafiku i shkronjës **V, v** të shtypit, kalendar, foto të stinëve.

Lidhja me fushat e tjera: Lënda: Matematikë, Arte

Përshkrimi kontekstual i situatës:

- ***Veprimtari paraprake:***

Hapi 1. Mësuesi/ja lexon disa gjëza për stinët e vitit.

Janë tri motra e një vëlla, ***Ditë më shumë, asnjë nuk ka.*** *(stinët e vitit)*	***Të parit thinjat era ia merr,*** ***E dyta plot lule trazuar,*** ***Tjetra e nxehtë plot diell,*** ***E fundit me fruta ngarkuar.*** ***Ç'është ?*** *(stinët e vitit)*	***Një lis me dymbëdhjetë dega,*** ***Gjashtë të buta,*** ***Gjashtë të egra.*** *(Muajt e vitit)*

Nxënësit gjejnë gjëzat dhe nxiten të thonë gjëza të tjera për muajit e viti ose vjersha të ndryshme.

Hapi 2. Hapen librat. Nxënësit lexojnë titullin **Viti dhe stinët** të cilin mësuesi/ja e shkruan në tabelë.

Pyet: Cila shkronjë ka ngjyrë të kuqe?

Në muret e klasës janë vendosur etiketa me muajt e vitit dhe nxënësit grupohen sipas muajve kur kanë lindur. Në të njëjtën mënyrë veprohet edhe për stinët e vitit.

Mirë është që në klasë të jetë një poster i madh i ngjashëm me atë të librit.

Veprimet në situatë

Hapi 3. Njihen nxënësit me tingullin dhe shkronjën **V, v**.

Përsëriten stinët e vitit. ***Pranvera, vera, vjeshta, dimri.***
Në cilën fjalë është tingulli V?
Hapi 4. Demonstron para klasës grafikun e shkronjës së vogël dhe të madhe të shtypit. Nxit nxënësit të bëjnë ngjashmëritë dhe dallimet me shkronjat e tjera dhe objekte të tjera rrethanore. Thekson shqiptimin e saj dhe nxit nxënësit që kanë vështirësi në shqiptim ta përsërisin atë në fillim dhe mes të fjalës. Nxiten nxënësit të gjejnë fjalë që fillojnë me **V**, e kanë në trup ose mbarojnë me **V**.
Hapi 5. Nxënësit punojnë individualisht për plotësimin e shkronjave në fjalët mungesore.
Avioni, kova, violina, veshi.
Bëhet leximi dhe ndarja e tyre në rrokje. Ngre disa nxënës që shkruajnë fjalët në tabelë.
Mësuesi/ja shkruan fjalinë kryesore në tabelë.
Vilma e Valoni mësuan për kalendarin e vitit.
Nxënësit ndajnë në etiketa.
Bëhet ndarja e fjalëve në rrokje. *Vilma, valoni, vitit.*

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 6.
Në fletore nxënësit shkruajnë shkronjën e madhe dhe të vogël të shtypit. Gjithashtu mund të vizatojnë objekte që fillon me shkronjën **V**.
Në pjesë të prera gazetash ose revistash, nxënësit gjejnë dhe qarkojnë shkronjën **V, v**.

Vlerësimi i situatës:
Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Shqipton tingullin **V.**
- ✓ Gjen dhe thotë fjalë që fillojnë me ***V*** ose që përmbajnë shkronjën **V** në trup të tyre.
- ✓ Lexon fjalë globalisht.
- ✓ Plotëson sipas figurës fjalë mungesore.
- ✓ Pyet, përgjigjet, shpreh mendimet, ndjenjat dhe emocionet e tij, si dhe diskuton në grupe të vogla për tema që i interesojnë.

Detyrë shtëpie:

1. Lexo dhe shkruaj stinët e vitit.
2. Shkruaj 10 fjalë me shkronjën **V**.
3. Vizato stinën që ty pëlqen më shumë.

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla: 1**	**Klasa: 1**
Tema mësimore: Punim e shkrim i shkronjës **V, v,** Abetare pune faqe **44**		**Situata e të nxënit:** Viti dhe stinët	

***Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe**

Nxënësi:

- ***(3)Kompetenca e të nxënit:*** Ndjek udhëzimet e dhëna për të realizuar një veprim
- ***(4) Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin :*** Identifikon burimet e nevojshme dhe i përdor në mënyrë të drejtë.
- ***(5)Kompetenca personale:*** Bashkëpunon me të tjerët pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitetet në klasë, shkollë apo jashtë saj

***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore**

Nxënësi:

- Shkruan shkronjës **V, v** të shtypit sipas modelit
- Lidh rrokjet për të krijuar fjalë
- Lidh fjalët për të krijuar grupe fjalësh sipas kuptimit.
- Shkruan rrokje, fjalë, fjali.
- Plotëson pjesët që u mungojnë fjalëve ose fjalive

Fjalë kyçe:

Vapori, violina, avioni

Teknika dhe strategji:

- Lojë me top
- Diskutim
- Demonstrim
- Punë individuale
- Analizë – sintezë fjalësh, fjalish.

Burimet e informacionit dhe mjete: Shkronjat individuale dhe kolektive, fletore pune,

Lidhja me fushat e tjera: Edukim për shoqërinë, Edukim fizik

Përshkrimi kontekstual i situatës

- ***Veprimet paraprake***

Hapi 1. Mësuesi/ja lexon përrallën " Dymbëdhjetë muajt e vitit". Nxit nxënësit të diskutojnë rreth përmbajtjes shkurtimisht.

- *Pse i dhanë dhuratë plakës së parë?*
- *Po plakës së dytë pse nuk i dhanë?*
- *Cili nga muajt e vitit është më i mirë?*

Hapi 2. Nxënësit vendosen në formë rrethi. Kalojnë një top dorë më dorë. Nxënësi që pret topin duhet të thotë fjalë që përmban shkronjën **V,** disa fjalë shkruhen në tabelë. Të tjerët i lexojnë dhe qarkojnë shkronjën **V**.

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 3. Nxënësit emërtojnë dhe komentojnë figurat. I përgjigjen pyetjeve:

- *Çfarë është?*
- *Për çfarë shërben?*
- *A keni hipur në avion?*
- *Po në anije?*
- *Të pëlqejnë tingujt e violinës?*

Nxënësit lexojnë globalisht fjalët dhe plotësojnë shkronjën **v** që mungon.

Vapori, violina, avioni.

Hapi 4. Punohet sipas kërkesave në fletoren e punës. Modelohet shkronja **V,v.**

Plotësohen fjalët me rrokjet që mungojnë.
Vonë, i vakët, varëse, vrapi, nevoja, vapori.
Lidh rrokjet për të krijuar fjalë dhe fjalët për të krijuar grupe fjalësh me kuptim.
Vonë, vera, kova, vija,
Vij shpejt
Var kapelën
Vjel rrushin
Vjen avioni
Plotësohen fjalitë me fjalë mungesore.
Vera iku me avion.
Viti i Ri vjen me dhurata.

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 5. Nxit nxënësit të diskutojnë me njëri tjetrin dhe të korrigjojnë fletoret e njëri – tjetrit.
Nxënësit lexojnë fjalët dhe fjalitë që krijuan gjatë ushtrimeve në fletoren e punës.
Nxënësit më të përparuar mund të formojnë disa fjali në fletore me disa nga grupet e fjalëve që krijuan. I lexojnë ato me zë të lartë.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Shkruan shkronjës **V, v** të shtypit sipas modelit
- ✓ Lidh rrokjet për të krijuar fjalë
- ✓ Lidh fjalët për të krijuar grupe fjalësh sipas kuptimit.
- ✓ Shkruan rrokje, fjalë, fjali.
- ✓ Plotëson pjesët që u mungojnë fjalëve ose fjalive

Detyrë shtëpie:

4. Formo nga fjali me fjalët : *vapori, violina, avioni.*
5. Kopjo bukur në fletore 2 fjalitë e fundit.

Refleksione:

<table>
<tr><td>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla: 1</td><td>Klasa: 1</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore: Punim e lexim i shkronjës V, v faqe 63 të Abetares.</td><td colspan="2">Situata e të nxënit:
Viti dhe stinët</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe
Nxënësi:
➢ (1)Kompetenca e komunikim dhe të shprehurit: Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup
➢ (3)Kompetenca e të nxënit : Parashtron pyetje dhe përgjigjet në pyetjet për temën /problemin/ detyrën e dhënë në njërën nga format e të shprehurit
➢ (4)Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin: Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) Dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në shtëpi
➢ (6) Kompetenca qytetare: Shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive, vendos duke bashkëpunuar me të gjithë anëtarët për mënyrat që çojnë drejt përfundimit të një aktiviteti të caktuar.</td></tr>
<tr><td colspan="3">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore
Nxënësi:
➕ Lexon fjalë, fjali, tekst.
➕ Pyet, përgjigjet, shpreh mendimet, ndjenjat dhe emocionet e tij, si dhe diskuton në grupe të vogla për tema që i interesojnë.
➕ Veçon disa elemente të teksteve si: titujt, kapitujt dhe ilustrimet si p.sh. Në një kalendar dallon vitin, muajt, ditët,
➕ Shkruan emrat e stinëve të vitit, ditët e javës dhe muajt e vitit.
➕ Përdor gjatë prezantimeve të tij edhe elemente të tilla si: foto dhe piktura.</td><td>Fjalë kyçe: kalendar, stinë, muaj, javë, ditë.

Teknika dhe strategji:
❖ Diskutim paraprak
❖ Marrëdhënie pyetje-përgjigje
❖ Punë me grupe.
❖ Punë individuale/çifte</td></tr>
<tr><td colspan="3">Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, modele shkronjash individuale, grafiku i shkronjës V, v të shtypit, kalendar, foto të stinëve.</td><td>Lidhja me fushat e tjera:
Arte</td></tr>
<tr><td colspan="4">Përshkrimi kontekstual i situatës:
▪ Veprimtari paraprake
Hapi 1: Mësuesi/ ja paraqet para klasë një kalendar dhe nxit nxënësit në diskutim.
○ Çfarë është ky?
○ Pse e përdorim?
○ Sa muaj ka viti?
○ Cilët janë ata?
○ Sa stinë ka?
○ Cilat janë?
○ Sa ditë ka java?
○ Cilat janë?
○ Në çfarë muaji jemi?</td></tr>
</table>

- *Cilës stinë i takon ky muaj?*
- *Çfarë dite është sot?*

▪ ***Veprimet në situatë***

Hapi 2: Mësuesi/ja lexon me intonacion tekstin. Nxënësit vërejnë figurat dhe ndjekin leximin. Më pas lihen nxënësit të lexojnë në heshtje për disa minuta pjesën. Disa nxënës lexojnë me intonacion sipas paragrafëve.

Hapi 3: Klasa ndahet në 4 grupe. Kriter për ndarjen në grupe do të jetë stina në të cilën ka lindur secili.

Detyrat e secilit grup:

- Shkruaj emrin e stinës.
- Shkruaj emrat e muajve të stinës.
- Bëj vizatime të stinës.
- Shkruaj disa karakteristika të stinës.

Mësuesi/ja udhëzon grupet që gjatë përshkrimit të stinës të kenë parasysh: *motin, veshjen, lulet, frutat, ngjarjet kryesore*.

▪ ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 4: Secili grup bën prezantimin e punëve. Grupet vlerësojnë njëri-tjetrin duke argumentuar përgjigjet. Gjatë prezantimit mësuesi/ja ngul këmbë që nxënësit të përshkruajnë karakteristikat e stinës që i përkasin sipas kritereve që janë vënë më sipër.

Punët ekspozohen në muret e klasës.

Hapi 5: Nxënësit në mënyrë individuale plotësojnë emrat e stinëve, muajve, ditëve të javës.

I lexojnë me zë të lartë.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Lexon fjalë, fjali, tekst.
- ✓ Pyet, përgjigjet, shpreh mendimet, ndjenjat dhe emocionet e tij, si dhe diskuton në grupe të vogla për tema që i interesojnë
- ✓ Veçon disa elemente të teksteve si: titujt, kapitujt dhe ilustrimet si p.sh. *Në një kalendar dallon vitin, muajt, ditët.*
- ✓ Shkruan emrat e stinëve të vitit, ditët e javës dhe muajt e vitit.
- ✓ Përdor gjatë prezantimeve të tij edhe elemente të tilla si: foto dhe piktura.

Detyrë shtëpie:

- Mëso përmendësh ditët e javës, muajt dhe stinët e vitit.
- Shkruaj emrat e ditëve të javës, muajve dhe stinëve të vitit.

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla: 1**	**Klasa: 1**
Tema mësimore: Ushtrime aplikative për shkrim dore, shkronja **V, v.**		**Situata e të nxënit:** Viti dhe stinët	

***Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe**

Nxënësi:

- ***Kompetenca e të nxënit:*** Ndjek udhëzimet e dhëna në një tekst për të realizuar një veprim / aktivitet / detyrë, që kërkohet.
- ***Kompetenca e të nxënit:*** Grumbullon dhe klasifikon materialet e performancës së vet, për përgatitjen apo pasurimin e portofolit personal.
- ***Kompetenca qytetare:*** Shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive, vendos duke bashkëpunuar me të gjithë anëtarët për mënyrat që çojnë drejt përfundimit të një aktiviteti të caktuar.

***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore**

Nxënësi:

- Shkruan shkronjat **V, v** të dorës duke u ndihmuar nga modeli.
- Shkruan shkronjat **V, v** me të gjitha elementet duke e lidhur me shkronjat e tjera.
- Shkruan fjalë me të kopjuar ose diktuar duke përdorur shkronjën **V, v** në fillim, në trup të fjalës.
- Respekton hapësirën mes shkronjave, fjalëve dhe fjalive.

Fjalë kyçe:

Shkronjë e madhe, shkronjë e vogël e dorës,
Viti, pranvera, vera, vjeshta

Teknika dhe strategji:

- Lojë me shkronja
- Demonstrim
- Punë individuale
- Punë në çifte/punë në dyshe
- Lexim individual

Burimet e informacionit dhe mjete: Fletore e punës, fletore shkrimi, modele shkronjash individuale, grafiku i shkronjës **V, v** të shtypit dhe të dorës, etiketa me fjalë me shkronjën **V,** fletë kalendari, rrethi i stinëve.

Lidhja me fushat e tjera: Matematikë, Arte ej.

Përshkrimi kontekstual i situatës

- ***Veprimtari paraprake***

Hapi 1. Mësuesi/ ja ka përgatitur rrethin e stinëve dhe nxënësit duhet ta plotësojnë atë.



Mund të përgatitet dhe një fletë kalendari dhe nxënësit plotësojnë me emrat e ditëve të javës dhe datat:

p.sh.

Muaji: JANAR

E hënë	E martë	E mërkurë	E enjte	E premte	E shtunë	E diel
	1	2	3	4	5	6
7	8	9	10	11	12	13
14	15	16	17	18	19	20
21	22	23	24	25	26	27
28	29	30	31			

Hapi 2. Nxënësit shkruajnë në fletore stinët e vitit.
I lexojnë ato me zë të lartë. Me disa prej tyre mund të formojnë fjali. Përsëriten dhe muajt e vitit dhe ditët e javës.

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 3. Përsëriten shkronjat **V, v** të shtypit dhe grafiku i tyre.
Shpjegoj grafikun e shkronjës **V, v** të dorës dhe e shoqëruar me lëvizjen në ajër të nxënësve.
Shpjegohen elementet përbërës të saj.
Bëhet dallimi me shkronjën **v** të shtypit, si dhe i **v** së madhe dhe të vogël të dorës. Bëhet dallimi i shkronjës **V,v** të madhe dhe asaj të vogël të dorës.
Ngre nxënës në tabelë që shkruajnë shkronjën dhe lidhjen e saj me shkronjat e tjera në fjalë.
Hapi 4. Më pas nxënësit punojnë në fletoren e punës sipas modelit. Nxënësit lexojnë fjalët dhe fjalinë që shkruan me shkrim dore. Bëhet kontrolli individual i detyrës.

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 5. Diktim me shkronja dore.
Va, ve, vi, vu, vo, vë, violinë, vapori, vrapova, Kosova, Tetova, Vlora.
Valbona jeton në Kosovë.
Nxënësit lexojnë fjalët që shkruan me shkronja dore.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Shkruan shkronjat **V, v** të dorës duke u ndihmuar nga modeli.
- ✓ Shkruan shkronjat **V, v** me të gjitha elementet duke e lidhur me shkronjat e tjera.
- ✓ Shkruan fjalë me të kopjuar ose diktuar duke përdorur shkronjën **V, v** në fillim, në trup të fjalës.
- ✓ Respekton hapësirën mes shkronjave, fjalëve dhe fjalive.

Detyrë shtëpie:

1. Shkruaj nga 3 rreshta me shkronja/rrokje/fjalë ose fjali me shkronjën **V**.

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1	**Klasa:** 1
Tema mësimore: Punim i faqes **62-63** të Abetares. ***Kalendari i vitit***		**Situata e të nxënit:** Viti dhe stinët	

***Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe**

Nxënësi:

- ***Kompetenca e të nxënit:*** Ndjek udhëzimet e dhëna në një tekst për të realizuar një veprim / aktivitet / detyrë, që kërkohet
- ***Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin*** Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në shtëpi.
- ***Kompetenca qytetare:*** Shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive, vendos duke bashkëpunuar me të gjithë anëtarët për mënyrat që çojnë drejt përfundimit të një aktiviteti të caktuar.

***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore**

Nxënësi:

- Shqipton saktë dhe me intonacionin e theksin e duhur fjalët dhe fjalitë.
- Veçon disa elemente të teksteve si: titujt, kapitujt dhe ilustrimet si p.sh. *Në një kalendar dallon vitin, muajt, ditët.*
- Lidh fjalët për të krijuar fjali me kuptim.
- Përdor drejt shkronjën e madhe në shkrimin e emrave të qyteteve.

Fjalë kyçe:

Vit, stinë, javë, ditë, muaj, vera, vjeshta, pranvera.

Teknika dhe strategji:

- Punë me çift ose grupe
- Punë individuale
- Lexim fjalësh, fjalish
- Analizë – sintezë
- Punë në dyshe/grup

Burimet e informacionit dhe mjete:

Libri i nxënësit, modele shkronjash individuale, grafiku i shkronjës **V,v** të shtypit, etiketa të muajve, stinëve, ditëve të javës.

Lidhja me fushat e tjera:

Lënda: Matematikë, Edukim fizik, Arte

Përshkrimi kontekstual i situatës

- ***Veprimtari praktike***

Hapi 1. Mësuesi/ja ka përgatitur etiketa me emrat e muajve dhe në çifte ose në grupe, nxënësit duhet t'i renditnin ato sipas radhës. Përdorin numrat rreshtorë për t'i prezantuar.

P.sh. Janari është muaji i parë, shkurti është muaji i dytë e kështu me radhë.

Del fitues çifti më i shpejtë dhe më i saktë. Mund të improvizohet dhe trupi i gjarprit i ndarë në 12 pjesë, në të cilin nxënësit vendosin etiketat me emrat e muajve të vitit.

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 2. Punohet me pjesën e fundit të faqes **62** dhe **63**.
Rilexojnë fjalinë: ***Vilma e Valoni mësuan për kalendarin e vitit.***
Bëhet ndarja e fjalëve në etiketa.
U kërkohet nxënësve të gjejnë fjalën e parë, të dytë e kështu me radhë si dhe në rend të ngatërruar.
Hapi 3. Lihen të punojnë individualisht për ushtrimet e fundit të faqes **63**.
Nxënësit duhet të lidhin rrokjet për të krijuar fjalë:
KOVA, VAPA, TAVA, VALA,
Në krahët e avionit nxënësit duhet të lidhin fjalët që janë në krahët e avionit në fjali me kuptim.

- *Vjeshta vjen pas verës.*
- *Vera vjen pas pranverës.*
- *Pranvera vjen para verës.*

Hapi 4.
Zhvillohet një lojë ku nxënësit me etiketat e muajve në duar duhet të renditen sipas radhës, sapo mësuesi/ja jep sinjalin. Pas renditjes së drejtë lexojnë me zë të lartë etiketat që kanë në duar.
Në të njëjtën mënyrë veprohet me stinët dhe ditët e javës. Mund të përsëritet me grupe të ndryshme nxënësish.

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 5. Nxënësit shkruajnë me shkronjat e shtypit dhe të dorës, emrat e qyteteve. Theksohet se emrat e qyteteve shkruhen me shkronjë të madhe.
Nëse mjafton koha, nxënësit mund të formojnë fjali me to. Më pas i lexojnë me zë të lartë.

Vlerësimi i situatës:
Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Shqipton saktë dhe me intonacionin e theksin e duhur fjalët dhe fjalitë.
- ✓ Veçon disa elemente të teksteve si: titujt, kapitujt dhe ilustrimet si p.sh. *Në një kalendar dallon vitin, muajt, ditët.*
- ✓ Lidh fjalët për të krijuar fjali me kuptim.
- ✓ Përdor drejt shkronjën e madhe në shkrimin e emrave të qyteteve.

Detyrë shtëpie:

1. Kopjo me shkronja dore fjalitë që formove në klasë fq **63**.
2. Krijo vetë një kalendar, duke përdorur fantazinë.

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1	**Klasa:** 1
Tema mësimore: Punim i shkronjës **Q, q** faqe **64** të Abetares.		**Situata e të nxënit:** Qershitë	

***Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe**

Nxënësi:

- ***(1)Kompetenca e komunikim dhe të shprehurit:*** Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar.
- ***(3)Kompetenca e të nxënit:*** Parashtron pyetje dhe përgjigje në lidhje me temën.
- ***(4)Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin:*** Gjen të përbashkëtat dhe ndryshimet ndërmjet aktiviteteve që bën në shkollë me ato në shtëpi.

Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore** Nxënësi: - Shqipton tingullin **Q** - Gjen dhe thotë fjalë që fillojnë me ***Q ose që përmbajnë shkronjën **Q** në trup të tyre. - Lexon fjalë globalisht. - Plotëson sipas figurës fjalë mungesore. - Pyet, përgjigjet, shpreh mendimet, ndjenjat dhe emocionet e tij, si dhe diskuton në grupe të vogla për tema që i interesojnë.	**Fjalë kyçe:** *Qershitë, qepa, qukapiku, qeni,* **Teknika dhe strategji:** - Këngë: Qershia - Marrëdhënie pyetje-përgjigje - Vëzhgim - Demonstrim - Punë individuale/Çift
Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, modele shkronjash individuale, grafiku i shkronjës **Q, q** të shtypit, kalendar, foto të qershive ose pemëve me qershi. Modele qershish të bëra me letër punëdore dhe spango.	**Lidhja me fushat e tjera:** Lënda: Matematikë, Arte

Përshkrimi kontekstual i situatës:

- ***Veprimtari paraprake:***

Hapi 1. Mësuesi/ja lë nxënësit të dëgjojnë dhe i shoqëron ata të këndojnë këngën ***" Qershia"***. Ndërkohë në orën e arteve mund të ketë përgatitur qershi me letër punëdore dhe spango dhe ia vë fëmijëve në vesh.

Jam e vogël, rrumbullake,
Jam e shijshme për merake,
Piqem herët në pranverë,
Jam e kuqe, nuk kam erë.

Më pëlqen e gjithë njerëzia,
Por më shumë më ha fëmija.
A e dini se kush jam?
Unë 'Qershi' emrin e kam.

Hapi 2. Hapen librat. Nxënësit lexojnë titullin **Qershitë** të cilin mësuesi/ja e shkruan në tabelë.

Pyet:

- *Cila shkronjë ka ngjyrë të kuqe?*
- *Ju pëlqejnë qershitë?*
- *Kur piqen ato?*
- *Çfarë ngjyre kanë?*
- *Si është shija e tyre?*

- *Çfarë forme kanë?*

▪ ***Veprimet në situatë***

Hapi 3. Njihen nxënësit me tingullin dhe shkronjën **Q, q.**

Demonstron para klasës grafikun e shkronjës së vogël dhe të madhe të shtypit. Nxit nxënësit të bëjnë ngjashmëritë dhe dallimet me shkronjat e tjera dhe objekte të tjera rrethanore. Bëhet dallimi midis **p** dhe **q**. Thekson shqiptimin e saj dhe nxit nxënësit që kanë vështirësi në shqiptim ta përsërisin atë në fillim dhe mes të fjalës. Bëhet dallimi me tingullin **Ç**, që shpesh ngatërrohet. Nxiten nxënësit të gjejnë fjalë që fillojnë me **Q**, e kanë në trup ose mbarojnë me **Q**.

Hapi 4. Nxiten nxënësit të formojnë fjali ose një tekst të shkurtër nisur nga përvoja, një film që kanë parë ose fantazia.

Ndihmon me pyetje:

- *Në cilën stinë janë?*
- *Çfarë po bëjnë fëmijët?*
- *Çfarë vë re në fytyrat e tyre?*
- *Po ti a ke vjelë ndonjëherë qershi?*

Hapi 5. Nxënësit punojnë individualisht për plotësimin e shkronjave në fjalët mungesore.

Qershia, qepa, qeni, qukapiku.

Bëhet leximi dhe ndarja e tyre në rrokje. Ngre disa nxënës që shkruajnë fjalët në tabelë.

Mësuesi/ja shkruan fjalinë kryesore në tabelë.

Në qershor piqen qershitë.

Nxënësit ndajnë në etiketa.

Bëhet ndarja e fjalëve në rrokje. *Qershor, piqen, qershi*

▪ ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 6.

Mësuesi paraqet para klasës etiketa me fjalë që përmbajnë shkronjën Q, disa që përmbajnë Ç dhe P.

Lihen nxënësit të lexojnë në heshtje. Nëse fjala përmban Q, ata duhet të duartrokasin.

Disa fjalë që mund të përdore janë:

çanta, veçoj, quhem, peshku, kap, çakmak, qukapik etj.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Shqipton tingullin **Q**
- ✓ Gjen dhe thotë fjalë që fillojnë me ***Q*** ose që përmbajnë shkronjën **Q** në trup të tyre.
- ✓ Lexon fjalë globalisht.
- ✓ Plotëson sipas figurës fjalë mungesore.
- ✓ Pyet, përgjigjet, shpreh mendimet, ndjenjat dhe emocionet e tij, si dhe diskuton në grupe të vogla për tema që i interesojnë.

Detyrë shtëpie:

1. Vizato një pemë qershie.
2. Shkruaj 10 fjalë që përmbajnë shkronjën **Q**.
3. Shkruaj 3 fjali për figurën.

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1	**Klasa:** 1
Tema mësimore: Punim e shkrim i shkronjës **Q, q**, Abetare pune faqe **45**		**Situata e të nxënit:** Qershitë	

***Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe**

Nxënësi:

- ***(3)Kompetenca e të nxënit:*** Ndjek udhëzimet e dhëna për të realizuar një veprim
- ***(4) Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin:*** Identifikon burimet e nevojshme dhe i përdor në mënyrë të drejtë.
- ***(5)Kompetenca personale:*** Bashkëpunon me të tjerët pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitetet në klasë, shkollë apo jashtë saj.

***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore**

Nxënësi:

- Shkruan shkronjës **Q, q** të shtypit sipas modelit.
- Lidh rrokjet për të krijuar fjalë.
- Lidh fjalët për të krijuar grupe fjalësh sipas kuptimit.
- Shkruan rrokje, fjalë, fjali.
- Plotëson pjesët që u mungojnë fjalëve ose fjalive.

Fjalë kyçe:
Qengji, manushaqe, qeni

Teknika dhe strategji:

- Lojë me etiketa
- Diskutim
- Punë individuale
- Analizë – sintezë fjalësh, fjalish.
- Punë në çifte

Burimet e informacionit dhe mjete: Shkronjat individuale dhe kolektive, fletore pune.

Lidhja me fushat e tjera:
Dituri natyre, arte

Përshkrimi kontekstual i situatës

- ***Veprimet paraprake***

Hapi 1. Mësuesi/ja ka përgatitur disa etiketa në formën e kokrrave të qershisë. Në të cilat ka shkruar rrokje p.sh.





Nxënësit lidhin rrokjet dhe lexojnë fjalët që formuan. Disa fjalë shkruhen në tabelë.

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 2. Nxënësit emërtojnë dhe komentojnë figurat. I përgjigjen pyetjeve:

- *Çfarë është?*
- *Për çfarë shërben?*
- *Si bën qengji?*
- *Si quhen prindërit e qengjit?*
- *Kur çelin manushaqet?*
- *Si quhen ndryshe ato?*

- *Ju pëlqen të mbani qen?*

Nxënësit lexojnë globalisht fjalët dhe plotësojnë shkronjën **q** që mungon.

Qengji, manushaqe, qeni

Hapi 3. Punohet sipas kërkesave në fletoren e punës. Modelohet shkronja **Q, q.**

Lidhin rrokjet për të krijuar fjalë.

qeshi, qepi, qoshe, qumësht,

liqen, quhem, qahem, qëroj,

iriq, faqe, shoqe, peshqit.

Lidh fjalët për të krijuar grupe fjalësh me kuptim.

heq kapelën

qaj pak,

qëroj qepën,

qep fustanin,

qesh shumë,

poqi mishin

Shkruajnë fjalinë duke plotësuar fjalët që mungojnë dhe krijuar hapësirën e duhur midis fjalëve.

Rosat lahen në liqen.

Patat rrinë pranë liqenit.

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 4. Nxit nxënësit të diskutojnë me njëri tjetrin dhe të korrigjojnë fletoret e njëri-tjetrit.

Nxënësit lexojnë fjalët dhe fjalitë që krijuan gjatë ushtrimeve në fletoren e punës.

Nxënësit më të përparuar mund të formojnë disa fjali në fletore me disa nga grupet e fjalëve që krijuan.

I lexojnë ato me zë të lartë.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Shkruan shkronjës **Q, q** të shtypit sipas modelit.
- ✓ Lidh rrokjet për të krijuar fjalë.
- ✓ Lidh fjalët për të krijuar grupe fjalësh sipas kuptimit.
- ✓ Shkruan rrokje, fjalë, fjali.
- ✓ Plotëson pjesët që u mungojnë fjalëve ose fjalive.

Detyrë shtëpie:

1. Formo nga fjali me fjalët: *qengji, manushaqe, qeni.*
2. Kopjo bukur në fletore 2 fjalitë e fundit.

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1	**Klasa:** 1
Tema mësimore: Punim e lexim i shkronjës **Q, q** faqe **65** të Abetares.		**Situata e të nxënit:** Qershitë	

***Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe**

Nxënësi:

- ***(1)Kompetenca e komunikim dhe të shprehurit:*** Lexon me zë një tekst së paku prej gjysmë faqeje të pa lexuar më parë.
- ***(1) Kompetenca e komunikim dhe të shprehurit:*** Identifikon personazhet e një tregimi.
- ***(3) Kompetenca e të nxënit:*** Parashtron pyetje dhe përgjigjet në pyetjet për temën /problemin/ detyrën e dhënë në njërën nga format e të shprehurit.

***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore**	**Fjalë kyçe:** *tregim, titull, personazhe, qorton*
Nxënësi: - Lexon fjalë, fjali, tekst. - Pyet, përgjigjet, shpreh mendimet, ndjenjat dhe emocionet e tij, si dhe diskuton në grupe të vogla për tema që i interesojnë. - Rilexon tekstin për të kuptuar përmbajtjen e tij. - Parashikon rreth përmbajtjes së tekstit duke u mbështetur te titulli, ilustrimet dhe fjalët kyçe të tekstit.	**Teknika dhe strategji :** ❖ Lojë gjëzë ❖ Marrëdhënie pyetje-përgjigje ❖ Punë me grupe. ❖ Punë individuale/çifte
Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, modele shkronjash individuale, grafiku i shkronjës **Q, q** të shtypit.	**Lidhja me fushat e tjera:** Edukim për shoqërinë, matematikë.

Përshkrimi kontekstual i situatës:

- ***Veprimtari paraprake***

Hapi 1: Mësuesi/ ja ka porositur më parë nxënësit të mësojnë vjersha ose gjëza për qershinë.

Rruqe – rruqe, Brenda dru e jashtë e kuqe.	E ëma shami jeshile, e bija shami kuqe.

Disa të dhëna për qershitë:

Qershia *përmban shumë kalori dhe vitamina.*

- *Na mbrojnë nga inflamacionet.*
- *Ndihmon për një pamje më të mirë.*
- *Lufton tensionin e lartë të gjakut.*
- *Ndihmon muskujt, sidomos pas stërvitjeve fizike.*
- *Ndihmon për një gjumë më të mirë.*
  Parandalon humbjen e kujtesës.

Hapi 2: Bën prezantimin e tregimit. Shkruan titullin në tabelë. Nxit nxënësit të diskutojnë sipas titullit dhe figurës. Mund t'u vendosin emra fëmijëve dhe qenit.

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 3: Mësuesi/ja lexon me intonacion 2 herë tregimin.

Hapen librat. Nxit nxënësit të përshkruajnë figurën. Bëhet leximi në korr i tregimit disa herë.

Hapi 4: Më pas lihen nxënësit të lexojnë në heshtje për disa minuta tregimin. Në varësi të numrit të nxënësve në klasë mësuesja bën leximin e tregimit në zinxhir me nga një ose më shumë fjali.

Mund të kërkohet nga nxënësit edhe të lexojnë fjalinë e parë, të dytë e kështu me radhë ose me rend të ngatërruar. Nxënësit që paraqesin vështirësi mund t'i pyesë në fjalë të veçanta të thjeshta.

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 5: Diskutim rreth përmbajtjes.

- *Si e ka titullin tregimi?*
- *Si quhen personazhet?*
- *Në cilin muaj zhvillohet ngjarja?*
- *Pse i qortoi Qemali?*
- *Cilat qenë dy gabimet që bënë fëmijët?*
- *A i kuptuan gabimet fëmijët?*
- *Pse nuk duhen ngrënë pa larë qershitë?*
- *Çfarë mësoni nga tregimi?*
- *Po ju, keni bërë ndonjë gabim të ngjashëm?*
- *Kur ju kanë qortuar për herë të fundit? Pse?*

Hapi 6: Nxënësit në mënyrë individuale gjejnë përgjigjen e saktë për dy pyetjet që janë në libër. Diskutojnë në dyshe më shokun e bankës ose në grup për përgjigjet e dhëna.

- Kur piqen qershitë?
- *Qershitë piqen në qershor.*
- Pse i qortoi rojtari fëmijët?
- *Rojtari i qortoi fëmijët sepse ata morën pa leje qershi.*

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Lexon fjalë, fjali, tekst.
- ✓ Pyet, përgjigjet, shpreh mendimet, ndjenjat dhe emocionet e tij, si dhe diskuton në grupe të vogla për tema që i interesojnë
- ✓ Rilexon tekstin për të kuptuar përmbajtjen e tij.
- ✓ Parashikon rreth përmbajtjes së tekstit duke u mbështetur te titulli, ilustrimet dhe fjalët kyçe të tekstit

Detyrë shtëpie:

1. Kopjo 4 fjali që të pëlqejnë më shumë nga teksti.
2. Përgjigju me shkrim 2 pyetjeve në fq. 65.

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1	**Klasa:** 1
Tema mësimore: Ushtrime aplikative për shkrim dore, shkronja **Q, q**.		**Situata e të nxënit:** Qershitë	

***Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe**

Nxënësi:

- ***(3)Kompetenca e të nxënit:*** Mbikëqyr në mënyrë të pavarur përparimin e vet në një detyrë duke përdorur detyra të ndryshme. Korrigjon gabimet.
- ***(3)Kompetenca e të nxënit:*** Grumbullon dhe klasifikon materialet e performancës së vet, për përgatitjen apo pasurimin e portofolit personal
- ***(6)Kompetenca qytetare:*** Bashkëpunon në grup dhe respekton rregullat e grupit.

***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore**

Nxënësi:

- Shkruan shkronjat **Q, q** të dorës duke u ndihmuar nga modeli.
- Shkruan shkronjat **Q, q** me të gjitha elementet duke e lidhur me shkronjat e tjera.
- Shkruan fjalë me të kopjuar ose diktuar duke përdorur shkronjën **Q, q** në fillim, në trup të fjalës.
- Respekton hapësirën mes shkronjave, fjalëve dhe fjalive.

Fjalë kyçe:
Shkronjë e madhe , shkronjë e vogël e dorës, Qep, miq, fiq, shqiptar, Shqipëri, etj.

Teknika dhe strategji:

- Lojë me etiketa
- Demonstrim
- Punë individuale
- Punë në çifte/punë në dyshe
- Lexim individual

Burimet e informacionit dhe mjete: Fletore e punës, fletore shkrimi, modele shkronjash individuale, grafiku i shkronjës **Q, q** të shtypit dhe të dorës, një pemë e improvizuar me kartoni.

Lidhja me fushat e tjera: Arte ej.

Përshkrimi kontekstual i situatës

- ***Veprimtari paraprake***

Hapi 1. Mësuesi/ja ka përgatitur një pemë të madhe prej kartoni ose e vizaton në tabelë. Nxënësit kanë prerë që më parë në fletë punëdore me ngjyrë të kuqe, forma të rrumbullakëta. Në to, ata do të shkruajnë fjalë të ndryshme me shkronjën **Q** dhe do t'i ngjisin në degët e pemës. Më pas nxënësit lexojnë fjalët që krijuan në pemët e qershisë.

Kjo veprimtari mund të organizohet dhe me grupe me 3-4 nxënës, ku nxënësit e secilit grup shkruajnë fjali. Secila fjalë do të shkruhet në etiketa të ndryshme, por duhen renditur në pemë sipas kuptimit. Grupet lexojnë fjalitë e njëri-tjetrit.

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 2. Përsëriten shkronjat **Q, q** të shtypit dhe grafiku i tyre.

Shpjegoj grafikun e shkronjës **Q, q** të dorës e shoqëruar me lëvizjen në ajër të nxënësve. Shpjegohen elementet përbërës të saj. Bëhet dallimi me shkronjën **q** të shtypit, si dhe i **q** së madhe dhe të vogël të dorës. Bëhet dallimi i shkronjës **Q, q** të madhe dhe asaj të vogël të dorës.

Bëhet dallimi midis **O** dhe **Q** të madhe të dorës , si dhe **p** dhe **q**, të vogël të dorës.

Ngre nxënës në tabelë që shkruajnë shkronjën dhe lidhjen e saj me shkronjat e tjera në fjalë.

Hapi 3. Më pas nxënësit punojnë në fletoren e punës sipas modelit. Nxënësit lexojnë fjalët dhe fjalinë

që shkruan me shkrim dore. Bëhet kontrolli individual i detyrës. Fjalët që shkruan në degët e qershisë, i shkruajnë sërish në fletore, por me shkrim dore ▪ ***Demonstrim i rezultateve të arritura*** **Hapi 4.** Diktim me shkronja dore. *Qe, qe, qu ,qo,që, miq, fiqtë, shqiptar, qeshim, përqafim, qytet.* *Jam krenar që jam shqiptar.* *Shqipëria është atdheu im.* Nxënësit lexojnë fjalët që shkruan me shkronja dore.
Vlerësimi i situatës: ***Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:*** ✓ Shkruan shkronjat **Q, q** të dorës duke u ndihmuar nga modeli. ✓ Shkruan shkronjat **Q, q** me të gjitha elementet duke e lidhur me shkronjat e tjera. ✓ Shkruan fjalë me të kopjuar ose diktuar duke përdorur shkronjën **Q, q** në fillim, në trup të fjalës. ✓ Respekton hapësirën mes shkronjave, fjalëve dhe fjalive.
Detyrë shtëpie: **1.** Shkruaj nga 3 rreshta me shkronja/rrokje/fjalë ose fjali me shkronjën **Q**.
Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1	**Klasa:** 1
Tema mësimore: Punim i faqes **64-65** të Abetares. ***Qershitë u poqën***		**Situata e të nxënit:** Qershitë	

***Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe**

Nxënësi:

- ***(1)Kompetenca e komunikim dhe të shprehurit:*** Shpreh mesazhin e një teksti të thjeshtë, nëpërmjet njërës nga format shprehëse: të folurit, shkrimit.
- ***(3)Kompetenca e të nxënit:*** Parashtron pyetje dhe përgjigjet në pyetjet për temën në njërën nga format e të shprehurit.
- ***(3)Kompetenca e të nxënit:*** Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes.
- ***(6)Kompetenca qytetare:*** Diskuton dhe bashkëpunon me anëtarët e grupit.

***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore**

Nxënësi:

- Pyet, përgjigjet, shpreh mendimet, ndjenjat dhe emocionet e tij, si dhe diskuton në grupe të vogla për tema që i interesojnë.
- Tregon që e ka kuptuar tekstin e lexuar: *duke ritreguar shkurtimisht dhe me fjalë të thjeshta brendinë; duke përmendur çështjet kryesore; duke dhënë shembuj ose ilustrime nga teksti.*
- Qarkon rrokjet me shkronjën **q** në fjalë të ndryshme.
- Dallon përdorimin e shkronjës **q** dhe **p** në fjalë të ndryshme.
- Plotëson një skedë me të dhëna personale.

Fjalë kyçe:

Pëlqej, qumësht, përqafim, qerpik, qaraman, qaj,

Teknika dhe strategji:

- Punë grupe
- Punë individuale
- Lexim fjalësh, fjalish
- Analizë – sintezë
- Punë në dyshe/grup

Burimet e informacionit dhe mjete:

Libri i nxënësit, modele shkronjash individuale dhe kolektive, grafiku i shkronjës **Q, q** të shtypit, të dorës, etiketa me fjalitë tekstit "*Qershitë u poqën.*"

Lidhja me fushat e tjera:

Lënda: Matematikë, Edukim fizik, Arte

Përshkrimi kontekstual i situatës

- ***Veprimtari praktike***

Hapi 1. Mësuesi ka përgatitur fjali të tekstit të shkruar në etiketa dhe ia jep nxënësve në grupe në rend të ngatërruar. Nxënësit duhet të renditin fjalitë sipas radhës së veprimeve, pa i parë në libër Vlerësohet grupi që i radhiti më shpejt dhe saktë fjalitë.

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 2. Punohet me pjesën e fundit të faqes **64** dhe **65**.

Rilexojnë fjalinë: ***Në qershor piqen qershitë.***

Bëhet ndarja e fjalëve në etiketa.

Nxënësit plotësojnë individualisht fjalitë me fjalë mungesore. Kontrollojnë me shokun e bankës.

Bebi qan shumë.

Mami qëron qepën.

Lexojnë fjalitë me zë të lartë.

Hapi 3. Lihen të punojnë individualisht për ushtrimet e fundit të faqes **65**.
Mësuesi/ja bën edhe një herë dallimin midis shkronjës **q** dhe shkronjës **p** dhe nxit nxënësit të japin shembuj të përdorimit të këtyre shkronjave.
Më pas plotësojnë individualisht shkronjën e duhur në fjalët: *qafa, pula, qepa, pako.*
Në ushtrimin tjetër nxënësit duhet të qarkojnë rrokjen *qo, qu, qa, qe* në fjalë të ndryshme dhe e lidhin me rrokjen përkatëse.
Kontrollojnë punët e njëri-tjetrit.

Hapi 4.
Mësuesi/ja shpjegon se çfarë është skeda dhe kur mund të përdoret ajo.
Udhëzon nxënësit se duhet të plotësojnë skedën dhe i lë nxënësit të plotësojnë në mënyrë të pavarur atë. Kujton përdorimin e shkronjës së madhe te marte njerëzve dhe te emri i shkollës, si dhe përdorimi i thonjëzave te emri i shkollës. P.sh.:

Unë quhem Era.

Shkolla ime quhet "7 Marsi".

Mësuesja ime quhet Shpresa.

Kam një vëlla të vogël qaraman.

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 5. Nxënësit lexojnë skedën. Mësuesi/ja korrigjon individualisht mënyrën se si kanë përdorur shkronjën e madhe.
Lexojnë duke respektuar hapësirat te fjalia e fundit.
Qershitë piqen në qershor.
Kopjojnë fjalinë bukur me shkronja dore.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Pyet, përgjigjet, shpreh mendimet, ndjenjat dhe emocionet e tij, si dhe diskuton në grupe të vogla për tema që i interesojnë.
- ✓ Tregon që e ka kuptuar tekstin e lexuar: *duke ritreguar shkurtimisht dhe me fjalë të thjeshta brendinë; duke përmendur çështjet kryesore; duke dhënë shembuj ose ilustrime nga teksti*
- ✓ Qarkon rrokjet me shkronjën **q** në fjalë të ndryshme.
- ✓ Dallon përdorimin e shkronjës **q** dhe **p** në fjalë të ndryshme.
- ✓ Plotëson një skedë me të dhëna personale.

Detyrë shtëpie:

1. Krijo vetë një skedë sipas modelit.
2. Formo fjali me fjalët: qumësht, përqafim, qortoj.

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1	**Klasa:** 1
Tema mësimore: Punim i shkronjës D,d/Abetare fq. 66			**Situata e të nxënit:** Ditëlindja ime

Rezultatet e të nxënit sipas **sipas kompetencave kyçe:**

Nxënësi:

(1)Kompetenca e komunikim dhe të shprehurit: paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup.

(3)Kompetenca e të nxënit: sqaron me anë të të folurit hapat e zgjidhjes së një problemi të thjeshtë, me të cilin ballafaqohet në një situatë jetësore.

(3)Kompetenca e të nxënit: ndjek udhëzimet e dhëna në një tekst për të realizuar një veprim /aktivitet /detyrë, që kërkohet.

(3)Kompetenca e të nxënit: parashtron pyetje dhe përgjigjet në pyetjet për temën /problemin/detyrën e dhënë në njërën nga format e të shprehurit.

(6)Kompetenca qytetare: shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive.

Rezultatet e të nxënit **të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:**

Nxënësi:

- Shqipton, shkruan dhe lexon tingullin dhe shkronjën D,d.
- Shkruan dhe lexon fjalë me shkronjën d dhe shkronjat e mësuara.
- Përshkruan mbi bazën e figurave.
- Formon fjali me fjalët e fjalorit.

Fjalë kyçe:

ditëlindje, festë, shokë, dhurata, Drini

Teknika dhe strategji

- Bisedë
- Analizë e sintezë
- Veprimtari në dyshe
- Veprimtari individuale

Burimet e informacionit dhe mjete:

Abetare, Abetare pune, shkronja D, d; tullumbace, pako dhuratash, magnetofon

Lidhja me fushat e tjera:

Matematikë

Shoqëria dhe mjedisi

Edukim me të drejtat e fëmijëve

Përshkrim kontekstual i situatës:

Veprimtari paraprake

Nxënësit nxiten të tregojnë për ditëlindjen e tyre. Mësuesja ndihmon me pyetjet:

- Kur e keni ditëlindjen?
- Si e prisni këtë ditë?
- Pse e prisni me gëzim?
-Si e festoni?

Veprimet në situatë:

Hapi i parë: Analizë e sintezë

Mësuesja shkruan fjalinë: *Drini po feston ditëlindjen.*

Kryhet procesi i analizës për shkëputjen e tingullit dhe shkronjës D,d:

- Sa fjalë ka fjalia?
- Cilat fjalë kanë shkronjën D?
- Sa rrokje ka fjala Drini?
- Në cilën rrokje ndodhet shkronja d?
- Po te fjala ditëlindje në cilën rrokje ndodhet?

Mësuesja ndihmon nxënësit të ndajnë fjalët në rrokje.

Ushtrohen në shqiptimin e tingullit të ri dhe theksohet se është tingull bashkëtingëllor.

Nxënësit gjejnë fjalë me shkronjën d, ndërsa mësuesja i shkruan në tabelë.

Hapi i dytë: Bisedë

Hapet libri dhe komentohet figura qëndrore. Mësuesja ndihmon me pyetjet:

-Çfarë po shikoni?

- Si është zbukuruar ambienti?
- Çfarë ka mbi tavolinë?
- Çfarë po bëjnë fëmijët?
- Si ndihen ata? Pse mendoni kështu?
- Çfarë ka të përbashkët me ditëlindjen tuaj?

Hapi i tretë: Veprimtari në dyshe

Lexohen dhe plotësohen fjalët e fjalorit me radhë nga nxënësit: *dielli, dora, dera, domatja.*

Pasi analizohen në rrokje, formohen fjali dhe shkruhen në tabelë.

Hapi i katërt: Veprimtari individuale

Nxënësit qarkojnë shkronjën D,d në fletë gazete ose libra për fëmijë.

Demonstrim i rezultateve të arritura:

Formohen fjalët ditëlindje, pasdite, paradite.

Qarkohen rrokjet që përmbajnë shkronjën d në fjalët e dhëna. **Vlerësimi i situatës:** Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi: • Shqipton, shkruan dhe lexon tingullin dhe shkronjën D,d. • Shkruan dhe lexon fjalë me shkronjën d dhe shkronjat e mësuara. • Përshkruan mbi bazën e figurave. • Formon fjali me fjalët e fjalorit.
Detyra: 1. Nga 2 rreshta me shkronjën e madhe e të vogël të shtypit D,d. 2. Shkrim fjalësh me shkronjën d. 3. Shkrim i 3 fjalive me shkronjën d.
Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1	**Klasa:** 1
Tema mësimore: Punim e shkrim i shkronjës D,d/Abetare pune fq. 47			**Situata e të nxënit:** Ditëlindja ime

***Rezultatet e të nxënit* sipas kompetencave kyçe:**
Nxënësi:
(1)Kompetenca e komunikim dhe të shprehurit: paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup.

(1)Kompetenca e komunikim dhe të shprehurit: sqaron me anë të të folurit hapat e zgjidhjes së një problemi të thjeshtë, me të cilin ballafaqohet në një situatë jetësore.

(3)Kompetenca e të nxënit: ndjek udhëzimet e dhëna në një tekst për të realizuar një veprim / aktivitet / detyrë, që kërkohet.

(3)Kompetenca e të nxënit: zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes.

(4) Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin: identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në shtëpi.

***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:**

Nxënësi:

- Shkruan shkronjën D, d të shtypit.
- Formon dhe shkruan fjalë dhe grupe fjalësh me shkronjën d dhe shkronjat e mësuara.
- Plotëson fjalitë me fjalët e dhëna.
- Ruan hapësirën midis fjalëve.

Fjalë kyçe:

ditëlindje, festë, lodra,

Teknika dhe strategji

- Punë në grup
- Punë individuale
- Veprimtari në dyshe

Burimet e informacionit dhe mjete:

Abetare pune, shkronja D, d e shtypit; fletë; materiale vizatimi; libra për fëmijë.

Lidhja me fushat e tjera:

Matematikë

Shoqëria dhe mjedisi

Edukim me të drejtat e fëmijëve

Përshkrim kontekstual i situatës:
Veprimtari paraprake

Nxënësit, duke punuar në grup, do të shkruajnë fjalë që lidhen me ditëlindjen (festë, tortë, etj).

Lexohen dhe shkruhen në tabelë, krahasohen gjetjet ndërmjet grupeve.

Mësuesja nxit sa më shumë nxënësit të flasin rreth kësaj veprimtarie.

Veprimet në situatë:
Hapi i parë: Punë në grup

Mësuesja paraqet shkronjën D,d të shtypit.

Bëhet krahasimi me shkronjat e tjera.

Ushtrohen nxënësit në shkrimin e shkronjës duke e lëvizur fillimisht dorën në ajër.

Identifikojnë shkronjën D, d në fjalët e shkruara në tabelë.

Hapi i dytë: Punë individuale

Nxënësit shkruajnë shkronjat dhe rrokjet në detyrën e parë te Abetarja e punës.

Mësuesja ndjek punën e nxënësve dhe kur bindet që e kanë shkruar shumë mire shkronjën e parë, i lë të punojnë në mënyrë të pavarur.

Hapi i tretë: Veprimtari në dyshe

Emërtohen figurat nga nxënësit, analizohen në rrokje dhe shkruhen fjalët (dimri, dielli,dardha).

Mësuesja u kërkon nxënësve të formojnë fjali me këto fjalë.

Nxënësit lidhin fjalët e dhëna sipas kuptimit dhe formojnë grupe fjalësh (kudo shkoj, ngado kërkova, kurdoherë dëshiroj, drejt shtëpisë, nderoj shokët,ndaj domaten,ndihmoj dajën,dua të dal).

Nxënësit formojnë fjali me grupet e formuara për të njohur më mirë kuptimin e tyre.

Demonstrim i rezultateve të arritura:

Formohen grupet me fjalët e dhëna (dal te dera,dua të ha etj)

Ndahen fjalët në fjalitë e dhëna dhe shkruhen si duhet.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- Shkruan shkronjën D, d të shtypit.
- Formon dhe shkruan fjalë dhe grupe fjalësh me shkronjën d dhe shkronjat e mësuara.
- Plotëson fjalitë me fjalët e dhëna.
- Ruan hapësirën midis fjalëve.

Detyra:

1. Shkrim i grupeve të fjalëve që formuan.
2. Formim i tre fjalive me to.

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1	**Klasa:** 1
Tema msimore Punim e lexim i shkronjës D,d /Abetare fq. 67		**Situata e të nxënit** Ditëlindja ime	

***Rezultatet e të nxënit* sipas kompetencave kyçe:**

Nxënësi:

(1)Kompetenca e komunikim dhe të shprehurit: lexon me zë një tekst së paku prej gjysmë faqeje të pa lexuar më parë.

(1)Kompetenca e komunikim dhe të shprehurit: shpreh mesazhin e një teksti të thjeshtë përmes të folurit.

(3)Kompetenca e të nxënit:parashtron pyetje dhe përgjigjet në pyetjet për temën në njërën nga format e të shprehurit.

4) Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin:gjen të përbashkëtat dhe ndryshimet ndërmjet aktiviteteve që kryhen në klasë dhe në shtëpi.

(6)Kompetenca qytetare: shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive.

***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:** Nxënësi: • Përshkruan figurën duke folur rrjedhshëm dhe me intonacionin e duhur. • Lexon tekstin me intonacion. • Sjell përvoja të ngjashme nga jeta.	**Fjalë kyçe:** ditëlindje,dhurata,këngë, lojëra, urime **Teknika dhe strategji** • Bisedë • Lexim me ndalesa • Punë individuale
Burimet e informacionit dhe mjete: Teksti i Abetares, mjete vizatimi, magnetofon, Cd, shkronja D, d	**Lidhja me fushat e tjera:** Matematikë, Arte, Shoqëria dhe mjedisi

Përshkrimi kontekstual i situatës:

Veprimtari paraprake

Në sfond, mësuesja vendos këngën "Shumë urime për ty".

Lihen nxënësit të këndojnë e më pas të shprehin emocionet e tyre.

- Ç'ju kujton kjo këngë?

- Si ndiheni kur këndohet për ju kjo këngë?
- Çfarë shprehim nëpërmjet kësaj kënge?
- Le ta këndojmë edhe një herë së bashku.

Veprimet në situatë:

Hapi i parë: Bisedë

Komentohet figura e tekstit. Mësuesja drejton pyetjet:

-Ç'po bëjnë fëmijët?

- Çfarë ka mbi tavolinë?
- Si ndihen fëmijët?
- Nga e kuptoni?
- Sa vjeç mbush fëmija që ka ditëlindjen?

Hapi i dytë: Lexim me ndalesa

Ndahet teksti në dy pjesë: pjesa e parë që nga fillimi deri te "…filma vizatimorë", pjesa e dytë që nga "Linda e Eranda…" deri në fund.

Lexohet pjesa e parë nga disa nxënës. Mësuesja drejton pyetje rreth përmbajtjes:

- Kush e kishte ditëlindjen?
- Kë kishte ftuar ai?
- Çfarë kishin blerë shokët e Drinit?
- Si mendoni se ndihet Drini?
- Pse mendoni kështu?

Përsëritet veprimtaria për pjesën e dytë: lexohet, drejtohen pyetje rreth përmbajtjes.

Hapi i tretë: Punë individuale

Nxënësit lexojnë tekstin në heshtje.

Demonstrim i rezultateve të arritura.

Lexohet teksti nga nxënësit me zë të lartë.

Tregohet mesazhi me anë të të folurit.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- Përshkruan figurën duke folur rrjedhshëm dhe me intonacionin e duhur.
- Lexon tekstin me intonacion.

Detyra:

1. Lexim i tekstit rrjedhshëm.
2. Ilustrim i tekstit me vizatim.

Refleksione:

<table>
<tr><td>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla: 1</td><td>Klasa: 1</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore:
Ushtrime aplikative për shkrim dore D,d/Abetare pune</td><td colspan="2">Situata e të nxënit
Ditëlindja ime</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:
Nxënësi:
(3)Kompetenca e të nxënit:ndjek udhëzimet e dhëna për të realizuar një detyrë që i kërkohet.
(3)Kompetenca e të nxënit: mbikqyr në mënyrë të pavarur përparimin e vet në një detyrë duke përdorur teknika të ndryshme për gjetjen e gabimeve dhe i korrigjon ato derisa gjen zgjidhjen.
(3)Kompetenca e të nxënit: grumbullon dhe klasifikon materialet e performancës së vet, për përgatitjen apo pasurimin e portofolit personal.
(6)Kompetenca qytetare: diskuton dhe në bashkëpunim me anëtarët e grupit vendos rregullat e punës në grup.</td></tr>
<tr><td colspan="2" rowspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:
Nxënësi:
• Modelon bukur grafikun e shkronjës së madhe dhe të vogël të dorës D, d.
• Lidh shkronjën D, d me shkronjat e tjera.
• Shkruan fjalë dhe fjali me shkronja të dorës.</td><td colspan="2">Fjalë kyçe:
ditëlindje,dhurata,këngë,
lojëra, urime</td></tr>
<tr><td colspan="2">Teknika dhe strategji:
• Punë në grup
• Analizë dhe sintezë
• Punë individuale
• Veprimtari në dyshe</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet e informacionit dhe mjete:
Abetare pune, shkronja e dorës D, d, fletore shkrimi, mjete vizatimi</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë
Arte
Edukim me të drejtat e fëmijëve</td></tr>
<tr><td colspan="4">Përshkrimi kontekstual i situatës:
Veprimtari paraprake
Në tabelë, mësuesja vendose një foto nga festimet e ditëlindjeve të nxënësve.
Nxiten nxënësit të përshkruajnë foton duke emërtuar çdo gjë që shohin.</td></tr>
</table>

Më pas shkruajnë fjalë me shkrim dore duke emërtuar objektet që shohin.

Lexohen shkruhen në tabelë dhe bëhen korrigjimet e nevojshme.

Veprimet në situatë:

Hapi i parë: Punë në grup

Mësuesja u kërkon nxënësve të lëvizin dorën që shkruajnë në ajër sipas grafikut të shkronjës D, d. duke ndjekur lëvizjen e dorës së saj.

Hapi i dytë: Analizë e sintezë

Mësuesja paraqet modelin e shkronjës së dorës D, d.

Nxënësit bëjnë krahasimin me shkronjat e tjera të mësuara ose me elemente të veçanta të tyre.

Mësuesja shkruan shkronjën në tabelë e më pas fton 2 – 3 nxënës ta shkruajnë.

Shpjegohet dhe lidhja e shkronjës me shkronjat e tjera.

Hapi i tretë: Punë individuale

Ushtrohen nxënësit në shkrimin e shkronjave në fletë të bardha me lapsa me ngjyra.

Shkruajnë sipas modelit shkronjën D,d të dorës në Abetaren e punës.

Vëzhgohen nxënësit gjatë punës dhe ndihmohen nëse kanë vështirësi.

Hapi i katërt: Veprimtari në dyshe:

Nxënësit shkruajnë shkronjë D, d në balona të parapërgatitura dhe i vendosin në këndin e punimeve.

Demonstrim i rezultateve të arritura:

Shkrim fjalësh me shkronjën e dorës D, d në fletoren individuale.

dora, dera, domate, Drini, Durrësi

Drini feston ditëlindjen.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- Modelon bukur grafikun e shkronjës së madhe dhe të vogël të dorës D, d.
- Shkruan fjalë dhe fjali me shkronja të dorës.

Detyra: 1. Shkrim nga 3 rreshta me shkronjën e madhe dhe të vogël të dorës D, d. 2. Shkrim fjalë me shkronja dore që përmbajnë D, d. 3. Shkrim i 5 fjalive me shkronja dore.
Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1	**Klasa:** 1
Tema mësimore: Punim i fq. 66- 67 të Abetares		**Situata e të nxënit:** Ditëlindja ime	
Rezultatet e të nxënit* sipas kompetencave kyçe:** Nxënësi: ***(1)Kompetenca e komunikim dhe të shprehurit: ritregon ngjarjen e një teksti të dëgjuar, përmbajtja e të cilit nuk është më shumë se një faqe teksti. ***(1)Kompetenca e komunikim dhe të shprehurit:*** shpreh mesazhin e një teksti të thjeshtë letrar përmes të folurit. ***3)Kompetenca e të nxënit:*** ndjek udhëzimet e dhëna në një tekst për të realizuar një detyrë që kërkohet. ***(4) Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin:*** gjen të përbashkëtat dhe ndryshimet ndërmjet aktiviteteve, që organizohen në shkollë me ato në shtëpi dhe i përshkruan në mënyrë individuale përmes njërës nga format e të shprehurit duke i diskutuar në grup. ***(5)Kompetenca personale:*** bashkëpunon me të tjerët pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitetet në klasë, shkollë apo jashtë saj.			
***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:**		**Fjalë kyçe:** ditëlindje, dhurata, lojëra,torte, shokë	

Nxënësi: • Lexon tekstin me intonacionin e duhur. • U përgjigjet pyetjeve që lidhen me përmbajtjen e tekstit. • Formon e shkruan fjali me fjalët e dhëna. • Ruan hapësirat midis fjalëve.	**Teknika dhe strategji:** • Pyetja sjell pyetjen • Punë individuale • Veprimtari në dyshe
Burimet e informacionit dhe mjete: Teksti i Abetares, shkronja ilustruese, mjete vizatimi, foto nga festimet e ditëlindjeve, libra për fëmijë.	**Lidhja me fushat e tjera:** Matematikë Arte Edukim me të drejtat e fëmijëve

Përshkrimi kontekstual i situatës:

Veprimtari paraprake

Nxiten nxënësit të diskutojnë me anë të pyetjes:

- Çfarë ndodh në ditëlindjen tuaj?

Ndihmohen me pyetjet:

- Si përgatiteni një ditë para?
- Çfarë bëni kur vijnë shokët?
- Cili është moment më i bukur? Pse? (Ilustrohet biseda me foto të nxënësve.)

Veprimet në situatë:

Hapi i parë: Pyetja sjell pyetjen

Pyetje rreth tekstit:

- Kush e kishte ditëlindjen?
- Çfarë i blenë shokët?
- Çfarë bëri Linda? Po Eranda?
- Cili mendoni se ishte moment më i bukur?
- Pse mendoni kështu?

Hapi i dytë: Punë individuale

Lexim i tekstit nga nxënësit me pjesë. Tërheq vëmendjen në respektimin e shenjave të pikësimit.

Hapi i tretë: Veprimtari në dyshe

Punim i ushtrimeve në tekst duke bashkëpunuar në dyshe. Ndihmohen për detyrat që kanë vështirësi.

Tërhiqet vëmendja te përdorimi i saktë i shkronjave b dhe d (dora, dara, dera, bora).

Ilustrim i situatës së ditëlindjes me vizatim.

Demonstrim i rezultateve të arritura:

Lexim i tekstit me intonacion.

Shkrim i fjalive të formuara.

Unë kam disa shokë.

Dikush trokiti në derë.

Prita derisa mbaroi.

Vlerësimi i situatës :

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- Lexon tekstin me intonacionin e duhur.
- U përgjigjet pyetjeve që lidhen me përmbajtjen e tekstit.
- Formon e shkruan fjali me fjalët e dhëna.
- Ruan hapësirat midis fjalëve.

Detyra:

1. Lexim rrjedhshëm i tekstit.
2. Ritregim i tekstit.
3. Shkrim i pjesës që pëlqen.

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1	**Klasa:** 1
Tema mësimore: Punim i tingullit dhe shkronjës Dh,dh/Abetare fq. 68			**Situata e të nxënit:** Te dentistja

***Rezultatet e të nxënit* sipas kompetencave kyçe:**

Nxënësi:

(1)Kompetenca e komunikim dhe të shprehurit: paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup.

(1)Kompetenca e komunikim dhe të shprehurit: sqaron me anë të të folurit hapat e zgjidhjes së një problemi të thjeshtë, me të cilin ballafaqohet në një situatë jetësore.

(3)Kompetenca e të nxënit: ndjek udhëzimet e dhëna në një tekst për të realizuar një veprim / aktivitet / detyrë, që kërkohet.

(3)Kompetenca e të nxënit: parashtron pyetje dhe përgjigjet në pyetjet për temën /problemin/ detyrën e dhënë në njërën nga format e të shprehurit.

(6)Kompetenca qytetare: shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive.

***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:**

Nxënësi:

- Shqipton, shkruan dhe lexon tingullin dhe shkronjën Dh,dh.
- Shkruan dhe lexon fjalë me shkronjën dh dhe shkronjat e mësuara.
- Përshkruan mbi bazën e figurave duke folur rrjedhshëm, qartë.
- Lexon globalisht fjalët në Abetare.
- Formon fjali me fjalët e fjalorit.

Fjalë kyçe:

dentiste, dhëmb, Bardhi, dhemb

Teknika dhe strategji:

- Analizë e sintezë
- Bashkëbisedim
- Veprimtari në dyshe
- Punë individuale

Burimet e informacionit dhe mjete:

Abetare, shkronja Dh,dh; etiketa me fjalët e fjalorit;foto , postera ku tregohet kujdesi për dhëmbët, furç, dhëmbësh, pastë.

Lidhja me fushat e tjera:

Matematikë
Edukim me të drejtat e fëmijëve
Edukim shëndetësor

Përshkrim kontekstual i situatës:

Veprimtari paraprake

Nxënësit nxiten të emërtojnë objektet mbi tavolinë(furçë dhëmbësh, pastë).

-Përse përdoren? Kur i lani dhëmbët? Si i lani? (veprohet konkretisht me lëvizjen e dorës ose me larje të plotë nga 2-3 nxënës). Pse duhet t'i lajmë? Ç'ndodh kur nuk i lajmë? Si quhet mjeku që na mjekon dhëmbët? Si ndieni kur shkoni te dentist?

Veprimet në situatë:

Rezultatet e të nxënit Analizë e sintezë

Mësuesja shkruan në tabelë fjalinë: *Bardhit i dhemb dhëmbi.*

Kryhet procesi i analizës për shkëputjen e tingullit dhe shkronjës dh: Sa fjalë ka fjalia? Cila është fjala e parë? Po e dyta? E treta? Ku ndodhet shkronja dh në fjalën e parë? Po në fjalët e tjera?

Çohen 2 – 3 nxënës dhe qarkojnë shkronjën dh.

Ushtrohen në shqiptimin e tingullit të ri dhe theksohet se është tingull bashkëtingëllor.

Nxënësit gjejnë fjalë me shkronjën dh në fillim, në mes dhe në fund.

Hapi i dytë: Bashkëbisedim

Hapet libri dhe komentohet figura qendrore.

- Çfarë shikoni?

- Si ndihet Bardhi?

- Nga e kuptoni?

- Ku po shkon ai?

Hapi i tretë: Veprimtari në dyshe

Lexohen dhe plotësohen fjalët e fjalorit me radhë nga nxënësit:dhëmbi,dhjeta,dhia,dhurata.

Pasi analizohen në rrokje, formohen fjali dhe shkruhen në tabelë. Nxënësit qarkojnë shkronjën dh dhe tregojnë pozicionin e saj (në fillim, në mes, në fund).

Hapi i katërt: Punë individuale

Nxënësit vizatojnë një ose dy figura që përmbajnë shkronjën dh dhe e vendosin në portofolin e tyre.

Demonstrim i rezultateve të arritura:

Formohen fjali me fjalët e dhëna.

Qarkohen rrokjet që përmbajnë shkronjën dh në fjalët e dhëna.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- Shqipton, shkruan dhe lexon tingullin dhe shkronjën Dh, dh.
- Shkruan dhe lexon fjalë me shkronjën dh, dhe shkronjat e mësuara.
- Përshkruan mbi bazën e figurave.
- Lexon globalisht fjalët në Abetare.
- Formon fjali me fjalët e fjalorit.

Detyra:

1. Nga 2 rreshta me shkronjën e madhe e të vogël të shtypit Dh,dh.
2. Shkrim i fjalëve të fjalorit.
3. Shkrim i fjalive me to.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1	**Klasa:** 1
Tema mësimore Punim e shkrim i shkronjës Dh, dh/Abetare pune		**Situata e të nxënit:** Te dentistja	

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:

Nxënësi:

(1)Kompetenca e komunikim dhe të shprehurit: sqaron me anë të të folurit hapat e zgjidhjes së një problemi të thjeshtë, me të cilin ballafaqohet në një situatë jetësore.

K.3 ndjek udhëzimet e dhëna në një tekst për të realizuar një veprim / aktivitet / detyrë, që kërkohet.

K.3 zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes.

K.4 identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në shtëpi.

Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: • Shkruan shkronjën Dh, dh të shtypit. • Formon dhe shkruan fjalë dhe grupe fjalësh me shkronjën dh dhe shkronjat e mësuara. • Lexon dhe shkruan fjalinë e dhënë. • Ruan hapësirën midis fjalëve.	**Fjalë kyçe:** dentiste, dhëmb, dhemb, Bardhit **Teknika dhe strategji** • Analizë e sintezë • Punë individuale • Veprimtari në dyshe
Burimet e informacionit dhe mjete: Abetare pune, shkronjat Dh, dh; etiketa me fjalët kyçe.	**Lidhja me fushat e tjera:** Matematikë Edukim shëndetësor Edukim me të drejtat e fëmijëve

Përshkrimi kontekstual i situatës:

Veprimtari paraprake

Mësuesja paraqet etiketat e fjalëve dhëmb, dhemb, Bardhi, dentiste.

Nxënësit renditin etiketat për të formuar fjalinë: *Bardhit i dhemb dhëmbi*.

-Ç'lidhje ka dentisti me këtë fjali?

Nxënësit flasin për kontrollin që bëjnë te dentistja.

Veprimet në situatë:

Hapi i parë: Analizë e sintezë

Mësuesja paraqet shkronjën Dh, dh. Bëhet krahasimi me shkronjat e tjera.(Dh me D; dh me d).

Ushtrohen në shkrimin e shkronjës dhe identifikimin e saj në fjalët e shkruara në tabelë.

Hapi i dytë: Punë individuale

Nxënësit shkruajnë shkronjat dhe rrokjet në detyrën e parë.

Mësuesja ndjek nga afër punën e nxënësve dhe kur bindet që po shkruajnë mirë i lë të vazhdojnë në mënyrë të pavarur.

Emërtohen figurat, analizohen në rrokje dhe shkruhen fjalët (dhurata, kërpudha, dhelpra).

Hapi i tretë: Veprimtari në dyshe:

Nxënësit lidhin fjalët e dhëna sipas kuptimit dhe formojnë grupe fjalësh (dha provim, lodhem shumë, lidh fjongon, dhuroj dhurata, urdhëroj fëmijët,shurdhoi veshët).

Me grupet e formuara nxënësit formojnë gojarisht edhe fjali.

Demonstrim i rezultateve të arritura:

Formohen fjalët duke lidhur me shigjetë:

hekurudhë, luleshtrydhe, borëbardha, udhëtar

Lexohet dhe shkruhet si duhet fjalia: Dhjetori është muaji i dhuratave.

Vlerësimi i situatës:
Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- Shkruan shkronjën Dh,dh të shtypit.
- Formon dhe shkruan fjalë dhe grupe fjalësh me shkronjën dh dhe shkronjat e mësuara.
- Lexon dhe shkruan fjalinë e dhënë.
- Ruan hapësirën midis fjalëve.

Detyra:

1. Shkrim i grupeve të fjalëve që formuan.
2. Formim i tre fjalive me to.

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1	**Klasa:** 1
Tema mësimore: Punim e lexim i shkronjës Dh,dh /Abetare fq. 69		**Situata e të nxënit:** Te dentistja	
Rezultatet e të nxënit* sipas kompetencave kyçe:** Nxënësi: ***(1)Kompetenca e komunikim dhe të shprehurit: lexon me zë një tekst së paku prej gjysmë faqeje të pa lexuar më parë. ***(1)Kompetenca e komunikim dhe të shprehurit:*** shpreh mesazhin e një teksti të thjeshtë përmes të folurit. ***(3)Kompetenca e të nxënit:*** parashtron pyetje dhe përgjigjet në pyetjet për temën në njërën nga format e të shprehurit. ***(6)Kompetenca qytetare:*** shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive.			
***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:** Nxënësi: • Përshkruan figurën duke folur rrjedhshëm dhe me intonacionin e duhur. • Lexon tekstin me intonacion. • Sjell përvoja të ngjashme nga jeta.		**Fjalë kyçe:** dentiste, dhëmb, dhemb, këshilla **Strategji dhe teknika:** • Bashkëbisedim • Lexim me ndalesa • Punë individuale	
Burimet e informacionit dhe mjete: Teksti i Abetares, mjete vizatimi, postera me kujdesin ndaj dhëmbëve, furçë dhëmbësh, pastë.		**Lidhja me fushat e tjera:** Matematikë Arte Edukim shëndetësor Edukim me të drejtat e fëmijëve	
Përshkrimi kontekstual i situatës: ***Veprimtari paraprake*** Mësuesja në tabelë vendos postera me kujdesin ndaj dhëmbëve. Nxiten nxënësit të flasin rreth tyre: -Çfarë paraqesin? Ku i keni parë këto postera? Çfarë ju vjen në mend kur i shihni?etj.			

Veprimet në situatë:

Hapi i parë: Bashkëbisedim

Komentohet figura e tekstit:

- Çfarë paraqitet në foto? Çfarë po bën dentistja? Pse ka vendosur maskë te goja? Çfarë doni të dini për foton më shumë?

Hapi i dytë: Lexim me ndalesa

Ndahet teksti në tre pjesë: pjesa e parë që nga fillimi deri te "…duhej mjekuar", pjesa e dytë që nga "Bardhi nisi të qante… deri… ajo i bëri një gjilpërë"dhe pjesa e tretë që nga "dentistja i dha …" deri në fund.

Lexohet pjesa e parë nga disa nxënës. Mësuesja drejton pyetjet rreth përmbajtjes:

- Çfarë kishte Bardhi?

- Pse i dhembte dhëmbi?

- Pse nisi të qante sa pa dentisten?

- Ajo ka ndodhur ndonjëherë juve kështu si Bardhit?

Përsëritet veprimtaria për pjesën e dytë dhe të tretë: lexohet, drejtohen pyetje rreth përmbajtjes.

Hapi i tretë: Punë individuale

Lexohet teksti në heshtje.

Mësuesja u kërkon nxënësve të lexojnë vetëm fjalët që përmbajnë shkronjën dh.

Demonstrim i rezultateve të arritura:

Lexohet teksti nga nxënësit me zë të lartë.

Tregohet mesazhi me anë të të folurit.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- Përshkruan figurën duke folur rrjedhshëm dhe me intonacionin e duhur.
- Lexon tekstin me intonacion.

Detyra:

1. Lexim i tekstit rrjedhshëm.
2. Shkrim i këshillave të dentistes.

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1	**Klasa:** 1
Tema mësimore: Ushtrime aplikative për shkrim dore Dh,dh/Abetare pune		**Situata e të nxënit:** Te dentistja	

***Rezultatet e të nxënit* sipas kompetencave kyçe:**

Nxënësi:

(3)Kompetenca e të nxënit: ndjek udhëzimet e dhëna për të realizuar një detyrë që i kërkohet.

(3)Kompetenca e të nxënit: mbikëqyr në mënyrë të pavarur përparimin e vet në një detyrë duke përdorur teknika të ndryshme për gjetjen e gabimeve dhe i korrigjon ato derisa gjen zgjidhjen.

(3)Kompetenca e të nxënit:grumbullon dhe klasifikon materialet e performancës së vet, për përgatitjen apo pasurimin e portofolit personal.

(6)Kompetenca qytetare:diskuton dhe në bashkëpunim me anëtarët e grupit vendos rregullat e punës në grup.

***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:**

Nxënësi:

- Modelon bukur grafikun e shkronjës së madhe dhe të vogël të dorës Dh, dh.
- Lidh shkronjën Dh, dh me shkronjat e tjera.
- Shkruan fjalë dhe fjali me shkronja të dorës.

Fjalë kyçe:

dhëmbi, dhemb, dhimbje

Strategji dhe teknika:

- Analizë e sintezë
- Punë individuale
- Veprimtari në dyshe

Burimet e informacionit dhe mjete:

Abetare pune, shkronja e dorës Dh, dh, fletore shkrimi, mjete vizatimi

Lidhja me fushat e tjera:

Matematikë
Arte
Edukim me të drejtat e fëmijëve

Përshkrimi kontekstual i situatës:

Veprimtari paraprake

Mësuesja shkruan në tabelë paraprakisht këshillat që dentistja i dha Bardhit.

Nxënësit i lexojnë dhe japin argumentet e tyre për secilën.

Për çdo këshillë tregojnë si e zbatojnë ata vetë.

Veprimet në situatë:

Hapi i parë: Analizë e sintezë

Mësuesja paraqet modelin e shkronjës së dorës Dh,dh. Bëhet krahasimi i tyre me shkronjat e tjera(d,h)

Nxënësit ngrenë dorën në ajër dhe lëvizin nën drejtimin e mësueses sipas modelit të shkronjës së dorës Dh,dh.

Shkruhet shkronja e re në tabelë nga mësuesja dhe nga 2-3 nxënës

Ushtrohen në shkrimin e shkronjave në fletë të bardha me lapsa me ngjyra.

Hapi i dytë: Punë individuale

Nxënësit shkruajnë sipas modelit shkronjën Dh, dh të dorës në Abetaren e punës.

Vëzhgohen nxënësit gjatë punës dhe ndihmohen nëse kanë vështirësi.

Mësuesja ndjek punën dhe vetëm kur bindet se po e shkruajnë si duhet i lë të punojnë në mënyrë të pavarur.

Hapi i tretë: Veprimtari në dyshe

Nxënësit shkruajnë shkronjën Dh, dh në shabllone të përgatitura nga mësuesja dhe i vendosin në këndin e punimeve.

Demonstrim i rezultateve të arritura:

Shkrim fjalësh me shkronjën e dorës Dh, dh në fletoren individuale:

dhëmbi, dhia, dhjeta, dhurata, dardha

Dhia na jep qumësht.

Vlerësimi i situatës:
Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- Modelon bukur grafikun e shkronjës së madhe dhe të vogël të dorës Dh,dh.
- Shkruan fjalë dhe fjali me shkronja të dorës.

Detyra:

1. Shkrim nga 3 rreshta me shkronjën e madhe dhe të vogël të dorës Dh,dh.
2. Shkrim fjalë me shkronja dore që përmbajnë Dh, dh.
3. Shkrim i 5 fjalive me shkronja dore.

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1	**Klasa:** 1
Tema mësimore: Punim i fq. 68- 69 të Abetares. Bardhi te dentistja		**Situata e të nxënit:** Te dentistja	

***Rezultatet e të nxënit* sipas kompetencave kyçe:**

Nxënësi:

(1)Kompetenca e komunikim dhe të shprehurit: ritregon ngjarjen e një teksti të dëgjuar, përmbajtja e të cilit nuk është më shumë se një faqe teksti.

(1)Kompetenca e komunikim dhe të shprehurit: shpreh mesazhin e një teksti të thjeshtë letrar përmes të folurit.

(3)Kompetenca e të nxënit: ndjek udhëzimet e dhëna në një tekst për të realizuar një detyrë që kërkohet.

(5)Kompetenca personale: bashkëpunon me të tjerët pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitetet në klasë, shkollë apo jashtë saj.

***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:**

Nxënësi:

- Lexon tekstin me intonacionin e duhur.
- U përgjigjet pyetjeve që lidhen me përmbajtjen e tekstit.
- Shkruan fjalë dhe fjali me shkronjat e mësuara, të shtypit dhe të dorës.
- Ruan hapësirat midis fjalëve.

Fjalë kyçe:

dentiste, dhëmb, dhemb, Bardhi

Strategji dhe teknika:

- Pyetja sjell pyetjen
- Punë individuale
- Veprimtari në dyshe
- Rrjeti i diskutimit

Burimet e informacionit dhe mjete:

Teksti i Abetares, shkronja ilustruese, mjete vizatimi, libra për fëmijë.

Lidhja me fushat e tjera:

Matematikë, Arte,

Edukim me të drejtat e fëmijëve,

Edukim shëndetësor

Përshkrimi kontekstual i situatës:

Veprimtari paraprake

Zhvillohet një bisedë me dentisten e shkollës për kujdesin që duhet të tregojnë nxënësit për dhëmbët.

Nxiten nxënësit të bëjnë pyetje.

Veprimet në situatë:

Hapi i parë: Pyetja sjell pyetjen

Pyetje rreth tekstit: A e dini sa dhëmbë kemi në gojë? Sa kemi lart? Sa kemi poshtë? Pse shkoi Bardhi te dentistja? Çfarë bëri dentistja? Pse qau ai? Si iu duket ky veprim i Bardhit? Po ju si do të vepronit po të ishit në vend të tij? Cilat këshilla lexoi Bardhi?

Hapi i dytë: Punë individuale

-Lexim i tekstit me zë nga nxënësit. Tërheq vëmendjen në respektimin e shenjave të pikësimit.

Hapi i tretë: Veprimtari në dyshe

Punim i ushtrimeve në tekst duke bashkëpunuar në dyshe. Ndihmohen për detyrat që kanë vështirësi.

llëmbi apo dhëmbi?

llampa apo llamba?

Shkruajnë këshillat duke përdorur ngjyra të ndryshme.

Hapi i katërt: Rrjeti i diskutimit

Zhvillohet një diskutim me nxënësit rreth pyetjes: *A duhet të shkojnë fëmijët te dentistja? Pse?*

Nxiten nxënësit të argumentojnë përgjigjet.

Mësuesja përmbledh përgjigjet e nxënësve dhe këshillon nxënësit të kontrollojnë rregullisht dhëmbët te dentistja dhe të kujdesen për ta.

Demonstrim i rezultateve të arritura:

Lexim i tekstit me intonacion.

Shkrim i fjalisë me shkrim shtypi dhe dore duke ruajtur hapësirat mes fjalëve:

Dhurata kujdeset për dhëmbët.

Vlerësimi i situatës:

- Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:
- Lexon tekstin me intonacionin e duhur.
- U përgjigjet pyetjeve që lidhen me përmbajtjen e tekstit.
- Shkruan fjali me shkronjat e shtypit dhe të dorës.
- Ruan hapësirat midis fjalëve.

Detyra:

1. Lexim rrjedhshëm i tekstit.
2. Ritregim i tekstit.
3. Shkrim i pjesës që pëlqen.

Refleksione:

<table>
<tr><td>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla: 1</td><td>Klasa: 1</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore:
Punim i faqes 48 Abetare pune</td><td colspan="2">Situata e të nxënit:
Luaj me shkronjat</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:
Nxënësi:
(3)Kompetenca e të nxënit: ndjek udhëzimet e dhëna në një tekst për të realizuar një veprim / aktivitet / detyrë, që kërkohet.
(3)Kompetenca e të nxënit: zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes.
(4) Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin: identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në shtëpi.
(5)Kompetenca personale: bashkëpunon me të tjerët pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitetet në klasë, shkollë apo jashtë saj.</td></tr>
<tr><td colspan="2" rowspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:
Nxënësi:
• Shkruan shkronjat rr,j,v,q,d,dh të shtypit e të dorës.
• Formon dhe shkruan fjalë me rrokjet e dhëna.
• Plotëson dhe shkruan fjalinë e dhënë me shkrim dore.
• Ruan hapësirën midis fjalëve.</td><td colspan="2">Fjalë kyçe:
shkronjë, fjalë, fjali</td></tr>
<tr><td colspan="2">Strategji dhe teknika:
• Punë në grup
• Punë individuale
• Veprimtari në dyshe</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet e informacionit dhe mjete:
Abetare pune, shkronjat rr,j,q,v,d, dh; etiketa me fjalë që plotësojnë fjalitë e dhëna</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë
Edukim me të drejtat e fëmijëve</td></tr>
<tr><td colspan="4">Përshkrimi kontekstual i situatës:
Veprimtari paraprake
Paraqes shkronjat rr, j,q,v,d,dh në tabelë dhe nxiten nxënësit t’i shqiptojnë.
Vendosen figura të ndryshme në tavolinat e nxënësve dhe lihen të identifikojnë ato që kanë shkronjat e mësipërme.</td></tr>
</table>

Mësuesja shpërndan shkronja lëvizore në çdo tavolinë dhe nxit nxënësit të formojnë fjali me to. Lexohen fjalët e formuara.

Veprimet në situatë:

Hapi i parë: Punë në grup

Veprimtari me rrokje : vendosen rrokje të ndryshme në tabelë dhe lihen nxënësit të formojnë fjalë me to.

Fjalët shkruhen në etiketa me shkrim dore dhe vendosen në një vend të dukshëm në klasë.

Nxiten nxënësit të lexojnë fjalët e dhëna.

Hapi i dytë: Veprimtari në dyshe:

Nxënësit punojnë të pavarur për plotësimin e detyrave në fletoren e punës fq.48 dhe kontrollojnë në dyshe.

Plotësohen fjalët me rrokjet që duhen: rrota, lejleku, vapori, qukapiku, akullore, dielli.

Formohen dhe shkruhen fjalët: rripi, qeni, janari, , llokume, vapa, dita.

Shkruhen dhe lexohen fjalët: qumësht, shpendi.

Plotësohen fjalitë me shkrim dore:

Unë quhem…

Unë jam…vjeç.

Mua më pëlqen…

Unë rri…

Hapi i tretë: Punë individuale

Shkruajnë sipas niveleve në fletoren individuale:

Niveli i parë: fjalët e ushtrimit të parë nga Abetarja e punës

Niveli i dytë: shkruajnë nga dy fjalë me shkronjat: rr, q, j, v, d,dh.

Niveli i tretë: shkruan tre fjali me këto shkronja.

Demonstrim i rezultateve të arritura:

Emërtojnë figurat e dhëna.

Shkruajnë fjalë me shkronjat e mësuara.

Vlerësimi i situatës:
Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- Shkruan shkronjat rr, j, v, q, d, dh të shtypit e të dorës.
- Formon dhe shkruan fjalë me rrokjet e dhëna.
- Plotëson dhe shkruan fjalinë e dhënë me shkrim dore.
- Ruan hapësirën midis fjalëve.

Detyra:

1. Shkrim fjalësh me shkronjat e mësuara.

2. Formim fjalish me shkronjat e mësuara.
Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1	**Klasa:** 1
Tema mësimore: Punim i faqes 70 të Abetares		**Situata e të nxënit:** Luaj me shkronjat	
Rezultatet e të nxënit* sipas kompetencave kyçe:** Nxënësi: ***(1)Kompetenca e komunikim dhe të shprehurit: paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup. ***(3)Kompetenca e të nxënit:*** zgjidh në mënyrë të pavarur detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes. ***(3)Kompetenca e të nxënit:*** ndjek udhëzimet e dhëna në një tekst për të realizuar një detyrë që kërkohet. ***(3)Kompetenca e të nxënit:*** grumbullon dhe klasifikon materialet e performancës së vet, për përgatitjen apo pasurimin e portofolit personal. ***(4) Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin:*** identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre në klasë. ***(5)Kompetenca personale:*** bashkëpunon me të tjerët pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitetet në klasë. ***(6)Kompetenca qytetare:*** vendos duke bashkëpunuar me të gjithë anëtarët për mënyrat që çojnë drejt përfundimit të një aktiviteti të caktuar.			
***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës** mësimore: Nxënësi: • Shkruan fjalë me shkronjat e mësuara. • Rendit fjalët në një fjali me 3-4 fjalë. • Ruan hapësirat midis fjalëve. • Përdor shkronjën e madhe në fillim të fjalisë.		**Fjalë kyçe:** fjalë, shkronjë, fjali **Strategji dhe teknika:** • Punë në grup • Bashkëbisedim • Punë individuale	
Burimet e informacionit dhe mjete: Teksti i Abetares, shkronja ilustruese shtypi e dore, mjete vizatimi, libra për fëmijë		**Lidhja me fushat e tjera:** Matematikë Arte	
Përshkrimi kontekstual i situatës: ***Veprimtari paraprake*** Mësuesja u tregon nxënësve përrallëzën: "Një ditë prej ditësh, shkronjat u mblodhën në një festë të bukur.Midis shkronjave të tjera ishin edhe shkronjat rr, j, v, q, d, dh. Mbasi luajtën me shkronjat e tjera, ato morën lapsin dhe shkruajtën fjalë që përmbanin këto shkronja. Por, fjalët nuk po ju kujtoheshin". - Si thoni, a mund t'i ndihmojmë ne me disa fjalë?			

- Le të nisim atëherë.

Veprimet në situatë:

Hapi i parë: Punë në grupe:

Secilit nxënës i jepet një nga shkronjat e mësipërme dhe shkruan fjalë me të. Më pas sipas grupeve i ngjitin në fletë kartoni ku janë shkruar të zbukuruara shkronjat rr, j, v, q, d, dh.

Mësuesja ndjek punën e nxënësve në çdo tavolinë.

Prezantohen punët nga nxënësit duke lexuar fjalët e shkruara.

Hapi i dytë: Bashkëbisedim

Sa fjalë keni shkruar ? Gjeni numrin e saktë.

Nxënësit lihen të numërojnë fjalët e shkruara.

Hapi i tretë: Punë individuale

Nxënësit punojnë në tekst për të plotësuar ushtrimet e dhëna:

Qarkojnë shkronjat e dhëna në fjalët përkatëse.

Emërto figurat dhe shkruhen fjalët: *rroba, jelek, violinë, qukapik, domate, dhuratë.*

Renditen fjalët në fjali dhe shkruhen si duhet: *Dorina luan me violinë. Jetmiri punon me kompjuter. Valoni vrapon me qenin.*

Demonstrim i rezultateve të arritura:

Shkrim i fjalëve me shkronjat e mësuara të dorës

Renditje e fjalëve në fjali dhe shkrim i fjalive

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- Shkruan saktë fjalë me shkronjat e mësuara.
- Rendit fjalët në një fjali me 3-4 fjalë.
- Shkruan si duhet fjalinë.

Detyra:

1. Shkruajnë fjalë me shkrim dore.
2. Shkruajnë fjali me figurat e dhëna në tekst.
3. Qarkojnë shkronjat e mësuar në fletë gazete.

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1	**Klasa:** 1
Tema mësimore: Punim i faqes 71 të Abetares			**Situata e të nxënit:** Viti i Ri
Rezultatet e të nxënit* sipas kompetencave kyçe:** Nxënësi: ***(1)Kompetenca e komunikim dhe të shprehurit: paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup. ***(1)Kompetenca e komunikim dhe të shprehurit:*** sqaron me anë të të folurit hapat e zgjidhjes së një problemi të thjeshtë, me të cilin ballafaqohet në një situatë jetësore. ***(3)Kompetenca e të nxënit:*** ndjek udhëzimet e dhëna në një tekst për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë, që kërkohet. ***(3)Kompetenca e të nxënit:*** parashtron pyetje dhe përgjigjet në pyetjet për temën /problemin/detyrën e dhënë në njërën nga format e të shprehurit. ***(6)Kompetenca qytetare:*** shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive.			
***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:** Nxënësi: • Përshkruan figurën duke folur rrjedhshëm e me intonacion. • Lexon tekstin me intonacionin e duhur. • U përgjigjet pyetjeve që lidhen me përmbajtjen e tekstit.			**Fjalë kyçe:** dhurata, festë, urime, fëmijë,Viti i Ri **Strategji dhe teknika:** • Parashikim mbi bazën e fotos • Lexim me ndalesa • Punë individuale
Burimet e informacionit dhe mjete: Abetare, shkronja lëvizore, foto , ngjyra			**Lidhja me fushat e tjera:** Matematikë Edukim me të drejtat e fëmijëve Art
Përshkrim kontekstual i situatës: ***Veprimtari paraprake*** Më parë nxënësit janë porositur të sjellin foto nga festimi i Vitit të Ri në familjet e tyre. Nxiten nxënësit të përshkruajnë atmosferën e kësaj feste në familje.			

Ndihmohen me pyetjet:

-Kur festohet Viti i Ri? Çfarë tregon kjo festë? Ku e festoni ju? Me kë e festoni? Pse është festë e veçantë? Çfarë u pëlqen më shumë në këtë festë?

Veprimet në situatë:

Hapi i parë: Parashikim mbi bazën e fotos

Hapet libri dhe komentohet figura qendrore.

Nxiten nxënësit të parashikojnë ngjarjen mbi bazën e figurave.

Dëgjohen 3- 4 nxënës.

Hapi i dytë: Lexim me ndalesa

Lexohet teksti duke e ndarë me pjesë dhe duke e shoqëruar me pyetje rreth përmbajtjes:

-Pse plaku u Vitit të Ri shkoi në shitore?

-Ç'bëri ai kur erdhi Viti i Ri?

-Pse u kënaqën fëmijët?

-Si do të ndiheshit ju?

Hapi i tretë: Punë individuale

Lexim i tekstit nga nxënësit me radhë.

Demonstrim i rezultateve të arritura:

Lexim i tekstit me intonacion nga nxënësit.

Përgjigje e pyetjeve rreth përmbajtjes.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- Përshkruan figurën duke folur rrjedhshëm e me intonacion.
- Lexon tekstin me intonacionin e duhur.
- U përgjigjet pyetjeve që lidhen me përmbajtjen e tekstit.

Detyra:

1. Lexim i tekstit rrjedhshëm.
2. Shkrim i pjesës që u pëlqen.

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1	**Klasa:** 1
Tema mësimore: Veprimtari shkrimi (diktim)		**Situata e të nxënit:** Luaj me shkronjat	

***Rezultatet e të nxënit* sipas kompetencave kyçe:**

Nxënësi:

(3)Kompetenca e të nxënit: ndjek udhëzimet e dhëna për të realizuar një detyrë që i kërkohet.

(3)Kompetenca e të nxënit: mbikëqyr në mënyrë të pavarur përparimin e vet në një detyrë duke përdorur teknika të ndryshme për gjetjen e gabimeve dhe i korrigjon ato derisa gjen zgjidhjen.

(3)Kompetenca e të nxënit: grumbullon dhe klasifikon materialet e performancës së vet, për përgatitjen apo pasurimin e portofolit personal.

(6)Kompetenca qytetare: diskuton dhe në bashkëpunim me anëtarët e grupit vendos rregullat e punës në grup.

***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:**

Nxënësi:

- Modelon bukur grafikët e shkronjave të mëdha dhe të vogla të dorës që ka mësuar deri tani.
- Lidh shkronjat me njëra-tjetrën në fjalë.
- Shkruan fjalë dhe fjali me shkronjat e dorës me të diktuar.
- Ruan hapësirat midis fjalëve.
- Përdor shkronjën e madhe në fillim të fjalisë dhe pikën në fund të saj.

Fjalë kyçe:

shkronjë, fjalë, rrokje, fjali

Strategji dhe teknika:

- Stuhi mendimi
- Veprimtari në dyshe
- Punë individuale

Burimet e informacionit dhe mjete:

Shkronjat e dorës, fletore shkrimi, mjete vizatimi

Lidhja me fushat e tjera:

Matematikë
Arte
Edukim me të drejtat e fëmijëve

Përshkrimi kontekstual i situatës:

Veprimtari paraprake

Përsëritin korazi shkronjat e alfabetit nga tabela.
Mësuesja organizon lojëra të ndryshme me nxënësit duke përdorur shkronjat e dorës:
Një nxënës lëviz dorën në ajër sipas modelit të një shkronje dore, të madhe ose të vogël, ndërsa nxënësit e tjerë gjejnë cila shkronjë është.

Veprimet në situatë:

Hapi i parë: Stuhi mendimi

Mësuesja paraqet modelet e disa shkronjave të dorës dhe nxit nxënësit të gjejnë fjalë që kanë në trup të tyre këtë shkronjë .

Fjalët e gjetura shkruhen nga nxënës të ndryshëm në tabelë. Mësuesja tregon kujdes në lidhjen e saktë të shkronjave me njëra-tjetrën.

Hapi i dytë: Veprimtari në dyshe

Mësuesja u shpërndan nxënësve etiketa me fjalë të shkruara me shkrim dore të cilave u mungojnë rrokje. Nxënësit, duke punuar në dyshe, do të gjejnë rrokjen që mungon dhe do të shkruajnë fjalët të plota.

(rroba, qukapiku, dhelpra, dhuratë, vjeshta, qeni, domate, kokrra, boja etj.).

Hapi i tretë: Punë individuale

Nxënësit shkruajnë në fletoren individuale me të diktuar fjalët dhe fjalitë:

jaka, dimri, topi, qershor, dhomë, dardhë, qukapiku, vapor, vjeshta, pranvera, kokrra, rroba,

janar, java, tava, kova, qoshe, qepë,domate, dritare.

Pranvera është stina e luleve.

Dhelpra është kafshë dinake.

Qukapiku mbron pemët.

Demonstrim i rezultateve të arritura:

Shkrim i fjalëve dhe fjalive me shkrim dore me të diktuar.

Vlerësimi i situatës :
Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- Modelon bukur grafikët e shkronjave të mëdha dhe të vogla të dorës që ka mësuar deri tani.
- Lidh shkronjat me njëra-tjetrën në fjalë.
- Shkruan fjalë dhe fjali me shkronjat e dorës me të diktuar.
- Ruan hapësirat midis fjalëve.
- Përdor shkronjën e madhe në fillim të fjalisë dhe pikën në fund të saj.

Detyra:

1. Vetëdiktim me shkronjat e mësuara.

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1	**Klasa:** 1
Tema mësimore: Përforcim i shkronjave të mësuara.		**Situata e të nxënit:** Dhuratat	

***Rezultatet e të nxënit* sipas kompetencave kyçe:**

Nxënësi:

(1)Kompetenca e komunikim dhe të shprehurit: paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup.

(3)Kompetenca e të nxënit: zgjidh në mënyrë të pavarur detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes.

(3)Kompetenca e të nxënit: grumbullon dhe klasifikon materialet e performancës së vet, për përgatitjen apo pasurimin e portofolit personal.

(4) Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin: identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre në klasë.

(5)Kompetenca personale: bashkëpunon me të tjerët pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitetet në klasë.

(6)Kompetenca qytetare: vendos duke bashkëpunuar me të gjithë anëtarët për mënyrat që çojnë drejt përfundimit të një aktiviteti të caktuar.

***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:** Nxënësi: • Flet rrjedhshëm, qartë kur përshkruan diçka. • Lexon fjalë dhe fjali me shkronjat e mësuara. • Shkruan urime, kartolina urimi.	**Fjalë kyçe:** dhuratë, dhuroj, festë **Strategji dhe teknika:** • Bashkëbisedim • Punë në grup • Punë individuale
Burimet e informacionit dhe mjete: Teksti i Abetares, shkronja ilustruese shtypi e dore, mjete vizatimi, libra për fëmijë, kartolina, magnetofon, CD, kënga "Dhuratë për ditëlindje".	**Lidhja me fushat e tjera:** Matematikë Arte Edukim me të drejtat e fëmijëve

Përshkrimi kontekstual i situatës:

Veprimtari paraprake

Mësuesja vendos në magnetofon këngën "Dhuratë për ditëlindjen" dhe nxit nxënësit të këndojnë këngën në qoftë se e dinë.

Pyet nxënësit:

- Për çfarë flet kënga?

- Çfarë i dhuruan shokët për ditëlindje?
- Si mendoni se ndihet djali? Pse mendoni kështu?
- Si ndiheni ju kur merrni dhurata? Po kur jepni?
- Kur mund të japim dhuratë?

Mësuesja u tregon nxënësve se do të përgatitin dhurata për shokët.

Veprimet në situatë:

Hapi i parë: Punë në grupe:

Nxënësit organizohen në grupe dhe u jepen udhëzimet përkatëse.

Çdo grup do të përgatitë një dhuratë dhe do të shkruajë urimin përkatës në një kartolinë sipas rastit.

Mësuesja ndjek nga afër punën e nxënësve dhe sigurohet që të përfshihen të gjithë nxënësit në punë dhe të përdoren me kujdes mjetet e punës.

Nxënësit do të kujdesen që dhurata të jetë sa më e rregullt në paketim.

Prezantim i punës së grupeve.

Hapi i dytë: Punë individuale

Nxënësit punojnë në fletë individuale sipas niveleve me ushtrime të tipit:

Shkruaj një kartolinë/niveli i parë

Shkruaj një letër për shokun /niveli i dytë

Demonstrim i rezultateve të arritura:

Shkrim i fjalëve me shkronjat e mësuara të dorës
Lexim i fjalëve me shkronjat e mësuara.

Vlerësimi i situatës:
Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- Flet rrjedhshëm,qartë kur përshkruan diçka.
- Lexon fjalë dhe fjali me shkronjat e mësuara
- Shkruan urime, kartolina urimi.

Detyra:

1. Shkruajnë fjali me shkrim dore.

Refleksione:

<table>
<tr><td>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla: 1</td><td>Klasa: 1</td></tr>
<tr><td colspan="3">Tema mësimore:
Punim i tingullit dhe shkronjës Ll,ll/Abetare faqe 72</td><td>Situata e të nxënit:
Ëmbëlsirat</td></tr>
<tr><td colspan="4">R.N. sipas kompetencave kyçe:
Nxënësi:
K.1 paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup.
K.2 sqaron me anë të të folurit hapat e zgjidhjes së një problemi të thjeshtë, me të cilin ballafaqohet në një situatë jetësore
K.3 ndjek udhëzimet e dhëna në një tekst për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë, që kërkohet.
K.3 parashtron pyetje dhe përgjigjet në pyetjet për temën/problemin/detyrën e dhënë në njërën nga format e të shprehurit.</td></tr>
<tr><td colspan="3" rowspan="2">R.N. të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:
Nxënësi:
• Shqipton, shkruan dhe lexon tingullin dhe shkronjën Ll, ll.
• Shkruan dhe lexon fjalë me shkronjën ll dhe shkronjat e mësuara.
• Përshkruan mbi bazën e figurave.
• Qarkon rrokjet që përmbajnë shkronjën ll në fjalë të ndryshme.</td><td>Fjalë kyçe:
akullore, tullumbace, mollë, kukull</td></tr>
<tr><td>Strategji dhe teknika:
• Analizë dhe sintezë
• Bashkëbisedim
• Punë individuale</td></tr>
<tr><td colspan="3">Burimet e informacionit dhe mjete:
Abetare, shkronja Ll, ll; tullumbace, foto, libra për fëmijë</td><td>Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë, Arte,
Edukim me të drejtat e fëmijëve</td></tr>
<tr><td colspan="4">Përshkrim kontekstual i situatës:
Veprimtari paraprake
Në një fletë të palosur në formë fizarmonike, nxënësit shkruajnë emra ëmbëlsirash.(kek, tortë,akullore, etj.) Hapet fleta dhe i shkruaj fjalët në tabelë.
Për secilën prej tyre ata shprehin mendimet lirshëm:
- Si është? Pse u pëlqen?
- Kur duhen ngrënë ëmbëlsirat? Pse duhet treguar kujdes me ngrënien e tyre?</td></tr>
</table>

Veprimet në situatë:

Hapi i parë: Analizë dhe sintezë

Nga fjalët që emërtojnë nxënësit në veprimtarinë paraprake, mësuesja veçon fjalën akullore dhe nxiten të formojnë fjali me të. Shkruaj fjalinë: *Arushi bleu akullore.*

Kryhet procesi i analizës duke e ndarë fjalinë në fjalë dhe fjalën akullore në rrokje, për shkëputjen e tingullit dhe shkronjës Ll, ll.

- Sa fjalë ka fjalia? Sa rrokje ka fjala akullore? Sa shkronja ka? Cilat janë zanore? Po bashkëtingëllore?

Ushtrohen në shqiptimin e tingullit të ri dhe theksohet se është tingull bashkëtingëllor.

Hapi i dytë: Bashkëbisedim

Hapet libri dhe komentohet figura qendrore:

- Çfarë shihni në figurë?

- Ku e ka blerë akulloren? Si mendoni se ndihet arushi?

- Ç'figura të tjera shikoni?

- Çfarë kanë të përbashkët këto figura? (përmbajnë shkronjën ll).

Pasi analizohen në rrokje, formohen fjali dhe shkruhen në tabelë.

Hapi i tretë: Punë individuale

Nxënësit vizatojnë 1-2 figura që kanë shkronjën ll.

Punimet i vendosin në portofolin individual

Demonstrim i rezultateve të arritura:

Lexohen fjalët në faqen 72.

Qarkohen rrokjet që përmbajnë shkronjën ll në fjalët e dhëna.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- Shqipton, shkruan dhe lexon tingullin dhe shkronjën Ll,ll.
- Shkruan dhe lexon fjalë me shkronjën ll dhe shkronjat e mësuara.
- Përshkruan mbi bazën e figurave.
- Qarkon rrokjet që përmbajnë shkronjën ll në fjalë të ndryshme.

Detyra:

1. Nga 2 rreshta me shkronjën e madhe e të vogël të shtypit Ll,ll.
2. Shkrim fjalësh me shkronjën ll.
3. Shkrim i 3 fjalive me shkronjën ll.

Refleksione:

<table>
<tr><td>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla: 1</td><td>Klasa: 1</td></tr>
<tr><td colspan="3">Tema mësimore:
Punim e shkrim i shkronjës Ll,ll/Abetare pune</td><td>Situata e të nxënit:
Ëmbëlsirat</td></tr>
<tr><td colspan="4">R.N. sipas kompetencave kyçe:
Nxënësi:
K.2 sqaron me anë të të folurit hapat e zgjidhjes së një problemi të thjeshtë, me të cilin ballafaqohet në një situatë jetësore.
K.3 ndjek udhëzimet e dhëna në një tekst për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë, që kërkohet.
K.3 zgjidh në mënyrë të pavarur detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes.
K.4 identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre në klasë.</td></tr>
<tr><td colspan="3" rowspan="2">R.N. të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:
Nxënësi:
• Shkruan shkronjën Ll, ll të shtypit.
• Formon dhe shkruan fjalë dhe grupe fjalësh me shkronjën ll dhe shkronjat e mësuara.
• Plotëson fjalitë me fjalët e dhëna.
• Ruan hapësirën midis fjalëve.</td><td>Fjalë kyçe:
akullore, mollë, tullumbace</td></tr>
<tr><td>Strategji dhe teknika:
• Analizë dhe sintezë
• Punë individuale
• Veprimtari në dyshe</td></tr>
<tr><td colspan="3">Burimet e informacionit dhe mjete:
Abetare pune, shkronja Ll, ll e shtypit; fletë; materiale vizatimi; libra për fëmijë</td><td>Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë,
Edukim me të drejtat e fëmijëve</td></tr>
<tr><td colspan="4">Përshkrim kontekstual i situatës:
Veprimtari paraprake
Etiketat me fjalët që përmban faqja 46 e Abetares së punës ngjiten mbi kaushët e akulloreve prej letre.
Lexohen nga nxënësit dhe analizohen në rrokje dhe shkronja. Formohen fjali me to gojarisht. (kukull, akullore, molla).</td></tr>
</table>

Veprimet në situatë:

Hapi i parë: Analizë dhe sintezë

Mësuesja paraqet shkronjën Ll, ll. Bëhet krahasimi me shkronjat e tjera (L,l).

Ushtrohen në shkrimin e shkronjës dhe identifikimin e saj në fjalët e shkruara në veprimtarinë hyrëse.

Hapi i dytë: Punë individuale

Shkruajnë shkronjat dhe rrokjet në detyrën e parë. Shkruajnë në fillim vetëm një dhe pasi mësuesja bindet se është shkruar mirë, lihen të vazhdojnë vetë.

Lidhen rrokjet dhe formohen fjalët. Shkruhen përbri fjalët e formuara.

Hapi i tretë: Veprimtari në dyshe

Nxënësit lidhin fjalët e dhëna sipas kuptimit dhe formojnë grupe fjalësh:

- petulla, vetulla, pëllumbi, populli
- truall, akull, llastik, mashkull
- balli, shalli, kulla, sholla
- mbjell ullinj, mbështjell me shall, vesh pallton, blej akullore.

Demonstrim i rezultateve të arritura:

Ndahen fjalët në fjalitë e dhëna dhe shkruhen si duhet.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- Shkruan shkronjën Ll, ll të shtypit.
- Formon dhe shkruan fjalë dhe grupe fjalësh me shkronjën ll dhe shkronjat e mësuara.
- Plotëson fjalitë me fjalët e dhëna.
- Ruan hapësirën midis fjalëve

Detyra:

1. Shkrim i grupeve të fjalëve që formuan.
2. Formim i tre fjalive me to.

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 1	Klasa: 1
Tema mësimore: Punim e lexim i shkronjës Ll,ll /Abetare fq.73		Situata e të nxënit: Ëmbëlsirat	
R.N. sipas kompetencave kyçe: Nxënësi: K.1 paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup. K.1 shpreh mesazhin e një teksti të thjeshtë përmes të folurit. K.3 parashtron pyetje dhe përgjigjet në pyetjet për temën në njërën nga format e të shprehurit. K.6 shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive.			
R.N. të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: • Përshkruan figurën duke folur rrjedhshëm dhe me intonacionin e duhur. • Lexon vjershën me intonacion. • U përgjigjet pyetjeve që lidhen me përmbajtjen e vjershës. • Sjell përvoja të ngjashme nga jeta.		Fjalë kyçe: akullore, ëmbëltore, shurup, kaush Strategji dhe teknika • Parashikim mbi bazën e fotos • Lexim i drejtuar • Punë individuale	
Burimet e informacionit dhe mjete: Teksti i Abetares, mjete vizatimi, libra për fëmijë		Lidhja me fushat e tjera: Matematikë Arte Edukim shëndetësor	
Përshkrimi kontekstual i situatës: *Veprimtari paraprake* Nxiten nxënësit të përshkruajnë akulloren. Mësuesja ndihmon me pyetjet: - Si është nëse e prek? - Si është nëse e provon? - Me se përgatitet? Ku mbahet ajo? - Pse duhet vendosur në frigorifer? - Çfarë kujdesi duhet të tregojmë me të? Pse?			

Veprimet në situatë:

Hapi i parë: Parashikim i ngjarjes mbi bazën e fotos

Komentohet figura e tekstit:

- Çfarë paraqitet në foto?
- Çfarë ka në dorë arushi? Si duken ato?
- Çfarë mendoni se ka ndodhur?

Dëgjohen 3 – 4 nxënës të parashikojnë ngjarjen mbi bazën e fotos.

- Le ta shohim çfarë ka ndodhur.

Hapi i dytë: Lexim i drejtuar

Lexohet vjersha "Kush e hëngri akulloren?" me intonacionin e duhur nga mësuesja.

Nxiten nxënësit të flasin rreth përmbajtjes së saj me anë të pyetjeve:

- Pse arushi bleu dy akullore?
- Çfarë gabimi bëri ai?
- Si do të kishit vepruar ju?
- Çfarë mendoni se i tha mami arushit?
- A e menduat dhe ju ngjarjen kështu?

Hapi i tretë: Punë individuale

Lexohet vjersha në heshtje.

Demonstrim i rezultateve të arritura:

Lexohet vjersha nga nxënësit me zë të lartë.

Tregohet mesazhi me anë të të folurit.

Vlerësimi i situatës:
Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- Përshkruan figurën duke folur rrjedhshëm dhe me intonacionin e duhur.
- Lexon vjershën me intonacion.
- U përgjigjet pyetjeve që lidhen me përmbajtjen e vjershës.

Detyra:

1. Lexim i vjershës rrjedhshëm.
2. Mësim i vjershës përmendësh.

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 1	Klasa: 1
Tema mësimore: Ushtrime aplikative për shkrim dore ***Ll,ll*** /Abetare pune		Situata e të nxënit: Ëmbëlsirat	
R.N. sipas kompetencave kyçe: Nxënësi: K.3 ndjek udhëzimet e dhëna për të realizuar një detyrë që i kërkohet. K.3 mbikëqyr në mënyrë të pavarur përparimin e vet në një detyrë duke përdorur teknika të ndryshme për gjetjen e gabimeve dhe i korrigjon ato derisa gjen zgjidhjen. K.3 grumbullon dhe klasifikon materialet e performancës së vet, për përgatitjen apo pasurimin e portofolit personal.			
R.N. të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: • Modelon bukur grafikun e shkronjës së madhe dhe të vogël të dorës ***Ll,ll***. • Lidh shkronjën ***Ll,ll*** me shkronjat e tjera të dorës. • Shkruan fjalë dhe fjali me shkronja të dorës.		Fjalë kyçe: akullore, mollë Strategji dhe teknika: • Analizë dhe sintezë • Punë individuale • Veprimtari në dyshe	
Burimet e informacionit dhe mjete: Abetare pune, shkronja e dorës ***Ll,ll***, fletore shkrimi, mjete vizatimi		Lidhja me fushat e tjera: Matematikë Arte Edukim me të drejtat e fëmijëve	
Përshkrimi kontekstual i situatës: *Veprimtari paraprake* Nxiten nxënësit të formojnë fjali për akulloren. I shkruaj fjalitë me shkrim dore në tabelë. Identifikojnë shkronjën ***Ll, ll*** dhe pozicionin në të cilin ndodhet. Nxiten të lëvizin dorën në ajër për të shkruar shkronjën ***Ll, ll*** të dorës disa herë nën drejtimin e mësueses.			

Veprimet në situatë:

Hapi i parë: Analizë dhe sintezë

Mësuesja paraqet modelin e shkronjës së dorës ***Ll,ll***. Bëhet krahasimi i tyre me shkronjat e tjera (***L,l***)

Ushtrohen në shkrimin e shkronjave në fletë të bardha me lapsa me ngjyra.

Hapi i dytë: Punë individuale

Nxënësit shkruajnë sipas modelit shkronjën ***Ll,ll*** të dorës në Abetaren e punës.

Vëzhgohen nxënësit gjatë punës nga mësuesja dhe ndihmohen nëse kanë vështirësi.

Hapi i tretë: Veprimtari në dyshe

Në fletë të prera në formë balonash nxënësit shkruajnë shkronjën e dorës ***Ll,ll*** dhe i vendosin në një kënd të klasës.

Demonstrim i rezultateve të arritura:

Shkrim fjalësh me shkronjën e dorës ***Ll,ll*** në fletoren individuale:

molla, kukull, pallat, akullore,pallto, petulla

Arushi bleu akullore.

Vlerësimi i situatës:
Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- Modelon bukur grafikun e shkronjës së madhe dhe të vogël të dorës ***Ll,ll.***
- Shkruan fjalë dhe fjali me shkronja të dorës.

Detyra:

1. Shkrim nga 3 rreshta me shkronjën e madhe dhe të vogël të dorës ***Ll,ll***.
2. Shkrim fjalë me shkronja dore që përmbajnë ***Ll***, ***ll.***
3. Shkrim i 5 fjalive me shkronja dore.

Refleksione:

<table>
<tr><td>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla: 1</td><td>Klasa: 1</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore
Punim i faqes 72-73 të Abetares</td><td colspan="2">Situata e të nxënit:
Ëmbëlsirat</td></tr>
<tr><td colspan="4">R.N. sipas kompetencave kyçe:
Nxënësi:
K.1 ritregon ngjarjen e një teksti të dëgjuar, përmbajtja e të cilit nuk është më shumë se një faqe teksti.
K.1 shpreh mesazhin e një teksti të thjeshtë letrar përmes të folurit.
K.3 ndjek udhëzimet e dhëna në një tekst për të realizuar një detyrë që kërkohet.
K.5 bashkëpunon me të tjerët pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitetet në klasë, shkollë apo jashtë saj.</td></tr>
<tr><td colspan="2" rowspan="2">R.N. të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:
Nxënësi:
• Reciton vjershën me intonacionin e duhur.
• U përgjigjet pyetjeve që lidhen me përmbajtjen e saj.
• Formon e shkruan fjali me fjalët e dhëna.
• Ruan hapësirat midis fjalëve.</td><td colspan="2">Fjalë kyçe:
akullore, ëmbëltore, shurup, kaush</td></tr>
<tr><td colspan="2">Strategji dhe teknika:
• Pyetja sjell pyetjen
• Punë individuale
• Veprimtari në dyshe</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet e informacionit dhe mjete:
Teksti i Abetares, shkronja ilustruese, mjete vizatimi, libra për fëmijë.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë
Arte
Edukim shëndetësor</td></tr>
<tr><td colspan="4">Përshkrimi kontekstual i situatës:
Në tabelë shkruhet fjalia: Ëmbëlsira ime e preferuar është ...
Nxënësit shkruajnë fjalinë të plotë në një fletë dhe e ngjitin në tabelë.
Lexohen nga nxënësit dhe grupohen sipas zgjedhjes që kanë bërë.
- Cila ëmbëlsirë pëlqehet më shumë në klasën tonë? Sa nxënës e pëlqejnë? Po më pak?
- Ç’kujdes duhet të tregojmë me ëmbëlsirat? Pse?</td></tr>
</table>

Veprimet në situatë:

Hapi i parë: Pyetja sjell pyetjen

Mësuesja drejton pyetje rreth përmbajtjes së vjershës:

- Ku zhvillohet ngjarja?
- Çfarë kishte në park?
- Si ishin akulloret?
- Pse arushi bleu dy akullore?
- Çfarë i ndodhi atij?
- Si mendoni se mund të ketë vazhduar ngjarja më pas?

Hapi i dytë: Punë individuale

Recitim i vjershës nga nxënësit.

Hapi i tretë: Veprimtari në dyshe

Nxënësit punojnë ushtrimet në tekst duke bashkëpunuar në dyshe.

Ndihmohen për detyrat që kanë vështirësi:

Pëllumbi solli letrën.

Akullorja kullon pikë–pikë.

Dielli është në qiell.

Drini bleu akullore.

Vizatim i akullores së preferuar.

Demonstrim i rezultateve të arritura:

Recitim i vjershës me intonacion.

Shkrim i fjalive të formuara.

Vlerësimi i situatës:
Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- Reciton vjershën me intonacionin e duhur.
- U përgjigjet pyetjeve që lidhen me përmbajtjen e saj.
- Formon e shkruan fjali me fjalët e dhëna.
- Ruan hapësirat midis fjalëve.

Detyra:

1. Shkrim i pjesës që pëlqen.
2. Ilustrim me vizatim.

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla 1	Klasa 1
Tema mësimore: Punim i tingullit dhe shkronjës G, g Abetare fq. 74			Situata e të nxënit: Kafshët

R.N. sipas kompetencave kyçe:

Nxënësi:

K.1 paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup.

K.3 ndjek udhëzimet e dhëna në një tekst për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë, që kërkohet.

K.3 parashtron pyetje dhe përgjigjet në pyetjet për temën/problemin/detyrën e dhënë në njërën nga format e të shprehurit.

K.6 shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive.

R.N. të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:

Nxënësi:

- Shqipton, shkruan dhe lexon tingullin dhe shkronjën G,g.
- Shkruan dhe lexon fjalë me shkronjën g dhe shkronjat e mësuara.
- Përshkruan mbi bazën e figurave.
- Qarkon rrokjet që përmbajnë shkronjën g në fjalë të ndryshme.
- Formon e lexon fjali me fjalët e dhëna.

Fjalë kyçe:

gomar, maskë, përgatit

Strategji dhe teknika:

- Stuhi mendimi
- Analizë dhe sintezë
- Bisedë
- Punë individuale

Burimet e informacionit dhe mjete:

Abetare, shkronja G, g, maska, foto, libra për fëmijë, gjëegjëza

Lidhja me fushat e tjera:

Matematikë
Arte
Edukim me të drejtat e fëmijëve

Përshkrim kontekstual i situatës:

Veprimtari paraprake

Mësuesja shkruan në ë tabelë fjalët: Goma, Ora, Miu, Ariu, Rosa, Iriqi dhe drejton pyetjet:

- Si lexohen këto fjalë?

Lihen nxënësit 2-3' të lexojnë në heshtje e më pas vazhdon:

- Cila është fjala e parë? Me cilën shkronjë fillon?

Kështu vazhdon edhe me fjalët e tjera.

- Cilën fjalë mund të formojmë me shkronjat e para të këtyre fjalëve? (GOMARI)
- Çfarë dini për gomarin? (shkruhen në tabelë mendimet e nxënësve)



Veprimet në situatë:

Hapi i parë: Analizë dhe sintezë

Mësuesja shkruan fjalinë: *Gomari përgatiti një maskë.*

Kryhet procesi i analizës duke e ndarë fjalinë në fjalë dhe fjalën gomari në rrokje, për shkëputjen e tingullit dhe shkronjës G, g:

- Sa fjalë ka fjalia? Sa rrokje ka fjala gomari? Sa shkronja ka? Cilat janë zanore? Po bashkëtingëllore?

Ushtrohen nxënësit në shqiptimin e tingullit të ri dhe theksohet se është tingull bashkëtingëllor.

Hapi i dytë: Bisedë

Hapet libri dhe komentohet figura qendrore:

- Çfarë shihni në figurë? Çfarë po bën ai?
- Si iu duket veprimi i tij? Pse mendoni se ka vendosur maskë gomari?

Hapi i tretë: Veprimtari në dyshe

Plotësohen fjalët poshtë figurave: globi, gota, gështenja, gërshëra.

Pasi analizohen në rrokje, formohen fjali dhe shkruhen në tabelë nga mësuesja.

Nxënësit qarkojnë shkronjën g dhe tregojnë pozicionin e saj.

Hapi i katërt: Punë individuale

Nxënësit vizatojnë 1-2 figura që kanë shkronjën g.

Punimet i vendosin në portofolin individual.

Demonstrim i rezultateve të arritura:

Qarkohen rrokjet që përmbajnë shkronjën g në fjalët e dhëna: gropa, gruri, gripi, grepi, ngrica, ngadalë, i ngathët, ngre.

Formohen dhe lexohen fjalitë me fjalët e dhëna:

Gozhda ngulet në dërrasë. Globi ngrohet nga dielli. Genti ngrihet herët. Vlerësimi i situatës: Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi: • Shqipton, shkruan dhe lexon tingullin dhe shkronjën G,g. • Shkruan dhe lexon fjalë me shkronjën g dhe shkronjat e mësuara. • Përshkruan mbi bazën e figurave. • Qarkon rrokjet që përmbajnë shkronjën g në fjalë të ndryshme. • Formon e lexon fjali me fjalët e dhëna.
Detyra: **1.** Nga 2 rreshta me shkronjën e madhe e të vogël të shtypit G, g. **2.** Shkrim fjalësh me shkronjën g.
Refleksione:

<table>
<tr><td>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla: 1</td><td>Klasa: 1</td></tr>
<tr><td colspan="3">Tema mësimore:
Punim e shkrim i shkronjës G,g/Abetare pune</td><td>Situata e të nxënit:
Kafshët</td></tr>
<tr><td colspan="4">R.N. sipas kompetencave kyçe:
Nxënësi:
K.1 paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup.
K.2 sqaron me anë të të folurit hapat e zgjidhjes së një problemi të thjeshtë, me të cilin ballafaqohet në një situatë jetësore.
K.3 ndjek udhëzimet e dhëna në një tekst për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë, që kërkohet.
K.3 zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes.
K.4 identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në shtëpi.</td></tr>
<tr><td colspan="3" rowspan="2">R.N. të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:
Nxënësi:
• Shkruan shkronjën G, g të shtypit.
• Formon dhe shkruan fjalë dhe grupe fjalësh me shkronjën g dhe shkronjat e mësuara.
• Plotëson fjalitë me fjalët e dhëna.
• Ruan hapësirën midis fjalëve.</td><td>Fjalë kyçe:
gomari, kanguri, gaforre, grera</td></tr>
<tr><td>Strategji dhe teknika:
• Analizë dhe sintezë
• Punë individuale
• Veprimtari në dyshe</td></tr>
<tr><td colspan="3">Burimet e informacionit dhe mjete:
Abetare pune, shkronja G, g e shtypit; fletë; materiale vizatimi; libra për fëmijë</td><td>Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë
Shoqëria dhe mjedisi,
Edukim me të drejtat e fëmijëve</td></tr>
<tr><td colspan="4">Përshkrim kontekstual i situatës:
Veprimtari paraprake
Nxënësit, duke punuar në dyshe, do të shkruajnë emra kafshësh.
Lexohen dhe shkruhen në tabelë, krahasohen gjetjet ndërmjet dysheve.
Veçohen fjalët që përmbajnë shkronjën g, përcaktohet pozicioni i tyre në fjalë.</td></tr>
</table>

Veprimet në situatë:

Hapi i parë: Analizë dhe sintezë

Përsërite shkronjat e mësuar të shtypit duke u lexuar korazi nga nxënësit me zë të lartë.

Mësuesja paraqet shkronjën G,g. Bëhet krahasimi me shkronjat e tjera.

Ushtrohen në shkrimin e shkronjës dhe identifikimin e saj në fjalët e shkruara në tabelë.

Hapi i dytë: Punë individuale

Nxënësit shkruajnë shkronjat dhe rrokjet në detyrën e parë në Abetaren e punës.

Emërtohen figurat, analizohen në rrokje dhe shkruhen fjalët: globi, gërshëra, gështenja.

Hapi i tretë: Veprimtari në dyshe:

Nxënësit lidhin fjalët e dhëna sipas kuptimit dhe formojnë grupe fjalësh:

gatuaj drekën, ngroh gishtat, lag rrugën, ngrin në frigorifer, gris gazetën, ngul gozhdë.

Grupet e formuara shkruhen në hapësirat përkatëse.

Demonstrim i rezultateve të arritura:

Formohen dhe shkruhen fjalët me rrokjet e dhëna: gripi, grupi, gruri, vargu ,gazeta, gomari, ngrohtësi, tregimi.

Plotësohen fjalitë me fjalët e dhëna dhe shkruhen si duhet:

Në rrugë duken shenjat rrugore.

Në rrugë nuk duken shenjat rrugore.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- Shkruan shkronjën G, g të shtypit.
- Formon dhe shkruan fjalë dhe grupe fjalësh me shkronjën g dhe shkronjat e mësuara.
- Plotëson fjalitë me fjalët e dhëna.
- Ruan hapësirën midis fjalëve.

Detyra:

1. Shkrim i grupeve të fjalëve që formuan.
2. Formim i fjalive me to.

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 1	Klasa: 1
Tema mësimore Punim e lexim i shkronjës G,g /Abetare fq. 75		Situata e të nxënit: Kafshët	
R.N. sipas kompetencave kyçe: Nxënësi: K.1 lexon me zë një tekst së paku prej gjysmë faqeje të pa lexuar më parë. K.1 shpreh mesazhin e një teksti të thjeshtë përmes të folurit. K.3 parashtron pyetje dhe përgjigjet në pyetjet për temën në njërën nga format e të shprehurit. K.4 identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre.			
R.N. të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: • Përshkruan figurën duke folur rrjedhshëm dhe me intonacionin e duhur. • Lexon tekstin me intonacion. • U përgjigjet pyetjeve që lidhen me përmbajtjen.		Fjalë kyçe: gomar, maskë, kafshë Strategji dhe teknika: • Bisedë • Lexim me ndalesa • Punë individuale • Rrjeti i diskutimit	
Burimet e informacionit dhe mjete: Teksti i Abetares, mjete vizatimi, libra për fëmijë, maska, videoprojektor, laptop		Lidhja me fushat e tjera: Matematikë Arte Edukim me të drejtat e fëmijëve	
Përshkrimi kontekstual i situatës *Veprimtari paraprake* Paraqiten me videoprojektor pamje nga festimet e karnavaleve dhe lihen nxënësit të shprehin mendimin e tyre rreth pamjeve dhe të sjellin përvoja personale në qoftë se kanë. - Mendoni sikur sot në klasë do të zhvillojmë Ditën e Karnavaleve. - Cilën maskë do të përgatitnit? Pse? - Me çfarë do ta përgatitnit?			

Veprimet në situatë:

Hapi i parë: Bisedë

Mësuesja shkruan titullin në tabelë dhe nxit nxënësit të komentojnë figurën e tekstit:

- Cilat kafshë duken në figurë? Çfarë po bën gomari? Si duket ai? Pse mendoni se vuri maskë?

- Çfarë mendoni se do të ndodhë?

Hapi i dytë: Lexim me ndalesa

Ndahet teksti në dy pjesë: pjesa e parë që nga fillimi deri te "…nuk e njohu".

Mbas leximit, mësuesja drejton pyetjet:

- Çfarë bëri gomari? Si mendoni se u ndje ai? Çfarë mendoni se do të ndodhë më pas?

Pjesa e dytë që nga "Gomari u ndie…" deri në fund.

Mësuesja drejton pyetjet:

- A ndodhi ashtu si menduat? Çfarë ndodhi? Ç'mendim keni për veprimin e gomarit? Po për veprimin e kafshëve të tjera?

Hapi i tretë: Punë individuale

Lexohet teksti në heshtje e pastaj me zë të lartë.

Hapi i katërt: Rrjeti i diskutimit

Diskutim: A kanë të drejtë kafshët që u tallën me gomarin? Pse?

Nxënësit ndahen në dy grupe sipas përgjigjes që japin dhe argumentojnë mendimin e tyre.

Demonstrim i rezultateve të arritura:

Lexohet teksti nga nxënësit me zë të lartë.

Tregohet mesazhi me anë të të folurit.

Vlerësimi i situatës:
Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- Përshkruan figurën duke folur rrjedhshëm dhe me intonacionin e duhur.
- Lexon tekstin me intonacion.
- U përgjigjet pyetjeve që lidhen me përmbajtjen.

Detyra:

1. Lexim i tekstit rrjedhshëm.
2. Ilustrim i tekstit me vizatim.
3. Shkrim i pjesës që pëlqejnë.

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 1	Klasa: 1
Tema mësimore Ushtrime aplikative për shkrim dore ***G,g*** /Abetare pune		Situata e të nxënit: Kafshët	
R.N. sipas kompetencave kyçe: Nxënësi: K.3 ndjek udhëzimet e dhëna për të realizuar një detyrë që i kërkohet. K.3 mbikëqyr në mënyrë të pavarur përparimin e vet në një detyrë duke përdorur teknika të ndryshme për gjetjen e gabimeve dhe i korrigjon ato derisa gjen zgjidhjen. K.3 grumbullon dhe klasifikon materialet e performancës së vet, për përgatitjen apo pasurimin e portofolit personal. K.6 diskuton dhe në bashkëpunim me anëtarët e grupit vendos rregullat e punës në grup.			
R.N. të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: • Modelon bukur grafikun e shkronjës së madhe dhe të vogël të dorës ***G,g.*** • Lidh shkronjën ***G,g*** me shkronjat e tjera. • Shkruan fjalë dhe fjali me shkronja të dorës.		Fjalë kyçe: gomari, kanguri, gaforre,grera Strategji dhe teknika: • Analizë dhe sintezë • Punë individuale • Veprimtari në dyshe	
Burimet e informacionit dhe mjete: Abetare pune, shkronja e dorës G, g, fletore shkrimi, mjete vizatimi		Lidhja me fushat e tjera: Matematikë Arte Edukim me të drejtat e fëmijëve	
Përshkrimi kontekstual i situatës: *Veprimtari paraprake* Mësuesja shkruan në tabelë me shkrim dore fjalët: ***gomari, kanguri, gaforre, grera.*** Nxënësit i lexojnë dhe formojnë fjali me secilën prej tyre. Nxiten të tregojnë më shumë rreth këtyre kafshëve. - Çfarë kanë të përbashkët këto fjalë? (shkronjën ***g)***			

Veprimet në situatë:

Hapi i parë: Analizë dhe sintezë

Mësuesja paraqet modelin e shkronjës së dorës ***G,g.***

Bëhet krahasimi i tyre me shkronjat e tjera (S, L, j).

Nxënësit ngrenë dorën në ajër dhe lëvizin nën drejtimin e mësueses sipas modelit të shkronjës së dorës G,g.

Ushtrohen në shkrimin e shkronjave në fletë të bardha me lapsa me ngjyra.

Hapi i dytë: Punë individuale

Nxënësit shkruajnë sipas modelit shkronjën G,g të dorës në Abetaren e punës.

Vëzhgohen nxënësit gjatë punës dhe ndihmohen nëse kanë vështirësi.

Kur mësuesja bindet se e kanë shkruar bukur, i lë të punojnë në mënyrë të pavarur.

Shkrim me të diktuar në fletoren individuale:

gruri, gropa, globi, gërshëra, gishta, ngrohem

Gruri mbillet në vjeshtë.

Hapi i tretë: Veprimtari në dyshe

Nxënësit shkruajnë shkronjën ***G,g*** në fletë të parapërgatitura dhe vizatojnë një figurë që përmban shkronjën g.

Punimet e nxënësve vendosen në një kënd të klasës.

Demonstrim i rezultateve të arritura:

Shkrim fjalësh dhe fjalish me shkronjën e dorës ***G,g*** në fletoren individuale.

Vlerësimi i situatës:
Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- Modelon bukur grafikun e shkronjës së madhe dhe të vogël të dorës ***G,g.***
- Shkruan fjalë dhe fjali me shkronja të dorës.

Detyra:

1. Shkrim nga 3 rreshta me shkronjën e madhe dhe të vogël të dorës ***G,g.***
2. Shkrim fjalë me shkronja dore që përmbajnë ***G, g.***
3. Shkrim i 5 fjalive me shkronja dore.

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 1	Klasa: 1
Tema mësimore: Punim i fq. 74-75 të Abetares		Situata e të nxënit: Kafshët	

R.N. sipas kompetencave kyçe:

Nxënësi:

K.1 ritregon ngjarjen e një teksti të dëgjuar, përmbajtja e të cilit nuk është më shumë se një faqe teksti.

K.1 shpreh mesazhin e një teksti të thjeshtë letrar përmes të folurit.

K.3 ndjek udhëzimet e dhëna në një tekst për të realizuar një detyrë që kërkohet.

K.5 bashkëpunon me të tjerët pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitetet në klasë, shkollë apo jashtë saj.

R.N. të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: • Lexon përrallën qartë dhe me intonacion • U përgjigjet pyetjeve që lidhen me përmbajtjen e përrallës. • Tregon cilësi të kafshëve duke i krahasuar me njëra – tjetrën. • Nxjerr mesazhin e përrallës. • Interpreton në role .	Fjalë kyçe: gomari, maskë, përgatit Strategji dhe teknika: • Pyetja sjell pyetjen • Punë individuale • Veprimtari në dyshe
Burimet e informacionit dhe mjete: Teksti i Abetares, shkronja ilustruese, mjete vizatimi, libra për fëmijë.	Lidhja me fushat e tjera: Arte Edukim mjedisor Shkencat natyrore

Përshkrimi kontekstual i situatës:

Veprimtari paraprake

Në tabelë vendos etiketat e fjalëve kali, gomari,ujku, ariu, lopa,delja,macja,qeni.

Nxënësit zgjedhin njërën prej tyre dhe imitojnë zërat.

Përsëritet veprimtaria disa herë.

Veprimet në situatë:

Hapi i parë: Pyetja sjell pyetjen

Pyetje rreth përmbajtjes së përrallës:

- Ku zhvillohet ngjarja? Çfarë bëri gomari? Pse mendoni se e përgatiti? Si e zbuluan kafshët e tjera?
- Si u sollën ato? Ç'mendim keni për veprimin e gomarit? Po për veprimin e kafshëve të tjera?
- Çfarë mësojmë nga kjo përrallë?

Interpretohet përralla në role 2-3 herë.

Hapi i dytë: Punë individuale

Lexim i tekstit me zë të lartë nga nxënësit.

Ritregim i ngjarjes nga 2-3 nxënës.

Hapi i tretë: Veprimtari në dyshe

Mësuesja u shpërndan nxënësve etiketat me fjalët: i urtë, punëtor, i bindur, i fortë, i ngadaltë, i bukur, i shpejtë.

Në tabelë vendos në një anë etiketën me fjalën kali dhe në anën tjetër fjalën gomari. Nxënësit do të vendosin etiketën atje ku përshtatet më mirë (te kali ose te gomari).

Venë në dukje të përbashkëtat dhe ndryshimet ndërmjet tyre.

Demonstrim i rezultateve të arritura:

Lexim i përrallës qartë e me intonacion.

Shkrim i dy fjalive për gomarin.

Vlerësimi i situatës:
Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- Lexon përrallën qartë dhe me intonacion.
- U përgjigjet pyetjeve që lidhen me përmbajtjen e përrallës.
- Tregon cilësi të kafshëve duke i krahasuar me njëra – tjetrën.
- Nxjerr mesazhin e përrallës.

Detyra:

1. Shkrim i pjesës që pëlqen.
2. Ilustrim me vizatim.

Refleksione:

<table>
<tr><td>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla: 1</td><td>Klasa: 1</td></tr>
<tr><td colspan="3">Tema mësimore:
Punim i shkronjës Gj, gj. Faqe 76 e Abetares</td><td>Situata e të nxënit:
Gjëegjëzat</td></tr>
<tr><td colspan="4">R.N. sipas kompetencave kyçe:
Nxënësi:
K.1 paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup.
K.3 ndjek udhëzimet e dhëna në një tekst për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë, që kërkohet.
K.3 parashtron pyetje dhe përgjigjet në pyetjet për temën/problemin/detyrën e dhënë në njërën nga format e të shprehurit.
K.5 bashkëpunon me të tjerët pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitetet në klasë, shkollë apo jashtë saj.
K.6 shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive.</td></tr>
<tr><td colspan="3" rowspan="2">R.N. të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:
Nxënësi:
• Përshkruan mbi bazën e figurave.
• Shqipton, shkruan dhe lexon tingullin dhe shkronjën Gj,gj.
• Qarkon shkronjën Gj,gj të shtypit në pozicione të ndryshme të fjalës.
• Shkruan dhe lexon fjalë me shkronjën gj dhe shkronjat e mësuara.
• Shkruan fjalë mbi bazën e figurave.</td><td>Fjalë kyçe:
gjyshi, gjëegjëzë</td></tr>
<tr><td>Teknika dhe strategji:
• Bisedë rreth figurës
• Analizë e sintezë
• Veprimtari në dyshe</td></tr>
<tr><td colspan="3">Burimet e informacionit dhe mjete:
Abetare, shkronja Gj, gj, etiketa fjalësh, foto, libra për fëmijë, gjëegjëza</td><td>Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë
Arte
Edukim me të drejtat e fëmijëve</td></tr>
<tr><td colspan="4">Përshkrim kontekstual i situatës:
Veprimtari paraprake:

Nxënësit njoftohen që më parë për të sjellë secili nga një gjëegjëzë. I palosin dhe i hedhin në një kuti.
Hapen disa fletë dhe lexohen gjëegjëzat. Nxënësit përpiqen të gjejnë gjëegjëzat e dëgjuara.</td></tr>
</table>

Veprimet në situatë:

Hapi 1: Bisedë rreth figurës

Mësuesja nxit nxënësit të vërejnë figurën në tekst. Nxënësit vërejnë figurën dhe tregojnë çfarë shohin dhe çfarë kuptojnë. Ndihmohen me pyetjet:

- Çfarë po bëjnë fëmijët? Si duken ata? Pse mendoni se janë të kënaqur? Po ju si do të ndiheshit?

Hapi i dytë: Analizë e sintezë

Mësuesja shkruan në tabelë fjalinë: *Gjyshi tregon gjëegjëza.*

Nxënësit lexojnë fjalinë korazi. Kryhet procesi i analizës duke e ndarë fjalinë në fjalë dhe fjalët në rrokje, për shkëputjen e tingullit dhe shkronjës Gj, gj.

Mësuesja ndihmon me pyetjet :Sa fjalë ka fjalia? Sa rrokje ka fjala gjyshi? Sa shkronja ka? Cilat janë zanore? Po bashkëtingëllore?

Nxënësit shqiptojnë tingullin e ri gj.

Mësuesja nxit nxënësit të gjejnë fjalë të tjera me shkronjën gj në fillim, në mes dhe në fund të fjalës.

Shkruhen fjalët në tabelë dhe qarkohet shkronja e re.

Hapi i tretë: Prezantim i shkronjës

Mësuesja paraqet grafikun e shkronjës Gj, gj. Nxënësit bëjnë dallimin e shkronjës së madhe e të vogël të shtypit.

Shkruhet shkronja në tabelë.

Lëvizet dora në ajër nën drejtimin e mësueses sipas grafikut të shkronjës Gj,gj.

Nxënësit shkruajnë nga 2-3 rreshta me shkronjën Gj,gj në fletoren individuale.

Hapi i katërt: Veprimtari në dyshe

Vizatohen 1-2 figura që kanë shkronjën gj.

Demonstrim i rezultateve të arritura:

Nxënësit shkruajnë fjalët mbi bazën e figurave: gjethe,gjilpërë, gjerdan, gjashtë, gjirafë, gjarpër.

Lexohen fjalët e shkruara.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- Përshkruan mbi bazën e figurave.
- Shqipton, shkruan dhe lexon tingullin dhe shkronjën Gj, gj.
- Qarkon shkronjën Gj, gj të shtypit në pozicione të ndryshme të fjalës.
- Shkruan dhe lexon fjalë me shkronjën gj dhe shkronjat e mësuara.
- Shkruan fjalë mbi bazën e figurave.

Detyra:

1. Shkruhen nga 2 rreshta me shkronjën e madhe e të vogël të shtypit Gj, gj.
2. Shkruhen fjalë me shkronjën Gj, gj.

3. Shkruhen 3 fjali me shkronjat e mësuara.			
Refleksione:			
Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 1	Klasa: 1
Tema mësimore: Punim e shkrim i shkronjës Gj,gj. Abetare pune fq. 51			Situata e të nxënit: Gjëegjëzat
R.N.sipas kompetencave kyçe: **Nxënësi:** K.1 paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup. K.3 ndjek udhëzimet e dhëna në një tekst për të realizuar një veprim / aktivitet / detyrë, që kërkohet. K.3 mbikëqyr në mënyrë të pavarur përparimin e vet në një detyrë, aktivitet duke përdorur teknika të ndryshme për gjetjen e gabimeve (si shënim të gabimeve - vështirësive) dhe i korrigjon ato derisa gjen zgjidhjen. K.4 identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë. K.6 shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive.			
R.N. të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: • Shkruan shkronjën Gj,gj të madhe e të vogël të shtypit mbi bazën e modelit. • Shkruan fjalë me shkronjën gj mbi bazën e figurave të dhëna. • Formon e shkruan fjalë 2- 3 rrokëshe mbi bazën e rrokjeve të dhëna. • U përgjigjet pyetjeve të dhëna me shkrim.			Fjalë kyçe: gjyshi, gjëegjëzë, gjarpri,gjashta, qengji Teknika dhe strategji: • Lojë • Punë në grup • Punë individuale • Veprimtari në dyshe
Burimet e informacionit dhe mjete: Abetare, shkronja Gj, gj, etiketa fjalësh, foto, libra për fëmijë, gjëegjëza			Lidhja me fushat e tjera: Matematikë Arte Edukim me të drejtat e fëmijëve
Përshkrim kontekstual i situatës:			

Veprimtari paraprake:

Nxënësit do të tregojnë shkurt për gjyshin e tyre. Mësuesja ndihmon me pyetjet:

- Si quhet? Si kujdeset për ty?

Veprimet në situatë:

Hapi 1: Lojë

Mësuesja ndan nxënësit në dy grupe. Njëri grup shkruan shkronjën Gj të madhe të shtypit , ndërsa grupi tjetër shkruan shkronjën gj të vogël të shtypit. Në momentin që mësuesja thotë TANI, nxënësit lëvizin nëpër klasë dhe formojnë çiftet e shkronjave Gj-gj.

Hapi i dytë: Punë në grup

Mësuesja u kërkon nxënësve të komentojnë figurat (gjarpri, gjashta, qengji).

Për secilën figurë pyet: Çfarë është? Për çfarë nevojitet? A ju pëlqen? Pse?

Lexohen fjalët në mënyrë globale dhe plotësohen kutizat bosh me shkronjën gj.

Hapi i tretë: Punë individuale

Mësuesja paraqet grafikun e shkronjës Gj, gj.

Shkruhet shkronja në tabelë.

Lihen të shkruajnë vetëm një shkronjë në Abetaren e punës dhe kur bindet se e kanë shkruar si duhet, i lë të punojnë në mënyrë të pavarur.

Hapi i katërt: Veprimtari në dyshe

Nxënësit punojnë në dyshe për të plotësuar detyrat e tjera në Abetaren e punës.

Mësuesja ndjek punën e nxënësve dhe ndihmon për çdo paqartësi që mund të kenë duke i shkruar fjalët apo fjalitë në tabelë.

Demonstrim i rezultateve të arritura:

Nxënësit shkruajnë fjalët gjyshi, gjëegjëzë, qengji.

Formojnë fjali me fjalët e shkruara.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- Shkruan shkronjën Gj,gj të madhe e të vogël të shtypit mbi bazën e modelit.
- Shkruan fjalë me shkronjën gj mbi bazën e figurave të dhëna.
- Formon e shkruan fjalë 2- 3 rrokëshe mbi bazën e rrokjeve të dhëna.
- U përgjigjet pyetjeve të dhëna me shkrim

Detyra:

1. Shkruhen fjalë me shkronjën Gj,gj.

2. Shkruhen 5 fjali me shkronjat e mësuara.			
Refleksione:			
Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 1	Klasa: 1
Tema mësimore: Punim e lexim i shkronjës Gj, gj. Faqe 77 e Abetares			Situata e të nxënit: Gjëegjëzat
R.N. sipas kompetencave kyçe: Nxënësi: K.1 shpreh me gojë për 3-5 minuta para moshatarëve dhe të tjerëve përjetimet dhe emocionet që e kanë shoqëruar gjatë dëgjimit të një tregimi apo përralle. K.3 parashtron pyetje dhe përgjigjet në pyetjet për temën /problemin/detyrën e dhënë në njërën nga format e të shprehurit. K.4 identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë. K.6 shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive.			
R.N. të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: • Lexon fjalitë qartë dhe saktë. • Përshkruan figurat që ilustrojnë gjëegjëzat. • Gjen zgjidhjen e gjëegjëzave të dhëna në tekst.			Fjalë kyçe: gjyshi, gjëegjëzë, gërshërë, gjumi, gjilpërë, gjeli Teknika dhe strategji: • Stuhi mendimi • Punë në grup • Punë individuale • Veprimtari në dyshe
Burimet e informacionit dhe mjete: Abetare, shkronja Gj, gj, etiketa fjalësh, foto, libra për fëmijë, gjëegjëza, materiale vizatimi			Lidhja me fushat e tjera: Matematikë Arte Edukim me të drejtat e fëmijëve
Përshkrim kontekstual i situatës: Veprimtari paraprake: Nxënësit tregojnë gjëegjëza që dinë për 3-4' dhe gjejnë zgjidhjet. Mësuesja nxit nxënësit në bisedë:			

-Çfarë janë gjëegjëzat? Si duhet vepruar që t'i gjejmë saktë përgjigjet? (lidhja kuptimore me sendin ose objektin që përshkruhet në gjëegjëzë). Përse përdoren gjëegjëza?

Veprimet në situatë:

Hapi 1: Punë në grupe

Nxënësit organizohen në grupe.

Secilit grup i shpërndahen gjëegjëzat e tekstit dhe figurat përkatëse. Nxënësit do të lexojnë në heshtje gjëegjëzat dhe do të bëjnë lidhjen me figurën përkatëse. Mbasi të jenë bindur për gjetjet e duhura i ngjitin në një fletë. Mësuesja ndjek nga afër punën e nxënësve dhe ndihmon për çdo vështirësi.

Lexohen nga disa nxënës dhe bëhen korrigjimet e nevojshme.

Hapi i dytë: Veprimtari në dyshe

Mësuesja u kërkon nxënësve të punojnë në dyshe me tekstin.

Nxënësi i parë lexon një gjëegjëzë, tjetri gjen zgjidhjen. Për gjëegjëzat e tjera, nxënësit ndërrojnë rolet,

Dëgjohen disa dyshe.

Hapi i tretë: Punë individuale

Mësuesja u kërkon nxënësve të shkruajnë njërën prej gjëegjëzave që pëlqejnë në fletë dhe ta ilustrojnë me vizatim.

Punët e nxënësve ngjiten në këndin e klasës.

Demonstrim i rezultateve të arritura:

Nxënësit lexojnë gjëegjëzat në tekst.

Gjejnë zgjidhjet e gjëegjëzave.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- Lexon fjalitë qartë dhe saktë.
- Përshkruan figurat që ilustrojnë gjëegjëzat.
- Gjen zgjidhjen e gjëegjëzave të dhëna në tekst.

Detyra:

1. Shkruhen dy gjëegjëza të tjera të gjetura nga burime të ndryshme.
2. Ilustrohen me vizatim.

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 1	Klasa: 1

<table>
<tr><td>Tema mësimore:
Ushtrime aplikative për shkrim dore. Shkronja Gj,gj.</td><td>Situata e të nxënit:
Gjëegjëzat</td></tr>
<tr><td colspan="2">R.N. sipas kompetencave kyçe:
Nxënësi:
K.3 ndjek udhëzimet e dhëna në një tekst për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë, që kërkohet.
K.3 mbikëqyr në mënyrë të pavarur përparimin e vet në një detyrë, aktivitet duke përdorur teknika të ndryshme për gjetjen e gabimeve (si shënim të gabimeve - vështirësive) dhe i korrigjon ato derisa gjen zgjidhjen.
K.4 identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë.
K.6 shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive.</td></tr>
<tr><td rowspan="2">R.N. të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:
Nxënësi:
• Shkruan shkronjën Gj,gj të madhe e të vogël të dorës mbi bazën e modelit.
• Shkruan fjalë me shkronjën Gj,gj mbi bazën e modelit.
• Shkruan fjalë e fjali me shkronjat e mësuara me të diktuar.
• Ruan hapësirat midis fjalëve.</td><td>Fjalë kyçe:
gjyshi, gjëegjëzë, gjumi, gjeli, shkronjat, gjilpërë, gërshërë.</td></tr>
<tr><td>Teknika dhe strategji:
• Lojë
• Punë në grup
• Punë individuale
• Veprimtari në dyshe</td></tr>
<tr><td>Burimet e informacionit dhe mjete:
Abetare, shkronja Gj,gj e dorës, etiketa fjalësh me shkrim dore, foto, libra për fëmijë, gjëegjëza.</td><td>Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë, Arte,
Edukim me të drejtat e fëmijëve</td></tr>
<tr><td colspan="2">Përshkrim kontekstual i situatës:
Veprimtari paraprake:
Nxënësit do të kujtojnë gjëegjëzat që mësuan në orën e Abetares dhe për çdo zgjidhje gjejnë etiketën përkatëse të shkruar me shkrim dore: gjumi, gjeli, shkronjat, gjilpërë, gërshërë.

Veprimet në situatë:
Hapi 1: Lojë</td></tr>
</table>

Mësuesja orienton nxënësit:

Mbyllini sytë dhe ngrini lart dorën që shkruani. Provojmë të lëvizim dorën në mënyrë që të shkruajmë shkronjën e madhe dhe të vogël të dorës ***Gj,gj.***

Hapi i dytë: Punë në grup

Mësuesja paraqet para nxënësve shkronjën e madhe e të vogël të dorës ***Gj,gj.***

Ngrihen 2-3 nxënës në tabelë për ta shkruar.

I udhëzon nxënësit të shkruajnë shkronjat në fletë të bardha me lapsa me ngjyra.

Më pas nxënësit shkruajnë në Abetaren e punës shkronjat dhe fjalët sipas modelit. Mësuesja ndjek punën e nxënësve dhe mbasi bindet që e shkruajnë mire i lë të punojnë në mënyrë të pavarur.

Hapi i tretë: Punë individuale

Nxënësit shkruajnë me të diktuar fjalët dhe fjalinë në fletoren individuale:

gjuha, gjeli, gjumi, Gjirokastra, Gjakova

Gjuha shqipe është e bukur.

Hapi i katërt: Veprimtari në dyshe

Nxënësit punojnë në dyshe sipas niveleve për të plotësuar balonat me shkronjën gj.

Balonat përgatiten paraprakisht dhe nxënësit shkruajnë shkronjën ***Gj,gj*** (niveli i parë), fjalë me shkronjën ***Gj,gj*** (niveli i dytë).

Mësuesja ndjek punën e nxënësve dhe ndihmon për çdo vështirësi që mund të kenë.

Balonat e përgatitura vendosen në këndin e punimeve.

Nxënësit vlerësohen dhe stimulohen për pjesëmarrjen në çdo etapë të orës.

Demonstrim i rezultateve të arritura:

Nxënësit shkruajnë shkronjën ***Gj,gj*** sipas modelit.

Shkruajnë fjalë dhe fjali me shkronjën ***Gj,gj***.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- Shkruan shkronjën ***Gj,gj*** të madhe e të vogël të dorës mbi bazën e modelit.
- Shkruan fjalë me shkronjën ***Gj,gj*** mbi bazën e modelit.
- Shkruan fjalë e fjali me shkronjat e mësuara me të diktuar.
- Ruan hapësirat midis fjalëve.

Detyra:

1. Shkruhen nga dy rreshta me shkronjën ***Gj,gj.***
2. Shkruhen 3 fjali me shkronjat e mësuara.

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 1	Klasa: 1

<table>
<tr><td>Tema mësimore:
Punim i faqes 76-77 të Abetares. Gjëegjëzat</td><td>Situata e të nxënit:
Gjuha shqipe</td></tr>
<tr><td colspan="2">R.N. sipas kompetencave kyçe:
Nxënësi:
K.1 paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup.
K.3 parashtron pyetje dhe përgjigjet në pyetjet për temën /problemin/ detyrën e dhënë në njërën nga format e të shprehurit.
K.3 ndjek udhëzimet e dhëna në një tekst për të realizuar një veprim / aktivitet / detyrë, që kërkohet.
K.4 identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë.
K.6 shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive.
K.7 realizojnë punime origjinale, vetjake duke përdorur figurat e gjetura nga burime informacioni, si një formë për të shprehur emocionet e tyre.</td></tr>
<tr><td rowspan="2">R.N. të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:
Nxënësi:
• Lexon fjalitë qartë dhe saktë.
• Analizon dhe sintetizon rrokje, fjalë dhe fjali.
• Lexon dhe shkruan emra njerëzish që kanë shkronjën Gj në trup të tyre.
• Përdor pikën si shenjë pikësimi.</td><td>Fjalë kyçe:
gjyshi, gjëegjëzë, gërshërë, gjumi, gjilpërë, gjeli</td></tr>
<tr><td>Teknika dhe strategji:
• Stuhi mendimi
• Punë në grup
• Punë individuale
• Veprimtari në dyshe</td></tr>
<tr><td>Burimet e informacionit dhe mjete:
Abetare, shkronja Gj, gj, etiketa fjalësh, foto, libra për fëmijë, gjëegjëza, materiale vizatimi</td><td>Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë
Arte
Edukim me të drejtat e fëmijëve</td></tr>
<tr><td colspan="2">Përshkrim kontekstual i situatës:
Veprimtari paraprake:
Mësuesja shkruan në tabelë fjalën” Gjuha shqipe”.
U kërkon nxënësve të shkruajnë një fjali për gjuhën shqipe.
Nxënësit shkruajnë fjalitë dhe i lexojnë me zë të lartë.
Fjalitë më të bukura vendosen në një kënd me titull “Gjuha shqipe”.</td></tr>
</table>

Veprimet në situatë:

Hapi 1: Punë në grupe

Nxënësit organizohen në grupe.

Secili grup do të gjejë fjalë me rrokjet gja,gje, gju, gji, gje, gjo dhe do t'i shkruajë në një fletë A/4.

Lexohen dhe numërohen fjalët e shkruara nga nxënësit.

Hapi i dytë: Veprimtari në dyshe

Mësuesja u kërkon nxënësve të punojnë në dyshe me tekstin.

Nxënësit do të qarkojnë rrokjet me shkronjën gj në fjalët e dhëna.

Do të lidhin me shigjetë rrokjen me pjesën tjetër të fjalës.

Do të shkruajnë fjali duke plotësuar atë me fjalën që mungon.

Mësuesja ndjek nga afër punën e nxënësve dhe ndihmon nxënësit që mund të kenë vështirësi.

Nxënësit kontrollojnë punën me njëri-tjetrin duke këmbyer librat dhe më pas lexohen me zë të lartë.

Theksohet përdorimi i shkronjës së madhe në shkrimin e emrave të qyteteve dhe i pikës në fund të fjalive.

Hapi i tretë: Punë individuale

Mësuesja u kërkon nxënësve të shkruajnë emra njerëzish me shkronjën Gj.

Nxënësit shkruajnë dhe më pas i lexojnë.

Demonstrim i rezultateve të arritura:

Nxënësit plotësojnë ushtrimet në tekst.

Shkruajnë emra njerëzish me shkronjën Gj.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- Lexon fjalitë qartë dhe saktë.
- Analizon dhe sintetizon rrokje, fjalë dhe fjali.
- Lexon dhe shkruan emra njerëzish që kanë shkronjën Gj në trup të tyre.
- Përdor pikën si shenjë pikësimi.

Detyra:

1. Shkruajnë fjali me shkronjën Gj, gj.

Refleksione:

<table>
<tr><td>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla: 1</td><td>Klasa: 1</td></tr>
<tr><td colspan="3">Tema mësimore:
Punim i shkronjës Th,t h. Faqe 78 e Abetares</td><td>Situata e të nxënit:
Skënderbeu</td></tr>
<tr><td colspan="4">R.N. sipas kompetencave kyçe:
Nxënësi:
K.1 paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup.
K.3 ndjek udhëzimet e dhëna në një tekst për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë, që kërkohet.
K.3 parashtron pyetje dhe përgjigjet në pyetjet për temën/problemin/detyrën e dhënë në njërën nga format e të shprehurit.
K.6 shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive.</td></tr>
<tr><td colspan="3" rowspan="2">R.N. të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:
Nxënësi:
• Përshkruan mbi bazën e figurave duke folur rrjedhshëm, qartë dhe me intonacion.
• Shqipton, shkruan dhe lexon tingullin dhe shkronjën Th,th.
• Qarkon shkronjën Th,th të shtypit në pozicione të ndryshme të fjalës.
• Shkruan dhe lexon fjalë me shkronjën th dhe shkronjat e mësuara.</td><td>Fjalë kyçe:
Skënderbeu, thënie, thupra, theu</td></tr>
<tr><td>Teknika dhe strategji:
• Bisedë rreth figurës
• Analizë e sintezë
• Veprimtari në dyshe</td></tr>
<tr><td colspan="3">Burimet e informacionit dhe mjete:
Abetare, shkronja Th, th, etiketa fjalësh, foto të Skënderbeut, libra për fëmijë, tregime.</td><td>Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë
Arte</td></tr>
<tr><td colspan="4">Përshkrim kontekstual i situatës:
Veprimtari paraprake:

Nxënësit njoftohen që më parë të pyesin prindërit për Skënderbeun.
Ora e mësimit fillon me një bisedë rreth Skënderbeut. Mësuesja paraqet foto të Skënderbeut dhe nxit nxënësit të tregojnë ç’dinë për të:
- Kë po shihni në foto?
- Çfarë mësuat nga prindërit për Skënderbeun?</td></tr>
</table>

Veprimet në situatë:

Hapi 1: Bisedë rreth figurës

Mësuesja nxit nxënësit të vërejnë figurën në tekst. Nxënësit vërejnë figurën dhe tregojnë çfarë shohin dhe çfarë kuptojnë. Ndihmohen me pyetjet:

- Kë po shikoni? Si janë veshur? Cili mendoni se është Skënderbeu? Cilët qëndrojnë para tij?

Çfarë mbajnë në duar? Çfarë mendoni se po bëjnë ata? Cili nga ju e di këtë ngjarje?

Hapi i dytë: Analizë e sintezë

Mësuesja shkruan në tabelë fjalinë: *Gjini nuk i theu thuprat.*

Nxënësit lexojnë fjalinë korazi. Kryhet procesi i analizës duke e ndarë fjalinë në fjalë dhe fjalët në rrokje, për shkëputjen e tingullit dhe shkronjës Th, th.

Mësuesja ndihmon me pyetjet :

-Sa fjalë ka fjalia? Në cilat fjalë ndodhet shkronja th? Sa rrokje ka fjala theu? Po fjala thuprat?

Nxënësit shqiptojnë tingullin e ri th.

Paraqiten figura që përmbajnë shkronjën th në tabelë, emërtohen nga nxënësi dhe tregojnë ku dëgjojnë tingullin th (thesi, gjethe, thikë etj).

Mësuesja nxit nxënësit të gjejnë fjalë të tjera me shkronjën th në fillim, në mes dhe në fund të fjalës.

Shkruhen fjalët në tabelë dhe qarkohet shkronja e re.

(Nxënësit duke ecur para klasës mund të numërojnë fjalë me shkronjën th).

Hapi i tretë: Prezantim i shkronjës

Mësuesja paraqet grafikun e shkronjës Th, th. Nxënësit bëjnë dallimin e shkronjës së madhe e të vogël të shtypit.

Shkruhet shkronja në tabelë.

Lëvizet dora në ajër nën drejtimin e mësueses sipas grafikut të shkronjës Th, th.

Nxënësit shkruajnë nga 2-3 rreshta me shkronjën Gj, gj në fletoren individuale.

Vizatohen 1-2 figura që kanë shkronjën gj.

Demonstrim i rezultateve të arritura:

Nxënësit bashkojnë rrokjet për të formuar fjalë dhe i shkruajnë: thesi, rrethi, thana, thumbi, uthull, thoi;

thelloj, i thellë, thirri, kthehem, thyhej.

Lexohen fjalët e shkruara.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- Përshkruan mbi bazën e figurave.
- Shqipton, shkruan dhe lexon tingullin dhe shkronjën Th, th të fjalës.
- Shkruan dhe lexon fjalë me shkronjën th dhe shkronjat e mësuara.

Detyra:

1. Shkruhen nga 2 rreshta me shkronjën e madhe e të vogël të shtypit Th, th.
2. Shkruhen fjalë me shkronjën Th,th.
3. Gjeni në libra për fëmijë fjalë të tjera me shkronjën th dhe sillini në klasë.

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 1	Klasa: 1
Tema mësimore: Punim e shkrim i shkronjës Th,th. Abetare pune fq. 52			Situata e të nxënit: Skënderbeu

R.N. sipas kompetencave kyçe:

Nxënësi:

K.1 paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup.

K.3 ndjek udhëzimet e dhëna në një tekst për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë, që kërkohet.

K.3 mbikëqyr në mënyrë të pavarur përparimin e vet në një detyrë, aktivitet duke përdorur teknika të ndryshme për gjetjen e gabimeve (si shënim të gabimeve - vështirësive) dhe i korrigjon ato derisa gjen zgjidhjen.

K.4 identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë.

K.6 shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive.

R.N. të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: • Shkruan shkronjën Th, th të shtypit mbi bazën e modelit. • Shkruan fjalë me shkronjën gj mbi bazën e figurave të dhëna. • Formon e shkruan fjalë 2- 3 rrokëshe mbi bazën e rrokjeve të dhëna. • Formon grupe fjalësh me fjalët e dhëna duke i lidhur sipas kuptimit. • Shkruan fjalitë e dhëna duke ruajtur hapësirat midis fjalëve.	Fjalë kyçe: gjyshi, gjëegjëzë, gjarpri,gjashta, qengji Teknika dhe strategji: • Lojë • Punë në grup • Punë individuale • Veprimtari në dyshe
Burimet e informacionit dhe mjete: Abetare, shkronja Th, th, etiketa fjalësh, foto të Skënderbeut, libra për fëmijë, videoprojektor, laptop, CD	Lidhja me fushat e tjera: Matematikë Arte

Përshkrim kontekstual i situatës:

Veprimtari paraprake:

Në videoprojektor paraqiten foto të Skënderbeut, armët e Skënderbeut, monumenti i Skënderbeut në sheshin Skënderbej.

Nxiten nxënësit të flasin rreth fotove.

Mund të ftohet dhe një nga gjyshërit e nxënësve për të treguar mbi jetën e Skënderbeut.

Veprimet në situatë:

Hapi 1: Lojë

Mësuesja ndan nxënësit në dy grupe. Njëri grup shkruan shkronjën Th të madhe të shtypit, ndërsa grupi tjetër shkruan shkronjën th të vogël të shtypit. Në momentin që mësuesja thotë TANI, nxënësit lëvizin nëpër klasë dhe formojnë çiftet e shkronjave Th – th.

Hapi i dytë: Punë në grup

Mësuesja u kërkon nxënësve të komentojnë figurat (thesi, gjethe, thuthuq).

Për secilën figurë pyet: Çfarë është? Për çfarë nevojitet? A ju pëlqen? Pse?

Lexohen fjalët në mënyrë globale dhe plotësohen kutizat bosh me shkronjën th.

Hapi i tretë: Punë individuale

Mësuesja paraqet grafikun e shkronjës Th, th.

Shkruhet shkronja në tabelë.

Lihen të shkruajnë vetëm një shkronjë në Abetaren e punës dhe kur bindet se e kanë shkruar si duhet, i lë të punojnë në mënyrë të pavarur.

Nxënësit këmbejnë librat me njëri-tjetrin për të parë si kanë punuar.

Hapi i katërt: Veprimtari në dyshe

Nxënësit punojnë në dyshe për të plotësuar detyrat e tjera në Abetaren e punës.

Mësuesja ndjek punën e nxënësve dhe ndihmon për çdo paqartësi që mund të kenë duke i shkruar fjalët apo fjalitë në tabelë: them mësimet, thërras motrën, puth nënën, mbath mbathjet, thith aromën, kthej makinën.

Demonstrim i rezultateve të arritura:

Nxënësit shkruajnë fjalët : vëth, thesi, thupra, tharëse.

Formojnë fjali me fjalët e shkruara.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- Shkruan shkronjën Th,th të madhe e të vogël të shtypit mbi bazën e modelit.
- Shkruan fjalë me shkronjën th mbi bazën e figurave të dhëna.
- Formon e shkruan fjalë 2- 3 rrokëshe mbi bazën e rrokjeve të dhëna.
- Formon grupe fjalësh me fjalët e dhëna duke i lidhur sipas kuptimit.
- Shkruan fjalitë e dhëna duke ruajtur hapësirat midis fjalëve.

Detyra:

1. Shkruhen fjalë me shkronjën Th.
2. Shkruhen 5 fjali me shkronjat e mësuara.

Refleksione:

<table>
<tr><td>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla: 1</td><td>Klasa: 1</td></tr>
<tr><td colspan="3">Tema mësimore:
Punim e lexim i shkronjës Th, th. Faqe 79 e Abetares</td><td>Situata e të nxënit:
Skënderbeu</td></tr>
<tr><td colspan="4">R.N. sipas kompetencave kyçe:
Nxënësi:
K.1 shpreh me gojë për 3-5 minuta para moshatarëve dhe të tjerëve përjetimet dhe emocionet që e kanë shoqëruar gjatë dëgjimit të një tregimi apo përralle.
K.3 parashtron pyetje dhe përgjigjet në pyetjet për temën /problemin/ detyrën e dhënë në njërën nga format e të shprehurit.
K.4 identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë.
K.6 shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive.</td></tr>
<tr><td colspan="3" rowspan="2">R.N. të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:
Nxënësi:
• Lexon tekstin qartë dhe saktë.
• Përshkruan figurën që ilustron tekstin.
• U përgjigjet pyetjeve që lidhen me përmbajtjen.
• Dallon titullin në pjesën e dhënë.
• Pyet për t’u sqaruar rreth përmbajtjes së tekstit ose rreth fjalëve të panjohura për të.</td><td>Fjalë kyçe:
Skënderbeu, thupra, trima, porosi</td></tr>
<tr><td>Teknika dhe strategji:
• Parashikim i ngjarjes
• Lexim me ndalesa
• Punë individuale</td></tr>
<tr><td colspan="3">Burimet e informacionit dhe mjete:
Abetare, shkronja Th, th, etiketa fjalësh, foto, libra për fëmijë, tregime, materiale vizatimi</td><td>Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë
Arte
Shoqëria dhe mjedisi</td></tr>
<tr><td colspan="4">Përshkrim kontekstual i situatës:
Veprimtari paraprake:
Mësuesja u kërkon nxënësve të kujtojnë përrallën “Plaku dhe rrepa”.
- Çfarë donte të bënte plaku? (të shkulte një rrepë).
- Çfarë bëri kur nuk e shkuli dot? (thirri plakën, qenin e shtëpisë e më pas macen).
- Ç’mësuat nga kjo përrallë?</td></tr>
</table>

Veprimet në situatë:

Hapi 1: Parashikim i ngjarjes

Mësuesja shkruan titullin në tabelë: *Porosia e fundit e Skënderbeut*.

Nxiten nxënësit të mendojnë për 2-3' se cila mund të ishte porosia e tij u fundit duke u bazuar edhe te figura.

Dëgjohen disa nxënës dhe shkruhen përgjigjet e tyre në tabelë.

Hapi i dytë: Lexim me ndalesa

Mësuesja ndan tekstin në pjesë dhe lexohet me ndalesa:

Ndalesa e parë: që nga fillimi deri te "… së bashku thyeji!" Pyet:

- Kur i thirri Skënderbeu trimat? Pse i thirri? Çfarë i tha Gjinit? Çfarë mendoni se do të ndodhë? Pse?

Ndalesa e dytë: deri te "… thyen dot". Pyet:

- A ndodhi ashtu si menduat? Çfarë ndodhi? Si mendoni se vazhdon ngjarja?

Ndalesa e tretë: deri në fund. Mësuesja pyet:

- Çfarë i tha Skënderbeu Gjonit? Çfarë ndodhi? Cila ishte porosia e fundit e Skënderbeut? A ishte ashtu si menduat në fillim?

Hapi i tretë: Punë individuale

Mësuesja u kërkon nxënësve të lexojnë tekstin në heshtje dhe të drejtojnë pyetje nëqoftëse kanë.

Pyetjet e nxënësve shkruhen në tabelë dhe më pas u jepet përgjigje.

Lexohet teksti zinxhir nga nxënësit nga 2-3 fjali.

Demonstrim i rezultateve të arritura:

Nxënësit lexojnë tekstin me intonacion.

Nxjerrin mesazhin e tekstit.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- Lexon tekstin qartë dhe saktë.
- Lexon tekstin qartë dhe saktë.
- Përshkruan figurën që ilustron tekstin.
- U përgjigjet pyetjeve që lidhen me përmbajtjen.
- Dallon titullin në pjesën e dhënë.
- Pyet për t'u sqaruar rreth përmbajtjes së tekstit ose rreth fjalëve të panjohura për të. .

Detyra:

1. Lexohet teksti rrjedhshëm e me intonacion.
2. Shkruhen dy fjali për Skënderbeun.

Refleksione:

<table>
<tr><td>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla: 1</td><td>Klasa: 1</td></tr>
<tr><td colspan="3">Tema mësimore:
Ushtrime aplikative për shkrim dore. Shkronja Th,th.</td><td>Situata e të nxënit:
Skënderbeu</td></tr>
<tr><td colspan="4">R.N. sipas kompetencave kyçe:
Nxënësi:
K.3 ndjek udhëzimet e dhëna në një tekst për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë, që kërkohet.
K.3 mbikëqyr në mënyrë të pavarur përparimin e vet në një detyrë, aktivitet duke përdorur teknika të ndryshme për gjetjen e gabimeve (si shënim të gabimeve - vështirësive) dhe i korrigjon ato derisa gjen zgjidhjen.
K.4 identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë.
K.6 shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive.</td></tr>
<tr><td colspan="3" rowspan="2">R.N. të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:
Nxënësi:
• Shkruan shkronjën Th, th të madhe e të vogël të dorës mbi bazën e modelit.
• Shkruan fjalë me shkronjën Th, th mbi bazën e modelit.
• Shkruan fjalë e fjali me shkronjat e mësuara me të diktuar.
• Ruan hapësirat midis fjalëve.</td><td>Fjalë kyçe:
gjethe, thesi, Thethi</td></tr>
<tr><td>Teknika dhe strategji:
• Lojë
• Demonstrim
• Punë individuale
• Veprimtari në dyshe</td></tr>
<tr><td colspan="3">Burimet e informacionit dhe mjete:
Abetare, shkronja Th, th e dorës, etiketa fjalësh me shkrim dore, foto, libra për fëmijë</td><td>Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë
Arte
Edukim me të drejtat e fëmijëve</td></tr>
<tr><td colspan="4">Përshkrim kontekstual i situatës:
Veprimtari paraprake:
Nxënësit do të kujtojnë shkronjat e mësuar të dorës duke i lexuar në tabelë qorrazi dhe duke lexuar fjalë me shkrim dore të shkruara në etiketa të ndryshme. Për çdo fjalë mësuesja pyet: Sa shkronja ka? Cilat janë zanore? Cilat janë bashkëtingëllore?</td></tr>
</table>

Veprimet në situatë:

Hapi 1: Lojë

Mësuesja orienton nxënësit :

-Mbyllini sytë dhe ngrini lart dorën që shkruani. Provojmë të lëvizim dorën në mënyrë që të shkruajmë shkronjën e madhe dhe të vogël të dorës ***Th, th.***

Hapi i dytë: Demonstrim

Mësuesja paraqet para nxënësve shkronjën e madhe e të vogël të dorës ***Th, th..***

Ngrihen 2-3 nxënës në tabelë për ta shkruar.

I udhëzon nxënësit të shkruajnë shkronjat në fletë të bardha me lapsa me ngjyra.

Më pas nxënësit shkruajnë në Abetaren e punës shkronjat dhe fjalët sipas modelit.

Mësuesja ndjek punën e nxënësve dhe mbasi bindet që e shkruajnë mirë i lë të punojnë në mënyrë të pavarur.

Hapi i tretë: Punë individuale

Nxënësit shkruajnë me të diktuar fjalët dhe fjalinë në fletoren individuale:

thesi, gjethe, thupra, uthulla, thembra

Thethi është fshat i bukur.

Hapi i katërt: Veprimtari në dyshe

Nxënësit punojnë në dyshe sipas niveleve për të plotësuar balonat me shkronjën th.

Balonat përgatiten paraprakisht dhe nxënësit shkruajnë shkronjën ***Th, th*** (niveli i parë), fjalë me shkronjën ***Th, th*** (niveli i dytë) dhe fjali (niveli i tretë).

Mësuesja ndjek punën e nxënësve dhe ndihmon për çdo vështirësi që mund të kenë.

Balonat e përgatitura vendosen në këndin e punimeve.

Demonstrim i rezultateve të arritura:

Nxënësit shkruajnë shkronjën ***Th, th*** sipas modelit.

Shkruajnë fjalë dhe fjali me shkronjën ***Th,th.***

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- Shkruan shkronjën ***Th, th*** të madhe e të vogël të dorës mbi bazën e modelit.
- Shkruan fjalë me shkronjën ***Th, th*** mbi bazën e modelit.
- Shkruan fjalë e fjali me shkronjat e mësuara me të diktuar.
- Ruan hapësirat midis fjalëve.

Detyra:

1. Shkruhen nga dy rreshta me shkronjën ***Th, th.***
2. Shkruhen fjalë dhe fjali me shkronjën ***Th,th***.

Refleksione:

<table>
<tr><td>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla: 1</td><td>Klasa: 1</td></tr>
<tr><td colspan="3">Tema mësimore:
Punim i faqes78 -79 të Abetares. Porosia e fundit e Skënderbeut</td><td>Situata e të nxënit:
Skënderbeu</td></tr>
<tr><td colspan="4">R.N. sipas kompetencave kyçe:
Nxënësi:
K.1 paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup.
K.3 parashtron pyetje dhe përgjigjet në pyetjet për temën/problemin/detyrën e dhënë në njërën nga format e të shprehurit.
K.3 ndjek udhëzimet e dhëna në një tekst për të realizuar një veprim/aktivitet /detyrë, që kërkohet.
K.4 identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë.
K.6 shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive.
K.7 realizojnë punime origjinale, vetjake duke përdorur figurat e gjetura nga burime informacioni, si një formë për të shprehur emocionet e tyre.</td></tr>
<tr><td colspan="3" rowspan="2">R.N. të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:
Nxënësi:
Lexon tekstin rrjedhshëm e me intonacion.
Interpreton në role.
Shkruan fjalë me shkronjën th mbi bazën e figurave.
Shkruan fjali me fjalët e dhëna.
Përdor pikën si shenjë pikësimi.</td><td>Fjalë kyçe:
Skënderbeu, trima, thupra, porosi</td></tr>
<tr><td>Teknika dhe strategji:
Stuhi mendimi
Punë në grup
Punë individuale
Veprimtari në dyshe
Dramatizim</td></tr>
<tr><td colspan="3">Burimet e informacionit dhe mjete:
Abetare, shkronja Th, th, etiketa fjalësh, foto, libra për fëmijë, materiale vizatimi</td><td>Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë
Arte
Edukim me të drejtat e fëmijëve</td></tr>
<tr><td colspan="4">Përshkrim kontekstual i situatës:
Veprimtari paraprake:
Mësuesja shtron për diskutim pyetjen:
- Cila ishte porosia e fundit e Skënderbeut? Pse Skënderbeu u la këtë porosi trimave të tij?
Dëgjon mendimet e nxënësve dhe plotëson.</td></tr>
</table>

Veprimet në situatë:

Hapi 1: Punë në grupe

Nxënësit organizohen në grupe.

Secili grup do të formojë fjali me fjalët: Skënderbeu, thupra, theu, porosi, thirri.

Fjalitë diskutohen në grup dhe përzgjidhen më të bukurat për t'u paraqitur para të tjerëve.

Hapi i dytë: Veprimtari në dyshe

Mësuesja u kërkon nxënësve të punojnë në dyshe me tekstin.

-Do të shkruajnë fjalët mbi bazën e figurave dhe të plotësojnë kutizat përkatëse:

gjethe, thesi, thika, tharëse, vëthë, thupër.

-Do të shkruajnë fjali duke plotësuar atë me fjalën që mungon:

Bashkimi theu thuprën. Genti tha mësimin. Mësuesja thirri fëmijët.

Mësuesja ndjek nga afër punën e nxënësve dhe ndihmon nxënësit që mund të kenë vështirësi.

Nxënësit kontrollojnë punën me njëri- tjetrin duke këmbyer librat dhe më pas lexohen me zë të lartë.

Theksohet përdorimi i shkronjës së madhe në fillim të fjalisë dhe përdorimi i pikës në fund të fjalive.

Hapi i tretë: Punë individuale

Lexim i tekstit me zë të lartë.

Hapi i katërt: Dramatizim

Dramatizohet pjesa nga nxënësit me grupe.

Demonstrim i rezultateve të arritura:

Nxënësit lexojnë tekstin rrjedhshëm e me intonacion.

Plotësojnë ushtrimet në tekst.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- Lexon tekstin rrjedhshëm e me intonacion.
- Analizon dhe sintetizon rrokje, fjalë dhe fjali.
- Shkruan fjalë me shkronjën th mbi bazën e figurave.
- Shkruan fjali me fjalët e dhëna.
- Përdor pikën si shenjë pikësimi.

Detyra:

1. Shkruajnë fjalitë e detyrës së fundit.

Refleksione:

<table>
<tr><td>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla: 1</td><td>Klasa: 1</td></tr>
<tr><td colspan="3">Tema mësimore:
Punim i shkronjës C, c. Faqe 80 e Abetares</td><td>Situata e të nxënit:
Zogjtë</td></tr>
<tr><td colspan="4">R.N. sipas kompetencave kyçe:
Nxënësi:
K.1 paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup.
K.3 ndjek udhëzimet e dhëna në një tekst për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë, që kërkohet.
K.3 parashtron pyetje dhe përgjigjet në pyetjet për temën/problemin/detyrën e dhënë në njërën nga format e të shprehurit.
K.5 bashkëpunon me të tjerët pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitetet në klasë, shkollë apo jashtë saj.
K.6 shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive.</td></tr>
<tr><td colspan="3" rowspan="2">R.N. të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:
Nxënësi:
• Përshkruan mbi bazën e figurave.
• Shqipton, shkruan dhe lexon tingullin dhe shkronjën C,c.
• Qarkon shkronjën C,c të shtypit në pozicione të ndryshme të fjalës.
• Shkruan dhe lexon fjalë me shkronjën c dhe shkronjat e mësuara.
• Shkruan fjalë duke plotësuar rrokjet e dhëna.</td><td>Fjalë kyçe:
trumcaku, cicërima, cicëron</td></tr>
<tr><td>Teknika dhe strategji:
• Bisedë rreth figurës
• Analizë e sintezë
• Veprimtari në dyshe</td></tr>
<tr><td colspan="3">Burimet e informacionit dhe mjete:
Abetare, shkronja C, c, etiketa fjalësh, foto, libra për fëmijë, vjersha për zogjtë</td><td>Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë
Arte
Edukim mjedisor</td></tr>
<tr><td colspan="4">Përshkrim kontekstual i situatës:
Veprimtari paraprake:
Mësuesja vendos në magnetofon cicërima zogjsh dhe lihen nxënësit të dëgjojnë për disa çaste.
- Çfarë po dëgjoni? Çfarë ndieni kur dëgjoni cicërimat e zogjve? Ku dëgjohen më shumë?
Kush di të imitojë cicërimat e tyre? Çfarë dini tjetër për zogjtë?</td></tr>
</table>

Veprimet në situatë:

Hapi 1: Bisedë rreth figurës

Mësuesja nxit nxënësit të vërejnë figurën në tekst. Nxënësit vërejnë figurën dhe tregojnë çfarë shohin dhe çfarë kuptojnë. Ndihmohen me pyetjet:

- Çfarë po bën vajza? Çfarë mban në duar? Ku ka qëndruar ajo? Kë po shikon ajo? Cila stinë mendoni se është? Pse mendoni kështu?

Hapi i dytë: Analizë e sintezë

Mësuesja shkruan në tabelë fjalinë: *Trumcaku cicëronte i gëzuar.*

Nxënësit lexojnë fjalinë korazi. Kryhet procesi i analizës duke e ndarë fjalinë në fjalë dhe fjalët në rrokje, për shkëputjen e tingullit dhe shkronjës c.

Mësuesja ndihmon me pyetjet :

-Sa fjalë ka fjalia? Sa rrokje ka fjala trumcaku? Sa shkronja ka? Cilat janë zanore? Po bashkëtingëllore?

Nxënësit shqiptojnë tingullin e ri c.

Mësuesja nxit nxënësit të gjejnë fjalë të tjera me shkronjën g në fillim, në mes dhe në fund të fjalës.

Shkruhen fjalët në tabelë dhe qarkohet shkronja e re.

Hapi i tretë: Prezantim i shkronjës

Mësuesja paraqet grafikun e shkronjës C,c. Nxënësit bëjnë dallimin e shkronjës së madhe e të vogël të shtypit. Shkruhet shkronja në tabelë. Lëvizet dora në ajër nën drejtimin e mësueses sipas grafikut të shkronjës C, c.

Nxënësit shkruajnë nga 2-3 rreshta me shkronjën C,c në fletoren individuale.

Hapi i katërt: Veprimtari në dyshe

Vizatohen 1-2 figura që kanë shkronjën c.

Demonstrim i rezultateve të arritura:

Nxënësit qarkojnë rrokjet që përmbajnë shkronjën c në fjalët e dhëna.

Shkruajnë fjalët duke plotësuar rrokjet e dhëna: speci, pica, kocka, grindaveci, ngrica, karroca, përtaci, karroca.

Lexohen fjalët e shkruara.

Vlerësimi i situatës:
Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- Përshkruan mbi bazën e figurave.
- Shqipton, shkruan dhe lexon tingullin dhe shkronjën C, c.
- Qarkon shkronjën C,c të shtypit në pozicione të ndryshme të fjalës.
- Shkruan dhe lexon fjalë me shkronjën c dhe shkronjat e mësuara.

Detyra:

1. Shkruhen nga 2 rreshta me shkronjën e madhe e të vogël të shtypit C, c.
2. Shkruhen fjalë me shkronjën C, c.
3. Mësojnë vjersha për zogjtë.

<table>
<tr><td colspan="4">Refleksione:</td></tr>
<tr><td>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla: 1</td><td>Klasa: 1</td></tr>
<tr><td colspan="3">Tema mësimore:
Punim e shkrim i shkronjës C, c Abetare pune fq. 53</td><td>Situata e të nxënit:
Zogjtë</td></tr>
<tr><td colspan="4">R.N. sipas kompetencave kyçe:
Nxënësi:
K.1 paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup.
K.3 ndjek udhëzimet e dhëna në një tekst për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë, që kërkohet.
K.3 mbikëqyr në mënyrë të pavarur përparimin e vet në një detyrë, aktivitet duke përdorur teknika të ndryshme për gjetjen e gabimeve (si shënim të gabimeve - vështirësive) dhe i korrigjon ato derisa gjen zgjidhjen.
K.4 identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë.
K.6 shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive.</td></tr>
<tr><td colspan="3" rowspan="2">R.N. të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:
Nxënësi:
• Shkruan shkronjën C,c mbi bazën e modelit.
• Shkruan fjalë me shkronjën c mbi bazën e figurave të dhëna.
• Formon e shkruan fjalë 2- 3 rrokëshe mbi bazën e rrokjeve të dhëna.
• Plotëson pjesën e fjalisë që mungon.
• Shkruan fjalë dhe fjali me të diktuar.</td><td>Fjalë kyçe:
gjyshi, gjëegjëzë, gjarpri,gjashta, qengji</td></tr>
<tr><td>Teknika dhe strategji:
• Lojë
• Punë në grup
• Punë individuale
• Veprimtari në dyshe</td></tr>
<tr><td colspan="3">Burimet e informacionit dhe mjete:
Abetare, shkronja C, c, etiketa fjalësh, foto, libra për fëmijë, vjersha</td><td>Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë
Arte
Edukim mjedisor</td></tr>
<tr><td colspan="4">Përshkrim kontekstual i situatës:
Veprimtari paraprake:
Nxënësit do të recitojnë vjershat që kanë mësuar për zogjtë.
Mësuesja lexon një vjershë nga librat për fëmijë.</td></tr>
</table>

Veprimet në situatë:

Hapi 1: Lojë

Mësuesja ndan nxënësit në dy grupe. Njëri grup shkruan shkronjën C të madhe të shtypit, ndërsa grupi tjetër shkruan shkronjën C të vogël të shtypit. Në momentin që mësuesja thotë TANI, nxënësit lëvizin nëpër klasë dhe formojnë çiftet e shkronjave C –c.

Hapi i dytë: Punë në grup

Mësuesja u kërkon nxënësve të komentojnë figurat: cirk, mace, këpucë.

Për secilën figurë pyet: Çfarë është? Për çfarë nevojitet? A ju pëlqen? Pse?

Lexohen fjalët në mënyrë globale dhe plotësohen kutizat bosh me shkronjën c.

Hapi i tretë: Punë individuale

Mësuesja paraqet grafikun e shkronjës C, c.

Shkruhet shkronja në tabelë.

Lihen të shkruajnë vetëm një shkronjë në Abetaren e punës dhe kur bindet se e kanë shkruar si duhet, i lë të punojnë në mënyrë të pavarur.

Hapi i katërt: Veprimtari në dyshe

Nxënësit punojnë në dyshe për të plotësuar detyrat e tjera në Abetaren e punës.

Mësuesja ndjek punën e nxënësve dhe ndihmon për çdo paqartësi që mund të kenë duke i shkruar fjalët apo fjalitë në tabelë:

Plotësohen grupet e fjalëve: eci rrugës, copëtoj bukën, ngacmoj shokët, pëlcas tullumbacen

Lidhen me shigjetë fjalitë: *Trumcaku copëton picën copa-copa. Keci i vogël ngacmon kecat e tjerë. Brirët e cjapit godasin me forcë.*

Shkruhet si duhet fjalia: Keci i vogël ngacmon kecat.

Nxënësit shkëmbejnë fletoret me njëri-tjetrin dhe të kontrollojnë si kanë punuar.

Demonstrim i rezultateve të arritura:

Nxënësit shkruajnë me të diktuar fjalët dhe fjalinë:

mace, kecat, cjapi, këpuca, copëtoj, tullumbace, trumcaku

Cicërimat e zogjve na kënaqin.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- Shkruan shkronjën C, c mbi bazën e modelit.
- Shkruan fjalë me shkronjën c mbi bazën e figurave të dhëna.
- Formon e shkruan fjalë 2- 3 rrokëshe mbi bazën e rrokjeve të dhëna.
- Plotëson pjesën e fjalisë që mungon.
- Shkruan fjalë dhe fjali me të diktuar.

Detyra: Shkruhen fjalë me shkronjën C, c.
Shkruhen 5 fjali me shkronjat e mësuara.

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 1	Klasa: 1
Tema mësimore: Punim e lexim i shkronjës C, c. Faqe 81 e Abetares			Situata e të nxënit: Zogjtë
R.N. sipas kompetencave kyçe: **Nxënësi:** K.1 shpreh me gojë për 3-5 minuta para moshatarëve dhe të tjerëve përjetimet dhe emocionet që e kanë shoqëruar gjatë dëgjimit të një tregimi apo përralle. K.3 parashtron pyetje dhe përgjigjet në pyetjet për temën /problemin/detyrën e dhënë në njërën nga format e të shprehurit; K.4 identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë. K.6 shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive. K.7 realizojnë punime origjinale, vetjake duke përdorur figurat e gjetura nga burime informacioni, si një formë për të shprehur emocionet e tyre.			
R.N. të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: • Parashikon rreth përmbajtjes së tekstit duke u mbështetur te titulli, ilustrimet. • Pyet për t'u sqaruar rreth përmbajtjes së tekstit ose rreth fjalëve të panjohura për të. • Lexon tekstin qartë dhe saktë. • U përgjigjet pyetjeve që lidhen me përmbajtjen.			Fjalë kyçe: Ola, trumcaku, pica, byreku, grimcon Teknika dhe strategji: • Punë në grup • Parashikimi i ngjarjes • Lexim me ndalesa • Punë individuale
Burimet e informacionit dhe mjete: Abetare, shkronja C,c, etiketa fjalësh, foto, libra për fëmijë, materiale vizatimi			Lidhja me fushat e tjera: Matematikë Arte Edukim mjedisor
Përshkrim kontekstual i situatës: *Veprimtari paraprake:* Mësuesja u kërkon nxënësve të emërtojnë objekte që kanë formë të rrumbullakët. Nxënësit mendojnë për 2- 3' dhe i shkruajnë fjalët në një fletë. I lexojnë dhe mësuesja i shkruan në tabelë (unaza, gjerdani, rrethi gjimnastikor etj). Më pas u shpërndan nxënësve rrathë prej letrave me ngjyra dhe i pyet se me cilën shkronjë u ngjan (o). -Ndajeni në mes. Cila shkronjë u formua?			

Veprimet në situatë:
Hapi 1: Parashikim i ngjarjes

Mësuesja shkruan titullin në tabelë dhe i nxit nxënësit të mendojnë se si zhvillohet ngjarja.

Nxënësit mendojnë disa çaste dhe më pas tregojnë si e kanë parashikuar ngjarjen.

Hapi i dytë: Lexim me ndalesa

Ndahet teksti në dy pjesë: pjesa e parë që nga fillimi deri te "…foli Ola".

Mbas leximit, mësuesja drejton pyetjet:

- Çfarë i kërkoi babai Olës? Cilat fjalë gjeti Ola? Çfarë mendoni se do të ndodhë më pas?

Pjesa e dytë deri te "… po e grimconte atë".

Mësuesja drejton pyetjet:

- A ndodhi ashtu si menduat? Çfarë ndodhi? Çfarë mendoni se do të ndodhë më pas?

Pjesa e tretë deri në fund:

- Pse u shqetësua Ola? Si përfundoi ngjarja? A e menduat dhe ju kështu?

Hapi i tretë: Punë individuale

Nxënësit lexojnë tekstin në heshtje dhe nënvizojnë fjalët që nuk i kuptuan.

Shpjegohen fjalët që mund të kenë të paqarta.

Lexohet teksti me zë të lartë nga nxënësit.

Demonstrim i rezultateve të arritura:

Nxënësit u përgjigjen pyetjeve rreth përmbajtjes me gojë:

- Çfarë i kërkoi babai Olës? Cilat fjalë gjeti Ola? Çfarë kishte ndodhur me byrekun? Cila pjesë u pëlqeu më shumë në këtë tekst?

Formojnë e shkruajnë fjali me fjalët pica, trumcaku, grimcon.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- Parashikon rreth përmbajtjes së tekstit duke u mbështetur te titulli, ilustrimet.
- Pyet për t'u sqaruar rreth përmbajtjes së tekstit ose rreth fjalëve të panjohura për të.
- Lexon tekstin qartë dhe saktë.
- U përgjigjet pyetjeve që lidhen me përmbajtjen.

Detyra:

1. Lexohet teksti rrjedhshëm.
2. Kopjohet pjesa që u pëlqen.

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 1	Klasa: 1
Tema mësimore: Ushtrime aplikative për shkrim dore. Shkronja **ë,c**.			Situata e të nxënit: Zogjtë
R.N. sipas kompetencave kyçe: Nxënësi: K.3 ndjek udhëzimet e dhëna në një tekst për të realizuar një veprim / aktivitet / detyrë, që kërkohet. K.3 mbikëqyr në mënyrë të pavarur përparimin e vet në një detyrë, aktivitet duke përdorur teknika të ndryshme për gjetjen e gabimeve (si shënim të gabimeve - vështirësive) dhe i korrigjon ato derisa gjen zgjidhjen. K.4 identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë. K.6 shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive.			
R.N. të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: • Shkruan shkronjën **ë,c** të madhe e të vogël të dorës mbi bazën e modelit. • Shkruan fjalë me shkronjën **ë,c** mbi bazën e modelit. • Shkruan fjalë e fjali me shkronjat e mësuara me të diktuar. • Ruan hapësirat midis fjalëve.			Fjalë kyçe: Ceni, kecat, ngacmon,tullumbace Teknika dhe strategji: • Lojë • Punë në grup • Punë individuale • Veprimtari në dyshe
Burimet e informacionit dhe mjete: Abetare, shkronja **ë, c** e dorës, etiketa fjalësh me shkrim dore, foto, libra për fëmijë			Lidhja me fushat e tjera: Matematikë Arte Edukim mjedisor
Përshkrim kontekstual i situatës: *Veprimtari paraprake:* Mësuesja u shpërndan nxënësve etiketa me fjalë të shkruara me shkrim dore. Nxënësit i lexojnë dhe i renditin për të formuar fjali. Fjalitë e formuara i shkruajnë në fletë e më pas i lexojnë. Mësuesja i shkruan në tabelë.			

thërrime / ajo / i grimcon / buke

cicëron / trumcaku / në dritare

dëgjon / Ola/ e trumcakut / cicërimat

Mësuesja orienton nxënësit për t'i renditur në tekst.

Trumcaku cicëron në dritare.

Ola dëgjon cicërimat e trumcakut.

Ajo i grimcon thërrime buke.

Veprimet në situatë:

Hapi 1: Lojë

Mësuesja orienton nxënësit :

Mbyllini sytë dhe ngrini lart dorën që shkruani. Provojmë të lëvizim dorën në mënyrë që të shkruajmë shkronjën e madhe dhe të vogël të dorës ***C,c***

Hapi i dytë: Punë në grup

Mësuesja paraqet para nxënësve shkronjën e madhe e të vogël të dorës ***C,c.***

Ngrihen 2-3 nxënës në tabelë për ta shkruar.

I udhëzon nxënësit të shkruajnë shkronjat në fletë të bardha me lapsa me ngjyra.

Më pas nxënësit shkruajnë në Abetaren e punës shkronjat dhe fjalët sipas modelit. Mësuesja ndjek punën e nxënësve dhe mbasi bindet që e shkruajnë mire i lë të punojnë në mënyrë të pavarur.

Hapi i tretë: Punë individuale

Nxënësit shkruajnë me të diktuar fjalët dhe fjalinë në fletoren individuale:

kecat, cepi, pinca, copëtoj, grimca, Ceni, ngacmon

Ceni bleu tullumbace për festë.

Hapi i katërt: Veprimtari në dyshe

Nxënësit punojnë në dyshe sipas niveleve për të plotësuar balonat me shkronjën gj.

Balonat përgatiten paraprakisht dhe nxënësit shkruajnë shkronjën ***C,c*** (niveli i parë), fjalë me shkronjën ***C,c*** (niveli i dytë).

Mësuesja ndjek punën e nxënësve dhe ndihmon për çdo vështirësi që mund të kenë.

Balonat e përgatitura vendosen në këndin e punimeve.

Nxënësit vlerësohen dhe stimulohen për pjesëmarrjen në çdo etapë të orës. Demonstrim i rezultateve të arritura: Nxënësit shkruajnë shkronjën ***ë,c*** sipas modelit. Shkruajnë fjalë dhe fjali me shkronjën ***ë,c*** Vlerësimi i situatës: Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi: • Shkruan shkronjën ***ë,c*** të madhe e të vogël të dorës mbi bazën e modelit. • Shkruan fjalë me shkronjën ***ë,c*** mbi bazën e modelit. • Shkruan fjalë e fjali me shkronjat e mësuara me të diktuar. • Ruan hapësirat midis fjalëve.
Detyra: **1.** Shkruhen nga dy rreshta me shkronjën ***ë,c.*** **2.** Shkruhen fjalë me shkronjën ***ë,c***. **3.** Shkruhen 3 fjali me shkronjat e mësuara.
Refleksione:

<table>
<tr><td>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla: 1</td><td>Klasa: 1</td></tr>
<tr><td colspan="3">Tema mësimore:
Punim i faqes80-81 të Abetares. Ola dhe trumcaku</td><td>Situata e të nxënit:
Zogjtë</td></tr>
<tr><td colspan="4">R.N. sipas kompetencave kyçe:
Nxënësi:
K.1 paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup.
K.3 parashtron pyetje dhe përgjigjet në pyetjet për temën/problemin/detyrën e dhënë në njërën nga format e të shprehurit.
K.3 ndjek udhëzimet e dhëna në një tekst për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë, që kërkohet.
K.4 identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë.
K.6 shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive.
K.7 realizojnë punime origjinale, vetjake duke përdorur figurat e gjetura nga burime informacioni, si një formë për të shprehur emocionet e tyre.</td></tr>
<tr><td colspan="3" rowspan="2">R.N. të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:
Nxënësi:
• Lexon tekstin rrjedhshëm e me intonacion.
• Ritregon ngjarjen me fjalët e veta.
• Interpreton në role.
• Shkruan fjali me shkrim shtypi dhe dore.
• Përdor shkronjën e madhe në fillim të fjalisë.
• Përdor pikën si shenjë pikësimi në fund të fjalisë.</td><td>Fjalë kyçe:
Ola, trumcaku, grimcon</td></tr>
<tr><td>Teknika dhe strategji:
• Dramatizim
• Punë në grup
• Punë individuale
• Veprimtari në dyshe</td></tr>
<tr><td colspan="3">Burimet e informacionit dhe mjete:
Abetare, shkronja C,c, etiketa fjalësh, foto, libra për fëmijë, gjëegjëza, materiale vizatimi</td><td>Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë
Arte
Edukim mjedisor</td></tr>
<tr><td colspan="4">Përshkrim kontekstual i situatës:
Veprimtari paraprake:
Në tabelë, mësuesja shkruan:
b - - - - - - (bilbili)
k - - - - - - (kanarina)
p - - - - - - (pëllumbi)
p - - - - - - - (papagalli)
Nxiten nxënësit të gjejnë fjalët duke i kujtuar se janë emra zogjsh.
Fjalët e gjetura analizohen në rrokje dhe formohen fjali.</td></tr>
</table>

Veprimet në situatë:

Hapi 1: Punë në grupe

Mësuesja organizon nxënësit në grupe dhe cakton rolet.

Nxënësit interpretojnë në role tekstin.

Hapi i dytë: Veprimtari në dyshe

Mësuesja u kërkon nxënësve të punojnë në dyshe me tekstin.

Nxënësit do të nënvizojnë në tekst fjalët me shkronjën c.

Do të gjejnë fjalët që fshihen në shkronjat e dhëna në tabelën – lojë: mace, kocka, malor, cjap, raca, karroca.

Do të ndajnë fjalët në fjalinë e dhënë dhe do ta shkruajnë me shkronja shtypi dhe dore:

Cirku u mbush me fëmijë.

Cirku u mbush me fëmijë.

Mësuesja ndjek nga afër punën e nxënësve dhe ndihmon nxënësit që mund të kenë vështirësi.

Nxënësit kontrollojnë punën me njëri- tjetrin duke këmbyer librat dhe më pas lexohen me zë të lartë.

Theksohet përdorimi i shkronjës së madhe në fillim të fjalisë dhe pikës në fund të saj.

Hapi i tretë: Punë individuale

Lexim i tekstit me intonacion.

Demonstrim i rezultateve të arritura:

Nxënësit plotësojnë ushtrimet në tekst.

Ritregojnë ngjarjen me fjalët e tyre.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- Lexon tekstin rrjedhshëm e me intonacion.
- Ritregon ngjarjen me fjalët e veta.
- Interpreton në role.
- Shkruan fjali me shkrim shtypi dhe dore.
- Përdor shkronjën e madhe në fillim të fjalisë.
- Përdor pikën si shenjë pikësimi në fund të fjalisë.

Detyra:

1. Shkruajnë fjali me shkronjën C, c me të diktuar.

Refleksione:

<table>
<tr><td>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla: 1</td><td>Klasa: 1</td></tr>
<tr><td colspan="3">Tema mësimore:
Punim i shkronjës Ç, ç. Faqe 82 e Abetares</td><td>Situata e të nxënit:
Veshjet tona</td></tr>
<tr><td colspan="4">R.N. sipas kompetencave kyçe:
Nxënësi:
K.1 paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup.
K.2 paraqet argumente pro dhe kundër për një mendim, qëndrim, sjellje të manifestuar nga një apo më shumë persona (në klasë/shkollë apo jashtë saj).
K.3 ndjek udhëzimet e dhëna në një tekst për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë, që kërkohet.
K.3 parashtron pyetje dhe përgjigjet në pyetjet për temën/problemin/detyrën e dhënë në njërën nga format e të shprehurit.
K.6 shpreh, dëgjon dhe respekton mendimin e secilit anëtar dhe vendos për mënyrat e përfundimit të një aktiviteti të përbashkët.
K.6 shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive.</td></tr>
<tr><td colspan="3" rowspan="2">R.N. të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:
Nxënësi:
• Përshkruan mbi bazën e figurave duke folur rrjedhshëm, qartë dhe me intonacion.
• Shqipton, shkruan dhe lexon tingullin dhe shkronjën Ç, ç.
• Qarkon shkronjën Ç, ç të shtypit në pozicione të ndryshme të fjalës.
• Shkruan dhe lexon fjalë me shkronjën ç dhe shkronjat e mësuara.</td><td>Fjalë kyçe:
palaço, çizme, çantë, kapuç, çorape</td></tr>
<tr><td>Teknika dhe strategji:
• Bisedë rreth figurës
• Analizë e sintezë
• Veprimtari në dyshe</td></tr>
<tr><td colspan="3">Burimet e informacionit dhe mjete:
Abetare, shkronja Ç, ç, etiketa fjalësh, foto veshjesh të ndryshme, libra për fëmijë, tregime.</td><td>Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë
Arte
Edukim fizik, sporte dhe shëndet
Edukim me të drejtat e fëmijëve</td></tr>
<tr><td colspan="4">Përshkrim kontekstual i situatës:
Veprimtari paraprake:
Nxënësit do të shkruajnë në një fletë fjalë që emërtojnë veshje të ndryshme.
Lexohen fjalët e shkruara dhe shkruhen në tabelë nga mësuesja.
Nxënësit bëjnë komente për veshje të ndryshme.</td></tr>
</table>

Veprimet në situatë:

Hapi 1: Bisedë rreth figurës

Mësuesja nxit nxënësit të vërejnë figurën në tekst. Nxënësit vërejnë figurën dhe tregojnë çfarë shohin dhe çfarë kuptojnë. Ndihmohen me pyetjet: Kë po shikoni ? Si është veshur ai? Ku ka shkuar ai? Çfarë mendoni se do të blerë? Pse mendoni kështu? Po ju çfarë do të zgjidhnit?

Hapi i dytë: Analizë e sintezë

Mësuesja shkruan në tabelë fjalinë: *Palaçoja bleu këpucë të çuditshme.*

Nxënësit lexojnë fjalinë korazi. Kryhet procesi i analizës duke e ndarë fjalinë në fjalë dhe fjalët në rrokje, për shkëputjen e tingullit dhe shkronjës Ç,ç.

Mësuesja ndihmon me pyetjet : Sa fjalë ka fjalia? Në cilat fjalë dëgjoni tingullin ç? Sa rrokje ka fjala palaçoja? Po fjala çuditshme?

Nxënësit shqiptojnë tingullin e ri ç, theksohet se është tingull bashkëtingëllor.

Paraqiten figura që përmbajnë shkronjën ç në tabelë, emërtohen nga nxënësi dhe tregojnë ku dëgjojnë tingullin ç (çizme, çantë, kapuç, çorape etj).

Mësuesja nxit nxënësit të gjejnë fjalë të tjera me shkronjën ç në fillim, në mes dhe në fund të fjalës.

Shkruhen fjalët në tabelë dhe qarkohet shkronja e re.

(Nxënësit duke ecur para klasës mund të numërojnë fjalë me shkronjën ç).

Hapi i tretë: Prezantim i shkronjës

Mësuesja paraqet grafikun e shkronjës Ç, ç të shtypit. Nxënësit bëjnë dallimin e shkronjës së madhe e të vogël të shtypit.

Shkruhet shkronja në tabelë. Lëvizet dora në ajër nën drejtimin e mësueses sipas grafikut të shkronjës Ç, ç.

Nxënësit shkruajnë nga 2-3 rreshta me shkronjën Ç, ç në fletoren individuale. Vizatohen 1-2 figura që kanë shkronjën ç.

Demonstrim i rezultateve të arritura:

Nxënësit bashkojnë rrokjet për të formuar fjalë dhe i shkruajnë: çadra, çohem, çelës, çaji, çora, çelësa, çajnik, çorape, çantë.

Lexohen fjalët dhe qarkohen rrokjet që përmbajnë shkronjën ç.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- Përshkruan mbi bazën e figurave duke folur rrjedhshëm, qartë dhe me intonacion.
- Shqipton, shkruan dhe lexon tingullin dhe shkronjën Ç, ç.
- Qarkon shkronjën Ç, ç të shtypit në pozicione të ndryshme të fjalës.
- Shkruan dhe lexon fjalë me shkronjën ç dhe shkronjat e mësuara.

Detyra: Shkruhen nga 2 rreshta me shkronjën e madhe e të vogël të shtypit Ç, ç.
Shkruhen fjalë me shkronjën ç.

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 1	Klasa: 1
Tema mësimore: Punim e shkrim i shkronjës Ç, ç. Abetare pune fq. 54			Situata e të nxënit: Veshjet tona

R.N. sipas kompetencave kyçe:

Nxënësi:

K.1 paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup.

K.3 ndjek udhëzimet e dhëna në një tekst për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë, që kërkohet.

K.3 mbikëqyr në mënyrë të pavarur përparimin e vet në një detyrë, aktivitet duke përdorur teknika të ndryshme për gjetjen e gabimeve (si shënim të gabimeve - vështirësive) dhe i korrigjon ato derisa gjen zgjidhjen.

K.4 identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë.

K.6 shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive.

R.N. të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:

Nxënësi:

- Shkruan shkronjën Ç, ç të shtypit mbi bazën e modelit.
- Shkruan fjalë me shkronjën ç mbi bazën e figurave të dhëna.
- Formon e shkruan fjalë 2- 3 rrokëshe mbi bazën e rrokjeve të dhëna.
- Formon grupe fjalësh me fjalët e dhëna duke i lidhur sipas kuptimit.
- U përgjigjet me shkrim pyetjeve të dhëna.

Fjalë kyçe:

Kapuç, çorape, çizme, paloçeta

Teknika dhe strategji:

- Lojë
- Punë në grup
- Punë individuale
- Veprimtari në dyshe

Burimet e informacionit dhe mjete:

Abetare, shkronja Ç, ç, etiketa fjalësh, libra për fëmijë

Lidhja me fushat e tjera:

Matematikë
Arte

Përshkrim kontekstual i situatës:

Veprimtari paraprake:

Në etiketa mësuesja shkruan emra veshjesh të ndryshme.

Një nxënës çohet, e lexon fjalën e parë (p.sh., kapuç) dhe përpiqet t'ua shpjegojë të tjerëve me anë të gjesteve. Përsëritet loja deri sa të gjenden të gjitha etiketat (kapuç, çorape, çadra, çizme, paloçeta, çantë).

Për fjalët që mund të kenë vështirësi, mësuesja ndihmon nxënësit derisa të zbulohet.

Veprimet në situatë:

Hapi 1: Lojë

Mësuesja ndan nxënësit në dy grupe. Njëri grup shkruan shkronjën Ç të madhe të shtypit , ndërsa grupi tjetër shkruan shkronjën ç të vogël të shtypit. Në momentin që mësuesja thotë TANI, nxënësit lëvizin nëpër klasë dhe formojnë çiftet e shkronjave Ç - ç.

Hapi i dytë: Punë në grup

Mësuesja u kërkon nxënësve të komentojnë figurat (biçikleta, çokollata).

Për secilën figurë pyet: Çfarë është? Për çfarë nevojitet? A ju pëlqen? Pse? Cilën do të zgjidhnit ndërmjet të dyjave?

Lexohen fjalët në mënyrë globale dhe plotësohen kutizat bosh me shkronjën ç.

Hapi i tretë: Punë individuale

Mësuesja paraqet grafikun e shkronjës Ç, ç.

Shkruhet shkronja në tabelë.

Lihen të shkruajnë vetëm një shkronjë në Abetaren e punës dhe kur bindet se e kanë shkruar si duhet, i lë të punojnë në mënyrë të pavarur.

Nxënësit këmbejnë librat me njëri-tjetrin për të parë si kanë punuar.

Hapi i katërt: Veprimtari në dyshe

Nxënësit punojnë në dyshe për të plotësuar detyrat e tjera në Abetaren e punës.

Mësuesja ndjek punën e nxënësve dhe ndihmon për çdo paqartësi që mund të kenë duke i shkruar fjalët apo fjalitë në tabelë: çuditem shumë, çaj dru, çukit thërrime, çlodh mendjen.

U përgjigjen pyetjeve: Çfarë kanë në kokë fëmijët? Fëmijët kanë në kokë kapuçë.

Çfarë bëjnë fëmijët? Fëmijët luajnë me topa bore.

Demonstrim i rezultateve të arritura:

Nxënësit shkruajnë fjalët: kapuç, çadra, biçikletë, çorape

Formojnë fjali me fjalët e shkruara.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- Shkruan shkronjën Ç, ç të shtypit mbi bazën e modelit.
- Shkruan fjalë me shkronjën ç mbi bazën e figurave të dhëna.
- Formon e shkruan fjalë 2-3 rrokëshe mbi bazën e rrokjeve të dhëna.
- Formon grupe fjalësh me fjalët e dhëna duke i lidhur sipas kuptimit.
- U përgjigjet me shkrim pyetjeve të dhëna.

Detyra:

1. Shkruhen fjalë me shkronjën ç.
2. Shkruhen 5 fjali me shkronjat e mësuara.

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 1	Klasa: 1
Tema mësimore: Punim e lexim i shkronjës Ç, ç. Faqe 83 e Abetares			Situata e të nxënit: Palaçoja
R.N. sipas kompetencave kyçe: Nxënësi: K.1 lexon me zë një tekst së paku prej gjysmë faqeje të pa lexuar më parë. K.3 parashtron pyetje dhe përgjigjet në pyetjet për temën /problemin/detyrën e dhënë në njërën nga format e të shprehurit. K.4 identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë. K.6 shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive. K.7 realizon punime origjinale, vetjake duke përdorur figurat e gjetura nga burime informacioni, si një formë për të shprehur emocionet e tij.			
R.N. të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: • Lexon tekstin qartë dhe saktë. • Përshkruan figurën që ilustron tekstin. • U përgjigjet pyetjeve që lidhen me përmbajtjen. • Dallon titullin në pjesën e dhënë. • Pyet për t'u sqaruar rreth përmbajtjes së tekstit ose rreth fjalëve të panjohura për të.			Fjalë kyçe: palaçoja, shitore, shitëse, çizme Teknika dhe strategji: • Parashikim i ngjarjes • Lexim me ndalesa • Punë individuale
Burimet e informacionit dhe mjete: Abetare, shkronja Ç, ç, etiketa fjalësh, foto, libra për fëmijë, tregime, materiale vizatimi.			Lidhja me fushat e tjera: Matematikë Arte
Përshkrim kontekstual i situatës: *Veprimtari paraprake:* Nxënësit organizohen në grupe. Secili grup do të veshë një nga nxënësit si palaço duke e bërë sa më interesant. Prezantohen para klasës. Kjo veprimtari mund të bëhet edhe duke vizatuar një palaço në mënyrë sa më interesante.			

Veprimet në situatë:
Hapi 1: Parashikim i ngjarjes

Mësuesja shkruan titullin në tabelë: *Palaçoja në shitore*.

Nxiten nxënësit të mendojnë për 2-3' se çfarë mund të blerë palaçoja në shitore duke u bazuar edhe te figura. Dëgjohen disa nxënës dhe shkruhen përgjigjet e tyre në tabelë.

Hapi i dytë: Lexim me ndalesa

Mësuesja ndan tekstin në pjesë dhe lexohet me ndalesa:

Ndalesa e parë: që nga fillimi deri te "… i tha shitësja." Pyet: Pse shkoi palaçoja në shitore? Pse shikonte rreth e rrotull ai? Pse u habit? Çfarë mendoni se do të zgjedhë?

Ndalesa e dytë: deri te "… çizmen e kuqe". Pyet: A ndodhi ashtu si menduat? Çfarë ndodhi? Si mendoni se vazhdon ngjarja?

Ndalesa e tretë: deri në fund. Mësuesja pyet: Çfarë i tha shitësja palaços? Çfarë ndodhi? Pse çalonte palaçoja? Pse iku i kënaqur? A ishte ngjarja ashtu si e menduat në fillim?

Hapi i tretë: Punë individuale

Mësuesja u kërkon nxënësve të lexojnë tekstin në heshtje dhe të drejtojnë pyetje në qoftë se kanë.

Pyetjet e nxënësve shkruhen në tabelë dhe më pas u jepet përgjigje.

Lexohet teksti zinxhir nga nxënësit nga 2-3 fjali.

Demonstrim i rezultateve të arritura:

Nxënësit lexojnë tekstin me intonacion.

Nxjerrin mesazhin e tekstit.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- Lexon tekstin qartë dhe saktë.
- Përshkruan figurën që ilustron tekstin.
- U përgjigjet pyetjeve që lidhen me përmbajtjen.
- Dallon titullin në pjesën e dhënë.
- Pyet për t'u sqaruar rreth përmbajtjes së tekstit ose rreth fjalëve të panjohura për të.

Detyra:

1. Lexohet teksti rrjedhshëm e me intonacion.
2. Shkruhen dy fjali për palaçon.

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 1	Klasa: 1
Tema mësimore: Ushtrime aplikative për shkrim dore. Shkronja ***ç, ç***.			Situata e të nxënit: Veshjet tona

R.N. sipas kompetencave kyçe:

Nxënësi:

K.3 ndjek udhëzimet e dhëna në një tekst për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë, që kërkohet.

K.3 mbikëqyr në mënyrë të pavarur përparimin e vet në një detyrë, aktivitet duke përdorur teknika të ndryshme për gjetjen e gabimeve (si shënim të gabimeve-vështirësive) dhe i korrigjon ato derisa gjen zgjidhjen.

K.4 identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë.

K.6 shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive.

R.N. të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:

Nxënësi:

- Shkruan shkronjën ***ç, ç.***
- Shkruan fjalë me shkronjën ***ç, ç*** mbi bazën e modelit.
- Shkruan fjalë e fjali me shkronjat e mësuara me të diktuar.
- Ruan hapësirat midis fjalëve.

Fjalë kyçe:

çorape, çizme, kapuç,

Teknika dhe strategji:

- Lojë
- Demonstrim
- Punë individuale
- Veprimtari në dyshe

Burimet e informacionit dhe mjete:

Abetare, shkronja ***ç, ç*** e dorës, etiketa fjalësh me shkrim dore, foto, libra për fëmijë

Lidhja me fushat e tjera:

Matematikë
Arte
Edukim me të drejtat e fëmijëve

Përshkrim kontekstual i situatës:

Veprimtari paraprake:

Nxënësit do të kujtojnë shkronjat e mësuar të dorës duke i lexuar në tabelë korrazi.

Shkruajnë fjalë në tabelë nxënës të ndryshëm me shkronjat e mësuara dhe lexohen nga nxënësit e tjerë:

biçikletë, çantë, çajnik, çadra, kaçavidë, peliçe, etj.

Për çdo fjalë mësuesja pyet: Sa shkronja ka? Cilat janë zanore? Cilat janë bashkëtingëllore?

Veprimet në situatë:

Hapi 1: Lojë

Mësuesja orienton nxënësit : Mbyllini sytë dhe ngrini lart dorën që shkruani. Provojmë të lëvizim dorën në mënyrë që të shkruajmë shkronjën e madhe dhe të vogël të dorës **Ç, ç.**

Hapi i dytë: Demonstrim

Mësuesja paraqet para nxënësve shkronjën e madhe e të vogël të dorës **Ç,ç.**

Krahasohet me shkronjën C,c. Ngrihen 2-3 nxënës në tabelë për ta shkruar.

Mësuesja i udhëzon nxënësit të shkruajnë shkronjat në fletë të bardha me lapsa me ngjyra.

Më pas nxënësit shkruajnë në Abetaren e punës shkronjat dhe fjalët sipas modelit.

Mësuesja ndjek punën e nxënësve dhe mbasi bindet që e shkruajnë mirë i lë të punojnë në mënyrë të pavarur.

Hapi i tretë: Punë individuale

Nxënësit shkruajnë me të diktuar fjalët dhe fjalinë në fletoren individuale:

kapuç, çuditem, çokollatë, biçikletë, çohem, çajnik

Çimi shkoi në Korçë.

Hapi i katërt: Veprimtari në dyshe

Nxënësit punojnë në dyshe sipas niveleve për të plotësuar balonat me shkronjën ç.

Balonat përgatiten paraprakisht dhe nxënësit shkruajnë shkronjën **Ç, ç** (niveli i parë), fjalë me shkronjën **Ç, ç** (niveli i dytë) dhe fjali (niveli i tretë).

Mësuesja ndjek punën e nxënësve dhe ndihmon për çdo vështirësi që mund të kenë.

Balonat e përgatitura vendosen në këndin e punimeve.

Nxënësit vlerësohen dhe stimulohen për pjesëmarrjen në çdo etapë të orës.

Demonstrim i rezultateve të arritura:

Nxënësit shkruajnë shkronjën **Ç, ç** sipas modelit.

Shkruajnë fjalë dhe fjali me shkronjën **Ç,ç.**

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- Shkruan shkronjën **Ç, ç**
- Shkruan fjalë me shkronjën **Ç, ç** mbi bazën e modelit.
- Shkruan fjalë e fjali me shkronjat e mësuara me të diktuar.
- Ruan hapësirat midis fjalëve.

Detyra:

1. Shkruhen nga dy rreshta me shkronjën **Ç, ç.**
2. Shkruhen fjalë me shkronjën **Ç, ç**.

3. Shkruhen 3 fjali me shkronjat e mësuara.
Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 1	Klasa: 1
Tema mësimore: Punim i faqes 82-83 të Abetares. Palaçoja në shitore			Situata e të nxënit: Palaçoja
R.N. sipas kompetencave kyçe: Nxënësi: K.1 ritregon ngjarjen e një teksti të dëgjuar, përmbajtja e të cilit nuk është më shumë se një faqe teksti. K.3 parashtron pyetje dhe përgjigjet në pyetjet për temën/problemin/detyrën e dhënë në njërën nga format e të shprehurit. K.3 ndjek udhëzimet e dhëna në një tekst për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë, që kërkohet. K.4 identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë. K.6 shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive. K.7 realizojnë punime origjinale, vetjake duke përdorur figurat e gjetura nga burime informacioni, si një formë për të shprehur emocionet e tyre.			
R.N. të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: • Lexon tekstin rrjedhshëm e me intonacion. • Ritregon ngjarjen me fjalët e tij. • Interpreton në role. • Shkruan fjalë me shkronjën ç. • Shkruan fjali me fjalët e dhëna. • Përdor pikën si shenjë pikësimi.			Fjalë kyçe: palaçoja, shitore, çizme Teknika dhe strategji: • Stuhi mendimi • Punë në grup • Veprimtari në dyshe • Dramatizim
Burimet e informacionit dhe mjete: Abetare, shkronja Ç, ç, etiketa fjalësh, foto, libra për fëmijë, materiale vizatimi, videoprojektor.			Lidhja me fushat e tjera: Matematikë Arte Edukim me të drejtat e fëmijëve
Përshkrim kontekstual i situatës: *Veprimtari paraprake:* Mësuesja shtron për diskutim pyetjen: *Ku mendoni se shkoi palaçoja mbasi doli nga shitorja*? Dëgjohen mendimet e nxënësve. Mësuesja mund të shfaqë në videoprojektor pamje me interpretime të palaços në cirk ose foto të ndryshme.			

Nxënësit sjellin përvoja dhe eksperienca personale nga jeta.

Veprimet në situatë:

Hapi 1: Punë në grupe

Nxënësit organizohen në grupe.

Secili grup do të formojë fjali me fjalët: palaço, shitore, çalë–çalë, çizme, këpucë.

Fjalitë diskutohen në grup dhe mund të renditen për të formuar një tekst.

Lexohen nga nxënësit sipas grupeve.

Hapi i dytë: Veprimtari në dyshe

Nxënësit ritregojnë përmbajtjen e ngjarjes me njëri-tjetrin.

Dëgjohen disa dyshe.

Hapi i katërt: Dramatizim

Dramatizohet pjesa nga nxënësit me grupe.

Demonstrim i rezultateve të arritura:

Nxënësit lexojnë tekstin rrjedhshëm e me intonacion.

Plotësojnë ushtrimet në tekst:

Qarkojnë shkronjën e duhur: qen apo çen? Qumësht apo çumësht? Qershi apo çershi?

Ngjyrosin palaçon.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- Lexon tekstin rrjedhshëm e me intonacion.
- Ritregon ngjarjen me fjalët e tij.
- Interpreton në role.
- Shkruan fjalë me shkronjën ç.
- Shkruan fjali me fjalët e dhëna.
- Përdor pikën si shenjë pikësimi.

Detyra:

1. Shkruajnë ngjarjen të përmbledhur shkurt.
2. Vizatojnë palaçon.

Refleksione:

<table>
<tr><td>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla: 1</td><td>Klasa: 1</td></tr>
<tr><td colspan="3">Tema mësimore:
Punim i faqes 84 të Abetares</td><td>Situata e të nxënit:
Ushqimet</td></tr>
<tr><td colspan="4">R.N. sipas kompetencave kyçe:
Nxënësi:
K.3 parashtron pyetje dhe përgjigjet në pyetjet për temën/problemin/detyrën e dhënë në njërën nga format e të shprehurit.
K.3 ndjek udhëzimet e dhëna në një tekst për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë, që kërkohet.
K.4 identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë.
K.6 shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive.
K.7 realizon punime origjinale, vetjake duke përdorur figurat e gjetura nga burime informacioni, si një formë për të shprehur emocionet e tij.</td></tr>
<tr><td colspan="3" rowspan="2">R.N. të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:
Nxënësi:
• Shkruan fjalë me shkronjat ll, g, gj, th,c, ç duke përdorur shkronjat e shtypit dhe të dorës, të vogla dhe të mëdha.
• Ndan fjalët në rrokje e shkronja.
• Shkruan fjali me fjalët e dhëna.
• U përgjigjet pyetjeve të dhëna me shkrim
• Përdor pikën si shenjë pikësimi.</td><td>Fjalë kyçe:
akullore, gështenja, thana, speci, çaj</td></tr>
<tr><td>Teknika dhe strategji:
• Stuhi mendimi
• Punë në grup
• Veprimtari në dyshe
• Punë individuale</td></tr>
<tr><td colspan="3">Burimet e informacionit dhe mjete:
Abetare, shkronja lëvizore, etiketa fjalësh, foto, libra për fëmijë, materiale vizatimi</td><td>Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë
Arte
Edukim me të drejtat e fëmijëve</td></tr>
<tr><td colspan="4">Përshkrim kontekstual i situatës:
Veprimtari paraprake:
Nxënësit organizohen në grupe.
Secili grup do të formojë fjali me fjalët: akullore, gështenja, thana, speci, çaj.
Lexohen nga nxënësit sipas grupeve.
- Çfarë kanë të përbashkët këto fjalë? (emërtojnë ushqime).
- Cila është më e pëlqyera për ju?</td></tr>
</table>

Veprimet në situatë:

Hapi 1: Stuhi mendimi

Mësuesja nxit nxënësit të tregojnë fjalë që përmbajnë shkronjat :ll, g, gj, th, c,ç.

Fjalët shkruhen në tabelë dhe identifikohen shkronjat e kërkuara, p.sh.:

Ll – molla, tullumbace,kukulla, llambë,etj.

Po kështu edhe shkronjat e tjera.

Hapi i dytë: Veprimtari në dyshe

Nxënësit plotësojnë ushtrimet në libër duke bashkëpunuar në dyshe:

Ndihmohen nga mësuesja për përgjigjet që japin në lidhje me pjesët e kompjuterit.

Nxënësit këmbejnë librat dhe kontrollojnë njëri-tjetrin si kanë punuar.

Hapi i tretë: Punë individuale

Nxënësit formojnë fjali me fjalët: pëllumbi, gjilpëra, thes, këpucë, çorape.

Fjalitë shkruhen në fletoren individuale me shkrim dore.

Demonstrim i rezultateve të arritura:

Nxënësit shkruajnë fjalë me shkronjat e mësuara.

Plotësojnë ushtrimet në tekst:

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- Shkruan fjalë me shkronjat ll, g, gj, th,c, ç duke përdorur shkronjat e shtypit dhe të dorës, të vogla dhe të mëdha.
- Ndan fjalët në rrokje e shkronja.
- Shkruan fjali me fjalët e dhëna.
- U përgjigjet pyetjeve të dhëna me shkrim
- Përdor pikën si shenjë pikësimi.

Detyra:

1. Shkruajnë gjashtë fjali me shkronjat e dorës ***ll, g, gj, th, c,ç.***

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 1	Klasa: 1
Tema mësimore Punim i faqes 55 Abetare pune		Situata e të nxënit Luaj me shkronjat	
R.N. sipas kompetencave kyçe: Nxënësi: K.3 ndjek udhëzimet e dhëna në një tekst për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë, që kërkohet. K.3 zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes. K.4 identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në shtëpi. K.5 bashkëpunon me të tjerët pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitetet në klasë, shkollë apo jashtë saj.			
R.N. të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: • Shkruan shkronjat ll, g, gj, th, c, ç të shtypit e të dorës. • Formon dhe shkruan fjalë me rrokjet e dhëna. • Plotëson dhe shkruan fjalitë e dhëna me shkrim dore. • Ruan hapësirën midis fjalëve.		Fjalë kyçe: shkronjë, fjalë, fjali Strategji dhe teknika: • Punë në grup • Punë individuale • Veprimtari në dyshe	
Burimet e informacionit dhe mjete: Abetare pune, shkronjat ll, g, gj, th, c, ç; etiketa me fjalë që plotësojnë fjalitë e dhëna		Lidhja me fushat e tjera: Matematikë Edukim me të drejtat e fëmijëve Shkencat natyrore	
Përshkrimi kontekstual i situatës: *Veprimtari paraprake* Mësuesja paraqet shkronjat ll, g, gj, th, c, ç në tabelë dhe nxit nxënësit t'i shqiptojnë tingujt e tyre. Vendosen figura të ndryshme në tavolinat e nxënësve dhe lihen të identifikojnë ato që kanë shkronjat e mësipërme(akullore, gërshërë, gjethe, thes, këpucë, çadër, kapuç, gështenjë, etj.).			

Veprimet në situatë:

Hapi i parë: Punë në grup

Veprimtari me rrokje: vendosen rrokje të ndryshme në tabelë dhe lihen nxënësit të formojnë fjalë me to.

Fjalët shkruhen në etiketa me shkrim dore dhe vendosen në një vend të dukshëm në klasë.

Nxiten nxënësit të lexojnë fjalët e dhëna.

Hapi i dytë: Veprimtari në dyshe:

Nxënësit punojnë të pavarur për plotësimin e detyrave në fletoren e punës fq. 55 dhe kontrollojnë në dyshe.

- Shkruajnë shkronjat e dorës ll, g, gj, th, c, ç.

-Plotësohen fjalët me rrokjet që duhen: speci, biçikleta, thika, kërpudha, gërshëra, gjarpri.

-Formohen dhe shkruhen grupet e fjalëve: çuditem shumë, dhuroj dhurata, çaj dru, ngacmoj shokët, gjej, gjilpërën, copëtoj letrën, thërras mamin, thërrmoj bukën, gjuaj peshq

-Shkruhen dhe lexohen fjalët në kutiza: çati, gjashtë, këpucë, gjilpërë.

- Shkruajnë me shkronja dore emra kafshësh me shkronjat g, c, gj: ***gomari, kangurri, cjapi, keci, gjirafa, gjarpri***

-Plotësohen fjalitë duke përdorur fjalët e dhëna.

Hapi i tretë: Punë individuale

Shkruajnë sipas niveleve në fletoren individuale:

Niveli i parë: fjalët e ushtrimit të parë nga Abetarja e punës

Niveli i dytë: shkruajnë nga dy fjalë me shkronjat: ll, g, gj, th, c, ç.

Niveli i tretë: shkruan tre fjali me këto shkronja.

Demonstrim i rezultateve të arritura:

Emërtojnë figurat e dhëna.

Shkruajnë dhe lexojnë fjalë me shkronjate mësuara.

Vlerësimi i situatës:
Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- Shkruan shkronjat ll, g, gj, th, c, ç të shtypit e të dorës.
- Formon dhe shkruan fjalë me rrokjet e dhëna.
- Plotëson dhe shkruan fjalitë e dhëna me shkrim dore.
- Ruan hapësirën midis fjalëve.

Detyra:

1. Shkrim fjalësh me shkronjat e mësuara.
2. Formim fjalish me shkronjat e mësuara.

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 1	Klasa: 1
Tema mësimore: Punim i faqes 85 të Abetares			Situata e të nxënit: Mbjellim bimë

R.N. sipas kompetencave kyçe:

Nxënësi:

K.1 lexon me zë një tekst së paku prej gjysmë faqeje të pa lexuar më parë.

K.1 shkruan një tekst të shkurtër (gjysmë faqe për një temë të caktuar).

K.2 sqaron me anë të të folurit hapat e zgjidhjes së një problemi të thjeshtë, me të cilin ballafaqohet në një situatë jetësore.
K.3 parashtron pyetje dhe përgjigjet në pyetjet për temën /problemin/detyrën e dhënë në njërën nga format e të shprehurit.

K.4 identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë.

K.6 shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive.

R.N. të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: • Përshkruan figurat që ilustrojnë tekstin. • Rendit fjalitë sipas radhës. • Lexon tekstin qartë dhe saktë. • U përgjigjet pyetjeve që lidhen me përmbajtjen. • Pyet për t'u sqaruar rreth përmbajtjes së tekstit ose rreth fjalëve të panjohura për të . • Shkruan tregimin me shkronja dore.	Fjalë kyçe: miushi, mbjell, vazo, fara,pleh, ujit Teknika dhe strategji: • Veprimtari në dyshe • Punë në grupe • Punë individuale
Burimet e informacionit dhe mjete: Abetare, shkronja lëvizore, foto me pjesët e bimës, libra për fëmijë, tregime, vazo, fara, dhe, pleh, videoprojektor.	Lidhja me fushat e tjera: Matematikë Arte Shkencat natyrore

Përshkrim kontekstual i situatës:

Veprimtari paraprake:

Me videoprojektor, mësuesja shfaq sekuenca nga rritja e farave të mbjella ose paraqiten foto me faza të ndryshme të rritjes së farës së mbjellë.

- Kujtoni nga Dituria e natyrës cilat ishin pjesët e bimës?
- Si mbijnë farat?
- Si duhet të kujdesemi për to që të rriten?

Veprimet në situatë:

Hapi 1: Veprimtari në dyshe

Hapen librat dhe lihen nxënësit të vërejnë figurat: Çfarë shikoni? Ç'po bën miushi? Sa vazo ka mbjellë?

Nxënësit do të punojnë në dyshe për të renditur fjalitë sipas radhës. Ata do të vendosin numrat sipas radhës në kutizat përkatëse.

Lexohen fjalitë e renditura nga dy – tri dyshe.

Shkruhen në tabelë për të bërë kontrollin e renditjes.

Nxënësit drejtojnë pyetje në qoftë se kanë.

Hapi i dytë: Punë individuale

Nxënësit e shkruajnë tregimin me shkronjat e dorës në fletoren individuale.

Shkëmbejnë fletoret me njëri-tjetrin për të parë si kanë punuar dhe më pas dorëzojnë fletoren për vlerësim.

Hapi i tretë: Punë në grupe

Nxënësit ndahen në grupe dhe mbjellin fara bimësh të ndryshme.

Gjatë punës kontrollohen, ndihmohen.

Përshkruajnë punën e bërë.

Demonstrim i rezultateve të arritura:

Nxënësit shkruajnë të renditur dhe lexojnë tekstin me intonacion.

Nxjerrin mesazhin e tekstit.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- Përshkruan figurat që ilustrojnë tekstin.
- Rendit fjalitë sipas radhës.
- Lexon tekstin qartë dhe saktë.
- U përgjigjet pyetjeve që lidhen me përmbajtjen.
- Pyet për t'u sqaruar rreth përmbajtjes së tekstit ose rreth fjalëve të panjohura për të .
- Shkruan tregimin me shkronja dore.

Detyra:

1. Shkruajnë tregimin me shkronja shtypi.

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 1	Klasa: 1
Tema mësimore Veprimtari shkrimi (diktim)		Situata e të nxënit Luaj me shkronjat	

R.N. sipas kompetencave kyçe:

Nxënësi:

K.3 ndjek udhëzimet e dhëna për të realizuar një detyrë që i kërkohet.

K.3 mbikëqyr në mënyrë të pavarur përparimin e vet në një detyrë duke përdorur teknika të ndryshme për gjetjen e gabimeve dhe i korrigjon ato derisa gjen zgjidhjen.

K.3 grumbullon dhe klasifikon materialet e performancës së vet, për përgatitjen apo pasurimin e portofolit personal.

K.6 diskuton dhe në bashkëpunim me anëtarët e grupit vendos rregullat e punës në grup.

R.N. të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: • Modelon bukur grafikët e shkronjave të mëdha dhe të vogla të dorës që ka mësuar deri tani.. • Lidh shkronjat me njëra-tjetrën në fjalë. • Shkruan fjalë dhe fjali me shkronjat e dorës me të diktuar. • Ruan hapësirat midis fjalëve. • Përdor shkronjën e madhe në fillim të fjalisë dhe pikën në fund të saj.	Fjalë kyçe: shkronjë, rrokje, fjalë, fjali Strategji dhe teknika: • Stuhi mendimi • Veprimtari në dyshe • Punë individuale
Burimet e informacionit dhe mjete: Shkronjat e dorës, fletore shkrimi, mjete vizatimi, tabelë alfabeti	Lidhja me fushat e tjera: Matematikë Edukim me të drejtat e fëmijëve

Përshkrimi kontekstual i situatës:

Veprimtari paraprake

Përsëritin koras shkronjat e alfabetit nga tabela.
Mësuesja organizon lojëra të ndryshme me nxënësit duke përdorur shkronjat e dorës:
Një nxënës lëviz dorën në ajër sipas modelit të një shkronje dore, të madhe ose të vogël, ndërsa nxënësit e tjerë gjejnë cila shkronjë është.

Veprimet në situatë:

Hapi i parë: Stuhi mendimi

Mësuesja paraqet modelet e disa shkronjave të dorës dhe nxit nxënësit të gjejnë fjalë që kanë në trup të tyre këtë shkronjë ***(ll, Ll, g, G,gj, Gj, th, Th, c, C, ç, Ç).***

Fjalët e gjetura shkruhen nga nxënës të ndryshëm në tabelë. Mësuesja tregon kujdes në lidhjen e saktë të shkronjave me njëra-tjetrën.

Hapi i dytë: Veprimtari në dyshe

Mësuesja u shpërndan nxënësve etiketa me fjalë të shkruara me shkrim dore të cilave u mungojnë rrokje. Nxënësit, duke punuar në dyshe, do të gjejnë rrokjen që mungon dhe do të shkruajnë fjalët të plota.

(***çanta, gjethe, thupra, pica, pecetë, biçikleta, gjirafa, globi, kukulla etj .).***

Hapi i tretë: Punë individuale

Nxënësit shkruajnë në fletoren individuale me të diktuar fjalët dhe fjalitë:

shalli, shkolla, akullore, gruri, gështenja, gatuaj, qengji, gjilpëra, gjethe, tharëse, thes, cirku, karrocë, tullumbace,biçikletë, çokollatë, çuditem

Qengji i vogël rri pranë nënës.

Gështenjat piqen në vjeshtë.

Macja është kafshë shtëpiake.

Demonstrim i rezultateve të arritura:

Shkrim i fjalëve dhe fjalive me shkrim dore me të diktuar.

Vlerësimi i situatës :
Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- Modelon bukur grafikët e shkronjave të mëdha dhe të vogla të dorës që ka mësuar deri tani.
- Lidh shkronjat me njëra-tjetrën në fjalë.
- Shkruan fjalë dhe fjali me shkronjat e dorës me të diktuar.
- Ruan hapësirat midis fjalëve.
- Përdor shkronjën e madhe në fillim të fjalisë dhe pikën në fund të saj.

Detyra:

1. Vetëdiktim me shkronjat e mësuara.

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 1	Klasa: 1
Tema mësimore Përforcim i shkronjave të mësuara.		Situata e të nxënit 4 stinët	

R.N. sipas kompetencave kyçe:

Nxënësi:

K.1 paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup.

K. 3 zgjidh në mënyrë të pavarur detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes.

K.3 ndjek udhëzimet e dhëna në një tekst për të realizuar një detyrë që kërkohet.

K.3 grumbullon dhe klasifikon materialet e performancës së vet, për përgatitjen apo pasurimin e portofolit personal.

K.4 identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre në klasë.

K.5 bashkëpunon me të tjerët pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitetet në klasë.

K.6 vendos duke bashkëpunuar me të gjithë anëtarët për mënyrat që çojnë drejt përfundimit të një aktiviteti të caktuar.

R.N. të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: • Flet rrjedhshëm,qartë kur përshkruan diçka. • Shkruan fjalë me shkronjat e mësuara. • Rendit fjalët në një fjali me 3-4 fjalë. • Shkruan si duhet fjalinë.	Fjalë kyçe: stinë, pranvera, vera, vjeshta, dimri Strategji dhe teknika: • Punë në grup • Bashkëbisedim • Punë individuale
Burimet e informacionit dhe mjete: Teksti i Abetares, shkronja ilustruese shtypi e dore, mjete vizatimi, libra për fëmijë, vjersha për stinët, magnetofon, CD, foto të stinëve.	Lidhja me fushat e tjera: Matematikë Arte Edukim me të drejtat e fëmijëve Edukim shëndetësor

Përshkrimi kontekstual i situatës:

Veprimtari paraprake

Mësuesja vendos në magnetofon pjesën "4 stinët" e Vivaldit dhe paraqet foto të stinëve. Nxiten nxënësit të shprehin mendimet e tyre rreth fotove dhe rreth pjesës muzikore që dëgjojnë. Ndihmohen me pyetjet:

-Cila stinë është e para? Cila vjen pas saj? Po pas verës cila stinë vjen? Çfarë ndryshimi vini re? A e dini pse ndodh kjo? Ç'është kjo që po dëgjojmë? Si ndiheni?

Veprimet në situatë:

Hapi i parë: Punë në grupe:

Secilit nxënës i jepet një shkronjë dhe shkruan fjalë me të. Më pas sipas grupeve i ngjitin në fletë kartoni të modeluara në mënyrë të tillë që të formohen stinët. Grupi i parë i shkruan fjalët në petale lulesh të bardha, grupi i dytë në gjethe të gjelbra, grupi i tretë në gjethe të verdha dhe grupi i katërt në shirita të bardhë (për të dhënë idenë e borës).

U jepen fjali të prera në etiketa, renditen dhe ngjitën poshtë figurës së formuar sipas grupeve.

Pranvera është stina e luleve. Në verë bën shumë vapë. Në vjeshtë piqen frutat. Dimri është stinë e ftohtë.

Hapi i dytë: Bashkëbisedim

Prezantim i punës së grupeve.

-Sa fjalë keni vendosur afërsisht nëpër pemë ? Gjeni numrin e saktë. Krahasohen gjetjet.

Hapi i tretë: Punë individuale

Nxënësit punojnë në fletë individuale sipas niveleve me ushtrime të tipit:

Emërto figurat (qershi, dardhë) / niveli ë parë

Rendit fjalët në fjali (ka, Pranvera, shumë, të bukura, lule) / niveli i dytë

Shkruajnë fjali për stinët / niveli i tretë

Hapi i tretë:

Lexohen vjersha për stinët.
Këndohet kënga "4 stinët"
Demonstrim i rezultateve të arritura:

Shkrim i fjalëve me shkronjat e mësuara të dorës.
Renditje e fjalëve në fjali dhe shkrim i fjalive.

Vlerësimi i situatës:
Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- Shkruan saktë fjalë me shkronjat e mësuara.
- Rendit fjalët në një fjali me 3-4 fjalë.
- Shkruan si duhet fjalinë.

Detyra:

1. Shkruajnë fjalë me shkrim dore.
2. Shkruajnë 4 fjali për stinët.
3. Ilustrojnë stinën që pëlqejnë.

Refleksione:

Emri : _____

Test në Gjuhë shqipe (Abetare)
Tremujori i dytë

1. Diktim **(10 pikë)**

_____
_____
_____
_____
_____
_____
_____
_____
_____
_____

2. Lidh rrokjet: **(3 pikë)**

ja mri _____

rro nar _____

di ba _____

3. Qarko fjalën e shkruar saktë. **(3 pikë)**

moll dardha qukapiku

mollë darva cukapiku

4. Plotëso fjalët. **(3 pikë)**

__ __ rshi thu __ __ __ glo __ __

5. Ndaj fjalët me vijë dhe shkruaj fjalinë si duhet: **(2 pikë)**

Gentifestoiditëlindjenmeshokët.

_____
_____
_____

6. Plotëso fjalitë me fjalët që duhen. **(2 pikë)**

Pranvera është stinë _____. (e bukur, e fortë)

Blerta i mban pastër _____. (akulloret, librat)

7. Nënvizo fjalinë që ka kuptim. **(1 pikë)**

Teuta takoi shoqen e kopshtit. Genti takoi këpucët e reja.

8. Emërto figurat: **(3 pikë)**

_____ _____ _____
_____ _____ _____
_____ _____ _____

9. Sa fjalë kanë fjalitë? **(2 pikë)**

Dorina kujdeset shumë për dhëmbët. _____
Valmira shkruan shumë bukur. _____

10. Rendit si duhet fjalët në fjali. **(2 pikë)**

shokët me luan Blerimi në oborr.

_____
_____
_____

11. Përgjigju me fjali të plota. **(2 pikë)**

Në cilën stinë jemi tani?

_____

Si quhet mësuesja jote?

_____

APK	ANP	AK	ASHK	ASH
0-7	8-14	15-21	22-29	30-33

<table>
<tr><td>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla: 1</td><td>Klasa: 1</td></tr>
<tr><td colspan="3">Tema mësimore:
Punim i shkronjës Nj, nj Faqe 86 e Abetares</td><td>Situata e të nxënit:
Njollat</td></tr>
<tr><td colspan="4">R.N. sipas kompetencave kyçe:
Nxënësi:
K.1 paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup.
K.2 paraqet argumente pro dhe kundër për një mendim, qëndrim, sjellje të manifestuar nga një apo më shumë persona (në klasë/shkollë apo jashtë saj).
K.3 ndjek udhëzimet e dhëna në një tekst për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë, që kërkohet.
K.3 parashtron pyetje dhe përgjigjet në pyetjet për temën/problemin/detyrën e dhënë në njërën nga format e të shprehurit.
K.6 shpreh, dëgjon dhe respekton mendimin e secilit anëtar dhe vendos për mënyrat e përfundimit të një aktiviteti të përbashkët
K.6 shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive.</td></tr>
<tr><td colspan="3" rowspan="2">R.N. të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:
Nxënësi:
• Përshkruan mbi bazën e figurave duke folur rrjedhshëm, qartë dhe me intonacion.
• Shqipton, shkruan dhe lexon tingullin dhe shkronjën Nj,nj.
• Qarkon shkronjën Nj,nj të shtypit në pozicione të ndryshme të fjalës.
• Shkruan dhe lexon fjalë me shkronjën nj dhe shkronjat e mësuara.
• Plotëson pjesët që u mungojnë fjalëve .</td><td>Fjalë kyçe:
Njomëza, njolla, foshnja, binjake, shqiponja, njëshi</td></tr>
<tr><td>Teknika dhe strategji:
• Bisedë rreth figurës
• Analizë e sintezë
• Veprimtari në dyshe</td></tr>
<tr><td colspan="3">Burimet e informacionit dhe mjete:
Abetare, shkronja Nj, nj, etiketa fjalësh, foto të ndryshme me figurat e tekstit, libra për fëmijë, tregime</td><td>Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë
Arte
Edukim fizik,sporte dhe shëndet
Edukim me të drejtat e fëmijëve</td></tr>
<tr><td colspan="4">Përshkrim kontekstual i situatës:
Veprimtari paraprake:
Mësuesja pyet nxënësit:
- A e dini nga cilat sëmundje preken shpesh fëmijët?
- Me çfarë shenjash shoqërohen ato?
- A keni dëgjuar për vaksinat?
- Përse i bëjmë vaksinat?</td></tr>
</table>

Veprimet në situatë:

Hapi 1: Bisedë rreth figurës
Mësuesja nxit nxënësit të vërejnë figurën në tekst. Nxënësit vërejnë figurën dhe tregojnë çfarë shohin dhe çfarë kuptojnë. Ndihmohen me pyetjet:
- Kë po shikoni?
- Çfarë ka vajza?
- Pse është mbushur me njolla?
- Çfarë po shikon në ëndërr ajo?
Hapi i dytë: Analizë e sintezë
Mësuesja shkruan në tabelë fjalinë: *Njomëza ka njolla në faqe.*
Nxënësit lexojnë fjalinë korazi. Kryhet procesi i analizës duke e ndarë fjalinë në fjalë dhe fjalët në rrokje, për shkëputjen e tingullit dhe shkronjës Nj,nj.
Mësuesja ndihmon me pyetjet :
-Sa fjalë ka fjalia?
-Në cilat fjalë dëgjoni tingullin nj?
-Sa rrokje ka fjala Njomëza?
-Po fjala njolla?
Nxënësit shqiptojnë tingullin e ri nj; theksohet se është tingull bashkëtingëllor.
Paraqiten figura që përmbajnë shkronjën nj në tabelë, emërtohen nga nxënësi dhe tregojnë ku dëgjojnë tingullin nj (njollë, binjake, njëshi, shqiponjë,etj).
Mësuesja nxit nxënësit të gjejnë fjalë të tjera me shkronjën nj në fillim, në mes dhe në fund të fjalës.
Shkruhen fjalët në tabelë dhe qarkohet shkronja e re.
(Nxënësit duke ecur para klasës mund të numërojnë fjalë me shkronjën nj).
Hapi i tretë: Prezantim i shkronjës
Mësuesja paraqet grafikun e shkronjës Nj, nj të shtypit. Nxënësit bëjnë dallimin e shkronjës së madhe e të vogël të shtypit.
Shkruhet shkronja në tabelë.
Lëvizet dora në ajër nën drejtimin e mësueses sipas grafikut të shkronjës Nj,nj.
Nxënësit shkruajnë nga 2-3 rreshta me shkronjën Nj,nj në fletoren individuale.
Vizatohen 1-2 figura që kanë shkronjën nj.
Demonstrim i rezultateve të arritura:
Nxënësit plotësojnë e lexojnë fjalët: foshnjë, binjake, shqiponjë, njëshi
Formohen fjalitë duke lidhur fjalët e dhëna:
Njomëza rri në shtrat. Njëshi është numër. Anjeza njeh shkronjat.
Vlerësimi i situatës:
Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- Përshkruan mbi bazën e figurave duke folur rrjedhshëm, qartë dhe me intonacion.
- Shqipton, shkruan dhe lexon tingullin dhe shkronjën Nj, nj.
- Qarkon shkronjën Nj,nj të shtypit në pozicione të ndryshme të fjalës.
- Shkruan dhe lexon fjalë me shkronjën nj dhe shkronjat e mësuara.

Detyra:

1. Shkruhen nga 2 rreshta me shkronjën e madhe e të vogël të shtypit Nj, nj.
2. Shkruhen fjalë dhe fjali me shkronjën nj.

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 1	Klasa: 1
Tema mësimore: Punim e shkrim i shkronjës Nj, nj. Abetare pune fq. 56			Situata e të nxënit: Shqiponja

R.N. sipas kompetencave kyçe:
Nxënësi:
K.1 paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup.
K.3 ndjek udhëzimet e dhëna në një tekst për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë, që kërkohet.
K.3 mbikëqyr në mënyrë të pavarur përparimin e vet në një detyrë, aktivitet duke përdorur teknika të ndryshme për gjetjen e gabimeve (si shënim të gabimeve - vështirësive) dhe i korrigjon ato derisa gjen zgjidhjen.
K.4 identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë.
K.6 shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive.

R.N. të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:
Nxënësi:
- Shkruan shkronjën Nj, nj të shtypit mbi bazën e modelit.
- Shkruan fjalë me shkronjën nj mbi bazën e figurave të dhëna.
- Formon e shkruan fjalë 3-4 rrokëshe mbi bazën e rrokjeve të dhëna.
- Formon grupe fjalësh me fjalët e dhëna duke i lidhur sipas kuptimit.
- Shkruajnë fjali me shprehjet e dhëna.

Fjalë kyçe:
njollë, shkronjë, shqiponjë, njëshi, gështenja

Teknika dhe strategji:
- Lojë
- Punë në grup
- Punë individuale
- Veprimtari në dyshe

Burimet e informacionit dhe mjete:
Abetare, shkronja Nj, nj, etiketa fjalësh, libra për fëmijë

Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë
Arte

Përshkrim kontekstual i situatës:
Veprimtari paraprake:

Mësuesja nxit nxënësit të tregojnë çfarë dinë për shqiponjën. Mendimet e nxënësve i shkruan në tabelë pa i komentuar.



Këndohet kënga e shqiponjave.

Veprimet në situatë:
Hapi 1: Lojë
Mësuesja ndan nxënësit në dy grupe. Njëri grup shkruan shkronjën Nj të madhe të shtypit , ndërsa grupi tjetër shkruan shkronjën nj të vogël të shtypit. Në momentin që mësuesja thotë TANI, nxënësit lëvizin nëpër klasë dhe formojnë çiftet e shkronjave Nj - nj.

Hapi i dytë: Punë në grup

Mësuesja u kërkon nxënësve të komentojnë figurat (njëshi, shkronja,shqiponja).
Për secilën figurë pyet: Çfarë është? Për çfarë nevojitet? A ju pëlqen? Pse? Cilën do të zgjidhnit ndërmjet të triave?
Lexohen fjalët në mënyrë globale dhe plotësohen kutizat bosh me shkronjën nj.

Hapi i tretë: Punë individuale

Mësuesja paraqet grafikun e shkronjës Nj,nj.
Shkruhet shkronja në tabelë.
Lihen të shkruajnë vetëm një shkronjë në Abetaren e punës dhe kur bindet se e kanë shkruar si duhet, i lë të punojnë në mënyrë të pavarur.
Nxënësit këmbejnë librat me njëri – tjetrin për të parë si kanë punuar.

Hapi i katërt: Veprimtari në dyshe

Nxënësit punojnë në dyshe për të plotësuar detyrat e tjera në Abetaren e punës.
Mësuesja ndjek punën e nxënësve dhe ndihmon për çdo paqartësi që mund të kenë duke i shkruar fjalët apo fjalitë në tabelë: njoh kompjuterin, njoftoj shokun, njom lulet, njollos rrobat.
Shkruajnë fjali me shprehjet: Na ishte njëherë… Asnjëherë…

Demonstrim i rezultateve të arritura:

Nxënësit shkruajnë fjalët : gështenjë, shqiponjë, mushkonjë, njoftoj.
Formojnë fjali me fjalët e shkruara.

Vlerësimi i situatës:
Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- Shkruan shkronjën Nj,nj të shtypit mbi bazën e modelit.
- Shkruan fjalë me shkronjën nj mbi bazën e figurave të dhëna.
- Formon e shkruan fjalë 3-4 rrokëshe mbi bazën e rrokjeve të dhëna.
- Formon grupe fjalësh me fjalët e dhëna duke i lidhur sipas kuptimit.
- Shkruajnë fjali me shprehjet e dhëna.

Detyra:

1. Shkruhen fjalë me shkronjën nj.
2. Përshkruajnë shqiponjën me tre fjali.

Refleksione:

<table>
<tr><td>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla: 1</td><td>Klasa: 1</td></tr>
<tr><td colspan="3">Tema mësimore:
Punim e lexim i shkronjës Nj,nj. Faqe 87 e Abetares</td><td>Situata e të nxënit:
Njollat</td></tr>
<tr><td colspan="4">R.N. sipas kompetencave kyçe:
Nxënësi:
K.1 shpreh me gojë për 3-5 minuta para moshatarëve dhe të tjerëve përjetimet dhe emocionet që e kanë shoqëruar gjatë dëgjimit të një tregimi apo përralle.
K.3 parashtron pyetje dhe përgjigjet në pyetjet për temën/problemin/detyrën e dhënë në njërën nga format e të shprehurit;
K.4 identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë.
K.6 shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive.
K.7 realizon punime origjinale, vetjake duke përdorur figurat e gjetura nga burime informacioni, si një formë për të shprehur emocionet e tyre.</td></tr>
<tr><td colspan="3" rowspan="2">R.N. të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:
Nxënësi:

• Lexon tekstin qartë dhe saktë.
• Përshkruan figurën që ilustron tekstin.
• Parashikon ngjarjen në bazë të titullit dhe figurës.
• U përgjigjet pyetjeve që lidhen me përmbajtjen.
• Dallon titullin në pjesën e dhënë.
• Pyet për t’u sqaruar rreth përmbajtjes së tekstit ose rreth fjalëve të panjohura për të.</td><td>Fjalë kyçe:
Njomëza, njolla, e njoma</td></tr>
<tr><td>Teknika dhe strategji:
• Parashikim i ngjarjes
• Lexim me ndalesa
• Punë individuale</td></tr>
<tr><td colspan="3">Burimet e informacionit dhe mjete:
Abetare, shkronja Nj, nj, etiketa fjalësh, foto, libra për fëmijë, tregime, materiale vizatimi.</td><td>Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë
Arte
Edukim fizik, sporte dhe shëndet</td></tr>
<tr><td colspan="4">Përshkrim kontekstual i situatës:
Veprimtari paraprake:

Bisedë: Si ndieni kur jeni të sëmurë? Kush ju qëndron pranë? Si kujdesen ata? A ju ka ndodhur të mbusheni me njolla në fytyrë kur jeni sëmurë? Tregoni si jeni ndier.
Mund të zhvillohet një bisedë e shkurtër me mjeken e shkollës.</td></tr>
</table>

Veprimet në situatë:
Hapi 1: Parashikim i ngjarjes

Mësuesja shkruan titullin në tabelë: *Njollat e Njomëzës*
Nxiten nxënësit të mendojnë për 2-3'se çfarë mund të ketë ndodhur me Njomëzën duke u bazuar te figura.
Dëgjohen disa nxënës.
Hapi i dytë: Lexim me ndalesa
Mësuesja ndan tekstin në pjesë dhe lexohet me ndalesa:
Ndalesa e parë: që nga fillimi deri te "… të njohur e të panjohur." Pyet:
-Si u ngrit Njomëza në mëngjes?
- Çfarë mendoni se kishte?
- Çfarë pa në ëndërr?
- Çfarë mendoni se do të ndodhë?
Ndalesa e dytë: deri te "… një kërpudhë e vogël". Pyet:
-A ndodhi ashtu si menduat?
-Çfarë ndodhi?
-Si mendoni se vazhdon ngjarja?
Ndalesa e tretë: deri në fund. Mësuesja pyet:
-Çfarë bëri Njomëza?
-Çfarë ndodhi?
- Pse u gëzua ajo?
-A ishte ngjarja ashtu si e menduat në fillim?
Hapi i tretë: Punë individuale

Mësuesja u kërkon nxënësve të lexojnë tekstin në heshtje dhe të drejtojnë pyetje në qoftë se kanë.
Pyetjet e nxënësve shkruhen në tabelë dhe më pas u jepet përgjigje.
Lexohet teksti zinxhir nga nxënësit nga 2-3 fjali.
Demonstrim i rezultateve të arritura:

Nxënësit lexojnë tekstin me intonacion.
Nxjerrin mesazhin e tekstit.
Vlerësimi i situatës:
Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- Lexon tekstin qartë dhe saktë.
- Përshkruan figurën që ilustron tekstin.
- Parashikon ngjarjen në bazë të titullit dhe figurës.
- U përgjigjet pyetjeve që lidhen me përmbajtjen.
- Dallon titullin në pjesën e dhënë.
- Pyet për t'u sqaruar rreth përmbajtjes së tekstit ose rreth fjalëve të panjohura për të.

Detyra:

1. Lexohet teksti rrjedhshëm e me intonacion.
2. Kopjojnë një pjesë me shkrim dore.

Refleksione:

<table>
<tr><td>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla: 1</td><td>Klasa: 1</td></tr>
<tr><td colspan="3">Tema mësimore:
Ushtrime aplikative për shkrim dore. Shkronja ***Nj, nj***.</td><td>Situata e të nxënit:
Njollat</td></tr>
<tr><td colspan="4">R.N. sipas kompetencave kyçe:
Nxënësi:
K.3 ndjek udhëzimet e dhëna në një tekst për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë, që kërkohet.
K.3 mbikëqyr në mënyrë të pavarur përparimin e vet në një detyrë, aktivitet duke përdorur teknika të ndryshme për gjetjen e gabimeve (si shënim të gabimeve - vështirësive) dhe i korrigjon ato derisa gjen zgjidhjen.
K.4 identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë.
K.6 shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive.</td></tr>
<tr><td colspan="3" rowspan="2">R.N të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:
Nxënësi:
• Shkruan shkronjën ***Nj,nj*** mbi bazën e modelit.
• Shkruan fjalë me shkronjën ***Nj,nj*** mbi bazën e modelit.
• Shkruan fjalë e fjali me shkronjat e mësuara me të diktuar.
• Ruan hapësirat midis fjalëve.</td><td>Fjalë kyçe:
njëshi, njollë, njeh</td></tr>
<tr><td>Teknika dhe strategji:
• Lojë
• Demonstrim
• Punë individuale
• Veprimtari në dyshe</td></tr>
<tr><td colspan="3">Burimet e informacionit dhe mjete:
Abetare, shkronja ***Nj,nj*** e dorës, etiketa fjalësh me shkrim dore, foto, libra për fëmijë</td><td>Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë
Arte
Edukim me të drejtat e fëmijëve</td></tr>
<tr><td colspan="4">Përshkrim kontekstual i situatës:
Veprimtari paraprake

Nxënësit do të kujtojnë shkronjat e mësuar të dorës duke i lexuar në tabelë korrazi.
Shkruajnë fjalë në tabelë nxënës të ndryshëm me shkronjat e mësuara dhe lexohen nga nxënësit e tjerë: njollë, njeh, njëshi, gështenja, shqiponja, binjake
Për çdo fjalë mësuesja pyet: Sa shkronja ka? Cilat janë zanore? Cilat janë bashkëtingëllore?</td></tr>
</table>

Veprimet në situatë:
Hapi 1: Lojë

Mësuesja orienton nxënësit:
- Mbyllini sytë dhe ngrini lart dorën që shkruani. Provojmë të lëvizim dorën në mënyrë që të shkruajmë shkronjën e madhe dhe të vogël të dorës ***Nj,nj.***
Hapi i dytë: Demonstrim
Mësuesja paraqet para nxënësve shkronjën e madhe e të vogël të dorës ***Nj,nj.***
Krahasohet shkronja e madhe me shkronjën e vogël si dhe me shkronjat ***N, n, j.***
Ngrihen 2-3 nxënës në tabelë për ta shkruar.
Mësuesja i udhëzon nxënësit të shkruajnë shkronjat në fletë të bardha me lapsa me ngjyra.
Më pas nxënësit shkruajnë në Abetaren e punës shkronjat dhe fjalët sipas modelit.
Mësuesja ndjek punën e nxënësve dhe mbasi bindet që e shkruajnë mirë i lë të punojnë në mënyrë të pavarur.

Hapi i tretë: Punë individuale
Nxënësit shkruajnë me të diktuar fjalët dhe fjalinë në fletoren individuale:
njeriu, njëshi, binjake, njoh, shqiponjë, foshnjë
Shqiponja ka sqep të fortë.

Hapi i katërt: Veprimtari në dyshe
Nxënësit punojnë në dyshe sipas niveleve për të plotësuar balonat me shkronjën ç.
Balonat përgatiten paraprakisht dhe nxënësit shkruajnë shkronjën ***Nj,nj*** (niveli i parë), fjalë me shkronjën ***NJ,nj*** (niveli i dytë) dhe fjali (niveli i tretë).
Mësuesja ndjek punën e nxënësve dhe ndihmon për çdo vështirësi që mund të kenë.
Balonat e përgatitura vendosen në këndin e punimeve.
Nxënësit vlerësohen dhe stimulohen për pjesëmarrjen në çdo etapë të orës.

Demonstrim i rezultateve të arritura:
Nxënësit shkruajnë shkronjën ***Nj, nj*** sipas modelit.
Shkruajnë fjalë dhe fjali me shkronjën ***Nj,nj.***

Vlerësimi i situatës:
Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:
- Shkruan shkronjën ***Nj,nj*** mbi bazën e modelit.
- Shkruan fjalë me shkronjën ***Nj,nj*** mbi bazën e modelit.
- Shkruan fjalë e fjali me shkronjat e mësuara me të diktuar.
- Ruan hapësirat midis fjalëve.

Detyra:
1. Shkruhen nga dy rreshta me shkronjën ***Nj,nj.***
2. Shkruhen fjalë me shkronjën ***Nj,nj.***
3. Shkruhen 3 fjali me shkronjat e mësuara me të diktuar.

Refleksione:

<table>
<tr><td>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla: 1</td><td>Klasa: 1</td></tr>
<tr><td colspan="3">Tema mësimore:
Punim i faqes 86-87 të Abetares. Njollat e njomëzës</td><td>Situata e të nxënit:
Njollat</td></tr>
<tr><td colspan="4">R.N. sipas kompetencave kyçe:
Nxënësi:
K.1 paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup.
K.3 parashtron pyetje dhe përgjigjet në pyetjet për temën/problemin/detyrën e dhënë në njërën nga format e të shprehurit.
K.3 ndjek udhëzimet e dhëna në një tekst për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë, që kërkohet.
K.4 identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë.
K.6 shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive.
K.7 realizojnë punime origjinale, vetjake duke përdorur figurat e gjetura nga burime informacioni, si një formë për të shprehur emocionet e tyre.</td></tr>
<tr><td colspan="3" rowspan="2">R.N. të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:
Nxënësi:
• Lexon tekstin rrjedhshëm e me intonacion.
• Ritregon ngjarjen me fjalët e tij.
• Interpreton në role.
• Shkruan fjalë me shkronjën nj.
• Plotëson fjalitë me fjalët e dhëna.
• Përdor pikën si shenjë pikësimi.</td><td>Fjalë kyçe:
Njomëza, njollë,të njohur, të panjohur, flutur, kërpudhë.</td></tr>
<tr><td>Teknika dhe strategji:
• Stuhi mendimi
• Punë në grup
• Veprimtari në dyshe
• Dramatizim</td></tr>
<tr><td colspan="3">Burimet e informacionit dhe mjete:
Abetare, shkronja Nj, nj etiketa fjalësh, foto, libra për fëmijë, materiale vizatimi, videoprojektor.</td><td>Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë
Arte
Edukim me të drejtat e fëmijëve</td></tr>
<tr><td colspan="4">Përshkrim kontekstual i situatës:
Veprimtari paraprake:

Mësuesja u shpërndan nxënësve etiketat me fjalët njollë, flutur, pasqyrë, ëndërr, kapelë.
Nxënësit që kanë etiketat duhet t’ua shpjegojnë me gjeste nxënësve të tjerë derisa të zbulohen fjalët.
Shkruhen fjalët në tabelë dhe mund të formohen fjali.</td></tr>
</table>

Veprimet në situatë:
Hapi 1: Punë në grupe

Nxënësit organizohen në grupe.
Secili grup do të formojë fjali me fjalët: njomëza, njolla, flutura, kërpudha, temperaturë.
Fjalitë diskutohen në grup dhe mund të renditen për të formuar një tekst
Lexohen nga nxënësit sipas grupeve.

Hapi i dytë: Veprimtari në dyshe

Nxënësit ritregojnë përmbajtjen e ngjarjes me njëri-tjetrin.
Dëgjohen disa dyshe.

Hapi i tretë: Dramatizim

Dramatizohet pjesa nga nxënësit me grupe.

Demonstrim i rezultateve të arritura:

Nxënësit lexojnë tekstin rrjedhshëm e me intonacion.
Plotësojnë ushtrimet në tekst:

Vlerësimi i situatës:
Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- Lexon tekstin rrjedhshëm e me intonacion.
- Ritregon ngjarjen me fjalët e tij.
- Interpreton në role.
- Shkruan fjalë me shkronjën nj.
- Plotëson fjalitë me fjalët e dhëna.
- Përdor pikën si shenjë pikësimi.

Detyra:

1. Shkruajnë ngjarjen të përmbledhur shkurt
2. Ilustrojnë me vizatim.

Refleksione:

<table>
<tr><td>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla: 1</td><td>Klasa: 1</td></tr>
<tr><td colspan="3">Tema mësimore:
Punim i shkronjës Y, y. Faqe 88 e Abetares</td><td>Situata e të nxënit:
Ngjyrat e natyrës</td></tr>
<tr><td colspan="4">R.N. sipas kompetencave kyçe:
Nxënësi:
K.1 paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup.
K.3 ndjek udhëzimet e dhëna në një tekst për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë, që kërkohet.
K.3 parashtron pyetje dhe përgjigjet në pyetjet për temën/problemin/detyrën e dhënë në njërën nga format e të shprehurit.
K.5 bashkëpunon me të tjerët pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitetet në klasë, shkollë apo jashtë saj.
K.6 shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive.</td></tr>
<tr><td colspan="3" rowspan="2">R.N. të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:
Nxënësi:
• Përshkruan mbi bazën e figurave.
• Shqipton, shkruan dhe lexon tingullin dhe shkronjën Y, y.
• Qarkon shkronjën Y, y të shtypit në pozicione të ndryshme të fjalës.
• Shkruan dhe lexon fjalë me shkronjën y dhe shkronjat e mësuara.</td><td>Fjalë kyçe:
ylber, ngjyra, natyra</td></tr>
<tr><td>Teknika dhe strategji:
• Bisedë rreth figurës
• Analizë e sintezë
• Veprimtari në dyshe</td></tr>
<tr><td colspan="3">Burimet e informacionit dhe mjete:
Abetare, shkronja Y, y, etiketa fjalësh, foto, libra për fëmijë, vjersha për natyrën</td><td>Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë
Arte
Edukim mjedisor</td></tr>
<tr><td colspan="4">Përshkrim kontekstual i situatës:
Veprimtari paraprake:

Mësuesja i nxjerr nxënësit në oborrin e shkollës ose në një park të afërt dhe i orienton të vëzhgojnë ngjyrat që shohin në natyrë..
- Çfarë po shikoni?
- Çfarë ngjyre kanë pemët? Po qielli? Toka? etj.
- Cila ngjyrë duket më shumë?
- A ka ngjyra të tjera veç këtyre që shohim?
Mund të organizohet loja “Topa ngjyrash”: Mësuesja hedh topin drejt nxënësve duke nisur fjalinë:E bardhë si...Nxënësit e pasojnë topin dhe përfundojnë fjalinë (…si borë).
Përsëritet loja disa herë.</td></tr>
</table>

Hapi 1: Bisedë rreth figurës
Mësuesja nxit nxënësit të vërejnë figurën në tekst. Nxënësit vërejnë figurën dhe tregojnë çfarë shohin dhe çfarë kuptojnë. Ndihmohen me pyetjet:
-Çfarë shikoni?
-Kur del ylberi?
-Cilat janë ngjyrat e tij?
- Sa ngjyra janë?
- Si duket ylberi?

Hapi i dytë: Analizë e sintezë
Mësuesja shkruan në tabelë fjalinë: *Ylberi ka shtatë ngjyra.*
Nxënësit lexojnë fjalinë korazi. Kryhet procesi i analizës duke e ndarë fjalinë në fjalë dhe fjalët në rrokje, për shkëputjen e tingullit dhe shkronjës y.
Mësuesja ndihmon me pyetjet :
-Sa fjalë ka fjalia? Sa rrokje ka fjala ylberi? Sa shkronja ka? Cilat janë zanore? Po bashkëtingëllore?
Nxënësit shqiptojnë tingullin e ri y.
Mësuesja nxit nxënësit të gjejnë fjalë të tjera me shkronjën y në fillim, në mes dhe në fund të fjalës.
Shkruhen fjalët në tabelë dhe qarkohet shkronja e re.

Hapi i tretë: Punë individuale
Mësuesja paraqet grafikun e shkronjës Y, y. Nxënësit bëjnë dallimin e shkronjës së madhe e të vogël të shtypit.
Shkruhet shkronja në tabelë.
Lëvizet dora në ajër nën drejtimin e mësueses sipas grafikut të shkronjës Y, y.
Nxënësit shkruajnë nga 2-3 rreshta me shkronjën Y, y në fletoren individuale.

Hapi i katërt: Veprimtari në dyshe

Vizatohet ylberi.

Demonstrim i rezultateve të arritura:

Plotësohen fjalët sipas figurave të dhëna dhe lexohen.
Lexohen fjalët e shkruara.

Vlerësimi i situatës:
Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- Përshkruan mbi bazën e figurave.
- Shqipton, shkruan dhe lexon tingullin dhe shkronjën Y, y.
- Qarkon shkronjën Y, y të shtypit në pozicione të ndryshme të fjalës.
- Shkruan dhe lexon fjalë me shkronjën y dhe shkronjat e mësuara.

Detyra:

1. Shkruhen nga 2 rreshta me shkronjën e madhe e të vogël të shtypit Y, y.
2. Shkruhen fjalë me shkronjën Y, y.
3. Mësojnë vjersha për natyrën.

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 1	Klasa: 1
Tema mësimore: Punim e shkrim i shkronjës Y, y. Abetare pune fq. 57			Situata e të nxënit: Ngjyrat e natyrës

R.N. sipas kompetencave kyçe:
Nxënësi:
K.1 paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup.
K.3 ndjek udhëzimet e dhëna në një tekst për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë, që kërkohet.
K.3 mbikëqyr në mënyrë të pavarur përparimin e vet në një detyrë, aktivitet duke përdorur teknika të ndryshme për gjetjen e gabimeve (si shënim të gabimeve - vështirësive) dhe i korrigjon ato derisa gjen zgjidhjen.
K.4 identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë.
K.6 shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive.

R.N. të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:
Nxënësi:

- Shkruan shkronjën Y,y të shtypit mbi bazën e modelit.
- Shkruan fjalë me shkronjën y mbi bazën e figurave të dhëna.
- Formon e shkruan fjalë 2- 3 rrokëshe mbi bazën e rrokjeve të dhëna.
- U përgjigjet me shkrim pyetjeve të dhëna.
- Përdor si duhet shenjat e pikësimit në fund të fjalisë.

Fjalë kyçe:
ylber, ngjyra, natyrë

Teknika dhe strategji:

- Lojë
- Punë në grup
- Punë individuale
- Veprimtari në dyshe

Burimet e informacionit dhe mjete:
Abetare, shkronja Y,y, etiketa fjalësh, , libra për fëmijë

Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë
Arte

Përshkrim kontekstual i situatës:
Veprimtari paraprake:

Në etiketa mësuesja shkruan fjalët: *natyra, ngjyra, ylber*i të ndara në rrokje.
Nxënësit punojnë në dyshe për t'i renditur në mënyrë që të formohen fjalët e mësipërme.
Fjalët e formuara shkruhen në një fletë dhe formohen fjali.
Lexohen fjalitë nga nxënësit dhe shkruhen në tabelë nga mësuesja.

Veprimet në situatë:
Hapi 1: Lojë
Mësuesja ndan nxënësit në dy grupe. Njëri grup shkruan shkronjën Y të madhe të shtypit , ndërsa grupi tjetër shkruan shkronjën y të vogël të shtypit. Në momentin që mësuesja thotë TANI, nxënësit lëvizin nëpër klasë dhe formojnë çiftet e shkronjave Y-y.

Hapi i dytë: Punë në grup

Mësuesja u kërkon nxënësve të komentojnë figurat (dyshi, ngjyra, ylberi).
Për secilën figurë pyet: Çfarë është? Për çfarë nevojitet? A ju pëlqen? Pse? Cilën do të zgjidhnit ndërmjet të triave?
Lexohen fjalët në mënyrë globale dhe plotësohen kutizat bosh me shkronjën y.
Formohen fjali me fjalët e dhëna.

Hapi i tretë: Punë individuale

Mësuesja paraqet grafikun e shkronjës Y,y.
Shkruhet shkronja në tabelë.
Lihen të shkruajnë vetëm një shkronjë në Abetaren e punës dhe kur bindet se e kanë shkruar si duhet, i lë të punojnë në mënyrë të pavarur.
Nxënësit këmbejnë librat me njëri-tjetrin për të parë si kanë punuar.

Hapi i katërt: Veprimtari në dyshe

Nxënësit punojnë në dyshe për të plotësuar detyrat e tjera në Abetaren e punës.
Mësuesja ndjek punën e nxënësve dhe ndihmon për çdo paqartësi që mund të kenë duke i shkruar fjalët apo fjalitë në tabelë: fytyra, qymyri, ylberi,qyteti.
U përgjigjen pyetjeve: Kur del ylberi?
Cilat janë ngjyrat e ylberit?
Demonstrim i rezultateve të arritura:

Nxënësit shkruajnë fjalët: natyrë, ylber, ngjyrë, luleshtrydhe
Formojnë fjali me fjalët e shkruara.

Vlerësimi i situatës:
Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- Shkruan shkronjën Y, y të shtypit mbi bazën e modelit.
- Shkruan fjalë me shkronjën y mbi bazën e figurave të dhëna.
- Formon e shkruan fjalë 2- 3 rrokëshe mbi bazën e rrokjeve të dhëna.
- U përgjigjet me shkrim pyetjeve të dhëna.
- Përdor si duhet shenjat e pikësimit në fund të fjalisë.

Detyra:
Shkruhen fjalë me shkronjën y.
Shkruhen 5 fjali me shkronjat e mësuara.

Refleksione:

<table>
<tr><td>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla: 1</td><td>Klasa: 1</td></tr>
<tr><td colspan="3">Tema mësimore:
Punim e lexim i shkronjës Y, y. Faqe 89 e Abetares</td><td>Situata e të nxënit:
Ngjyrat</td></tr>
<tr><td colspan="4">R.N. sipas kompetencave kyçe:
Nxënësi:
K.1 shpreh me gojë për 3-5 minuta para moshatarëve dhe të tjerëve përjetimet dhe emocionet që e kanë shoqëruar gjatë dëgjimit të një tregimi apo përralle.
K.3 parashtron pyetje dhe përgjigjet në pyetjet për temën /problemin/detyrën e dhënë në njërën nga format e të shprehurit.
K.4 identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë.
K.6 shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive.
K.7 realizojnë punime origjinale, vetjake duke përdorur figurat e gjetura nga burime informacioni, si një formë për të shprehur emocionet e tyre.</td></tr>
<tr><td colspan="3" rowspan="2">R.N. të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:
Nxënësi:
• Lexon tekstin qartë dhe saktë.
• Përshkruan figurën që ilustron tekstin.
• Parashikon ngjarjen duke u bazuar te figura dhe titulli.
• U përgjigjet pyetjeve që lidhen me përmbajtjen.
• Dallon titullin në pjesën e dhënë.
• Pyet për t’u sqaruar rreth përmbajtjes së tekstit ose rreth fjalëve të panjohura për të.</td><td>Fjalë kyçe:
lapsa, ngjyra, ylber</td></tr>
<tr><td>Teknika dhe strategji:
• Parashikim i ngjarjes
• Lexim me ndalesa
• Punë individuale
• Dramatizim</td></tr>
<tr><td colspan="3">Burimet e informacionit dhe mjete:
Abetare, shkronja Y,y, etiketa fjalësh, foto, libra për fëmijë, tregime, materiale vizatimi</td><td>Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë
Arte
Shoqëria dhe mjedisi</td></tr>
<tr><td colspan="4">Përshkrim kontekstual i situatës:
Veprimtari paraprake:

Mësuesja u kërkon nxënësve të vizatojnë diçka sipas dëshirës ku të përdoret ngjyra e bardhë.
Nxënësit prezantojnë punën e tyre dhe e përshkruajnë.

Veprimet në situatë:
Hapi 1: Parashikim i ngjarjes</td></tr>
</table>

Mësuesja shkruan titullin në tabelë: *Lapsat me ngjyra*.
Nxiten nxënësit të mendojnë për 2-3'se çfarë mund të ketë ndodhur me lapsat duke u bazuar edhe te figura.
Dëgjohen disa nxënës dhe shkruhen përgjigjet e tyre në tabelë.

Hapi i dytë: Lexim me ndalesa
Mësuesja ndan tekstin në pjesë dhe lexohet me ndalesa:
Ndalesa e parë: që nga fillimi deri te "… u mërzit shumë." Pyet:
-Pse ngjyra kërcyen përpjetë nga gëzimi?
- Po ngjyra e bardhë pse u mërzit?
- Si do të ndiheshit ju po të ishit në vendin e saj?
- Çfarë mendoni se do të ndodhë më pas?
Ndalesa e dytë: deri në fund. Pyet:
-A ndodhi ashtu si menduat?
-Çfarë ndodhi?
-Pse u kënaq ngjyra e bardhë?
-A ishte ngjarja ashtu si e menduat në fillim?

Hapi i tretë: Punë individuale
Mësuesja u kërkon nxënësve të lexojnë tekstin në heshtje dhe të drejtojnë pyetje në qoftë se kanë.
Pyetjet e nxënësve shkruhen në tabelë dhe më pas u jepet përgjigje.
Lexohet teksti zinxhir nga nxënësit nga 2-3 fjali.

Hapi i katërt: Dramatizim

Dramatizohet teksti nga nxënësit.

Demonstrim i rezultateve të arritura:

Nxënësit lexojnë tekstin me intonacion.
U përgjigjen pyetjeve që lidhen me përmbajtjen.

Vlerësimi i situatës:
Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- Lexon tekstin qartë dhe saktë.
- Përshkruan figurën që ilustron tekstin.
- Parashikon ngjarjen duke u bazuar te figura dhe titulli.
- U përgjigjet pyetjeve që lidhen me përmbajtjen.
- Dallon titullin në pjesën e dhënë.
- Pyet për t'u sqaruar rreth përmbajtjes së tekstit ose rreth fjalëve të panjohura për të.

Detyra:

1. Lexohet teksti rrjedhshëm e me intonacion.
2. Shkruhen emrat e ngjyrave.

Refleksione:

<table>
<tr><td>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla: 1</td><td>Klasa: 1</td></tr>
<tr><td colspan="3">Tema mësimore:
Ushtrime aplikative për shkrim dore. Shkronja Y,y.</td><td>Situata e të nxënit:
Ngjyrat</td></tr>
<tr><td colspan="4">R.N. sipas kompetencave kyçe:
Nxënësi:
K.3 ndjek udhëzimet e dhëna në një tekst për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë, që kërkohet.
K.3 mbikëqyr në mënyrë të pavarur përparimin e vet në një detyrë, aktivitet duke përdorur teknika të ndryshme për gjetjen e gabimeve (si shënim të gabimeve - vështirësive) dhe i korrigjon ato derisa gjen zgjidhjen.
K.4 identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë.
K.6 shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive.</td></tr>
<tr><td colspan="3" rowspan="2">R.N. të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:
Nxënësi:
• Shkruan shkronjën Y,y mbi bazën e modelit.
• Shkruan fjalë me shkronjën Y,y mbi bazën e modelit.
• Shkruan fjalë e fjali me shkronjat e mësuara me të diktuar.
• Ruan hapësirat midis fjalëve.</td><td>Fjalë kyçe:
ngjyra, ylber</td></tr>
<tr><td>Teknika dhe strategji:
• Lojë
• Demonstrim
• Punë individuale
• Veprimtari në dyshe</td></tr>
<tr><td colspan="3">Burimet e informacionit dhe mjete:
Abetare, shkronja Y,y e dorës, etiketa fjalësh me shkrim dore, foto, libra për fëmijë</td><td>Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë
Arte
Edukim me të drejtat e fëmijëve</td></tr>
<tr><td colspan="4">Përshkrim kontekstual i situatës:
Veprimtari paraprake:

Nxënësit do të kujtojnë shkronjat e mësuar të dorës duke i lexuar në tabelë korrazi.
Shkruajnë fjalë në tabelë nxënës të ndryshëm me shkronjat e mësuara dhe lexohen nga nxënësit e tjerë:
Për çdo fjalë mësuesja pyet: Sa shkronja ka? Cilat janë zanore? Cilat janë bashkëtingëllore?

Veprimet në situatë:</td></tr>
</table>

Hapi 1: Lojë

Mësuesja orienton nxënësit:
- Mbyllini sytë dhe ngrini lart dorën që shkruani. Provojmë të lëvizim dorën në mënyrë që të shkruajmë shkronjën e madhe dhe të vogël të dorës ***Y,y.***

Hapi i dytë: Demonstrim
Mësuesja paraqet para nxënësve shkronjën e madhe e të vogël të dorës ***Y,y.***
Ngrihen 2-3 nxënës në tabelë për ta shkruar.
Mësuesja i udhëzon nxënësit të shkruajnë shkronjat në fletë të bardha me lapsa me ngjyra.
Më pas nxënësit shkruajnë në Abetaren e punës shkronjat dhe fjalët sipas modelit.
Mësuesja ndjek punën e nxënësve dhe mbasi bindet që e shkruajnë mirë i lë të punojnë në mënyrë të pavarur.

Hapi i tretë: Punë individuale
Nxënësit shkruajnë me të diktuar fjalët dhe fjalinë në fletoren individuale:
ylber, fytyrë, ngjyrë, natyrë, fyell, dallëndyshe, luleshtrydhe
Ylberi ka shtatë ngjyra.

Hapi i katërt: Veprimtari në dyshe
Nxënësit punojnë në dyshe sipas niveleve për të plotësuar balonat me shkronjën ç.
Balonat përgatiten paraprakisht dhe nxënësit shkruajnë shkronjën ***Y,y*** (niveli i parë), fjalë me shkronjën ***Y ç*** (niveli i dytë) dhe fjali (niveli i tretë).
Mësuesja ndjek punën e nxënësve dhe ndihmon për çdo vështirësi që mund të kenë.
Balonat e përgatitura vendosen në këndin e punimeve.
Nxënësit vlerësohen dhe stimulohen për pjesëmarrjen në çdo etapë të orës.

Demonstrim i rezultateve të arritura:
Nxënësit shkruajnë shkronjën ***Y,y*** sipas modelit.
Shkruajnë fjalë dhe fjali me shkronjën ***Y,y.***

Vlerësimi i situatës:
Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:
- Shkruan shkronjën ***Y,y*** mbi bazën e modelit.
- Shkruan fjalë me shkronjën ***Y,y*** mbi bazën e modelit.
- Shkruan fjalë e fjali me shkronjat e mësuara me të diktuar.
- Ruan hapësirat midis fjalëve.

Detyra:
1. Shkruhen nga dy rreshta me shkronjën ***Y,y.***
2. Shkruhen fjalë me shkronjën ***Y,y.***
3. Shkruhen 3 fjali me shkronjat e mësuara.

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 1	Klasa: 1
Tema mësimore: Punim i faqes 88-89 të Abetares. Lapsat me ngjyra			Situata e të nxënit: Ngjyrat
R.N. sipas kompetencave kyçe: Nxënësi: K.1 paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup. K.3 parashtron pyetje dhe përgjigjet në pyetjet për temën /problemin/detyrën e dhënë në njërën nga format e të shprehurit. K.3 ndjek udhëzimet e dhëna në një tekst për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë, që kërkohet. K.4 identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë. K.6 shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive. K.7 realizojnë punime origjinale, vetjake duke përdorur figurat e gjetura nga burime informacioni, si një formë për të shprehur emocionet e tyre.			
R.N. të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: • Lexon tekstin rrjedhshëm e me intonacion. • Ritregon ngjarjen me fjalët e tij. • Shkruan fjalë me shkronjën y. • Ndan fjalët e dhëna në rrokje.			Fjalë kyçe: ngjyra, lapsa, ylber Teknika dhe strategji: • Stuhi mendimi • Punë në grup • Veprimtari në dyshe
Burimet e informacionit dhe mjete: Abetare, shkronja Y, y, etiketa fjalësh, foto, libra për fëmijë, materiale vizatimi, videoprojektor.			Lidhja me fushat e tjera: Matematikë Arte Edukim me të drejtat e fëmijëve
Përshkrim kontekstual i situatës: *Veprimtari paraprake:* Mësuesja vizaton në tabelë: zanore bashkëtingëllore			

Kërkon nga nxënësit të shkruajnë zanoret dhe bashkëtingëlloret që kanë mësuar.
Lexohen, diskutohen.

Veprimet në situatë:
Hapi 1: Punë në grupe

Nxënësit organizohen në grupe.
Secili grup do të formojë fjali me fjalët: ngjyra, lapsa, ylber, mësuesja, fytyrë.
Fjalitë diskutohen në grup dhe mund të renditen për të formuar një tekst nëse është e mundur.
Lexohen nga nxënësit sipas grupeve.

Hapi i dytë: Veprimtari në dyshe

Nxënësit ritregojnë përmbajtjen e ngjarjes me njëri-tjetrin.
Dëgjohen disa dyshe.

Demonstrim i rezultateve të arritura:

Nxënësit lexojnë tekstin rrjedhshëm e me intonacion.
Plotësojnë ushtrimet në tekst:
Ndajnë në rrokje fjalët: rryma, qytet, dyshek, byrek, dallëndyshe, fyelli, fytyra.
Vizatojnë ylberin në një fletë.

Vlerësimi i situatës:
Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- Lexon tekstin rrjedhshëm e me intonacion.
- Ritregon ngjarjen me fjalët e tij.
- Shkruan fjalë me shkronjën y.
- Ndan fjalët e dhëna në rrokje.

Detyra:

1. Shkruajnë një pjesë nga teksti.

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 1	Klasa: 1
Tema mësimore: Punim i shkronjës Z, z. Faqe 890 e Abetares			Situata e të nxënit: Nënë Tereza

R.N. sipas kompetencave kyçe:
Nxënësi:
K.1 paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup.
K.3 ndjek udhëzimet e dhëna në një tekst për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë, që kërkohet.
K.3 parashtron pyetje dhe përgjigjet në pyetjet për temën/problemin/detyrën e dhënë në njërën nga format e të shprehurit.
K.5 bashkëpunon me të tjerët pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitetet në klasë, shkollë apo jashtë saj.
K.6 shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive.

R.N. të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:
Nxënësi:

- Përshkruan mbi bazën e figurave.
- Shqipton, shkruan dhe lexon tingullin dhe shkronjën Z, z.
- Shkruan dhe lexon fjalë me shkronjën z dhe shkronjat e mësuara.

Fjalë kyçe:
Nënë Tereza, zemërmirë, shenjtore

Teknika dhe strategji:

- Stuhi mendimi
- Bisedë rreth figurës
- Analizë e sintezë
- Veprimtari në dyshe

Burimet e informacionit dhe mjete:
Abetare, shkronja Z,z, etiketa fjalësh, foto të Nënë Terezës, libra për fëmijë

Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë
Arte
Edukim me të drejtat e fëmijëve

Përshkrim kontekstual i situatës:
Veprimtari paraprake:

Mësuesja kërkon nga nxënësit të tregojnë çfarë dinë për Nënë Terezën dhe mendimet e tyre i shkruan pa i komentuar në tabelë.



Nëse është e nevojshme,mësuesja jep informacion për Nënë Terezën.

Hapi 1: Bisedë rreth figurës

Mësuesja nxit nxënësit të vërejnë figurën në tekst. Nxënësit vërejnë figurën dhe tregojnë çfarë shohin dhe çfarë kuptojnë. Ndihmohen me pyetjet:
-Çfarë shikoni?
-Me kë ka dalë në fotografi?
- Çfarë tregon kjo?

Hapi i dytë: Analizë e sintezë
Mësuesja shkruan në tabelë titullin: *Zemra e Nënë Terezës*
Nxënësit lexojnë titullin korazi. Kryhet procesi i analizës duke e ndarë në fjalë dhe fjalët në rrokje, për shkëputjen e tingullit dhe shkronjës z.
Mësuesja ndihmon me pyetjet :
-Sa fjalë janë? Në cilat fjalë dëgjoni tingullin z? Sa rrokje ka fjala zemra? Sa shkronja ka? Cilat janë zanore? Po bashkëtingëllore?
Nxënësit shqiptojnë tingullin e ri z.
Mësuesja nxit nxënësit të gjejnë fjalë të tjera me shkronjën z në fillim, në mes dhe në fund të fjalës.
Shkruhen fjalët në tabelë dhe qarkohet shkronja e re.

Hapi i tretë: Punë individuale

Mësuesja paraqet grafikun e shkronjës Z, z. Nxënësit bëjnë dallimin e shkronjës së madhe e të vogël të shtypit.
Shkruhet shkronja në tabelë.
Lëvizet dora në ajër nën drejtimin e mësueses sipas grafikut të shkronjës Z, z.
Nxënësit shkruajnë nga 2-3 rreshta me shkronjën Z, z në fletoren individuale.

Hapi i katërt: Veprimtari në dyshe

Vizatohen 1-2 objekte që kanë shkronjën z.

Demonstrim i rezultateve të arritura:

Plotësohen fjalët në kutizat e dhëna dhe lexohen.
Lexohen fjalët e shkruara.

Vlerësimi i situatës:
Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- Përshkruan mbi bazën e figurave.
- Shqipton, shkruan dhe lexon tingullin dhe shkronjën Z, z.
- Shkruan dhe lexon fjalë me shkronjën z dhe shkronjat e mësuara.

Detyra:

1. Shkruhen nga 2 rreshta me shkronjën e madhe e të vogël të shtypit Z, z.
2. Shkruhen fjalë me shkronjën Z, z.
3. Pyesin prindërit për Nënë Terezën.

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 1	Klasa: 1
Tema mësimore: Punim e shkrim i shkronjës Z, z. Abetare pune fq. 58			Situata e të nxënit: Nënë Tereza

R.N. sipas kompetencave kyçe:
Nxënësi:
K.1 paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup.
K.3 ndjek udhëzimet e dhëna në një tekst për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë, që kërkohet.
K.3 mbikëqyr në mënyrë të pavarur përparimin e vet në një detyrë, aktivitet duke përdorur teknika të ndryshme për gjetjen e gabimeve (si shënim të gabimeve-vështirësive) dhe i korrigjon ato derisa gjen zgjidhjen.
K.4 identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë.
K.6 shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive.

R.N. të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:
Nxënësi:
- Shkruan shkronjën Z, z mbi bazën e modelit.
- Formon e shkruan fjalë 2-3 rrokëshe mbi bazën e rrokjeve të dhëna.
- Shkruan fjalë me kuptim të kundërt me fjalët e dhëna.
- Plotëson fjalitë me fjalët e dhëna.
- Përdor si duhet shenjat e pikësimit në fund të fjalisë.

Fjalë kyçe:
Zogu, çezma,televizor, ekspozitë

Teknika dhe strategji:
- Lojë
- Punë në grup
- Punë individuale
- Veprimtari në dyshe

Burimet e informacionit dhe mjete:
Abetare, shkronja Z, z, etiketa fjalësh, libra për fëmijë

Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë
Arte

Përshkrim kontekstual i situatës:
Veprimtari paraprake:

Në etiketa mësuesja shkruan fjalët: Tereza, Nënë, zemërmirë, është.
Nxënësit punojnë në dyshe për t'i renditur në mënyrë që të formohet fjali.
Shkruhet fjalia në fletë.
Një nxënës e shkruan në tabelë. Diskutohet përdorimi i shkronjës së madhe te fjala Nënë.

Veprimet në situatë:

Hapi 1: Lojë
Mësuesja ndan nxënësit në dy grupe. Njëri grup shkruan shkronjën Z të madhe të shtypit , ndërsa grupi tjetër shkruan shkronjën Z të vogël të shtypit. Në momentin që mësuesja thotë TANI, nxënësit lëvizin nëpër klasë dhe formojnë çiftet e shkronjave Z -z.

Hapi i dytë: Punë në grup

Mësuesja u kërkon nxënësve të komentojnë figurat (zogu, çezma, zambaku).
Për secilën figurë pyet: Çfarë është? Për çfarë nevojitet? A ju pëlqen? Pse? Cilën do të zgjidhnit ndërmjet të triave?
Lexohen fjalët në mënyrë globale dhe plotësohen kutizat bosh me shkronjën z.

Hapi i tretë: Punë individuale

Mësuesja paraqet grafikun e shkronjës Z, z.
Shkruhet shkronja në tabelë.
Lihen të shkruajnë vetëm një shkronjë në Abetaren e punës dhe kur bindet se e kanë shkruar si duhet, i lë të punojnë në mënyrë të pavarur.
Nxënësit këmbejnë librat me njëri-tjetrin për të parë si kanë punuar.

Hapi i katërt: Veprimtari në dyshe

Nxënësit punojnë në dyshe për të plotësuar detyrat e tjera në Abetaren e punës.
Mësuesja ndjek punën e nxënësve dhe ndihmon për çdo paqartësi që mund të kenë duke i shkruar fjalët apo fjalitë në tabelë: zanore, çamçakëz, televizor, ekspozita.
plotësojnë fjalitë me fjalët e dhëna.

Demonstrim i rezultateve të arritura:

Nxënësit shkruajnë fjalët: zogu, zemër, vazo, zambak
Formojnë fjali me fjalët e shkruara.

Vlerësimi i situatës:
Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- Shkruan shkronjën Z, z mbi bazën e modelit.
- Formon e shkruan fjalë 2- 3 rrokëshe mbi bazën e rrokjeve të dhëna.
- Shkruan fjalë me kuptim të kundërt me fjalët e dhëna.
- Plotëson fjalitë me fjalët e dhëna.
- Përdor si duhet shenjat e pikësimit në fund të fjalisë.

Detyra:

1. Shkruhen fjalë me shkronjën z.
2. Shkruhen 5 fjali me shkronjat e mësuara.

Refleksione:

<table>
<tr><td>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla: 1</td><td>Klasa: 1</td></tr>
<tr><td colspan="3">Tema mësimore:
Punim e lexim i shkronjës Z, z. Faqe 90 e Abetares</td><td>Situata e të nxënit:
Nënë Tereza</td></tr>
<tr><td colspan="4">R.N. sipas kompetencave kyçe:
Nxënësi:
K.1 shpreh me gojë për 3-5 minuta para moshatarëve dhe të tjerëve përjetimet dhe emocionet që e kanë shoqëruar gjatë dëgjimit të një tregimi apo përralle.
K.3 parashtron pyetje dhe përgjigjet në pyetjet për temën /problemin/detyrën e dhënë në njërën nga format e të shprehurit.
K.4 identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë.
K.6 shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive.
K.7 realizojnë punime origjinale, vetjake duke përdorur figurat e gjetura nga burime informacioni, si një formë për të shprehur emocionet e tyre.</td></tr>
<tr><td colspan="3" rowspan="2">R.N. të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:
Nxënësi:
• Lexon tekstin qartë dhe saktë.
• Përshkruan figurën që ilustron tekstin.
• U përgjigjet pyetjeve që lidhen me përmbajtjen.
• Dallon titullin në pjesën e dhënë.
• Pyet për t’u sqaruar rreth përmbajtjes së tekstit ose rreth fjalëve të panjohura për të.
• Shpreh ndjenjat dhe mendimet personale rreth pjesës që lexon, me ndihmën e mësueses.</td><td>Fjalë kyçe:
Nënë Tereza, zemërmirë, shenjtore</td></tr>
<tr><td>Teknika dhe strategji:
• Teknika e pyetjeve
• Punë individuale
• Veprimtari në dyshe</td></tr>
<tr><td colspan="3">Burimet e informacionit dhe mjete:
Abetare, shkronja Z, z, etiketa fjalësh, foto, libra për fëmijë, materiale vizatimi</td><td>Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë
Arte
Shoqëria dhe mjedisi</td></tr>
<tr><td colspan="4">Përshkrim kontekstual i situatës:
Veprimtari paraprake:
Mësuesja u kërkon nxënësve të tregojnë çfarë mësuan nga prindërit për nënë Terezën.
I ndihmon me pyetjet:
- Nga ishte Nënë Tereza?
- Ku jetoi ajo gjatë jetës së saj?
- Çfarë bëri ajo për njerëzit e varfër?
- Çfarë do të doje të bëje si ajo?
Tregohen foto, shënime mbi jetën e saj.</td></tr>
</table>

Veprimet në situatë:
Hapi i parë: Lexim i drejtuar

Mësuesja shkruan titullin në tabelë: *Zemra e Nënë Terezës*.
Lexohet teksti nga mësuesja me zë të lartë. Nxënësit nënvizojnë fjalët e reja që nuk ua dinë kuptimin.
Shpjegohet kuptimi i fjalës shenjtore.

Hapi i dytë: Punë individuale

Mësuesja u kërkon nxënësve të lexojnë tekstin në heshtje dhe të drejtojnë pyetje në qoftë se kanë.
Pyetjet e nxënësve shkruhen në tabelë dhe më pas u jepet përgjigje.
Lexohet teksti zinxhir nga nxënësit nga 2-3 fjali.
Lexim i plotë nga 2-3 nxënës.

Hapi i tretë: Veprimtari në dyshe

Nxënësit shkruajnë 2- 3 fjali për Nënë Terezën në shirita letre.
Lexohen fjalitë dhe mund të ngjiten brenda një zemre të madhe.
Lihen nxënësit të shprehin përjetimet e tyre nga puna e përfunduar.

Demonstrim i rezultateve të arritura:

Nxënësit lexojnë tekstin me intonacion.
U përgjigjen pyetjeve që lidhen me përmbajtjen.

Vlerësimi i situatës:
Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- Lexon tekstin qartë dhe saktë.
- Përshkruan figurën që ilustron tekstin.
- U përgjigjet pyetjeve që lidhen me përmbajtjen.
- Dallon titullin në pjesën e dhënë.
- Pyet për t'u sqaruar rreth përmbajtjes së tekstit ose rreth fjalëve të panjohura për të.

Detyra:

1. Lexohet teksti rrjedhshëm e me intonacion.
2. Përshkruajnë Nënë Terezën me 3-4 fjali.

Refleksione:

<table>
<tr><td>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla: 1</td><td>Klasa: 1</td></tr>
<tr><td colspan="3">Tema mësimore:
Ushtrime aplikative për shkrim dore. Shkronja Z, z.</td><td>Situata e të nxënit:
Nënë Tereza</td></tr>
<tr><td colspan="4">R.N. sipas kompetencave kyçe:
Nxënësi:
K.3 ndjek udhëzimet e dhëna në një tekst për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë, që kërkohet.
K.3 mbikëqyr në mënyrë të pavarur përparimin e vet në një detyrë, aktivitet duke përdorur teknika të ndryshme për gjetjen e gabimeve (si shënim të gabimeve - vështirësive) dhe i korrigjon ato derisa gjen zgjidhjen.
K.4 identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë.
K.6 shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive.</td></tr>
<tr><td colspan="3" rowspan="2">R.N. të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:
Nxënësi:
• Shkruan shkronjën Z, z mbi bazën e modelit.
• Shkruan fjalë me shkronjën Z,z mbi bazën e modelit.
• Shkruan fjalë e fjali me shkronjat e mësuara me të diktuar.
• Ruan hapësirat midis fjalëve.
• Përdor shkronjën e madhe në fillim të fjalisë.</td><td>Fjalë kyçe:
Nënë Tereza, zemërmirë</td></tr>
<tr><td>Teknika dhe strategji:
• Lojë
• Demonstrim
• Punë individuale
• Veprimtari në dyshe</td></tr>
<tr><td colspan="3">Burimet e informacionit dhe mjete:
Abetare, shkronja Z, z e dorës, etiketa fjalësh me shkrim dore, foto, libra për fëmijë</td><td>Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë
Arte
Edukim me të drejtat e fëmijëve</td></tr>
<tr><td colspan="4">Përshkrim kontekstual i situatës:
Veprimtari paraprake:

Nxënësit do të kujtojnë shkronjat e mësuar të dorës duke i lexuar në tabelë korrazi.
Shkruajnë fjalë në tabelë nxënës të ndryshëm me shkronjat e mësuara dhe lexohen nga nxënësit e tjerë:
Për çdo fjalë mësuesja pyet: Sa shkronja ka? Cilat janë zanore? Cilat janë bashkëtingëllore?

Veprimet në situatë:
Hapi 1: Lojë

Mësuesja orienton nxënësit :</td></tr>
</table>

-Mbyllini sytë dhe ngrini lart dorën që shkruani. Provojmë të lëvizim dorën në mënyrë që të shkruajmë shkronjën e madhe dhe të vogël të dorës *Z,z.*

Hapi i dytë: Demonstrim
Mësuesja paraqet para nxënësve shkronjën e madhe e të vogël të dorës *Z,z.*
Ngrihen 2-3 nxënës në tabelë për ta shkruar.
Mësuesja i udhëzon nxënësit të shkruajnë shkronjat në fletë të bardha me lapsa me ngjyra.
Më pas nxënësit shkruajnë në Abetaren e punës shkronjat dhe fjalët sipas modelit.
Mësuesja ndjek punën e nxënësve dhe mbasi bindet që e shkruajnë mirë i lë të punojnë në mënyrë të pavarur.
Hapi i tretë: Punë individuale

Nxënësit shkruajnë me të diktuar fjalët dhe fjalinë në fletoren individuale:
zemër, zogu, zanore, televizor, zambaku, zgjohem, zbuloj
Zana i hodhi zogut grimca buke.

Hapi i katërt: Veprimtari në dyshe
Nxënësit punojnë në dyshe sipas niveleve për të plotësuar balonat me shkronjën z.
Balonat përgatiten paraprakisht dhe nxënësit shkruajnë shkronjën *Z, z* (niveli i parë), fjalë me shkronjën *Z,z* (niveli i dytë) dhe fjali (niveli i tretë).
Mësuesja ndjek punën e nxënësve dhe ndihmon për çdo vështirësi që mund të kenë.
Balonat e përgatitura vendosen në këndin e punimeve.
Nxënësit vlerësohen dhe stimulohen për pjesëmarrjen në çdo etapë të orës.

Demonstrim i rezultateve të arritura:
Nxënësit shkruajnë shkronjën *Z,z* sipas modelit.
Shkruajnë fjalë dhe fjali me shkronjën *Z,z.*

Vlerësimi i situatës:
Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- Shkruan shkronjën *Z,z* mbi bazën e modelit.
- Shkruan fjalë me shkronjën *Z,z* mbi bazën e modelit.
- Shkruan fjalë e fjali me shkronjat e mësuara me të diktuar.
- Ruan hapësirat midis fjalëve.
- Përdor shkronjën e madhe në fillim të fjalisë.

Detyra:

1. Shkruhen nga dy rreshta me shkronjën *Z,z.*
2. Shkruhen fjalë me shkronjën *Z,z.*
3. Shkruhen 3 fjali me shkronjat e mësuara.

Refleksione:

<table>
<tr><td>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla: 1</td><td>Klasa: 1</td></tr>
<tr><td colspan="3">Tema mësimore:
Punim i faqes 90 -91 të Abetares. Zemra e Nënë Terezës</td><td>Situata e të nxënit:
Nënë Tereza</td></tr>
<tr><td colspan="4">R.N. sipas kompetencave kyçe:
Nxënësi:
K.1 paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup.
K.3 parashtron pyetje dhe përgjigjet në pyetjet për temën /problemin/detyrën e dhënë në njërën nga format e të shprehurit.
K.3 ndjek udhëzimet e dhëna në një tekst për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë, që kërkohet.
K.4 identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë.
K.6 shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive.</td></tr>
<tr><td colspan="3" rowspan="2">R.N. të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:
Nxënësi:
• Lexon tekstin rrjedhshëm e me intonacion.
• Ritregon ngjarjen me fjalët e tij.
• Shkruan fjalë me shkronjën z.
• Plotëson fjalitë me fjalët që mungojnë.
• Lidh fjalët me kuptim të kundërt.</td><td>Fjalë kyçe:
Nënë Tereza, e dashur, e dhembshur, zemërbutë</td></tr>
<tr><td>Teknika dhe strategji:
• Punë në grup
• Veprimtari në dyshe</td></tr>
<tr><td colspan="3">Burimet e informacionit dhe mjete:
Abetare, shkronja Z, z, etiketa fjalësh, foto, libra për fëmijë, materiale vizatimi.</td><td>Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë
Arte
Edukim me të drejtat e fëmijëve</td></tr>
<tr><td colspan="4">Përshkrim kontekstual i situatës:
Veprimtari paraprake:
Mësuesja shkruan në tabelë tri gjëegjëza:

Natë e ditë pa pushim,
rreh e rreh me rrëmbim,
nuk ka mjeshtër në botë
të bëjë mall më të fortë.
(zemra)

Hekur përqark
e mish në bark.
(unaza)

Rreth e rrotull bardhësi,
brenda argjend e flori.
(veza)</td></tr>
</table>

Veprimet në situatë:

Hapi 1: Punë në grupe

Nxënësit organizohen në grupe.
Secili grup do të formojë fjalë me rrokjet ze.
Fjalët diskutohen në grup dhe lexohen nga një nxënës për çdo grup.
Krahasohen gjetjet midis grupeve.

Hapi i dytë: Veprimtari në dyshe

Nxënësit ritregojnë përmbajtjen e ngjarjes me njëri-tjetrin.
Dëgjohen disa dyshe.

Hapi i tretë: Bashkëbisedim

Mësuesja nxit nxënësit të përfundojnë fjalinë *Unë jam krenar për Nënë Terezën sepse…*
Mendimet e nxënësve shkruhen në tabelë.

Demonstrim i rezultateve të arritura:

Nxënësit lexojnë tekstin rrjedhshëm e me intonacion.
Plotësojnë ushtrimet në tekst:
Lidhin fjalët me kuptim të kundërt dhe formojnë fjali gojarisht me to (mbush – zbraz, mbuloj – zbuloj, fle – zgjohem, hip – zbres).

Vlerësimi i situatës:
Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- Lexon tekstin rrjedhshëm e me intonacion.
- Ritregon ngjarjen me fjalët e tij.
- Shkruan fjalë me shkronjën z.
- Plotëson fjalitë me fjalët që mungojnë.
- Lidh fjalët me kuptim të kundërt.

Detyra:

1. Formojnë fjali me fjalët me kuptim të kundërt (ushtrimi në tekst).

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 1	Klasa: 1
Tema mësimore: Punim i shkronjës X, x. Faqe 92 e Abetares			Situata e të nxënit: Xixëllonja

R.N. sipas kompetencave kyçe:
Nxënësi:
K.1 paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup.
K.3 ndjek udhëzimet e dhëna në një tekst për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë, që kërkohet.
K.3 parashtron pyetje dhe përgjigjet në pyetjet për temën/problemin/detyrën e dhënë në njërën nga format e të shprehurit.
K.5 bashkëpunon me të tjerët pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitetet në klasë, shkollë apo jashtë saj.
K.6 shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive.

R.N. të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:
Nxënësi:

- Përshkruan mbi bazën e figurave.
- Shqipton, shkruan dhe lexon tingullin dhe shkronjën X, x.
- Qarkon shkronjën X, x të shtypit në pozicione të ndryshme të fjalës.
- Shkruan dhe lexon fjalë me shkronjën x dhe shkronjat e mësuara.
- U përgjigjet pyetjeve që lidhen me përmbajtjen.
- Reciton vjershën me intonacion.

Fjalë kyçe:
xixëllonja, xixa, xixëllon

Teknika dhe strategji:

- Bisedë rreth figurës
- Analizë e sintezë
- Veprimtari në dyshe

Burimet e informacionit dhe mjete:
Abetare, shkronja X, x, etiketa fjalësh, foto, libra për fëmijë, vjersha

Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë
Arte
Edukim mjedisor

Përshkrim kontekstual i situatës:
Veprimtari paraprake:

Nxiten nxënësit të thonë fjalë me shkronjën x. Mësuesja i shkruan në tabelë:



Hapi 1: Bisedë rreth figurës

Mësuesja nxit nxënësit të vërejnë figurën në tekst. Nxënësit vërejnë figurën dhe tregojnë çfarë shohin dhe çfarë kuptojnë. Ndihmohen me pyetjet:
-Çfarë shikoni?
-Çfarë po bëjnë fëmijët?
-Si duken ata?
-A keni provuar ndonjëherë ju të kapni xixëllonja?

Hapi i dytë: Analizë e sintezë

Mësuesja shkruan në tabelë titullin: *Xixëllonja.*
Kryhet procesi i analizës duke e ndarë fjalën në rrokje për shkëputjen e tingullit dhe shkronjës x.
Mësuesja ndihmon me pyetjet :
- Sa rrokje ka fjala xixëllonja? Sa shkronja ka? Cilat janë zanore? Po bashkëtingëllore?
Nxënësit shqiptojnë tingullin e ri x.

Hapi i tretë: Punë individuale

Lexohet vjersha strofë-strofë.
Lexim i plotë i vjershës nga disa nxënës.
Recitohet vjersha nga nxënësit që mund të jenë gati.

Demonstrim i rezultateve të arritura:

Plotësohen fjalët sipas figurave të dhëna dhe lexohen.
U përgjigjen pyetjeve që lidhen me përmbajtjen.

Vlerësimi i situatës:
Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- Përshkruan mbi bazën e figurave.
- Shqipton, shkruan dhe lexon tingullin dhe shkronjën X, x.
- Qarkon shkronjën X, x të shtypit në pozicione të ndryshme të fjalës.
- Shkruan dhe lexon fjalë me shkronjën x dhe shkronjat e mësuara.
- U përgjigjet pyetjeve që lidhen me përmbajtjen.
- Reciton vjershën me intonacion.

Detyra:

1. Shkruhen fjalë me shkronjën x.
2. Mësojnë vjershën përmendësh.

Refleksione:

<table>
<tr><td>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla: 1</td><td>Klasa: 1</td></tr>
<tr><td colspan="3">Tema mësimore:
Punim e shkrim i shkronjës X, x. Abetare pune fq. 59</td><td>Situata e të nxënit:
Xixëllonja</td></tr>
<tr><td colspan="4">R.N. sipas kompetencave kyçe:
Nxënësi:
K.1 paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup.
K.3 ndjek udhëzimet e dhëna në një tekst për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë, që kërkohet.
K.3 mbikëqyr në mënyrë të pavarur përparimin e vet në një detyrë, aktivitet duke përdorur teknika të ndryshme për gjetjen e gabimeve (si shënim të gabimeve - vështirësive) dhe i korrigjon ato derisa gjen zgjidhjen.
K.4 identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë.
K.6 shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive.</td></tr>
<tr><td colspan="3" rowspan="2">R.N. të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:
Nxënësi:
• Shkruan shkronjën X,x të shtypit mbi bazën e modelit.
• Shkruan fjalë me shkronjën x mbi bazën e figurave të dhëna.
• Formon e shkruan fjalë 2- 3 rrokëshe mbi bazën e rrokjeve të dhëna.
• Plotëson fjalitë me fjalët e dhëna.
• Përdor si duhet shenjat e pikësimit në fund të fjalisë.</td><td>Fjalë kyçe:
xixëllonja, xixa, xixëllon</td></tr>
<tr><td>Teknika dhe strategji:
• Lojë
• Punë në grup
• Punë individuale
• Veprimtari në dyshe</td></tr>
<tr><td colspan="3">Burimet e informacionit dhe mjete:
Abetare, shkronja X,x, etiketa fjalësh, libra për fëmijë</td><td>Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë
Arte</td></tr>
<tr><td colspan="4">Përshkrim kontekstual i situatës:
Veprimtari paraprake:

Në etiketa mësuesja shkruan fjalët: xixëllonja, xixa, xixëllon të ndara në rrokje.
Nxënësit punojnë në dyshe për t’i renditur në mënyrë që të formohen fjalët e mësipërme.
Fjalët e formuara shkruhen në një fletë dhe formohen fjali.
Lexohen fjalitë nga nxënësit dhe shkruhen në tabelë nga mësuesja.

Veprimet në situatë:
Hapi 1: Lojë
Mësuesja ndan nxënësit në dy grupe. Njëri grup shkruan shkronjën X të madhe të shtypit, ndërsa grupi tjetër shkruan shkronjën x të vogël të shtypit. Në momentin që mësuesja thotë TANI, nxënësit lëvizin nëpër klasë dhe formojnë çiftet e shkronjave X-x.</td></tr>
</table>

Hapi i dytë: Punë në grup

Mësuesja u kërkon nxënësve të emërtojnë figurat (xixa, lexon, xixëllonja).
Lexohen fjalët në mënyrë globale dhe plotësohen kutizat bosh me shkronjën x.

Hapi i tretë: Punë individuale

Mësuesja paraqet grafikun e shkronjës X, x.
Shkruhet shkronja në tabelë.
Lihen të shkruajnë vetëm një shkronjë në Abetaren e punës dhe kur bindet se e kanë shkruar si duhet, i lë të punojnë në mënyrë të pavarur.
Nxënësit këmbejnë librat me njëri-tjetrin për të parë si kanë punuar.

Hapi i katërt: Veprimtari në dyshe

Nxënësit punojnë në dyshe për të plotësuar detyrat e tjera në Abetaren e punës.
Mësuesja ndjek punën e nxënësve dhe ndihmon për çdo paqartësi që mund të kenë duke i shkruar fjalët apo fjalitë në tabelë: nxitim, nxënësi, nxehtësi, xixëllonja.
Plotësojnë fjalitë duke vendosur në vend të figurave fjalët e duhura:
Nxënësi lexon librin.
Xixëllonja xixëllon natën.
Nxënësit nxitojnë për në shkollë.
Dielli nxeh tokën.

Demonstrim i rezultateve të arritura:

Nxënësit shkruajnë fjalët: nxënës, lexon, nxiton.
Formojnë fjali me fjalët e shkruara.

Vlerësimi i situatës:
Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- Shkruan shkronjën X,x të shtypit mbi bazën e modelit.
- Shkruan fjalë me shkronjën x mbi bazën e figurave të dhëna.
- Formon e shkruan fjalë 2- 3 rrokëshe mbi bazën e rrokjeve të dhëna.
- Plotëson fjalitë me fjalët e dhëna.
- Përdor si duhet shenjat e pikësimit në fund të fjalisë.

Detyra:

1. Shkruhen fjalë me shkronjën x.
2. Shkruhen 5 fjali me shkronjat e mësuara.

Refleksione:

<table>
<tr><td>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla: 1</td><td>Klasa: 1</td></tr>
<tr><td colspan="3">Tema mësimore:
Punim e lexim i shkronjës X, x. Faqe 93 e Abetares</td><td>Situata e të nxënit:
Xixëllonja</td></tr>
<tr><td colspan="4">R.N. sipas kompetencave kyçe:
Nxënësi:
K.1 shpreh me gojë për 3-5 minuta para moshatarëve dhe të tjerëve përjetimet dhe emocionet që e kanë shoqëruar gjatë dëgjimit të një tregimi apo përralle.
K.3 parashtron pyetje dhe përgjigjet në pyetjet për temën /problemin/detyrën e dhënë në njërën nga format e të shprehurit.
K.4 identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë.
K.6 shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive.
K.7 realizojnë punime origjinale, vetjake duke përdorur figurat e gjetura nga burime informacioni, si një formë për të shprehur emocionet e tyre.</td></tr>
<tr><td colspan="3" rowspan="2">R.N. të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:
Nxënësi:
• Lexon vjershën qartë dhe saktë.
• Përshkruan figurën që ilustron tekstin.
• U përgjigjet pyetjeve që lidhen me përmbajtjen e vjershës.
• Dallon titullin në pjesën e dhënë.
• Pyet për t’u sqaruar rreth përmbajtjes së vjershës ose rreth fjalëve të panjohura për të.</td><td>Fjalë kyçe:
yll, xixëllonjë, xixëllon</td></tr>
<tr><td>Teknika dhe strategji:
• Punë në grup
• Punë individuale
• Veprimtari në dyshe</td></tr>
<tr><td colspan="3">Burimet e informacionit dhe mjete:
Abetare, shkronja X, x, etiketa fjalësh, foto, libra për fëmijë, tregime, materiale vizatimi</td><td>Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë
Arte
Shoqëria dhe mjedisi</td></tr>
<tr><td colspan="4">Përshkrim kontekstual i situatës:

Veprimtari paraprake:

Mësuesja u kërkon nxënësve të plotësojnë fjalitë:

Xixëllonja xixëllon _____

Xixëllonja shihet _____

Xixëllonja është _____

Xixëllonja më pëlqen sepse _____

Nxënësit prezantojnë punën e tyre.</td></tr>
</table>

Veprimet në situatë:

Hapi 1: Punë në grup

Mësuesja shkruan titullin në tabelë: *Ylli i vogël lart në qiell*.

Për çdo grup mësuesja shpërndan vargjet e strofës së parë të ndarë në rreshta.

Nxënësit rreshtojnë vargjet sipas kuptimit dhe i lexojnë.

Përsëritet veprimtaria për strofën e dytë.

Hapi i dytë: Punë individuale

Nxënësit lexojnë vjershën në libër dhe kontrollojnë renditjen që bënë më parë.

Bëjnë pyetje rreth vjershës ose për fjalët që nuk i kuptojnë.

Hapi i tretë: Veprimtari në dyshe

Nxënësit punojnë në dyshe për të formuar fjali me fjalët e dhëna në tekst.

Lexohen fjalitë e formuara dhe bëhen korrigjimet e nevojshme.

Demonstrim i rezultateve të arritura:

Nxënësit lexojnë vjershën me intonacion.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- Lexon vjershën qartë dhe saktë.
- Përshkruan figurën që ilustron tekstin.
- U përgjigjet pyetjeve që lidhen me përmbajtjen e vjershës.
- Dallon titullin në pjesën e dhënë.
- Pyet për t'u sqaruar rreth përmbajtjes së vjershës ose rreth fjalëve të panjohura për të.

Detyra:

1. Lexohet vjersha rrjedhshëm e me intonacion.
2. Mësohet vjersha përmendësh dhe recitohet me intonacion.

Refleksione:

<table>
<tr><td>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla: 1</td><td>Klasa: 1</td></tr>
<tr><td colspan="3">Tema mësimore:
Ushtrime aplikative për shkrim dore. Shkronja $\mathcal{X}$, x.</td><td>Situata e të nxënit:
Xixëllonja</td></tr>
<tr><td colspan="4">R.N. sipas kompetencave kyçe:
Nxënësi:
K.3 ndjek udhëzimet e dhëna në një tekst për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë, që kërkohet.
K.3 mbikëqyr në mënyrë të pavarur përparimin e vet në një detyrë, aktivitet duke përdorur teknika të ndryshme për gjetjen e gabimeve (si shënim të gabimeve - vështirësive) dhe i korrigjon ato derisa gjen zgjidhjen.
K.4 identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë.
K.6 shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive.</td></tr>
<tr><td colspan="3" rowspan="2">R.N. të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:
Nxënësi:
• Shkruan shkronjën $\mathcal{X}$,x mbi bazën e modelit.
• Shkruan fjalë me shkronjën $\mathcal{X}$,x mbi bazën e modelit.
• Shkruan fjalë e fjali me shkronjat e mësuara me të diktuar.
• Ruan hapësirat midis fjalëve.</td><td>Fjalë kyçe:
xixëllonja, xixa, xixëllon</td></tr>
<tr><td>Teknika dhe strategji:
• Lojë
• Demonstrim
• Punë individuale
• Veprimtari në dyshe</td></tr>
<tr><td colspan="3">Burimet e informacionit dhe mjete:
Abetare, shkronja $\mathcal{X}$, x e dorës, etiketa fjalësh me shkrim dore, foto, libra për fëmijë.</td><td>Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë
Arte
Edukim me të drejtat e fëmijëve</td></tr>
<tr><td colspan="4">Përshkrim kontekstual i situatës:
Veprimtari paraprake

Nxënësit do të kujtojnë shkronjat e mësuar të dorës duke i lexuar në tabelë korrazi.
Shkruajnë fjalë në tabelë nxënës të ndryshëm me shkronjat e mësuara dhe lexohen nga nxënësit e tjerë:
Për çdo fjalë mësuesja pyet: Sa shkronja ka? Cilat janë zanore? Cilat janë bashkëtingëllore?</td></tr>
</table>

Veprimet në situatë:
Hapi 1: Lojë
Mësuesja orienton nxënësit:
-Mbyllini sytë dhe ngrini lart dorën që shkruani. Provojmë të lëvizim dorën në mënyrë që të shkruajmë shkronjën e madhe dhe të vogël të dorës ***X,x.***
Hapi i dytë: Demonstrim

Mësuesja paraqet para nxënësve shkronjën e madhe e të vogël të dorës ***X,x.***
Ngrihen 2-3 nxënës në tabelë për ta shkruar.
Mësuesja i udhëzon nxënësit të shkruajnë shkronjat në fletë të bardha me lapsa me ngjyra.
Më pas nxënësit shkruajnë në Abetaren e punës shkronjat dhe fjalët sipas modelit.
Mësuesja ndjek punën e nxënësve dhe mbasi bindet që e shkruajnë mirë i lë të punojnë në mënyrë të pavarur.
Hapi i tretë: Punë individuale

Nxënësit shkruajnë me të diktuar fjalët dhe fjalinë në fletoren individuale:
xixa, lexon, nxiton, nxeh, nxij, xixëllon
Xixëllonja xixëllon natën.

Hapi i katërt: Veprimtari në dyshe

Nxënësit punojnë në dyshe sipas niveleve për të plotësuar balonat me shkronjën ç.
Balonat përgatiten paraprakisht dhe nxënësit shkruajnë shkronjën ***X, x*** (niveli i parë), fjalë me shkronjën ***X x*** (niveli i dytë) dhe fjali (niveli i tretë).
Mësuesja ndjek punën e nxënësve dhe ndihmon për çdo vështirësi që mund të kenë.
Balonat e përgatitura vendosen në këndin e punimeve.
Nxënësit vlerësohen dhe stimulohen për pjesëmarrjen në çdo etapë të orës.

Demonstrim i rezultateve të arritura:

Nxënësit shkruajnë shkronjën ***X,x*** sipas modelit.
Shkruajnë fjalë dhe fjali me shkronjën ***X,x.***

Vlerësimi i situatës:
Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- Shkruan shkronjën ***X,x*** mbi bazën e modelit.
- Shkruan fjalë me shkronjën ***X,x*** mbi bazën e modelit.
- Skruan fjalë e fjali me shkronjat e mësuara me të diktuar.
- Ruan hapësirat midis fjalëve.

Detyra:

1. Shkruhen nga dy rreshta me shkronjën ***X,x.***
2. Shkruhen 3 fjali me shkronjat e mësuara.

Refleksione:

<table>
<tr><td>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla: 1</td><td>Klasa: 1</td></tr>
<tr><td colspan="3">Tema mësimore:
Punim i faqes 92 -93 të Abetares. Ylli i vogël lart në qiell</td><td>Situata e të nxënit:
Xixëllonja</td></tr>
<tr><td colspan="4">R.N. sipas kompetencave kyçe:
Nxënësi:
K.1 paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup.
K.3 parashtron pyetje dhe përgjigjet në pyetjet për temën /problemin/detyrën e dhënë në njërën nga format e të shprehurit.
K.3 ndjek udhëzimet e dhëna në një tekst për të realizuar një veprim/aktivitet /detyrë, që kërkohet.
K.4 identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë.
K.6 shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive.
K.7 realizojnë punime origjinale, vetjake duke përdorur figurat e gjetura nga burime informacioni, si një formë për të shprehur emocionet e tyre.</td></tr>
<tr><td colspan="3" rowspan="2">R.N. të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:
Nxënësi:
• Lexon vjershën rrjedhshëm e me intonacion.
• Reciton vjershën Ylli i vogël lart në qiell.
• Shkruan fjali me fjalët e dhëna.
• Shpreh qartë mendimin e tij.</td><td>Fjalë kyçe:
yll, xixëllon, xixa - xixa</td></tr>
<tr><td>Teknika dhe strategji:
• Stuhi mendimi
• Punë në grup
• Veprimtari në dyshe</td></tr>
<tr><td colspan="3">Burimet e informacionit dhe mjete:
Abetare, shkronja X,x, etiketa fjalësh, foto, libra për fëmijë, materiale vizatimi, videoprojektor.</td><td>Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë
Arte
Edukim me të drejtat e fëmijëve</td></tr>
<tr><td colspan="4">Përshkrim kontekstual i situatës:
Veprimtari paraprake:
Mësuesja shfaq me videoprojektor (ose me foto) pamje të qiellit natën ku duket vezullimi i yjeve dhe nxiten nxënësit të shprehin mendimet e tyre rreth pamjeve. Ndihmohen me pyetjet:
- Çfarë shikoni?
- Si e kuptoni që janë pamje nga qielli?
- Si duken yjet?
- Pse fotot janë bërë natën?
- Çfarë ka tjetër në hapësirë?
Lexohet vjersha nga dy nxënës.</td></tr>
</table>

Veprimet në situatë:

Hapi 1: Punë në grupe

Nxënësit organizohen në grupe.
Secili grup do të formojë fjali me fjalët: xixëllonjë, xixa, xixëllon, shkëndijë.
Fjalitë diskutohen në grup dhe zgjidhen më të bukurat. Mund të renditen për të formuar një tekst nëse është e mundur dhe ngjiten në një fletë të bardhë. Shkruajnë dhe një titull në fletë.
Lexohen nga nxënësit sipas grupeve.

Hapi i dytë: Veprimtari në dyshe

Nxënësit recitojnë vjershën me intonacion njëri pas tjetrit.
Shkruajnë fjali me fjalët e dhëna dhe diskutojnë në dyshe.

Demonstrim i rezultateve të arritura:

Nxënësit lexojnë vjershën rrjedhshëm e me intonacion.
Formojnë katër fjali me fjalën nxeh.
Gjejnë e plotësojnë në kutizat bosh fjalët: lexim, nxeh, xixa, nxitoj, nxin.

Vlerësimi i situatës:
Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- Lexon vjershën rrjedhshëm e me intonacion.
- Reciton vjershën *Ylli i vogël lart në qiell.*
- Shkruan fjali me fjalët e dhëna.
- Shpreh qartë mendimin e tij.

Detyra:

1. Shkruajnë fjalitë e detyrës së parë në tekst.
2. Punojnë me vetëdiktim fjalë me shkronjën x.
3. Vizatojnë natën me yje.

Refleksione:

Tema mësimore: Punim i shkronjës **Xh, xh** faqe **94** të Abetares	**Situata e të nxënit:** Profesionet

***Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe**

Nxënësi:

- ***(1)Kompetenca e komunikim dhe të shprehurit:*** Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar.
- ***(3)Kompetenca e të nxënit:*** Parashtron pyetje dhe përgjigje në lidhje me temën.
- ***(4)Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin:*** Gjen të përbashkëtat dhe ndryshimet ndërmjet aktiviteteve që bën në shkollë me ato në shtëpi.

Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore** Nxënësi: - Shqipton tingullin **Xh** - Gjen dhe thotë fjalë që fillojnë me ***Xh ose që përmbajnë shkronjën **Xh** në trup të tyre. - Plotëson sipas figurës fjalë mungesore. - Pyet, përgjigjet, shpreh mendimet, ndjenjat dhe emocionet e tij, si dhe diskuton në grupe të vogla për tema që i interesojnë	**Fjalë kyçe:** *Xhaketa, panxhari, valixhe,* **Teknika dhe strategji:** - Këngë: "Xhamadani vija-vija" - Marrëdhënie pyetje-përgjigje - Vëzhgim - Demonstrim - Punë individuale/ Çift
Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, modele shkronjash individuale, grafiku i shkronjës **Xh, xh** të shtypit, foto të profesioneve të ndryshme.	**Lidhja me fushat e tjera:** Lënda: Matematikë, Arte

Përshkrimi kontekstual i situatës:

- ***Veprimtari paraprake:***

Hapi 1. Mësuesi/ja lë nxënësit të dëgjojnë dhe i shoqëron ata të këndojnë këngën "Xhamadani vija- vija". Kjo këngë mund të gjendet ne yotube në këtë link: https://www.youtube.com/watch?v=Knik715yYB0.

Hapi 2. Mësuesi/ja shkruan në tabelë fjalën " Xhamaprerësi". Pyet nxënësit se çfarë do të thotë. Shpjegon se është një profesion që merret me prerjen e xhamave.

- *Po ju çfarë profesionesh pëlqeni të bëni kur të rriteni?Pse?*
- *Cilat janë profesione të vështira?*
- *Po më i bukuri?*

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 3. Njihen nxënësit me tingullin dhe shkronjën **Xh, xh**.

Demonstron para klasës grafikun e shkronjës së vogël dhe të madhe të shtypit. Tregon se është e përbërë nga dy shkronja **X** dhe **H**.

Nxit nxënësit të bëjnë ngjashmëritë dhe dallimet me shkronjat e tjera dhe objekte të tjera rrethanore.

Nxiten nxënësit të gjejnë fjalë që fillojnë me **Xh**, e kanë në trup ose mbarojnë me **xh**.

Xh	**Xh**	**Xh**
Xhami	zinxhir	Xhuxh .....

Hapi 4. Nxënësit në fletoret e punës shkruajnë dy rreshta me shkronjën **xh** të madhe dhe të vogël të shtypit si dhe disa fjalë nga ato që u shkruan në tabelë.

Hapi 5. Nxënësit punojnë individualisht për plotësimin e shkronjave në fjalët mungesore.

Xhaketa, panxhari, valixhe.

Diskutohet me nxënësit për to:

- *Çfarë janë?*
- *Përse shërbejnë?*
- *Cilët veshin xhaketë?*
- *Për çfarë shërben panxhari?*
- *Kur përdoret valixhja?*

Bëhet leximi dhe ndarja e tyre në rrokje. Ngre disa nxënës që shkruajnë fjalët në tabelë.

Në mënyrë individuale nxënësit qarkojnë rrokjen përkatëse në fjalë.

Lexohen me zë të lartë fjalët.

Mësuesi/ja mund të shpjegojë kuptimin e disa fjalëve të cilat nxënësit nuk i ka hasur më parë.

Me disa prej tyre formojnë fjali.

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 6.

Mësuesi/ja paraqet para klasës etiketa me fjalë që përmbajnë ose jo shkronjën **Xh**. Lihen nxënësit të lexojnë në heshtje. Nëse fjala përmban shkronjën **Xh**, ata duhet të duartrokasin.

Disa fjalë që mund të përdore janë:

Viç, xhaxhi, gonxhe, zinxhiri, çanta, zhapik, etj.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Shqipton tingullin **Xh.**
- ✓ Gjen dhe thotë fjalë që fillojnë me ***Xh*** ose që përmbajnë shkronjën **Xh** në trup të tyre.
- ✓ Plotëson sipas figurës fjalë mungesore.
- ✓ Pyet, përgjigjet, shpreh mendimet, ndjenjat dhe emocionet e tij, si dhe diskuton në grupe të vogla për tema që i interesojnë.

Detyrë shtëpie:

1. Vizato një profesion që të pëlqen.
2. Shkruaj 10 fjalë që përmbajnë shkronjën **xh**.
3. Shkruaj 3 fjali për figurën.

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1	**Klasa:** 1
Tema mësimore: Punim e shkrim i shkronjës **Xh, xh,** Abetare pune faqe **60**		**Situata e të nxënit:** Profesionet	

***Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe**

Nxënësi:

- ***(3)Kompetenca e të nxënit:*** Ndjek udhëzimet e dhëna për të realizuar një veprim.
- ***(4) Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin :*** Identifikon burimet e nevojshme dhe i përdor në mënyrë të drejtë.
- ***(5)Kompetenca personale:*** Bashkëpunon me të tjerët pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitetet në klasë, shkollë apo jashtë saj.

***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore**

Nxënësi:

- Shkruan shkronjës **Xh, xh** të shtypit sipas modelit
- Shkruan rrokje, fjalë, fjali.
- Lidh fjalën me figurën përkatëse.
- Rendit fjalët në fjali.
- Bën pyetje rreth figurës dhe i përgjigjet atyre me fjali të plotë.

Fjalë kyçe:
Valixhe, gonxhe, xhuxh, xhup

Teknika dhe strategji:

- Lojë me etiketa
- Diskutim
- Punë individuale
- Analizë – sintezë fjalësh, fjalish.
- Punë në çifte

Burimet e informacionit dhe mjete: Shkronjat individuale dhe kolektive, fletore pune, etiketa me emra profesionesh.

Lidhja me fushat e tjera:
Dituri natyre, arte

Përshkrimi kontekstual i situatës

- ***Veprimet paraprake***

Hapi 1. Mësuesi/ja ka përgatitur disa etiketa me profesione të ndryshme, nxënësit zgjedhin një dhe diskutojnë nëse e pëlqejnë ose jo atë profesion. Duhet të argumentojnë përgjigjet.

Inxhinier	Shofer	Mjek	Hidraulik
Mësues	Axhustator	Kuzhinier	Xhenerik

Mund të ketë mendime pro dhe kundër, stimulohen me pyetje përforcuese.

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 2. Nxënësit emërtojnë dhe komentojnë figurat. I përgjigjen pyetjeve:

- *Çfarë është?*
- *Për çfarë shërben?*
- *Ku i keni parë xhuxhat?*
- *Çfarë janë ata?*

Nxënësit lexojnë fjalët dhe plotësojnë shkronjën **xh** që mungon.

Valixhe, gonxhe, xhuxha.

Hapi 3. Punohet sipas kërkesave në fletoren e punës. Modelohet shkronja **Xh, xh**.
Renditin fjalët për të krijuar fjalinë:
Xhuxhi i vogël ka një xhup me xhep.
Lidh fjalët me figurën përkatëse.
Nxit nxënësit të diskutojnë figurat dhe të hartojnë pyetje për to. Mund t'i vendosin emra fëmijëve.
Ku shkon Xhimi?
Xhimi po ikën në mal.
Përse po ikën ai?
Ai po ikën për pushime.
Me kë po ikën Xhimi?
Xhimi po ikën me Xhenin.

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 4. Nxit nxënësit të diskutojnë me njëri tjetrin dhe të korrigjojnë fletoret e njëri-tjetrit.
Nxënësit lexojnë fjalët dhe fjalitë që krijuan gjatë ushtrimeve në fletoren e punës.
Bëhen konkluzionet e orës.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Shkruan shkronjës **Xh, xh** të shtypit sipas modelit.
- ✓ Shkruan rrokje, fjalë, fjali.
- ✓ Lidh fjalën me figurën përkatëse.
- ✓ Rendit fjalët në fjali.
- ✓ Bën pyetje rreth figurës dhe i përgjigjet atyre me fjali të plotë.

Detyrë shtëpie:

1. Formo fjali me fjalët : *valixhe, gonxhe, xhuxha.*
2. Kopjo bukur në fletore pyetjet dhe përgjigjet rreth figurës.
3. Përshkruaj me disa fjali profesionin që të pëlqen.

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1	**Klasa:** 1
Tema mësimore: Punim e lexim i shkronjës **Xh, xh** faqe **95** të Abetares		**Situata e të nxënit:** Profesionet	

***Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe**

Nxënësi:

- ***(1)Kompetenca e komunikim dhe të shprehurit:*** Lexon me zë një tekst së paku prej gjysmë faqeje të pa lexuar më parë.
- ***(1) Kompetenca e komunikim dhe të shprehurit:*** Identifikon personazhet e një tregimi.
- ***(3) Kompetenca e të nxënit:*** Parashtron pyetje dhe përgjigjet në pyetjet për temën /problemin/ detyrën e dhënë në njërën nga format e të shprehurit.

***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore**	**Fjalë kyçe:** *tregim, titull, personazhe, dëshirë*
Nxënësi: - Lexon fjali, tekst. - Pyet, përgjigjet, shpreh mendimet, ndjenjat dhe emocionet e tij, si dhe diskuton në grupe të vogla për tema që i interesojnë - Tregon që e ka kuptuar tekstin e lexuar: *duke ritreguar shkurtimisht dhe me fjalë të thjeshta brendinë; duke përmendur çështjet kryesore; duke dhënë shembuj ose ilustrime nga teksti;*	**Teknika dhe strategji :** ❖ Diskutim me tema paraprakë. ❖ Marrëdhënie pyetje-përgjigje ❖ Punë individuale/çifte
Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, modele shkronjash individuale e kolektive, grafiku i shkronjës **Xh, xh** të shtypit.	**Lidhja me fushat e tjera:** Edukim për shoqërinë, Matematikë.

Përshkrimi kontekstual i situatës:

- ***Veprimtari paraprake***

Hapi 1: Mësuesi/ ja shkruan në tabelë titullin dhe disa fjalë kyçe të mësimit.

Xhamaprerësi

Dëshirë e paplotësuar, miliona qiej të vegjël, gjysh, nip.

Lihen nxënësit të mendohen për disa minuta. Këshillohen që nëse e kanë lexuar më parë tregimin, të mos përsëritin përmbajtjen e tij.

Dëgjohen modelet që kanë përgatitur nxënësit. Vlerësohen për fantazinë e përdorur, ndërtimin e saktë të fjalive, strukturën e tekstit.

Hapen librat. Nxit nxënësit të përshkruajnë figurën.

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 2: Mësuesi/ja bën prezantimin e tregimit dhe lexon tekstin me intonacion.

Krahasohen krijimet e nxënësve me tregimin e librit. Nxitet diskutimi midis nxënësve.

Shpjegon fjalët e reja: *diamant, copëza, miliona qiej, kurorë, të panumërta.*

Hapi 3: Më pas lihen nxënësit të lexojnë në heshtje për disa minuta tregimin. Në varësi të numrit të nxënësve në klasë mësuesja bën leximin e tregimit në zinxhir me nga një ose më shumë fjali.

Mund të kërkohet nga nxënësit edhe të lexojnë fjalinë e parë, të dytë e kështu me radhë ose me rend të

ngatërruar.

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 4: Diskutim rreth përmbajtjes.

- *Si e ka titullin tregimi?*
- *Si quhen personazhet?*
- *Çfarë profesioni kishte gjyshi Xhemë?*
- *Cila qe dëshira e tij e paplotësuar?*
- *Si e kishte ndarë qiellin nipi i tij?*
- *Çfarë mësoni nga tregimi?*
- *Po ju çfarë profesioni pëlqeni? Pse?*
- *Cila është dëshira juaj e paplotësuar?*

Hapi 5: Nxënësit në mënyrë individuale gjejnë përgjigjen e saktë për dy pyetjet që janë në libër. Diskutojnë në dyshe më shokun e bankës ose në grup për përgjigjet e dhëna.

- Çfarë profesioni kishte gjyshi Xhemë?
- *Gjyshi Xhemë ishte xhamaprerës?*
- *Si quhet guri që pret xhamat?*
- Guri që pret xhamat quhet diamant.
- *Çfarë i mësoi nipi gjyshit?*
- Nipi i mësoi se si mund të realizonte dëshirën e tij.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Lexon fjali, tekst.
- ✓ Pyet, përgjigjet, shpreh mendimet, ndjenjat dhe emocionet e tij, si dhe diskuton në grupe të vogla për tema që i interesojnë
- ✓ Tregon që e ka kuptuar tekstin e lexuar: *duke ritreguar shkurtimisht dhe me fjalë të thjeshta brendinë; duke përmendur çështjet kryesore; duke dhënë shembuj ose ilustrime nga teksti.*

Detyrë shtëpie:

1. Kopjo 4 fjali që të pëlqejnë më shumë nga teksti.
2. Përgjigju me shkrim 3 pyetjeve në fq. 95.

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1	**Klasa:** 1
Tema mësimore: Ushtrime aplikative për shkrim dore, shkronja **Xh, xh.**		**Situata e të nxënit:** Profesionet	

***Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe**

Nxënësi:

- ***(3)Kompetenca e të nxënit:*** Mbikëqyr në mënyrë të pavarur përparimin e vet në një detyrë duke përdorur detyra të ndryshme. Korrigjon gabimet.
- ***(3)Kompetenca e të nxënit:*** Grumbullon dhe klasifikon materialet e performancës së vet, për përgatitjen apo pasurimin e portofolit personal.
- ***(6)Kompetenca qytetare:*** Bashkëpunon në grup dhe respekton rregullat e grupit.

***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore**

Nxënësi:

- Shkruan shkronjat **Xh, xh** të dorës duke u ndihmuar nga modeli.
- Shkruan shkronjat **Xh, xh** me të gjitha elementet duke e lidhur me shkronjat e tjera.
- Shkruan fjalë me të kopjuar ose diktuar duke përdorur shkronjën **Xh, xh** në fillim, në trup të fjalës.
- Respekton hapësirën mes shkronjave, fjalëve dhe fjalive.

Fjalë kyçe:
Shkronjë e madhe, shkronjë e vogël e dorës, Xhup, oxhaku, inxhinier, xhep, gonxhe, etj.

Teknika dhe strategji:

- Lojë me etiketa
- Demonstrim
- Punë individuale
- Punë në çifte/punë në dyshe
- Lexim individual

Burimet e informacionit dhe mjete: Fletore e punës, fletore shkrimi , modele shkronjash individuale e kolektive, grafiku i shkronjës **Xh, xh** të shtypit dhe të dorës, etiketa me fjalë që përmbajnë shkronjën **Xh.**

Lidhja me fushat e tjera: Arte

Përshkrimi kontekstual i situatës

- ***Veprimtari paraprake***

Hapi 1. Mësuesi/ja ka përgatitur etiketa me grupe fjalësh të ngatërruara. Nxënësit duhet t'i renditin si duhet fjalitë.

gonxhe	Trëndafili	çeli	një

e	tigri	jetojnë	Luani	xhungël	në

bleu	im	Xhaxhai	një	më	xhaketë

Kjo veprimtari mund të organizohet dhe me grupe me 3-4 nxënës, ku nxënësit e secilit grup shkruajnë fjali. Grupet lexojnë fjalitë e njëri-tjetrit.

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 2. Përsëriten shkronjat **Xh, xh** të shtypit dhe grafiku i tyre.

Shpjegoj grafikun e shkronjës **Xh, xh** të dorës e shoqëruar me lëvizjen në ajër të nxënësve. Shpjegohen

elementet përbërës të saj. Bëhet dallimi me shkronjën **xh** të shtypit, si dhe i **xh** së madhe dhe të vogël të dorës. Bëhet dallimi i shkronjës **Xh, xh** të madhe dhe asaj të vogël të dorës.
Ngre nxënës në tabelë që shkruajnë shkronjën dhe lidhjen e saj me shkronjat e tjera në fjalë.
Hapi 3. Më pas nxënësit punojnë në fletoren e punës sipas modelit. Nxënësit lexojnë fjalët dhe fjalinë që shkruan me shkrim dore. Bëhet kontrolli individual i detyrës.
Fjalitë e etiketave, që krijuan në pjesën e parë të orës, nxënësit i shkruajnë në fletore, por me shkrim dore.

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 4. Diktim me shkronja dore.
xha, xhe,xhi, xhu, xho, xhy
oxhak, xham, panxhar, xhubletë, xhungël, valixhe
Çanta ime ka dy xhepa me zinxhir.
Mua më pëlqen sallata me panxhar.
Xhaxhai i Gencit është inxhinier.
Nxënësit lexojnë fjalët që shkruan me shkronja dore.

Vlerësimi i situatës:
Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- Shkruan shkronjat **Xh, xh** të dorës duke u ndihmuar nga modeli.
- Shkruan shkronjat **Xh, xh** me të gjitha elementet duke e lidhur me shkronjat e tjera.
- Shkruan fjalë me të kopjuar ose diktuar duke përdorur shkronjën **Xh, xh** në fillim, në trup të fjalës
- Respekton hapësirën mes shkronjave, fjalëve dhe fjalive.

Detyrë shtëpie:

1. Shkruaj nga 3 rreshta me shkronja/rrokje/fjalë ose fjali me shkronjën **xh.**

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1	**Klasa:** 1
Tema mësimore: Punim i faqes **94 - 95** të Abetares. ***Xhamaprerësi***		**Situata e të nxënit:** Profesionet	

***Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe**

Nxënësi:

- ***(1)Kompetenca e komunikim dhe të shprehurit :*** Shpreh mesazhin e një teksti të thjeshtë, nëpërmjet njërës nga format shprehëse: të folurit, shkrimit.
- ***(3)Kompetenca e të nxënit:*** Parashtron pyetje dhe përgjigjet në pyetjet për temën në njërën nga format e të shprehurit.
- ***(3(Kompetenca e të nxënit:*** Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes
- ***(6)Kompetenca qytetare:*** Diskuton dhe bashkëpunon me anëtarët e grupit.

***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore**

Nxënësi:

- Pyet, përgjigjet, shpreh mendimet, ndjenjat dhe emocionet e tij, si dhe diskuton në grupe të vogla për tema që i interesojnë
- Tregon që e ka kuptuar tekstin e lexuar: *duke ritreguar shkurtimisht dhe me fjalë të thjeshta brendinë; duke përmendur çështjet kryesore; duke dhënë shembuj ose ilustrime nga teksti*
- Dallon përdorimin e shkronjës **xh** dhe **gj** në fjalë të ndryshme
- Rendit si duhet fjalët në fjali.

Fjalë kyçe:

Xhamaprerës, oxhak, xhinse, xhama, etj.

Teknika dhe strategji:

- Diskutim paraprak
- Punë individuale
- Lexim fjalësh, fjalish
- Analizë – sintezë
- Punë në dyshe/grup

Burimet e informacionit dhe mjete:

Libri i nxënësit, modele shkronjash individuale dhe kolektive, grafiku i shkronjës **Xh, xh** të shtypit, të dorës.

Lidhja me fushat e tjera:

Lënda: Matematikë, arte

Përshkrimi kontekstual i situatës

- ***Veprimtari praktike***

Hapi 1. Diskutim paraprak rreth përmbajtjes së tregimit.

- *Si e ka titullin tregimi?*
- *Si quhen personazhet?*
- *Çfarë profesioni kishte gjyshi Xhemë?*
- *Cila qe dëshira e tij e paplotësuar?*
- *Si e kishte ndarë qiellin nipi i tij?*
- *Çfarë mësoni nga tregimi?*

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 2. Klasa ndahet në disa grupe.

Grupi 1: Ritregojnë përmbajtjen e pjesës duke u ndihmuar nga pyetjet.

Grupi 2: Ritregojnë përmbajtjen me fjalët e tyre.

Grupi 3: Lexojnë/interpretojnë pjesën në role.
Grupi 4: Jep mendime për prezantimet e shokëve, duke argumentuar përgjigjen.
Hapi 3. Lihen të punojnë individualisht për ushtrimet e fundit të faqes **95**.
Mësuesi/ja bën edhe një herë dallimin midis shkronjës **xh** dhe shkronjës **gj** dhe nxit nxënësit të japin shembuj të përdorimit të këtyre shkronjave.
Më pas plotësojnë individualisht shkronjën e duhur në fjalët: *oxhak, gjirafë, gjethe.*
Në ushtrimin tjetër nxënësit duhet renditin si duhet fjalët në fjali duke dhënë mendimin e tij.
Xhuxhat i kam xhan.
Xhinset i pëlqej.
Fjalia e shkruar me shkronja të mëdha të shtypit duhet të ndahet në fjalë dhe të rishkruhet me shkronjat e vogla dhe të mëdha të shtypit.
Xhamaprerësi pret xhama.
Kontrollojnë punët e njëri-tjetrit.

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 4.
Detyrë me individuale me shkrim
Grupi 1: Përgjigju me shkrim pyetjeve rreth përmbajtjes.
Grupi 2: Shkruaj disa fjali rreth përmbajtjes së tekstit.
Nëse nuk mjafton koha për detyrën, përfundon në shtëpi.

Vlerësimi i situatës:
Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Pyet, përgjigjet, shpreh mendimet, ndjenjat dhe emocionet e tij, si dhe diskuton në grupe të vogla për tema që i interesojnë.
- ✓ Tregon që e ka kuptuar tekstin e lexuar: *duke ritreguar shkurtimisht dhe me fjalë të thjeshta brendinë; duke përmendur çështjet kryesore; duke dhënë shembuj ose ilustrime nga teksti.*
- ✓ Dallon përdorimin e shkronjës **xh** dhe **gj** në fjalë të ndryshme.
- ✓ Rendit si duhet fjalët në fjali.

Detyrë shtëpie:

1. Shkruaj emrat e 10 profesioneve që njeh.
2. Formo fjali me fjalët: xhungël, xhubletë, xhaxha, valixhe.

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1	**Klasa:** 1
Tema mësimore: Punim i shkronjës **Zh, zh** faqe **96** të Abetares		**Situata e të nxënit:** Të mbrojmë natyrën	

***Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe**

Nxënësi:

- ***(1)Kompetenca e komunikim dhe të shprehurit:*** Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar.
- ***(3)Kompetenca e të nxënit :*** Parashtron pyetje dhe përgjigje në lidhje me temën.
- ***(4)Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin:*** Gjen të përbashkëtat dhe ndryshimet ndërmjet aktiviteteve që bën në shkollë me ato në shtëpi.

***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore**

Nxënësi:

- Shqipton tingullin **Zh**
- Gjen dhe thotë fjalë që fillojnë me **Zh** ose që përmbajnë shkronjën **Zh** në trup të tyre.
- Lexon fjali, tekst për të kuptuar përmbajtjen.
- Pyet, përgjigjet, shpreh mendimet, ndjenjat dhe emocionet e tij, si dhe diskuton në grupe të vogla për tema që i interesojnë.

Fjalë kyçe:

Zhurma, natyrë, mbrojtje e natyrës,

Teknika dhe strategji:

- Diskutim paraprak
- Marrëdhënie pyetje-përgjigje
- Vëzhgim
- Demonstrim
- Punë individuale/Çift

Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, modele shkronjash individuale, grafiku i shkronjës **Zh, zh** të shtypit, foto të ndryshme të ndotjes së natyrës.

Lidhja me fushat e tjera: Lënda: Matematikë, Arte, Edukim mjedisor, Dituri natyre

Përshkrimi kontekstual i situatës:

- ***Veprimtari paraprake:***

Hapi 1. Mësuesi/ja shfrytëzon njohuritë e nxënësve në dituri natyre dhe edukim mjedisor për rrezikun e planetit tonë nga ndotja.

- *Pse themi që planeti është në rrezik?*
- *Çfarë e rrezikon planetin tonë?*
- *Nga cilat ndotje është i rrezikuar planeti ynë?*
- *Cilët e kanë shkaktuar këtë?*
- *Jepni disa shembuj?*

Hapi 2. Mësuesi/ja shkruan në tabelë fjalën **" Zhurmat e pyllit"**. Nxit fantazinë e nxënësve.

- Pse mund të ketë zhurma në pyll?
- Për çfarë mund të jenë të shqetësuara kafshët?
- Çfarë mund të diskutojnë.

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 3. Njihen nxënësit me tingullin dhe shkronjën **Zh, zh.**

Demonstron para klasës grafikun e shkronjës së vogël dhe të madhe të shtypit. Tregon se është e përbërë nga dy shkronja **Z** dhe **H**.

Nxit nxënësit të bëjnë ngjashmëritë dhe dallimet me shkronjat e tjera dhe objekte të tjera rrethanore.

Nxiten nxënësit të gjejnë fjalë që fillojnë me **Zh**, e kanë në trup ose mbarojnë me **zh**.

Bëhet dallimi midis **Xh** dhe **Zh**

zh	zh	zh
Zhurmë	vazhdon	plazh .....

Hapi 4. Mësuesi thekson se kjo është shkronja e fundit e alfabetit. Bëhet përsëritje e shkronjave të alfabetit duke dalluar zanoret dhe bashkëtingëlloret.

Hapi 5. Mësuesi/ja lexon përrallën. Nxit nxënësit të ndjekin leximin.

Shpjegon fjalët e reja:

Kuvend, i mungon bukuria, zhyti në këtë gjendje.

Shpjegon se pse janë përdorur me shkronjë të madhe fjalët Dielli, Toka, Uji.

Disa nxënës bëjnë leximin e përrallës.

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 6.

Diskutim rreth përmbajtjes së përrallës:

- *Si e ka titullin përralla?*
- *Cilët janë personazhet?*
- *Pse janë të shqetësuar ata?*
- *Çfarë ndihme do të jepte dielli?*
- *Po Toka dhe Uji?*
- *Çfarë ndihme do të jepnin Zamira dhe Xhoi?*

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Shqipton tingullin **Zh**
- ✓ Gjen dhe thotë fjalë që fillojnë me **Zh** ose që përmbajnë shkronjën **Zh** në trup të tyre.
- ✓ Lexon fjali, tekst për të kuptuar përmbajtjen.
- ✓ Pyet, përgjigjet, shpreh mendimet, ndjenjat dhe emocionet e tij, si dhe diskuton në grupe të vogla për tema që i interesojnë.

Detyrë shtëpie:

1. Shkruaj 10 fjalë që përmbajnë shkronjën **zh.**
2. Përgjigju me disa fjali:
   - *Çfarë ndihme do të jepnin Zamira dhe Xhoi?*

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1	**Klasa:** 1
Tema mësimore: Punim e shkrim i shkronjës **Zh, zh**, Abetare pune faqe **61.**		**Situata e të nxënit:** Të mbrojmë natyrën	

***Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe**

Nxënësi:

- ***(3)Kompetenca e të nxënit:*** Ndjek udhëzimet e dhëna për të realizuar një veprim.
- ***(4) Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin:*** Identifikon burimet e nevojshme dhe i përdor në mënyrë të drejtë.
- ***(5)Kompetenca personale:*** Bashkëpunon me të tjerët pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitetet në klasë, shkollë apo jashtë saj.

***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore**

Nxënësi:

- Shkruan shkronjës **Zh, zh** të shtypit sipas modelit.
- Shkruan rrokje, fjalë, fjali.
- Plotëson fali mungesore.
- Shkruan fjalë me kuptim të kundërt, duke përdorur shkronjën **Zh.**
- Shkruan zanoret dhe bashkëtingëlloret.

Fjalë kyçe:
Gozhdë, lëvozhgë, zhapik, abazhur.

Teknika dhe strategji:

- Lojë me etiketa/punë me grupe
- Diskutim
- Punë individuale
- Analizë – sintezë fjalësh, fjalish.
- Punë në çifte

Burimet e informacionit dhe mjete: Shkronjat individuale dhe kolektive, fletore pune, etiketa me vargjet e vjershës për **Zh.**

Lidhja me fushat e tjera:
Dituri natyre, arte

Përshkrimi kontekstual i situatës

- ***Veprimet paraprake***

Hapi 1. Mësuesi/ja ka përgatitur etiketa me vargjet e vjershës për shkronjën Zh. Nxënësit pasi e dëgjojnë 2 herë nga mësuesja, duhet t'i renditin vargjet sipas radhës.

Zh-ja jam e zhurma dua

Por tani e heshtur rri

Abetarja mbaron me mua

Fund !S'ka mësim të ri

Unë e fundit ju përcjell

Lexohet disa herë vjersha nga nxënësit.

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 2. Nxënësit emërtojnë dhe komentojnë figurat. I përgjigjen pyetjeve:

- *Çfarë është?*

- *Për çfarë shërben?*
- *Çfarë del nga lëvozhga?*
- *Ku jeton zhapiku?*

Nxënësit lexojnë fjalët dhe plotësojnë shkronjën **zh** që mungon.
Gozhda, lëvozhgë, zhapik.

Hapi 3. Punohet sipas kërkesave në fletoren e punës. Modelohet shkronja **Zh, zh**.

- Nxënësit plotësojnë pyetjet:

Materiali që behët beton? *Zhavorr*
Vendi ku shkojmë të pushojmë në verë? *Plazh*
Sendi me të cilin mbërthejmë dërrasat? *Gozhdë*
Kafsha së cilës i fillon emri me zh? *Zhapik*

- Gjejnë fjalët me kuptim të kundërt:

Duket --- zhduket
Vesh --- zhvesh
Vlerësoj – zhvlerësoj
Dëmtoj --- zhdëmtoj

- Plotësojnë fjalitë sipas foljeve të dhëna.

Unë zhytem në det.
Unë zhgaravis muret e klasës.
Unë zhvishem shpejt.
Unë vazhdoj të shkruaj bukur.

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 4. Plotësojnë zanoret dhe bashkëtingëlloret. Përsëriten në korr disa herë.
Nxit nxënësit të diskutojnë me njëri tjetrin dhe të korrigjojnë fletoret e njëri-tjetrit.
Nxënësit lexojnë fjalët dhe fjalitë që krijuan gjatë ushtrimeve në fletoren e punës.
Bëhen konkluzionet e orës.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Shkruan shkronjës **Zh, zh** të shtypit sipas modelit.
- ✓ Shkruan rrokje, fjalë, fjali.
- ✓ Plotëson fali mungesore.
- ✓ Shkruan fjalë me kuptim të kundërt, duke përdorur shkronjën **Zh**.
- ✓ Shkruan zanoret dhe bashkëtingëlloret.

Detyrë shtëpie:

1. Formo fjali me fjalët: *gozhdë, lëvozhgë, zhapik*
2. Kopjo bukur në fletore fjalitë që formove.
3. Shkruaj zanoret dhe bashkëtingëlloret.
4. Mëso përmendësh alfabetin e gjuhës shqipe.

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1	**Klasa:** 1
Tema mësimore: Punim e lexim i shkronjës **Zh, zh** faqe **97** të Abetares		**Situata e të nxënit:** Të mbrojmë natyrën	

***Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe**

Nxënësi:

- ***(1)Kompetenca e komunikim dhe të shprehurit:*** Lexon me zë një tekst së paku prej gjysmë faqeje të pa lexuar më parë.
- ***(3) Kompetenca e të nxënit:*** Parashtron pyetje dhe përgjigjet në pyetjet për temën /problemin/ detyrën e dhënë në njërën nga format e të shprehurit.
- ***(6)Kompetenca qytetare:*** Shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive, vendos duke bashkëpunuar me të gjithë anëtarët për mënyrat që çojnë drejt përfundimit të një aktiviteti të caktuar.

***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore**

Nxënësi:

- Shqipton saktë dhe me intonacionin e theksin e duhur fjalët dhe fjalitë.
- Pyet, përgjigjet, shpreh mendimet, ndjenjat dhe emocionet e tij, si dhe diskuton në grupe të vogla për tema që i interesojnë.
- Rilexon tekstin për ta kuptuar më mirë atë (kur është e nevojshme).

Fjalë kyçe: *Vjershë, shkronjë, strofa.*

Teknika dhe strategji:

- Kënga e alfabetit
- Lojë me etiketa .
- Marrëdhënie pyetje-përgjigje
- Punë në grupe

Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, modele shkronjash individuale e kolektive,grafiku i shkronjës **Zh, zh** të shtypit, etiketa me vargjet e vjershës.

Lidhja me fushat e tjera: Muzikë , Matematikë.

Përshkrimi kontekstual i situatës:

- ***Veprimtari paraprake***

Hapi 1: Nxënësit dëgjojnë këngën e alfabetit dhe këndojnë këngën në korr duke e shoqëruar me lëvizje trupore.

Bëhet përsëritja e alfabetit.

- *Si ndiheni tani që mbaruam të gjitha shkronjat?*
- *Ju duket vetja se keni mësuar shumë?*

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 2: Mësuesi/ja bën prezantimin e vjershës dhe e lexon atë me intonacion. Kujton që vjershat shkruhen me strofa dhe kanë rimë.

Shpjegon fjalët dhe shprehjet e reja:

Më bëhej zemra mal, pulëbardhat nëpër valë, na priftë e mbara.

Bëhet leximi në korr i vjershës.

Bëhet komenti i figurës. Diskutohet për pamjen e natyrës.

- *Si është natyra?*

- *Si është qielli?*
- *Si ndihen fëmijët?*

Hapi 3: Më pas lihen nxënësit të lexojnë në heshtje për disa minuta vjershën. Bëhet leximi në zinxhir i saj sipas strofave. Mund të kërkohet nga nxënësit edhe të lexojnë strofën e parë, të dytë e kështu me radhë ose me rend të ngatërruar.

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 4: Diskutim rreth përmbajtjes.

- *Si e ka titullin tregimi?*
- *Pse mund të ishte mërzitur Zh?*
- *Pse ishte e gëzuar ajo?*
- *Si i uron fëmijët shkronja Zh?*

Hapi 6: Mësuesi/ ja ka përgatitur etiketa me strofa të vjershës, ia jep nxënësve të ngatërruara dhe duhet t'i renditin si duhet pa i parë në libër.

Bëhet leximi i vjershës ose recitimi i saj nëse nxënësit arrijnë ta mësojnë përmendësh që në klasë.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Shqipton saktë dhe me intonacionin e theksin e duhur fjalët dhe fjalitë.
- ✓ Pyet, përgjigjet, shpreh mendimet, ndjenjat dhe emocionet e tij, si dhe diskuton në grupe të vogla për tema që i interesojnë.
- ✓ Rilexon tekstin për ta kuptuar më mirë atë (kur është e nevojshme).

Detyrë shtëpie:

1. Mëso vjershën përmendësh.
2. Kopjo bukur në fletore?
3. Shkruaj me disa fjali se si e ndjen veten që ke mbaruar të gjitha shkronjat e alfabetit.

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1	**Klasa:** 1
Tema mësimore: Ushtrime aplikative për shkrim dore, shkronja **Zh, zh**.		**Situata e të nxënit:** Të mbrojmë natyrën	

***Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe**

Nxënësi:

- ***(3)Kompetenca e të nxënit:*** Mbikëqyr në mënyrë të pavarur përparimin e vet në një detyrë duke përdorur detyra të ndryshme. Korrigjon gabimet.
- ***(3)Kompetenca e të nxënit:*** Grumbullon dhe klasifikon materialet e performancës së vet, për përgatitjen apo pasurimin e portofolit personal.
- ***(6)Kompetenca qytetare:*** Bashkëpunon në grup dhe respekton rregullat e grupit.

***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore**

Nxënësi:

- Shkruan shkronjat **Zh, zh** të dorës duke u ndihmuar nga modeli.
- Shkruan shkronjat **Zh, zh** me të gjitha elementet duke e lidhur me shkronjat e tjera.
- Shkruan fjalë me të kopjuar ose diktuar duke përdorur shkronjën **Zh, zh** në fillim, në trup të fjalës.
- Respekton hapësirën mes shkronjave, fjalëve dhe fjalive.

Fjalë kyçe:

Shkronjë e madhe, shkronjë e vogël e dorës, Zhapik, zhytem, zhurmë, zhavorr.

Teknika dhe strategji:

- Lojë me etiketa
- Demonstrim
- Punë individuale
- Punë në çifte/punë në dyshe
- Lexim individual

Burimet e informacionit dhe mjete: Fletore e punës, fletore shkrimi , modele shkronjash individuale e kolektive, grafiku i shkronjës **Zh, zh** të shtypit dhe të dorës, etiketa me fjalë që përmbajnë shkronjën **Zh.**

Lidhja me fushat e tjera: Arte

Përshkrimi kontekstual i situatës

- ***Veprimtari paraprake***

Hapi 1. Mësuesi/ja ka përgatitur etiketa me grupe fjalësh të ngatërruara. Nxënësit duhet t'i renditin si duhet fjalitë.

quhet	Materiali	që	betoni	zhavorr	bëhet

plazh	verë	shkojmë	në	ne	Në

Dërrasat	me	mbërthejmë	i	gozhdë

Kjo veprimtari mund të organizohet dhe me grupe me 3 -4 nxënës, ku nxënësit e secilit grup shkruajnë fjali. Grupet lexojnë fjalitë e njëri-tjetrit.

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 2. Përsëriten shkronjat **Zh, zh,** të shtypit dhe grafiku i tyre.

Shpjegoj grafikun e shkronjës **Zh, zh** të dorës e shoqëruar me lëvizjen në ajër të nxënësve. Shpjegohen elementet përbërës të saj. Bëhet dallimi me shkronjën **zh** të shtypit, si dhe i **zh** së madhe dhe të vogël të

dorës. Bëhet dallimi i shkronjës **Zh, zh** të madhe dhe asaj të vogël të dorës.
Ngre nxënës në tabelë që shkruajnë shkronjën dhe lidhjen e saj me shkronjat e tjera në fjalë.
Hapi 3. Më pas nxënësit punojnë në fletoren e punës sipas modelit. Nxënësit lexojnë fjalët dhe fjalinë që shkruan me shkrim dore. Bëhet kontrolli individual i detyrës.
Fjalitë e etiketave, që krijuan në pjesën e parë të orës, nxënësit i shkruajnë në fletore, por me shkrim dore.

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 4. Diktim me shkronja dore.
zha, zhe, zhi, zhu, zho, zhy
plazh, zhapik, zhytem, zhurmë, zhavorr
Fëmijët zhyteshin në det.
Zogu doli nga lëvozhga.
Në pyll dëgjohet zhurma e gjinkallave.
Nxënësit lexojnë fjalët që shkruan me shkronja dore.

Vlerësimi i situatës:
Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Shkruan shkronjat **Zh, zh** të dorës duke u ndihmuar nga modeli.
- ✓ Shkruan shkronjat **Zh, zh** me të gjitha elementet duke e lidhur me shkronjat e tjera.
- ✓ Shkruan fjalë me të kopjuar ose diktuar duke përdorur shkronjën **Zh, zh** në fillim, në trup të fjalës
- ✓ Respekton hapësirën mes shkronjave, fjalëve dhe fjalive.

Detyrë shtëpie:

1. Shkruaj nga 3 rreshta me shkronja/rrokje/fjalë ose fjali me shkronjën **zh**.

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1	**Klasa:** 1
Tema mësimore: Punim i faqes **96 - 97** të Abetares. ***Zhurma e pyllit.***		**Situata e të nxënit:** Të mbrojmë natyrën	

***Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe**

Nxënësi:

- ***(1)Kompetenca e komunikim dhe të shprehurit:*** Shpreh mesazhin e një teksti të thjeshtë, nëpërmjet njërës nga format shprehëse: të folurit, shkrimit.
- ***(3)Kompetenca e të nxënit:*** Parashtron pyetje dhe përgjigjet në pyetjet për temën në njërën nga format e të shprehurit.
- ***(3(Kompetenca e të nxënit:*** Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes.
- ***(6)Kompetenca qytetare:*** Diskuton dhe bashkëpunon me anëtarët e grupit.

***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore**

Nxënësi:

- Pyet, përgjigjet, shpreh mendimet, ndjenjat dhe emocionet e tij, si dhe diskuton në grupe të vogla për tema që i interesojnë.
- Tregon që e ka kuptuar tekstin e lexuar: *duke ritreguar shkurtimisht dhe me fjalë të thjeshta brendinë; duke përmendur çështjet kryesore; duke dhënë shembuj ose ilustrime nga teksti.*
- Shkruan fjalë me kuptim të kundërt duke përdorur shkronjën **Zh**.
- Reciton vjersha të shkurtra, të mësuara përmendsh.

Fjalë kyçe:

Lëvozhga, plazh, gozhdë, zhapiku. etj.

Teknika dhe strategji:

- Diskutim paraprak
- Punë individuale
- Lexim fjalësh, fjalish
- Analizë – sintezë
- Punë në dyshe/grup

Burimet e informacionit dhe mjete:

Libri i nxënësit, modele shkronjash individuale dhe kolektive, grafiku i shkronjës **Zh, zh** të shtypit, të dorës.

Lidhja me fushat e tjera:

Lënda: Matematikë, arte

Përshkrimi kontekstual i situatës

- ***Veprimtari praktike***

Hapi 1. Diskutim paraprak rreth përmbajtjes së përrallës "Zhurmat e pyllit".

- *Si e ka titullin përralla?*
- *Cilët janë personazhet?*
- *Pse janë të shqetësuar ata?*
- *Çfarë ndihme do të jepte dielli?*
- *Po Toka dhe Uji?*
- *Çfarë ndihme do të jepnin Zamira dhe Xhoi?*
- *Po ju, çfarë ndihme do të jepnit në ndihmë të natyrës?*

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 2. Klasa ndahet në disa grupe.

Grupi 1: Ritregojnë përmbajtjen e pjesës duke u ndihmuar nga pyetjet.

Grupi 2: Ritregojnë përmbajtjen me fjalët e tyre.

Grupi 3: Lexojnë/interpretojnë pjesën në role.
Grupi 4: Jep mendime për prezantimet e shokëve duke argumentuar përgjigjen.
Hapi 3. Lihen të punojnë individualisht për ushtrimet e fundit të faqes **96** dhe fillimin e faqes **97**.
Nxënësit plotësojnë dhe lexojnë fjalët: *plazh, lëvozhgë, gozhdë, zhapiku.*
Shkruajnë fjalët me kuptim të kundërt duke përdorur shkronjën zh
vesh – zhvesh, bëj – zhbëj, duket – zhduket.
Plotësojnë përgjigjen e saktë.
Nxit nxënësit të diskutojnë se si e kuptojnë shprehjen:
Me një pemë shumë shkrepëse,
me një fije shkrepëse,
digjet një pyll i tërë.
Dilet në një përfundim të përbashkët për të bashkëpunuar të gjithë për mbrojtjen e natyrës.

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 4. Konkurs recitimi.
Nxënësit recitojnë vjershën
" Zh, moj zh, a je mërzitur?
Pjesa tjetër e klasës voton për nxënësin ose nxënësen që recitoi më mirë.

Vlerësimi i situatës:
Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- Pyet, përgjigjet, shpreh mendimet, ndjenjat dhe emocionet e tij, si dhe diskuton në grupe të vogla për tema që i interesojnë.
- Tregon që e ka kuptuar tekstin e lexuar: *duke ritreguar shkurtimisht dhe me fjalë të thjeshta brendinë; duke përmendur çështjet kryesore; duke dhënë shembuj ose ilustrime nga teksti*.
- Shkruan fjalë me kuptim të kundërt duke përdorur shkronjën **Zh**.
- Reciton vjersha të shkurtra, të mësuara përmendsh.

Detyrë shtëpie:

1. Shkruaj me disa fjali se si do të veprosh ti për të mbrojtur natyrën.
2. Shkruaj shkurt përmbajtjen e përrallës.
3. Shkruaj bukur alfabetin e gjuhës shqipe.

Refleksione:

<table>
<tr><td>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla: 1</td><td>Klasa: 1</td></tr>
<tr><td colspan="3">Tema mësimore:
Punim i faqes 98 të Abetares</td><td>Situata e të nxënit:
Alfabeti i gjuhës shqipe</td></tr>
<tr><td colspan="4">R.N. sipas kompetencave kyçe:
Nxënësi:
K.1 paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup.
K.3 parashtron pyetje dhe përgjigjet në pyetjet për temën /problemin/detyrën e dhënë në njërën nga format e të shprehurit.
K.3 mbikëqyr në mënyrë të pavarur përparimin e vet në një detyrë, aktivitet duke përdorur teknika të ndryshme për gjetjen e gabimeve (si shënim të gabimeve - vështirësive) dhe i korrigjon ato derisa gjen zgjidhjen.
K.3 grumbullon dhe klasifikon materialet e performancës së vet, për përgatitjen apo pasurimin e portofolit personal.
K.4 identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në shtëpi.
K.5 bashkëpunon me të tjerët pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitetet në klasë, shkollë apo jashtë saj.
K.6 shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive.</td></tr>
<tr><td colspan="3" rowspan="2">R.N. të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:
Nxënësi:
• Shqipton, shkruan dhe lexon tingujt dhe shkronjat e gjuhës shqipe nga A në M.
• Shkruan dhe lexon fjalë me shkronjat e mësuara, të shtypit dhe të dorës.
• Bën dallimin ndërmjet zanoreve dhe bashkëtingëlloreve.</td><td>Fjalë kyçe:
shkronjë, tingull, alfabet,zanore, bashkëtingëllore, shkronja dyshe.</td></tr>
<tr><td>Teknika dhe strategji:
• Lojë
• Punë në grup
• Veprimtari në dyshe
• Punë individuale</td></tr>
<tr><td colspan="3">Burimet e informacionit dhe mjete:
Abetare, shkronja lëvizore, foto, tabelë alfabeti, mjete vizatimi, videoprojektor, CD.</td><td>Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë
Arte
Edukim me të drejtat e fëmijëve</td></tr>
<tr><td colspan="4">Përshkrim kontekstual i situatës:
Veprimtari paraprake
Me videoprojektor shfaqet alfabeti i gjuhës shqipe me shkronja dore. Nxënësit lexojnë korazi shkronjat.
- Sa shkronja ka alfabeti i gjuhës shqipe?
- Sa janë zanore? Sa janë bashkëtingëllore?
- Thoni disa zanore. Thoni disa bashkëtingëllore.
- Thoni disa shkronja dyshe.</td></tr>
</table>

Këndohet kënga e alfabetit të shkronjave.

Veprimet në situatë:
Hapi i parë: Lojë

Mësuesja paraqet disa shkronja lëvizore para nxënësve dhe për çdo shkronjë, nxënësit do të gjejnë fjalë me të: (me gojë)

A ----- akullore, ariu, balona, shkolla, manaferra etj.
B ----- babai, bariu, bleta, banane, bukë etj.
Përsëritet me disa shkronja (e, g, h, k, j).

Hapi i dytë: Punë në grup

Mësuesja lexon një tekst të shkurtër . Nxënësit do të dëgjojnë dhe do të shkruajnë vetëm fjalët që përmbajnë një tingull të caktuar, p.sh. tingullin m.
Fjalët që do të përzgjedhin i shkruajnë në një fletë dhe numërojnë sa kanë gjetur.
Krahasohen gjetjet me grupet e tjera.

Hapi i tretë: Veprimtari në dyshe

Nxënësit do të lexojnë faqen 98 të Abetares në heshtje dhe pastaj me zë të lartë.

Hapi i katërt: Punë individuale

Formojnë fjali me fjalët: flutura, lapsi, molla, balona, dhëmbi në fletoren individuale me shkronja dore.
Lexohen fjalitë e shkruara.
Vizatojnë shkronja të zbukuruara sipas imagjinatës në fletë të bardha.

Demonstrim i rezultateve të arritura:
Lexojnë e shkruajnë shkronjat e alfabetit nga A deri në M.

Vlerësimi i situatës:
Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- Shqipton, shkruan dhe lexon tingujt dhe shkronjat e gjuhës shqipe.
- Shkruan dhe lexon fjalë me shkronjat e mësuara, të shtypit dhe të dorës.
- Bën dallimin ndërmjet zanoreve dhe bashkëtingëlloreve

Detyra: Shkruajnë shkronjat e dorës nga A deri në M.
Shkruajnë fjalë me secilën shkronjë.
Shkruajnë pesë fjali me shkronjat që duan.

Refleksione:

<table>
<tr><td>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla: 1</td><td>Klasa: 1</td></tr>
<tr><td colspan="3">Tema mësimore:
Punim i faqes 99 të Abetares</td><td>Situata e të nxënit:
Alfabeti i gjuhës shqipe</td></tr>
<tr><td colspan="4">R.N. sipas kompetencave kyçe:
Nxënësi:
K.1 paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup.
K.3 mbikëqyr në mënyrë të pavarur përparimin e vet në një detyrë, aktivitet duke përdorur teknika të ndryshme për gjetjen e gabimeve (si shënim të gabimeve - vështirësive) dhe i korrigjon ato derisa gjen zgjidhjen.
K.3 grumbullon dhe klasifikon materialet e performancës së vet, për përgatitjen apo pasurimin e portofolit personal.
K.4 identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në shtëpi.
K.5 bashkëpunon me të tjerët pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitetet në klasë, shkollë apo jashtë saj.
K.6 shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive.</td></tr>
<tr><td colspan="3" rowspan="2">R.N. të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:
Nxënësi:
• Shqipton, shkruan dhe lexon tingujt dhe shkronjat e gjuhës shqipe nga N deri në Zh.
• Shkruan dhe lexon fjalë me shkronjat e mësuara, të shtypit dhe të dorës.
• Bën dallimin ndërmjet zanoreve dhe bashkëtingëlloreve.</td><td>Fjalë kyçe:
shkronjë, tingull, alfabet, zanore, bashkëtingëllore, shkronja dyshe.</td></tr>
<tr><td>Teknika dhe strategji:
• Lojë
• Punë në grup
• Veprimtari në dyshe
• Punë individuale</td></tr>
<tr><td colspan="3">Burimet e informacionit dhe mjete:
Abetare, shkronja lëvizore, foto, tabelë alfabeti, mjete vizatimi</td><td>Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë
Arte
Edukim me të drejtat e fëmijëve</td></tr>
<tr><td colspan="4">Përshkrim kontekstual i situatës:
Veprimtari paraprake
Lojë:
Një nxënës çohet para klasës dhe lëviz dorën në ajër duke shkruar shkronjën P të shtypit ose të dorës.
Nxënësit e tjerë do të gjejnë cila shkronjë është.
Përsëritet loja me shkronja të tjera duke aktivizuar nxënës të ndryshëm.
Shkronjën e gjetur e shkruajnë në shtyllën përkatëse në tabelë:</td></tr>
</table>

Zanore	Bashkëtingëllore

Veprimet në situatë:
Hapi i parë: Punë në grupe

Mësuesja i jep çdo grupi shkronjën T. Nxënësit për 3' do të shkruajnë disa fjalë me të.
Krahasohen gjetjet me grupet e tjera.
Përsëritet veprimtaria me shkronja të tjera nga faqja 99.

Hapi i dytë: Punë në grup

Mësuesja lexon një tekst të shkurtër. Nxënësit do të dëgjojnë dhe do të shkruajnë vetëm fjalët që përmbajnë një tingull të caktuar, p.sh. tingullin v.
Fjalët që do të përzgjedhin i shkruajnë në një fletë dhe numërojnë sa kanë gjetur.
Krahasohen gjetjet me grupet e tjera.

Hapi i tretë: Veprimtari në dyshe

Nxënësit do të lexojnë faqen 99 të Abetares në heshtje dhe pastaj me zë të lartë.

Hapi i katërt: Punë individuale

Formojnë fjali me fjalët: qershia, rrushi, ylberi, zemra në fletoren individuale me shkronja dore.
Lexohen fjalitë e shkruara.
Vizatojnë shkronja të zbukuruara sipas imagjinatës në fletë të bardha.

Demonstrim i rezultateve të arritura:
Lexojnë e shkruajnë shkronjat e alfabetit nga N deri në Zh.

Vlerësimi i situatës:
Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- Shqipton, shkruan dhe lexon tingujt dhe shkronjat e gjuhës shqipe nga N deri në Zh.
- Shkruan dhe lexon fjalë me shkronjat e mësuara, të shtypit dhe të dorës.
- Bën dallimin ndërmjet zanoreve dhe bashkëtingëlloreve

Detyra:

1. Shkruajnë shkronjat e dorës nga N deri në Zh.
2. Shkruajnë fjalë me secilën shkronjë.
3. Shkruajnë pesë fjali me shkronjat që duan.

Refleksione:

<table>
<tr><td>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla: 1</td><td>Klasa: 1</td></tr>
<tr><td colspan="3">Tema mësimore:
Punim i faqes 98-99 të Abetares</td><td>Situata e të nxënit:
Alfabeti i gjuhës shqipe</td></tr>
<tr><td colspan="4">R.N. sipas kompetencave kyçe:
Nxënësi:
K.1 paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup.
K.3 mbikëqyr në mënyrë të pavarur përparimin e vet në një detyrë, aktivitet duke përdorur teknika të ndryshme për gjetjen e gabimeve (si shënim të gabimeve - vështirësive) dhe i korrigjon ato derisa gjen zgjidhjen.
K.3 grumbullon dhe klasifikon materialet e performancës së vet, për përgatitjen apo pasurimin e portofolit personal.
K.4 identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në shtëpi.
K.5 bashkëpunon me të tjerët pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitetet në klasë, shkollë apo jashtë saj.
K.6 diskuton dhe në bashkëpunim me anëtarët e grupit vendos rregullat e punës në grup.</td></tr>
<tr><td colspan="3" rowspan="2">R.N. të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:
Nxënësi:
• Shqipton, shkruan dhe lexon tingujt dhe shkronjat e gjuhës shqipe nga A deri në Zh.
• Shkruan dhe lexon fjalë me shkronjat e mësuara, të shtypit dhe të dorës.
• Bën dallimin ndërmjet zanoreve dhe bashkëtingëlloreve.</td><td>Fjalë kyçe:
shkronjë, tingull, alfabet,zanore, bashkëtingëllore, shkronja dyshe.</td></tr>
<tr><td>Teknika dhe strategji:
• Lojë
• Punë në grup
• Veprimtari në dyshe
• Punë individuale</td></tr>
<tr><td colspan="3">Burimet e informacionit dhe mjete:
Abetare, shkronja lëvizore, foto, tabelë alfabeti, mjete vizatimi, fletë të palosura në formë fizarmonike.</td><td>Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë
Arte
Edukim me të drejtat e fëmijëve</td></tr>
<tr><td colspan="4">Përshkrim kontekstual i situatës:
Veprimtari paraprake

Në çdo tavolinë mësuesja shpërndan fletë të palosura në formë fizarmonike. Në çdo palosje mësuesja ka shkruar një shkronjë. Nxënësit do të shkruajnë fjalën e parë që u vjen në mend me këtë shkronjë. Prezantohen fjalët e shkruara nga nxënësit.</td></tr>
</table>

Veprimet në situatë:
Hapi i parë: Punë në grup

Në çdo tavolinë mësuesja shpërndan nga një fletë të ndarë në kutiza (6 x 6).
Në çdo kutizë është shkruar nga një shkronjë sipas rendit alfabetik.
Për secilën shkronjë nxënësit shkruajnë nga një fjalë që fillon me këtë shkronjë.
Prezantim i punës nga nxënësit.

Hapi i dytë: Punë në grup

Nxënësit modelojnë shkronjat e alfabetit duke përdorur mjete të ndryshme dhe i renditin sipas rendit alfabetik në një format kartoni.

Hapi i katërt: Punë individuale

Shkruajnë shkronjat e alfabetit.
Vizatojnë shkronja të zbukuruara sipas imagjinatës në fletë të bardha.

Demonstrim i rezultateve të arritura:
Lexojnë e shkruajnë shkronjat e alfabetit nga A deri në Zh.

Vlerësimi i situatës:
Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- Shqipton, shkruan dhe lexon tingujt dhe shkronjat e gjuhës shqipe nga A deri në Zh.
- Shkruan dhe lexon fjalë me shkronjat e mësuara, të shtypit dhe të dorës.
- Bën dallimin ndërmjet zanoreve dhe bashkëtingëlloreve.

Detyra:

1. Shkruajnë shkronjat e dorës nga A deri në Zh.
2. Shkruajnë pesë fjali me shkronjat që duan.

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 1	Klasa: 1
Tema mësimore Veprimtari shkrimi (diktim)		Situata e të nxënit Alfabeti i gjuhës shqipe	
R.N. sipas kompetencave kyçe: Nxënësi: K.3 ndjek udhëzimet e dhëna për të realizuar një detyrë që i kërkohet. K.3 mbikëqyr në mënyrë të pavarur përparimin e vet në një detyrë duke përdorur teknika të ndryshme për gjetjen e gabimeve dhe i korrigjon ato, derisa gjen zgjidhjen. K.3 grumbullon dhe klasifikon materialet e performancës së vet, për përgatitjen apo pasurimin e portofolit personal.			
R.N. të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: • Modelon bukur grafikët e shkronjave të mëdha dhe të vogla të dorës. • Shkruan fjalë dhe fjali me shkronjat e dorës me të diktuar. • Ruan hapësirat midis fjalëve. • Përdor shkronjën e madhe në fillim të fjalisë dhe pikën në fund të saj.		Fjalë kyçe: shkronjë, fjalë, rrokje, fjali Strategji dhe teknika: • Stuhi mendimi • Veprimtari në dyshe • Punë individuale	
Burimet e informacionit dhe mjete: Shkronjat e dorës, fletore shkrimi, mjete vizatimi, tabelë alfabeti.		Lidhja me fushat e tjera: Matematikë Arte Edukim me të drejtat e fëmijëve	
Përshkrimi kontekstual i situatës: *Veprimtari paraprake* Mësuesja u jep nxënësve nga një shkronjë të shtypit. Nxënësit vizatojnë shkronjat përkatëse të dorës të mëdha (të zbukuruara). Shkronjat e vizatuara ngjiten në një karton të titulluar *Alfabeti i gjuhës shqipe.* Lexohet korazi nga nxënësit. Këndohet kënga e alfabetit.			

Veprimet në situatë:

Hapi i parë: Punë në grupe

Mësuesja ka përgatitur disa shporta të vogla dhe i shpërndan nëpër tavolina. Nxënësit i ngjitin dhe mbi to shkruajnë secili nga një fjalë me shkrim dore. Shportat e fjalëve vendosen në një kënd të klasës.

Hapi i dytë: Veprimtari në dyshe

Mësuesja u shpërndan nxënësve etiketa me fjali të shkruara me shkrim dore të cilave u mungojnë fjalë. Nxënësit, duke punuar në dyshe, do të plotësojnë fjalitë me fjalët e duhura.

Gjuha shqipe ka _____.
Zanoret e gjuhës shqipe janë _____.
Ne mësuam _____.
Tani dimë _____.

Hapi i tretë: Punë individuale

Nxënësit shkruajnë në fletoren individuale me të diktuar tekstin:

Pranvera sapo kishte ardhur. Bleta e vogël u zgjua nga gjumi i dimrit. U nis të gjente ushqim. Shkoi te pema e qershisë. Ajo nuk i kishte çelur akoma lulet e saj. Shkoi te pema e mollës. As molla nuk kishte çelur lule për të. Aty pranë ndjeu një aromë të këndshme. Bleta e vogël u afrua. Ishte manushaqja. Ajo i kishte çelur petalet e para.

Demonstrim i rezultateve të arritura:

Shkrim i fjalive me shkrim dore me të diktuar.

Vlerësimi i situatës:
Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- Modelon bukur grafikët e shkronjave të mëdha dhe të vogla të dorës.
- Shkruan fjalë dhe fjali me shkronjat e dorës me të diktuar.
- Ruan hapësirat midis fjalëve.
- Përdor shkronjën e madhe në fillim të fjalisë dhe pikën në fund të saj.

Detyra:

1. Shkruajnë një tekst të shkurtër.

Refleksione:

<table>
<tr><td>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla: 1</td><td>Klasa: 1</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore
Test</td><td colspan="2">Situata e të nxënit
Unë tani di</td></tr>
<tr><td colspan="4">R.N. sipas kompetencave kyçe:
Nxënësi:
K.3 ndjek udhëzimet e dhëna për të realizuar një detyrë që i kërkohet.
K.3 mbikëqyr në mënyrë të pavarur përparimin e vet në një detyrë, duke përdorur teknika të ndryshme për gjetjen e gabimeve dhe i korrigjon ato derisa gjen zgjidhjen.
K.3 grumbullon dhe klasifikon materialet e performancës së vet, për përgatitjen apo pasurimin e portofolit personal.</td></tr>
<tr><td colspan="2" rowspan="2">R.N. të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:
Nxënësi:
• Dallon dhe shkruan shkronjat e gjuhës shqipe, të shtypit dhe të dorës.
• Respekton hapësirën mes shkronjave, fjalëve.
• Plotëson pjesët që u mungojnë fjalëve ose fjalive.
• Shkruan fjalë me tri-katër rrokje.
• Shkruajnë fjalë dhe fjali me të diktuar.
• U përgjigjet me shkrim pyetjeve të thjeshta.</td><td colspan="2">Fjalë kyçe:
shkronjë, fjalë, rrokje, fjali</td></tr>
<tr><td colspan="2">Strategji dhe teknika:
• Punë individuale
• Diskutim</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet e informacionit dhe mjete:
fletë testi, njohuritë paraprake të nxënësve.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë
Arte
Edukim me të drejtat e fëmijëve</td></tr>
<tr><td colspan="4">Përshkrimi kontekstual i situatës:
Veprimtari paraprake
Mësuesja i njeh nxënësit me temën dhe rezultatet e pritshme.
U jep udhëzime për kujdesin që duhet të tregojnë gjatë punës.</td></tr>
</table>

Veprimet në situatë:

Hapi i parë: Punë individuale

Mësuesja u shpërndan nxënësve fletët e testit.
Nxënësit punojnë të pavarur.
Disa nga detyrat në test mund të jenë:

- Lidh rrokjet për të formuar fjalë.
- Qarko fjalën e shkruar saktë.
- Plotëso fjalët me rroken e duhur.
- Ndaj fjalët me vijë dhe shkruaj fjalinë si duhet.
- Plotëso fjalitë me fjalët që duhen.
- Emërto figurat.
- Sa fjalë ka fjalia?
- Rendit si duhet fjalët në fjali.
- Përgjigju me fjali të plota.

Hapi i dytë: Diskutim

Në varësi të kohës diskutohen disa nga ushtrimet me nxënësit.

Demonstrim i rezultateve të arritura:

Plotësim i detyrave të testit

Vlerësimi i situatës:
Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- Dallon dhe shkruan shkronjat e gjuhës shqipe, të shtypit dhe të dorës.
- Respekton hapësirën mes shkronjave, fjalëve.
- Plotëson pjesët që u mungojnë fjalëve ose fjalive.
- Shkruan fjalë me tri - katër rrokje.
- Shkruajnë fjalë dhe fjali me të diktuar.
- U përgjigjet me shkrim pyetjeve të thjeshta.

Detyra:

1. Ushtrime të ngjashme me testin.

Refleksione:

PLANIFIKIMI DITOR PËR PASABETAREN

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1	**Klasa:** 1
Tema mësimore: Abetare, Abetare		**Situata e të nxënit:** Gjuha jonë e bukur	

***Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe**

Nxënësi:

- ***(1) Kompetenca e komunikim dhe të shprehurit:*** Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar.
- ***(3)Kompetenca e të nxënit:*** Parashtron pyetje dhe përgjigje në lidhje me temën.

***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore**	**Fjalë kyçe:**
Nxënësi: - Shqipton saktë dhe me intonacionin e theksin e duhur fjalët dhe fjalitë. - Pyet, përgjigjet, shpreh mendimet, ndjenjat dhe emocionet e tij, si dhe diskuton në grupe të vogla për tema që i interesojnë. - Reciton vjersha të shkurtra, të mësuara përmendësh.	*Gjuha shqipe, vargje* **Teknika dhe strategji:** ❖ Recitim ❖ Diskutim ❖ Marrëdhënie pyetje-përgjigje ❖ Gushëkuqi rrethor
Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, vjersha të ndryshme për gjuhën shqipe, cd, magnetofon, foto të Gjergj Fishtës dhe Naim Frashërit	**Lidhja me fushat e tjera:** Muzikë, Edukim për shoqërinë

Përshkrimi kontekstual i situatës:

- ***Veprimtari paraprake:***

Hapi 1. Mësuesi/ja bën një prezantim të pjesës së tretë të librit Pasabetare, përmbajtjes së saj dhe të fletores së punës dhe qëllimeve që ka kjo pjesë për përforcimin e leximit, shkrimit dhe koncepteve të para gjuhësore.

Dëgjohet në magnetofon kënga "Gjuha shqipe, gjuha jonë", ose incizime të recitimeve nga aktorë shqiptarë të vjershave të gjuhës shqipe.

Veprimet në situatë

Hapi 2. Mësuesi/ja lexon vargjet për Gjuhën shqipe të Naim Frashërit dhe Gjergj Fishtës, bën një prezantim të shkurtër dhe me fjalë të thjeshta për poetët.

Shpjegon shkurt ndryshimin e dialektit toskë dhe gegë.

Qëllimi i vjershave është përshkrimi i gjuhës shqipe dhe krahasimi i saj me objektet më të bukura dhe dukuritë më të fuqishme.

Hapi 3. Mësuesi/ja bën prezantimin e vjershës "Shkronjë, shkronjë". Lexon vjershën me intonacion.

Shpjegon fjalët dhe shprehjet e reja: *bota vetë, kumbim, e lashtë.*

Lexohet nga nxënësit dhe nxiten ta mësojnë përmendësh.

Hapi 4. Diskutohet rreth përmbajtjes së vjershës

- *Si e kuptoni shprehjen "sillma diellin në dritare".*
- *Pse dora e fëmijës është e lumtur?*
- *Si e gjen botën nëpërmjet shkronjave?*
- *Çfarë keni mësuar ju shkronjë pas shkronje?*
- *Po ju si ndiheni kur lexoni dhe shkruani bukur gjuhën shqipe?*

Demonstrim i rezultateve të arritura

Hapi 5. Kërkohet nga nxënësit të lexojnë përmes teknikës "Gushëkuqi rrethor". E nis një nxënës në vargun e parë, pastaj njëri pas tjetrit lexojnë vargjet sipas radhës. Pas leximit nxënësit shkruajnë në fletore disa vargje që i pëlqejnë nga vjersha.
Vlerësimi i situatës: ***Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:*** ✓ Shqipton saktë dhe me intonacionin e theksin e duhur fjalët dhe fjalitë. ✓ Pyet, përgjigjet, shpreh mendimet, ndjenjat dhe emocionet e tij, si dhe diskuton në grupe të vogla për tema që i interesojnë. ✓ Reciton vjersha të shkurtra, të mësuara përmendësh.
Detyrë shtëpie: 1. Mëso përmendësh vjershat. 2. Kopjo njërën nga vjershat. 3. Përgjigju me disa fjali pyetjes: Si është gjuha shqipe?
Refleksione:

PLANIFIKIMI DITOR PËR PASABETAREN

<table>
<tr><td>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla: 1</td><td>Klasa: 1</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore: Recitojmë vjersha të ndryshme</td><td colspan="2">Situata e të nxënit: Gjuha jonë e bukur</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe
Nxënësi:
➢ (1) Kompetenca e komunikim dhe të shprehurit: Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar.
➢ (3) Kompetenca e të nxënit: Parashtron pyetje dhe përgjigje në lidhje me temën.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore
Nxënësi:
- Shqipton saktë dhe me intonacionin e theksin e duhur fjalët dhe fjalitë.
- Pyet, përgjigjet, shpreh mendimet, ndjenjat dhe emocionet e tij, si dhe diskuton në grupe të vogla për tema që i interesojnë.
- Reciton vjersha të shkurtra, të mësuara përmendësh.
- Veçon disa detaje interesante gjatë të dëgjuarit.
- Dallon elemente të tekstit, të tilla, si: paragrafi, rreshti, strofa, vargu.</td><td colspan="2">Fjalë kyçe:
Gjuha shqipe, vargje,

Teknika dhe strategji:
❖ Recitim
❖ Diskutim
❖ Marrëdhënie pyetje-përgjigje
❖ Konkurs</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, vjersha të ndryshme për gjuhën shqipe, cd, magnetofon, vjersha të ndryshme për fëmijë.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera: Muzikë, Edukim për shoqërinë</td></tr>
<tr><td colspan="4">Përshkrimi kontekstual i situatës:
▪ Veprimtari paraprake:
Hapi 1. Dëgjohet në magnetofon kënga “Gjuha shqipe, gjuha jonë”, ose incizime të recitimeve të vjershave të gjuhës shqipe nga aktorë shqiptarë. Mund të kërkohet dhe ndihmë nga nxënës të talentuar në interpretim të klasave më të larta.
Veprimet në situatë
Hapi 2. Mësuesi/ja pasi bën prezantimin e temës, jep disa këshilla për teknikën e recitimit.
1. Ritmi i vargjeve: leximi ose recitimi i rrokjeve brenda vargut, ritmika e krijuar prej tyre, që e bën më të kënaqshme poezinë.
2. Zëri: Duhet të ketë lartësi dhe forcë të ndryshme. Ndryshimi i forcës së zërit gjatë recitimit është shume i domosdoshëm.
3. Intonacioni: Shpreh ndjenjën dhe qëndrimin e poetit, intonacioni është ngjyra, ëmbëlsia, egërsia, dhembshuria, përkëdhelja emocionale që emërton fjala ose fjalia.
4. Pauza: Një pushim i shkurtër. Pas çdo shenje pikësimi, ne duhet të bëjmë pauzë. E ilustron me shembuj.
5. Theksi: Shqiptimi me zë më fortë dhe me ton më të ngritur i një rrokje ose zanoreje në fjalë. Ai dallon fjalët sipas kuptimit të tyre.
6. Tempi: Shpejtësia me të cilën bëhet diçka. Në recitim ai varet nga pauzat, gjeste, mimika, intonacioni.
7. Gjestet: Lëvizjet e duarve, të kokës, trupit, syve dhe e pjesëve të fytyrës.</td></tr>
</table>

Shënim: *Kjo është një përmbledhje e shkurtër e materialit për teknikën e recitimit. Mësuesi/ja mund të zgjerojë njohuritë në literaturat bashkëkohore.*

Hapi 3. Klasa ndahet në katër grupe:

Grupi 1: Reciton vargjet e N. Frashërit për gjuhën shqipe.

Grupi 2: Reciton vargjet e Gj. Fishtës për gjuhën shqipe.

Grupi 3: Reciton vjershën "Abetare, Abetare"

Grupi 4: Reciton vjersha të ndryshme për shkronjat, të mësuara gjatë periudhës së abetares.

Mund të krijohet një juri me mësuesen e gjuhës dhe disa nxënës të talentuar të klasave të larta, ose mund të bëhet votimi për recituesin më të mirë nga vetë nxënësit. Secilit nxë3nës i jepet një fletë e vogël, në të cilën duhet të shkruajë vetëm një emër të shokut ose shoqes që mendoi se recitoi më bukur. Fletët palosen dhe grumbullohen në një kuti. Mësuesi/ ja ose një nxënës hap fletët e votimit dhe lexon emrat e votuar. Nxënësi/ ja që ka marrë më shumë vota, zgjidhet fitues, mund të ketë vend te dytë dhe të tretë.

Hapi 4. Nxënësit recitojnë sipas grupeve dhe duke pasur parasysh porositë e mësueses për teknikën e recitimit.

Demonstrim i rezultateve të arritura

Hapi 5. Sipas mënyrës së mësipërme të votimit, zgjidhen nxënësit më të mirë. Mësuesi/ja thekson se çfarë bënë më mirë këta nxënës se të tjerët. Jep këshilla dhe porosi për ata që nuk recituan si duhet, duke i inkurajuar ata.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Shqipton saktë dhe me intonacionin e theksin e duhur fjalët dhe fjalitë
- ✓ Pyet, përgjigjet, shpreh mendimet, ndjenjat dhe emocionet e tij, si dhe diskuton në grupe të vogla për tema që i interesojnë.
- ✓ Reciton vjersha të shkurtra, të mësuara përmendësh
- ✓ Veçon disa detaje interesante gjatë të dëgjuarit.
- ✓ Dallon elemente të tekstit, të tilla, si: paragrafi, rreshti, strofa, vargu

Detyrë shtëpie:

1. Bëj një vizatim, duke u frymëzuar nga ora e mësimit që u bë sot.

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1
Tema mësimore: Mësojmë për gjuhën Ush. 1,2 fq. 62		**Klasa:** 1
Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe** Nxënësi: ➢ ***(3)Kompetenca e të nxënit: Ndjek udhëzimet e dhëna në një tekst për të realizuar një veprim/aktivitet /detyrë, që kërkohet. ➢ ***(3)Kompetenca e të nxënit:*** Mbikëqyr në mënyrë të pavarur përparimin e vet në një detyrë, aktivitet duke përdorur teknika të ndryshme për gjetjen e gabimeve (si shënim të gabimeve - vështirësive) dhe i korrigjon ato derisa gjen zgjidhjen. ➢ ***(6) Kompetenca qytetare:*** Diskuton dhe në bashkëpunim me anëtarët e grupit vendos rregullat e punës në grup.		**Fjalë kyçe:** *Fjalë, emra njerëzish, emra kafshësh, emra sendesh.*
***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:** Nxënësi: - Nënvizon fjalë në tekste të ndryshme. - Dallon fjalët që tregojnë emra njerëzish, sendesh dhe kafshësh. - Gjen grupe fjalësh që emërtojnë njerëz, kafshë, sende.		**Teknika dhe strategji:** ❖ Vëzhgim ❖ Stuhi mendimesh ❖ Punë e pavarur ❖ Alfabeti i njëpasnjëshëm
Burimet e informacionit dhe mjete: Njohuritë paraprake të nxënësve, fletore pune, libra jashtëshkollorë, objekte të ndryshme rrethanore.		**Lidhja me fushat e tjera:** Dituri natyre, Edukim për shoqërinë

SITUATA E TË NXËNIT

Përshkrimi kontekstual i situatës:

- ***Veprimtari paraprake:***

Hapi 1. Mësuesi/ja prek objekte të ndryshme në klasë dhe nxit nxënësit të thonë emrin e tyre. Thekson se këto janë ***emra.***
Mund të bëjë përkufizimin se: "Çdo gjë që shohim, prekin, dëgjojmë, nuhasim është emër".
Ilustrohet me shembuj.

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 2. Mësuesi/ja krijon në tabelë disa bashkësi, të cilat plotësohen nga nxënësit në formën e stuhisë së mendimeve.



Hapi 3. Mësuesi/ja bën një prezantim të shkurtër të kësaj pjese të fletores së punës dhe rezultateve të nxënësit që do arrijë nxënësi në fund të fletores.
Hapen fletoret e punës. Ngre nxënës që lexojnë kërkesat dhe diskutohet se si do të plotësohen ushtrimet.

U. 1, 2. Nxënësit lexojnë emrat që janë shkruar, i kopjojnë me shkronja dore dhe plotësojnë vendet bosh me emra të tjera që janë përmendur në orën e parë.
Nxënësit lexojnë emrat sipas kategorive.

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 4. Klasa ndahet në grupe. Secilit grup i jepet një tabelë në të cilën janë shkruar shkronjat e alfabetit. Nxënësit duhet të shkruajnë emra për secilën shkronjë.

a ariu	**b** breshka	**c** celulari	**ç** çanta	**d** dritare	**Dh** dhia
e **....**	**ë** **.....**	**f**	**g**	**gj**	**h**
i **...**	**j** **.....**	**k**	**l**	**ll**	**m**
n	**nj**	**o**	**p**	**q**	**r**
rr	**s**	**sh**	**t**	**th**	**u**
v	**x**	**xh**	**y**	**z**	**zh**

Nxënësit lexojnë fjalët që kanë gjetur. Fiton grupi që plotëson më shpejt dhe më saktë tabelën.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Nënvizon fjalë në tekste të ndryshme.
- ✓ Dallon fjalët që tregojnë emra njerëzish, sendesh dhe kafshësh.
- ✓ Gjen grupe fjalësh që emërtojnë njerëz, kafshë, sende.

Detyrë shtëpie:

1. Plotëso tabelën e mëposhtme:

Emra njerëzish	Emra kafshësh	Emra sendesh

2. Gjej dhe shkruaj emrat që janë përdorur në vjershë "Abetare, Abetare"

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1
Tema mësimore: Mendime të ngjyrosura		**Klasa:** 1
Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe** Nxënësi: ➢ ***(1) Kompetenca e komunikim dhe të shprehurit: Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar. ➢ ***(3)Kompetenca e të nxënit:*** Parashtron pyetje dhe përgjigje në lidhje me temën.		**Fjalë kyçe:** *Tregim, titull, dialog, shenja pikësimi, mendime, shkarravina,*
***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore** Nxënësi: - Shqipton saktë dhe me intonacionin e theksin e duhur fjalët dhe fjalitë - Tregon shkurtimisht përmbajtjen e tekstit (rreth një faqe teksti) duke e ilustruar me detaje dhe ilustrime. - Lidh informacionin e dëgjuar me përvojat e tij ose me informacione që i ka lexuar në tekste të tjera. - Shpreh ndjenjat dhe mendimet personale rreth pjesës që lexon, me ndihmën ose nxitjen e mësuesit *(Si ndjeheni pasi keni lexuar këtë përrallë? A do donit të përfundonte ndryshe? Çfarë do të kishit bërë ju, në një rast të tillë?)*		**Teknika dhe strategji:** ❖ Parashikim me terma paraprakë ❖ Lexim me ndalesa. ❖ Marrëdhënie pyetje - përgjigje ❖ Lexim me role
Burimet e informacionit dhe mjete: Njohuritë paraprake të nxënësve, Libri i nxënësit, fletore klase.		**Lidhja me fushat e tjera:** Arte, Edukim për shoqërinë
SITUATA E TË NXËNIT		
Përshkrimi kontekstual i situatës: ▪ ***Veprimtari paraprake:*** ***Hapi 1.*** Mësuesi/ja shkruan në tabelë titullin: ***"Mendime me ngjyra"*** si dhe disa fjalë kyçe të mësimit si : *vija të zeza, mendime të zeza, mendime me ngjyra.* Nxit nxënësit të japin mendime rreth figurave dhe fjalëve të shkruara në tabelë. Mund të krijojnë dhe krijime të shkurtra sipas fantazisë. ▪ ***Veprimet në situatë*** ***Hapi 2.*** Mësuesi/ja bën prezantimin e tregimit. Bën leximin me ndalesa: **Ndalesa e parë:** Tiku po bën.... deri te ... i përgjigjet ai. Mësuesi/ ja pyet ○ *Cilët marrin pjesë në tregim?* ○ *Çfarë po bëjnë ata?* ○ *Cila është pyetja që i bën motra, vëllait?* **Ndalesa e dytë:** Po ti nuk di ..... deri te ... largohet nga i vëllai. ○ *Si i përgjigjet vëllai motrës?*		

- *Për çfarë e pyet ajo sërish?*
- *Pse mbeti e pakënaqur marta?*
- *Pse Martës i dukeshin të shëmtuara mendimet e Tikut?*

Ndalesa e tretë: Pas pak, Marta... deri në fund.

- *Çfarë bëri motra?*
- *Pse e gënjeu Tikun?*
- *Pse u çudit Tiku?*

Hapi 3. Nxënësit e lexojnë tregimin në heshtje. Më pas ndahen në grupe dhe e lexojnë pjesën me role. Mësuesi/ja tërheq vëmendjen tek intonacioni i përdorur në fjalitë me pikëpyetje dhe pikëçuditëse.

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 4. Nxënësit në dyshe ose individualisht, plotësojnë ushtrimet e fundit të faqes.
Nënvizojnë me të kuqe veprimet që bën Marta dhe me blu veprimet e Tikut.
Mësuesi/ja kujton edhe një herë intonacionin me të cilin lexohen fjalitë që mbarojnë me pikëpyetje dhe pikëçuditëse. Mund të përmendë që fjalitë që mbarojnë me pikëpyetje quhen fjali pyetëse dhe fjalitë që mbarojnë me pikëçuditëse quhen fjali thirrmore.
Nxënësit gjejnë dhe shënojnë fjalitë që mbarojnë me (?) dhe (!).

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Shqipton saktë dhe me intonacionin e theksin e duhur fjalët dhe fjalitë
- ✓ Tregon shkurtimisht përmbajtjen e tekstit (rreth një faqe teksti) duke e ilustruar me detaje dhe ilustrime.
- ✓ Lidh informacionin e dëgjuar me përvojat e tij ose me informacione që i ka lexuar në tekste të tjera.
- ✓ Shpreh ndjenjat dhe mendimet personale rreth pjesës që lexon, me ndihmën ose nxitjen e mësuesit *(Si ndjeheni pasi keni lexuar këtë përrallë? A do donit të përfundonte ndryshe? Çfarë do të kishit bërë ju, në një rast të tillë?*

Detyrë shtëpie:

1. Lexo tekstin dhe mëso përmbajtjen.
2. Kopjo nga teksti fjalitë që mbarojnë me (?) dhe (!).

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1
Tema mësimore: Emra njerëzish dhe sendesh Ush 3, 4 fq. 62		**Klasa:** 1
Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe** Nxënësi: ➢ ***(3) Kompetenca e të nxënit: Ndjek udhëzimet e dhëna në një tekst për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë, që kërkohet. ➢ ***(3)Kompetenca e të nxënit:*** Mbikëqyr në mënyrë të pavarur përparimin e vet në një detyrë, aktivitet duke përdorur eknika të ndryshme për gjetjen e gabimeve (si shënim të gabimeve - vështirësive) dhe i korrigjon ato derisa gjen zgjidhjen. ➢ ***(6) Kompetenca qytetare:*** Diskuton dhe në bashkëpunim me anëtarët e grupit vendos rregullat e punës në grup.		**Fjalë kyçe:** *Fjalë, emra njerëzish, emra kafshësh, emra sendesh.*
***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:** Nxënësi: - Nënvizon fjalë në tekste të ndryshme. - Dallon fjalët që tregojnë emra njerëzish, sendesh dhe kafshësh. - Gjen grupe fjalësh që emërtojnë njerëz, kafshë, sende.		**Teknika dhe strategji:** ❖ Stuhi mendimesh ❖ Punë në dyshe ❖ Punë e pavarur ❖ Lojë fjalësh
Burimet e informacionit dhe mjete: Njohuritë paraprake të nxënësve, fletore pune, libra jashtëshkollorë, pjesë nga përralla të njohura për fëmijë.		**Lidhja me fushat e tjera:** Dituri natyre, Edukim për shoqërinë

SITUATA E TË NXËNIT

Përshkrimi kontekstual i situatës:

- ***Veprimtari paraprake:***

Hapi 1. Mësuesi/ja ka përgatitur një tabelë të ngjashme me atë të detyrës së shtëpisë së një dite më parë dhe nxit nxënësit të plotësojnë atë. Mund të lexojnë dhe fjalë nga detyra e shtëpisë.

Emra njerëzish	Emra kafshësh	Emra sendesh

Përsëriten njohuritë teorike që janë marrë orën e kaluar për emrin.
Kujdes! Bën dallimin midis emrave të njerëzve dhe emrave që u vendosen njerëzve, apo emrave të kafshëve dhe emrave që u vihen kafshëve, p.sh. qen Bobi.

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 2. Mësuesi/ja shpërndan nxënësve pjesë nga përralla të njohura ose jo dhe u kërkon atyre të gjejnë emra të njerëzve, të kafshëve dhe sendeve. P.sh. te përralla" Zhurmat e pyllit"
Mund të zhvillohet në formën e garës dhe del fitues dyshja që ka gjetur më shumë emra.

Hapi 3. Hapen fletoret e punës. Ngre nxënës që lexojnë kërkesat dhe diskutohet se si do të plotësohen ushtrimet.

U. 3. Nxënësit plotësojnë sipas modelit bashkësitë me emra njerëzish, sendesh, kafshësh. Kujtohet se emrat që i vendosim njerëzve shkruhen me shkronjë të madhe. Ilustrohet me shembuj:
halla Anila dhe jo *Halla Anila, doktor Gjergji* dhe jo *Doktor Gjergji* etj.
Nxënësit kontrollojnë detyrat e njëri – tjetrit dhe ndihmojnë të plotësojnë saktë, ata që i kanë gabim.

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 4. Mësuesi/ja përgatit për nxënësit tabela si modeli i mëposhtëm. Nxënësit duhet të lexojnë në drejtimin vertikal dhe horizontal, emra të ndryshëm njerëzish, kafshësh, sendesh dhe t'i qarkojnë ato.

Q	**E**	**R**	**SH**	**I**
E	**N**	**O**	**I**	**R**
N	**A**	**S**	**SH**	**I**
A	**RR**	**A**	**E**	**Q**
M	**J**	**E**	**K**	**U**
A	**R**	**I**	**K**	**A**
M	**O**	**T**	**Ë**	**R**
A	**V**	**I**	**O**	**N**

Fjalët që mund të krijohen janë:
Horizontalisht: *qershi, Eno, arra, mjeku, ari, rika, motër, avion.*
Vertikalisht: *qen, mama, ena, rosa, shishe, iriq.*
Emrat e gjetur i shkruajnë në bashkësi:

Nëse mjafton koha, fjalët mund të shkruhen në fletore. Me disa prej tyre formohen fjali.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Nënvizon fjalë në tekste të ndryshme.
- ✓ Dallon fjalët që tregojnë emra njerëzish, sendesh dhe kafshësh.
- ✓ Gjen grupe fjalësh që emërtojnë njerëz, kafshë, sende.

Detyrë shtëpie:

1. Në tregimin "Mendime të ngjyrosura" gjej 4 emra njerëzish dhe 4 emra sendesh.
2. Formo fjali me to.

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1
Tema mësimore: Për një shkronjë që ti s'e vë.		**Klasa:** 1
Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe** Nxënësi: ➢ ***(1) Kompetenca e komunikim dhe të shprehurit: Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar. ➢ ***(1)Kompetenca e komunikim dhe të shprehurit:*** Identifikon personazhet kryesore të një tregimi, drame apo filmi dhe luan rolin e njërit prej personazheve në bashkëveprim me moshatarët ➢ ***(3)Kompetenca e të nxënit:*** Parashtron pyetje dhe përgjigje në lidhje me temën. ➢ ***(4)Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin:*** Gjen të përbashkëtat dhe ndryshimet ndërmjet aktiviteteve, që organizohen në shkollë me ato në shtëpi dhe i përshkruan në mënyrë individuale përmes njërës nga format e të shprehurit duke i diskutuar në grup.		**Fjalë kyçe:** *Vjershë, varg, strofë, shkronjë, recitimi, gabim.*
***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore** Nxënësi: - Shprehet saktë, kuptueshëm dhe me fjali të plota, kur bën një kërkesë, pyet, sqaron, kërkon ndjesë, falënderon dhe u përgjigjet pyetjeve. - Lidh informacionin e dëgjuar me përvojat e tij ose me informacione që i ka lexuar në tekste të tjera. - Përshkruan me fjalë të thjeshta personazhet dhe tregon se cilët janë personazhet e preferuara. - Reciton vjersha të shkurtra, të mësuara përmendësh.		**Teknika dhe strategji:** ❖ Lojë me etiketa ❖ Lojë gjëzë ❖ Lojë në role ❖ Marrëdhënie pyetje – përgjigje ❖ Punë individuale ❖ Diagrami i Venit
Burimet e informacionit dhe mjete: Njohuritë paraprake të nxënësve, Libri i nxënësit, fletore klase, etiketa me fjalë të shkruara gabim.		**Lidhja me fushat e tjera:** Muzikë, Edukim për shoqërinë
SITUATA E TË NXËNIT		
Përshkrimi kontekstual i situatës: ▪ ***Veprimtari paraprake:*** ***Hapi 1.*** Mësuesi/ja shpërndan nxënësve, etiketa në të cilat janë shkruar fjalë që u mungojnë një apo dy shkronja dhe kërkon që nxënësit të gjejnë, të shkruajnë dhe më pas të lexojnë fjalën ashtu si duhet. Kjo veprimtari mund të zhvillohet në dyshe ose individualisht, në varësi të numrit dhe përbërjes së klasës. ▪ ***Veprimet në situatë*** ***Hapi 2.*** Në tabelë është shkruar alfabeti i gjuhës shqipe. Përsëritet në korr nga gjithë klasa. Mësuesi/ja heq disa shkronja dhe nxënës të caktuar nxiten të gjejnë shkronjën që mungon. Theksohet se nëse është zanore apo bashkëtingëllore.		

Mund të thotë dhe gjëegjëza për shkronjat.

Porsi motra rrojnë bashkë,

Janë plot tridhjetë e gjashtë,

Që të gjitha emër kanë.

A e dini cilat janë?

Hapi 3. Mësuesi/ja shkruan titullin në tabelë dhe bën prezantimin e vjershës. Shpjegon fjalët dhe shprehjet e reja: *hataja, bujk.*
Bëhet leximi i vjershës në korr. Lihen nxënësit të lexojnë në heshtje atë.
Ndahen rolet, bëhet leximi dhe interpretimi në role.
Hapi 4. Diskutohet rreth përmbajtjes

- *Midis kujt zhvillohet dialogu?*
- *Si i kishte bërë detyrat Besniku?*
- *Pse kishte bërë shumë gabime ai?*
- *Cilat qenë gabimet që kishte bërë?*
- *Sa kohë shpenzoni ju për të bërë detyrat?*
- *Po kur i keni bërë shpejt çfarë ka ndodhur?*
- *Çfarë mësoni nga vjersha?*

▪ ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 5. Nxënësit në dyshe ose individualisht, plotësojnë ushtrimet e fundit të faqes.
Nxënësit duhet të shkruajnë emrat e sendeve dhe njerëzve në vjershë. Duhet të plotësojnë emrat e fjalëve të përdorur në vjershë, si dhe të shkruajnë tiparet e përbashkëta dhe të ndryshme midis vetes dhe Besnikut. Komentohet dhe diskutohet rreth tipareve të Besnikut dhe tipareve që duhet të ketë një nxënës i rregullt.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Shprehet saktë, kuptueshëm dhe me fjali të plota, kur bën një kërkesë, pyet, sqaron, kërkon ndjesë, falënderon dhe u përgjigjet pyetjeve.
- ✓ Lidh informacionin e dëgjuar me përvojat e tij ose me informacione që i ka lexuar në tekste të tjera.
- ✓ Përshkruan me fjalë të thjeshta personazhet dhe tregon se cilët janë personazhet e preferuara
- ✓ Reciton vjersha të shkurtra, të mësuara përmendësh.

Detyrë shtëpie:

1. Lexo tekstin dhe mëso përmbajtjen.
2. Kopjo nga teksti fjalitë që mbarojnë me (?) dhe (!).

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1
Tema mësimore: Emra kafshësh e shpendësh Fq 63		**Klasa:** 1
Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe** Nxënësi: ➢ ***(3) Kompetenca e të nxënit: Ndjek udhëzimet e dhëna në një tekst për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë, që kërkohet. ➢ ***(3) Kompetenca e të nxënit:*** Mbikëqyr në mënyrë të pavarur përparimin e vet në një detyrë, aktivitet duke përdorur teknika të ndryshme për gjetjen e gabimeve (si shënim të gabimeve - vështirësive) dhe i korrigjon ato derisa gjen zgjidhjen. ➢ ***(6) Kompetenca qytetare:*** Shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive, vendos duke bashkëpunuar me të gjithë anëtarët për mënyrat që çojnë drejt përfundimit të një aktiviteti të caktuar.		**Fjalë kyçe:** *Fjalë, emra kafshësh, emra shpendësh.*
***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:** Nxënësi: - Nënvizon fjalë në tekste të ndryshme. - Gjen grupe fjalësh që emërtojnë emra kafshësh e shpendësh. - Shkruan emra të përveçëm kafshësh e shpendësh.		**Teknika dhe strategji:** ❖ Diskutim paraprak ❖ Punë në dyshe ❖ Punë e pavarur ❖ Lojë fjalësh
Burimet e informacionit dhe mjete: Njohuritë paraprake të nxënësve, fletore pune, libra jashtëshkollorë, DVD me filma për fëmijë, ku personazhet janë kafshë.		**Lidhja me fushat e tjera:** Dituri natyre

SITUATA E TË NXËNIT

Përshkrimi kontekstual i situatës:

- ***Veprimtari paraprake:***

Hapi 1. Mësuesi/ja lexon një përrallë dhe nxit nxënësit të mbajnë shënim emrat e kafshëve që janë përmendur atje. Thekson se emrat që u vendosen kafshëve shkruhen me shkronjë të madhe. Gjithashtu mund të kujtohen personazhe të ndryshme të filmave vizatimorë ose përrallave të njohura për fëmijë.

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 2. Mësuesi/ja shpërndan nxënësve një tabelë, të cilën duhet ta plotësojnë me emrat që gjetën në pjesën e parë. Kjo veprimtari mund të zhvillohet në dyshe.

Kafsha	Emri i veçantë
qen	Lesi
mace	Pisika
derri	Pepe
.....	.....

Hapi 3. Hapen fletoret e punës. Ngre nxënës që lexojnë kërkesat dhe diskutohet se si do të plotësohen ushtrimet.

U.1. Nxënësit shkruajnë emrat e kafshëve në bashkësi dhe i vendosin emra të veçantë në kutiza. Theksohet edhe njëherë përdorimi i shkronjës së madhe.

kali Hipo dhe jo *Kali Hipo, pula Bardhoshe* dhe *Pula bardhoshe.*

U.2. Nxënësit plotësojnë llojin e kafshës, shpendit dhe i vendosin emra sipas dëshirës, duke përdorur emra personazhesh së filmave që kanë parë ose përralla që kanë lexuar.

Nxënësit kontrollojnë detyrat e njëri – tjetrit dhe ndihmojnë të plotësojnë saktë, ata që i kanë gabim.

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 4. Mësuesi/ ja i të nxënësit të shikojnë një film p.sh. "Mbreti Luan", të cilin mund ta gjejë në linkun e mëposhtëm: https://www.youtube.com/watch?v=2_KHpM8tHFë.

Nxënësit duhet të shkruajnë në fletoren e klasës emrat e kafshëve që marrin pjesë dhe emrat e personazheve, p.sh. luani Simba etj.

Në pamundësi nxënësve u jepen përralla të shkurtra me personazhe kafshë dhe duhet të gjejnë emrat e kafshëve dhe personazheve.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Nënvizon fjalë në tekste të ndryshme.
- ✓ Gjen grupe fjalësh që emërtojnë emra kafshësh e shpendësh.
- ✓ Shkruan emra të përveçëm kafshësh e shpendësh.

Detyrë shtëpie:

1. Ushtrimi 3, fq 63.
2. Shkruaj 5 emra kafshësh dhe 5 emra që i vendos kafshëve.

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1
Tema mësimore: Alfabeti i gjyshe Rozës		**Klasa:** 1
Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe** Nxënësi: ➢ ***(1)Kompetenca e komunikim dhe të shprehurit: Identifikon personazhet kryesore të një tregimi, drame apo filmi dhe luan rolin e njërit prej personazheve në bashkëveprim me moshatarët. ➢ ***(3) Kompetenca e të nxënit:*** Parashtron pyetje dhe përgjigje në lidhje me temën. ➢ ***(4) Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin:*** Gjen të përbashkëtat dhe ndryshimet ndërmjet aktiviteteve, që organizohen në shkollë me ato në shtëpi dhe i përshkruan në mënyrë individuale përmes njërës nga format e të shprehurit duke i diskutuar në grup.		**Fjalë kyçe:** *Tregim, personazhe, okulist, alfabet.*
***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore** Nxënësi: - Përqendrohet në çështjet kryesore, kur rrëfen një ngjarje ose një përvojë të tijën para shokëve dhe shoqeve, mësuesve. - Lidh informacionin e dëgjuar me përvojat e tij ose me informacione që i ka lexuar në tekste të tjera. - Pyet, përgjigjet, shpreh mendimet, ndjenjat dhe emocionet e tij, si dhe diskuton në grupe të vogla për tema që i interesojnë.		**Teknika dhe strategji:** ❖ Lojë me etiketa ❖ Marrëdhënie pyetje – përgjigje ❖ Gushëkuqi rrethor ❖ Punë individuale
Burimet e informacionit dhe mjete: Njohuritë paraprake të nxënësve, Libri i nxënësit, fletore klase, etiketa me shkronjat e alfabetit.		**Lidhja me fushat e tjera:** Edukim për shoqërinë
SITUATA E TË NXËNIT		
Përshkrimi kontekstual i situatës: ▪ ***Veprimtari paraprake*** ***Hapi 1.*** Mësuesi/ja shpërndan nxënësve , etiketa në të cilat janë shkruar shkronjat e alfabetit, nëse klasa ka më pak se 36 nxënës, një nxënësi mund t'i japë dy shkronja të njëpasnjëshme. Sapo mësuesi/ja jep sinjalin, nxënësit duhet të rreshtohen në qetësi dhe pa komunikuar me të tjerët sipas radhës së alfabetit. Përsëritet alfabeti në korr. ▪ ***Veprimet në situatë*** ***Hapi 2.*** Zhvillohet një bisedë për marrëdhëniet që kanë nxënësit me gjyshërit, nëse i kanë shoqëruar ndonjëherë te mjeku i syve ose okulisti apo jo. Kërkohet nga nxënësit të shpjegojnë se çfarë është okulisti dhe të përshkruajnë se si zhvillohet vizita te mjeku okulist.		

- *Po mjeku që viziton fëmijët si quhet?*
- *Dini emra të tjerë mjekësh?*

Hapi 3. Mësuesi/ ja shkruan titullin në tabelë dhe bën prezantimin e tregimit.
Bëhet leximi i vjershës në korr. Lihen nxënësit të lexojnë në heshtje atë. Bëhet leximi

Hapi 4. Diskutohet rreth përmbajtjes

- *Cilët janë personazhet?*
- *Ku e shoqëroi gjyshen Gjoni?*
- *Çfarë i kërkoi mjeku gjyshes?*
- *Pse Gjoni tha se tabela nuk ishte në rregull?*
- *Pse qeshën mjeku dhe gjyshja?*
- *Si mendoni se do të vazhdojë tregimi?*

▪ ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 5. Nxënësit në dyshe ose individualisht, plotësojnë ushtrimet e fundit të faqes.
Nxënësit shënojnë alternativën e saktë për pyetjet.

- Ku shkuan Gjoni dhe gjyshja? -- *Te doktori*
- Pse shkuan te doktori i syve? -- *Për të vizituar sytë.*
- Pse qeshën mjeku dhe gjyshja? ---- *Sepse Gjoni gaboi.*

Në fletoren e klasës, nxënësit shkruajnë emra sendesh që fillojnë me A, E, P, T
p.sh. *Aparat, peshore, tabelë, elektrik.*
Bëhen konkluzionet e orës.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Përqendrohet në çështjet kryesore, kur rrëfen një ngjarje ose një përvojë të tijën para shokëve dhe shoqeve, mësuesve
- ✓ Lidh informacionin e dëgjuar me përvojat e tij ose me informacione që i ka lexuar në tekste të tjera.
- ✓ Pyet, përgjigjet, shpreh mendimet, ndjenjat dhe emocionet e tij, si dhe diskuton në grupe të vogla për tema që i interesojnë

Detyrë shtëpie:

1. Me ndihmën e prindërve bëj një palë syzë prej letre.
2. Shkruaj emrat e shokëve dhe shoqeve të klasës duke i renditur sipas alfabetit.

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1
Tema mësimore: Emra njerëzish dhe sendesh Fq. 64.		**Klasa:** 1
Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe** Nxënësi: ➢ ***(3)Kompetenca e të nxënit: Ndjek udhëzimet e dhëna në një tekst për të realizuar një veprim/aktivitet /detyrë, që kërkohet. ➢ ***(3)Kompetenca e të nxënit:*** Grumbullon dhe klasifikon materialet e performancës së vet, për përgatitjen apo pasurimin e portofolit personal. ➢ ***(5) Kompetenca personale***: Bashkëpunon me të tjerët pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitetet në klasë, shkollë apo jashtë saj.		**Fjalë kyçe:** *Fjalë, emra njerëzish, sendesh, femra, meshkuj.*
***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:** Nxënësi: - Nënvizon fjalë në tekste të ndryshme që tregon emra njerëzish dhe emra sendesh. - Gjen grupe fjalësh që emërtojnë emra njerëzish dhe sendesh. - Dallon emrat e gjinisë femërore nga ata mashkullore (në mënyrë intuitive).		**Teknika dhe strategji:** ❖ Mbajtja e strukturuar e shënimeve ❖ Diskutim paraprak ❖ Punë në dyshe ❖ Punë e pavarur
Burimet e informacionit dhe mjete: Njohuritë paraprake të nxënësve, fletore pune, libra jashtëshkollorë.		**Lidhja me fushat e tjera:** Matematikë, dituri natyre

SITUATA E TË NXËNIT

Përshkrimi kontekstual i situatës:

- ***Veprimtari paraprake:***

Hapi 1. Kujtohet koncepti i emrit dhe ilustrohet me shembuj.

Mësuesi/ja lexon një tregim dhe nxit nxënësit të mbajnë shënim emrat e njerëzve dhe sendeve që janë përmendur atje. Thekson se emrat që u vendosen njerëzve shkruhen me shkronjë të madhe.

Gjithashtu mund të kujtohen personazhe të ndryshme të filmave për fëmijë.

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 2. Mësuesi/ja shpërndan nxënësve një tabelë, të cilën duhet ta plotësojnë me emrat që gjetën në pjesën e parë. Kjo veprimtari mund të zhvillohet në dyshe.

Emra njerëzish Femra	**Emra njerëzish Meshkuj**		**Emra sendesh**
mësuese	mësuesi		lapsi
doktoresha	doktor		lulja
police	polic		molla
.....	.....		.....

Hapi 3. Hapen fletoret e punës. Ngre nxënës që lexojnë kërkesat dhe diskutohet se si do të plotësohen ushtrimet.

U.1. Nxënësit duhet të vendosin emra fëmijëve që janë në varkën A.

Përsëritet se emrat e njerëzve shkruhen me shkronjë të madhe.

Në varkën B, nxënësit i grupojnë në emra që tregojnë meshkuj dhe emra që tregojnë femra. Kjo bëhet në mënyrë intuitive.

U.2. Nxënësit lexojnë dhe emërtojnë figurat. Mund të flitet dhe për rëndësinë që kanë frutat dhe perimet në zhvillimin e shëndetshëm të tyre.

Nxiten të diskutojnë se si mund të dallojnë emrat mashkullorë dhe femërorë.

Nxënësit vendosin në kërpudhën e kuqe emrat që mbarojnë me **a** dhe në kërpudhën lejla emrat që mbarojnë me **i**. Mësuesi/ja shpjegon se emrat e kërpudhës së parë quhen emra *femërorë* dhe emrat e kërpudhës së dytë quhen emra *mashkullorë*.

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 4. Mësuesi/ ja kërkon nga nxënësit të gjejnë 3 emra njerëzish dhe 3 emra sendesh nga libri i abetares dhe me secilin prej tyre të formojë fjali.

Nxënësit lexojnë fjalitë që formuan.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Nënvizon fjalë në tekste të ndryshme që tregon emra njerëzish dhe emra sendesh.
- ✓ Gjen grupe fjalësh që emërtojnë emra njerëzish dhe sendesh.
- ✓ Dallon emrat e gjinisë femërore nga ata mashkullore (në mënyrë intuitive).

Detyrë shtëpie:

1. Ushtrimi 3, fq. 64.
2. Shkruaj 5 emra njerëzish dhe 5 emra sendesh.

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1
Tema mësimore: Para televizorit		**Klasa:** 1
Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe** Nxënësi: ➢ ***(1)Kompetenca e komunikim dhe të shprehurit: Identifikon personazhet kryesore të një tregimi, drame apo filmi dhe luan rolin e njërit prej personazheve në bashkëveprim me moshatarët ➢ ***(3)Kompetenca e të nxënit:*** Parashtron pyetje dhe përgjigje në lidhje me temën. ➢ ***(4)Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin:*** Gjen të përbashkëtat dhe ndryshimet ndërmjet aktiviteteve, që organizohen në shkollë me ato në shtëpi dhe i përshkruan në mënyrë individuale përmes njërës nga format e të shprehurit duke i diskutuar në grup.		**Fjalë kyçe:** *Titull, pjesë, tregim, personazh, hyrje, mbyllje.*
***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore** Nxënësi: - Rilexon tekstin për ta kuptuar më mirë atë (kur është e nevojshme. - Lidh informacionin e dëgjuar me përvojat e tij ose me informacione që i ka lexuar në tekste të tjera. - Pyet, përgjigjet, shpreh mendimet, ndjenjat dhe emocionet e tij, si dhe diskuton në grupe të vogla për tema që i interesojnë - Dallon elemente të tekstit, të tilla, si: paragrafi, rreshti.		**Teknika dhe strategji:** ❖ Diskutim paraprak ❖ Stuhi mendimesh ❖ Dora e fshehtë ❖ Punë në grupe ❖ Marrëdhënie pyetje – përgjigje ❖ Punë individuale ❖ Rrjeti i diskutimit
Burimet e informacionit dhe mjete: Njohuritë paraprake të nxënësve, Libri i nxënësit, fletore klase, DVD me filma për fëmijë, TV.		**Lidhja me fushat e tjera:** Edukim për shoqërinë, Matematikë
SITUATA E TË NXËNIT		
Përshkrimi kontekstual i situatës: ▪ ***Veprimtari paraprake:*** ***Hapi 1.*** Mësuesi/ja i lë nxënësit të shikojnë një film për fëmijë para televizorit ose mund të ketë programuar më parë vajtje në kinema ose teatër. Mësuesi/ja i lë të shprehen lirshëm me njëri-tjetrin. Nxit diskutimin: – *Çfarë të pëlqen të shohësh në TV?* – *Sa orë kalon në ditë duke parë TV?* ▪ ***Veprimet në situatë*** ***Hapi 2.*** Klasa është ndarë në grupe. Mësuesi/ ja ka përgatitur për secilin grup zarfe me tregimin e ndarë në pjesë. Sqaron nxënësit: "nëpër fletë është shkruar një tregim. Nëse i bashkoni si duhet fletët, ju mund ta formoni sërish tregimin".		

Thekson se tregimi përbëhet nga:

- *Pjesa hyrëse*
- *Zhvillimi*
- *Mbyllja*

Hapi 3. Nxënësit renditnin tregimin sipas radhës. Më pas hapin librin dhe i vendosin numra paragrafëve. Secili grup nxjerr një përfaqësues që lexon tregimin e plotë ose mund të lexohet me radhë nga një paragraf sipas radhës, nga të gjithë pjesëtarët e grupit.

Shpjegohen fjalët dhe shprehjet e reja: *sherr, kanal, çiklistë, dokumentarë, trazovaç.*

Hapi 4. Diskutohet rreth përmbajtjes

- *Cilët marrin pjesë në tregim?*
- *Çfarë bëjnë ata?*
- *Çfarë u pëlqen të shohin në TV?*
- *Pse nuk bien dakord me njëri – tjetrin?*
- *Po ju i keni këto shqetësime në familjen tuaj?*
- *Si i keni zgjidhur?*

▪ ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 5. Nxënësit në dyshe ose individualisht, plotësojnë ushtrimet e fundit të faqes.

Nxënësit shënojnë alternativën e saktë për pyetjet.

- Kush merr pjesë në tregim? -- *Motra dhe vëllai*
- Si shkojnë motra me vëllanë? -- *Nuk merren vesh*

Hapi 6.

Po	Të shikosh TV është mirë apo keq?	Jo

Nxiten nxënësit të argumentojnë përgjigjet.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Rilexon tekstin për ta kuptuar më mirë atë (kur është e nevojshme).
- ✓ Lidh informacionin e dëgjuar me përvojat e tij ose me informacione që i ka lexuar në tekste të tjera.
- ✓ Pyet, përgjigjet, shpreh mendimet, ndjenjat dhe emocionet e tij, si dhe diskuton në grupe të vogla për tema që i interesojnë
- ✓ Dallon elemente të tekstit, të tilla, si: paragrafi, rreshti.

Detyrë shtëpie:

1. Përshkruaj emisionin që të pëlqen më shumë.
2. Shkruaj një zgjidhje për problemin që kanë motra dhe vëllai.

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1
Tema mësimore: Emra Fq. 65		**Klasa:** 1
Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe** Nxënësi: ➢ ***(3) Kompetenca e të nxënit: Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes. ➢ ***(3) Kompetenca e të nxënit:*** Grumbullon dhe klasifikon materialet e performancës së vet, për përgatitjen apo pasurimin e portofolit personal. ➢ ***(6) Kompetenca qytetare:*** Diskuton dhe në bashkëpunim me anëtarët e grupit vendos rregullat e punës në grup.		**Fjalë kyçe:** *Fjalë, emra njerëzish, femra, meshkuj.*
***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:** Nxënësi: - Nënvizon në tekste të ndryshme fjalë që tregojnë emra njerëzish - Dallon emrat e gjinisë femërore nga ata mashkullore (në mënyrë intuitive). - Shkruan emra njerëzish që mbarojnë me **a** ose me **i** sipas modelit.		**Teknika dhe strategji:** ❖ Lojë me etiketa ❖ Punë në dyshe ❖ Punë e pavarur ❖ Lojë
Burimet e informacionit dhe mjete: Njohuritë paraprake të nxënësve, fletore pune, libra jashtëshkollorë, etiketa me emra njerëzish të gjinisë femërore dhe mashkullore, karton me ngjyrë rozë dhe bojëqielli.		**Lidhja me fushat e tjera:** Edukim për shoqërinë

SITUATA E TË NXËNIT

Përshkrimi kontekstual i situatës:

- ***Veprimtari paraprake:***

Hapi 1. Mësuesi/ja ka përgatitu etiketa duke e ndarë klasën në grupe ose në dyshe. Etiketat përmbajnë emra njerëzish të gjinisë femërore dhe mashkullore.

djali	**vajza**	**vëllai**
Iliri	**motra**	**Genti**
nxënësi	**Teuta**	**nxënësja**

Bëhet sërish sqarimi se cilët emra shkruhen me të madhe dhe ilustrohen me shembuj.
Nxënësit i grupojnë në dy grupe etiketat sipas mbaresave. Theksohet se grupi që mbaron me a ose ja quhen emrat të gjinisë femërore dhe emrat që mbarojnë me i ose u quhen të gjinisë mashkullore. Nuk ngulet këmbë në konceptin teorik, mjafton që nxënësit të ndajnë saktë në grupe emrat sipas gjinisë edhe në mënyrë intuitive.

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 2. Mësuesi/ja ka ndarë tabelën në dy pjesë ose vendos në mënyrë simbolike një karton rozë dhe një karton blu.

Nxënësit ngrihen dhe ngjisin etiketat me emra të gjinisë femërore në kartonin rozë dhe ato të gjinisë mashkullore në kartonin blu.
Lexohen me zë të lartë duke theksuar mbaresat.
Hapi 3. Hapen fletoret e punës. Ngre nxënës që lexojnë kërkesat dhe diskutohet se si do të plotësohen ushtrimet.
U.1. Nxënësit duhet të vendosin në bashkësinë rozë emrat e vajzave (femërorë) dhe në bashkësinë bojëqielli emrat e djemve (mashkullorë).

Emra femërorë



Emra mashkullorë

U.2. Nxënësit lexojnë dhe emërtojnë figurat. Plotësojnë në mënyrë të pavarur sipas modelit ushtrimin. Kujtohet se fjalia mbaron me shkronjë të madhe dhe në fund i vendosim pikë. Emrat e përveçëm të njerëzve shkruhen më shkronjë të madhe.

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 4. Klasa ndahet në dy grupe, djem dhe vajza. Njëri pas tjetrit ata shkruajnë emrat e tyre, vajzat në kartonin rozë dhe djemtë na kartonin bojë qielli.
Mund të ketë në klasë emra vajzash si Megi, Xheni etj. që nuk mbarojnë me **a**, ose emra djemsh si Xhino, Enea etj., që nuk mbarojnë me **i**.
Mësuesi/ja sqaron se këto janë emra të huaj dhe për këto emra nuk vlen rregulli i mbaresës **a** dhe i që mësuan në gjuhën shqipe.

Vlerësimi i situatës:
Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Nënvizon në tekste të ndryshme fjalë që tregojnë emra njerëzish.
- ✓ Dallon emrat e gjinisë femërore nga ata mashkullore (në mënyrë intuitive).
- ✓ Shkruan emra njerëzish që mbarojnë me **a** ose me **i** sipas modelit.

Detyrë shtëpie:

1. Ushtrimi 3, fq. 65.
2. Plotëso tabelën e mëposhtme:

Emra femërorë	Emra mashkullorë

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1
Tema mësimore: Edukata		**Klasa:** 1
Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe** Nxënësi: ➢ ***(1) Kompetenca e komunikim dhe të shprehurit: Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup. ➢ ***(3) Kompetenca e të nxënit:*** Parashtron pyetje dhe përgjigje në lidhje me temën.		**Fjalë kyçe:** *Vjershë, varg, strofë, edukatë*
***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore** Nxënësi: - Shqipton saktë dhe me intonacionin e theksin e duhur fjalët dhe fjalitë. - Pyet, përgjigjet, shpreh mendimet, ndjenjat dhe emocionet e tij, si dhe diskuton në grupe të vogla për tema që i interesojnë. - Dallon elemente të tekstit, të tilla, si: paragrafi, rreshti, strofa, vargu. - Tregon se si ndikojnë ilustrimet për të kuptuar më mirë tekstin.		**Teknika dhe strategji:** ❖ Diskutim paraprak ❖ Stuhi mendimesh ❖ Gushëkuqi rrethor ❖ Marrëdhënie pyetje – përgjigje ❖ Punë individuale ❖ Rrjeti i diskutimit
Burimet e informacionit dhe mjete: Njohuritë paraprake të nxënësve, Libri i nxënësit, fletore klase, foto të kafshëve shtëpiake.		**Lidhja me fushat e tjera:** Edukim për shoqërinë, Dituri natyre

SITUATA E TË NXËNIT

Përshkrimi kontekstual i situatës:

- ***Veprimtari paraprake:***

Hapi 1. Mësuesi/ja nxjerr para klasës disa foto kafshësh shtëpiake dhe nxit nxënësit të flasin rreth tyre.

- *A mbani kafshë shtëpiake ?*
- *Përshkruani kafshën shtëpiake që mbani në shtëpi.*
- *Si janë sjelljet e tyre?*

Nxiten nxënësit t'i bëjnë pyetje njëri – tjetrit për kafshët shtëpiake që mbajnë.

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 2. Shkruan në tabelë titullin e vjershës dhe nxit nxënësit të flasin se çfarë mendojnë ata për edukatën.

Shkruhen të gjitha përgjigjet e nxënësve në tabelë.

Hapi 3. Hapen librat. Bëhet komenti i figurës.

- *Çfarë po bëjnë macet?*
- *Po qentë?*

Mësuesi/ja lexon vjershën dhe shpjegon fjalët dhe shprehjet e reja.
Hanin tok, kuvendonin, u shqyen, shamatë.
Lihen nxënësit të lexojnë vjershën në heshtje.
Bëhet leximi i vjershës në zinxhir, secili nxënës lexon nga një strofë.
Hapi 4. Diskutohet rreth përmbajtjes.

- *Cilët marrin pjesë vjershë?*
- *Çfarë po bënin macet?*
- *Si menduan qentë?*
- *Ç'ndodhi me qentë kur morën kockën?*
- *A u treguan të edukuar ata?*
- *Çfarë mësoni nga vjersha?*

▪ ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 5. Nxënësit në dyshe ose individualisht, plotësojnë ushtrimet e fundit të faqes.
Nxënësit shënojnë alternativën e saktë për pyetjet.
Shkruajnë fjali për macen dhe qenin.
Hapi 6. Zhvillohet një rrjet diskutimi për pyetjen.
Cilët treguan edukatën qentë apo macet?
Diskutohet rreth shprehjes: *"Kjo është edukata"*.
Nxiten nxënësit të argumentojnë përgjigjet.

Vlerësimi i situatës:
Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Shqipton saktë dhe me intonacionin e theksin e duhur fjalët dhe fjalitë.
- ✓ Pyet, përgjigjet, shpreh mendimet, ndjenjat dhe emocionet e tij, si dhe diskuton në grupe të vogla për tema që i interesojnë.
- ✓ Dallon elemente të tekstit, të tilla, si: paragrafi, rreshti, strofa, vargu.
- ✓ Tregon se si ndikojnë ilustrimet për të kuptuar më mirë tekstin

Detyrë shtëpie:

1. Përshkruaj në fletore kafshën shtëpiake që të pëlqen.
2. Shkruaj në fletore katër vargjet që të pëlqejnë më shumë.
3. Mëso vjershën përmendësh.

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1
Tema mësimore: Emra njerëzish-kafshësh-sendesh Fq. 66		**Klasa:** 1
Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe** Nxënësi: ➢ ***(3) Kompetenca e të nxënit: Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes. ➢ ***(3) Kompetenca e të nxënit:*** Mbikëqyr në mënyrë të pavarur përparimin e vet në një detyrë, aktivitet duke përdorur teknika të ndryshme për gjetjen e gabimeve (si shënim të gabimeve - vështirësive) dhe i korrigjon ato derisa gjen zgjidhjen. ➢ ***(6) Kompetenca qytetare:*** Shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive, vendos duke bashkëpunuar me të gjithë anëtarët për mënyrat që çojnë drejt përfundimit të një aktiviteti të caktuar.		**Fjalë kyçe:** *Fjalë, emra kafshësh, emra njerëzish, emra sendesh.*
***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:** Nxënësi: - Shkruan emra kafshësh, sendesh, njerëzish, në trajtën e shquar dhe të pashquar, të numrit njëjës, në të dy gjinitë sipas modelit dhe në mënyrë intuitive. - Grupon, shkruan emra sipas modelit: *kalë – kali, burrë – burri, vajzë – vajza, televizor – televizori, derë – dera.*		**Teknika dhe strategji:** ❖ Diskutim paraprak ❖ Punë në grupe ❖ Punë e pavarur ❖ Punë në dyshe
Burimet e informacionit dhe mjete: Njohuritë paraprake të nxënësve, fletore pune, libra jashtëshkollorë, etiketa me emra në të dy trajtat.		**Lidhja me fushat e tjera:** Dituri natyre, matematikë.

SITUATA E TË NXËNIT

Përshkrimi kontekstual i situatës:

- ***Veprimtari paraprake:***

Hapi 1. Mësuesi/ja kërkon nga nxënësit të thonë disa emra sipas modelit të mëposhtëm për fjalët: *kalë, vajzë, djalë, televizor, derë, etj.*

kalë	kali
lopë	lopa
djalë	djali
.....	.....

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 2. Mësuesi/ja u shpërndan grupeve zarfe me 10 etiketa, në të cilat janë shkruar 5 emra të ndryshëm në trajtën e shquar dhe të pashquar. Nxënësit duhet të çiftojnë emrat, *p.sh. libër – libri, shportë- shporta, etj.* Theksohet se përshtatja e emrave sipas trajtave bëhet në mënyrë intuitive nga nxënësit dhe duke ndjekur modelin. Fiton grupi që i grupon më shpejt dhe saktë emrat.
Çiftet e emrave ngjiten në tabelë, p.sh.

doktor	doktori

Hapi 3. Hapen fletoret e punës. Ngre nxënës që lexojnë kërkesat dhe diskutohet se si do të plotësohen ushtrimet.

U.1. Nxënësit plotësojnë tabelat me emra kafshësh, njerëzish, sendesh në të dy trajtat e numrit njëjës, sipas modelit.

Emra kafshësh				
kalë	kali		lopë	lopa
lepur	lepuri		mace	macja
qen	qeni		dhi	dhia
luan	luani		dhelpër	dhelpra
gomar	gomari		dele	delja

Emra njerëzish				
burrë	burri		vajzë	vajza
lojtar	lojtari		studente	studentja
djalë	djali		nxënëse	nxënësja
gjysh	gjyshi		mësuese	mësuesja
pilot	piloti		gjyshe	gjyshja

Emra sendesh				
televizor	televizori		derë	dera
telefon	telefoni		balonë	balona
libër	libri		fshesë	fshesa
laptop	laptopi		çantë	çanta
laps	lapsi		daulle	daullja

Nxënësit kontrollojnë detyrat e njëri – tjetrit dhe ndihmojnë të plotësojnë saktë, ata që i kanë gabim.

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 4. Nxënësit në dyshe gjejnë një emër, të cilin e përshtatin sipas modelit të mësipërm në dy trajtat e numrit njëjës. Lihen të mendojnë dhe përshtatin fjalët për disa minuta.

Secila dyshe thotë emrin, njëri në trajtën e pashquar dhe tjetri në të shquarën, p.sh. pulë – pula.

Dyshja i shkruan emrat në tabelë.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- Shkruan emra kafshësh, sendesh, njerëzish, në trajtën e shquar dhe të pashquar, të numrit njëjës, në të dy gjinitë sipas modelit dhe në mënyrë intuitive.
- Grupon, shkruan emra sipas modelit: *kalë - kali, burrë – burri, vajzë – vajza, televizor – televizori, derë – dera.*

Detyrë shtëpie:

1. Në vjershën Edukata, gjej dy emra kafshësh dhe dy emra njerëzish dhe vendosi në tabelë si modeli i mësipërm.
2. Formo fjali me fjalët: *shkollë – shkolla, futbollist – futbollisti.*

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1
Tema mësimore: Në zyrën e babit		**Klasa:** 1
Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe** Nxënësi: ➢ ***(1) Kompetenca e komunikim dhe të shprehurit: Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup. ➢ ***(3) Kompetenca e të nxënit:*** Parashtron pyetje dhe përgjigje në lidhje me temën. ➢ ***(4) Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin:*** Gjen të përbashkëtat dhe ndryshimet ndërmjet aktiviteteve, që organizohen në shkollë me ato në shtëpi dhe i përshkruan në mënyrë individuale përmes njërës nga format e të shprehurit duke i diskutuar në grup.		**Fjalë kyçe:** *Tastierë, shkresë, ekonomist, titull, pjesë, tregim, personazh.*
***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore** Nxënësi: - Shqipton saktë dhe me intonacionin e theksin e duhur fjalët dhe fjalitë. - Lidh informacionin e dëgjuar me përvojat e tij ose me informacione që i ka lexuar në tekste të tjera. - Shpreh ndjenjat dhe mendimet personale rreth pjesës që lexon, me ndihmën ose nxitjen e mësuesit.		**Teknika dhe strategji:** ❖ Harta e koncepteve ❖ Gushëkuqi rrethor ❖ Marrëdhënie pyetje – përgjigje ❖ Punë individuale ❖ Rrjeti i diskutimit
Burimet e informacionit dhe mjete: Njohuritë paraprake të nxënësve, Libri i nxënësit, fletore klase, foto të profesioneve të ndryshme.		**Lidhja me fushat e tjera:** Edukim për shoqërinë, Arte

SITUATA E TË NXËNIT

Përshkrimi kontekstual i situatës:

- ***Veprimtari paraprake:***

Hapi 1. Mësuesi/ja shkruan në tabelë fjalën profesionet dhe nxit nxënësit të thonë profesionet që njohin.

- *Çfarë profesioni bëjnë prindërit tuaj?*
- *Çfarë profesioni ju pëlqen ju të bëni?*
- *Përshkruani disa nga profesionet?*



- ***Veprimet në situatë***

Hapi 2. Shkruan në tabelë titullin e tregimit "Në zyrën e babit".
U thotë nxënësve se do të lexojnë një pjesë që lidhet me punën e prindërve.
"Personazhi, i cili viziton punën e babit, është një moshatar me ju.

- *Çfarë ndodhi më tej?"*

Mësuesi/ja e zbërthen përmes teknikës "Di, Dua të di, Mësova."
Mësuesi/ ja pyet:

- *Çfarë dini tani për pjesën që do të lexojmë?*
- *Çfarë doni të dini më tej?*

Priten pyetje të larmishme nga nxënësit.
Vazhdohet me leximin.

- *A morët përgjigje për pyetjet që bëtë?*
- *Për cilat pyetje morët përgjigje dhe për cilat jo?*

Hapi 3. Mësuesi/ ja kërkon nga nxënësit ta lexojnë pjesën dhe të nënvizojnë fjalët që lidhen me profesionin e babit të Dorinës. Shpjegohen fjalët e reja*: tastierë, ekonomist, shkresa, serioz, ia merr frymën* etj.
Mësuesi/ja pyet sërish.

- *Çfarë mësuam sot?*

Hapi 4. Kërkohet nga nxënësit të përshkruajnë profesionet e prindërve, duke u udhëhequr nga pyetjet e tekstit në lidhje me diskutimin.

- *Çfarë pune bën babi/mami?*
- *Cila është ajo gjë që të pëlqen më shumë në profesionin e mamit/ babit/*
- *Si ndihesh për punën që bën mami/ babi? (i/e kënaqur? I/e lumtur? Krenar/e ?)*

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 5. Nxënësit në dyshe ose individualisht, plotësojnë ushtrimet e fundit të faqes.
Nxënësit i përgjigjen me shkrim pyetjeve në fletore.
Lexohen dhe diskutohen përgjigjet.
Shkruajnë disa emra profesionesh.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Shqipton saktë dhe me intonacionin e theksin e duhur fjalët dhe fjalitë.
- ✓ Lidh informacionin e dëgjuar me përvojat e tij ose me informacione që i ka lexuar në tekste të tjera.
- ✓ Shpreh ndjenjat dhe mendimet personale rreth pjesës që lexon, me ndihmën ose nxitjen e mësuesit.

Detyrë shtëpie:

1. Përshkruaj në fletore një profesion që të pëlqen të bësh.
2. Çfarë do të bëhesh kur të rritesh dhe pse?
3. Vizato profesionin që të pëlqen.

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1
Tema mësimore: Emra Fq. 67.		**Klasa:** 1
Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe** Nxënësi: ➢ ***(3) Kompetenca e të nxënit: Mbikëqyr në mënyrë të pavarur përparimin e vet në një detyrë, aktivitet duke përdorur teknika të ndryshme për gjetjen e gabimeve (si shënim të gabimeve - vështirësive) dhe i korrigjon ato derisa gjen zgjidhjen. ➢ ***(3) Kompetenca e të nxënit:*** Grumbullon dhe klasifikon materialet e performancës së vet, për përgatitjen apo pasurimin e portofolit personal. ➢ ***(6) Kompetenca qytetare:*** Diskuton dhe në bashkëpunim me anëtarët e grupit vendos rregullat e punës në grup.		**Fjalë kyçe:** *Fjalë, emra të përafërt, emrat e të vegjëlve të kafshëve, emrat e sendeve të mëdha.*
***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:** Nxënësi: ➢ Shkruan dhe lidh fjalë sipas një fushe të përbashkët semantike. ➢ Shkruan fjali me emra profesionesh. ➢ Shkruan emrat e të vegjëlve të kafshëve dhe të sendeve të mëdha.		**Teknika dhe strategji:** ❖ Diskutim paraprak ❖ Punë në dyshe ❖ Punë individuale ❖ Lojë me etiketa ❖ Punë me grupe
Burimet e informacionit dhe mjete: Njohuritë paraprake të nxënësve, fletore pune, libra jashtëshkollorë, foto objektesh të ndryshme, etiketa me emra profesionesh, vargjet e vjershës së T. Gjokutaj *"**Shpejt i rregulloni**"*.		**Lidhja me fushat e tjera:** Dituri natyre, Edukim për shoqërinë, Matematikë

SITUATA E TË NXËNIT

Përshkrimi kontekstual i situatës:

- ***Veprimtari paraprake:***

Hapi 1. Mësuesi/ja ka vendosur në tabelë disa foto objektesh që kanë një përafërsi kuptimore: *zjarr – tym, lugë – pjatë, shkollë – nxënës, shkumës – tabelë etj.*

Kërkon që edhe nxënësit të gjejnë raste të ngjashme me shembujt e dhënë.

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 2. Nxënësit në dyshe gjejnë dy emra që kanë lidhje kuptimore me njëri – tjetrin, si në shembullin e mësipërm. Lihen të mendojnë dhe gjejnë dyshet e fjalëve për disa minuta.

Pas kohës përgatitore, nxënësit thonë emrat e gjetur.

Dyshja i shkruan emrat në tabelë.

Hapi 3. Hapen fletoret e punës. Ngre nxënës që lexojnë kërkesat dhe diskutohet se si do të plotësohen ushtrimet.

U.1. Nxënësit lidhin fjalët në dyshe sipas kuptimit dhe më pas i shkruajnë në gjethet me ngjyra në të djathtë të fletës.

Syze – sy, oxhak –tym, parfumeri – parfum, i trëndafiltë – trëndafil, gazetar – gazetë, shkollor – shkollë, skiator – ski, peshkatar – peshk.

U.2. Mësuesi/ja kërkon nga nxënësit të gjejnë emrat e profesioneve që janë në figurë. Formohen fjalitë, të cilat shkruhen në fletore dhe lexohen me zë të lartë.

- *Ai që bën bukë, quhet bukëpjekës.*
- *Ai që pret mishin, quhet kasap.*
- *Ai që gatuan, quhet kuzhinier.*
- *Ai që shëron sëmundjet. quhet doktor.*

U.3. Në mënyrë të pavarur punohet për ushtrimin 3 dhe 4. Nxënësit plotësojnë emrat e të vegjëlve të kafshëve dhe të sendeve të mëdha.

Qen – këlysh, mace – kotele, kalë – mëz, dele – qengj.

U.4. *Derë – portë, barkë – anije, shtëpi – pallat.*

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 4. Klasa ndahet në grupe. Secilit grup i jepet një vjersha e T. Gjokutaj, të cilën nxënësit duhet ta rregullojnë sipas kuptimit.

Shpejt i rregulloni

Lopa bëri qengj bardhosh,
delja bëri viç larosh,
pula klloçkë bëri kec,
kec të vogël grindavec,
dhia ngrohu dhjetë vezë
dhe nxori zogj të zes...

Fjalët, duke shkruar,
më janë ngatërruar,
ju që i lexoni,
shpejt, i rregulloni!

Fiton grupi që rendit më shpejt dhe saktë vjershën.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- Shkruan dhe lidh fjalë sipas një fushe të përbashkët semantike.
- Shkruan fjali me emra profesionesh.
- Shkruan emrat e të vegjëlve të kafshëve dhe të sendeve të mëdha.

Detyrë shtëpie:

1. Ushtrimi 5, fq. 67.
2. Formo fjali me emrat që gjete në ushtrimin 4.

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1
Tema mësimore: Librat rrinë radhë - radhë		**Klasa:** 1
Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe** Nxënësi: ➢ ***(1) Kompetenca e komunikim dhe të shprehurit: Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar. ➢ ***(3) Kompetenca e të nxënit:*** Parashtron pyetje dhe përgjigje në lidhje me temën. ➢ ***(4) Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin:*** Gjen të përbashkëtat dhe ndryshimet ndërmjet aktiviteteve, që organizohen në shkollë me ato në shtëpi dhe i përshkruan në mënyrë individuale përmes njërës nga format e të shprehurit duke i diskutuar në grup. ➢ ***(6) Kompetenca qytetare:*** Diskuton dhe në bashkëpunim me anëtarët e grupit vendos rregullat e punës në grup.		**Fjalë kyçe:** *Vjershë, varg, strofë, libër*
***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore** Nxënësi: ✚ Shprehet saktë, kuptueshëm dhe me fjali të plota, kur bën një kërkesë, pyet, sqaron, kërkon ndjesë, falënderon dhe u përgjigjet pyetjeve. ✚ Lidh informacionin e dëgjuar me përvojat e tij ose me informacione që i ka lexuar në tekste të tjera. ✚ Reciton vjersha të shkurtra, të mësuara përmendësh.		**Teknika dhe strategji:** ❖ Stuhi mendimesh ❖ Dora e fshehtë ❖ Marrëdhënie pyetje – përgjigje ❖ Punë individuale ❖ Pesëvargësh
Burimet e informacionit dhe mjete: Njohuritë paraprake të nxënësve, Libri i nxënësit, fletore klase, libra të ndryshëm për fëmijë.		**Lidhja me fushat e tjera:** Edukim për shoqërinë,

SITUATA E TË NXËNIT

Përshkrimi kontekstual i situatës:

- ***Veprimtari paraprake:***

Hapi 1. Bëhet një vizitë në bibliotekën e shkollës. Nëse është e mundur krejt ora mund të zhvillohet në bibliotekë. Mund të organizohet një bisedë për punonjësen e bibliotekës, e cila i flet për rëndësinë e librit.

Hapi 2. Nxiten nxënësit të flasin për librin. Ndihmon me pyetje ndihmëse.

- *Si është libri për ju?*
- *Çfarë mësoni prej tij?*
- *Përmendi disa libra që keni lexuar?*



- ***Veprimet në situatë***

Hapi 3. Mësuesi/ja bën prezantimin e vjershës. Lexon atë me intonacion, shpjegon fjalët dhe shprehjet e reja.

Presin syrin t'i lexojë. Hyjnë në botim time.

Bëhet leximi në korr i vjershës. Lihen nxënësit të lexojnë vjershën në heshtje.

Hapi 4. Mësuesi/ja ka përgatitur vjershën të shkruar në fletë dhe ta ndarë në strofa. Strofat e vjershës në rend të ngatërruar i jepen çdo grupi dhe lihen nxënësit t'i renditin sipas radhës.

Bëhet leximi i vjershës në zinxhir, secili nxënës lexon nga një strofë.

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 5. Nxënësit në dyshe ose individualisht, plotësojnë ushtrimet e fundit të faqes.

Nënvizojnë fjalët me tri rrokje.

Shkruajnë titullin e disa librave që kanë në bibliotekën e tyre. Theksohen se titujt e librave shkruhen me shkronjë të madhe.

Hapi 6. Pesëvargësh për librin.

Meqenëse nxënësit nuk e dinë konceptin mbiemër, folje, sinonim. Mësuesi/ja i ndihmon me pyetje ndihmëse.

Libri

Interesant i bukur *(2 mbiemra) (Si është?)*

Lexohet të mëson të argëton *(3 folje) (Çfarë bën?)*

Libri është shoku im. (*një fjali me 4 fjalë)*

Dituri (*sinonim)(një fjalë të ngjashme*)

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- Shprehet saktë, kuptueshëm dhe me fjali të plota, kur bën një kërkesë, pyet, sqaron, kërkon ndjesë, falënderon dhe u përgjigjet pyetjeve.
- Lidh informacionin e dëgjuar me përvojat e tij ose me informacione që i ka lexuar në tekste të tjera.
- Reciton vjersha të shkurtra, të mësuara përmendësh.

Detyrë shtëpie:

1. Mëso vjershën përmendësh.
2. Kopjo bukur disa vargje nga vjersha që të pëlqejnë më shumë.

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1
Tema mësimore: Emra në njëjës dhe shumës fq. 68		**Klasa:** 1
Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe** Nxënësi: ➢ ***(3) Kompetenca e të nxënit: Ndjek udhëzimet e dhëna në një tekst për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë, që kërkohet. ➢ ***(3) Kompetenca e të nxënit:*** Parashtron pyetje dhe përgjigjet në pyetjet për temën /problemin/detyrën e dhënë në njërën nga format e të shprehurit. ➢ ***(6 Kompetenca qytetare:*** Diskuton dhe në bashkëpunim me anëtarët e grupit vendos rregullat e punës në grup.		**Fjalë kyçe:** *Fjalë, emra njëjës, shumës, pyetje, përgjigje*
***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:** Nxënësi: - Dallon emrin në numrin njëjës dhe në numrin shumës (në mënyrë intuitive). - Gjen shumësin e emrave sipas modelit dhe duke përdorur intuitën. - Shkruan pyetje dhe përgjigje sipas figurave. - Përdor drejt pikën dhe pikëpyetjen në fund të fjalisë. - Përdor drejt shkronjën e madhe në fillim të fjalisë.		**Teknika dhe strategji:** ❖ Diskutim paraprak ❖ Punë në dyshe ❖ Punë e pavarur
Burimet e informacionit dhe mjete: Njohuritë paraprake të nxënësve, fletore pune, libra jashtëshkollorë, foto të objekteve të ndryshme.		**Lidhja me fushat e tjera:** Dituri natyre, Matematikë.

SITUATA E TË NXËNIT

Përshkrimi kontekstual i situatës:

- ***Veprimtari paraprake:***

Hapi 1. Mësuesi/ja paraqet para nxënësve figura që paraqesin një ose disa objekte, p.sh. *një laps* dhe më pas *disa lapsa*. Mund të paraqesë dhe objekte rrethanore, në fillim një objekt dhe më pas disa objekte. Nxit nxënësit t'i emërtojnë ato. Korrigjon nëse nxënësit shprehen gabim në formimin e shumësit të emrave. Mësuesi/ja përdor fjalën njëjës për një objekt dhe shumës dhe për dy ose më shumë objekte.

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 2. Nxënësit në dyshe gjejnë një emër dhe e vendosin në numrin njëjës dhe shumës. Lihen të mendojnë dhe gjejnë dyshet e fjalëve për dy minuta.
Pas kohës përgatitore, nxënësit thonë emrat e gjetur.
p.sh njëri thotë: *një fletore,* tjetri thotë *disa fletore.* Dyshja i shkruan emrat në tabelë.
Hapi 3. Hapen fletoret e punës. Ngre nxënës që lexojnë kërkesat dhe diskutohet se si do të plotësohen ushtrimet.
U.1. Nxënësit shkruajnë sipas modelit emrat njëherë në numrin njëjës dhe njëherë në numrin shumës.
Një yll – shumë yje, një mollë – shumë mollë, një top – disa topa, një katror – disa katrorë.
Vazhdohet në të njëjtën mënyrë me ***ushtrimin 2***.
Këtu janë përdorur emra në të dy trajta dhe numrat. Nxënësit plotësojnë sipas modelit. Në këtë pjesë të ushtrimit nxënësit mund të kenë nevojë për ndihmë sidomos të plotësimi i tabelës me emra në

trajtën e pashquar të numrit shumës. Nuk është e nevojshme që mësuesi t'i sqarojë nxënësit për trajtat e emrit. Kjo nuk bën pjesë në program dhe është e vështirë për t'u kuptuar nga nxënësit në këtë fazë. Plotësimi do të bëhet sipas modeli dhe duke përdorur intuitën.

Nr. njëjës			**Nr. shumës**			**Nr. njëjës**			**Nr. shumës**	
Tr. e pashquar	Tr e shquar		Tr. e pashquar	Tr. e shquar		Tr. e pashquar	Tr. e shquar		Tr. e pashquar	Tr. e shquar
peshk	*peshku*		*peshq*	*peshqit*		*fik*	*fiku*		*fiq*	*fiqtë*
pemë	*pema*		*pemë*	*pemët*		*mik*	*miku*		*miq*	*miqtë*
çadër	*çadra*		*çadra*	*çadrat*		*shok*	*shoku*		*shokë*	*shokët*
gotë	*gota*		*gota*	*gotat*		*shoqe*	*shoqja*		*shoqe*	*shoqet*
ftua	*ftoi*		*ftonj*	*ftonjtë*		*sy*	*syri*		*sy*	*sytë*

Nxënësit kontrollojnë detyrat e njëri – tjetrit dhe ndihmojnë të plotësojnë saktë, ata që i kanë gabim. Me disa fjalë kërkohet që të formojnë fjali.

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 4. Diskutohet për figurat. Nxënësit duhet të formojnë nga një pyetje dhe t'i përgjigjen pyetjeve me fjali të plotë.

Kujtohet se në fund të pyetjeve vendosim pikëpyetje dhe në fund të përgjigjeve vendosim pikë. Fjalitë fillojnë me shkronjë të madhe. Udhëzohen të lexojnë dhe përdorin fjalët poshtë figurave për ndihmë.

- *Ku po fle djali?*
- *Djali fle në shtrat.*
- *Çfarë ndodhet në pemë?*
- *Në pemë është një fole zogu.*
- *Çfarë është kjo?*
- *Kjo është një shtëpi.*
- *Ku po kalon makina?*
- *Makina është në një kthesë rruge.*

Nëse mjafton koha, fjalitë mund të shkruhen në fletore.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Dallon emrin në numrin njëjës dhe në numrin shumës (në mënyrë intuitive).
- ✓ Gjen shumësin e emrave sipas modelit dhe duke përdorur intuitën.
- ✓ Shkruan pyetje dhe përgjigje sipas figurave.
- ✓ Përdor drejt pikën dhe pikëpyetjen në fund të fjalisë.
- ✓ Përdor drejt shkronjën e madhe në fillim të fjalisë.

Detyrë shtëpie:

1. Gjej nga një emër për çdo bashkësi te emrat e U.2 dhe formo fjali, p.sh.:

- *Në akuariumin tim ndodhet një peshk.*
- *Peshku është i kuq.*
- *Babi më solli disa peshq të tjerë.*
- *Peshqit janë me ngjyra të ndryshme.*

2. Formo një tabelë me emra e objekteve që ndodhen në çantën tënde, si modeli i ushtrimit 1.

Refleksione:

<table>
<tr><td>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla: 1</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore: Biçikleta</td><td>Klasa: 1</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe
Nxënësi:
➢ (1) Kompetenca e komunikim dhe të shprehurit: Identifikon personazhet kryesore të një tregimi, drame apo filmi dhe luan rolin e njërit prej personazheve në bashkëveprim me moshatarët
➢ (3) Kompetenca e të nxënit: Parashtron pyetje dhe përgjigje në lidhje me temën.
➢ (4) Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin: Gjen të përbashkëtat dhe ndryshimet ndërmjet aktiviteteve, që organizohen në shkollë me ato në shtëpi dhe i përshkruan në mënyrë individuale përmes njërës nga format e të shprehurit duke i diskutuar në grup.
➢ (6) Kompetenca qytetare: Diskuton dhe në bashkëpunim me anëtarët e grupit vendos rregullat e punës në grup.</td><td>Fjalë kyçe:
Tregim, titull, surprizë, dhuratë.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore
Nxënësi:
➢ Përqendrohet në çështjet kryesore, kur rrëfen një ngjarje ose një përvojë të tijën para shokëve dhe shoqeve, mësuesve.
➢ Lidh informacionin e dëgjuar me përvojat e tij ose me informacione që i ka lexuar në tekste të tjera.
➢ Pyet, përgjigjet, shpreh mendimet, ndjenjat dhe emocionet e tij, si dhe diskuton në grupe të vogla për tema që i interesojnë.</td><td>Teknika dhe strategji:
❖ Punë me mjete
❖ Diskutim
❖ DRTA
❖ Punë me grupe
❖ Punë individuale
❖ Bashkëbisedim</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet e informacionit dhe mjete: Njohuritë paraprake të nxënësve, Libri i nxënësit, fletore klase, materiale të ndryshme të ricikluesshme për të ndërtuar një biçikletë.</td><td>Lidhja me fushat e tjera:
Edukim për shoqërinë, Arte, Dituri natyre</td></tr>
<tr><td colspan="3">SITUATA E TË NXËNIT</td></tr>
<tr><td colspan="3">Përshkrimi kontekstual i situatës:
▪ Veprimtari paraprake:
Hapi 1. Mësuesi/ja ka njoftuar nxënësit ditë më parë për grumbullimin e materialeve të ricikluesshme, për të ndërtuar një biçikletë. Mund të jenë tela, lapsa, rrota të makinave të prishura etj. Kujtohet çfarë kanë mësuar në Dituri natyre për forcën shtytëse dhe lëvizëse. Lihen të punojnë në grupe të vogla për modelimin e biçikletës.
▪ Veprimet në situatë
Hapi 2. Mësuesi/ja nxit nxënësit të tregojnë pjesët e biçikletës. Ata që kanë biçikletë mund të përshkruajnë atë. Nxitet të flitet për rëndësinë e përdorimit të biçikletës në mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetin e njeriut.
Hapi 3. Mësuesi/ja shkruan titullin në tabelë dhe bën prezantimin e tregimit.
Bëhet leximi me ndalesa. Leximi mund të bëhet nga nxënësit.</td></tr>
</table>

Ndalesa e parë: *Ishte nata e .....* deri te ..... *ç'të jetë vallë..?*

- *Kur zhvillohet ngjarja?*
- *Çfarë shqetësimi ka vajza?*
- *Çfarë mund të ketë zarfi?*

Ndalesa e dytë: *U ngrita në mëngjes.....* deri te ..... *Nuk mu durua.*

- *Çfarë mendon vajza?*
- *Po ju keni të njëjtin mendim me vajzën?*
- *E kishit parashikuar se do të ndodhte kjo?*
- *Çfarë mendoni se do të ndodhë më pas?*

Ndalesa e tretë: *Vrapova .....* deri te .....*në fund të shkallëve.*

- *Çfarë kishte zarfi?*
- *Si mendoni se do të mbyllet tregimi?*
- *A ka dalë parashikimi juaj i mëparshëm?*

Ndalesa e katërt: *I zbrita shkallët .....* deri në fund.

- *Çfarë mund të jetë poshtë shkallëve?*
- *Ju pëlqen dhurata që mori vajza?*
- *Po ju keni marrë dhuratë të ngjashme?*

Shënim: *Në mënyrë që metoda e mësipërme të japë rezultat, mirë është që të mos lejohen nxënësit të hapin librin dhe të porositen ata nxënës që mund ta kenë lexuar më parë, të mos i tregojnë shokëve.*

Hapi 4. Në grupe mendoni një mbyllje tjetër për tregimin dhe shkruajeni atë në fletore ose e thotë një pjesëtar i grupit.

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 5. Nxënësit në dyshe ose individualisht, plotësojnë ushtrimet e fundit të faqes.
Nxënësit shënojnë alternativën e saktë për pyetjet, ngjyrosin biçikletën sipas dëshirës.

Hapi 6. Mund të bëhet në formën e bashkëbisedimit ose të shkrimit të lirë.

- *Cila është dhurata më e pëlqyer për djem dhe vajza?*
- *A ju pëlqejnë surprizat?*

Bëhen konkluzionet e orës së mësimit.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Përqendrohet në çështjet kryesore, kur rrëfen një ngjarje ose një përvojë të tijën para shokëve dhe shoqeve, mësuesve.
- ✓ Lidh informacionin e dëgjuar me përvojat e tij ose me informacione që i ka lexuar në tekste të tjera.
- ✓ Pyet, përgjigjet, shpreh mendimet, ndjenjat dhe emocionet e tij, si dhe diskuton në grupe të vogla për tema që i interesojnë.

Detyrë shtëpie:

1. Përgjigju me shkrim pyetjeve rreth përmbajtjes që janë në libër.
2. Përshkruaj lodrën tënde të preferuar.
3. Vizato një biçikletë dhe shkruaj pjesët e saj.

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1
Tema mësimore: Fjalë që tregojnë cilësi, fq. 69		**Klasa:** 1
Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe** Nxënësi: ➢ ***(3) Kompetenca e të nxënit: Ndjek udhëzimet e dhëna në një tekst për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë, që kërkohet. ➢ ***(3) Kompetenca e të nxënit:*** Mbikëqyr në mënyrë të pavarur përparimin e vet në një detyrë, aktivitet duke përdorur teknika të ndryshme për gjetjen e gabimeve (si shënim të gabimeve - vështirësive) dhe i korrigjon ato derisa gjen zgjidhjen. ➢ ***(6) Kompetenca qytetare:*** Shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive, vendos duke bashkëpunuar me të gjithë anëtarët për mënyrat që çojnë drejt përfundimit të një aktiviteti të caktuar.		**Fjalë kyçe:** *Fjalë, cilësi të emrit, mbiemra.*
***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:** Nxënësi: - Dallon fjalët që tregojnë cilësi të emrit (me ndihmën e mësuesit). - Plotëson fjali duke përdorur cilësi të emrit. - Përshkruan me fjalë të thjeshta veshje ose objekte të ndryshme të përdorimit të përditshëm.		**Teknika dhe strategji:** ❖ Stuhi mendimesh ❖ Vëzhgim ❖ Punë e pavarur ❖ Shkrim i lirë ❖ Lojë gjëzë
Burimet e informacionit dhe mjete: Njohuritë paraprake të nxënësve, fletore pune, libra jashtëshkollorë, akull i grirë, foto të vendeve me borë.		**Lidhja me fushat e tjera:** Dituri natyre, Edukim për shoqërinë.

SITUATA E TË NXËNIT

Përshkrimi kontekstual i situatës:

- ***Veprimtari paraprake:***

Hapi 1. Mësuesi/ja shkruan në tabelë fjalën dëbora dhe kërkon nga nxënësit të thonë çfarë dinë për të. Mund të afishojë në muret e klasës dhe foto të borës ose mund të porositë fëmijët një ditë më parë të sjellin foto të tyre, të cilat i kanë bërë në ditë me borë.

Si është dëbora?

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 2. Mësuesi/ja mund të marrë në një termus akull të grirë, që improvizon borën. I lë nxënësit ta shohin, prekin, shijojnë. Improvizon rënien e borës me pambuk. Mund të marrë edhe video, në të cilën nxënësit të shohin rënien e dëborës.

Hapi 3. Hapen fletoret e punës. Ngre nxënës që lexojnë kërkesat dhe diskutohet se si do të plotësohen ushtrimet.

U.1. Nxënësit plotësojnë në mënyrë të pavarur ushtrimin 1, duke u ndihmuar nga përvoja personale

dhe fjalët që ndodhen në fund të faqes.
Në qoftë se e sheh është *e bardhë.*
Në qoftë se e prek është *e ftohtë* dhe *e butë.*
Në qoftë se e ha është *pa shije.*
Në qoftë se e sheh duke rënë është *e lehtë.*
Në qoftë se shkrin është *e lëngshme.*
Nxënësit lexojnë përgjigjet dhe i krahasojnë me njëri-tjetrin.
Nxit nxënësit të nënvizojnë fjalët e gjetura për borën.
Mësuesi/ja shpjegon se këto quhen mbiemra (përjashto fjalën *pa shije*) dhe i përdorin për të treguar se si janë emrat. Ilustron me shembuj*: nxënës i mirë, vajzë e bukur, djalë i shkathët etj.*
U.2. Mësuesi/ja nxit nxënësit të përshkruajnë objektet që janë në figurë.
Mirë është që nxënësit të kenë marrë me vete veshje të ngjashme dhe i përshkruajnë duke i parë dhe prekur. Nxënësit lidhin figurën me cilësitë. Plotësojnë fjalitë sipas figurave.
Dorezat janë të kuqe.
Triko është e leshtë.
Pantallonat janë të gjata.
Xhupi është i trashë.
Çorapet janë të shkurtra.
Shalli është i lehtë.
Atletet janë të bukura.
Kapuçi është i ngrohtë.
Lexohen fjalitë që nxënësit shkruan.
Demonstrim i rezultateve të arritura
Hapi 4. Nxënësit duhet të përshkruajnë një objekt pa ia thënë emrin, duke përdorur sa më shumë cilësi. Më pas e lexon para klasës dhe nxënësit e tjerë duhet ta gjejnë në formën e gjëegjëzës.
Është i rrumbullakët, është i shijshëm, ka ngjyrë portokalli, ka lëng të ëmbël, pak të thartë.
Kush është?
Bëhen konkluzionet e orës.

Vlerësimi i situatës:
Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:
- ✓ Dallon fjalët që tregojnë cilësi të emrit (me ndihmën e mësuesit).
- ✓ Plotëson fjali duke përdorur cilësi të emrit.
- ✓ Përshkruan me fjalë të thjeshta veshje ose objekt të ndryshme të përdorimit të përditshëm.

Detyrë shtëpie:
1. Përshkruaj shokun ose shoqen tënde. Përdor sa më shumë cilësi.
2. Shkruaj se si janë disa nga objektet e tua më të pëlqyera.
3. Përshkruaj biçikletën e vajzës te pjesa "Biçikleta".

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1
Tema mësimore: Dy duar tre fëmijë		**Klasa:** 1
Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe** Nxënësi: ➢ ***(1) Kompetenca e komunikim dhe të shprehurit: Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar. ➢ ***(3) Kompetenca e të nxënit:*** Parashtron pyetje dhe përgjigje në lidhje me temën. ➢ ***(4) Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin:*** Gjen të përbashkëtat dhe ndryshimet ndërmjet aktiviteteve, që organizohen në shkollë me ato në shtëpi dhe i përshkruan në mënyrë individuale përmes njërës nga format e të shprehurit duke i diskutuar në grup.		**Fjalë kyçe:** *Vjershë, varg, strofë, dashuri, nënë.*
***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore** Nxënësi: - Shprehet saktë, kuptueshëm dhe me fjali të plota, kur bën një kërkesë, pyet, sqaron, kërkon ndjesë, falënderon dhe u përgjigjet pyetjeve. - Lidh informacionin e dëgjuar me përvojat e tij ose me informacione që i ka lexuar në tekste të tjera. - Reciton vjersha të shkurtra, të mësuara përmendësh.		**Teknika dhe strategji:** ❖ Dëgjim muzikor: "Kënga e nënës" ❖ Diskutim me terma paraprakë ❖ Marrëdhënie pyetje – përgjigje ❖ Punë individuale ❖ Pesëvargësh
Burimet e informacionit dhe mjete: Njohuritë paraprake të nxënësve, Libri i nxënësit, fletore klase.		**Lidhja me fushat e tjera:** Muzikë, Edukim për shoqërinë
SITUATA E TË NXËNIT		
Përshkrimi kontekstual i situatës: ▪ ***Veprimtari paraprake:*** ***Hapi 1.*** Dëgjohet dhe këndohet kënga e nënës. Mësuesi/ja mund ta gjejë në këtë link: https://www.youtube.com/watch?v=7mT8MV0nrPU Nxiten nxënësit të flasin për dashurinë që kanë për nënën dhe ndjenjat që ju ngjall kjo këngë. ▪ ***Veprimet në situatë*** ***Hapi 2.*** Mësuesi/ ja shkruan në tabelë titullin dhe disa fjalë kyçe. *"Dy duar, tre fëmijë", nëna, përqafim, jap dorën.* Nxiten nxënësit të japin supozime për përmbajtjen e vjershës. Mund të krijojnë dhe një tregim të shkurtër. ***Hapi 3.*** Mësuesi/ja lexon me intonacion vjershën. Shpjegon fjalët dhe shprehjet e reja: *e praruar, hodh në përqafim.* Bëhet leximi i vjershës në korr. Lihen nxënësit të lexojnë në heshtje atë. Lexohet në formë zinxhiri nga një strofë secili nxënës. Mund të ketë nxënës që e mësojnë shpejt		

përmendësh. Nxiten ta recitojnë bukura të.

Hapi 4. Diskutohet rreth përmbajtjes

- *Si e ka titullin pjesa?*
- *Si e kuptoni ju titullin "Dy duar, tre fëmijë"?*
- *Pse dora e mamit quhet e praruar?*
- *A i ndan dot nëna fëmijët?*
- *Pse thuhet se zemra e nënës është madhe?*
- *Në cilin varg e gjeni ju këtë?*
- *Thoni një fjali për nënë tuaj.*

▪ ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 5. Nxënësit në dyshe ose individualisht, plotësojnë ushtrimet e fundit të faqes.

Nxënësit duhet të plotësojnë fjalitë:

- Duart e mamit tim *më përkëdhelin.*
- Çdo ditë mami *më përqafon.*
- Me duart e mamit *ndihem i/e sigurt.*
- *Janë të shijshme gatimet* prej duarve të mamit.
- Unë i puth *me dashuri duart e mamit.*

Hapi 6. Pesëvargësh për *nënën*.

Meqenëse nxënësit nuk e dinë konceptin mbiemër, folje, sinonim. Mësuesi/ja i ndihmon me pyetje ndihmëse.

Nëna

E dashur e mirë *(2 mbiemra) (Si është?)*

Na rrit edukon mëson *(3 folje) (Çfarë bën?)*

Nënën time e dua shumë. (*një fjali me 4 fjalë)*

Mami (*sinonim)(një fjalë të ngjashme*)

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Shprehet saktë, kuptueshëm dhe me fjali të plota, kur bën një kërkesë, pyet, sqaron, kërkon ndjesë, falënderon dhe u përgjigjet pyetjeve.
- ✓ Lidh informacionin e dëgjuar me përvojat e tij ose me informacione që i ka lexuar në tekste të tjera.
- ✓ Përshkruan me fjalë të thjeshta personazhet dhe tregon se cilët janë personazhet e preferuara.
- ✓ Reciton vjersha të shkurtra, të mësuara përmendësh.

Detyrë shtëpie:

1. Mëso vjershën përmendësh.
2. Vizato dorën e mamit.
3. Shkruaj një letër për mamin. *(Zbukuroje sipas dëshirës).*

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1
Tema mësimore: Fjalë që tregojnë cilësi Fq. 70		**Klasa:** 1
Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe** Nxënësi: ➢ ***(3) Kompetenca e të nxënit: Ndjek udhëzimet e dhëna në një tekst për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë, që kërkohet ➢ ***(3) Kompetenca e të nxënit:*** Grumbullon dhe klasifikon materialet e performancës së vet, për përgatitjen apo pasurimin e portofolit personal. ➢ ***(5) Kompetenca personale:*** Bashkëpunon me të tjerët pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitetet në klasë, shkollë apo jashtë saj.		**Fjalë kyçe:** *Fjalë, cilësi të emrave, mbiemër.*
***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:** Nxënësi: - Lidh emrat e kafshëve të ndryshme me cilësitë e tyre. - Dallon fjalët që tregojnë cilësi të emrit (me ndihmën e mësuesit). - Plotëson pjesë të fjalëve që tregojnë cilësi. - Formon fjali me grupet e fjalëve (emër + cilësi).		**Teknika dhe strategji:** ❖ Vëzhgim ❖ Diskutim paraprak ❖ Punë në dyshe ❖ Punë e pavarur
Burimet e informacionit dhe mjete: Njohuritë paraprake të nxënësve, fletore pune, libra jashtëshkollorë, foto kafshësh, etiketa me mbiemra.		**Lidhja me fushat e tjera:** Matematikë, Dituri natyre

SITUATA E TË NXËNIT

Përshkrimi kontekstual i situatës:

- ***Veprimtari paraprake:***

Hapi 1. Nxënësit lexojnë detyrën e shtëpisë e dhënë në orën e kaluar, ku nxënësit duhet të përshkruanin shoqen ose shokun e tyre. nxënësit e tjerë gjejnë fjalët cilësuese që ai/ajo ka përdorur. Disa nga cilësitë e gjetura shkruhen në tabelë.

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 2. Mësuesi/demonstron para nxënësve figura kafshësh dhe nxënësit përshkruajnë ato duke përdorur sa më shumë cilësi.

p.sh. Qeni është kafshë shtëpiake, është besnik, ka dëgjim të mprehtë, nuhatje të hollë etj.

Hapi 3. Hapen fletoret e punës. Nxënësit lexojnë kërkesat dhe diskutojnë se si do të plotësojnë ushtrimet.

U.1. Nxënësit duhet të duhet të lidhin kafshën me cilësinë.

Luani i egër, peshku i vogël, kali i shpejtë, breshka e ngadaltë, lepuri i bukur, macja e dobishme, gjarpri helmues, tigri mishngrënës, flutura shumëngjyrëshe, lopa barngrënëse.

Me disa nga grupet e fjalëve të formuara, nxënësit formojnë fjali.

U.2. Mësuesi ngre para klasës disa nxënës dhe nxit të tjerët t'i përshkruajnë nga pamja e jashtme.

Duhet të tregohet i kujdesshëm që të mos lejojë nxënësit të etiketojnë shokët/shoqet me cilësi ofenduese ose të meta që ata mund të kenë.
Nxënësit plotësojnë fjalët e cilësisë që mungon, duke përshtatur me figurën.
I gjatë, i shkurtër, i shëndoshë, i dobët.

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 4. Mësuesi/ja shpërndan nxënësve disa etiketa me mbiemra dhe kërkon nga nxënësit t'i mësojnë përmendësh dhe më pas t'i shkruajnë në fletore pa i parë. Fitues është nxënësi që shkruan sa më shumë mbiemra saktë dhe pa gabime. Mësuesi/ja vë në dukje se grupi i parë i mbiemrave mbarojnë gjithmonë me – ë- dhe grupi i dytë nuk e mban shkronjën – ë – në fund.

I gjatë, i fortë, i bardhë, i ngushtë, i gjerë, i artë, i shëndoshë, i lartë, i butë, i ngadaltë, i shpejtë.
I pjerrët, i dobët, i afërt, i hekurt, i akullt, i pjekur, i vogël, i shkurtër, i shëndetshëm, i kujdesshëm.

Me disa prej tyre nxënësit formojnë fjali.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Lidh emrat e kafshëve të ndryshme me cilësitë e tyre.
- ✓ Dallon fjalët që tregojnë cilësi të emrit (me ndihmën e mësuesit).
- ✓ Plotëson pjesë të fjalëve që tregojnë cilësi.
- ✓ Formon fjali me grupet e fjalëve (emër + cilësi).

Detyrë shtëpie:

1. Ushtrimi 3, fq 70.
2. Formo fjali me grupet e fjalëve: *flutur shumëngjyrëshe, mace e dobishme, djalë i gjatë, etj.*

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1
Tema mësimore: Hunda e Pinokut		**Klasa:** 1
Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe** Nxënësi: ➢ ***(1) Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar. ➢ ***(1) Kompetenca e komunikim dhe të shprehurit:*** Shpreh me gojë dhe me shkrim për 3-5 minuta para moshatarëve dhe të tjerëve përjetimet dhe emocionet që e kanë shoqëruar gjatë shikimit të një filmi ose dokumentari, dëgjimit të një tregimi apo përralle. ➢ ***(3) Kompetenca e të nxënit:*** Parashtron pyetje dhe përgjigje në lidhje me temën. ➢ ***(7) Kompetenca digjitale***: Ritregon ngjarjen e një teksti të dëgjuar (nga mjetet audio-vizuale), përmbajtja e të cilit të mos jetë më shumë se një faqe teksti.		**Fjalë kyçe:** *Përrallë, titull, dialog, gënjeshtër.*
***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore** Nxënësi: - Shqipton saktë dhe me intonacionin e theksin e duhur fjalët dhe fjalitë. - Përcakton dy-tre tipare të përrallave, fabulave, tregimeve, poezive. - Përshkruan me fjalë të thjeshta personazhet dhe tregon se cilët janë personazhet e preferuara. - Shpreh ndjenjat dhe mendimet personale rreth pjesës që lexon, me ndihmën ose nxitjen e mësuesit *(Si ndjeheni pasi keni lexuar këtë përrallë? A do donit të përfundonte ndryshe? Çfarë do të kishit bërë ju, në një rast të tillë?*		**Teknika dhe strategji:** ❖ Film ose lexim i përrallës. ❖ Marrëdhënie pyetje - përgjigje ❖ Lexim me role ❖ Rrjeti i diskutimit
Burimet e informacionit dhe mjete: Njohuritë paraprake të nxënësve, Libri i nxënësit, fletore klase. DVD, libri "Pinoku"		**Lidhja me fushat e tjera:** Arte, Edukim për shoqërinë
SITUATA E TË NXËNIT		
Përshkrimi kontekstual i situatës: ▪ ***Veprimtari paraprake:*** ***Hapi 1.*** Lihen nxënësit të shikojnë filmin "Pinoku", fragmente të tij. Në pamundësi, mund të lexohet përralla ose të ritregohet nga mësuesja ose nxënësit filmi që kanë parë në TV. Mund të porositen ditë më parë që të shikojnë në internet filmin "Pinoku". ▪ ***Veprimet në situatë*** ***Hapi 2.*** Mësuesi/ja bën prezantimin e përrallës. Nxënësit lexojnë përrallën në heshtje. Shpjegohen fjalët dhe shprehjet e reja:		

Monedha ari, barnatore, barna.

Bëhet leximi i pjesës në role. Përsëritet disa herë me grupe të ndryshme nxënësish.

Hapi 3. Lihen të diskutojnë në dyshe për përmbajtjes.

- *Për çfarë e pyeti Zana Pinokun?*
- *A i tha të vërtetën Zanës ai?*
- *Si e kuptoi Zana që Pinoku po gënjente?*
- *Pse e gënjeu Zanën Pinoku?*
- *Cilat janë tri gënjeshtrat e Pinokut?*
- *A e shpëtuan gënjeshtrat Pinokun?*
- *Si vazhdon përralla?*
- *E keni dëgjuar fjalën e urtë "Gënjeshtra i ka këmbët e shkurtra"?*
- *Si e kuptoni ju këtë?*

Nxënësit në grupe diskutojnë për vazhdimin e përrallës. Mund të japin variantin që kanë parë në film ose lexuar në libër. Por mund të gjejnë një vazhdim duke përdorur fantazinë.

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 4. Nxënësit në dyshe ose individualisht, plotësojnë ushtrimet e fundit të faqes.

Nënvizojnë me laps fjalitë që tregojnë gënjeshtrat e Pinokut.

- *I kam humbur.*
- *Në pyllin këtu afër.*
- *Katër monedhat nuk më kam humbur. Me to bleva në barnatore barnat e Baba Karlos.*

Hapi 5. Zhvillohet një rrjet diskutimi.

Po	Të shpëton gënjeshtra nga dënimet?	Jo

Nxiten nxënësit të argumentojnë përgjigjet.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Shqipton saktë dhe me intonacionin e theksin e duhur fjalët dhe fjalitë.
- ✓ Përcakton dy-tre tipare të përrallave, fabulave, tregimeve, poezive.
- ✓ Përshkruan me fjalë të thjeshta personazhet dhe tregon se cilët janë personazhet e preferuara.
- ✓ Shpreh ndjenjat dhe mendimet personale rreth pjesës që lexon, me ndihmën ose nxitjen e mësuesit *(Si ndjeheni pasi keni lexuar këtë përrallë? A do donit të përfundonte ndryshe? Çfarë do të kishit bërë ju, në një rast të tillë?*

Detyrë shtëpie:

1. Vizato Pinokun.
2. Shkruaj gabimet e Pinokut.
3. Mëso përmbajtjen e përrallës.

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1
Tema mësimore: Dramatizim i një pjese		**Klasa:** 1
Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe** Nxënësi: ➢ ***(1) Kompetenca e komunikim dhe të shprehurit: Shpreh me gojë dhe me shkrim për 3-5 minuta para moshatarëve dhe të tjerëve përjetimet dhe emocionet që e kanë shoqëruar gjatë shikimit të një filmi ose dokumentari, dëgjimit të një tregimi apo përralle. ➢ ***(5) Kompetenca personale:*** Bashkëpunon me të tjerët pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitetet në klasë, shkollë apo jashtë saj. ➢ ***(7) Kompetenca digjitale***: Ritregon ngjarjen e një teksti të dëgjuar (nga mjetet audio-vizuale), përmbajtja e të cilit të mos jetë më shumë se një faqe teksti.		**Fjalë kyçe:** *Personazhe, dramatizim, aktorë, skenografi, regjisor.*
***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore** Nxënësi: - Shqipton saktë dhe me intonacionin e theksin e duhur fjalët dhe fjalitë. - Përcakton dy-tre tipare të përrallave, fabulave, tregimeve, poezive. - Përshkruan me fjalë të thjeshta personazhet dhe tregon se cilët janë personazhet e preferuara. - Shpreh ndjenjat dhe mendimet personale rreth pjesës që lexon, me ndihmën ose nxitjen e mësuesit *(Si ndjeheni pasi keni lexuar këtë përrallë? A do donit të përfundonte ndryshe? Çfarë do të kishit bërë ju, në një rast të tillë?*		**Teknika dhe strategji:** ❖ Film ose lexim i përrallës. ❖ Lojë në role ❖ Punë në grupe
Burimet e informacionit dhe mjete: Njohuritë paraprake të nxënësve, Libri i nxënësit, fletore klase, DVD, veshje të personazheve		**Lidhja me fushat e tjera:** Arte, Edukim për shoqërinë
SITUATA E TË NXËNIT		
Përshkrimi kontekstual i situatës: ▪ ***Veprimtari paraprake:*** ***Hapi 1.*** Nxënësit janë porositur ditë më parë të shohin disa herë filmin e Pinokut. Janë ndarë rolet dhe janë caktuar pjesët që duhet të mësojnë përmendësh. Gjithashtu janë porositur të marrin ose të përshtatin veshje të personazheve. Mësuesi/ja nuk mjaftohet vetëm me interpretimin e fragmentit që është në librin e abetares, por përshtat dhe përgatit krejt përrallën. Mund të shfrytëzojë orët e lëndës me zgjedhje dhe të orës kujdestare. Nëse është mundësia mund të ftohen prindër, mësues të shkollës dhe nxënës të klasave të		

tjera. Mund të improvizohet edhe një skenë me mjete rrethanore nga vetë nxënësit dhe prindërit. Mësuesi/ja duhet të kujdeset që të fotografojë ose filmojë lojën e grupeve. Me fotot mund të krijohet një album ose një poster që ekspozohet në muret e klasës.

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 2. Gjithë klasa do të ndahet në disa grupe sipas prirjeve të nxënësve.

- **Grupi i aktrimit** (2 – 3 grupe)
- **Grupi i skenografisë**
- **Grupi i organizimit të shfaqjes**
- **Regjisorët**

Personazhet: *Pinoku, Baba Karlo, Zana Blu, Bulkthi Xhim, Dhelpra, Maçoku,,,*
Nxënësit interpretojnë me radhë sipas grupeve. Është e rëndësishme që mësuesi/ja të caktojë me rol të gjithë nxënësit, edhe ata që kanë vështirësi në të nxënë. Mund t'i jepet një rol simbolik.

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 3. Nxiten nxënësit të diskutojnë për realizimin e shfaqjes. Vlerësojnë grupet dhe aktorët më të spikatur. Përshkruajnë personazhin më të pëlqyer. Nxiten të flasin se çfarë ndjenë gjatë përgatitjes për shfaqje dhe lojës.
Bëhen konkluzionet e orës.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Shqipton saktë dhe me intonacionin e theksin e duhur fjalët dhe fjalitë.
- ✓ Përcakton dy-tre tipare të përrallave, fabulave, tregimeve, poezive.
- ✓ Përshkruan me fjalë të thjeshta personazhet dhe tregon se cilët janë personazhet e preferuara.
- ✓ Shpreh ndjenjat dhe mendimet personale rreth pjesës që lexon, me ndihmën ose nxitjen e mësuesit *(Si ndjeheni pasi keni lexuar këtë përrallë? A do donit të përfundonte ndryshe? Çfarë do të kishit bërë ju, në një rast të tillë?*

Detyrë shtëpie:

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1
Tema mësimore: Përshkruajmë shokun, Faqe 71, ushtrimet 1, 4		**Klasa:** 1
Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe** Nxënësi: ➢ ***(1) Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup. ➢ ***(3) Kompetenca e të nxënit:*** Ndjek udhëzimet e dhëna në një tekst për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet. ➢ ***(3) Kompetenca e të nxënit:*** Mbikëqyr në mënyrë të pavarur përparimin e vet në një detyrë, aktivitet duke përdorur teknika të ndryshme për gjetjen e gabimeve (si shënim të gabimeve - vështirësive) dhe i korrigjon ato derisa gjen zgjidhjen. ➢ ***(6) Kompetenca qytetare:*** Diskuton dhe në bashkëpunim me anëtarët e grupit vendos rregullat e punës në grup.		**Fjalë kyçe:** *Cilësi, trup të gjatë, e bukur, e zgjuar, e gëzuar, e shkathët, sportive, serioz*
***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:** Nxënësi: - Shqipton saktë dhe me intonacionin e theksin e duhur fjalët dhe fjalitë. - Përqendrohet në çështjet kryesore, kur rrëfen një ngjarje ose një përvojë të tijën para shokëve dhe shoqeve, mësuesve dhe prindërve. - Pyet, përgjigjet, shpreh mendimet, ndjenjat dhe emocionet e tij, si dhe diskuton në grupe të vogla për tema që i interesojnë - Plotëson fjalitë sipas kuptimit.		**Teknika dhe strategji:** ❖ Punë në grupe ❖ Punë individuale ❖ Shkrim i lirë ❖ Punë në dyshe ❖ Lojë gjëzë
Burimet e informacionit dhe mjete: Njohuritë paraprake të nxënësve, fletore pune, libra jashtëshkollorë, foto të fëmijëve të moshave të ndryshme, A4, markera, etiketa me fjalë e bukur, e gjatë, e zgjuar...		**Lidhja me fushat e tjera:** Edukim për shoqërinë, Arte.

SITUATA E TË NXËNIT

Përshkrimi kontekstual i situatës:

- ***Veprimtari paraprake:***

Hapi 1. Mësuesi/ja ndan klasën në dy grupe dhe kërkon që nxënësit të plotësojnë me vizatime tiparet e fytyrës dhe veshjet e një djali dhe një vajze në fletë të mëdha ose në dërrasë duke krijuar cilësitë dalluese të tyre. Nxënësit veprojnë me radhë. Secili grup përshkruan flokët, sytë, buzët dhe veshjet e tyre. Mund të listohen edhe tipare të tjera dalluese nga fotot e sjella vetë nxënësit.

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 2. Mësuesi/ja orienton nxënësit të përshkruajnë fotografitë e Olës dhe Anit duke iu përgjigjur pyetjeve për të dhënë sa më shumë hollësi. Me kë ngjan? Si është veshur? Si i ka flokët? etj.

Ushtrimi 1. Nxënësit plotësojnë fjalitë duke iu përgjigjur pyetjeve *Si është?* dhe *Çfarë ka?* Përsëritet fakti se përgjigjet duhen të plota (me trup të gjatë, me flokë kafe, me sy të zinj, me buzë të kuqe, me veshje sportive).

Ushtrimi 4. Nxënësit përshkruajnë motrën ose vëllanë sipas modelit të ushtrimit 4.
Motra ime është **e bukur**, **e gjatë**, **e zgjuar**, **e gëzuar**.
Vëllai im është **i dobët**, **i shkathët**, **qaraman**. I kopjojnë fjalitë në fletore.
Hapi 3. Nxënësit përshkruajnë 3-4 cilësi të shokut të bankës në formën e një fjalie. Shkruhen ato në fletore.
Shoku im Andi është i gjatë, i bukur, i shkathët.

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 4. Nxënësit veprojnë në formën e lojës gjëzë për gjetjen e shokut/shoqes sipas cilësive përshkruese.
Shoqja ime është e dobët, e gjatë, e qeshur. ----Cila është ajo?
Hapi 5. Shoqërohet me foto përshkrimi i një personazhi të përrallave/filmave të preferuar nga nxënësit. P.sh. Elsa- flokë të gjata, të verdha, e ndjeshme, e ftohtë, e dobët, e bukur, mbretëresha e dëborës Spiderman- i shkathët, misterioz, i maskuar, i shpejtë, ka veshje të kuqe me vija blu... (njeriu merimangë)

Vlerësimi i situatës:
Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Shqipton saktë dhe me intonacionin e theksin e duhur fjalët dhe fjalitë.
- ✓ Përqendrohet në çështjet kryesore, kur rrëfen një ngjarje ose një përvojë të tijën para shokëve dhe shoqeve, mësuesve dhe prindërve
- ✓ Pyet, përgjigjet, shpreh mendimet, ndjenjat dhe emocionet e tij, si dhe diskuton në grupe të vogla për tema që i interesojnë.
- ✓ Krijon fjali të plota sipas kuptimit.

Detyrë shtëpie:

1. Përshkruaj motrën ose vëllanë me fjalë që tregojnë cilësinë.
2. Vizato dhe përshkruaj një personazh të preferuar filmi.

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1
Tema mësimore: Dielli dhe reja		**Klasa:** 1
Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe** Nxënësi: ➢ ***(1) Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar. ➢ ***(3) Kompetenca e të nxënit:*** Parashtron pyetje dhe përgjigje në lidhje me temën.		**Fjalë kyçe:** *Përrallë, titull, dialog, shenja pikësimi, dialog, dielli, reja, rrezet do të mbarohen,*
***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore** Nxënësi: - Shqipton saktë dhe me intonacionin e theksin e duhur fjalët dhe fjalitë. - Tregon shkurtimisht përmbajtjen e tekstit (rreth një faqe teksti) duke e ilustruar me detaje. - Lidh informacionin e dëgjuar me përvojat e tij ose me informacione që i ka lexuar në tekste të tjera. - Shpreh ndjenjat dhe mendimet personale rreth pjesës që lexon, me ndihmën ose nxitjen e mësuesit *(Si ndjeheni pasi keni lexuar këtë përrallë? A do donit të përfundonte ndryshe?*		**Teknika dhe strategji:** ❖ Parashikim me terma paraprakë ❖ Lexim me ndalesa. ❖ Marrëdhënie pyetje - përgjigje ❖ Lexim me role ❖ Rrjeti i diskutimit
Burimet e informacionit dhe mjete: Njohuritë paraprake të nxënësve, Libri i nxënësit, fletore klase, vizatime ose foto të diellit dhe resë, bojëra, A_4.		**Lidhja me fushat e tjera:** Shkencë, Edukim për shoqërinë

SITUATA E TË NXËNIT

Përshkrimi kontekstual i situatës:

- ***Veprimtari paraprake:***

Hapi 1. Mësuesi/ja shkruan në tabelë titullin: ***"Dielli dhe reja"*** si dhe disa fjalë kyçe të mësimit si: *udhëtonte, falënderojë, numëroi, dhuronte, merrte rrezet e tij*.
Nxit nxënësit të japin mendime rreth figurave dhe fjalëve të shkruara në tabelë. Nxënësit listojnë informacionet që kanë për diellin dhe retë. Mund të krijojnë dhe krijime të shkurtra sipas fantazisë.

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 2. Mësuesi/ja bën prezantimin e tregimit. Kalohet në leximin me ndalesa:
Ndalesa e parë: I gëzuar,... deri te ...pëshpëriste tërë inat:
Mësuesi/ ja pyet

- *Cilët marrin pjesë në përrallë?*
- *Çfarë po bëjnë dielli dhe reja?*
- *Çfarë i tha reja diellit?*

Ndalesa e dytë: - Thatësirë duarthatë,... deri tek .. të të falënderojë.

- *Për çfarë ishte inatosur reja?*
- *Si i përgjigjet dielli resë?*
- *Pse mbeti i pashqetësuar dielli?*

- *Si mendoni se do të veprojë më tej?*

Ndalesa e tretë: Dielli vazhdonte=... deri në fund.

- *Çfarë bëri dielli?*
- *Po reja si përfundoi?*
- *Cili është morali i pjesës?*

Hapi 3. Nxënësit e lexojnë tregimin në heshtje. Më pas ndahen në grupe dhe e lexojnë pjesën me role. Mësuesi/ja tërheq vëmendjen tek intonacioni i përdorur në fjali.

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 4. Nxënësit në dyshe ose individualisht, plotësojnë ushtrimet e fundit të faqes.
Nënvizojnë me të kuqe fjalët që tregojnë si është dielli dhe me blu si është reja. Nxënësit nënvizojnë në tekst fjalë që kanë dy bashkëtingëllore njëra pas tjetrës si p.sh MB, ND

Hapi 5. Mësuesi/ja udhëzon për diskutimet me metodën "Rrjetit i diskutimit" duke argumentuar pro dhe kundër.

PO A mund t'i mbarohen rrezet diellit?Pse? JO

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Shqipton saktë dhe me intonacionin e theksin e duhur fjalët dhe fjalitë.
- ✓ Tregon shkurtimisht përmbajtjen e tekstit (rreth një faqe teksti) duke e ilustruar me detaje.
- ✓ Lidh informacionin e dëgjuar me përvojat e tij ose me informacione që i ka lexuar në tekste të tjera.
- ✓ Shpreh ndjenjat dhe mendimet personale rreth pjesës që lexon, me ndihmën ose nxitjen e mësuesit

Detyrë shtëpie:

1. Lexo tekstin dhe mëso përmbajtjen.
2. Kopjo nga teksti fjalët që i thotë reja Diellit.
3. Kopjo 3 rreshtat e fundit të tekstit.
4. Vizato diellin dhe renë duke biseduar me njëri-tjetrin.

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1
Tema mësimore: Përshkruajmë sende dhe objekte Faqe 71 ushtrimet 2, 3		**Klasa:** 1
Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe** Nxënësi: ➢ ***(1) Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup. ➢ ***(3) Kompetenca e të nxënit:*** Ndjek udhëzimet e dhëna në një tekst për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet. ➢ ***(3) Kompetenca e të nxënit:*** Mbikëqyr në mënyrë të pavarur përparimin e vet në një detyrë, aktivitet duke përdorur teknika të ndryshme për gjetjen e gabimeve (si shënim të gabimeve - vështirësive) dhe i korrigjon ato derisa gjen zgjidhjen. ➢ ***(6) Kompetenca qytetare:*** Diskuton dhe në bashkëpunim me anëtarët e grupit vendos rregullat e punës në grup.		**Fjalë kyçe:** *Cilësi të sendeve* *prej letre, prej metali,* *prej druri, e ndezur,* *prej pambuku, fjali, modeli*
***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:** Nxënësi: - Shqipton saktë dhe me intonacionin e theksin e duhur fjalët dhe fjalitë. - Përqendrohet në çështjet kryesore, kur rrëfen një ngjarje ose një përvojë të tijën para shokëve dhe shoqeve, mësuesve dhe prindërve. - Pyet, përgjigjet, shpreh mendimet, ndjenjat dhe emocionet e tij, si dhe diskuton në grupe të vogla për tema që i interesojnë. - Plotëson fjalitë sipas kuptimit.		**Teknika dhe strategji:** ❖ Lojë- gjëzë ❖ Punë individuale ❖ Shkrim i lirë ❖ Punë në dyshe
Burimet e informacionit dhe mjete: Njohuritë paraprake të nxënësve, fletore pune, objekte, sende ose lodra, foto të sendeve të ndryshme, A4, etiketa me fjalët e re, e prishur...		**Lidhja me fushat e tjera:** Edukim për shoqërinë, Arte

SITUATA E TË NXËNIT

Përshkrimi kontekstual i situatës:

- ***Veprimtari paraprake:***

Hapi 1. Mësuesi/ja iu lexon nxënësve gjëegjëzat dhe iu kërkoj të mendojnë për përgjigjet e sakta.

Mbushur barkun plot me bojë
As nuk flet as nuk dëgjon
Por çfarë ti ke në mendje
Në fletore ai shënon.(stilolapsi)

Pulla, pulla,lule, lule
herë i madh e herë i vogël
fëmijët me qejf e mbajnë
ndonjëherë dhe e çajnë. (topi)

Secili nxënës përshkruan stilolapsin dhe topin.

Mund të listohen edhe tipare të tjera dalluese nga sendet/fotot e sjella vetë nxënësit.

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 2. Mësuesi/ja orienton nxënësit të përshkruajnë objektet/lodrat e sjella duke iu përgjigjur

pyetjeve për të dhënë sa më shumë hollësi. (e hollë, prej letre – fletorja, e rëndë, prej lëkure, e re - anta) Mund të përgatiten edhe etiketa me fjalët *e re, e hollë, i kaltër, punëtor, e prishur, qaraman...* dhe nxënësit iu shtojnë atyre emra të përshtatshëm sipas kuptimit duke i përdorur edhe në fjali.
P.sh. **nxënëse e re, derë e prishur**
Hapi 3. Kalohet në punimin e ushtrimeve të tekstit.
Ushtrimi 2. Nxënësit plotësojnë kuptimin e fjalive duke i lidhur me shigjetë sipas kuptimit.
Fletorja është e hollë/është prej letre.
Buka është e madhe/është prej mielli.
Gozhda është e fortë/është prej metali.
Tavolina është e gjatë/është prej druri.
Çanta është e bukur/është prej lëkure.
Llamba është e ndezur/është prej qelqi.
Bluza është e kuqe/është prej pambuku. Nxënësit lexojnë të plota fjalitë dhe i kopjojnë në fletore ato.
Ushtrimi 3. Nxënësit punojnë përshkrimet me fjali të plota sipas modelit.
Shporta është prej kashte. Shporta është e madhe.
Gozhda është prej metali. Gozhda është e fortë.
Tavolina është prej druri. Tavolina është e gjatë.
Çanta është prej lëkure. Çanta është e bukur.
Llamba është prej qelqi. Llamba është e ndezur.
Bluza është prej pambuku. Bluza është e kuqe.

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 4. Nxënësit përshkruajnë 3-4 cilësi të portofolit të mjeteve të tyre në formën e një fjalie.
Portofoli im është i kuq, i bukur, i trashë.
Hapi 5. Shoqërohet me foto përshkrimi i një objekti ose sendi të sjellë nga nxënësit. Libri – i trashë, i bukur, i ri. Ose iu tregohet nxënësve foto e një objekti dhe iu kërkohet përshkrimi i cilësive.

Vlerësimi i situatës:
Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Shqipton saktë dhe me intonacionin e theksin e duhur fjalët dhe fjalitë.
- ✓ Përqendrohet në çështjet kryesore, kur rrëfen një ngjarje ose një përvojë të tijën para shokëve dhe shoqeve, mësuesve dhe prindërve.
- ✓ Pyet, përgjigjet, shpreh mendimet, ndjenjat dhe emocionet e tij, si dhe diskuton në grupe të vogla për tema që i interesojnë.
- ✓ Krijon fjali të plota sipas kuptimit.

Detyrë shtëpie:

1. Përshkruaj lodrën ose biçikletën me fjalë që tregojnë cilësinë e tyre.
2. Vizato dhe përshkruaj një bluzë të preferuar.

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1
Tema mësimore: **Miqtë e pyllit**		**Klasa:** 1
Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe** Nxënësi: ➢ ***(1) Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: ○ Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar. ○ Lexon me zë një tekst së paku prej gjysmë faqeje të pa lexuar më parë. ➢ ***(3) Kompetenca e të nxënit:*** Parashtron pyetje dhe përgjigje në lidhje me temën.		**Fjalë kyçe:** *Titull, shenja pikësimi. pylli, mikesha, mollëkuqja, milingona, larva, gështenjë, kërpudhë, kësulë,*
***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore** Nxënësi: ✚ Shqipton saktë dhe me intonacionin e theksin e duhur fjalët dhe fjalitë. ✚ Tregon shkurtimisht përmbajtjen e tekstit (rreth një faqe teksti) duke e ilustruar me detaje. ✚ Lidh informacionin e dëgjuar me përvojat e tij ose me informacione që i ka lexuar në tekste të tjera. ✚ Shpreh ndjenjat dhe mendimet personale rreth pjesës që lexon, me ndihmën ose nxitjen e mësuesit *(Si ndjeheni pasi keni lexuar këtë pjesë? A do donit të përfundonte ndryshe?* ✚ Liston cilësitë e personazheve.		**Teknika dhe strategji:** ❖ Parashikim me terma paraprakë ❖ Lexim me ndalesa. ❖ Marrëdhënie pyetje – përgjigje. ❖ Punë në dyshe ❖ Dramatizim
Burimet e informacionit dhe mjete: Njohuritë paraprake të nxënësve, Libri i nxënësit, fletore klase, vizatime ose foto të pyllit dhe gjallesave që jetojnë në të, enciklopedi për fëmijë.		**Lidhja me fushat e tjera:** Shkencë, Edukim për shoqërinë

SITUATA E TË NXËNIT

Përshkrimi kontekstual i situatës:

- ***Veprimtari paraprake:***

Hapi 1. Mësuesi/ja shkruan në tabelë titullin: ***Miqtë e pyllit*** si dhe disa fjalë kyçe të mësimit si: *kërpudhë, mollëkuqe, milingonë, larva, mikesha, jetojnë, shoqe, gështenjë.*
Nxit nxënësit të japin mendime rreth figurave dhe fjalëve të shkruara në tabelë. Nxënësit listojnë informacionet që kanë për pyllin dhe jetesën e gjallesave të ndryshme aty. Nxënësit mund të krijojnë dhe krijime të shkurtra sipas fantazisë së tyre.
Hapi 3. Nxiten nxënësit të tregojnë gjithçka dinë për kërpudhat, milingonat, larvat si dhe pemët si gështenja.

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 2. Mësuesi/ja bën prezantimin e pjesës së tregimit. Kalohet në leximin me ndalesa:
Ndalesa e parë: Në këmbët e një... deri tek ... dhe larva.

Mësuesi/ja pyet:

- *Cilët marrin pjesë?*
- *Çfarë po bënte kërpudha?*
- *Si jetonin tri mikeshat?*
- *Çfarë ndodhi më tej me to?*

Ndalesa e dytë: Erdhi dimri... deri tek ... dhe u larguan.

- *Për çfarë do të mërzitej kërpudha?*
- *Ku vendosën të shkonin mikeshat? Pse?*
- *Si u sollën tri mikeshat me kërpudhën?*

Ndalesa e tretë: Por shoqet... deri në fund.

- *Çfarë bëri kërpudha?*
- *Po shoqet?*
- *Cili është morali i pjesës?*

Hapi 3. Nxënësit e lexojnë tregimin në heshtje. Mësuesi/ja tërheq vëmendjen tek intonacioni i përdorur në fjali.

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 4. Nxënësit në dyshe ose individualisht, plotësojnë ushtrimet në të majtë të faqes për gjetjen e personazheve, përgjigjen e pyetjeve rreth përmbajtjes.

Nxënësi/ja plotësojnë në tabelë mbiemrat që tregojnë cilësitë e personazheve (e bukur, e dashur, e vetmuar, e trembur, mirënjohëse).

Hapi 5. Mësuesi/ja udhëzon për lojë në role duke shtuar vetë fjalët me të cilat komunikuan mikeshat e pyllit me njëra-tjetrën.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Shqipton saktë dhe me theksin e duhur fjalët dhe fjalitë.
- ✓ Tregon shkurtimisht përmbajtjen e tekstit duke e ilustruar me detaje.
- ✓ Lidh informacionin e dëgjuar me përvojat e tij ose me informacione që i ka lexuar në tekste të tjera.
- ✓ Shpreh ndjenjat dhe mendimet personale rreth pjesës që lexon, me ndihmën ose nxitjen e mësuesit.

Detyrë shtëpie:

1. Lexo tekstin dhe mëso përmbajtjen.
2. Shkruaj/listo disa nga miqtë e pyllit.
3. Kopjo 3 rreshtat e fundit të tekstit.
4. Shkruaj cilësitë e personazheve.

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1
Tema mësimore: Fjalët që tregojnë cilësi, Faqe 72		**Klasa:** 1
Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe** Nxënësi: ➢ ***(1) Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup. ➢ ***(3) Kompetenca e të nxënit:*** Ndjek udhëzimet e dhëna në një tekst për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet. ➢ ***(3) Kompetenca e të nxënit:*** Mbikëqyr në mënyrë të pavarur përparimin e vet në një detyrë, aktivitet duke përdorur teknika të ndryshme për gjetjen e gabimeve (si shënim të gabimeve - vështirësive) dhe i korrigjon ato derisa gjen zgjidhjen. ➢ ***(6) Kompetenca qytetare:*** Diskuton dhe në bashkëpunim me anëtarët e grupit vendos rregullat e punës në grup.		**Fjalë kyçe:** *Cilësi, i pastër, i ngrohtë, i lehtë, i butë, i lumtur, i mirë, i shkurtër, kuptim i kundërt, përshkruaj*
***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:** Nxënësi: - Shqipton saktë dhe me intonacionin e theksin e duhur fjalët dhe fjalitë. - Përqendrohet në çështjet kryesore, kur rrëfen një ngjarje ose një përvojë të tijën para shokëve dhe shoqeve, mësuesve dhe prindërve. - Pyet, përgjigjet, shpreh mendimet, ndjenjat dhe emocionet e tij, si dhe diskuton në grupe të vogla për tema që i interesojnë. - Plotëson fjalitë sipas kuptimit. - Përgjigjet për pyetjet e dhëna.		**Teknika dhe strategji:** ❖ Punë në grupe ❖ Punë individuale ❖ Shkrim i lirë ❖ Punë në dyshe ❖ Lojë gjëzë
Burimet e informacionit dhe mjete: Njohuritë paraprake të nxënësve, fletore pune, figura të fotokopjuara, foto të fëmijëve me balona shumëngjyrëshe, A4, etiketa me mbiemra e pastër, e shkurtër, e butë...		**Lidhja me fushat e tjera:** Edukim për shoqërinë, Arte

SITUATA E TË NXËNIT

Përshkrimi kontekstual i situatës:

- ***Veprimtari paraprake:***

Hapi 1. Mësuesi/ja ndan klasën në dy grupe dhe kërkon që nxënësit të vizatojnë dhe listojnë cilësitë e zogut dhe të peshkut. Si është? Nxënësit veprojnë e lexojnë me radhë cilësitë e tyre. Mund të nxiten edhe përmes fotove të sjella nga vetë nxënësit.

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 2. Mësuesi/ja orienton nxënësit të tregojnë fjalët me kuptim të kundërt për etiketat e re- e vjetër ose të lidhin me njëra-tjetrën sipas kuptimit.



Ushtrimi 1. Nxënësit plotësojnë fjalët me kuptim të kundërt duke treguar kujdes.

sipër - poshtë,	i pastër - i papastër	i butë - i shëmtuar
afër - larg,	i ngrohtë - i ftohtë	i bukur - i shëmtuar

vonë - shpejt,	i lehtë - i rëndë	i gëzuar - i hidhëruar
të gjitha - asnjë,	i gabuar - i saktë	i madh - i vogël
para - pas,	i lartë - i ulët	i lumtur - i mërzitur
po - jo.	i shkurtër - i gjatë	i mirë - i keq

Ushtrimi 2. Nxënësit iu përgjigjen pyetjeve.

Në dimër	zogu	Si është?	Zogu është i vogël.
		Çfarë bën?	Zogu shtegton.
	lulet	Si janë?	Lulet janë të vyshkura.
		Çfarë bëjnë?	Lulet thahen.
Në verë	zogu	Si është?	
		Çfarë bën?	
	lulet	Si janë?	
		Çfarë bëjnë?	

Hapi 3. Nxënësit përshkruajnë figurën e librit në **Ushtrimi 3**. Shkruhen përgjigjet e pyetjeve në libër dhe fletore. Kujdes në përgjigjen e pyetjeve me fjali të plota.

Çfarë është? *Kjo është një balonë.*

Kush e ka? *Balonën e ka Miri./E ka Miri.*

Kush e ka në dorë? *Balonën në dorë e ka Miri.*

Si është? *Balona është e bukur.*

Si e ka bishtin? *Balona bishtin e ka me ngjyra.*

A të pëlqen të kesh një të tillë? *Po mua më pëlqen/të kem një të tillë.*

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 4. Shoqërohet me foto përshkrimi i cilësive të një lodre ose objekti të preferuar nga nxënësit. P.sh lapsi- i shkurtër, i ri, i hollë, treni- i gjatë, i vjetër, i bukur. Nxënësit nxiten edhe me fletët e fotokopjuara. Ose bëhet përshkrimi gjej objektin.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Shqipton saktë dhe me intonacionin e theksin e duhur fjalët dhe fjalitë.
- ✓ Përqendrohet në çështjet kryesore, kur rrëfen një ngjarje ose një përvojë të tijën para shokëve dhe shoqeve, mësuesve dhe prindërve.
- ✓ Pyet, përgjigjet, shpreh mendimet, ndjenjat dhe emocionet e tij, si dhe diskuton në grupe të vogla për tema që i interesojnë.
- ✓ Krijon fjali të plota sipas kuptimit.
- ✓ Përgjigjet me fjali të plota.

Detyrë shtëpie:

1. Përshkruaj çantën e shkollës.
2. Vizato dhe përshkruaj një lodër që të pëlqen.

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1
Tema mësimore: Zemërimi i luleve		**Klasa:** 1
Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe** Nxënësi: ➢ ***(1) Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: ○ Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar. ○ Lexon me zë një tekst së paku prej gjysmë faqeje të pa lexuar më parë. ➢ ***(3) Kompetenca e të nxënit:*** Parashtron pyetje dhe përgjigje në lidhje me temën.		**Fjalë kyçe:** *Lule, lëndina, kopshte, parqe, vazo, oborre, zemërimi, shqetësimi, lule natyre natyrale, lule artificiale.*
***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore** Nxënësi: - Shqipton saktë dhe me intonacionin e theksin e duhur fjalët dhe fjalitë. - Tregon shkurtimisht përmbajtjen e tekstit (rreth një faqe teksti) duke e ilustruar me detaje. - Lidh informacionin e dëgjuar me përvojat e tij ose me informacione që i ka lexuar në tekste të tjera. - Shpreh ndjenjat dhe mendimet personale rreth pjesës që lexon, me ndihmën ose nxitjen e mësuesit *(Si ndjeheni pasi keni lexuar këtë pjesë? A do donit të përfundonte ndryshe?* - Tregon ngjashmëritë dhe ndryshimet.		**Teknika dhe strategji:** ❖ Marrëdhënie pyetje–përgjigje. ❖ Punë në dyshe ❖ Lexim me kodim ❖ Lojë roli ❖ Diagrami i Venit
Burimet e informacionit dhe mjete: Njohuritë paraprake të nxënësve, Libri i nxënësit, fletore klase, lloje të ndryshme lulesh, foto të lëndinave me lule, fletë të fotokopjuara për ngjyrosje lulesh, maska lulesh, enciklopedi për fëmijë.		**Lidhja me fushat e tjera:** Shkencë, Edukim për shoqërinë

SITUATA E TË NXËNIT

Përshkrimi kontekstual i situatës:

- ***Veprimtari paraprake:***

Hapi 1. Mësuesi/ja nxit nxënësit të listojnë lloje lulesh që njohin. Japin mendime rreth figurave të paraqitura nga fushat me lule si dhe procesi i rritjes së lules (nga lënda shkencë). Nxënësit mund të recitojnë dhe krijime të shkurtra për lulet/gjëegjëza. P.sh. Lulëkuqja

Ka vello të kuqe,
Mbi flokë të zi,
Në arat me grurë
Ajo bën shtëpi
Lule ja thonë emrin
Cila është, e di?

Trëndafili

Gjemba ka,por s'është ferrë,
Lulëzon në pranverë
Në oborr atë e rritim,
E plehërojmë, e vaditim

Hapi 2. Nxiten nxënësit të tregojnë gjithçka dinë për llojet e luleve: natyrale, të thara, artificiale.

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 3. Mësuesi/ja bën prezantimin e titullit së tregimit ZEMËRIMI I LULEVE. Kalohet në komentin e fjalës zemërim. Mësuesi/ja pyet: Si e kuptoni? Ju ka ndodhur të zemëroheni? Kur/Pse? Po lulet pse mund të zemërohen?

Hapi 4. Hapet libri komentohen figurat dhe kalohet ne lexim në heshtje nga nxënësit të shoqëruar me kodim duke shënuar simbolin L mbi emrin e çdo luleje si dhe N kur lexojnë fjalë që shprehin ndjenja.

Hapi 5. Nxënësit veprojnë për ngjyrosjen e luleve të fotokopjuara i emërtojnë dhe përdorin në fjali ato.

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 6. Nxënësit në dyshe ose individualisht, udhëzohen të plotësojnë Diagramin e Venit për ngjashmëritë dhe ndryshimet mes luleve natyrale dhe artificiale. Në fund lexohen e komentohen.



Hapi 7. Mësuesi/ja udhëzon për lexim në role duke treguar kujdes në intonacionin e zërit gjatë bisedës së luleve ose një dramatizim me maska lulesh. (të përgatitura më parë).

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Shqipton saktë dhe me theksin e duhur fjalët dhe fjalitë.
- ✓ Tregon shkurtimisht përmbajtjen e tekstit duke e ilustruar me detaje.
- ✓ Lidh informacionin e dëgjuar me përvojat e tij ose me informacione që i ka lexuar në tekste të tjera.
- ✓ Shpreh ndjenjat dhe mendimet personale rreth pjesës që lexon, me ndihmën ose nxitjen e mësuesit.

Detyrë shtëpie:

1. Lexo tekstin dhe mëso përmbajtjen.
2. Shkruaj/listo/vizato disa nga lulet që njihni.
3. Kopjo 3-5 rreshtat e tekstit që të pëlqejnë më shumë.
4. Formo 3-5 fjali me emrat e luleve.

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1
Tema mësimore: Fjalët që tregojnë veprime, Faqe 73		**Klasa:** 1
Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe** Nxënësi: ➢ ***(1) Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup. ➢ ***(3) Kompetenca e të nxënit:*** Ndjek udhëzimet e dhëna në një tekst për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet. ➢ ***(3) Kompetenca e të nxënit:*** Mbikëqyr në mënyrë të pavarur përparimin e vet në një detyrë, aktivitet duke përdorur teknika të ndryshme për gjetjen e gabimeve (si shënim të gabimeve - vështirësive) dhe i korrigjon ato derisa gjen zgjidhjen.		**Fjalë kyçe:** *Veprime, shikojmë, flasim, derdhet, tingëllon, derdhet, nxeh, tharton, hapet, lan, pret, ngroh, godet...*
***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:** Nxënësi: - Shqipton saktë dhe me intonacionin e theksin e duhur fjalët dhe fjalitë. - Përqendrohet në çështjet kryesore, kur rrëfen një ngjarje ose një përvojë të tijën para shokëve dhe shoqeve, mësuesve dhe prindërve. - Pyet, përgjigjet, shpreh mendimet, ndjenjat dhe emocionet e tij, si dhe diskuton në grupe të vogla për tema që i interesojnë - Plotëson fjalitë sipas modelit dhe kuptimit. - Përgjigjet për pyetjet e dhëna.		**Teknika dhe strategji:** ❖ Lojë gjëzë ❖ Punë në grupe ❖ Punë individuale ❖ Shkrim i lirë ❖ Punë në dyshe
Burimet e informacionit dhe mjete: Njohuritë paraprake të nxënësve, fletore pune, figura kafshësh e sendesh të fotokopjuara, A4, etiketa me folje që tregojnë veprime lan, pret, tingëllon, leh, mbron, lodra me bateri		**Lidhja me fushat e tjera:** Edukim për shoqërinë, Arte

SITUATA E TË NXËNIT

Përshkrimi kontekstual i situatës:

- ***Veprimtari paraprake:***

Hapi 1. Mësuesi/ja u lexon nxënësve gjëegjëzat:

Me gëzof e bisht të butë
Është një kafshë shtëpiake
Kokë si lepur, veshë të shkurtër
Përmbi faqe mban mustaqe.(macja)

Rritet shumë në fusha/ në familje mbahet
Nënprodukt ka qumështin/ dhe mishi i hahet
herë e kuqërremtë,/ herë lara-lara
emrin e kësaj kafshe/ Kush e thotë e para?!

Si bën ajo? Kush mund ta imitojë?

Nxënësit tregojnë ato që dinë për to duke radhitur edhe cilësitë e tyre. Mund të nxiten edhe përmes fotove apo lodrave të sjella nga vetë nxënësit. Ose iu paraqiten nxënësve etiketat e tregon kush i kryen. Pret---gërshëra....

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 2. Mësuesi/ja orienton nxënësit të lexojnë me vëmendje kërkesat e ushtrimeve. Jepen udhëzime

për punimin e tyre. **Ushtrimi 1.** Nxënësit lidhin fjalët që tregojnë veprim me figurat duke treguar kujdes. Macja – mjaullin, qeni – leh, gomari – pëllet, kali – hingëllin, qengji – blegërin, bleta – gumëzhin. Nxënësit mund t'i përdorin në fjali që mund të shkruhen me shkrim dore në fletore.

Ushtrimi 2. Nxënësit shkruajnë fjali sipas modelit për veprimet që bëjnë kafshët me shkrim shtypi.

Pula kakarit.
Gomari pëllet.
Lopa pëllet.
Kali hingëllin.
Macja mjaullin.
Bleta gumëzhin.

Hapi 3. Nxënësit emërtojnë figurat e librit në **Ushtrimi 3**. Lidhen figurat me veprimet sipas kuptimit. p.sh., lumi-rrjedh, zilja-tingëllon, dielli-ngroh, çadra - mbron, çekiçi - godet, sapuni-lan, gërshëra-pret, limoni-tharton.

Ushtrimi 4. Nxënësit shkruajnë fjali sipas modelit duke përdorur informacionet e marra në ushtrimin e mëparshëm. *Zilja tingëllon. Uji derdhet. Dielli nxeh. Limoni tharton. Sapuni lan. Çadra hapet. Gërshëra pret. Çekiçi godet.*

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 4. Shoqërohet me përgjigje për veprimin që bëjnë sytë, goja, duart.

Me sy – shikojmë, me gojë – flasim, me duar – prekim, me laps – vizatojmë, me gërshërë – presim, me libra – lexojmë. Nxënësit nxiten edhe me fletët e fotokopjuara të tregojnë veprimin që kryen figura e dhënë nga mësuesja apo fotot e sjella. P.sh. zilja tingëllon.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Shqipton saktë dhe me intonacionin e theksin e duhur fjalët dhe fjalitë.
- ✓ Përqendrohet në çështjet kryesore, kur rrëfen një ngjarje ose një përvojë të tijën para shokëve dhe shoqeve, mësuesve dhe prindërve.
- ✓ Pyet, përgjigjet, shpreh mendimet, ndjenjat dhe emocionet e tij, si dhe diskuton në grupe të vogla për tema që i interesojnë.
- ✓ Krijon fjali të plota sipas kuptimit.
- ✓ Përgjigjet pyetjeve.

Detyrë shtëpie:

1. Shkruaj fjalitë e ushtrimit 4.
2. Krijo fjali me fjalët e ushtrimit 3.
3. Vizato tri mjete dhe shkruaj veprimin që kryen. (lapsi shkruan)

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1
Tema mësimore: Legjenda e lulediellit		**Klasa:** 1
Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe** Nxënësi: ➢ ***(1) Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: ○ Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar. ○ Lexon me zë një tekst së paku prej gjysmë faqeje të pa lexuar më parë. ***(3) Kompetenca e të nxënit:*** Parashtron pyetje dhe përgjigje në lidhje me temën.		**Fjalë kyçe:** *Luledielli, legjenda, dielli, Lulet, luleshtrydhe, luledele, lulelakër.*
***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore** Nxënësi: - Shqipton saktë me intonacionin e theksin e duhur fjalët dhe fjalitë. - Tregon shkurtimisht përmbajtjen e tekstit (rreth një faqe teksti) duke e ilustruar me detaje. - Lidh informacionin e dëgjuar me përvojat e tij ose me informacione që i ka lexuar në tekste të tjera. - Zgjeron fjalorin me fjalë dhe shprehje të reja. - Shpreh ndjenjat dhe mendimet personale rreth pjesës që lexon, me ndihmën ose nxitjen e mësuesit *(Si ndjeheni pasi keni lexuar këtë përrallë? A do donit të përfundonte ndryshe).*		**Teknika dhe strategji:** ❖ Alfabeti i njëpasnjëshëm në tryezë. ❖ Marrëdhënie pyetje - përgjigje ❖ Lexim me role ❖ Fragmenti - komenti
Burimet e informacionit dhe mjete: Njohuritë paraprake të nxënësve, Libri i nxënësit, fletore klase, vizatime ose foto të luledielli dhe luledeles, enciklopedi për fëmijë, bojëra, A4.		**Lidhja me fushat e tjera:** Shkencë, Edukim për shoqërinë
SITUATA E TË NXËNIT		
Përshkrimi kontekstual i situatës: ▪ ***Veprimtari paraprake:*** ***Hapi 1.*** Mësuesi/ja shkruan në tabelë titullin: ***"Legjenda e luledielli***t". Nxit nxënësit të japin mendime rreth figurave dhe fjalëve të shkruara në tabelë. Tregojnë edhe informacione që kanë për luledielli dhe përdorimet e saj. ***Hapi 2.*** Nxënësit veprojnë në grupe me nga 4-6 nxënës për realizimin e alfabetit të njëpasnjëshëm me emra lulesh.(iu kërkohet që për rastet që nuk ju kujtohen emra lulesh të veprojnë me shkronjat pasuese pa humbur kohë 3- min). ▪ ***Veprimet në situatë*** ***Hapi 3.*** Mësuesi/ja bën prezantimin dhe komentimin e figurave të tregimit. Kalohet në leximin zinxhir të pjesës duke respektuar intonacionin dhe shenjat e pikësimit. Më pas ndahen në grupe dhe e lexojnë pjesën me role.		

Hapi 4. Nxënësit e lexojnë tregimin në heshtje dhe iu përgjigjen pyetjeve rreth përmbajtjes:
Pse u habitën lulet në kopsht?
Si e kishte emrin lulja që çeli?
Çfarë i dhuroi Dielli lules?

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 5. Nxënësit në dyshe ose individualisht, plotësojnë ushtrimet e fundit të faqes 114 në lidhje me fjalëformimin. (lule+dielli=luledielli, lule+shtrydhe= luleshtrydhe) Iu kërkohet që të nënvizojnë në tekst fjalët që tregojnë veprim. (çeli, talleshin, merr, jepte, kthen, morën...) Cili është mesazhi i pjesës?

Hapi 6. Mësuesi/ja udhëzon për diskutimet me metodën Fragmenti/Komenti duke argumentuar pse. Zgjidh një apo dy fjali që të pëlqejnë më shumë dhe shkruaj pse. (veprohet në A4 me fletë të fotokopjuara)

Fragmenti	Komenti

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Shqipton saktë dhe me intonacionin e theksin e duhur fjalët dhe fjalitë.
- ✓ Tregon shkurtimisht përmbajtjen e tekstit (rreth një faqe teksti) duke e ilustruar me detaje.
- ✓ Lidh informacionin e dëgjuar me përvojat e tij ose me informacione që i ka lexuar në tekste të tjera.
- ✓ Shpreh ndjenjat dhe mendimet personale rreth pjesës që lexon, me ndihmën ose nxitjen e mësuesit.

Detyrë shtëpie:

1. Lexo tekstin dhe mëso përmbajtjen.
2. Kopjo nga teksti fjalët luleve dhe të Diellit.
3. Kopjo 3 rreshtat e fundit të tekstit.
4. Vizato luledielli dhe lulet e tjera duke biseduar me njëra-tjetrën.

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1
Tema mësimore: Fjalët që tregojnë veprime, Faqe 74		**Klasa:** 1
Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe** Nxënësi: ➢ ***(1) Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup. ➢ ***(3) Kompetenca e të nxënit:*** Ndjek udhëzimet e dhëna në një tekst për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet. ➢ ***(3) Kompetenca e të nxënit:*** Mbikëqyr në mënyrë të pavarur përparimin e vet në një detyrë, aktivitet duke përdorur teknika të ndryshme për gjetjen e gabimeve (si shënim të gabimeve - vështirësive) dhe i korrigjon ato derisa gjen zgjidhjen.		**Fjalë kyçe:** *Veprime, çfarë bëjnë, thumb, ka, sqep, lodra, hala, bisedon, luan*
***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:** Nxënësi: - Shqipton saktë dhe me intonacionin e theksin e duhur fjalët dhe fjalitë. - Përqendrohet në çështjet kryesore, kur rrëfen një ngjarje ose një përvojë të tijën para shokëve dhe shoqeve, mësuesve dhe prindërve. - Pyet, përgjigjet, shpreh mendimet, ndjenjat dhe emocionet e tij, si dhe diskuton në grupe të vogla për tema që i interesojnë - Plotëson fjalitë sipas modelit dhe kuptimit. - Përgjigjet për pyetjet e dhëna.		**Teknika dhe strategji:** ❖ Imagjinatë e drejtuar ❖ Punë në grupe ❖ Punë individuale ❖ Shkrim/vizatim i lirë ❖ Punë në dyshe
Burimet e informacionit dhe mjete: Njohuritë paraprake të nxënësve, fletore pune, figura nga libra jashtëshkollorë, A4, etiketa me folje që tregojnë veprime luan, mëson, noton, lan		**Lidhja me fushat e tjera:** Edukim për shoqërinë, Arte

SITUATA E TË NXËNIT

Përshkrimi kontekstual i situatës:

- ***Veprimtari paraprake:***

Hapi 1. Mësuesi/ja iu paraqet nxënësve etiketat me fjalët/ose shkruhen në dërrasë: *Ada, luan*, *noton, Bledi, mëson, lan* dhe kërkon që nxënësit të imagjinojnë një situatë për 5 minuta.

Nxënësit tregojnë 3-4 situata dhe përzgjedhin krijimin më tërheqës. Argumentojnë mendimin për vlerësimin e bërë.

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 2. Mësuesi/ja orienton nxënësit të lexojnë me vëmendje kërkesat e ushtrimeve. Jepen udhëzime për punimin e ushtrimeve.

Ushtrimi 1. Nxënësit shohin figurat dhe tregojnë veprimet që kryejnë fëmijët.

Beni nget biçikletën.

Ana luan me kukull.

Miri ha akullore.

Tani mëson mësimet.

Nxënësit mund të shkruajnë fjalitë në mënyrë të saktë duke përdorur fjalët e dhëna në të djathtë.

Ushtrimi 2. Nxënësit lidhin fjalët e dhëna në mollë sipas kuptimit dhe në rreshtat poshtë tyre shkruajnë fjali duke ndjekur modelin.

Zogu ka sqep.	Shtëpia ka derë.
Mushkonja ka thumb.	Fëmija ka lodra.
Lulja ka gjethe.	Qershia ka bërthamë.
Karroca ka rrota.	Peshku ka hala.
Barka ka vela.	Gjeli ka lafshë.

Hapi 3. Nxënësit të ndarë në grupe vizatojnë dhe përshkruajnë sipas fjalive të dhëna.

Grupi i parë – Shtëpia ka derë.

Grupi i dytë – Karroca ka rrota.

Grupi i tretë – Lulja ka gjethe.

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 4. Nxënësit shkruajnë fjali për figurat e dhëna në ushtrimin 3.

Fëmijët bisedojnë me gjyshin.

Vajzat luajnë me litar.

Vajza mëson mësimet.

Djali shëtit qenin.

Nxënësit nxiten të tregojnë veprimet që kryejnë fëmijët në figurat e librave për fëmijë.

P.sh., *Borëbardha pastron shtëpinë. Dreri drejton slitën. etj*

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Shqipton saktë dhe me intonacionin e theksin e duhur fjalët dhe fjalitë.
- ✓ Përqendrohet në çështjet kryesore, kur rrëfen një ngjarje ose një përvojë të tijën para shokëve dhe shoqeve, mësuesve dhe prindërve.
- ✓ Pyet, përgjigjet, shpreh mendimet, ndjenjat dhe emocionet e tij, si dhe diskuton në grupe të vogla për tema që i interesojnë.
- ✓ Krijon fjali të plota sipas kuptimit.
- ✓ Përgjigjet pyetjeve.

Detyrë shtëpie:

1. Shkruaj fjalitë e ushtrimit 1 me shkrim dore.
2. Kopjo fjalitë e ushtrimit 3.
3. Vizato dy objekte dhe shkruaj çfarë bëjnë me fjali të plota. (Nëna ujit lulet me vaditëse.)

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1
Tema mësimore: Piktura e Edlirës		**Klasa:** 1
Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe** Nxënësi: ➢ ***(1) Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: ○ Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar duke diskutuar në grup. ○ Lexon me zë një tekst së paku prej gjysmë faqeje të pa lexuar më parë. ➢ ***(3) Kompetenca e të nxënit:*** Parashtron pyetje dhe përgjigje në lidhje me temën me njërën nga format e të shprehurit.		**Fjalë kyçe:** *Piktura, vizatimi, këshilla, kali, ngjyra, ngjyros, dysheme, dëshirë*
***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore** Nxënësi: - Shqipton saktë dhe me intonacionin e theksin e duhur fjalët dhe fjalitë. - Tregon shkurtimisht përmbajtjen e tekstit (rreth një faqe teksti) duke e ilustruar me detaje. - Lidh informacionin e dëgjuar me përvojat e tij ose me informacione që i ka lexuar në tekste të tjera. - Shpreh ndjenjat dhe mendimet personale rreth pjesës që lexon, me ndihmën ose nxitjen e mësuesit *(Si ndjeheni pasi keni lexuar këtë pjesë?*		**Teknika dhe strategji:** ❖ Marrëdhënie pyetje – përgjigje. ❖ Punë në dyshe ❖ Lexim me kodim ❖ Lojë roli
Burimet e informacionit dhe mjete: Njohuritë paraprake të nxënësve, Libri i nxënësit, fletore klase, lloje të ndryshme kafshësh, foto, fletë të fotokopjuara për ngjyrosje kafshësh, enciklopedi për fëmijë.		**Lidhja me fushat e tjera:** Shkencë, Edukim për shoqërinë

SITUATA E TË NXËNIT

Përshkrimi kontekstual i situatës:

- ***Veprimtari paraprake:***

Hapi 1. Mësuesi/ja nxit nxënësit të listojnë lloje kafshësh që njohin. Japin mendime rreth fotove të paraqitura për kafshët shtëpiake ose nga enciklopedia për fëmijë. Nxënësit mund të recitojnë dhe krijime të shkurtra për kafshët ose iu kërkohet të gjejnë gjëegjëzën për kalin.

P.sh Kali

Katër këmbë ai ka ,
Është i egër dhe i butë
Mban pesha, transporton
është kafshë që vesh këpucë.

Hapi 2. Nxiten nxënësit të ngjyrosin fletët e fotokopjuara për kalin dhe ti vënë një emër atij. (3-4 min)

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 3. Mësuesi/ja bën prezantimin e titullit së tregimit PIKTURA E EDLIRËS. Kalohet në komentin

e fjalës pikturë. Mësuesi/ja pyet: Çfarë pikturoni më shpesh? Ju ka ndodhur të vizatoni kafshë apo figura të mëdha? Ku i keni vizatuar ato? Po për ngjyrosjen me cilat mjete keni punuar më shumë? Pse?

Hapi 4. Hapet libri komentohen figurat dhe kalohet në lexim në heshtje nga nxënësit të shoqëruar me kodim duke shënuar simbolin M për mjetet si dhe Nj për njerëzit.

Hapi 5. Nxënësit veprojnë për përgjigjen e pyetjeve rreth përmbajtjes të paraqitura në libër.

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 6. Nxënësit në dyshe ose individualisht, mendojnë ti bëjnë një pyetje Edlirës, ose luajnë lojë roli sikur njëra nga nxënëset është Edlira dhe tjetri/a është ai/ajo që e pyet. Nxënësit mund të veprojnë edhe për ritregimin e pjesës.

Hapi 7. Mësuesi/ja udhëzon për lexim në role duke treguar kujdes në intonacionin e zërit gjatë bisedës së mësueses me Edlirën ose një dramatizim i thjeshtë. Shkruhet edhe mesazhi i pjesës në dërrasë.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Shqipton saktë dhe me theksin e duhur fjalët dhe fjalitë.
- ✓ Tregon shkurtimisht përmbajtjen e tekstit duke e ilustruar me detaje.
- ✓ Lidh informacionin e dëgjuar me përvojat e tij ose me informacione që i ka lexuar në tekste të tjera.
- ✓ Shpreh ndjenjat dhe mendimet personale rreth pjesës që lexon, me ndihmën ose nxitjen e mësuesit.

Detyrë shtëpie:

1. Lexo tekstin dhe mëso përmbajtjen.
2. Listo emërto dhe vizato disa nga mjetet që shërbejnë për vizatim.
3. Kopjo 3-5 rreshtat e tekstit që të pëlqejnë më shumë.
4. Shkruaj dy këshilla për Edlirën.

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1
Tema mësimore: Fjalët që tregojnë veprime Faqe 75		**Klasa:** 1
Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe** Nxënësi: ➢ ***(1) Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup. ➢ ***(3) Kompetenca e të nxënit:*** Ndjek udhëzimet e dhëna në një tekst për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet. ➢ ***(3) Kompetenca e të nxënit:*** Mbikëqyr në mënyrë të pavarur përparimin e vet në një detyrë, aktivitet duke përdorur teknika të ndryshme për gjetjen e gabimeve (si shënim të gabimeve - vështirësive) dhe i korrigjon ato derisa gjen zgjidhjen.		**Fjalë kyçe:** *Veprime, dikur, tani, shpjegon, udhëzon, punon, shpenzon, studion, ndriçohej, sharrojmë, lyejmë, fshijmë, unë, ti, ai, ju, ne, ata.*
***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:** Nxënësi: - Shqipton saktë dhe me intonacionin e theksin e duhur fjalët dhe fjalitë. - Përqendrohet në çështjet kryesore, kur rrëfen një ngjarje ose një përvojë të tijën para shokëve dhe shoqeve, mësuesve dhe prindërve. - Pyet, përgjigjet, shpreh mendimet, ndjenjat dhe emocionet e tij, si dhe diskuton në grupe të vogla për tema që i interesojnë. - Plotëson fjalitë sipas modelit dhe kuptimit.		**Teknika dhe strategji:** ❖ Vëzhgim, demonstrim ❖ Punë në grupe ❖ Punë individuale ❖ Shkrim/vizatim i lirë ❖ Punë në dyshe
Burimet e informacionit dhe mjete: Njohuritë paraprake të nxënësve, fletore pune, figura nga libra jashtëshkollorë, A4, tabela me zgjedhim të foljeve, etiketa me përemrat vetorë unë, ti, ai/ajo, ne, ju, ata/ato.		**Lidhja me fushat e tjera:** Edukim për shoqërinë, Arte

SITUATA E TË NXËNIT

Përshkrimi kontekstual i situatës:

- ***Veprimtari paraprake:***

Hapi 1. Mësuesi/ja iu paraqet nxënësve tabelën e zgjedhimit të foljeve KAM e JAM. Bëhet leximi i tyre dhe komentimi i ndryshimeve që pësojnë ato gjatë zgjedhimit. (Nxënësve iu jepen informacione se fjalët që tregojnë veprim zgjedhohen sipas vetave që renditen si më poshtë.)

Unë	Kam	Jam	lexoj
Ti	Ke	Je	lexon
Ai/ajo	Ka	Është	lexon
Ne	Kemi	Jemi	lexojmë
Ju	Keni	Jeni	lexoni
Ata/ato	Kanë	Janë	lexojnë

Iu sugjerohet nxënësve të përdorin ato në fjali me gojë sipas modelit.

P.sh Unë kam libër. Unë jam nxënës. Ti lexon. Ata lexojnë.

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 2. Mësuesi/ja orienton nxënësit të lexojnë me vëmendje kërkesat e ushtrimeve. Jepen udhëzime

për punimin e tyre.

Ushtrimi 1. Nxënësit plotësojnë fjalitë sipas modelit të fjalive pohore dhe mohore.

Unë po bëj mësimet.	Unë nuk po bëj mësimet.
Ti po bën mësimet.	Ti nuk po bën mësimet.
Ai po bën mësimet.	Ai nuk po bën mësimet.
Ne po bëjmë mësimet.	Ne nuk po bëjmë mësimet.
Ju po bëni mësimet.	Ju nuk po bëni mësimet.
Ata po bëjnë mësimet.	Ata nuk po bëjnë mësimet.

Nxënësit mund të shkruajnë fjalitë në mënyrë të saktë duke përdorur si model fjalitë e dhëna në rreshtat e para të ushtrimit. (kujdes ndryshimet që pësojn folja gjatë zgjedhimit)

Ushtrimi 2. Nxënësit shkruajnë fjali me emrat e atyre që bëjnë veprimet e listuara në të majtë.

Shpjegon, udhëzon – *Mësuesja shpjegon dhe udhëzon*.

Vrapon, leh – *Qeni vrapon dhe leh.*

Ha bukë, fruta – *Fëmija ha bukë dhe fruta*.

Punon, shpenzon – *Njeriu punon dhe shpenzon*.

Studion – *Studiuesi studion*.

Hapi 3. **Ushtrimi 3.** Nxënësit të nxitur nga figurat plotësojnë fjalitë duke shoqëruar dhe me argumente e informacione.

DIKUR	TANI
Dikur ndriçohej me qiri.	Tani ndriçohet me llambë.
Dikur lëvizej me karrocë dhe me kalë.	Tani lëvizet me avion dhe autobus.

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 4. Nxënësit shkruajnë emrat e figurave të dhëna në **ushtrimin 4** dhe i lidhin me veprimin që ato kryejnë.

me gërshërë – presim me gjilpërë -- qepim

me fshesë -- fshijmë me çekiç -- mbërthejmë

me furçë – lyejmë me sharrë -- sharrojmë

Nxënësit nxiten të përdorin në fjali disa prej tyre duke ndjekur udhëzimet e **ushtrimin 5**.

P.sh. *Me gërshërë presim letër dhe copë. Me furçë lyejmë mure dhe pallate. Me fshesë fshijmë shtëpinë dhe oborrin etj.*

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Shqipton saktë dhe me intonacionin e theksin e duhur fjalët dhe fjalitë.
- ✓ Përqendrohet në çështjet kryesore, kur rrëfen një ngjarje ose një përvojë të tijën para shokëve dhe shoqeve, mësuesve dhe prindërve.
- ✓ Pyet, përgjigjet, shpreh mendimet, ndjenjat dhe emocionet e tij, si dhe diskuton në grupe të vogla për tema që i interesojnë.
- ✓ Krijon fjali të plota sipas kuptimit.

Detyrë shtëpie:

1. Shkruaj fjalitë e ushtrimit 1 me shkrim dore.
2. Kopjo fjalitë e ushtrimit 3.
3. Vizato dy objekte dhe shkruaj çfarë bëjnë me fjali të plota. (Nëna ujit lulet me vaditëse.)

Refleksione:

<table>
<tr><td>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla: 1</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore: Një gjuhë për të gjithë</td><td>Klasa: 1</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe
Nxënësi:
➢ (1) Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit:
○ Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar.
○ Lexon me zë një tekst së paku prej gjysmë faqeje të pa lexuar më parë.
➢ (3) Kompetenca e të nxënit:
○ Parashtron pyetje dhe përgjigje në lidhje me temën.
○ Ndjek udhëzimet e dhëna për të realizuar një veprim /aktivitet që kërkohet.
➢ (7) Kompetenca digjitale:
Realizon punime origjinale, vetjake duke përdorur figurat e gjetura nga burime informacioni, si një formë për të shprehur emocionet.</td><td>Fjalë kyçe:
Titull, gjuhë, Vjena, koncert, dirigjent, balet, tinguj, melodi, evropianë, amerikanë, aziatikë, australianë, afrikanë, gjuha e muzikës</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore
Nxënësi:
➕ Shqipton saktë dhe me intonacionin e theksin e duhur fjalët dhe fjalitë.
➕ Liston disa vegla muzikore.
➕ Lidh informacionin e dëgjuar me përvojat e tij ose me informacione që i ka lexuar në tekste të tjera.
➕ Shpreh ndjenjat dhe mendimet personale rreth pjesës që lexon, me ndihmën ose nxitjen e mësuesit.
➕ Krijon një orkestër të thjeshtë me vegla muzikore.
➕ Krijon melodi të thjeshta muzikore.</td><td>Teknika dhe strategji:
❖ Stuhi mendimesh/prezan-tim digjital.
❖ Marrëdhënie
❖ pyetje – përgjigje.
❖ Punë në dyshe/individuale
❖ Punë në grup</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet e informacionit dhe mjete: Njohuritë paraprake të nxënësve, Libri i nxënësit, fletore klase, foto të koncertit të Vjenës, vegla muzikore (lodër), videoprojektor, foto ose fletë të fotokopjuara me lloje veglash muzikore.</td><td>Lidhja me fushat e tjera:
Shkencë, Edukim për shoqërinë</td></tr>
<tr><td colspan="3">SITUATA E TË NXËNIT</td></tr>
<tr><td colspan="3">Përshkrimi kontekstual i situatës:
▪ Veprimtari paraprake:
Hapi 1. Mësuesi/ja shkruan në tabelë Koncerti i Vjenës dhe nxit diskutimet përmes pyetjeve:
- Keni dëgjuar për koncertin e Vjenës? Po për kohën kur zhvillohet ai?
- Nxënësit sjellin mendimet/informacionet e tyre, të cilat nëpërmjet diskutimit dhe fotove bëhen më të qarta për të gjithë.
Hapi 2. Në lidhje me koncertin, mësuesi/ja shfaq përmes videoprojektorit fragmente të melodive të përsosura të luajtura në të dhe nxit bashkëbisedimet dhe komentet mes nxënësve.</td></tr>
</table>

Hapi 3. Nxiten nxënësit të tregojnë si ndjehen kur dëgjojnë melodi të tilla.

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 4. Mësuesi/ja bën prezantimin e tekstit. Kalohet në leximin nga nxënësit dhe komentohen fjalët e shprehjet: (Vjena- kryeqyteti i Austrisë, koncert- shfaqje artistike me muzikë, dirigjent- drejtues i orkestrës, balet- lloj kërcimi, tinguj- melodi me vegla muzikore). Nxënësit i përdorin fjalët e fjalorit në fjali.

Hapi 5. Nxënësit e lexojnë tregimin në heshtje. Mësuesi/ja iu kërkon nxënësve të nënvizojnë fjalët që lidhen me muzikën dhe të komentojnë ato. Ju sqarohet nxënësve që gjuha muzikore është një gjuhë që kuptohet nga të gjithë popujt njësoj.

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 6. Nxënësit në dyshe ose individualisht, plotësojnë ushtrimet në fund të faqes 116 për përgjigjet e pyetjeve rreth përmbajtjes.

Nxënësi/ja plotësojnë emrat e veglave muzikore që shohin në figurë (piano, violinë, flaut, bateri).

Hapi 7. Mësuesi/ja udhëzon për lojë në role. Nxënësit improvizojnë një orkestër të vogël në klasë duke imituar tingujt e veglave të ndryshme muzikore si dhe të drejtuara nga një dirigjent. Gjatë kësaj ore mësimore mund të shfrytëzohen nxënësit e talentuar që dinë t'iu bien veglave muzikore për të krijuar një orkestër të vërtetë muzikore dhe realizimin e një melodie të shkurtër.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Shqipton saktë dhe me theksin e duhur fjalët dhe fjalitë.
- ✓ Tregon shkurtimisht për informacionet që merr përmes tekstit.
- ✓ Lidh informacionin e dëgjuar me përvojat e tij ose me informacione që i ka lexuar në tekste të tjera.
- ✓ Shpreh ndjenjat dhe mendimet personale rreth pjesës që lexon, me ndihmën ose nxitjen e mësuesit.
- ✓ Realizon melodi të thjeshta muzikore.

Detyrë shtëpie:

1. Lexo tekstin dhe merr informacione për gjuhën e muzikës.
2. Krijo fjali me fjalët e fjalorit.
3. Listo emrat e disa veglave muzikore.
4. Vizato dhe përshkruaj veglën e preferuar muzikore.

Refleksione:

Informacion shtesë

Koncerti është një ndër ngjarjet muzikore më të ndjekura të botës, i transmetuar nga stacionet televizive të të paktën dyzet vendeve, me një publik prej të paktën një miliard spektatorësh nga çdo pjesë e globit. Përveç muzikës ka edhe kërcime, nga balerinët e Operës së Shtetit, kryer në ambientet e brendshme dhe të jashtme të pallateve historike prestigjioze të Vjenës. Baletet ndiqen, për arsye logjistike, vetëm nga publiku televiziv. Koncerti tradicional i Filarmonikës së Vjenës mbahet që prej vitit 1939 në ditën e parë të vitit 1 Janar në sallën e artë të Musikverein të Vjenës.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1
Tema mësimore: Fjalët që tregojnë veprime, Faqe 76, ushtrimi 1.		**Klasa:** 1
Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe** Nxënësi: ➢ ***(1) Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup. ➢ ***(3) Kompetenca e të nxënit:*** ○ Ndjek udhëzimet e dhëna në një tekst për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet. ○ Mbikëqyr në mënyrë të pavarur përparimin e vet në një detyrë, aktivitet duke përdorur teknika të ndryshme për gjetjen e gabimeve (si shënim të gabimeve - vështirësive) dhe i korrigjon ato derisa gjen zgjidhjen. ○ Grumbullon dhe klasifikon materiale të performancës së vet, për pasurimin e portofolit personal.		**Fjalë kyçe:** *Veprime, çfarë bëjnë, thumb, koha e kryerjes së veprimit, koha, dje, sot, nesër*
***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:** Nxënësi: - Shqipton saktë dhe me intonacionin e theksin e duhur fjalët dhe fjalitë. - Pyet, përgjigjet, shpreh mendimet, ndjenjat dhe emocionet e tij, si dhe diskuton në grupe të vogla për tema që i interesojnë. - Plotëson fjalitë sipas modelit dhe kuptimit. - Përgjigjet për pyetjet e dhëna. - Argumenton mendimin për veprimet e kryera.		**Teknika dhe strategji:** ❖ Alfabeti i njëpasnjëshëm në tryezë ❖ Punë në grupe ❖ Punë individuale ❖ Shkrim/vizatim i lirë
Burimet e informacionit dhe mjete: Njohuritë paraprake të nxënësve, fletore pune, tablo me zgjedhime foljesh, A4, *flipchart*, fletë të fotokopjuara me alfabetin e njëpasnjëshëm, etiketa me fjalë.		**Lidhja me fushat e tjera:** Edukim për shoqërinë, Arte

SITUATA E TË NXËNIT

Përshkrimi kontekstual i situatës:

- ***Veprimtari paraprake:***

Hapi 1. Mësuesi/ja iu kërkon nxënësve të plotësojnë në dyshe ose grupe fletët e fotokopjuara me tabelën: Alfabeti i njëpasnjëshëm me fjalë që tregojnë veprim. Në shkronjat që hasin vështirësi iu kërkohet të lenë vendin bosh dhe të vazhdojnë më tej për rreth 5 minuta.

A-- arrij	b-- blej	c-- cicëron	ç -- çan	d	dh
e	ë	f	g	gj	h
i	j	k	l	ll	m
n	nj	o	p	q	r
rr	s	sh	t	th	u
v	x	xh	y	z	zh

Në fund të punës bëhet leximi i dy- tre prej punimeve.

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 2. Mësuesi/ja orienton nxënësit të tregojnë çfarë kanë kryer dje pasdite, çfarë po kryejnë sot si dhe çfarë do të kryejnë nesër gjithashtu. Jepen udhëzime për përgjigje me fjali të plota.
P.sh *Unë dje shkova në pishina. Tani unë po bëj mësim. Nesër unë do të shkoj në piknik.*
Disa nga fjalitë mund të shkruhen edhe në dërrasën e zezë për të nxitur analizën. Fillimisht nënvizohen fjalët që tregojnë veprim e më pas tregohet për kohën kur është kryer veprimi. Nxënësit tregojnë ndryshimet që vënë re te fjalët që tregojnë veprim që mund të cilësohen edhe si Folje (pjesë e ndryshueshme e ligjëratës).
Ushtrimi 1. Nxënësit shohin e komentojnë figurën si dhe lexojnë kërkesën e ushtrimit që kërkon plotësimin e vendeve bosh me fjalët që tregojnë veprimet e kryera DJE, SOT, NESËR.
Unë lexova lexoj do të lexoj
Unë dola dal do të dal
Ti fole flet do të flasësh...
Nxënësit plotësojnë me kujdes fjalët që tregojnë veprim duke i përshtatur me kohën e kryerjes së veprimit.

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 3. Nxënësit të ndarë në grupe vizatojnë dhe shkruajnë një fjali duke renditur etiketat e dhëna.
Grupi i parë – me bënë kala Ata rërë./*Ata bënë kala me rërë.*
Grupi i dytë – po bëjnë luledele. me tufë Ato /*Ato po bëjnë tufë me luledele*.
Grupi i tretë – do të bëjnë Ata fruta. shportë me / *Ata do të bëjnë shportë me fruta*.
Iu tërhiqet vëmendja të tregojnë kujdes në përdorimin e shkronjës së madhe në fillim të fjalisë dhe pikën në fund të saj.

Vlerësimi i situatës:
Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Shqipton saktë dhe me intonacionin e theksin e duhur fjalët dhe fjalitë.
- ✓ Përqendrohet në çështjet kryesore, kur rrëfen një ngjarje ose një përvojë të tijën para shokëve dhe shoqeve, mësuesve dhe prindërve.
- ✓ Pyet, përgjigjet, shpreh mendimet, ndjenjat dhe emocionet e tij, si dhe diskuton në grupe të vogla për tema që i interesojnë.
- ✓ Krijon fjali të plota sipas kuptimit.

Detyrë shtëpie:

1. Krijo fjali me 6 foljet e para të shtyllës (sot).
2. Kopjo shtyllën e tretë të ushtrimit 1 (nesër).

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1
Tema mësimore: Miq nga hapësira		**Klasa:** 1
Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe** Nxënësi: ➢ ***(1)Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: ○ Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar. ○ Lexon me zë një tekst së paku prej gjysmë faqeje të pa lexuar më parë. ➢ ***(3)Kompetenca e të nxënit:*** ○ Parashtron pyetje dhe përgjigje në lidhje me temën. ○ Ndjek udhëzimet e dhëna për të realizuar një veprim /aktivitet që kërkohet. ➢ ***(5) Kompetenca personale:*** Bashkëpunon me të tjerët pavarësisht aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitetet në klasë.		**Fjalë kyçe:** *Hapësira, disk, fjalorth, jashtëtokësor, fluturim, disku fluturues, planet, aeroplan, qyteti, trembën, frikësuar, imagjinoj*
***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore** Nxënësi: - Shqipton saktë dhe me intonacionin e theksin e duhur fjalët dhe fjalitë. - Liston disa mjete të fluturimit në hapësirë. - Lidh informacionin e dëgjuar me përvojat e tij ose me informacione që i ka lexuar në tekste të tjera. - Shpreh ndjenjat dhe mendimet personale rreth pjesës që lexon, me ndihmën ose nxitjen e mësuesit. - Dramatizon pjesën.		**Teknika dhe strategji:** ❖ Stuhi mendimesh ❖ Marrëdhënie ❖ pyetje – përgjigje. ❖ Punë në dyshe/individuale ❖ Lexim me kodim ❖ Punë në grup
Burimet e informacionit dhe mjete: Njohuritë paraprake të nxënësve, Libri i nxënësit, A4, disk fluturues, maskë ose veshje jashtëtokësori, aeroplan, enciklopedi për fëmijë.		**Lidhja me fushat e tjera:** Shkencë, Edukim për shoqërinë, arte
SITUATA E TË NXËNIT		
Përshkrimi kontekstual i situatës: ▪ ***Veprimtari paraprake:*** ***Hapi 1.*** Mësuesi/ja shkruan në tabelë titullin e tregimit ***Miq nga hapësira*** dhe nxit diskutimet përmes pyetjeve: - Kush janë disa nga mjetet që fluturojnë në hapësirë? Po për jashtëtokësorët çfarë dini? - Nxënësit sjellin mendimet/informacionet e tyre, të cilat nëpërmjet diskutimit të shoqëruara me foto bëhen më të qarta për të gjithë. ***Hapi 2.*** Në lidhje me diskun fluturues mësuesi/ja paraqet foto e lexon informacione nga enciklopeditë dhe nxit bisedimet dhe komentet mes nxënësve. ***Hapi 3.*** Nxiten nxënësit të tregojnë ngjashmëritë dhe ndryshimet mes diskut fluturues dhe mjeteve të		

tjera fluturuese si avioni, helikopteri.

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 4. Mësuesi/ja bën prezantimin e figurës dhe tekstit. Kalohet në komentin e figurës nga nxënësit. Lexohet zinxhir dhe komentohen fjalët e shprehjet: (disk- mjet fluturues, hapësirë- qielli, jashtëtokësor- qenie që nuk jeton në Tokë/Ufo). Nxënësit i përdorin fjalët e fjalorit në fjali.

Hapi 5. Nxënësit e lexojnë tregimin në heshtje. Mësuesi/ja iu kërkon nxënësve të shënojnë simbolet M- mjete fluturuese, N- ndjenja, F- fëmijët për fjalët dhe të komentojnë ato. *Ju sqarohet nxënësve që astronomia është shkencë që përfshin vrojtimin dhe shpjegimin e dukurive që ndodhin jashtë Tokës dhe atmosferës së saj. Ajo studion prejardhjen, zhvillimin, vetitë fizike dhe kimike të të gjitha trupave jashtë tokësorë që mund të vrojtohen në qiell, së bashku me të gjitha proceset (ecuritë) në të cilat ato përfshihen.*

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 6. Nxënësit në dyshe ose individualisht, plotësojnë ushtrimet në fund të faqes 117 për përgjigjet e pyetjeve rreth përmbajtjes.

Nxënësi/ja nënvizojnë në tregim fjalët që kanë në trup shkronjën –ë-. Në fund të punës bëhet leximi i fjalëve të nënvizuara e përdorimi në fjali i disave prej tyre.

Hapi 7. Mësuesi/ja udhëzon për lojë në role. Nxënësit improvizojnë një situatë gjatë takimit me një jashtëtokësor dhe biseda e Gimit me jashtëtokësorin duke përdorur edhe elementë të fantazisë së tyre. Nxënësit mund të ndahen në grupe për dramatizim dhe të vlerësojnë grupet më të saktë e të veçantë.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Shqipton saktë dhe me theksin e duhur fjalët dhe fjalitë.
- ✓ Tregon shkurtimisht përmbajtjen e tekstit.
- ✓ Lidh informacionin e dëgjuar me përvojat e tij ose me informacione që i ka lexuar në tekste të tjera.
- ✓ Shpreh ndjenjat dhe mendimet personale rreth pjesës që lexon, me ndihmën ose nxitjen e mësuesit.

Detyrë shtëpie:

1. Lexo tekstin dhe merr informacione për jashtëtokësorët.
2. Krijo fjali me fjalët e faqes 117.
3. Kopjo fjalët që mbarojnë me –ë-.
4. Vizato dhe përshkruaj një disk fluturues/jashtëtokësor.

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1
Tema mësimore: Fjalët që tregojnë veprime Faqe 76 ushtrime 2, 3		**Klasa:** 1
Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe** Nxënësi: ➢ ***(1) Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup. ➢ ***(3) Kompetenca e të nxënit:*** ○ Ndjek udhëzimet e dhëna në një tekst për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet. ○ Mbikëqyr në mënyrë të pavarur përparimin e vet në një detyrë, aktivitet duke përdorur teknika të ndryshme për gjetjen e gabimeve (si shënim të gabimeve - vështirësive) dhe i korrigjon ato derisa gjen zgjidhjen. ○ Grumbullon dhe klasifikon materiale të performancës së vet, për pasurimin e portofolit personal.		**Fjalë kyçe:** *Veprime, çfarë bëjnë, koha, dje, sot, nesër, isha, jam, do të jem, dje, pardje, sot, tani, nesër, pasnesër, pas një muaji viti, dite, muaji.*
***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:** Nxënësi: - Shqipton saktë dhe me intonacionin e theksin e duhur fjalët dhe fjalitë. - Përqendrohet në çështjet kryesore, kur rrëfen një ngjarje ose një përvojë të tijën para shokëve dhe shoqeve, mësuesve dhe prindërve. - Pyet, përgjigjet, shpreh mendimet, ndjenjat dhe emocionet e tij, si dhe diskuton në grupe të vogla për tema që i interesojnë. - Plotëson fjalitë sipas modelit dhe kuptimit.		**Teknika dhe strategji:** ❖ Imagjinatë e drejtuar ❖ Punë në grupe ❖ Punë individuale ❖ Shkrim/vizatim i lirë ❖ Punë në dyshe
Burimet e informacionit dhe mjete: Njohuritë paraprake të nxënësve, fletore pune, fotografi personale bebe/në shkollë/shtëpi, A4.		**Lidhja me fushat e tjera:** Edukim për shoqërinë, Arte,

SITUATA E TË NXËNIT

Përshkrimi kontekstual i situatës:

- ***Veprimtari paraprake:***

Hapi 1. Mësuesi/ja iu paraqet nxënësve etiketat me fjalitë/i shkruan në dërrasë:

Mësuesja lexon librin. **Nxënësit lexojnë librin.**

Diskutohet për ngjashmëritë dhe ndryshimet mes fjalive. Kujtohet fakti që fjalët që shprehin veprim ndryshojnë jo vetëm sipas kohës kur kryhet veprimi por edhe sipas numrit të atyre që e kryejnë veprimin.

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 2. Mësuesi/ja orienton nxënësit të lexojnë me vëmendje kërkesat e ushtrimeve. Jepen udhëzime për punimin e tyre duke treguar ruajtur kuptimin.

Ushtrimi 2. Nxënësit plotësojnë fjalitë sipas kuptimit duke i përshtatur me kohën e kryerjes së tyre.

Gjashtë vjet më parë, unë isha bebe/foshnje.

Tani unë jam nxënës shkolle/7 vjeç.
Pas disa vitesh, unë do të jem i/e rritur.
Nxënësit mund të shkruajnë fjalitë në mënyrë të saktë me disa alternativa duke përdorur fjalë nga bagazhi i fjalorit të tyre.
Ushtrimi 3. Nxënësit plotësojnë fjalitë sipas kuptimit duke respektuar ndryshimet që pësojnë foljet si në kohën kur është kryer veprimi edhe ne numër.
Gjashtë vjet më parë ne ishim bebe./foshnje.
Tani ne jemi nxënës shkolle/7 vjeçarë.
Pas disa vitesh, ne do të jemi të rritur.

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 4. Nxënësit shkruajnë fjali për fotot e sjella.
Nxënësit nxiten të shkruajnë fjali rreth tyre.
P.sh. *Unë kur isha i vogël vetëm qaja. Kur të rritem do të bëhem doktor. Etj.*

Vlerësimi i situatës:
Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Shqipton saktë dhe me intonacionin e theksin e duhur fjalët dhe fjalitë.
- ✓ Përqendrohet në çështjet kryesore, kur rrëfen një ngjarje ose një përvojë të tijën para shokëve dhe shoqeve, mësuesve dhe prindërve.
- ✓ Pyet, përgjigjet, shpreh mendimet, ndjenjat dhe emocionet e tij, si dhe diskuton në grupe të vogla për tema që i interesojnë.
- ✓ Krijon fjali të plota sipas kuptimit.

Detyrë shtëpie:

1. Shkruaj me 5-6 fjali si keni ndryshuar në vite.
2. Kopjo fjalitë e 2 rreshtave të fundit të dy ushtrimeve 2, 3.

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1
Tema mësimore: **Kur nuk kishte telefon**		**Klasa:** 1
Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe** Nxënësi: ➢ ***(1) Kompetenca e komunikim dhe të shprehurit: Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup. ➢ ***(3) Kompetenca e të nxënit:*** Parashtron pyetje dhe përgjigje në lidhje me temën. ➢ ***(4) Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin:*** Gjen të përbashkëtat dhe ndryshimet ndërmjet aktiviteteve, që organizohen në shkollë me ato në shtëpi dhe i përshkruan në mënyrë individuale përmes njërës nga format e të shprehurit duke i diskutuar në grup.		**Fjalë kyçe:** *telefon, telefon i prishur, komunikim, sinjali i tymit, lajmëtarët, tamburet, reja e tymit, lashtësi,*
***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore** Nxënësi: - Shqipton saktë dhe me intonacionin e theksin e duhur fjalët dhe fjalitë. - Lidh informacionin e dëgjuar me përvojat e tij ose me informacione që i ka lexuar në tekste të tjera. - Lexon në mënyrë të vetëdijshme. - Shpreh ndjenjat dhe mendimet personale rreth pjesës që lexon, me ndihmën ose nxitjen e mësuesit.		**Teknika dhe strategji:** ❖ Lojë "Telefoni i prishur" ❖ Imagjinatë e drejtuar ❖ Marrëdhënie pyetje – përgjigje ❖ Lexim me kodim ❖ Punë individuale ❖ Rrjeti i diskutimit
Burimet e informacionit dhe mjete: Njohuritë paraprake të nxënësve, Libri i nxënësit, fletore klase, telefon lodër, gota plastike fije/spango, A4.		**Lidhja me fushat e tjera:** Edukim për shoqërinë, Arte

SITUATA E TË NXËNIT

Përshkrimi kontekstual i situatës:

- ***Veprimtari paraprake:***

Hapi 1. Me nxënësit zhvillohet një lojë me titull "Telefoni i prishur" ku nxënësit pasojnë në vesh te njëri-tjetri fjalën e zgjedhur nga i pari deri tek i fundit. Nxënësit që e thonë gabim fjalën digjen nga loja.(veprohet 3-5min) Me nxënësit mund të zhvillohet edhe loja me mjetin e përgatitur si telefon me gota plastike dhe fije/spango.

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 2. Mësuesi/ja drejton imagjinatën e nxënësve si do të vepronit nëse një ditë do të ishit pa telefon. Dëgjohen mendimet e nxënësve e më pas kalohet në komentet e figurave të faqes 118.
Iu drejtohen pyetje si komunikoni tani me njëri-tjetrin? Po me ata që keni larg? Po më parë e dini si komunikonin njerëzit me njëri-tjetrin?
Hapi 3. Kalohet në leximin me kodim të tekstit duke shënuar M- fjalët që tregojnë mjetet e ndryshme të komunikimit. Fjalët e shënuara kopjohen në A4 e më pas kalohet në komentet rreth tyre. (telefonin, mjete, tamburet, sinjali i tymit, zjarre të mëdha...)
Hapi 4. Nxënësit veprojnë për t'ju dhënë përgjigje pyetjeve rreth tekstit të faqes 118.

Hapi 5. Nxënësit të ndarë në grupe tregojnë mënyrat e përdorimit të mjeteve të ndryshme telefon, kompjuter, zarfi me letra, posta elektronike (mail...).

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 6. Punohet me Rrjetin e diskutimit. Nxënësit tregojnë edhe për situata që i kanë zgjidhur me telefon.

A është mjet i domosdoshëm komunikimi telefoni? Pse?

PO JO

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Shqipton saktë dhe me intonacionin e theksin e duhur fjalët dhe fjalitë.
- ✓ Lidh informacionin e dëgjuar me përvojat e tij ose me informacione që i ka lexuar në tekste të tjera.
- ✓ Shpreh ndjenjat dhe mendimet personale rreth pjesës që lexon, me ndihmën ose nxitjen e mësuesit.

Detyrë shtëpie:

1. Vizato dhe përshkruaj një mjet të komunikimit.
2. Ndaj në rrokje fjalët që shprehin mjetet e komunikimit.
3. Krijo fjali me fjalët e fjalorit.

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1
Tema mësimore: Përshkruajmë ditëlindjen Faqe 77		**Klasa:** 1
Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe** Nxënësi: ➢ ***(1) Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup. ➢ ***(3) Kompetenca e të nxënit:*** Ndjek udhëzimet e dhëna në një tekst për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë, që kërkohet. ➢ ***(3) Kompetenca e të nxënit:*** Mbikëqyr në mënyrë të pavarur përparimin e vet në një detyrë, aktivitet duke përdorur teknika të ndryshme për gjetjen e gabimeve (si shënim të gabimeve - vështirësive) dhe i korrigjon ato derisa gjen zgjidhjen. ➢ ***(6) Kompetenca qytetare:*** Diskuton dhe në bashkëpunim me anëtarët e grupit vendos rregullat e punës në grup.		**Fjalë kyçe:** *Fjalë, grup fjalësh, atmosferë festive, ditëlindje.*
***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:** Nxënësi: - Shkruan tregime të thjeshta nisur nga figurat e dhëna. - Përshkruan me fjalët e tij si e kupton një pikturë, një pamje apo një fotografi. - Përshkruan një situatë ditëlindje, duke plotësuar fjalët që mungojnë. - Rrëfen histori e përvoja personale duke u ndihmuar nga pyetjet: *Kush? Cili? Çfarë? Si? Kur? Ku?*		**Teknika dhe strategji:** ❖ Diskutim paraprak ❖ Punë individuale ❖ Shkrim i lirë ❖ Diskutim ❖ Lojë me role
Burimet e informacionit dhe mjete: Njohuritë paraprake të nxënësve, fletore pune, foto të ditëlindjeve të nxënësve, objekte zbukurimi me letra me ngjyrë.		**Lidhja me fushat e tjera:** Muzikë, Art pamor.

SITUATA E TË NXËNIT

Përshkrimi kontekstual i situatës:

- ***Veprimtari paraprake:***

Hapi 1. Mësuesi/ja kontrollon datëlindjet e fëmijëve dhe nëse në njërën nga këto ditë, një nga nxënësit e klasës ka ditëlindjen, atëherë këtë orë mësimi e planifikon në njërën nga këto ditë, duke bërë ndryshimet në plan.

Nxënësit këshillohen të sjellin foto dhe DVD nga ditëlindjet e tyre dhe nxiten të përshkruajnë duke sjellë në klasë dhe emocionet e asaj dite.

Këndohet kënga e ditëlindjes. Mësuesi/ja kujdeset që në klasë të krijohet atmosfera festive e ditëlindjes.

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 2. Mësuesi/ja orienton nxënësit të përshkruajnë fotografitë, duke dhënë sa më shumë hollësi.

Ushtrimi 1. Nxënësit plotësojnë tekstin me fjalët dhe grupet e fjalëve e dhëna.

Festa e ditëlindjes

Sot unë ***kam*** ditëlindjen. Mbush ***shtatë*** vjeç. Në ditëlindje kam ftuar ***shokët*** e mi të klasës. Ne ***po*** festojmë së bashku. Shokët ***më kanë*** sjellë shumë ***dhurata***. Lili më ka sjellë ***një tren***. Miri më ka ***sjellë*** një album. Unë jam shumë ***i lumtur.*** Në tavolinë, mami ka ***përgatitur*** shumë ***gjëra***. Një ***tortë*** e madhe është në mes ***të tavolinës***. Kemi blerë ***lëng frutash*** e ***çokollata***. Sa bukur po e festoj ***ditëlindjen*** këtë vit!

Ushtrimi 2. Nxënësit do të përshkruajnë ditëlindjen e tyre ose të një personi ta dashur, motra, vëllai, një shok ose shoqe.

Për nxënësit që kanë vështirësi mësuesi/ja mund të shkruajë disa pyetje ndihmëse.

- *Kur e festove ditëlindjen?*
- *Ku e festove?*
- *Si e festove?*
- *Cilët ishin të ftuar?*
- *Çfarë dhuratash more?*

Hapi 3. Nxënësit lexojnë përshkrimet e bëra dhe diskutojnë për përshkrimin më të mirë. Nxiten nxënësit të argumentojnë përgjigjet e dhëna.

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 4. Lojë me role

Improvizohet një situatë ditëlindje në klasë. Në orën e artit pamor, nxënësit kanë përgatitur zbukurime me letra me ngjyrë, të cilat i vendosin në klasë duke krijuar një ambient festiv. Këndohen këngë të mësuara në muzikë dhe kërcehen motive popullore dhe ritmike.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Shkruan tregime të thjeshta nisur nga figurat e dhëna.
- ✓ Përshkruan me fjalët e tij si e kupton një pikturë, një pamje apo një fotografi.
- ✓ Përshkruan një situatë ditëlindje, duke plotësuar fjalët që mungojnë.
- ✓ Rrëfen histori e përvoja personale duke u ndihmuar nga pyetjet: *Kush? Cili? Çfarë? Si? Kur? Ku?*

Detyrë shtëpie:

1. Vizato një festë ditëlindjeje.
2. Përshkruaj një festë ditëlindje duke përdorur elemente fantastikë, p.sh., një festë ditëlindje e festuar në Hënë ose me të ftuar personazhe të filmave vizatimorë.

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1
Tema mësimore: Flasim për filmat vizatimorë, faqe 119		**Klasa:** 1
Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe** Nxënësi: ➢ ***(1) Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: Shpreh me gojë dhe me shkrim për 3-5 minuta para moshatarëve dhe të tjerëve përjetimet dhe emocionet që e kanë shoqëruar gjatë shikimit të një filmi ose dokumentari, dëgjimit të një tregimi apo përralle. ➢ ***(4) Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin:*** Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në shtëpi. ➢ ***(6) Kompetenca personale:*** Bashkëpunon me të tjerët pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitetet në klasë, shkollë apo jashtë saj.		**Fjalë kyçe:** *Film vizatimor, tituj, personazhe, dialog, të preferuar, interpretim etj.*
***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:** Nxënësi: - Shqipton saktë dhe me intonacionin e theksin e duhur fjalët dhe fjalitë. - Merr pjesë në lojë me role (me ndihmën e mësuesit ose të një të rrituri) dhe shpreh opinionet e tij rreth interpretimit të shokëve dhe shoqeve të klasës. - Shpreh pëlqim dhe interes ndaj tekstit që dëgjon: (*Më pëlqen kjo që po dëgjoj!*).		**Teknika dhe strategji:** ❖ Harta e mendimeve ❖ Shikim i një filmi vizatimor ❖ Diskutim ❖ Lojë me role
Burimet e informacionit dhe mjete: Njohuritë paraprake të nxënësve, DVD me filma vizatimorë, veshje të personazheve të ndryshme.		**Lidhja me fushat e tjera:** Arte, Edukim për shoqërinë

SITUATA E TË NXËNIT

Përshkrimi kontekstual i situatës:

- ***Veprimtari paraprake:***

Hapi 1. Mësuesi/ja nxit nxënësit të diskutojnë për filmat vizatimorë që pëlqejnë dhe personazhet e tyre të preferuar. Shkruhen në tabelë disa tituj të filmave vizatimorë së bashku me personazhet në formën e hartës së mendimeve p.sh.



- ***Veprimet në situatë***

Hapi 2. Mësuesi/ja në bashkëpunim me nxënësit kanë zgjedhur një film vizatimor, të cilin e shohin së

bashku. Nxiten të diskutojnë rreth tij.

- *Si është titulli?*
- *Cilët janë personazhet kryesore?*
- *Cilët janë personazhe të tjera?*
- *Kur zhvillohet ngjarja?*
- *Ku zhvillohet ngjarja?*
- *Si ka ndodhur?*
- *Pse ka këtë përfundim?*
- *Çfarë do të doje ndryshe?*
- *Çfarë mësoni nga filmi?*
- *Gjej një fund tjetër për filmin.*

Hapi 3. Nxiten nxënësit të tregojnë përmbajtjen e filmave të tjerë vizatimorë që ata pëlqejnë.
Mund të ndihmohen me pyetje të ngjashme me ato të mësipërmet.
Udhëzohen nxënësit e tjerë të bëjnë pyetje rreth asaj që dëgjojnë për të kuptuar më mirë përmbajtjen e asaj që dëgjojnë.

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 4. Nxënësit janë përgatitur më parë për të luajtur me role një pjesë të filmit vizatimor që ata pëlqejnë. Ata janë përgatitur me veshje dhe maska. Zhvillohet një lojë me role.
Bëhen konkluzionet dhe vlerësimet.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- Shqipton saktë dhe me intonacionin e theksin e duhur fjalët dhe fjalitë.
- Merr pjesë në lojë me role (me ndihmën e mësuesit ose të një të rrituri) dhe shpreh opinionet e tij rreth interpretimit të shokëve dhe shoqeve të klasës.
- Shpreh pëlqim dhe interes ndaj tekstit që dëgjon: (*Më pëlqen kjo që po dëgjoj!*).

Detyrë shtëpie:

1. Shkruaj titujt e filmave vizatimorë që pëlqejnë.
2. Përshkruaj me shkrim një film vizatimor.
3. Shkruaj mesazhin e filmit që ndoqët.

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1
Tema mësimore: Përshkruajnë ditë pushimi Faqe 78		**Klasa:** 1
Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe** Nxënësi: ➢ ***(1) Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Shkruan një tekst të shkurtër (gjysmë faqe për një temë të caktuar) ➢ ***(3) Kompetenca e të nxënit:*** Ndjek udhëzimet e dhëna në një tekst për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë, që kërkohet. ➢ ***(6) Kompetenca qytetare:*** Diskuton dhe në bashkëpunim me anëtarët e grupit vendos rregullat e punës në grup.		**Fjalë kyçe:** *Fjalë, fjali, tregim, përshkrim, pyetje, pranë, lodra, kohë*
***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:** Nxënësi: ➕ Përshkruan me fjalët e tij si e kupton një pikturë, një pamje apo një fotografi. ➕ Rrëfen histori e përvoja personale duke u ndihmuar nga pyetjet: *Kush? Cili? Çfarë? Si? Kur? Ku?* ➕ Pyet për t'u sqaruar rreth tekstit që do të shkruajë.		**Teknika dhe strategji:** ❖ Diskutim paraprak ❖ Punë individuale ❖ Diskutim - Argumentim ❖ Shkrim i lirë
Burimet e informacionit dhe mjete: Njohuritë paraprake të nxënësve, fletore pune, libra jashtëshkollorë, foto të nxënësve nga ditët e pushimit me familjen.		**Lidhja me fushat e tjera:** Dituri natyre, Edukim për shoqërinë.

SITUATA E TË NXËNIT

Përshkrimi kontekstual i situatës:

- ***Veprimtari paraprake:***

Hapi 1. Mësuesi/ja kërkon nga nxënësit të tregojnë se ku i kalojnë ditët e pushimit e fundjavat.

- *Ku shkoni?*
- *Me cilët shkoni?*
- *Me çfarë shkoni?*
- *Çfarë ju pëlqen më shumë të bëni?*
- *Ç'mbresa dhe kujtime ju kanë mbetur në mendje?*

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 2. **Ushtrimi 1.** Nxënësit orientohen të shohin figurën dhe të diskutojnë rreth saj. Udhëzohen nxënësit të shohin të gjitha detajet. Ndihmohen me pyetje ndihmëse.

- *Si është koha?*
- *Sa persona janë?*
- *Ku kanë shkuar?*
- *Çfarë po bëjnë?*
- *Si kaloi dita?*

Hapi 3. Nxënësit shkruajnë tekstin duke plotësuar fjalët që mungojnë, në mënyrë të pavarur.

Unë, mami dhe babi shkuam në *piknik.* Ne qëndruam në breg të *detit*. Babi mori *grepin* dhe shkoi të *peshkonte*. Ai po zë shumë *peshq*. Sa shumë *peshq* zuri ai sot ! Mami po përgatit *drekën.* Ajo po

pjek peshkun. Shikoni Umin! Çfarë po bën ai? *Ai po luan.* Edhe unë po luaj me *top.* Ne qëndruam *në bregdet* gjithë ditën. Sa shumë u kënaqëm!

Ushtrimi 2. Sot shkuam në mal.
Atje ishte *shumë bukur.*
U takuam *me shokë e shoqe.*
Kishim marrë me vete *ushqime e lodra.*
Qëndruam *disa orë.*
Kur u kthyem *në qytet nuk ndjemë lidhje.*

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 4. Mësuesja udhëzon nxënësit të përshkruajnë një ditë në piknik me familjen e tyre. Nxënësit lexojnë përshkrimet dhe japin mendime për përshkrimet e shokëve. Zgjidhen punët më të mira.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- Përshkruan me fjalët e tij si e kupton një pikturë, një pamje apo një fotografi.
- Rrëfen histori e përvoja personale duke u ndihmuar nga pyetjet: *Kush? Cili? Çfarë? Si? Kur? Ku?.*
- Pyet për t'u sqaruar rreth tekstit që do të shkruajë.

Detyrë shtëpie:

1. Paraqit me vizatim një ditë pushimi me familjen.
2. Shkruaj një ditë pikniku duke përdorur elemente dhe personazhe jorealë (fantastikë).

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1
Tema mësimore: Përshkruajmë një ditë me shi. Faqe 79		**Klasa:** 1
Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe** Nxënësi: ➢ ***(1) Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup. ➢ ***(3) Kompetenca e të nxënit:*** Ndjek udhëzimet e dhëna në një tekst për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë, që kërkohet. ➢ ***(3) Kompetenca e të nxënit:*** Mbikëqyr në mënyrë të pavarur përparimin e vet në një detyrë, aktivitet duke përdorur teknika të ndryshme për gjetjen e gabimeve (si shënim të gabimeve - vështirësive) dhe i korrigjon ato derisa gjen zgjidhjen. ➢ ***(6) Kompetenca qytetare:*** Diskuton dhe në bashkëpunim me anëtarët e grupit vendos rregullat e punës në grup.		**Fjalë kyçe:** *Fjalë, fjali, tregim, përshkrim, mot, shi.*
***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:** Nxënësi: - Shkruan tregime të thjeshta nisur nga figurat e dhëna. - Përshkruan me fjalët e tij si e kupton një pikturë, një pamje apo një fotografi. - Pyet për t'u sqaruar rreth tekstit që do të shkruajë.		**Teknika dhe strategji:** ❖ Dëgjim muzikor ❖ Punë individuale ❖ Shkrim i lirë ❖ Diskutim
Burimet e informacionit dhe mjete: Njohuritë paraprake të nxënësve, fletore pune, libra jashtëshkollorë, pamje nga koha me shi, Cd, magnetofon.		**Lidhja me fushat e tjera:** Dituri natyre, Muzikë

SITUATA E TË NXËNIT

Përshkrimi kontekstual i situatës:

- ***Veprimtari paraprake:***

Hapi 1. Nxënësit dëgjojnë këngën " Shi shi lagashi", të cilën mësuesi/ja mund ta gjejë në linkun e mëposhtëm.

https://www.youtube.com/watch?v=5l7o6NkM61k

Nxit nxënësit të përshkruajnë mbresa dhe ndodhi nga një ditë me shi. Ndihmohen nga pyetjet:

- *Si bëhet qielli kur bie shi?*
- *Në cilën stinë bie më shumë shi?*
- *Si është shiu kur të prek?*
- *Si formohet shiu?*

Mësuesi/ja ka porositur nxënësit ose ka sjellë vetë foto të ndryshme të kohës me shi.

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 2. Mësuesi/ja orienton nxënësit të përshkruajnë fotografitë, duke dhënë sa më shumë hollësi.

Ushtrimi 1. Nxënësit plotësojnë pyetjet dhe i përgjigjen me fjali të plotë.

Çfarë dite është sot? Sot është ditë e hënë.
Si është koha sot? Sot është kohë me shi.
Ku do të shkosh me prindërit? Unë do të shkoj te gjyshja.
Me se do të shkosh? Unë do të shkoj me autobus.
Kur do të ktheheni ju? Ne do të kthehemi në mbrëmje.

Ushtrimi 2. Plotësojnë fjalitë sipas modelit.

Ku është pema? Pema është në pyll.
Si është pema? Pema është e gjelbëruar.
Ku është dielli? Dielli është në qiell.
Si është dielli? Dielli është i ngrohtë.
Ku është molla? Molla është në degë.
Si është molla? Molla është e kuqe.
Ku është trëndafili ? Trëndafili është në oborr.
Si është trëndafili ? Trëndafili është i bukur.
Ku është rosa? Rosa është në liqen.
Si është rosa? Rosa është e vogël.

Hapi 3. Nxënësit lexojnë plotësimet e fjalive që kanë bërë dhe diskutojnë me njëri – tjetrin për pyetjet dhe përgjigjet e dhëna.

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 4. Shkrim i lirë.

Shkruaj një tregim të shkurtër me titull: ***"Ditë me shi"***

Ishte pranverë. Bashkë me prindërit kishin dalë shëtitje në park. Qielli sapo ishte mbushur me re të zeza. Papritur filloi të bubullinte. Filloi të binte një shi i rrëmbyeshëm. ne vrapuam dhe u strehuam në një strehë. Pas disa minutash shiu pushoi dhe retë u larguan. Ne vazhduan shëtitjen sërish.

Lexohen punët e nxënësve dhe diskutohet për punët më të mira.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Shkruan tregime të thjeshta nisur nga figurat e dhëna.
- ✓ Përshkruan me fjalët e tij si e kupton një pikturë, një pamje apo një fotografi.
- ✓ Pyet për t'u sqaruar rreth tekstit që do të shkruajë.

Detyrë shtëpie:

1. Vizato një ditë me shi.
2. Shkruaj pesë pyetje dhe pesë përgjigje duke përdorur: Çfarë? Si? Ku? Me së? Kur?

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1
Tema mësimore: Kush? Çfarë? Ku? Si? Pse? faqe 80		**Klasa:** 1
Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe** Nxënësi: ➢ ***(3) Kompetenca e të nxënit: Ndjek udhëzimet e dhëna në një tekst për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë, që kërkohet. ➢ ***(3) Kompetenca e të nxënit:*** Grumbullon dhe klasifikon materialet e performancës së vet, për përgatitjen apo pasurimin e portofolit personal. ➢ ***(5) Kompetenca personale:*** Bashkëpunon me të tjerët pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitetet në klasë, shkollë apo jashtë saj.		**Fjalë kyçe:** *Fjalë, fjali, pyetje, përgjigje.*
***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:** Nxënësi: - Shkruan pyetje duke përdorur përemrat pyetës: Kush? Ku? Kur? Çfarë? Si? Pse? - Plotëson fjalë që mungojnë në fjali, duke përshtatur intuitivisht foljen ndihmëse jam me përemrat vetorë. - Dallon përemrat vetorë: unë, ti, ai, ajo, ne, ju, ata, ato.		**Teknika dhe strategji:** ❖ Lojë me etiketa ❖ Diskutim paraprak ❖ Punë e pavarur ❖ Punë në dyshe
- **Burimet e informacionit dhe mjete:** Njohuritë paraprake të nxënësve, fletore pune, libra jashtëshkollorë, etiketa me përemrat pyetës: Kush? Ku? Kur? Çfarë? Si? Pse?		**Lidhja me fushat e tjera:** Edukim për shoqërinë

SITUATA E TË NXËNIT

Përshkrimi kontekstual i situatës:

- ***Veprimtari paraprake:***

Hapi 1. Mësuesi/ja ka përgatitur etiketa me kartonë me ngjyra në të cilat ka shkruar përemrat pyetës: Kush? Ku? Kur? Çfarë? Si? Pse?

Nxënësi duhet të formojnë pyetje me përemrat pyetës, shoku i bankës duhet të japë përgjigje.

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 2. Mësuesi/ja nxjerr disa foto të kthyera nga faqja e pasme dhe kërkon që nxënësit të drejtojnë pyetje të ndryshme. Pamjen e fotos e hap pak nga pak, me qëllim që nxënësve t'u shtohet interesimi dhe të pyesin vazhdimisht.

Hapi 3. Hapen fletoret e punës. Ngre nxënës që lexojnë kërkesat dhe diskutohet se si do të plotësohen ushtrimet. Theksohet se pyetjet marrin pikëpyetje në fund.

Ushtrimi 1.

Kush *është djali në foto?*

Çfarë *bën Artani?*

Ku *po e vendos letrën ai?*
Kush *është djali në foto?*
Çfarë *bën Iliri?*
Ku *po shkon me shpejtësi ai?*
Kush *është vajza në foto?*
Çfarë *bën Adela?*
Ku *është ulur ajo?*
Nxënësit krahasojnë pyetjet me njëri-tjetrin. Në fletoren e klasës shkruajnë përgjigjet.
Lexohen me zë të lartë.
Ushtrimi 2. Nxënësit plotësojnë fjalitë duke përshtatur intuitivisht foljen ndihmëse *jam* me përemrat vetorë:

Unë *jam* i fortë.	Ata *janë* shokë.
Ti *je* nxënëse.	Ju *jeni* duke biseduar.
Ai *është* i shqetësuar.	Ne *jemi* binjakë.

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 4. Mësuesi/ja kërkon nga nxënësit të formojnë fjali me përemrat vetorë unë, ti, ai, ajo, ne, ju, ata, ato, duke përdorur folje të ndryshme.
Nxënësit lexojnë fjalitë që kanë formuar.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Shkruan pyetje duke përdorur përemrat pyetës: Kush? Ku? Kur? Çfarë? Si? Pse?
- ✓ Plotëson fjalë që mungojnë në fjali, duke përshtatur intuitivisht foljen ndihmëse *jam* me përemrat vetorë.
- ✓ Dallon përemrat vetorë: unë, ti, ai, ajo, ne, ju, ata, ato.

Detyrë shtëpie:

1. Plotëso fjalitë sipas modelit:

Unë kam një libër të ri.	Ne ....
Ti ke	Ju ....
Ai ka	Ata ....

2. Formo pyetje me përemrat pyetës: Kush? Ku? Kur? Çfarë? Si? Pse? dhe shkruaj përgjigjet.

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla:** 1
Tema mësimore: Përshkruajmë stinët, Faqe 81		**Klasa:** 1
Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe** Nxënësi: ➢ ***(1) Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup ➢ ***(3) Kompetenca e të nxënit:*** Ndjek udhëzimet e dhëna në një tekst për të realizuar një veprim/aktivitet /detyrë, që kërkohet. ➢ ***(3) Kompetenca e të nxënit:*** Mbikëqyr në mënyrë të pavarur përparimin e vet në një detyrë, aktivitet duke përdorur teknika të ndryshme për gjetjen e gabimeve (si shënim të gabimeve - vështirësive) dhe i korrigjon ato derisa gjen zgjidhjen. ➢ ***(6) Kompetenca qytetare:*** Diskuton dhe në bashkëpunim me anëtarët e grupit vendos rregullat e punës në grup.		**Fjalë kyçe:** *Fjalë, fjali, tregim, përshkrim, pranvera, vera, vjeshta, dimri.*
***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:** Nxënësi: - Shqipton saktë dhe me intonacionin e theksin e duhur fjalët dhe fjalitë. - Përqendrohet në çështjet kryesore, kur rrëfen një ngjarje ose një përvojë të tijën para shokëve dhe shoqeve, mësuesve dhe prindërve. - Pyet, përgjigjet, shpreh mendimet, ndjenjat dhe emocionet e tij, si dhe diskuton në grupe të vogla për tema që i interesojnë.		**Teknika dhe strategji:** ❖ Punë në grupe ❖ Punë individuale ❖ Shkrim i lirë ❖ Rrjeti i diskutimit
Burimet e informacionit dhe mjete: Njohuritë paraprake të nxënësve, fletore pune, libra jashtëshkollorë, foto me pamje nga stinët e vitit.		**Lidhja me fushat e tjera:** Dituri natyre, Arte, Muzikë

SITUATA E TË NXËNIT

Përshkrimi kontekstual i situatës:

- ***Veprimtari paraprake:***

Hapi 1. Mësuesi/ja ndan klasën në grupe sipas stinës në të cilën kanë lindur, duke krijuar katër grupe të mëdha. Nxënësit bashkëbisedojnë për stinët dhe karakteristikat e tyre.
Secili grup përshkruan stinët e vitit, reciton vjersha ose bën një vizatim.
Mund të thuhen nga mësuesja dhe nxënësit gjëegjëza për stinët.

Janë tri motra e një vëlla, Ditë më shumë asnjë nuk ka.	Të parit thinjat era ia merr, I dyti plot lule trazuar, Tjera e nxehtë plot diell, E fundit me fruta ngarkuar, Ç'është?

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 2. Mësuesi/ja orienton nxënësit të përshkruajnë fotografitë, duke dhënë sa më shumë hollësi.
U.1. Nxënësit plotësojnë emrin e stinës dhe shkruajnë dy fjali për to. Përsëritet se fjalia fillon më shkronjë të madhe dhe në fund vendosim pikë.
U.2. Plotësojnë fjalitë:
Sot *bëra një shëtitje me shokët dhe shoqet.*
Në *pyll kundërmonte aroma e luleve dhe dëgjoheshin cicërimat e zogjve.*
Atje *qëndruam gjithë ditën.*
Sa *shumë u kënaqëm!*
Luajtëm *me fluturat dhe mblodhëm lule shumëngjyrëshe.*
Kur u kthyem *ndjeheshim të lumtur dhe plot energji.*
Hapi 3. Nxënësit lexojnë përshkrimet që kanë bërë dhe nxiten të japin mendim për punën e shokëve.
Hapi 4. Nxënësit përshkruajnë stinën që u pëlqen në formën e një teksti.
Duhet të kenë parasysh këto çështje:

- Moti
- Natyra
- Tiparet karakteristike
- Lulet
- Frutat
- Veshjet

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 5. Rrjeti i diskutimit

Cila stinë është më e bukur?
Pse?

Hapi 6. Dëgjohet kënga: "4 stinët"
Shoqërohet me lëvizje trupore.

Vlerësimi i situatës:
Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- ✓ Shqipton saktë dhe me intonacionin e theksin e duhur fjalët dhe fjalitë.
- ✓ Përqendrohet në çështjet kryesore, kur rrëfen një ngjarje ose një përvojë të tijën para shokëve dhe shoqeve, mësuesve dhe prindërve.
- ✓ Pyet, përgjigjet, shpreh mendimet, ndjenjat dhe emocionet e tij, si dhe diskuton në grupe të vogla për tema që i interesojnë.

Detyrë shtëpie:

1. Mëso përmendësh një vjershë për stinën tënde të preferuar.
2. Bëj një vizatim për stinën tënde të preferuar.

Refleksione:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla: 1**
Tema mësimore: Vlerësim përmbledhës		**Klasa: 1**
Rezultatet e të nxënit sipas* kompetencave kyçe** Nxënësi: ➢ ***(3) Kompetenca e të nxënit: Ndjek udhëzimet e dhëna në një tekst për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë, që kërkohet ➢ ***(3) Kompetenca e të nxënit:*** ○ Mbikëqyr në mënyrë të pavarur përparimin e vet në një detyrë, aktivitet duke përdorur teknika të ndryshme për gjetjen e gabimeve (si shënim të gabimeve - vështirësive) dhe i korrigjon ato derisa gjen zgjidhjen. ○ Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes.		**Fjalë kyçe:** *Test, shkronja, fjalë, fjali. plotëso,*
***Rezultatet e të nxënit* të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:** Nxënësi: - Lexon kërkesat e ushtrimeve në mënyrë të vetëdijshme. - Shkruam fjalë, fjali me shkrim dore ose shtypi. - Bën analizë - sintezë të fjalëve, fjalive.		**Teknika dhe strategji:** ❖ Diskutim paraprak ❖ Punë individuale ❖ Analizë – sintezë e fjalëve, fjalive
Burimet e informacionit dhe mjete: Njohuritë paraprake të nxënësve, fletë testimesh të fotokopjuara, shkronjat kolektive.		**Lidhja me fushat e tjera:** Matematikë

SITUATA E TË NXËNIT

Përshkrimi kontekstual i situatës:

- ***Veprimtari paraprake:***

Hapi 1. Mësuesi/ja njeh nxënësit me temën dhe kujton se çfarë është Testi, cili është qëllimi dhe rëndësia e tij. Përsëriten rregullat e sjelljes gjatë detyrës me shkrim dhe punës individuale.
Bëhet përsëritje e shkronjave të alfabetit të gjuhës shqipe.

- ***Veprimet në situatë***

Hapi 2. Mësuesi/ja ndan fletët e ushtrimeve të fotokopjuara më parë sipas dy grupeve.
Jep këshilla të qarta për çdo ushtrim. Nxit nxënësit të lexojnë me vetëdije kërkesat. Këshillon nxënësit të veprojnë me kujdes çdo etapë të ushtrimeve, duke i udhëzuar nxënësit hap pas hapi.
Hapi 3. Nxënësit punojnë të pavarur testin. Mësuesi/ja kalon pranë bankave dhe udhëzon nxënësit, sidomos ata që shfaqin vështirësi. Nxënësit duhet të shkruajnë me shkronjat e shtypit ose të dorës, sipas dëshirës me përjashtim të ushtrimeve ku është i detyrueshëm shkrimi i dorës.
Megjithatë është mirë që nxënësit të ushtrohen më shumë në punën me shkrim dore.
Ushtrimi 1. Nxënësit duhet të plotësojnë të dhënat individuale me shkrim dore ose shtypi. (rekomandohet me shkrim dore).
Ushtrimi 2. Mësuesi/ja duhet të këshillojë nxënësit të lexojnë me vëmendje tekstin për të kuptuar përmbajtjen. Nxënësit plotësojnë alternativen e saktë, përkatësisht

- *c)*
- *b)*
- *a).*

Ushtrimi 3. Nxënësit duhet të renditin si duhet fjalët në fjali.

Dallëndyshja ndërton folenë në pemë.

Ushtrimi 4.

Emra njerëzish	Emra kafshësh	Emra sendesh
nxënës	lopa	lapsi
vajzë	qeni	fletore

Ushtrimi 5.

Mua më pëlqejnë shumë qershitë. Ato piqen në muajin qershor. Kanë ngjyrë të kuqe dhe janë shumë të ëmbla. Kanë një bërthamë të vogël në mes dhe kanë tul të butë.

Ushtrimi 6.

Ku janë nxënësit?

Nxënësit janë në klasë.

Çfarë po bëjnë ata?

Ata po dëgjojnë mësuesin.

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 4. Mblidhen fletët, nxiten nxënësit të diskutojnë për vështirësitë dhe problemet që kanë pasur. Mësuesi/ja mban shënime që të përmirësohen më tej.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

Nxënësi:

1. Lexon kërkesat e ushtrimeve në mënyrë të vetëdijshme.
2. Shkruam fjalë, fjali dhe plotëson kuptimin e tyre.
3. Bën analizë - sintezë të fjalëve, fjalive.

Detyrë shtëpie:

Shkruaj nga një tekst me titull: *Një ditë në bibliotekë.*

Refleksione:

TEST VJETOR **ABETARE**

1. Plotëso *(5 pikë)*

Mua më quajnë _____ _____

dhe jam në _____ _____ _____

Mami im quhet_____

Mësuesja ime e ka emrin_____.

2. *Lexo me vëmendje tekstin e mëposhtëm.* *(3 pikë)*

Të premten, nxënësit e klasës së parë shkuan në Teatrin e kukullave. Atje panë shfaqjen "Piter Pan". Sapo u fikën dritat, në sallë ra qetësia. Fëmijët ndiqnin me vëmendje lojën e aktorëve. Artani filloi të qeshte me zë të lartë. Besa e qortoi me zë të ulët. Artani e kuptoi gabimin dhe u skuq. Fëmijët ndoqën të qetë shfaqjen.

Plotëso:

- Fëmijët shkuan në teatër: a) të hënën b) të dielën c) të premten
- Ata panë shfaqjen: a) Pinoku b) Piter Pan c) Kësulëkuqja
- Qetësinë e prishi: a) Artani b) Besa c) Teuta

3. *Rendit fjalinë si duhet.* *(4 pikë)*

ndërton	folenë	Dallëndyshja	në	pemë

_____

_____

4. *Plotëso tabelën e mëposhtme.* *(6 pikë)*

Emra njerëzish	Emra kafshësh	Emra sendesh

5. *Përshkruaj <u>frutën</u> që të pëlqen më shumë.* *(4 pikë)*

_____

_____

_____

_____

6. *Shkruaj 2 pyetje për figurën dhe përgjigju me fjali të plotë.* (*4 pikë*)



_____

_____

_____

_____

_____

_____

_____

Shkallët e vlerësimit	1 Arritje të pakënaqshme	2 Arritje që kanë nevojë për përmirësim	3 Arritje të kënaqshme	4 Arritje shumë të kënaqshme	5 Arritje të shkëlqyera

Vlerësimi sipas pikëve	0-6	7-12	12-16	17-21	22-26